RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN

(FINANCIAR DHE I PËRPUTHSHMËRISË)

“BASHKIA KAMËZ”

Tiranë, Prill 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**5**
a.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	5
b.	Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij	5
c.	Qëllimi i auditimit	5
d.	Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave	6
e.	Nga shqyrtimi i evidencave	6
f.	Paraqitja e gjetjeve kryesore	6
h.	Paraqitja e rekomandimeve kryesore	8
I.1	Konkluzion dhe Opinioni i auditimit	9
II.	**HYRJA**	**12**
1.	Objekti i auditimit	12
2.	Qëllimi i auditimit	12
3.	Identifikimi i çështhes	13
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	13
5.	Përgjegjësitë e audituesve	13
6.	Kriteret e vlerësimit	14
7.	Standardet e auditimit	15
8.	Metodat e auditimit	15
9.	Dokumentimi i auditimit	17
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**18**
1.	**InforM on i përgjithshëm mbi subjektin**	**18**
2.	**Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**.....	**18**
2.1.	**Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik**.....	18-38
	2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, Infrmimi dhe komonikimi si dhe monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.	
	2.1.2. Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm Publik.	
	2.2.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.	
2.2	**Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**	38-121
	2.2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.	
	2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.	
	2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës Covit 2019, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi. Niveli i realizimit të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre.	
	2.2.4. Vlerësimi i rrisqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike të detajuara me nr. fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të grandeve si FZHR, Ministritë e linjës etj.).	
	2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;	
	2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.	
2.3.	**Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**	121-149
	2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;	
	2.3.2. Plotësiae shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të	

	pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.	
	2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.	
	2.3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.	
2.4.	**Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.**	149-251
	2.4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve;	
	2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara;	
	2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe, për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.	
	2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.	
2.5.	**Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit**	251-263
	2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.	
	2.5.2. Auditim mbi mandat pagesat dhe ballafaqimime fletën e përllogaritjes së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj.	
2.6.	**Mbi organiizmin dhe funksionimin e Inspektoriatt Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV) .....**	263-273
	2.6.1. Auditim mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa lejeve hvillimore.....	
	2.6.2. Auditimi mbi ekzekutimet e vendimeve të IMTV, për subjektet të cilët kanë kryer kundërvatje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV	
	2.6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërine kushteve të ejeve tëndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit	
2.7.	**Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....**	273-275
	2.7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.	
	2.7.2 Realizimi programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.	
	2.7.3 Statusi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm.	
2.8.	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	275
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	278
V.	ANEKSET	323-334

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informate.
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
IT	Teknologjia e InforM onit.
NJA	Njësi Administrative.
AK	Autoriteti Kontraktor.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.

I. PMBJEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e Kamëzit është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave Bashkia Kamëz ndodhet 7 km larg kryeqytetit, Tiranës, në veriperëndim të saj. Kufizohet nga veriu me Kamëzn, nga jugu me Tiranën, nga lindja me Zall-Herrin dhe nga perëndimi me Bërxullin. Terreni në përgjithësi është i sheshtë, me një pjerrësi të lehtë drejt veriperëndimit. Zona ndodhet në një kuotë që varion nga 80-90 m mbi nivelin e detit në pjesën jugore, që zbret në 45 m mbi nivelin e detit, pranë aeroportit të Rinasit në pjesën veriore. Përshkohet nga rruga kombëtare që lidh kryeqytetin me veriun e vendit. Kamëza ndodhet në trekëndëshin strategjik: kryeqyteti Tiranë - aeroporti i Rinasit - porti i Durrësit. Kamza ka një sipërfaqe prej 37.18 km2, popullsia është 133,499 banorë dhe ka dy njësi administrative:

Bashkia Kamëz pas ndarjes së re territoriale përfshin nën administrimin e saj edhe njësinë administrative Paskuqan.

Misioni i Bashkisë Kamëz është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Kamëz si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Kamëz si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim finanacimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qéllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, përperiudhën 01.01.2022 - 31.12.2022. Për të giitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime pér përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Kamëz. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

- mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit, Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.
Metodogjia e përdorur për kryerjen e kétij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% té transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe tekNt e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nënauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 49 gjetje dhe ka dhënë 66 rekomandime, nga ku masa organizative me 33 gjetje dhe 37 rekomandime, 6 gjetje masa shpërblim dëmi dhe ka rekomanduar 7 në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve në vlerën **2,455,061 lekë** dhe, 10 gjetje të ardhura të munguara dhe ka rekomanduar 22 masa në vlerën 1,202,818 mijë lekë në fushën e të ardhurave.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me*:*

- **Procedurat e zbatimit të kontratave të punimeve të N t**
  - Në **6 raste**, nga auditimi i kontratave për punë publike për periudhën e auditimit 01.01.2022 – 31.12.2022 në vlerën totale **344,620,116 lekë pa TVSH ose 413,544,139 lekë me TVSH**, u konstatuan zëra pune të pakryera në volumet e situacionuara si dhe realizim i tyre jo në përputhje me specifikimet teknike në vlerën **2,455,968 lekë pa TVSH**, në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7, si dhe Kontratat përkatëse të zbatimit, **respektivisht për:**

- Vlera **779,673 lekë pa TVSH**, përfaqëson penalitet për punime të kryera jashtë afatit të kontratës Nr. 2399 Prot., datë 25.03.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve OE "A& P" SHPK.
- Vlera 772,800 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera në volumet e situacionuara dhe realizim zëra pune të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike në kontratën nr. 7477 prot., datë 23.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve BOE "N" SHPK & "B" SHPK me objekt "Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza".
- Vlera 195,763 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera në volumet e situacionuara në kontratën nr. 6910 prot., datë 01.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve OE "SH" SHPK me objekt "Rruga "Roskovec", segmenti 1,2 + Rr. "Florida" + Rr. "Rekjaviku" + Rr. "Berlin"+ Rr. "Skrapari" + Seg. Te rruga "Xhorxh Bush" + Seg. 1 te Blv. "Donald Tramp" + seg. 2 te Blv "Donald Tramp" + seg. 3 te Blv "Donald Tramp" + seg. 4 te Blv. "Donald Tramp" + Rr. "Altruisti" Rr. "Drita".
- Vlera 272,732 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera në volumet e situacionuara në kontratën nr. 7477 prot., datë 23.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve OE "A" SHPK me objekt "Rikonstruksion i rrugës Skënderbeu".

- Vlera 120,000 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike në kontratën nr. 7673 prot., datë 31.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve OE "E" SHPK me objekt "objekt "Rr. "William Shekspir" + Rr. "Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" + Rr. "Toni Bler" + Rr. "Iball" + Rr. "Daniel Alia".

- Vlera 360,000 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të pakryera në volumet e situacionuara dhe realizim zëra pune të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike nr. 7691 prot., datë 31.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve OE "N" SHPK me objekt "Nd. Rr. "Albanët" + Rrugicat në Valias + Rr. "Këmbanët" + Trotuaret në Rr. "Amsterdam", Valias i Ri".

- ***Procedurat e prokurimit publik*** për punë publike, mallra dhe shërbime:

Nga auditimi i **14** (katërmbëdhjetë) procedurave të prokurimit me objekt "Punë publike/Mallra", me vlerë të fondit limit 2,587,063,960 lekë pa TVSH dhe, kontrata të lidhura në vlerën 2,552,138,835 lekë pa TVSH të zhvilluara gjatë vitit 2022 në Bashkinë Kamëz, është konstatuar se NJP jo vetëm ka hartuar kërkesa për kualifikim të cilat nuk stimulojnë pjesëmarrjen e OE në garë, por janë kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe Dokumentet e Tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, ***ku ndër më kryesore janë***:

- NjP në **4** (katër), raste në përcaktimin e numrit të punonjësve ka përdorur standarde të dyfishta, konkretisht, për punime të së njëjtës natyrë është kërkuar një numër më i madh punonjësish në procedura me fond limit (volum punimesh) më të vogël në krahasim me numrin e punonjësve të kërkuar për një procedurë tjetër me fond limit (volum punimesh) më të madh.
- NjP në **4** (katër) raste ka kërkuar që OE duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë e cila të përfshijë kategorinë NP-7 (A) Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje, kriter i cili nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv.
- NjP në **2** (dy) raste ka kërkuar që në personelin kryesor, drejtues në licencën e shoqërisë OE të ketë 1 inxhinier mekanik, kriter i cili nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv.
- NjP në **1** (një) rast ka kërkuar që në personelin kryesor, drejtues në licencën e shoqërisë OE të ketë 1 saldator dhe 1 mekanik, kriter i cili nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv.
- NjP në **6** (gjashtë) raste ka kërkuar që për realizimin e kontratës, duhet të disponojë (1) Impiant Betoni automatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi dhe (2) nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi. Kërkesa të ekzagjeruar me natyrën dhe objektin e kontratës.
- NjP në **2** (dy) raste ka kërkuar që për realizimin e kontratës, duhet të disponojë (1) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton dhe (2) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi.
- NjP në **4** (katër) raste ka kërkuar që AK të vlerësojë ofertën ekonomike më favorshme, bazuar në kosto dhe, jo në çmim, duke mos krijuar kushte për një vlerësim objektiv të OE/BOE pjesëmarrës në garë, sipas peshës specifike për çdo kriter dhe nënkriter.
- NjP në **2** (dy) raste ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një kontrate të lidhur me një laborator për këtë objekt, i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analizat e materialeve (Beton i freskët dhe i ngurtësuar, përzierje bituminoze, materiale rrugore, gur natyror). Ky kriter është i tepërt, sepse kryerja e analizave është parashikuar në DT (Shtojca 16 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK), neni 13 "Testimet dhe Inspektimet".

- NJP në **3** (tre) raste ka kërkuar që OE ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listë pagesat e shoqërisë për periU të ndryshme. Konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar.
- NJP në të gjitha rastet ka kërkuar një numër të pa-argumentuar të makinerive/pajisjeve. Nuk ka asnjë analizë teknike ku sasia e makinerive/pajisjeve të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volume e tyre apo grafikun e punimeve.
- Në **1** (një) rast nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje makinë MZSH" KVO duhej të ishte anuluar kjo procedurë, sepse OE i shpallur fitues është nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të vendosura nga AK.
- Në **2** (dy) raste, për procedurat "Blerje makinë MZSH" dhe Në procedurën "Blerje peleti" mbi përllogaritjen e FL, janë marrë oferta nga tregu nga OE që në statusin e aktivitetit të tyre nuk kanë lidhje me objektet dhe natyrën e procedurës.

- ***Procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit***

- Në **5 (pesë)** raste nuk janë respektuar **kondicionet urbane** të parashikuara në ligj, siç janë hapësirat e dedikuara për parkim në raport me numrin e banorëve, **distancat nga ndërtimet** e tjera dhe nga kufiri i pronës, tipologjia e lejuar e ndërtimit e përcaktuar në dokumentet e planifikimit, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike.
- Në **6 (gjashtë) raste,** projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore, si: [Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjektit dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), për të gjithë hartuesit e projekteve ndërtimor; Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projekteve: konstruktiv; studimi sizmiko-gjeologjik; studimi gjeologo-inxhinierik; Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale për hartuesit e studimit gjeologo-inxhinierik dhe rilevimit topografik; Licenca profesionale e hartuesit të rilevimit topografik; Projekti arkitektonik nuk është i plotë në formatin DWG].
- Në **3 (tre) raste** Bashkia Kamëz dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) **nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike** që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

- ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

- Të ardhura të munguara në vlerën 771,305,000 lekë nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit, institucioneve dhe familjare.
- Të ardhura të munguara në vlerën 297,508,794 lekë ndaj 8,608 personave nga mosarkëtimi i e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje.
- Është konstatuar mos menaxhimin i mirë i të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, si në planifikim dhe arkëtim, duke evidentuar të ardhura të munguara (borxhit tatimor) për taksapaguesit familjarë dhe privat në shumën 1,211,818 mijë lekë.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Kamëz në lidhje me ***zbatimin e kontratave të punimeve të ndërtimit*** të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga sipërmarrësit e punimeve arkëtimin e vlerës prej **2,455,968 lekë pa TVSH,** të faturuara dhe të paguara nga AK, të konstatuar dëm ekonomik nga mos kryerja e punimeve. Të merren masa që për të gjitha punët publike, të kryhet Oponenca Teknike para fillimit të procedurës së prokurimit.
- Bashkia Kamëz ***në lidhje me të ardhurat e munguara***, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën **1,211,818 mijë** lekë nga taksapaguesit të biznesit, institucione shtetërore, familjarë, fermerë, individë etj.

- Bashkia Kamëz dhe Agjencia e Shërbimeve Publike në lidhje ***me procedurat e prokurimeve publike*** të marrin masat e nevojshme, që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet. AK për punët/mallrat/shërbimet të cilat është e mundur ndarja e saj në lote, të marrë masa për hartimin e kërkesave të veçanta për secilin lot, për rritjen e konkurrencës dhe efikasitetin. Në procedurat e prokurimit në vijim, të kryejë përllogaritjen e saktë të vlerës së kontratës. Gjatë hartimit të regjistrave të prokurimit, të grupojë emërtimin e procedurave me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve buxhetore. Titullari i AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST në kualifikimin e OE, e cila përëbën risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.
- Nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve (DPULMI) ***në lidhje me lejet ndërtimit***, të merren të gjitha masat për të respektuar kondicionet urbane, ku në çdo rast të ruhen distancat nga kufiri i pronës sipas përllogaritjes së parashikuar në rregullore. Të kërkojë cdo subjekti që aplikohon për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi dhe të ngarkuar në sistemin elektronik. Në cdo rast që aplikohet për leje ndërtimi,të merret mendimi i autoriteteve, të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Të marrë të gjitha masat për të përllogaritur në mënyrë të saktë sipërfaqen ndërtimore me funksion banim e pjesë takuese të sipërfaqeve të përbashkëta për çdo aplikim për pajisje me leje ndërtimi.

I.1. Konkluzion dhe Opinioni i auditimit.

I. <u>Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022</u>:

Grupi i auditimit të KLSH-^{së}, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Kamëz për periudhën ushtrimore 01.01.2022– 31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të parashkruara në paragrafin e "Bazës për **opinion me rezervë**" pasqyrat financiare vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit Bashkia Kamëz më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrit rregullator; Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA$^{\text{-të}}$). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Kamëz, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar

është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).
Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 është 110,757 mijë lekë.

Përshkrimi i çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

-Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" është mbivlersuar për vlerën 4,512,483 lekë pasi në të përfshihet vlera prej 4,272,483 lekë që i përket llogarisë 212 "Ndërtesa e Konstruksione" dhe vlera prej 240,000 lekë që i përket llogarisë 211 "Pyje e plantacione" të cilat në mbyllje të pasqyrave financiare janë nënvlersuar për vlerat përkatëse.

-Nga auditimi ka rezultuar se 1809 prona të transferuara me VKM nuk janë të rregjistruara në ASHK dhe nuk janë pasqyruar në kontabilitet në inventarin e aktiveve afatgjata.

II. Opinioni i auditimit mbi përputhshmërinë.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Kamëz për periudhën 01.10.2022 deri më 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Kamëz.

Pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në përfundim rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, efektet e të cilave janë *materiale por jo të përhapura*, të cilave justifikojnë dhënien e një ***opinioni të modifikuar"***.

*"Ne opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Kamëz janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur **janë materiale por jo të përhapura** dhe justifikojnë dhënien e një **opinioni të modifikuar**, e shprehur kjo në bazën për opinion.*

Baza për opinionin:

Nga auditimi i **14** procedurave të prokurimit publik, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, shkelje të cilat kanë konsistuar në këto mangësi:

-Në **14 raste**, kriteret e veçanta për pranim/kualifikim nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP, pasi janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe jo të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, veprime jo në përputhje kuadrin rregullator në fushën e procedurave të prokurimit.

-Në procedurat e prokurimit të audituara me fond limit në vlerën 2,258,063,960 lekë pa TVSH (14 procedura), rezultoi se ulja nga fondi limit është realizuar në vlerën 2,552,138,835 lekë pa TVSH ose % lëviz rreth 2 %.

-Në **1** rast, në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik me vlerë **10,728,000 lekë pa TVSH**, në mosplotësim të të gjitha kritereve të vendosura në dokumentet standarde të tenderit nga AK, duke u shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin në fushën e prokurimeve.

-Në **5** raste, në zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatuan punime të situacionuara jo në përputhje me faktin në vlerën **1,676,295 lekë** dhe, në **1** rast në zbatimin e kontratës së

shërbimit, u konstatua penalitet në vlerën **779,673 lekë** për mos realizim sipas afatit të përcaktuar në kontratë.
-Në **2** raste, u konstatua se nuk është kryer oponenca teknike për projektin e zbatimit me objekte "Ndërtim Rr. Frutikulturë (Rr. pingul me Rrugën Azem Galica + Rr. "Isuf Gervalla" + Rr. "Brezaret" dhe "Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza", në kundërshtim me Ligjin nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6 .
- Është konstatuar mos menaxhimin i mirë i të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, si në planifikim dhe arkëtim, duke evidentuar të ardhura të munguara (borxhit tatimor) për taksapaguesit familjarë dhe privat në shumën **1,202,062 mijë lekë.**
- Janë konstatuar anomali në moszbatim e plotë të akteve ligjore e nënligjore të MFK, në të gjithë komponentët e tij, dhe mos zbatim i plotë i rekomandimeve të lëna nga KLSH, në Auditimin e mëparshëm.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kamëz:
Strukturat drejtuese të Bashkisë Kamëz, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Kamëz janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për drejtimin dhe për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme[1], nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në
përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

[1] *ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.*

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 873/1, datë 10.10.2023, i ndryshuar me nr. 873/2 prot, datë 21.11.2023; ndryshuar me nr. 873/3 prot, datë 14.12.2023 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 13.10.2023 deri në datën 29.12.2023, për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022 në subjektin Bashkia Kamëz, u krye auditimi "Mbi Auditimin Financiar dhePërputhshmërie" nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S.M, *Përgjegjës Grupi*
2. A.F, Auditues
3. B.Sh, Auditues
4. S. J, Auditues
5. J.G, Auditues
6. A.Ç, Auditues
7. A.Z, Auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat e auditimit.

Është dhënia e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

-nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullat dhe ligjet e kontabilitetit;

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në zbatim të ligjit të Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

-auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit financiar për pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord të procedurave të prokurimit, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e Rekomandimeve për përmirësime.

2. Qëllimi i auditimit..

Është dhënia e opinionit dhe hartimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe inforM onet janë, në të gjitha aspektet materiale ose jo dhe në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (**ISSAI 1315)** .

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim opinionin tonë mbi pasqyrat financiare, të shpenzimeve operative dhe investimeve mbi bazën e procedurave të prokurimit të realizuara për to, si dhe menaxhimit të të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

3. Identifikimi i çështjes.

Ky Raport Përfundimtar Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kamëz, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiare në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kamëz, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj

5. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, etj.)

e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në Bashkinë Kamëz, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

6. Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:
- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "*Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*
- Kushtetuta e Republikë së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, me ndryshime;
- Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*".
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes Vendore".*
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"; i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.
- Ligji nr. 10450, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me ndryshime;
- Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr. 114/2015 "Për Auditimin e brendshëm në sektrin publik";
- Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen Administrativo – territoriale të Njësive të Qverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social";
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve Të Ndërtimit", i ndryshuar;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", indryshuar;
-VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar;
-VKM nr. 187, datë 08.03.2021 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit qendror të zgjedhjeve, Gjykatën e lartë, Prokurinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kyeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", i ndryshuar;
- VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencavepër tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj";
-VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa lehe dhe vlerave të zbatueshme për legalizim";
-UMF nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar;
-Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 "*Për miratimin e manualit të MFK*".
-Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*"
- Udhëzimi MF nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023";
- UMF nr. 2, datë 27.09.2019 "Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore".
-Udhëzimi nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyrjen e detyrimeve të prapambetura", i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2021 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit";
- UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, etj.

- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Rregullore “Mbi procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, daë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së e ndryshuar.
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Kamëz”;
- Vendimi nr. 5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave Bashkia Kamëz”;

7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”*që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 1000-2999 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”;
- ISSAI 1300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”;
- INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”*si dhe INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”;
- ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”*që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me
kontekstin specifik te auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë".
- Standarded Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditit të Brendshëm, etj.

8. Metodat e auditimit.

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periUsh. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve

dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

- *Kontrolli aritmetik*

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- *Kontrolli i vlerësimeve*

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmimi nga të tretët*

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- *Kontrolli sipas një treguesi*

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- *Intervista*

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Berat me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

- *Raporte dhe Informacione*

U shqyrtuan raporte, inforM one dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim

- *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të

influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja[2].

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe nëinspektime fizike; nëobservime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informaconit te personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra si dhe çështje të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura për përgatitjen e Projekt Raportit të Auditimit.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe përgatitjen më pas, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Evidencat mbështetëse si dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Auditimit, janë pjesë e Projekt Raportit të Auditimit dhe më pas për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

[2] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm ∗ Risku i kontrollit ∗ Risku i Zbulimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi Menaxhimi financiar dhe kontrollin e brendshëm.

2.1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, Infrmimi dhe komonikimi si dhe monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

2.1.2 Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm Publik.

2.1.3 Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

I. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një koncept i rëndësishëm, i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- inforM oneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Kamëz, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

<u>Komponenti "Mjedisi i kontrollit"</u>

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

<u>Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:</u>

Parimi 1 – Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike;

Parimi 2 – Titullari/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje;

Parimi 3 – Titullari/ Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë;

Parimi 4 – Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave;

Parimi 5 – Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Kamëz në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
-Nga auditimi i përgjigjeve të dhëna në pyetësorin e vetëvlerësimit, konstatohet se institucioni vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me Vendimin nr. 4119 prot., datë 11.05.2022 "Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz". Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.
-Kodi i Etikës është miratuar si një shtojcë e rregullores së brendshme, në mbështetje të ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik.
-Një problematikë e evidentuar lidhur me këtë parim është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.
-Me shkresën nr. 154 prot., datë 11.01.2019 është miratuar "Rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Kamëz" dhe "Rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Kamëz".
Gjatë vitit 2022 janë marrë 29 masa disiplinore:
23 "vërejtje" për shkelje të rregullave të etikës;
6 masa disiplinore të dhëna nga propozimet e KLSH;
-Lidhur me marrjen e masave për zbatimin e procedurave antikorrupsion, vlen të theksojmë se bashkia i zbaton kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin për sinjalizuesit, *por ende nuk ka procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla.*
-Për rastet e raportimit lidhur me ankesat për korrupsion, funksionon Autoriteti Përgjegjës, ngritur pranë bashkisë, në përputhje me kërkesat e ligjit 9367, datë 07.04.2005 *"Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike"*, i ndryshuar.
-Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore, bashkëpunon me zyrtarët raportues dhe zyrtarin autorizues në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil. -Bëhen dy vlerësime gjatë vitit kalendarik, vetëm për nëpunësit civil në periudhë prove vlerësimi është një vjeçar (kur përfundon periudha e provës).

Parimi 2 -Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
-Për vitin 2022, situata paraqitet pjesërisht efektive*, ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga një pjesë e drejtorive, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, treques performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion.*
-Bashkia Kamëz ka hartuar raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si edhe në Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë (MFE). *Mungon Plani i Veprimit për kontrollin e brendshëm dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij Plani;*
-Me Vendimin nr. 105 datë 1.02.2022 "Mbi miratimin e strategjisë së riskut" Kryetari i bashkisë Kamëz ka miratuar Strategjinë e Riskut të hartuar nga GMS.
-Nëpërmjet shkresës nr. 1819/1 prot., datë 23.02.2023 është dërguar pranë MFE-së "Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm".

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.
-Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrësi qeverisjes bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë.
-Për periudhën objekt auditimi, janë zhvilluar **8** mbledhje online dhe **18** mbledhje në sallën e Këshillit Bashkiak**.** Këshilli Bashkiak Kamëz, ka miratuar **174** vendime të paraqitura në formë tabele si vijon:

Muaji	Nr. i mbledhjeve	Mbledhje të radhës	Mbledhje jashtë radhe	Mbledhje të jashtëzakonshme	Vendime
Janar	2	1 (17.01.2022)	1 (28.01.2022)	-	11
Shkurt	2	1 (03.02.2022)	1 (18.02.2022)	-	15
Mars	3	1 (11.03.2022)	1 (18.03.2022) 1 (29.03.2022	-	16
Prill	1	1 (19.04.2022)	-	-	10
Maj	2	1 (09.05.2022)	1 (19.05.2022)	-	7
Qershor	3	1 (03.06.2022)	1 (17.06.2022) 1 (30.06.2022)	-	26
Korrik	3	1 (14.07.2022)	1 (19.07.2022) 1 (27.07.2022)	-	16
Gusht	1	1 (17.08.2022)	-	-	7
Shtator	2	1 (07.09.2022)	1 (29.09.2022)	-	17
Tetor	2	1 (14.10.2022)	1 (24.10.2022)	-	12
Nëntor	1	1 (25.11.2022)	-	-	11
Dhjetor	4	1 (05.12.2022)	1 (09.12.2022) 1 (16.12.2022) 1 (21.12.2022)		26
Totali	**26**	**12**	**14**	**-**	**174**

Burimi: Bashkia Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organi gramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit te delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.
-Titullari i Bashkisë ka udhëzuar organizimin institucional për menaxhimin e procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm nëpërmjet udhëzimit nr. 3024 datë 24.03.2021 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024"
-Dokumenti përfundimtar i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2022-2024 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 132 datë 22.12.2021. Ky dokument bashkë me Instrumentin e Planifikimit Financiar, është përcjellë në MFE nëpërmjet shkresës nr. 5605 prot., datë 28.05.2021.
-Me shkresën nr. 10877 prot., datë 18.06.2021, MFE ka përcjellë mendimet mbi PBA 2022-2024 të Bashkisë Kamëz.
-Për vitin 2022 janë hartuar **3** raporte monitorimi, përkatësisht për 4 mujorin e I-rë, 8 mujorin e II-të (progresivi) dhe vjetori, të përcjella në MFE me shkresën nr. 1710 prot., datë 21.02.2023.
-Bashkia Kamëz ka miratuar planin 5-vjeçar për strehimin social me VKB nr. 14 datë 15.07.2022. Plani rregullues i bashkisë është miratuar me VKB nr. 86 datë 14.07.2022 dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 01 datë 27.07.2022.

-Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se janë organizuar takime me drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve, si dhe janë organizuar takime me palët e treta si me grupet e interesit nëpërmjet dëgjesave me publikun.
-Nëpërmjet shkresës nr. 4814 prot., datë 10.05.2021, bashkia ka miratuar Planin e Masave dhe Veprimit "Për fazën përfundimtare të përgatitjes së programit buxhetor përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024".
-Gjatë vitit 2022 janë organizuar **8** Dëgjesa Publike, ku morën pjesë qytetarë, përfaqësues të komunitetit, grupe të interesuara, subjekte, institucione shtetërore, të zgjedhur vendore, përfaqësues të biznesit, shoqëri civile etj., të cilët përfshinë të gjithë territorin e bashkisë.
-Institucioni vepron mbi bazën e rregullores së brendshme e miratuar me Vendimin nr. 4119 prot., datë 11.05.2022 "Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz" e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
-Me Vendimin nr. 79 datë 26.01.2022 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz" për vitin 2022 është miratuar struktura e përbërë nga **266** punonjës, ndër të cilat **38** vende të lira dhe **228** vende të plotësuara. Kjo strukturë ka ndryshuar me vendimin nr. 203 prot., datë 24.02.2022, me vendimin nr. 262 prot., datë 15.03.2022, dhe vendimin nr. 405 prot., datë 04.05.2022.
-Përgjatë vitit 2022 janë rekrutuar **85** punonjës të rinj dhe janë larguar **33** punonjës. *Nga auditimi rezulton se në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni , nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës.*
-Me shkresën nr. 266/15 prot., datë 27.12.2022, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) i ka dërguar bashkisë, raportin përfundimtar të mbikëqyrjes dhe vendimin e tij në lidhje me ligjshmërinë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira dhe vlerësimin e nëpunësve civil.
Disa nga problematikat e evidentuara në këtë vendim janë:
-Gjatë realizimit të procedurave për përgatitjen dhe propozimin e strukturës së re organizative të bashkisë, nuk janë vlerësuar me përgjegjësi tiparet e çdo pozicioni pune, në raport me shërbimin civil;
-Në disa raste, nuk është verifikuar nga njësia përgjegjëse, nëse përmbushur detyrimet ligjore gjatë periudhës së provës, të parashikuara në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, për të vijuar më pas me deklarimin e punonjësve " nëpunës civil", nëpërmjet një akti administrativ të posaçëm, që është vendimi i eprorit;
- 26 punonjës janë emëruar nëpërmjet konkurrimit, por në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligj. Aktet e emërimit për këta punonjës të kategorisë ekzekutive, janë nxjerrë duke mos respektuar procedurat administrative për rekrutimin në shërbimin civil, të sanksionuara në nenet 22, 23, 24, dhe 25 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar;
-16 punonjës të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, të pranuar nga jashtë shërbimit civil janë emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 26/4 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.
-Nëpërmjet shkresës nr. 53/7 prot., datë 12.06.2023, KMSHC ka dërguar vendimin për përfundimin e verifikimit lidhur me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 145 datë 27.12.2022.
-Bashkia Kamëz ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.
-Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku konstatohet se bashkia përdor procedurat për delegimin e detyrave, kryesisht atë të delegimit në mungesë. Delegime ka me aktin nr. 469

prot., datë 15.09.2021, me aktin nr. 579 prot., datë 07.11.2021 dhe aktin nr. 887 prot., datë 15.11.2022.

Struktura e Bashkisë Kamëz për vitin 2022

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	**266**	Nëpunës Civilë	**139**
		Nëpunës me kontratë	**127**
Numri i të punësuarve me kontratë provizore	2	-	-
Vende vakante	38	-	

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Parimi 4 -Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

-Nga auditimi i dosjeve të rekrutimit përgjatë periudhës objekt auditimi, sa i takon procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, *nuk është realizuar procesi i vlerësimit në përputhje me procedurat e hollësishme të përcaktuara në VKM-në nr.109, datë 26.02.2014, i ndryshuar.*

-Nga kontrolli i dokumentacionit me përzgjedhje, konstatohet se nuk ka përfunduar procesi i vlerësimit për periudhën e provës dhe formularët e vlerësimit nuk janë pjesë e dosjes së secilit punonjës në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, të parashikuara në VKM-në nr. 243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar.

-Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, *bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.*

-Trajnime për menaxhimin financiar dhe kontrollin janë zhvilluar vetëm për punonjësit e Drejtorisë së Financës.

-Nga institucioni është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. *Nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.*

-Janë trajnuar 5 punonjës të policisë bashkiake pranë ambienteve të Akademisë së Sigurisë Tiranë në trajnimin me temë: "Për formimin dhe kualifikimin e punonjësve të policisë bashkiake".

Për vitin 2022 janë kryer nga ASPA **63** trajnime ku kanë marrë pjesë **20** nëpunës të institucionit.

-Komiteti i Auditimit është ngritur me urdhrin nr. 527 prot., datë 24.06.2022. Përgjatë vitit 2022 Komiteti i Auditimit ka zhvilluar 6 mbledhje dhe ka marrë 6 vendime.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, rezulton se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme.

-Gjithashtu, evidentohet se njësia publike ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë.

-Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

-Për vitin 2022, me shkresën nr. 152 prot., datë 7.02.2022, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 152 datë 7.02.2022 *"Për ndryshimin e grupit për Menaxhimin Strategjik në Bashkinë Kamëz"*. Në këtë urdhër është ngritur GMS me 22 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë.
GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informaci
onit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. Bashkia Kamëz zhvillon takimet e GMS, dhe këto takime dokumentohen me procesverbale.
-Me shkresën nr. 1819/1 prot., datë 23.02.2023 është dërguar pranë MFE "Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Kamëz dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm" për vitin 2022. Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë. ***Referuar kësaj deklarate, bashkia ka parashikuar të marrë këto masa për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit:***
-Për të siguruar përmbushjen e objektivave të institucionit të bashkisë në fushën e MFK dhe përmirësimin dukshëm të këtij sistemi do të përdoren burime njerëzore e materiale, duke synuar efektivitet maksimal për realizimin e veprimtarive të klasifikuara me prioritet të lartë, në Planin Strategjik dhe Vjetor dërguar në njësinë Qendrore të Harmonizimit të MFK/AB.
-Futja e sistemeve të reja IT, rritja e cilësisë së kryerjes së funksioneve dhe raportimit, zbatimi i legjislacionit të pushtetit vendor dhe Menaxhimi i Kontrollit Financiar, nëpërmjet rishikimit të brendshëm të cilësisë kërkojnë trajnim të vazhdueshëm.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20;
-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.1 "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK" a, b, c, d, pika 2.3.1;
-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Kreu II. "Dosja e Personelit";
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.1, Kapitulli IV "Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit", Kapitulli V, Anekset.

Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siGtë arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 6 – Specifikimi i objektivave të përshtatshëm.
Parimi 7 – Identifikimi dhe analiza e risqeve.
Parimi 8 – Mundësia e riskut të mashtrimeve.
Parimi 9 – Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.
Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA /

Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.
-Nga auditimi i të dhënave, duke marrë në konsideratë se bashkia duhet të specifikoj dokumentet e planifikimit, njësia ka përgatitur PBA, në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin.
Është e rëndësishme që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.
Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.
-Bashkia ka hartuar Planin e Masave për daljen nga gjendja e problemeve nëpërmjet procesverbalit nr. 2167/1 datë 29.07.2022 'Për hartimin e Planit të Masave për daljen nga gjendja e problemeve'
-Me shkresën nr. 4814 datë 10.05.2021 është ngritur një plan masash dhe veprimi për fazën përfundimtare të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2022-2024.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.
-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se përgjithësisht institucioni ka përcaktuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.
-*Evidentohen problematikanë hartimin e regjistrit të konsoliduar të risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Kamëz si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre.*
-Me Urdhrin nr.152, datë 07.02.2022, është ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe është hartuar regjistri i riskut nga disa prej strukturave të Bashkisë Kamëz. Regjistri i riskut është miratuar me aktin nr. 279 datë 02.07.2020 dhe strategjia e riskut është miratuar me vendimin nr. 105 datë 1.2.2022 "Për miratimin e Strategjisë së Riskut".
-Me Urdhrin nr. 48, datë 19.01.2022 "Për menaxhimin dhe koordinimit e riskut në bashkinë Kamëz" është caktuar si koordinatore risku Zj. U.E e cila është pjesë e strukturës së bashkisë në pozicionin e Zv. Kryetare. Nëpunësi Autorizues funksionet e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar i ka deleguar tek zj. R.B e caktuar me urdhrin nr. 244 prot., datë 11.03.2022.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.
-Nga auditimi evidentohet se Bashkia Kamëz nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.
-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar.
-Bashkia Kamëz ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime

strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2;

-Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 3 "Përgjegjësitë dhe detyrat e KR", pika 3.2.1 "Titullari i njësisë publike" pika 4 "Hapat për ngritjen e sistemit të MR"

-"Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.

Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siGtë arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 10 – Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit.

Parimi 11 – Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.

Parimi 12 – Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

-Në vijim të auditimit të kryer, mund të themi se ende ka problematika për t'u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e hartave apo manualeve të proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive. Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

-Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezulton se hartë dhe manual të proceseve të punës ka vetëm një prej drejtorive të bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit. Manuali i proceseve të punës është miratuar nga kryetari i bashkisë me shkresën nr. 283/1 prot., datë 14.01.2022, harta e proceseve të punës miratuar me shkresën nr. 284/2 prot., datë 14.01.2022.

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

-Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person. Detyrat janë të ndara. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Përgjegjësi i Buxhetit. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Specialisti i financës për kontabilizimin dhe autorizimi i pagesës nga Drejtori i Financës.

Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", bashkia i ka të qarta procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.)

-Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP.... dhe krijimi i tyre në sistemin e PP" është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjistër është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.

-Bashkia Kamëz ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Nëpërmjet VKB nr. 36 datë 20.03.2020është miratuar rregullorja e menaxhimin e aktiveve.

-Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit.

-Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" i ndryshuar.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

-Bashkia Kamëz ka një server për menaxhimin e sistemit të taksave të shtrirë edhe në Njësitë Administrative. Ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it, procedurë që e realizojnë nëpërmjet prokurimit të shërbimit me kontratë me kompaninë Besimes InforM on Systems Softëare, Institucioni përdor edhe sisteme të tjera të It-së si E-Lejet, sistemin e zyrës me një ndalesë, sistemin e pagesave me thesarin. Me aktin nr. 76/1 prot., datë 08.02.2021 është miratuar rregullore e brendshme e IT.

-Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

-Bashkia i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.

-Me Vendimin nr. 36 datë 20.03.2020, bashkia ka miratuar rregulloren "Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktivëve, inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivëve, dhe strategjinë e menaxhimit të riskut të aktivëve në Bashkinë Kamëz.

-Bashkia Kamëz nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

Gjurma e auditimit

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.
Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë.
Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.
-Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, bashkia ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara me vendimin nr. 394 datë 26.08.2020, e cila përmban disa nga proceset kryesore të punës. *Gjurma e auditimit nuk është ndërtuar sipas përcaktimeve të bëra në aneksin nr. 4 të Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.*
Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj.
Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;
-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 5.2.7 "Monitorimi dhe Raportimi";
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

Komponenti: "Informimi dhe komunikimi"

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.
Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 13 – Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i inforM onit përkatës cilësor.
Parimi 14 – Komunikimi i brendshëm
Parimi 15 – Komunikimi i jashtëm

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të auditimit, rezulton se bashkia i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.
-Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi , si brenda dhe jashtë institucionit por *ky sistem i raportimit nuk jep inforM on për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.*
-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.
-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.
-Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas programeve dhe projekteve.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.
-Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, proces verbalet e mbledhjeve u komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.
-Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë.
-Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.
-Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresor apo në rrugë elektronike nëpërmjet aksesit në adresat zyrtare të e-mailit.
-Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të inforM onit.
-Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 23, "InforM oni dhe Komunikimi" pika 2;
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

Komponenti: "Monitorimi"

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.
Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:
Parimi 16 – Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe/ose të veçanta;
Parimi 17 – Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.
-Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.
-Raportohet mbi baza periodike pranë MFE dhe GMS për veprimtarinë financiare referuar parashikimeve të PBA-së.
-Bashkia Kamëz monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar me shkresën nr. 1819/1 prot., datë 23.02.2023 në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE.
-Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit tëAuditimit të Brendshëm, performuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm . NJAB ka kryer auditim mbi MFK i cili është formal dhe pa u thelluar analitikisht për çdo subjekt të audituar.
-Bashkia Kamëz nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këtë bashki.
-Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.
-NJAB ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2022.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.
-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, "Monitorimi" pika 1;
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Përsa i përket sistemit të MFK: Gjatë auditimit të kryer në Bashkinë Kamëz, u konstatua se institucioni duhet të bëjë më shumë përpjekje në implementimin e kërkesave të MFK-së, dhe të përfshihet në këtë proces i gjithë stafi i bashkisë. Pyetësori i vetëvlerësimit të këtij institucioni paraqet situatën reale të tij në lidhje me këtë fushë, ku mbi 80 % e përgjigjeve të pyetësorit janë të besueshme.
Funksionimi i sistemit të MFK ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Bashkia ka ngritur një sistem pjesërisht efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk është hartuar Plani i Veprimit për kontrollin e brendshëm dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij Plani. Nuk është hartuar një regjistër i konsoliduar risku, dokumenti i listës (hartës) së proceseve të punës, nuk është përditësuar sipas kërkesave të parashikuara në ligj dokumenti i gjurmës së auditimit, nuk është hartuar një dokument i mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këtë bashki.

Titulli i Gjetjes : Në Bashkinë Kamëz funksionimi i sistemit të MFK ka shfaqur disa mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht.

Situata:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, Bashkia Kamëz ka ngritur një sistem pjesërisht efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Funksionimi i sistemit të MFK ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht.

Rregullorja e Brendshme ka një konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar edhe kompetencave e akteve nënligjore në fuqi akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

Mjedisi i kontrollit

-Bashkia Kamëz nuk ka hartuar plan veprimi për kontrollin e brendshëm dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij Plani;

-Nuk është hartuar një program trajnimi i mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, kodit të etikës etj., përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

-Mungojnë raportimet e rregullta periodike nga një pjesë e drejtorive, raportime të cilat nuk duhet të jenë të përqendruara vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion;

-Në dosjet e personelit ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

Menaxhimi i Riskut

-Evidentohen problematika në hartimin e regjistrit të konsoliduar të risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Kamëz si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre;

-Bashkia Kamëz nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues;

Aktivitetet e Kontrollit

-Mungojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive;

-Nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit;

Gjurma e auditimit nuk përfshin të gjitha proceset kryesore të punës dhe nuk është ndërtuar sipas përcaktimeve të bëra në aneksin nr. 4 të Manualit për MFK-në;

Informimi dhe komunikimi

- Sistemi i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj;

Monitorimi

-Bashkia Kamëz nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi;

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit"; Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Impakti: Mosnjohja e plotë dhe sa duhet e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" nga niveli i lartë drejtues i kritereve të MFK, ka sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: E mesme

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: (1) z. **R.S**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kamëz; (2) zj. **R.H**, në cilësinë e Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore; (3) zj. **U.E,** në cilësinë e ish zv. Kryetare e Bashkisë Kamëz (e deleguar si koordinatore e Riskut në Bashkinë Kamëz); (4) zj. **R.B**, në cilësinë e specialistes së strukturës së Drejtorisë së Financës dhe Kontabilitetit (e deleguar si koordinatore MFK në Bashkinë Kamëz).

II. Organizimi, përbërja dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm

Nënpika 2.1.2 dhe 2.1.3 e programit të auditimit.

Të përgjithshme:

Në zbatim të Ligjit Nr.114/2015, datë 20.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:

"*Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në germat a-c të kësaj pike"*, është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Auditit të Brendshëm (DAB) në varësi funksionale nga Titullari i Bashkisë Kamëz,duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

Kjo drejtori përgjatë periudhës objekt auditimi, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit nr. 79 dt. 26.01.2022, duke pasur në strukturën e saj 1 (një) Drejtor i Auditit të Brendshëm zj. B.Ddhe 4 (katër) specialiste auditi, nga këto 3 specialiste, zj. E.V, zj. V.Adhe zj. A.D.SH nuk janë të certifikuara si Audituese të Brendshme.

Bashkia Kamëz në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së saj dhe përmbushjes së objektivave të vendosura ka miratuar rregulloren e brendshme me nr. 4115 prot., datë 11.05.2022 *"Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz".* Në nenin 22 të kësaj rregulloreje janë përcaktuar mënyra e organizimit, kuadri ligjor, përgjegjësitë e drejtuesit të NJAB dhe audituesve të brendshëm, detyrat funksionale të tyre etj.

Stafi auditues u intervistua lidhur me njohuritë mbi rolin, përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë e tyre për shërbimin që ofrojnë, ku u evidentua se eksperienca profesionale e dy prej auditueseve është me pak se 3 (tre) vite në profesion dhe 0 (zero) vite në fushën e auditimit. Kanë përfunduar çertifikimin 2 (dy) auditues dhe janë në proçes certifikimi 2 (dy) auditues të tjerë. Rezulton se 1 (një) audituese është e pa certifikuar.

Struktura e njësisë AB për vitin 2022

Nr	PeriU	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/ vite	Certifikimi	Trajnime te vijueshme
	Për vitin 2022							
1	B.D	Drejtore	09.05.2005	Ekonomik	26	17	2008	05-09.12.2022
2	R.M	Auditues	05.01.2010	Ekonomik	33	14	2011	05-09.12.2022
3	E.V	Audituese	13.07.2021	Juridik	8	1	-	-
4	V.A	Audituese	03.03.2022	Ekonomik	3	0	-	-
5	A.D	Audituese	03.03.2022	Adm.Financiar	3	0	-	-

Burimi: NJAB Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Trajnimet e NjAB dhe certifikimet

Audituesit e brendshëm duhet të zgjerojnë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përgjegjësia për trajnimin nuk është vetëm e drejtuesit të auditimit të brendshëm ose struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit, por çdo auditues duhet të përditësojë individualisht njohuritë dhe aftësitë e veta mbi zhvillimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi tekNt dhe praktikat e reja të auditimit.
Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve të NJAB sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.
Për vitin 2022 trajnimet e audituesve të NJAB për Bashkinë Kamëz pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

Titulli i Gjetjes nr. 1: Burimet në dispozicion të strukturës audituese kanë mungesë të përvojës së punës në auditim. Kjo mbart riskun e pamjaftueshmërisë së burimeve për arritjen e objektivave në sasi por mund të cënojë dhe cilësinë e auditimeve.

Situata:
Nga auditimi u konstatua se burimet në dispozion të strukturës audituese kanë mungesë të përvojës së punës në profesion dhe të përvojës në auditim. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se audituese A. D. (Sh.) është punësuar në institucion në datë 03.03.2022 pa eksperience profesionale dhe në fushën e auditimit. Eksperienca të mëparshme në punë ka patur në detyra si shitëse, arkëtare. Audituese V. B. (T.) është punësuar në institucion në datë 03.03.2022 pa eksperiencë profesionale dhe në fushën e auditimit. Eksperienca të mëparshme në punë ka patur në detyra si shitëse dhe magaziniere.
NJAB në Bashkinë Kamëz, ka rekrutuar 2 (dy) audituese të cilat nuk kanë eksperiencë profesionale në fushën e auditimit në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, pika c të ligjit 114/2015 "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" që përcakton se: Audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si Auditues i Brendshëm dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm;
NJAB në Bashkinë Kamëz nuk ka filluar procesin e certifikimit për 1 (një) audituese në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, pika (ç) të ligjit 114.2015 "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik".
Kriteri: Ligji nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar.

Impakti: Rekrutimi i stafit auditues pa eksperiencë profesionale dhe në fushën e auditimit nuk jep siguri të mjaftueshme për përmbushjen dhe zbatimin e ligjit për funksionin dhe detyrat që ka auditi i brendshëm.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit rregullator të fushës.
Rëndësia: E mesme

Komiteti i Auditit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj,është krijuar nga Bashkia Kamëz me Urdhrin nr.527, datë 24.06.2022.
Komiteti i Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2022 ka zhvilluar 6 (gjashtë) mbledhje dhe ka marrë 6(gjashtë) vendime si më poshtë vijon:
-Vendimi nr.1 datë 13.07.2022 "Për miratimin e rregullores së KAB";
-Vendimi nr.2 datë 13.07.2022 "Për miratimin e kalendarit të mbledhjeve të KAB për vitin 2022";
-Vendimi nr.3 datë 27.09.2022 "Dhënie mendimi për kartën e AB";
-Vendimi nr.4 datë 29.09.2022 "Dhënie mendimi për programin e sigurimit të brendshëm të cilësisë";
-Vendimi nr.5 datë 07.10.2022 "Vlerësim pozitiv për planin strategjik 2023-2025 dhe planin vjetor të AB miratimin e rregullores së KAB";
-Vendimi nr.6 datë 18.10.2022 "Rekomandim për ndryshimin e planit vjetor të angazhimeve për vitin 2022".

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.
NJABnë mbështetje të Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik"* ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" në Bashkinë Kamëz e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr. 8823. prot., datë 30.09.2022 dhe rezulton se është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016".

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.

Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:
*"Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën **10 Tetor të çdo viti**. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data **20 Tetor e çdo viti**, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm….."*
Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publik edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm.

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik 2022-2024. Plani strategjik për vitet 2022-2024 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2022 janë miratuar me Urdhrin nr. 520, datë 15.10.2021 dhe janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.9747 prot., datë 15.10.2021, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe Urdhërin e Ministrittë Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2022

Nga auditimi rezultoi se:

Në planin vjetor të auditimit për vitin 2022, miratuar me shkresën nr. 9747 prot., datë 15.10.2021, janë programuar për auditim drejtori brenda strukturës së Bashkisë dhe institucione në varësi të saj.

Programi fillestar përfshin 8 misione auditimi të shërbimit të sigurisë, nga të cilat: 1 auditim i llojit "Të Përputhshmërisë" dhe 7 të llojit "Të Kombinuar"(financiare dhe të përputhshmërisë).

Në periudhën raportuese Plani vjetor i angazhimeve është rishikuar, bazuar në relacionin e hollësishëm të NJAB, ku janë shpjeguar arsyet e ndryshimeve të cilat janë miratuar me Urdhrin nr.9673, datë 21.10.2022 *"Për miratimin e ndryshimeve në planin vjetor 2022 të veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, të Bashkisë Kamëz"*

Për ndryshimet në planin vjetor është njohur dhe ka dhënë mendim pozitiv Komiteti i Auditimit të Brendshëm me Vendimin nr. 6 datë 18.10.2022.

Për vitin 2022, janë planifikuar për t'u kryer 8 auditime kundrejt 8 auditimeve të programuara, pra plani vjetor është realizuar 100%, nga të cilat 7 auditime paraqiten në statusin "*Angazhime të përfunduara*"dhe1 auditim në statusin "*Auditim në proces*".

Ndryshimi i Planit Vjetor të NJAB është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 9673/1 prot., datë 21.10.2022.

Për aktivitetin e vitit 2022 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 1470 prot., datë 14.02.2023.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2022, rezulton se janë dhënë 26 rekomandime gjithsej, prej të cilave 19 rekomandime janë të karakterit organizativ dhe 7 rekomandime "Për arkëtim" të cilat janë pranuar nga subjektet objekt auditimi. Nga rekomandimet e pranuara janë në proces zbatimi 6 prej tyre. Për Drejtorinë e Projekteve & Investimeve deri më datë 31.12.2022 është hartuar projekt raporti dhe nuk është hartuar raporti përfundimtar i auditimit, rekomandimet nuk janë raportuar. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Pranuar	Zbatuar	Në proces	Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2022	26	26	20	6	2	-	-	-
TOTALI		**26**	**26**	**20**	**6**	**2**	-	-	-

Burimi: NJAB Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën objekt auditimi, rezulton se programi i auditimit (strategjik dhe vjetor) është hartuar në linjë me synimet e bashkisë dhe bazuar nëkritere si:

-Fushat me risk te lartë;

-Kërkesat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;

-Objektivat e institucionit;

-Kërkesat e titullarit të bashkisë.

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB

Grupi auditimit duke patur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2022, zgjodhi të auditojë dosjet të cilat janë vlerësuar nga DAB me nivel të lartë risku siç janë:

-dosja e auditimit të kryer në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike*;*

-dosja e auditimit të kryer në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore";

-dosja e auditimit të kryer në Drejtoria e Strehimin dhe Emergjencave Civile*;*

-dosja e auditimit mbi "Zbatimin e rekomandimeve për vitin 2021".

Konkluzion:

-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;

-NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimi i dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;

Dosja e auditimit mbi "Zbatimin e rekomandimeve për vitin 2021"

Gjatë verifikimit të rekomandimeve të dhëna gjatë 2021 janë verifikuar dhe vlerësuar gjithashtu statusi i rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme.

Në mbështetje të planit vjetor të miratuar për vitin 2022 me Urdhrin nr. 520, datë 15.10.2021, ka qenë planifikuar edhe 1 angazhim auditimi, me objekt: "Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve".

Në auditimet e kryera gjatë vitit 2021 janë dhënë gjithsej **41** rekomandime të cilat janë pranuar nga subjektet objekt auditimi. Nga rekomandimet e pranuara janë në proces zbatimi **8** rekomandime prej tyre dhe nuk ka rekomandime të pazbatuara. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

ReferuarRaportit të Auditimit rezulton se:

Niveli i zbatimit të rekomandimeve, për periudhën2021 paraqitet si më poshtë:

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	2021	41	33	8	0	-	-	-	-
TOTALI		**41**	**33**	**8**	**0**	**-**	**-**	**-**	**-**

Burimi: NJAB Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka marrë në shqyrtim dhe ka mbikqyrur proçesin e monitorimit e ndjekjes së rekomandimeve të dhëna si nga struktura e auditimit të brendshëm, ashtu edhe nga KLSH.

Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm , si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë , vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kamëz ka miratuar me shkresën nr.8824 prot.,, datë 30.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë *"Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm"* dhe kryen vlerësimet e brendshme të cilësisë.

Programi për sigurimin e cilësisë është shqyrtuar nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm, i cili ka dhënë mendim pozitiv me Vendimin nr.4 datë 29.09.2022.
Nga shqyrtimi i këtij programi dhe anekseve përkatëse rezulton se janë të përcaktuar indikatorët e performacës, dhe evidentohet se anekset mbi monitorimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së njësisë, janë hartuar në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm.
Është hartuar rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashki në përputhje me ligjin nr. 60/2016 *"Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit".*
Janë hartuar regjistri i sinjalizimit të brendshëm dhe regjistri i kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja si detyrim ligjor i njësisë së auditimit në përputhje me ligjin nr. 60/2016 *"Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit".*

Dosja e përhershme
Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet.
Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:
-NJAB në Bashkinë Kamëz, ka rekrutuar 2 (dy) audituese të cilat nuk kanë eksperiencë profesionale dhe në fushën e auditimit në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, pika (c) të ligjit 114.2015 *"Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"* që përcakton se: *Audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si Auditues i Brendshëm dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm;*
-NJAB në Bashkinë Kamëz nuk ka filluar procesin e certifikimit për 1 (një) audituese në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, pika ç të të ligjit 114.2015 *"Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"*;
-Në çdo raport auditimi, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;
-NJAB në periudhën objekt auditimi ka kryer auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe vlerësimii dhënë për sistemin e kontrollit të brendshëm është formal, i të njëjtit format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara;

Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi: (1.zj. **B.D**, në cilësinë e Drejtoreshës e NJAB; 2.zj. **E.V,** në cilësinë e auditueses në NJAB; 3.zj. **V.A,** në cilësinë e auditueses në NJAB; 4.zj. **A.D,** në cilësinë e auditueses në NJAB; 5.z. **R.M,** në cilësinë e audituesit në NJAB: 6.zj. **R.H,** në cilësinë e Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore).

Nga përfaqësuesit e Bashkisë Kamëz, zj. R.H, me shkresën nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024, janë paraqitur observacione përkatësisht si në vijim:
Pretendimi i subjektit:
Zj. R.H, paraqet pretendimet si vijon:
Sa konstatuar në pikën II (organizimi dhe funksionimi i DAB), sqarojmë se:
Për emërimin e punonjësve është ndjekur procedura ligjore bazuar në legjislacionin e shërbimit civil.
Për pozicionin specialist auditimi është bërë shpallja e pozicionit të punës të Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Konkretisht për zj. E.V, më datë 06.05.2021 është bërë shpallja e vendit të punës për specialiste auditi ku me datë 18.05.2021 është njoftuar mbyllja e

procedurës pa u paraqitur asnjë kandidat. Është vazhduar procedura ku më datë 24.06.2021 është bërë shpallja dhe më datë 29.06.2021 është njoftuar mbyllja e procedurës pa u paraqitur asnjë kandidat. Në këto kushte kur nuk paraqiten kandidat që plotësojnë kriteret ka qenë e nevojshme plotësimi i strukturës me punonjës. Në lidhje me certifikimin e audituesve dy punonjëset (E.V dhe A.D) kanë vazhduar procesin e certifikimit dhe më datë 20.07.2023 janë pajisur me certifikatë me titullin "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik". Është komunikuar me Ministrinë e Financave ku do të bëhet certifikimi i audituesve të pa certifikuar sapo të na njoftojë ministria për fillimin e certifikimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH-së sqarojnë se:
Pranimi i kandidates E.V, në pozicionin e *"Specialistit të Auditit"* pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, pika c të Ligjit nr. 114.2015 *"Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"* (në fuqi në vitin 2022) që përcakton se: Audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si Auditues i Brendshëm dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm.
Në observacionet tuaja, ju nuk keni paraqitur dokumentacion shtesë, për pajisjen me certifikatë me titullin "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik" për punonjësen E.V. Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

2.2. MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT.

(2.2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor; - 2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura; -2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës Covit 2019, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi; -Niveli i realizimit të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre; -2.2.4 Vlerësimi i rrisqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike të detajuara me nr. fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të grandeve si FZHR, Ministritë e linjës etj.); -2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre; -2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.)

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit, u konstatua si vijon:

- **Dokumentacioni i audituar si më poshtë:**

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministritë e Linjës;
2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Tiranë për shpenzimet dhe të ardhurat;

4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendimeve gjyqësore;
6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimit të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin "Excel", si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).

➢ **Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua si më poshtë vijon:**

2.1. Programimi PBA-së dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022:

Nga auditimi i proçedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) me urdhër të Titullarit të institucionit, i cili për periudhën nën auditim rezulton me Urdhër nr. 330 datë 16.06.2021 dhe shkresën nr. 3304 prot., datë 16.06.2022. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se GMS përbëhet nga 19 anëtarë dhe se janë ngritur dhe miratuar 11 EMP për Bashkinë Kamëz.
Një shpërndarje e programeve buxhetore për vitin 2022 sipas funksioneve/nën funksioneve që NJVQV/Bashkitë janë përgjegjëse për ushtrimin e tyre të atribuar me Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", pasqyrohen në (***Aneksin nr. 2, Tabela nr. 1***).

Nga analiza e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, **rezultoi** se ka funksione/nënfunksione të cilat nuk kanë apo të jenë përfshirë në asnjë program buxhetimi si: F- "në fushën e mbrojtjes së mjedisit", "Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të kujdesit të shëndeti publik", F- "në fushën e zhvillimit ekonomik vendor" etj. Pra vihet re se nuk ka një harmonizim të planifikimit buxhetor të atyre nënfunksioneve që edhe pse u përkasin funksioneve të ndryshme, me një studim dhe analizë profesionale do të mbështesnin apo plotësonin njëra tjetrën, me qëllim realizimin në tërësi të shërbimeve ndaj komunitetit dhe territorit që mbulon Bashkia Kamëz.

Në mijë lekë

Nr.	Nënfunksioni	PROG	Emertimi i programit	Plani viti 2022	Fakti viti 2022
1	011	01110	Planifikim , menaxhim dhe administrim	434,291	326,226
2		01170	Gjendja Civile	6,964	6,665
3	031	03140	Sherbimet e Policise Vendore	21,068	16,722
4	032	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	194,677	158,316
5	041	04130	Mbeshtetja per zhvillim ekonomik	-	-
6	042	04220	Sherbimet bujqesore , inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve	11,952	7,003
7		04240	Menaxhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit	14,047	9,596
8		04260	Administrimi i Pyjeve e Kullotave	572	-
9	045	04520	Rrjeti rrugor rural	1,099,683	851,666
10		04570	Transporti publik	8,135	8,107
11	051	05100	Menaxhimi i Mbetjeve	221,048	175,134

12	061	06140	Planifikimi Urban Vendor	59,235	48,386
13	062	06260	Sherbimet Publike Vendore	61,989	27,497
14		06260	Sherbimet Publike Vendore (Nd.e pastrim gjelberimit)	120,199	106,470
15		06260	Sherbimet Publike Vendore (Nd. sherbimeve publike)	80,255	61,001
16	063	06370	Furnizimi me uje dhe kanalizime	287,100	287,100
17	081	08130	Sporti dhe argetim	22,685	19,503
18	082	08230	Trashigimia kulturore , eventet artistike dhe kulturore	35,600	25,671
19	091	09120	Arsimi baze perfshire parashkollorin	1,106,713	993,083
20	092	09230	Arsimi i mesem i pergjithshem	408,999	334,882
21	104	10430	Perkujdesi social	769,622	744,040
22	106	10661	Strehimi social	644,841	554,219
	15	**22**	**T O T A L I**	**5,609,673**	**4,761,286**

Burimi: Bashkia Kamëz

Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore*", Ligjin nr. 115/2014 "*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*", Ligjin nr. 9936/2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar me Ligjin nr. 57 datë 02.06.2016 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008*", Ligjin nr. 9652/2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, Ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetqeverisjes vendore*", Ligji nr. 9920/2008 "*Për proçedurat tatimore në RSH*", Udhëzimi Nr. 2 datë 06.02.2012 "*Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", Udhëzimi nr. 27 datë 26.02.2021 "*Për përgatitjen e PBA 2022-2024*", Udhëzimi plotësues nr. 23 datë 30.07.2018 "*Për proçedurat standarde të përgatitjes së PBA të NJVQV*", Ligji nr. 152/2015 "*Për shërbimin e Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi*" VKM nr. 165/2016 "*Për grupimin e e NJVQV për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave t pagave të funksionarëve të zgjedhur të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVQV*" i ndryshuar me VKM nr. 177 datë 08.03.2017, VKM nr. 929 datë 17.11.2010 "*Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë*" i ndryshuar, Ligji nr. 107/2014 "*Për planifikimin e territorit*" i ndryshuar, Ligji nr. 9970 datë 24.07.2008 "*Për barazinë gjinore*" i ndryshuar, Ligji nr. 79/2017 "*Për sportin*", VKM nr. 1720 datë 29.12.2008 "*Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv*", Udhëzimi nr. 395 datë 05.08.2019 "*Për përforcimin e administratës së Këshillit Bashkiak*" si dhe VKB "*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë e Kamzës për vitin 2022*". Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion *(kontratat në vazhdim),* angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit)*, tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme)*.

Në mijë lekë

Emërtimi i shpenzimit	**Bashkia Kamëz**			**NPGJT**			**NSHP**		
	Plan	**Fakt**	**Diferenc**	**Plan**	**Fakt**	**Diferenc**	**Plan**	**Fakt**	**Diferenc**
600	537,543	463,458	74,085	71,794,	70,421	1,373	30,821	30,563	258
601	87,715	75,930	11,785	11,558	11,219	339	5,181	4,822	359
602	411,399	308,240	103,159	30,363	23,970	6,393	23,122	14,545	8,577
230-231	2,946,309	2,458,980	487,329	6,284	810	5,474	21,131	11,071	10,060
606	1,426,253	1,287,207	139,046	200	50	150	-	-	-
Shuma	**5,409,219**	**4,593,815**	**815,404**	**120,199**	**106,470**	**13,729**	**80,255**	**61,001**	**19,254**

Burimi: Bashkia Kamëz

Një inforM on i përmbledhur për Bashkinë Kamëz bashkë me njësitë e varësisë, lidhur me kërkesat buxhetore për secilin zë buxhetor, pasqyrohet në tabelën përmbledhëse si më poshtë:

Mijë lekë

Viti 2022			
Emërtimi i shpenzimit	**Plan**	**Fakt**	**Diferenca**
600	568,364	564,442	3,922
601	104,454	91,971	12,483
602	464,884	346,755	118,129
230-231	2,973,724	2,470,861	502,863
606	1,426,453	1,287,257	139,196
Shuma	**5,609,673**	**4,761,286**	**848,387**

Burimi: Bashkia Kamëz/DFK

Duke bërë analizën e pagave rezultoi se pesha specifike e këtyre llogarive (600-601) të shpenzimeve ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara, është 672,818 (312,040 + 50,069) mijë lekë ose 12% të totalit <u>në *vitin 2022*</u>;

- **Mbi konsultimet me komunitetin dhe grupet e interesit**

- Nga auditimi rezultoi se Bashkia Kamëz për PBA 2022-2024 dhe Projekt buxhetin e vitit 2022, *ka zhvilluar takime për konsultime* me grupet e interesit në komunitet, konform Ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Kreu I neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA 2022-2024 dhe Projekt buxhetit vjetor 2022 nga ana e Bashkisë Kamëz, është publikuar në faqen Zyrtare të Bashkisë në formatin e përshtatur për publikun:

/////////	**PBA 2022-2024**	**P.Buxheti 2022**	Bashkia Kamëz NJA Paskuqan Lagjja Bathore
Datat	26-27 prill 2021	16-26 maj 2021	

- Buxhetet janë hartuar mbi bazën e nevojave të 3 (tre) njësive administrative: Kamëz, Paskuqan dhe Bathore, të NSHP dhe NPGJT, si dhe gjithë njësive shpenzuese të strukturës së bashkisë, etj. DFK u dërgon zyrtarisht shkresën për të paraqitur kërkesat e tyre buxhetore për të planifikuar shpenzimet për vitin në vijim.

Në mijë lekë

Njësi Administrative& Njësi Varësie	**PBA 2022-2024/ Plani Buxhetit 2022**
	Vlera
NJQ Kamëz	**5,609,673**
NJA Paskuqan	
NJA Bathore	
Ndërmarrja e Pastrim, Gjelbërim, Treg - NPGJT	
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike - NSHP	

Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi rezultoi se në PBA-në 2022-2024 dhe Planin vjetor të buxhetit për vitin 2022, janë shprehur objektivat strategjikë të bashkisë, të cilat mbështetur në PPV[3] dhe PZHS, bëjnë planifikime buxhetore për ato programe të cilësuara si më prioritaret me projektet përkatëse. U konstatua se në PBA 2022-2024, Planin e buxhetit vjetor 2022 janë paraqitur projektet me këto specifikime: kodin, titullin dhe përshkrimin e shkurtër të projektit, afatin e zbatimit me fillimin dhe përfundimin e tij, vlerën etj, në zbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 29.

[3] Vendimi nr. 3 i KKT datë 17.05.2019 "Miratimi i PPV Bashkia Kamëz"

Nga informacioni dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion, lidhur me investimet në mënyrë të përmbledhur pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Investime nga të Ardhurat e Bashkisë Kamëz						
PeriU	Nr. investime	Vlera e kontratës	Planifikuar për tu paguar në vitin 2022	Paguar në vitin 2022	Nr. i investimeve të mbetura për tu paguar	Vlera e mbetur për tu paguar 2023 dhe 2024
2016	4	26,284,620		1,817,507	3	
2017	10	9,590,817		8,914,307	3	676,510
2018	14	78,676,818		72,007,503	3	
2019	27	353,561,830		262,748,537	12	90,813,293
2020	27	485,842,379		339,065,331	18	146,777,048
2021	9	317,762,017		185,560,320	8	132,201,697
2022	**42**	**1,661,483,356**	**239,663,693**	**120,446,170**	**37**	**119,217,523**
Nëntotali I	**133**				**90**	
Investime nga buxheti i shtetit dhe AKUM-i						
2021	5	1,073,331,832	221,600,000	221,600,000	5	560,556,998
2022	1	668,060	-	-	1	668,060
Nëntotali II	**6**	**1,073,999,892**			**6**	**561,225,058**
Totali I+II	**139**	**2,735,483,248**			**96**	**680,442,581**

Punoi: Grupi i Auditimit

Nga inforM oni i pasqyruar në tabelë, **rezulton** se për vitin 2022 janë planifikuar nga të ardhurat e vetë bashkisë 42 investime në vlerën 1,661,483 mijë lekë, janë paguar plotësisht sipas planit (likuidim) për 5 investime; paguar pjesërisht për 8 investime dhe për 29 investime nuk është bërë asnjë pagesë deri në 31.12.2022. Nga buxheti i shtetit janë planifikuar 5 investime në vitin 2021 dhe 1 investim për vitin 2022, me një afat 3 vjeçar të pagesës, sipas cdo situacioni të punimeve të kryera.

- Për projektet e mëparshme të cilat kanë përfunduar dhe për arsye mos likuidimi, janë klasifikuar në statusin e "detyrimeve të prapambetura[4]".
- Me Udhëzimin e Brendshëm nr. 2196 datë 03.03.2021 është hartuar plani i punës për përgatitjen e PBA 2022-2024 dhe miratuar nga kryetari i bashkisë. Me Urdhrin nr. 330 datë 16.06.2021 është përditësuar GMS dhe krijuar 11 EMP, hartuar dhe plani vjetor i takimeve të GMS mbi ndjekjen e procesit të hartimit të PBA 2022-2024.
- PBA 2022-2024 dhe Buxheti vjetor për vitin 2022 kanë pësuar këto ndryshime dhe janë miratuar në Këshillin Bashkiak si më poshtë:

Nr.	PBA 2022-2024	P.Buxheti 2022
1	VKB nr.132 date 22.12.2021	
		VKB nr. 42 date 29.03.2022
		VKB nr. 56 date 19.05.2022
		VKB nr. 60 date 03.06.2022
		VKB nr. 70 date 17.06.2022
		VKB nr. 85 date 30.06.2022
		VKB nr.119 date 29.09.2022
		VKB nr.127 date 14.10.2022
	1	**7**

Burimi: Bashkia Kamëz/DFK

[4] Informacioni i detajuar pasqyrohet te rubrika "detyrime të prapambetura"

a. Ngaq auditimi rezultoi se, nga Bashkia Kamëz janë hartuar e miratuar "Kalendarët e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor" për Bashkinë Kamëz dhe njësive të varësisë/administrative për vitin 2022, konform Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 33;
Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në Këshillin e Njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për proçedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.
b. PBA 2022-2024 dhe Plani vjetor i buxhetit për vitin 2022, është miratuar me VKB nr. 132, datë 22.12.2021; Buxheti fillestar për vitin 2022 ka pësuar 7 ndryshime, i cili është miratuar sipas VKB-ve për shtesa/pakësime apo përdorim fondesh në buxhet, të pasqyruara në tabelën e mësipërme dhe konkretisht: VKB nr. 42 datë 22.12.2021 "Për një ndryshim në VKB nr. 132 dt. 22.12.2021 Mbi miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2022, 2023, 2024"; VKB nr. 56 datë 19.05.2022 "Mbi miratimin e ndryshimit në VKM nr. 132/2021 të buxhetit të vitit 2022 dhe PBA bashkia Kamëz"; VKB nr. 60 datë 03.06.2022 "Mbi miratimin e ndryshimeve të VKM nr. 132/2021 të buxhetit të vitit 2022 dhe PBA të Bashkisë Kamëz"; VKB nr. 67 datë 17.06.2022 dhe VKB nr. 70 datë 17.06.2022 "Mbi miratimin e ndryshimit në VKM nr. 132/2021 të buxhetit të vitit 2022 dhe PBA bashkia Kamëz"; VKB nr. 85 datë 30.06.2022, VKB nr. 119 datë 29.09.2022 dhe VKB nr. 127 datë 14.10.2022 "Mbi miratimin e ndryshimit të buxhetit të 2022-2024 të Bashkisë Kamëz"; sipas VKM-ve përkatëse nr. 291/2022, nr. 372/2022, dhe nr. 441/2022.

VKB nr. 42 datë 29.03.2022

lekë

Fondet që trashëgohen nga viti 2021				
	Gr/Kap	**Llog. ekonomike**	**Emërtimi**	**Vlera**
shtohet	00/01	600/601	Paga& Sig.shoq	12,995,718.0
shtohet	-//-	602	Shpenzime operative	21,156,219.0
shtohet	-//-	231	Investime	7,953,428.8
shtohet	-//-	602	Rindërtimi	28,738,000.0
shtohet	-//-	231	Rindërtimi	282,269,585.0
shtohet	-//-	699		536,399.0
shtohet	00/05	600/601	Paga& Sig.shoq	117,454.0
shtohet	-//-	602	Shpenzime operative	963,276.0
shtohet	-//-	231	Investime	552,356.0
shtohet	00/06	600/601	Paga& Sig.shoq	917,012.0
shtohet	-//-	602	Shpenzime operative	44,024,192.0
shtohet	-//-	231	Investime	122,794.0
Totali				**400,346,433.8**

VKB nr. 56 datë 19.05.2022

VKM 291/2022	Gr/Prog/Kap	Llog. ekonomike	Emërtimi	Vlera
Shtohet	00/06190/01	231	Rindërtimi	178,585,905.0
Totali				**178,585,905.0**

VKB nr. 60 datë 03.06.2022

VKM 372/2022	Gr/Prog/Kap	Llog. ekonomike	Emërtimi	Vlera
Shtohet	00/06190/01	231	Rindërtimi	183,427,859.0
Shtohet	00/03280/01	600/601	MZSH	4,213,190.0
Shtohet	00/03280/01	602	-//-	2,000,000.0
Totali				**189,641,049.0**

VKB nr. 70 datë 17.06.2022 & VKB nr. 67 datë 17.06.2022

VKM 441/2022	Gr/Prog/Kap	Llog. ekonomike	Emërtimi	Vlera
shtohet	00/06260/01	231		31,506,548.0
shtohet	00/10660/01	606	Rindërtimi	76,500,000.0
shtohet	00/03280/01	606	E.civile	3,700,000.0
pakësohet	00/03280/05	606		-3,700,000.0
Totali në vlerë të plotë				**108,006,548.0**

VKB nr. 85 datë 30.06.2022

VKM 441/2022	Gr/Prog/Kap	Llog. ekonomike	Emërtimi	Vlera
Shtohet	00/01110/01	230	Mbikqyres/kolaudues	534,301.0
Shtohet	00/01110/01	231	Rindërtim	161,893,140.0
Totali				**162,427,441.0**

VKM nr. 119 datë 29.09.2022

	Gr/Prog/Kap	Llog. ekonomike	Emërtimi	Vlera
Shtohet	00/09120/01	600/601	Arsimi 9 vjecar	19,155,290.0
Shtohet	00/10430/01	600	çerdhet	9,000,000.0
Shtohet	00/09120/06	231	Sistemim sheshi në 2 shkolla	5,763,899.0
Totali				**33,919,189.0**

VKB nr. 127datë 14.10.2022

	Gr/Prog/Kap	Llog. ekonomike	Emërtimi	Vlera
shtohet	00/04520/05	231	Ndërtim rruge	20,026,528.0
pakësohet	00/10430/05	602	çerdhe	-4,500,000.0
pakesohet	00/09120/05	602	Arsimi parashollor	-2,000,000.0
pakesohet	00/09120/05	600/601	Paga arsimi	-2,000,000.0
pakesohet	00/09120/05	606	Ndihme për nxënës të dalluar	-5,000,000.0
pakesohet	00/09230/05	606	Arsim i mesëm	-2,500,000.0
pakesohet	00/10660/05	606	Partneritet per strehimin	-2,000,000.0
pakesohet	00/01110/05	602	Aparati	-2,026,528.0
Totali				**20,026,528.0**

Ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në buxhetin e bashkisë për vitin 2022 me Vendim të Këshillit Bashkiak, kanë pasqyruar lëvizjet në buxhet sipas kodeve të programit, kapitulli, artikulli e vlerës, të cilat janë shoqëruar edhe me tabelat përkatëse, konform Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 26,27,28 e 29; neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;

c. Vendimeve të Këshillit Bashkiak për miratimin e PBA 2022-2024 dhe Planit vjetor 2022 dhe ndryshimeve të bëra, iu janë bashkëngjitur relacionet përkatëse, në të cilat janë dhënë inforM one mbi burimin e financimit me argumentet e nevojshme mbi të cilat mbështeten këto ndryshime.

d. VKB-të e miratuara janë regjistruar në Regjistrin e protokollit të Bashkisë Kamëz;

e. VKB-të për PBA/ Buxhetin vjetor dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit ushtrimor, janë konfirmuar për ligjshmëri nga Prefekti i Qarkut Tiranë, si dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë brenda afateve ligjore.

Konstatim: Nga Bashkia Kamëz, PBA 2022-2024 dhe Plani vjetor i buxhetit 2022 janë miratuar sëbashku, duke mos miratuar veçmas Planin Vjetor, në moszbatim të kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin 9936 datë 26.06.2008 "Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 29;

- **Planifikimet sipas PBA-së me ndryshimet:**

Në mijë lekë

Emërtimi	PBA 2022-2024		Buxheti 2022	
	Ardhura	Shpenzime	Ardhura	Shpenzime
Të ardhurat të veta të trashëguara viti 2021		-	4,501	-
Të trashëguara nga transf.pakushtëzuara 2021		-	25,502	-
Të trashëguara nga transf.specifike 2021		-	16,604	-
Të trashëguara nga transf.Rinderimi 2021		-	353,740	-
Plani i te ardhurave viti ushtrimor	1,435,818		1,592,703	-
Grante të pakushtëzuara viti 2022	544,281		621,649	-
Transferta specifike viti 2022	236,499		319,384	-
Grante të pakushtëzuara viti 2022 RiN	781,672		1,123,010	-
-Nga FZHSH		-	-	-
-Nga Ministritë e Linjës	980,209		302,340	-
-Donatorë të ndryshëm			-	-
-Transf buxheti, invalid, ndihma etj. (606)	561,664		1,250,240	-
Paga (600)		410,858	-	609,337
Sigurime shoqerore (601)		65,775	-	99,273
Shpenzime operative (602)		295,952	-	357,713
Transferta (604+606+609) Fondi rezerve		990,468	-	1,416,188
Investime (230+231) nga te ardhurat . Tr. Pakushtezuar		1,210,689	-	1,211,436
Investime RiN		781,672	0	1,411,402
Investime nga FZHR e M linjes		639,999	-	302,340
Te tjera (166, 651, 603,604, 606) dy ndermarrjet e varesise		144,730	-	201,985
-Nga huatë				
Totali	**4,540,143**	**4,540,143**	**5,609,673**	**5,609,673**

Burimi: *Bashkia Kamëz*

Të dhënat në tabelë janë për aparatin e bashkisë Kamëz së bashku me njësitë administrative dhe njësitë vartëse.

- Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se Bashkia Kamëz ka planifikuar që me të ardhurat e veta të mbulojë 28.5% të shpenzimeve të planifikuara *<u>për vitin 2022</u>*. Ndërkohë që nga tabela rezulton se të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës janë 62,538,8 mijë lekë, të ndara respektivisht: nga "të ardhurat e veta" 4,501 mijë lekë, nga "transferta e pakushtëzuar" 25,502 mijë lek, nga "transferta specifike" 16,604 mijë lekë, pa përfshirë të ardhurat e trashëguara nga transferta e rindërtimit.

në mijë lekë

Nr	Burimet e Financimit	Viti 2022	
		Plan	Fakt
1	Trasferta e Pakushtëzuar	647,151	612,551
2	Trasferta specifike, sektoriale	335,988	308,407
3	Të ardhurat e veta	1,597,204	1,061,114
4	Fondet e rindërtimit	1,890,935	1,635,989
5	Fondet e Kushtëzuara	302,340	302,340
6	Funksionet e deleguara	836,057	833,754
	Totali	**5,609,673**	**4,754,154**

Burimi: Bashkia Kamëz

Nga verifikimi dhe të dhënat e pasqyruara në tabelë *rezultoi se* shpenzimet me burim të "ardhurat"nga taksat e tarifat vendore janë planifikuar: *<u>për vitin 2022</u>* në vlerën 1,597,204 mijë lekë; në fakt janë përdorur në vlerën 1,061,114 mijë lekë ose 66.4%; Nga fondet e "pakushtëzuara" janë planifikuar 647,151 mijë lekë dhe shpenzuar 612,551 mijë lekë ose 94.7% e atyre*;* nga fondet e "specifike e sektoriale" janë planifikuar 335,988 mijë lekë dhe shpenzuar 308,407 mijë lekë ose 91.8%; nga fondet e kushtëzuara janë planifikuar dhe

përdorur në masë të plotë 302,340 mijë lekë si dhe nga funksionet e deleguara janë planifikuar 836,057 mijë lekë dhe përdorur 833,754 mijë lekë ose 99.7%.

Ndërsa buxheti fillestar *për vitin 2022* është planifikuar në vlerën e 2,398,002 mijë lekë ku përfshihen: shpenzime korrente, kapitale, fond rezervë dhe kontigjence, transferta sektoriale.dhe me fondet e trashëguara nga viti 2021 prej 46,607 mijë lekë (të ardhurat e veta & transfertave të pakushtëzuara & transferta specifike), me fondet e kushtëzuara dhe funksionet e deleguara arrin në vlerën e (plani progresiv) 5,609,673 mijë lekë dhe realizimi i tij në vlerën e 4,754,154 mijë lekë.
Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo vit buxhetor.
Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2022, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet.
Nga auditimi rezulton se janë bërë aktrakordimet me thesarin dhe *nuk rezultojnë diferenca*.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit 2022, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Në mijë lekë

Bashkia Kamzë së bashku me njësitë vartëse. Vetëm me të ardhurat e veta vendore + transferta e pakushtëzuar) Viti 2022.								**Në 000/lekë**
Art.		**(1)**	**(2)**	**(3)**	**(4)**	**(5)**	**(7)=(5)-(4)**	
	Emertimi	**Fakti i vitit paraardhës Viti 2021**	**PBA Plan Viti 2022**	**Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022 (VKB 132 datë 22/12/2021)**	**Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022**	**Fakti i 12-mujorit**	**Diferenca**	**% e realizimit**
600	Paga	255,235	325,773	371,167	385,249	326,321	58,928	84.7%
601	Sigurime Shoqërore	38,943	52,065	96,423	59,213	52,322	6,891	88,36%
600+601	**Paga +Sigurime**	**294,178**	**377,838**	**691,590**	**430,380**	**378,643**	**65,819**	**87.98%**
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	167,220	328,017	436,780	428,273	333,634	94,639	77.9%
603	Subvencione							
604	Transferta Korente të Brendshm	10,000	97,423	9,287	9,287	8,813	474	94.9%
605	Transferta Korente të							

	Huaja							
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	30,595	37,020	64,034	63,134	32,897	30,237	52.12%
602-606	**Shpenzime operative**	**207,815**	**397,352**	**510,102**	**500,694**	**375,344**	**125,350**	**75%**
Shpenzime Korrente		**501,993**	**775,190**	**1,201,692**	**931,074**	**753,987**		
230	Kapitale të Patrupëzuara	32,821						
231	Kapitale të Trupëzuara	787,825	1,199,631	1,166,421	1,151,963	926,719	225,244	80.5%
Shpenzime Kapitale		**820,746**	**1,199,631**	**1,166,421**	**1,151,963**	**926,719**	**225244**	80.5%
Totali (korrente + kapitale)		**1,322,639**	**1,974,821**	**2,368,112**	**2,083,037**	**1,680,706**	**402,331**	**80.7 %**

Burimi: Bashkia Kamëz

*Këtu nuk janë përfshirë shpenzimet me fonde nga transferta e kushtëzuar.

Në strukturën e PBA-së nga 36 programe buxhetore deri në vitin 2021 të miratuara me Udhëzimin e Ministrit të MFE nr. 23 datë 30.07.2018, me Udhëzimin nr. 7 datë 25.02.2022 për vitin 2022 e në vijim janë 26 programe të përcaktuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë për buxhetim. Kjo rënie e numrit të programeve buxhetore nga ana e MFE ka ardhur *si rezultat i* mungesës së një studimi për të përshtatur programet buxhetore të strukturës së PBA-ve me funksionet e NJVQV të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Referuar për sa më lart dhe nga analiza e vlerave në pasqyrat e mësipërme, **rezulton** se ka diferencime në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Kamëz nuk mund të bëjë planifikim të saktë të fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së linjës/FZHR), ka programe të nënfunksioneve si: 102 "Të moshuarit", 105-"Papunësia" dhe, 036-"Marrëdhëniet në komunitet", 056-"Ndërgjegjësimi mjedisor", 062/1-"programe zhvillimi", 072/2-"Shërbimi shëndetësor", 04130-"Mbështetja për zhvillim ekonomik" etj, rezultojnë të jenë programe pa fonde buxhetore, me fonde të papërfillshme apo në rënie; gjë për të cilat tregon se Bashkia Kamëz nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë.

- Diferencat e vlerave të PBA-ve në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë mungesë të analizës së thelluar në planifikimin e fondeve buxhetore në PBA, por edhe mungesën e një studimi të mirëfilltë në përcaktimin dhe vlerësimin e programeve prioritare për një harmonizim ndërmjet atyre programeve që i përkasin të njëjtit funksion apo funksioneve/nënfunksioneve të ndryshme, por që mbështesin apo plotësojnë njëri - tjetrin, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me planin strategjik dhe politikat institucionale. Kjo ka ardhur si rezultat edhe i mungesës së analizave nga ana e GMS për hartimin e realizimin e buxheteve në raport me Planin e Përgjithshëm të Zhvillimit Vendor dhe Strategjinë e Zhvillimit Vendor.

Konstatim. Bashkia Kamëz nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t'i kushtuar rëndësi programeve: 056-"Ndërgjegjësimi mjedisor" si programe që lidhen ngushtë me 051-"Menaxhimi i mbetjeve"; 036-"Marrëdhëniet në komunitet", 041-"Mbështetje për zhvillim ekonomik-Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi"; 072/2- "Shërbimi shëndetësor", 102 "Të moshuarit", 105 "Papunësia", mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë, tregon për një shërbim ku është cënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 23-30.

Gjatë vitit 2022 janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Nga auditimi i dokumentacionit *rezultoi* se për hartimin e projekt buxhetit vjetor 2022, janë marrë në konsideratë kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për 2 vitet buxhetorë paraardhës si dhe duke marrë drejtpërdrejtë edhe kërkesat buxhetore sipas nevojave të çdo njësie të strukturës së bashkisë dhe atyre vartëse, duke zbatuar kërkesat e nenit 40 pika 3/ç të ligjit nr. 67/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".



Grafiku i planifikimit dhe realizimit të buxhetit Bashkia Kamëz

Nga auditimi i dokumentacionit *rezultoi* gjithashtu se analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit Tiranë.
Nga auditimi *rezultoi* se nga ana e DFK gjatë vitit 2022 janë dërguar në Ministrinë e Financave Raportet e monitorimit për: analizën e shpenzimeve sipas programeve, treguesit e performancës, realizimi i shpenzimeve, treguesit financiarë, detyrimet e prapambetura, të ardhurat e veta të bashkisë dhe është bërë publikimi i këtij informacioni në web.
- Raporti i monitorimit për 4 mujorin e I viti 2022 me shkresën nr. 4524/1 datë 20.05.2022;
- Raporti i monitorimit për 8 mujorin e vitit 2022 me shkresën nr. 8606 datë 28.09.2022;
- Raporti i monitorimit për vitin 2022 me shkresën nr. 1710 datë 21.02.2023.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuara sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2022 *rezultoi* se PBA 2022-2024 të jetë realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë periudhës nën auditim, buxheti i Bashkisë Kamëz ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Tiranë.
Nga auditimi *rezultoi* se Kryetari i Bashkisë ka raportuar në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare të vitit të mbyllur ushtrimor 2022, në zbatim të neneve 11, 64 të ligjit nr. 30/2015 **"**Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 44. Nga pasqyra e mësipërme rezulton se janë në total 26

programe (nënfunksione), nga të cilat për vitin 2022 janë planifikuar për tu trajtuar me fonde buxhetore vetëm 22 programe;

Titulli i Gjetjes: Mbi planifikimin e PBA-ve dhe Planeve vjetore me programe buxhetore sipas prioriteteve vendore dhe institucionale u konstatua se:

Situata: **1.** Nga Bashkia Kamëz, PBA 2022-2024 dhe Plani vjetor i buxhetit 2022 janë miratuar sëbashku, duke mos miratuar veçmas Planin Vjetor 2022, në moszbatim të kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin 9936 datë 26.06.2008 "Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 29;

2. Bashkia Kamëz nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t'i kushtuar rëndësi programeve: 056-"Ndërgjegjësimi mjedisor" si program që lidhet ngushtë me 051-"Menaxhimi i mbetjeve"; 041-"Mbështetje për zhvillim ekonomik"; 072/2- "Shërbimi shëndetësor", 102 "Të moshuarit", 105 "Papunësia" etj., mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë, tregon për një shërbim ku është cënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 23-30.

Kriteri: Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, gërma "*dh*" të nenit 32, i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I neni 5 pika ç; Ligjin nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" Kreu IV, nenet 11-20; Ligjit nr. 10296/2010 "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Manualit MFK, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Kamëz.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e vëmendjes në planifikimin e fondeve të buxhetit vendor për programet prioritare në koherencë me Planin e Zhvillimit Vendor dhe Strategjitë Kombëtare, ul efektivitetin në aktivitetin e funksioneve të bashkisë për komunitetin, në moszbatim të përcaktimeve ligjore/nënligjore në fuqi.

Shkaku: Mungesa e një analize të detajuar nga Kryetari i bashkisë dhe e Grupit të Menaxhimit Strategjik e mos/realizimit të buxhetit në mbyllje të vitit ushtrimor dhe nxjerrja e detyrave për planifikimin e buxhetit vjetor dhe atë afatmesëm në vijim, të atyre programeve që i shërbejnë realizimit të objektivave institucionale në dobi të komunitetit.

Rëndësia: E mesme

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit

Për zbatimin e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Tiranë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha proçedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Tiranë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të vitit, të realizuara me VKB ose të diktuara nga transferta e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, *rezultoi* se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2022 vetëm për Bashkinë Kamëz (aparati) referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Mijë lekë

Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
1	Llogaria 600 "Paga"	537,543	463,458	86.2
2	Llogaria 601 "Sigurime shoqërore"	87,715	75,930	86.6
3	Llogaria 602 "Shpenzime operative"	411,399	308,240	74.9
4	Llogaria 604 "Transferime korrente të brendshme"	12,787	8,813	68.9

5	Llogaria 606 "Transferime për Buxhetet familjare dhe Individë"	1,398,066	1,278,393	91.5
6	Llogaria 609 "Rezervat"	15,400	0	0
7	Llogaritë 230-231 "Investime"	2,946,309	2,458,980	83.5
TOTALI		**5,409,219**	**4,593,814**	**84.9**

Burimi: Bashkia Kamëz

Referuar të dhënave të pasqyrës, rezulton se niveli i realizmit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 68.9% deri në 91.5% *për vitin 2022*: për llog 600/601 realizuar në masën 86.2% pasi planifikimi mbështetet në strukturën organizative dhe ky mosrealizim përfaqëson fondin për paga e sigurime të vendeve vakante deri në 31.12.2022; llog 230/231 realizuar në masën 83.5% dhe *rezulton* se mosrealizimi ka ardhur si rezultat i mungesës së fondeve nga mosrealizimi i të ardhurave të veta;

Viti 2022 bashkia Kamëz (aparati + njësi varësie)				
Emërtimi i shpenzimit	**Plan**	**Fakt**	**Diferenca**	**%**
600	568,364	564,442	3,922	**99.3**
601	104,454	91,971	12,483	**88**
602	464,884	346,755	118,129	**74.6**
230-231	2,973,724	2,470,861	502,863	**83.1**
606	1,426,453	1,287,257	139,196	**90.3**
Shuma	**5,609,673**	**4,761,286**	**848,387**	**84.9**

Burimi: Bashkia Kamëz

Referuar të dhënave të pasqyruara në tabelë, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 74.6% deri në 99.3% *për vitin 2022*: për llog 600/601 realizuar në masën 99.3% pasi planifikimi mbështetet në strukturën organizative dhe ky mosrealizim në vlerë të vogël përfaqëson fondin për paga e sigurime të vendeve vakante deri në 31.12.2022; llog 230/231 realizuar në masën 83.1% dhe rezulton se mosrealizimi ka ardhur si rezultat i mungesës së fondeve nga *mosrealizimi i të ardhurave të veta*;
Gjithashtu vërehet se niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti në vit po ashtu edhe niveli i realizimit në total dhe për çdo zë buxhetor, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Kamëz dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara. Peshën specifike më të madhe në buxhet ndaj totalit për vitin 2022 e zënë shpenzimet në llog 230-231 "investimet" e ndjekur nga llog.606 "transferta buxhetore familjare/individë".

- **Sipas burimeve të financimit:**

Sipas burimeve të financimit: **transferta e pakushtëzua, transferta specifike, të ardhura të veta,** treguesit e buxhetit janë planifikuar si më poshtë:

në mijë lekë

Nr.	**Emërtimi**	**Totali**	**Burimi i financimit**			**%**
			Transferta pakushtëzuara	**Transferta specifike/ sektoriale**	**Të Ardhura te veta**	**të ardhura të veta ndaj totalit**
1	Paga	633,445	156,742	248,196	228,507	**8.88**
2	Sig.shoqërore	105,661	28,068	41,332	36,261	**1.4**
3	Shpenzime Operative	486,000	147,093	20,556	318,351	**12.4**
4	Transferta korrente të brendshme	12,787	-		12,787	**0.5**
5	Trans.Buxh.Familjare/individ	60,903	780	12,352	47,771	**1.9**
6	Rezervat	15,000	-		15,000	**0.6**
7	Investimet	1,590,637	314,468	13,552	931,960	**36.2**
TOTALI		**2,573,776**	**647,151**	**335,988**	**1,590,637**	
në %		**100**	**25.2**	**13**	**61.8**	

Burimi: Bashkia Kamëz

Sipas burimeve të financimit: **transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta,** treguesit e buxhetit janë realizuar si më poshtë:

në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit			%
			Transferta pakushtëzuara	Transferta specifike/ sektoriale	Të Ardhura te veta	të ardhurat e veta ndaj totalit
1	Paga	560,079	156,276	233,758	170,045	**7.7**
2	Sig.shoqërore	318,994	254,700	37,442	26,852	**1.2**
3	Shpenzime Operative	349,191	137,886	15,507	195,798	**8.8**
4	Transferta korrente të brendshme	8,813	-	-	8,813	**0.4**
5	Trans.Buxh.Familjare/individë	41,673	690	8,826	32,157	**1.5**
6	Rezervat	-	-	-	-	**-**
7	Investimet	939,594	314,214	12,874	612,506	**27.6**
TOTALI		**2,218,344**	**863,766**	**308,407**	**1,046,171**	
në %		**100**	**38.9**	**13.9**	**47.2**	

Burimi: Bashkia Kamëz

- Nga të dhënat në pasqyrat e planifikimit e realizimit të buxhetit referuar burimit të financimit, *rezulton* se vlera totale e tij në planifikim është 2,573,776 mijë lekë dhe realizimi në 2,218,344 mijë lekë, ku peshën kryesore e zë buxheti nga "të ardhurat e veta" në vlerën 1,590,637 mijë lekë në planifikim ose 61.8% ndaj vlerës totale dhe 1,046,171 mijë lekë në realizim ose 47.2% të totalit; i ndjekur nga "transferta e pakushtëzuara" në vlerën e 647,151 mijë lekë në planifikim ose 25.2% dhe 863,766 mijë lekë në realizim ose 38.9% të totalit; nga "transferta specifike/sektoriale" në vlerën 335,988 mijë lekë ose 13% në planifikim dhe 308,407 mijë lekë në realizim ose 13.9% të totalit.
- Ndërsa nga zërat buxhetor me burim "të ardhurat e veta", në realizim janë: "investimet" me 612,506 mijë lekë ose 27.6% të totalit; "pagat" në vlerën 170,045 mijë lekë ose 7.7% të totalit; shpenzimet operative me 195,798 mijë lekë ose 8.8% të totalit të shpenzimeve.
- Nga "të ardhurat e veta" në raport me totalin për çdo zë buxhetor janë: "pagat" prej 170,045 mijë lekë ose 30.4% nga totali për "pagat"; "investimet" prej 612,506 mijë lekë ose 65.2%; "shpenzimet operative" prej 195,798 mijë lekë ose 56.1% nga totali i "shpenzimeve operative".

➢ **Realizimi faktik i buxheteve sipas periUve ushtrimore**

Nga auditimi *rezulton* se plani i Buxhetit është: *për vitin 2021* është 4,528,287 mijë lekë; *për vitin 2022* është 5,409,219 mijë lekë ose 880,932 mijë lekë më shumë; ndërsa buxheti faktik është në vlerën e 3,767,960 mijë lekë *për vitin 2021* dhe në vlerën e 5,409,219 mijë lekë për *vitin 2022* ose 825,854 mijë lekë më shumë. i shprehur në (%) *për vitin 2021* është realizuar në masën 83.2% dhe *në vitin 2022* është realizuar në masën 84.9% të tij, duke rezultuar me vlerë më të lartë.

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	Diferenca	Trendi
1	Shpenzimet e planifikuara (aparati)	4,528,287	5,409,219	880,932	↗
	Shpenzimet e planifikuara	4,608,238	5,609,673	1,001,435	↗
2	Shpenzimet faktike (aparati)	3,767,960	4,593,814	825,854	↗
	Shpenzimet faktike	3,843,457	4,761,286	917,829	↗
Raporti		**83.4%**	**84.9%**		↗

Burimi: Bashkia Kamëz

Sa më sipër **u konstatua** se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat e veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2021 dhe 2022 të ketë mosrealizime, por vlera e realizimit të buxhetit vjen me trend në rritje nga 83.4% për vitin 2021 në 84.9% për vitin 2022, gjë e cila pasqyrohet në tabelën më poshtë:

në mijë lekë

Emërtimi	2021	2022		Diferenca fakt 2022-2021	Trendi i realizimit
	Fakt	Plan	Fakt		
Shpenzime	3,767,960	5,409,219	4,593,814	**825,854**	↗
Të Ardhura	1,545,664	2,221,790	1,680,706	**135,042**	↗

Burimi: Bashkia Kamëz

- Nga auditimi *rezultoi* se: Bashkia Kamëz *nuk ka financime të huaja* për vitin 2022;
- Bashkia Kamëz *nuk ka aplikuar* për kredi në vitin 2022 (as në periudhat paraardhëse);
- Bashkia Kamëz *nuk ka patur* subvencione nga shteti.

Një pasqyrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet faktike të 2 viteve të fundit në tabelën e mëposhtme, *rezulton* se pavarësisht mosrealizimit, vlera e të ardhurave dhe e shpenzimeve ka trend në rritje nga viti në vit si dhe diferenca mes të ardhurave faktike dhe shpenzimeve faktike nga një vit në tjetrin vjen në rritje;

në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	Trendi
1	Të ardhurat faktike	1,545,664	1,680,706	↗
2	Shpenzimet faktike	3,767,960	4,593,814	↗
Diferenca		**(-)2,222,296**	**(-)2,913,108**	

Burimi: Bashkia Kamëz

➢ **Miratimi i buxhetit faktik:**

Bashkia Kamëz me VKB nr. 132 datë 28.04.2023 ka miratuar buxhetin faktik të vitit 2022, në zbatim të Ligjit nr. 139 /2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 44, me VKB nr. 21 datë 17.03.2023 dhe nr. 31 prot., datë 17.03.2023. Në këtë raport përfshihen: Analiza e shpenzimeve sipas programeve; Treguesit e performancës; Realizimi i shpenzimeve krahasuar me vitin pasardhës; Treguesit financiarë; Detyrimet e prapambetura; Të ardhurat e veta të bashkisë; Publikimi në WEB.

➢ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në MFE:**

Në zbatim të nenit 48 "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor" të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, udhëzimit nr. 22 dt.30.07.2018 "Për Proçedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore", si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore*", rezultoi* se nga ana e DFK të Bashkisë Kamëz janë bërë rregullisht raportimet 4, 8 dhe 12 mujore në Ministrinë e Financave. Këto raportime janë dërguar në MFE në rrugë elektronike nga adresa zyrtare institucionale dhe postare në afat;

➢ **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:**

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar Fondi rezervë, Fondi i kontigjencës dhe Fondi i Emergjencës, vlerat e planifikimit dhe përdorimit të tyre pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

mijë lekë

Emërtimi	Plan 2022	Fakt 2022	Diferenca
Fond Rezervë	30,400	0	30,400
Fond Emergjence	26,513	6,260	20,253
Fond Kontigjence	15,000	15,000	0
Mbrojtja Civile	70,741	70,741	0
Totali	**142,654**	**92,001**	**50,653**

Burimi: Bashkia Kamëz

Përdorimi i këtyre fondeve realizohet me miratimin e Këshillit Bashkiak. Me VKB nr. 132 datë 22.12.2021 "Për miratimin e PBA dhe planit vjetor 2022" është miratuar Fondi Rezervë në vlerën 30,400 mijë lekë dhe Fondi i Kontigjencës në vlerën 15,000 mijë lekë, që në total janë në vlerën 45,400 mijë lekë. Në referim të ligjit nr. 9936/2008 "Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë" këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara. **U konstatua** se vlera totale e tyre (FR +FK) është 109,026 mijë lekë më pak ose rreth 39.4% të vlerës që duhej të planifikohej dhe se *për vitin 2022*, Fondi i Kontigjencës është përdorur plotësisht dhe Fondi Rezervë nuk është përdorur;
Fondi i Emergjencës është planifikuar në vlerën 26,513 mijë lekë dhe përdorur në vlerën 6,260 mijë lekë. Fondi i Emergjencave përfaqëson fondet që bashkia planifikon në rastet e fatkeqësive natyrore në masën 1% të buxhetit.

- **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:**

Referuar kritereve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, nga ana e tyre, Pushteti Vendor/Bashkitë kanë për detyrim të miratojnë a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; b) vlerësimin vendor të riskut; c) planin vendor të emergjencave civile; ç) planin e zhvillimit urban, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile".
Nga sa më lart, nga auditimi **u konstatua** se Bashkia Kamëz *për vitin 2022* fondin për emergjencat civile nga të ardhurat e veta, e ka planifikuar në vlerën e 26,513 mijë lekë nga i cili është shpenzuar 6,260 mijë lekë dhe është trashëguar për vitin pasardhës 20,253 mijë lekë. Në arsyetimin tonë kjo tregon për një shpërndarje racionale në përdorimin e tij sipas hallkave të procesit, duke i kushtuar rëndësi jo vetëm përmirësimit të situatës pas fatkeqësive natyrore, por edhe masave paraprake për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.
Fondi që bashkitë duhet të kenë për emergjencat civile është në masën 4% të shpenzimeve buxhetore, ku 1% i planifikojnë nga të fondeve e veta dhe në masën 3% nga fondet e kushtëzuara nga buxheti i shtetit; për vitin 2022 ky fond është planifikuar (FE+MC) në vlerën 97,254 mijë lekë. Në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 65/1, nga auditimi rezultoi se ky fond duhet të ishte në vlerën e 102,951.04 mijë lekë, por që në fakt është planifikuar 5,697.04 mijë lekë më pak ose fondi i planifikuar përbën rreth 94.5% të vlerës që duhej planifikuar. Fondi për emergjencat civile është planifikuar në masën 103% dhe mbrojtja civile (nga AKMC) është planifikuar në masën 91.6%.

- **Realizimi i Investimeve:**

Planifikimi dhe realizimi i investimeve për vitin 2021 dhe 2022 për bashkinë Kamëz, me burim "financimi nga të ardhurat e veta" [AV] dhe "transferta e pakushtëzuara", pasqyrohet në tabelën më poshtë:

në mijë lekë

230-231	2021	2022			
	Fakt	**Plan**	**Fakt**	**Diferenca ndaj planifikimit**	**Diferenca ndaj faktit**
	820,746	1,590,637	939,594	(-)651,043	118,848

Burimi: Bashkia Kamëz/DFK

Nga auditimi **rezultoi** se në vitin 2022 janë rritur investimet me burim të ardhurat e veta me një numër prej 33 Investime dhe 1 investim me burim nga buxheti i shtetit & AKUM-i;

realizimi i shpenzimit të fondit të planifikuar për "investimet" në vitin 2021 është 820,746 mijë lekë, në vitin 2022 është 939,594 mijë lekë ose 118,848 mijë lekë më shumë; ndërsa ndaj planifikimit është (-) 651,043 mijë lekë. Pra *për vitin 2022* investimet kanë mosrealizim kundrejt planifikimit, por në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej 118,848 mijë lekë.

Duke iu referuar të dhënave në tabelën e mëposhtme të të ardhurave të Bashkisë Kamëz, rezultoi si më poshtë vijon:

Në mijë lekë

	Burimet e Financimit	Viti 2022		%
		Plan	Fakt	
230-231	Të ardhurat e veta	931,960	612,506	65.7
	Transferta specifike/sektoriale	13,552	12,874	95
	Transferta e pakushtëzuar	314,468	314,214	99.9
	Totali	**2,573,776**	**2,218,344**	**86.2**

Burimi: Bashkia Kamëz/DFK

Nga analiza e inforM onit të pasqyruar në tabelë, rezulton se realizimin më të lartë e kanë investimet me fonde nga "transferta e pakushtëzuar" në masën 99.9%, nga "transferta sektoriale" në masën 95% dhe më të ulët nga "të ardhurat e veta" në masën 65.7%. Ky **konstatim** sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat e veta për asnjë nga vitet (2021 dhe 2022) nuk janë realizuar, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, Ligji nr. 67 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë proçedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre në vitet paraardhëse

Nr	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	Trendi
1	Të ardhurat e veta plan	1,139,371	1,585,352	↗
2	Të ardhurat e veta fakt	792,636	1,055,658	↗
Diferenca		**(-)346,735**	**(-)529,694**	

Nga analiza e treguesve të tabelës së të ardhurave të veta, rezulton se diferenca mes realizimit faktik të të ardhurave të veta ndaj planifkimit ka trend në rritje.

- **Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.**

Përsa i përket situatës së pandemisë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Kamëz gjatë vitit 2022 *nuk ka patur fonde të planifikuara* dhe rrjedhimisht *as të shpenzuara* për nevoja specifike të situatës.

Titulli i Gjetjes: Mosrealizimi i planeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin dhe zbatimit të dispozitave ligjore u konstatua se:

Situata: 3. Nga analiza e të dhënave të buxhetit rezultuan diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta në vlerën 1,597,204 mijë lekë dhe shpenzimeve të tyre në vlerën 1,061,114 lekë, kështu nga të ardhurat e veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2021 dhe 2022 të ketë mosrealizime, ndonëse vlera e realizimit të buxhetit vjen me trend në rritje nga 83.4% për vitin 2021 në 84.9% për vitin 2022;

4. Me VKB nr. 132 datë 22.12.2021 "Për miratimin e PBA dhe planit vjetor 2022" është miratuar Fondi Rezervë (FR) në vlerën 30,400 mijë lekë dhe Fondi i Kontigjencës (FK) në vlerën 15,000 mijë lekë, që në total janë në vlerën 45,400 mijë lekë. Referuar ligjit nr.

9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara. U konstatua se vlera totale e tyre (FR +FK) është 109,026 mijë lekë më pak ose rreth 39.4% të vlerës që duhej të planifikohej dhe se për vitin 2022 nga ky fond, Fondi i Kontigjencës është përdorur plotësisht dhe Fondi Rezervë nuk është përdorur;

5. Referuar kritereve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumenteve orientuese për përdorimin e këtij fondi nga ana e Pushtetit Vendor/Bashkitë, u konstatua se për vitin 2022 fondi për emergjencat civile nga të ardhurat e veta është planifikuar në vlerën e 26,513 mijë lekë, nga i cili është shpenzuar 6,260 mijë lekë dhe është trashëguar për vitin pasardhës 20,253 mijë lekë. Fondi që bashkitë duhet të kenë për emergjencat civile është në masën 4% të shpenzimeve buxhetore, ku 1% i planifikojnë nga fondet e veta dhe në masën 3% nga fondet e kushtëzuara nga buxheti i shtetit; për vitin 2022 ky fond është planifikuar (FE+MC) në vlerën 97,254 mijë lekë. Bazuar në Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile" neni 65/1, nga auditimi rezultoi se ky fond duhet të ishte në vlerën e 102,951.04 mijë lekë, por që në fakt është planifikuar 5,697.04 mijë lekë më pak ose fondi i planifikuar përbën rreth 94.5% të vlerës që duhej të ishte planifikuar. Fondi për "emergjencat civile" (nga Bashkia Kamëz) është planifikuar në masën 103% dhe për "mbrojtja civile" (nga AKMC) është planifikuar në masën 91.6%.

6. Nga auditimi rezultoi se në vitin 2022 janë rritur investimet me burim të ardhurat e veta me një numër prej 33 investime dhe 1 investim me burim nga buxheti i shtetit & AKUM-i; realizimi i shpenzimit të fondit të planifikuar për “investimet” në vitin 2021 është 820,746 mijë lekë, në vitin 2022 është 939,594 mijë lekë ose 118,848 mijë lekë më shumë; ndërsa ndaj planifikimit është (-) 651,043 mijë lekë. Nga analiza e treguesve të tabelës së të ardhurave të veta, rezulton se diferenca mes realizimit faktik të të ardhurave të veta ndaj planifkimit ka trend në rritje si edhe të ardhurat e veta, vijnë në rritje nga viti në vit. Nisur nga sa më lart, rezulton se për vitin 2022 “investimet” kanë mosrealizim kundrejt planifikimit, por në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej 118,848 mijë lekë.

- Nga auditimi rezultoi se niveli i planifikimit buxhetor për investimet vjen në rritje nga viti në vit, ndërsa niveli i realizimit në total vjen në rënie nga viti 2021 në vitin 2022; nga tabela e planifikimit të shpenzimeve me burim të ardhurat e veta në vitin 2022 janë në vlerën 931,960 mijë lekë, investimet kanë mosrealizim kundrejt planifikimit në vlerën (-)146,754.8 mijë lekë; si dhe në krahasim me vitin 2021 ky mosrealizim ka një rritje prej (-)13,091.5 mijë lekë.

Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet (2021 dhe 2022) jo vetëm që nuk janë realizuar, por ka ardhur në rënie, veprime këto që bien ndesh me Ligjin nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat e veta për asnjë nga vitet (2021 dhe 2022) nuk janë realizuar, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, Ligji nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë proçedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre në vitet paraardhëse;

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat

Financiare", i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9 pika 1.3 germa "c" dhe "ç"; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 "*Për buxhetin e vitit 2020*", Aktin Normativ Nr.15, datë 15.4.2020, Ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 65/1; Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak;

Ndikimi/Efekti: Planifikimi jo real i të ardhurave të veta, i zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Shkaku: Planifikim i të ardhurave dhe më pas përdorimi i tyre për mallra/ shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke u mbështetur në planifikim dhe jo në realizimin faktik të të ardhurave të veta; Mungesa e një analize financiare në programimin e buxheteve, mosnxjerrja e konkluzioneve për mosrealizimet e buxheteve në periUt e mëparshme, si dhe mos respektimi për çdo rast i kërkesave për programimin e buxheteve vjetore dhe atyre afatmesme.

Rëndësia: E mesme

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si Ministritë e linjës etj.).

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës (progresive). Me fondet e vitit buxhetor ushtrimor, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZHR është konfirmuar se nuk ka detyrime të prapambetura ndër vite, por ai i krijuar në 2022.

Ky plan pasqyrohet në tabelën mëposhtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi i Detyrimeve	Totali i borxhit	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
1	Investime	324,120	324,120	-	-
2	Mallra & shërbime	88,419	88,419	-	-
3	Vendime Gjyqësore	0	0	-	-
Totali		**412,539**	**412,539**		

Burimi: Bashkia Kamëz

Situata e detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhëse në buxhetet respektive për vitin 2022, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Në mije lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2021	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2022	Total detyrime	Shlyerja gjate 2022	Mbetja në fund të vitit 2022
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës/ Rindërtimi dhe AKUM	151,367	245,284	396,651	151,367	245,284
b. Investime nga Bashkia	172,753	108,754	281,507	126,006	155,501
Investime	**324,120**	**354,038**	**678,158**	**277,373**	**400,785**
Mallra dhe shërbime	88,419	55,262	143,681	88,419	55,262
Vendime gjyqësore	0	0	0	0	0

Të tjera ...	0	0	0	0	0
Nëntotal	**88,419**	**55,262**	**143,681**	**88,419**	**55,262**
Totali	**412,539**	**409,300**	**821,839**	**365,792**	**456,047**

Burimi: Bashkia Kamëz

Me mbylljen e vitit ushtrimor, rezultojnë edhe vlerat e sakta të detyrimeve; gjithashtu kolona e gjendjes në fund të vitit 2021 është në vlerën e 412,539 mijë lekë (investime, mallra dhe shërbime).

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në rrugë elektronike dhe shkresore. Raportimi në ministri është bërë sipas udhëzimit nr. 2 datë 20.01.2020 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*", pika 106, ku citohet:

"*Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara që **jo më vonë se** data 10 Prill 2020 për remujorin e parë, 10 Korrik 2020 për tremujorin e dytë, 10 Tetor 2020 për tremujorin e tretë dhe 30 Janar 2021 për tremujorin e katërt, të dërgojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë inforM onin me shkrim dhe në rrugë elektronike për detyrimet e prapambetura sipas Shtojcës 5, "Raportimi periodik për detyrimet e prapambetura" bashkëlidhur këtij udhëzimi.*"[5]

Raportimi në degën e thesarit për vitin 2022 është dorëzuar me shkresën nr. 1712 prot., datë 21.02.2023, konform Udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*".

- Deri *<u>në 31.12.2021</u>* është në vlerën e 412,538 mijë lekë, ku 261,172 mijë lekë janë nga "investimet e bashkisë" dhe "mallra dhe shërbime"; <u>për vendimet gjyqësore nuk ka detyrime</u>;
- *<u>Për vitin 2022</u>* nga vlera e planifikuar dhe e miratuar me VKB për likujdim prej 821,839 mijë lekë, është paguar 365,792 mijë lekë ose 44.5% e saj, duke u mbartur për tu paguar në vitin 2023. Vlera e detyrimit sipas planifikimit për vitin 2023 shkon në vlerën 456,047 mijë lekë.

Një pasqyrim të detajuar të detyrimeve të prapambetura për periudhën deri më 31.12.2022, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021	Vlera e planifikuar për likujdim në planin e buxhetit 2022 për detyrimet e prapambetura	Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2021 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2022)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2022 (situata më 31.12.2022)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022
1	2	3	4	5	6=3-5	7	8=6+7
	I. Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta						
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore						
4864200	Detyrime për sherbime	88,419,120	88,419,120	88,419,120	0	55,261,950	55,261,950
4864300	Detyrime për mirembajtje						
4864400	Detyrime për investime	172,752,415	172,752,415	128,437,827	44,314,588	111,186,041	155,500,629
4864400	Detyrime për nga Ministrite e Linjes (specifiko FZHR etj...)						
4865600	Detyrime për mallra						
4864900	Detyrime te tjera						
Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta		**261,171,535**	**261,171,535**	**216,856,947**	**44,314,588**	**166,447,991**	**210,762,579**
	II. Detyrime te prapambetura nga granti (FZHR etj (Ministrite e linjës)						

[5] Në raportimet e bëra respektohet viti ushtrimor në të cilin realizohen shpenzimet vjetore të planifikuara në PBA

4864400	Detyrime për Investime nga Ministrite e Linjes (Min. e Infrastruktures) AKUM dhe Rindertim	151,366,885	151,366,885	151,366,885	0	245,284,182	245,284,182
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore (Min. e Brendshme per punonjes te GJ.Civile)	0					0
Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi Grantin		**151,366,885**	**151,366,885**	**151,366,885**	**0**	**245,284,182**	**245,284,182**
Detyrime ne total nga të ardhurat e veta + granti		**412,538,420**	**412,538,420**	**368,223,832**	**44,314,588**	**411,732,173**	**456,046,761**

Burimi:Bashkia Kamëz

Vlerat e detyrimeve të prapambetura përputhen me ato të konfirmuara nga MFE.[6]
Në mënyrë analitike po pasqyrojmë më poshtë detyrimet e prapambetura, vitin e krijimit, likuidimet pjesore apo të plota, vlera e detyrimit e mbartur për vitin 2023.

I DETYRIMET ME BURIM FINANCIMI NGA FONDET E BASHKISE

A. Vendimet Gjyqësore

Bashkia Kamëz aktualisht *nuk ka procese gjyqësore* për proçedura të vitit 2022 apo edhe për vitet paraardhëse për "dëmshpërblim page", "shpronësime", "dëmshpërblime" etj

B. Detyrime për Investimet (nga të ardhurat e veta)

Nr	Emërtimi Objektit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri i faturës	Data e Fatutës	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2021	Shtesat gjate vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
1	Ndertim rruga Halim Xhelo + Isa Boletini +Leka e Madh	K SHPK	-	-	-	1,890,829	0	1,890,829	0
2	Ndertim Rruga "Kukesi, Republika e Re"	N SHPK	08.04.2019	9	10.10.2020	15,572,316	2,572,316	15,572,316	2,572,316
3	Nderti m Rruga "Abaz Ermenji", rruga Ded Gjo Luli …Arben Broci …	N	-	-	-	19,999,029		19,999,029	0
4	Ndertim rruga e "Zanave " , Kaltersia + seg rruga e Arberit	K SHPK				10,359,678		10,359,678	0
5	Ndertim rruga Sado Koshenka	K				257,280		257,280	0
6	Ndertim ruga "Sali Murat Vranishti" + rruga "Hasan Zylfia" plus rruga Kaci	K				4,694,058		4,694,058	0
7	Ndertim rruga "Lure + Fatos	B SHPK	13.11.2020	10	29.12.2021	2,448,943	2,448,943		2,448,943

[6] https://financa.gov.al/detyrimet-e-prapambetura-2022/

	Çupi” Laknas								
8	Ndertim Pekin Rekjaviku Poliçan	K SHPK	12.11.2020	7	05.05.2021	7,887,675	7,112,325		15,000,000
9	Ndertim rruga Gjirokaster , Rruga Ansterdam, Rruga Perjetesia, Rruga Fierze …..	B SHPK	31.05.2019	148	30.11.2021	14,835,042	38,824,676	8,000,638	45,659,080
10	Ndertim rruga a’Ndoc Deda” dhe vazhdim seg Mustafa Xhani	B SHPK				7,892,856		7,892,856	0
11	Ndertim rruga .. Spirp Kote , rruga Pjeter Budi + Sali Myftia rruga lidhese Prengaj deri tek rr zef Serembe	K SHPK	02.05.2019	285	15.08.2019	11,697,456	26,848,000	11,697,456	26,848,000
12	Ndertim rruga Faik Konica , F Noli Paskuqan 2	N SHPK	31.07.2019	27	01.05.2020	683,048	683,048	5,046	678,002
13	Rikonstruksion shkolla Vllazerimi Fush K Babrurcik	N SHPK				5,103,751		5,103,751	0
14	Ndertim rruget (Iliria+ Burimi+Mbreteresha Suzane)	N SHPK	24.10.2018	16	06.04.2019	13,978,219		8,100,000	5,878,219
15	Ndertim rruga Myslim Shyri	N SHPK				3,479,748		3,479,748	0
16	Ndertim shkolla 9 vjecare Frutikulture	4 AM				15,445,957		15,445,957	
17	Nderti Ura Paskuqan 1	4 AM	12.10.2020	3	18.02.2021	39,658,521		13,512,622	26,145,899
18	Rikonstruksion rruga 2 Prilli….	A	17.12.2020	17	29.06.2021	2,800,627	2,800,627		2,800,627
19	Nderti rruga Bajram Curi+ Macukull	C SHPK	29.08.2018	546	31.05.2019	790,016	790,016		790,016
20	Ndertim rruga Gjergj Fishta	E	12.11.2020	5	07.06.2021	903,460	903,460		903,460

21	Ndertim rruga Nik Ndreka	ESHPK	29.10.2020	2714	01.10.2022		239,860		239,860
22	Ndertim rruga Loro Boriçi	GSHPK					294,907		294,907
23	Ndertim rruget Hasan Zylfia + rruga 28 Nentori	J SHPK					1,547,5741		1,547,574
24	Ndertim rruga Fahri Ramadani	K SHPK	18.12.2020	8	02.12.2021	1.031.388	1.031.388		1.031.388
25	Rikonstruksion I rruges Berisha	K	15.02.2021	25	28.05.2021	3,618,771	3,618,771	1,418,138	2,200,633
26	Ndertim rruga Havzi Nela + Ilia kaci	K	05.06.2019	39	28.10.2021	1,921,567	1,921,567	1	1,921,566
27	Ndertim rruga Demokraci a loti III Bathore	L	21.12.2021	131	02.12.2022		12,881,622		12,881,622
28	Ndertim rruga Macukull .. Gjallica etj	N					1,008,424	1,008,424	0
29	Ndertim seg I rruges Deja	N SHPK	20.08.2021	66	06.07.2022		5,658,517		5,658,517
Totali i detyrimit						**172,752,415**	**111,186,041**	**128,437,827**	**155,500,629**

Nga auditimi rezultoi se në fund të vitit 2021 janë 17 subjekte kreditore ndaj Bashkisë Kamëz me 26 fatura të palikuiduara në vlerën totale prej 172,752,415 lekë; në vitin 2022 janë shtuar 6 fatura të reja nga totali i të cilave janë likuiduar plotësisht ose pjesërisht 17 fatura në vlerën 128,437,827 lekë duke trashëguar për tu likujduar në vitin 2023 sipas planit të likuidimeve 20 fatura në vlerën totale 155,500,629 lekë; **u konstatua** se për likuidimin e detyrimeve të prapambetura ndaj subjekteve, bashkia Kamëz nuk ka respektuar radhën për likujdimin e atyre të krijuara më herët, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit" pika 13;

C. Detyrime për Mallra dhe Shërbime (nga të ardhurat e veta)

Nr.	Emërtimi i Objektit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2021	Shtesat gjate vitit 2022	Shlyerjet gjatë vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
1	Pagesa periodike sipas nenit 16 te kontarates te koncensionarit per pastrimin e qytetit (pagesa e autoritetit dhe tarifa koncensionare	E SHPK	23.05.2018	Fat nr.11 dt 01.07.2022	88,419,120	55,261,950	88,419,120	55,261,950
				Fat nr.16 dt 28.09.2022				
				Fat nr 17 dt 28.09.2022				
				Fat nr 18 dt 14.10.2022				
				Fat nr 19 dt 01.11.2022				

Totali i detyrimit	**1**	**5**	**88,419,120**	**55,261,950**	**88,419,120**	**55,261,950**

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Kamëz deri në fund të vitit 2021 është debitore "për mallra e shërbime" ndaj 1 subjekti me vlerë totale të faturës së shërbimit prej 88,419,120 lekë; gjatë vitit 2022 kanë hyrë për tu likuiduar edhe 4 fatura në vlerën totale 55,261,950 lekë; gjatë vitit 2022 janë likuiduar detyrimi i mbartur prej 88,419,120 lekë dhe janë trashëguar për tu paguar në vitin 2023 faturat e vitit 2022. Nga auditimi *rezulton* se likuidimi i faturave të prapambetura për mallra e shërbime të kryera ndër vite, është kryer sipas radhës konform VKM nr. 50 datë 5.2.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit" pika 13;

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre

II DETYRIME ME BURIM FINANCIMI NGA BUXHETI I SHTETIT (GRANTI)

	Emërtimi	Objekti	Numer fature/date	Gjendje 31.12.2021	Paguar 2022	Detyrimi i krijuar gjatë 2022	Gjendje më 31.12.2022	Burimi financimit
1				151,366,885	151,366,885	245,284,182	245,284,182	AKUM & Rindërtimi
	Totali Detyrimeve nga Fondi RiN t dhe AKUM			**151,366,885**	**151,366,885**	**245,284,182**	**245,284,182**	
	TOTALI I DETYRIMIT I + II						**456,046,761**	

Burimi:Bashkia Kamëz

Nga auditimi *rezulton* se gjendja e detyrimit deri në 31.12.2021 të investimeve me burim financimi nga buxheti i shtetit ku përfshihen fondet e rindërtimit dhe fonde nga AKUM-i është 151,366,885 lekë, vlerë e cila është likuiduar plotësisht në masë të plotë; gjatë vitit 2022 vlera totale e faturave të palikuiduara nga bashkia Kamëz deri në 31.12.2022 është 245,284,182 lekë, vlerë kjo që është mbartur për tu likuiduar në vitin 2023; kështu Bashkia Kamëz trashëgon për vitin 2023 një detyrim në vlerë totale 456,046,761 lekë.

- ***Programimi i fondeve për faturat e pa likuiduara në fund të periUve ushtrimore:***

Nga auditimi i PBA 2022-2024/Planit vjetor 2022, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, rezultoi se nuk është planifikuar më vete fondi *për programin 04960 "planifikim për detyrimet e prapambetura".* Fondi për likuidimin e tyre është përllogaritur duke u përfshirë në programet respektive. Nga auditimi i likuiditeteve *rezulton* se kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2022, për pamundësi likuiditeti të "Investime" dhe "mallra e shërbime", duke e kaluar afatin 60 ditor, kjo për arsye se nga Bashkia Kamëz në vitet paraardhëse nuk janë bërë planifikime të përllogaritura në mënyrë të studiuar që të bëhet e mundur likuidimi i çdo fature shërbimi apo mallrash brenda vitit ushtrimor. Kjo për shkak të mosrealizimit të të ardhurave sipas planifikimit.

Në gjykimin e grupit të auditimit planifikimi i fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në programin 04960, do rezultonte me menaxhim më me efektivitet të fondeve për çdo program të buxhetuar. Kjo është bërë e pamundur, pasi siç e theksuam edhe më lart, nga ana e MFE është reduktuar numri i programeve buxhetore për NJVQV

Bashkia Kamëz ka hartuar Raportin e Vetëvlerësimit Financiar për periudhën janar-Dhjetor 2022, miratuar nga Kryetari i bashkisë dhe rregjistruar me nr. 1709 prot., datë 21.02.2023. Ky raport i është dërguar në rrugë elektronike dhe me postë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë /Drejtoria e Financave Vendore. Situata e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit ushtrimor 2022 dhe klasifikimi i bashkisë mbi shkallën e vështirësisë financiare është si më poshtë :

NR	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	**Borxhe (a+b)**	**0**		
a	**Hua afatgjatë**	**0**		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	**Hua afatshkurtër**	**0**		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	**Detyrime (a+b+c)**	**210,762,579**		**8.35%**
a	**Shpenzime korrente**	**55,261,950**		
a,1	Mallra dhe shërbime	55,261,950		
a,2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera			
b	**Shenzime kapitale**	**155,500,629**		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private	325,018,780		
c	**Vendime gjyqësore**	**0**		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera	0		
III	**Totali (I+II)**	**210,762,579**	**2,525,160,073**	**8.35%**

Burimi: Bashkia Kamëz

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore				
	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare	Paaftësi paguese
Situata Normale e gjendjes fiannciare	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%
8.35%	**0**	**0**	**0**	**0**

Burimi: Bashkia Kamëz

Nga informacioni i pasqyruar në tabelë dhe i raportuar në MFE, rezulton se Bashkia Kamëz është *<u>në situatë normale financiare</u>*.

<u>Pretendimi i subjektit</u>: Në observacionin e dërguar nga Subjekti /Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit me shkresën nr. 226 prot., datë 09.01.2024 dhe me nr. 873/6 prot., datë 11.01.2024 (KLSH) dhe ridërguar me shkresën nr. 1751/1 prot., datë 29.02.2024 dhe nr. 873/7 prot., (KLSH) datë 04.03.2024 pretendohet si vijon: Pasi u njohëm me aktkonstatimin nr. 4, datë 29.12.2023, regjistruar në protokollin e bashkisë me nr. 9847/10 prot.datë 29.12.2023, po Ju paraqesim shpjegimet si vijon: Sa konstatuar në pikën 1.2 të Aktkonstatimit sqarojmë se Bashkia Kamëz ka zbatuar me përpikmëri programimin buxhetor duke planifikuar fonde dhe duke I kushtuar rëndësi programeve. Në hartimin e PBA jemi bazuar në instrumentin e planifikimit financiar, si dhe në UMF nr. 7 datë 25.02.2022 "Për një ndryshim në UMF nr. 23 datë 30.07.2018, për proçedurat standarte të përgatitjes së PBA të njësive të vetëqeverisjes vendore". Në shtojcën 1 është shënuar lisat e programeve që do të përdoren nga NJQV dhe nuk janë përfshirë programet e mëposhtme: Programi 056 "Ndergjegjësimi mjedisor", Programi 105 "Papunësia", Programi 036 "Marrëdhëniet në komunitet", Fondet për këto programe janë rritur nga viti në vit.Programi 052 "Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve", i është kushtuar vëmendje e veçantë pasi është krijuar Ujesjellës Kanalizimesh.a, si shoqëri mëvete e cial ka si objekt: *Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatoreve dhe shitja e tij; Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve; Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura; Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.* Kjo shoqëri planifikon fonde të konsiderueshme për realizimin e objektit të veprimtarisë. Programi 051 "Menaxhimi i mbetjeve", ku fondet për këtë program janë planifikuar në bazë të kontratës së

shërbimit të pastrimit të qytetit. Programi 041 “Mbështetje për zhvillimin ekonomik, shërbimi i tregjeve…..”, ky program është përfshirë në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”. Për vitin 2023 ky program është planifikuar më vete. Programi 07/2 “Shërbimi shëndetësor”, nga Ministria e Shëndetësisë dhe ceshtjeve sociale nuk na është planifikuar asnjë shpenzim për këtë program. Programi 036 “Marrëdhëniet në komunitet”, ky program është përfshirë në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”. Programi 105 “Papunësia”, ky program është përfshirë në programin 10430 “Përkujdesi social”. Programi 056 “Ndërgjegjësimi mjedisor”, ky program është përfshirë në programin 6260 “Shërbimet publike”.

- Sa konstatuar në lidhje me planifikimin buxhetore sqarojmë se: Për hartimin e buxhetit (dhe ndryshimet gjatë vitit) ju dërgohet shkresë të gjitha drejtorive që mbledhin të ardhura dhe kryejn e shpenzime, për paraqitjen e të dhënave, konkretisht me shkresen nr. 7195 prot. date 11.08.2022, ….etj. Pas paraqitjes së të dhënave hartohen tabelat përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore. Theksojmë se mosrealizimi i të ardhurave në pjesën më të madhe është tek zëri taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet dhe taksat dhe tarifat vendore për familjaret. Për këto dy zëra drejtoritë përkatëse janë të detyruar ti planifojnë pavarësisht nivelit të arkëtimit.
- Sa konstatuar në lidhje me Likuidimin e detyrimeve të prapambetura sqarojmë se:

Planifikimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 (trashëguar nga viti 2021) është berë në masën 100 % të vlerës. Detyrimet datë 31.12.2022 janë detyrime që janë krijuar gjatë vitit 2022, vlerë e cila ka ardhur në ulje nga viti në vit. (Bashkëngjitur në rrugë elektronike Udhëzimin nr. 7 datë 25.02.2022 dhe Udhëzimin nr.3 datë 28.002.2024). Duke shpresuar që shpjegimet do të merren në konsideratë:

Qendrimi i grupit të auditimit: Lidhur me observacionin tuaj mbi konstatimet e grupit të auditimit të përcjella në Akt konstatimin nr. 4 datë 29.12.2023 dhe Projekt Raportin e Auditimit me nr. 873/7 prot., datë 29.01.2024, ju sjellim në vëmendjen tuaj si më poshtë vijon: grupi i auditimit ka ushtruar auditim për periudhën 01.01.2022-31.12.2022; - Në paragrafin e parë për planifikimin e programeve buxhetore baza ligjore të cilës ju i jeni referuar UMF nr. 7 datë 25.02.2022, e cila vlen për hartimin e PBA-së dhe Planit vjetor 2023 e në vazhdim, ndërsa për hartimin e PBA 2022-2024 dhe Planit vjetor buxhetor 2022 jeni mbështetur në UMF nr. 23 datë 30.07.2018 e cila ka patur në përmbajtje të saj 36 programe, duke lënë mundësi mjaftueshëm për të përzgjedhur ato programe që janë pjesë e strategjive dhe planeve të zhvillimit vendor. Për programin 052 “Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve“ *merret parasysh nga grupi i auditimit*; Programi 105 “Papunësia“ përfshin politikat e Njësisë për uljen e papunësisë dhe ju pretendoni se është përfshirë në programin 10430 “Përkujdesi social” por rezulton se ky program përfshin fondet per ndihmën ekonomike , PAK etj. Dhe asnjë angazhim për uljen e papunpsië; Për program 072 “Shërbimi shëndetësor“ referuar nenit 23 të ligjit nr. 139/2015 ka funksion ndër të tjera "Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj"; duhet theksuar se ka edhe mungesë komunikimi dhe bashkëveprimi mes Bashkisë dhe Ministrisë së linjës për të përmbushur detyrimet ndaj komunitetit konform përcaktimeve ligjore; Programi 056 "Mbrojtja e mjedisit" ju pretendoni se është përfshirë në programin 06260 “Shërbimet publike”. Pastrimi i qytetit është shërbimi i programit 051 dhe mjedisi përmban 8 komponentë të tij: ajri, toka, uji, biodiversiteti, flora, fauna, zhurmat dhe klima për mbrojtjen e të cilëve nga auditimi rezulton se nuk janë përmbushur detyrimet e bashkisë për këtë funksion ndaj komunitetit si me mungesë të specialistëve të fushës ashtu edhe me planet vendore për mbrojtjen e mjedisit, përcaktuar në nenet 26 dhe 27/4,6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Pra pretendimi juaj në paragrafin e parë ***merret pjesërisht në konsideratë nga grupi i auditimit.***

- Lidhur për pretendimin në paragrafin e dytë konstatimi ynë ka asistuar pikërisht në faktin e planifikimit buxhetor që keni mbështetur mbi planin e të ardhurave dhe jo nga analiza e vlerës faktike të arkëtuar. Mungesa e analizave periodike dhe mosmarrja e masave apo hartimi i planeve strategjike dhe strategjive nga ana e bashkisë për të maksimizuar vjeljen e të ardhurave. Referuar Ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”neni 5 pika a citon ”*...Në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme...*”; neni 32 pika 3; neni 36 pika 2; neni 42 pika 1 ku citohet “*...Të ardhurat e miratuara në vendimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për buxhetin vjetor, përbëjnë kufirin minimal për t’u arkëtuar gjatë vitit buxhetor...”.* Për sa më lart peretendimi juaj në paragrafin e dytë ***nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.***

- Lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton sic edhe ju e pranoni me lindjen e detyrimeve të reja. Pra pamundësi likuiditeti në kohën e konstatimit të detyrimit brenda afatit 60 ditor. Planifikimi buxhetor përfshin edhe vlerën e detyrimeve të prapambetura që në fakt i përket programit *04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”* edhe planifikimin e fondeve për "investime" dhe "mallra e shërbime", gjë të cilën ju e keni përfshirë në programet respektive duke mos iu përgjigjur në kohë as me likuiditet pjesor. Referuar Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018, Udhëzimit nr. 7 datë 25.02.2022 dhe Udhëzimit nr, 3 datë 28.02.2024 dhe shtojcave të tyre, përsa i pëket konstatimeve qëndrojnë pasi ne kemi audituar periudhën 01.01.2022-31.12.2022; përsa i përket rekomadimeve përkatëse do merren parasydh udhëzimet e dala pas periudhës audituese që të vlejnë për

përmirësimin e punës për periUt në vijim. Për sa më lart pretendimi juaj ***merret pjesërisht në konsideratë nga grupi i auditimit***.

Titulli i gjetjes: Mbi planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga detyrimet kontraktuale për mallra, shërbime dhe investime u konstatua se:

Situata: 7. Në PBA 2022-2024/Planit vjetor 2022, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, u konstatua se fondi për detyrimet e prapambetura nuk është planifikuar veçmas në programin 04960 "planifikim për detyrimet e prapambetura", por është përllogaritur i përfshirë në fondin e secilit program që mbart detyrime; mos ndarja e fondeve sipas programeve përkatëse pra sipas destinacionit të përdorimit, ka sjellë likuidimin pjesor apo të plotë të detyrimeve të prapambetura (sipas rastit) dhe pamundësi likuiditeti të të gjitha faturave për "mallrave e shërbime" e "investimeve" të vitit ushtrimor për mungesë fondesh, duke u shoqëruar me lindjen e detyrimeve të reja dhe trashëgimin e tyre për vitin pasardhës. Rezultoi se vlera e detyrimeve të prapambetura sipas bilancit përputhet me atë të raportuar në MFE. Në gjykimin e grupit të auditimit planifikimi i fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në programin përkatës 04960, do të rezultonte me një menaxhim më me efektivitet të fondeve për çdo program të buxhetuar, në raste se nuk do të ishin reduktuar numri i programeve buxhetore nga MFE nëpërmjet udhëzimeve përkatëse: Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018, Udhëzimit nr. 7 datë 25.02.2022 etj.

8. Nga auditimi rezultoi se në fund të vitit 2021 janë 17 subjekte kreditore ndaj Bashkisë Kamëz për zërin "investime" me 26 fatura të palikuiduara në vlerën totale prej 172,752,415 lekë; në vitin 2022 janë shtuar edhe 6 fatura të reja nga totali i të cilave janë likuiduar plotësisht ose pjesërisht 17 fatura në vlerën 128,437,827 lekë, duke trashëguar për tu likujduar në vitin 2023 sipas planit të likuidimeve 20 fatura në vlerën totale 155,500,629 lekë; u konstatua se për likuidimin e detyrimeve të prapambetura ndaj subjekteve për zërin "investime", Bashkia Kamëz nuk ka respektuar radhën për likuidimin e atyre të krijuara më herët, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit" pika 13;

-Bashkia Kamëz deri në fund të vitit 2021 është debitore "për mallra e shërbime" ndaj 1 subjekti me vlerë totale të faturës së shërbimit prej 88,419,120 lekë; gjatë vitit 2022 kanë hyrë për tu likuiduar edhe 4 fatura në vlerën totale 55,261,950 lekë tre (3) prej të cilave në tejkalim të afatit 60 ditor; gjatë vitit 2022 janë likuiduar detyrimi i mbartur prej 88,419,120 lekë dhe janë trashëguar për tu paguar në vitin 2023 faturat e palikuiduara të vitit 2022.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar; UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 "*Për buxhetin e vitit 2020*", Aktin Normativ Nr.15, datë 15.4.2020; VKM nr. 50 datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimi"; Udhëzimit nr. 5 datë 27/02/2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura si dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i radhës së kreditorëve për likuidim sipas radhës brenda llojit, të periudhës së krijimit të detyrimit, sjell lindjen e detyrimeve të reja dhe shtimin e vlerës të atyre të krijuara në periudha të mëparshme, dukuri e cila nëse vijon për një periudhë relativisht të gjatë, riskon të kalojë në vështirësi financiare bashkinë dhe si pasojë uljen e performancës së shërbimeve të saj ndaj komunitetit;

Shkaku: Moszbatimi i akteve ligjore/nënligjore në fuqi lidhur me hartimin e PBA dhe Planeve vjetore të buxhetit mbi nevojat e komunitetit dhe të realizimit faktik të buxheteve

paraardhëse, mungesa e përllogaritjeve të studiuara të fondeve për shpenzim sipas cdo programi në raport me të ardhurat faktike dhe jo mbi planifikimin e tyre etj;
Rëndësia: E mesme.

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: (1) Z. R.S. Kryetar i Bashkisë Kamëz; (2) Znj.V.S Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Kontabilitetit; (3) Znj. U.E Koordinator i MFK; (4) Znj. R.B Koordinator i Riskut; (5) Anëtarët (18) e GMS në cilësinë e Menaxherëve të strukturave përkatëse të Bashkisë Kamëz, caktuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 330 datë 16.06.2021.

2.3.1 Vështrim i përgjithshëm mbi Zbatimin e rregullave dhe të proçedurave të përcaktuara për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të dala për menaxhimin e situatës së fatkeqësisë natyrore- tërmetit të 26 Nëntorit.

Paketa e Akteve ligjore mbi të cilat u fokusua grupi i auditimit është:

1. Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore";
2. Ligji nr.22/2018 'Për strehimin social';
3. Akt normativ nr. 6, datë 30.11.2019 'Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019';
4. Akt normativ nr. 7, datë 30.11.2019 'Për një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
5. Akt normativ nr. 8, datë 7.12.2019 "Për përdorimin e proçedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019";
6. Akt normativ nr. 9, datë 16.12.2019 'Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore'
7. Vendim nr. 751, datë 29.11.2019 për disa shtesa në vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të këshillit të ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Kamëz dhe Tiranë";
8. VKM nr. 878, datë 24.12.2019, "Për përbërjen, organizimin e veprimtarive dhe rregullat e funksionimit të KSHR"
9. VKM nr. 5, datë 6.1.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model";
10. VKM nr. 6, datë 6.1.2020 "Për kushtet, kriteret dhe proçedurat për zbatimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike";
11. VKM nr.26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara";
12. Akt Normativ nr. 37 datë 24.12.2020 "Për një ndryshim në Aktin Normativ nr. 8 datë 07.12.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e Proçedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qerasësh banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019".(ndryshim i nenit 7).

Politika e rindërtimit është ndërmarrë nga Ministria e Rindërtimit [MR] (*riN .gov.al*), e cila u krijua me Vendim nr. 11, datë 10.1.2020 – për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, për drejtimin e gjithë procesit sëbashku me Komisionin Shtetëror të Rindërtimit [KSHR] me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore – tërmetit të 26 nëntorit 2019 & për përbërjen, organizimin e veprimtarive dhe rregullat e funksionimit të [KSHR] si organ kolegjial. Aktorët e tjerë për rindërtimin dhe rivitalizimin e zonave të prekura nga tërmeti janë: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile [AKMC], Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit [AKPT], Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore/Bashkitë [NJVQV/B], si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit [FSHZH] *si njësi zbatuese* për rindërtimin e shtëpive individuale; grupimin dhe rindërtimin e shtëpive individuale në

zonat rurale, bashkë me ndërtimin e infrastrukturës mbështetëse; si dhe ndërtimin e lagjeve të reja urbane. Për këtë, qeverisja ndërmori rolin kryesor për përballimin e pasojave post-fatkeqësi, përkundër një qasjeje nga poshtë-lart, e cila sheh si thelbësor rolin e aktorëve në komunitet.

Edhe Bashkia Kamëz, për menaxhimin e situatës së rëndë të krijuar nga fatkeqësia natyrore - tërmeti i 26 Nëntorit 2019, u angazhua për përballimin dhe menaxhimin e situatës. Për zbatimin e akteve ligjore/nënligjore dhe menaxhimin më me efektivitet të situatës kontribuan të gjitha njësitë e strukturës së bashkisë dhe veçanërisht Drejtoria e Rindërtimit, njësi e krijuar enkas për menaxhimin me efektivitet të situatës.

I. Referuar përcaktimeve të kuadrit ligjor, grupi i auditimit përgatiti një pyetsor mbi të cilin do jepet një pasqyrim i aktivitetit të Bashkisë Kamëz për këtë proçedurë. Pyetsori iu dërgua Drejtorisë së Rindërtimit me rrugë elektronike (*e-mail datë 16.10.2023)*.

1. Në Bashkinë Kamëz cila njësi e strukturës organizative u angazhua për menaxhimin e situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019?
2. Numri i aplikuesve nga regjistri elektronik " Shtëpia Ime" për vitin 2022;
3. Kërkesa e Bashkisë Kamëz me <listën e nevojave> drejtuar Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për grante ku përfshihen: llojet e granteve, buxhetin përkatës, arsyetimin e përzgjedhjes së programit të granteve të rindërtimit etj;
4. Lista e përfituesve nga granti i subvencionit të qerasë, VKB–të për çdo listë të hartuar;
5. Komisioni i vlerësimit të aplikimeve (përbërja); Nga rregjistri i aplikimeve, a ka një listë me aplikantë jo fitues? Nëse po, të na vihet në dispozicion;
6. A ka patur një listë drejtuar Institutit të Ndërtimit për ekspertizë të thelluar? Nëse po të na vihet në dispozicion;
7. Referuar përllogaritjes në preventiv dhe shpërndarjes së fondeve (grantit) të përfituesit (likuidimit), të jepet informacioni sipas kërkesave të tabelës;
8. Shpërndarja e grantit sipas formularëve për vitin 2022;
9. Të vihet në dispozicion lista e përfituesve që janë likuiduar dhe VKB përkatëse.

Përgjigja e këtij pyetësori erdhi po në rrugë elektronike datë 19-20.10.2023. Rezultoi se njësia përgjegjëse në strukturë është Drejtoria e Rindërtimit, krijuar dhe miratuar me VKB nr. 37 datë 14.01.2021 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz"; ndërsa paralelisht është vazhduar puna në bashkëpunim me grupet e punës dhe komisionet e ngritura me Urdhër të brendshëm të kryetarit të bashkisë, konform kërkesave të akteve ligjore/nënligjore për rastet e fatkeqësive natyrore dhe ato të dala për fatkeqësinë natyrore tërmetin e 26 nëntorit 2019.

Struktura e Drejtorisë së Rindërtimit viti 2022				
Nr	**Emër Mbiemër**	**Pozicioni në strukturë**	**Formimi arsimor**	**Emërimi në detyrë**
1	F. Ç	Drejtor Drejtorie	Inxhinieri ndërtimi	U nr. 315 dt. 22.07.2020
2	D.Gj	Përgjegjës sektori	Juridik	U nr. 298 dt. 01.04.2022
3	A.L	Specialist rindërtimi	Menaxhim mjedisi	U nr. 408 dt. 06.08.2021
4	L.T	-//-	Ekonomiks	U nr. 294 dt. 01.06.2021
5	M.P	-//-	Administrim Ndërmarrjesh	U nr. 216 dt. 01.03.2022

Burimi: Bashkia Kamëz

II. Bashkia Kamëz disponon regjistrin elektronik në platformën on line "SHTËPIA IME", në zbatim të VKM nr. 5, datë 6.1.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" kreu II pika 10;
Nga auditimi *rezultoi* se gjatë vitit 2022 nuk ka patur aplikime në regjistrin elektronik "Shtëpia ime". Aplikimet në këtë portal janë mbyllur në fund të vitit 2020.
III. Bashkia Kamëz i vuri në dispozicion grupit të auditimit, kërkesat me "listën e nevojave" të miratuara me VKB drejtuar Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për grante, ku pëfshihen: llojet e granteve, buxheti përkatës, arsyetimin e përzgjedhjes së programit të granteve të rindërtimit etj.
Urdhrat e Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Kamëz janë në zbatim të VKM nr. 5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", i ndryshuar dhe Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
IV. Në Bashkinë Kamëz për vitin 2022 *nuk ka patur aplikime të reja*, për të përftuar nga granti i Rindërtimit;
V. Në Bashkinë Kamëz gjatë vitit 2022, komisioni i posaçëm lidhur me aplikuesit që janë skualifikuar, ka njoftuar zyrtarisht Drejtorinë e Rindërtimit si më poshtë:

Dosje të aplikuesve për grante nga rindërtimi të trajtuara nga komisioni i posaçëm në vitin 2022					
Bashkia Kamëz	**Nr. i shkresës**	**Komisioni i Posaçëm**	**Numri i dosjeve të aplikuara**	**Numri i aplikantëve të skualifikuar**	**%**
Lagjja Administrative nr. 2	8310/1 dt. 16.09.2022	N.K Kr. P.M M.Sh E.S J.P	42	34	**81**
Njësia Administrative Bathore	8475 dt. 21.09.2022	Y.SH L.S Sh.T E. S M.M	33	31	**94**
Njësia Administrative Paskuqan	8476 dt. 21.09.2022 8538 dt. 23.09.2022	E.B M.Sh L.D Xh.D F.Sh	73	62	**85**
3			**148**	**127**	**86**

Burimi: Bashkia Kamëz

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacionit në tabelë, *rezultoi* se deri në afatin e raportuar, situata e administrimit të dosjeve të aplikuara, të verifikimit dhe vendimit mbi vijueshmërinë e trajtimit të tyre, tregon për një numër të ulët të përfituesve nga grantet e rindërtimit dhe një numër të lartë të aplikuesve të skualifikuar në masën 86%.

- Nga listat e hartuara nga komisioni i posaçëm i secilës njësi administrative dhe tabela statistikore bashkëngjitur tyre, përcjellë Drejtorisë së Rindërtimit/Bashkia Kamëz, aplikuesit e kualifikuar pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emër	Atësi	Mbiemër	Nivel i dëmit	Shtojca A9,B, B1,C	V. Leje legalizim Ç.Pronësie	V. Fakti Kryeplak/ Administrator	Çertifikatë. Familjare	Akt Konstatim	Akt Ekspertize	Statusi	VKB e miratuara
Lagjja Administrative nr. 2												
1	N	O	Sh	DS4	√	√	JO	√	JO	√	Kualifiku	34/2022
2	M	Gj	P	DS4	√	JO	√	√	√	√	-//-	116/2021
3	Sh	Z	N	DS4	√	√	JO	√	√	√	-//-	-//-
4	S	H	B	DS5	√	√	√	√	√	√	-//	-//-
5	H	H	B	DS4	√	√	JO	√	√	√	-//-	-//-
6	V	Xh	C	DS4	√	√	JO	√	√	√	-//-	-//-

7	G	R	Xh	DS5	√	√	JO	√	√	√	-//-	-//-
8	A	M	D	DS4	√	√	JO	√	√	√	-//-	-//-
Njësia Administrative Bathore												**-//-**
1	I	M	Gj	DS4	√	√	√	√	JO	√	-//-	115/2021
2	B	R	S	DS5	√	JO	√	JO	√	√	-//-	-//-
Njësia Administrative Paskuqan												
1	G	A	P	DS1	√	√	JO	√	√	√	-//-	106/2021
2	Sh	R	Z	DS4	√	√	JO	√	√	√	-//-	58/2022
3	L	R	L	DS4	√	√	JO	√	√	√	-//-	107/2021
4	E	A	H	DS5	√	√	JO	√	√	√	-//-	-//-
5	B	D	L	DS4	√	√	JO	√	√	√	-//-	-//-
6	R	H	L	DS5	√	JO	√	√	√	√	-//-	-//-
7	Sh	M	H	DS4	√	JO	√	√	√	√	-//-	-//-
8	C	H	P	DS5	√	JO	√	√	√	√	-//-	105/2021
9	K	H	C	DS5	√	√	JO	√	√	√	-//-	107/2021
10	J	M	N	DS4	√	JO	√	√	√	√	-//-	49/2022
11	A	M	N	DS4	√	JO	√	√	√	√	-//-	49/2022
21					**-**	**7**	**12**	**1**	**2**	**-**	**21**	**8**

Punoi: Grupi i Auditimit

Nga analiza e inforM onit të pasqyruar në tabelë **rezultojnë** disa parregullsi në klasifikimin e përfituesve për mangësi në dokumentacion, për të cilat u kërkua sqarim mbi proçedurat dhe *verifikim i dosjeve*, konkretisht si mëposhtë:

- për mungesë të Vërtetim leje legalizimit apo Çertifikatë pronësisë në 7 raste; Vërtetim fakti nga Kryeplaku apo Administratori në 12 raste; për mungesë të Çertifikatës familjare në 1 rast dhe Akt Konstatimit në 2 raste, për 21 aplikues të kualifikuar.
- Nuk ka asnjë relacion të detajuar mbi arsyet e kualifikimit të tyre edhe pse me mungesa të dokumentacionit;[7]
- Lidhur me këtë konstatim, kërkuam të na vihen në dispozicion dosjet e 21 aplikuesve të kualifikuar si përfitues nga granti i rindërtimit.

• Komisioni i ngritur për vlerësimin e objekteve kolektive të dëmtuara në Valias është si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Formimi arsimor
1	E.Gj	Planifikim dhe Menaxhim Urban
2	E.B	Drejtësi
3	U.E	Drejtësi
4	E.B	Arkitekturë & Dizainer Urban
5	D.B	Financë

Burimi: Drejtoria e Rindërtimit

Ky komision gjatë vitit 2022 ka kualifikuar 141 subjekte të cilët janë ish banorë të pallateve në Valias dhe kanë përfituar njësi banimi në objektet e reja të ndëruara në kuadër të programit të rindërtimit në Valias. Nga ky komision *janë shfuqizuar* 9 subjekte të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Shfuqizime të subjekteve nga Komisioni i Posaçëm,Valias					
Nr.	**Emër**	**Atësi**	**Mbiemër**	**ID**	**Shënime**
1	B	O	Z	E....H	Shfuqizuar me arsyetimin se nga verifikimet e Komisionit të Posacem aplikuesi nuk disponon asnjë dokument ligjor
2	L	I	B	G....K	Aplikuesi ka përfituar strukturën e njësisë së banimit me tipologji 2+1 dhe shfuqizimi bëhet me arsyetimin se Lumturi Breti duhet të përfitojë strukturën e banimit me tipologji 3+1
3	M	Z	K	G....S	Shfuqizimi bëhet me arsyetimin se,nga verifikimet e Komisionit të Posaçëm aplikuesi disponon njësi biznesi dhe jo njësi banimi
4	S	A	D	G....S	Shfuqizuar me arsyetimin se nga verifikimet e Komisionit të Posacem aplikuesi nuk disponon asnjë dokument ligjor
5	S	H	K	E....G	Shfuqizuar me arsyetimin se nga verifikimet e Komisionit të Posacem aplikuesi është kualifikuar si subjekt aplikues I banesave kolektive ndërkohë në të vërtetë rezulton në banesë individuale

[7] Në fund të analizës gjendet paragrafi i sqarimit për konstatimin tonë nga ana e Drejtorisë së Rindërtimit

6	F	T	K	F....E	Subjekti aplikues Filloreta Kita është kualifikuar duke përfituar strukturën e njësisë së banimit me tipologji 3+1.Shfuqizimi bëhet me arsyetimin se,nga verifikimet është konstatuar se aplikuesi është në përbërjen familjare vetëm 1 person dhe si e tillë përfiton tipologjinë banesë 1+1.
7	A	Z	Z	H....K	Arsyetimi I shfuqizimit bëhet në zbatim të faktit se nuk ka patur banesë në objektet kolektive (Pallatet Valias) ,bazuar në vërtetimin e UKK-së ku rezulton se banesa është në rrugën "Shpresa"
8	S	V	C	H....Q	Shfuqizimi bëhet me arsyetimin dhe zbatimin e nenit 5 pika 3 të Aktit Normativ nr.9,datë 16/12/2019 ku përcaktohet se:"Nuk është subjekt përfitues individi ose familja që ka në pronësi ose posedim të ligjshëm ,më shumë se një banesë,në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ,pavarësisht nëse banesa që është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore ka qenë vendbanimi i zakonshëm.Në rast se të gjitha banesat në pronësi ose në posedim janë dëmtuar nga fatkeq/sia natyrore ,individi ose familja përfiton,sipas parashikimeve të këtij akti ,vetëm për banesën që në datën e fatkeqësisë natyrore përdorej si vendbanim i zakonshëm.Nëse pas përfitimit ,sipas kësaj pike,banesa ose banesat e tjera të familjes përfshihen në planin e detyruar vendor,përfitimi i sipërfaqeve nëndërtimet e reja do të kryhet sipas parashikimeve të këtij akti."
9	M	H	D	H....Q	Aplikuesi ka përfituar strukturën e njësisë së banimit me tipologji 2+1 dhe shfuqizimi bëhet me arsyetimin se Mentor Dankshi duhet të përfitojë strukturën e banimit me tipologji 3+1

Burimi; Bashkia Kamëz/DR

[Nga komunikimi verbal me Drejtorinë e Rindërtimit lidhur me kualifikimet, skualifikimet dhe me verifikimin e kritereve për çdo rast, na u dha ky sqarim: *Komisioni i posaçëm verifikon gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit. Pas klasifikimit të çdo aplikimi, bëhet publikimi i listave në cdo stendë të bashkisë apo njësive administrative përkatëse, nëpërmjet të cilave iu jepet mundësia çdo aplikuesi të ankimojë brenda 10 ditëve. Aplikuesit plotësojnë dokumentacionin e munguar për të cilin janë skualifikuar. Në përfundim të kësaj proçedure, komisioni nis në Drejtorinë e Rindërtimit dosjet, listën e aplikuesve sipas statusit dhe shkresën përcjellëse.*]

- Lidhur me proçedurën e ankimimeve, është ngritur Komisioni i verifikimit sipas informacionit në tabelën vijuese:

Komisioni i verifikimit të Ankimimeve			**Rikualifikime 4 aplikues**	**Emër Mbiemër**
Urdhri i krijimit	**Emër Mbiemër**	**Pozicioni në strukturë**		Gj.N
Nr. 338 dt. 26.04.2022	P.Gj	Drejtor NSHP	VKB nr. 66 dt.17.06.2022	R.A
	L.M	Drejtor PP		Xh.D
	G. B	Drejtor NPGJ		M.S

Punoi: Grupi i auditimit

Nga ana e Komisionit të shqyrtimit të ankesave dhe vlerësimit, me shkresën nr. 883 datë 30.01.2023 është hartuar relacioni mbi trajtimin e ankesave ardhur në bashki nga aplikuesit e skualifikuar.

Numri i ankimimeve	**Numri i kualifikimeve nga ankimimet**	**VKB**	**Numri i skualifikuar nga ankimimet**
32	6	66/17.06.2022 11/23.01.2023	**26**

Punoi: Grupi i auditimit

Një pasqyrim mbi numrin e përgjithshëm të aplikimeve jepet në tabelën e mëposhtme:

Viti	**Numri i aplikuesve**	**Numri i përfituesve**	**Numri i të skualifikuarve**
2020	2760	2606	**154**
2021			
2022			

Burimi:Bashkia Kamëz/DR

- Nga verifikimi i dosjeve të 21 aplikuesve të klasifikuar si përfitues nga granti i rindërtimit dhe 4 aplikuesve të kualifikuar nga komisioni i ankimimit, *rezultoi se* :

Emërtimi i Dokumentit	Numri i Dosjeve të verifikuara	Numri i dosjeve me mangësi/paplotësi në dokumentacion
Akt Konstatimi	25	0
Formulari i pikëzimit		7
Dokument konfirmues nga ASHK (në mungesë të çertif se pronesise)		4
Kontratë energjise elektrike		3
Akt ekspertizë e thelluar		0
Pa nëshkrimin e aplikuesit		19

Punoi: Grupi i auditimit

Nga verifkimi i dokumentacionit të dosjeve, aplikuesit e të cilave në vitin 2022 janë kualifikuar nga komisioni i posaçëm, rezultuan mangësi të cilat janë pasqyruar në tabelën e mësipërme. *Ndonëse me mangësitë e konstatuara, Drejtoria e rindërtimit i ka vazhduar proçedurat për trajtimin e tyre me fonde nga granti i rindërtimit.*
Nga Drejtoria e Rindërtimit lidhur me mungesën e konfirmimit nga ASHK, na u vu në dispoziocion edhe korrenspodenca mes Bashkisë Kamëz dhe ASHK:

Shkresa e Bashkisë	Numri i aplikuesve për konfirmim/familje	Përgjigje e ASHK	Numri i aplikuesve të konfirmuar
2555 dt. 08.04.2020		4103/1 dt. 04.05.2020	
3832 dt. 28.05.2020	251		
3837 dt. 29.05.2020	123	5398/1 dt. 01.06.2020	41
4004 dt. 04.06.2020	17	5979 dt. 12.06.2020	159
4153 dt. 08.06.2020	104		
4257 dt. 10.06.2020	371		
4278 dt. 11.06.2020	90	6157/1 dt. 23.06.2020	107
122 dt. 08.01.2021		273/1 dt. 08.02.2021	183
8 shkresa		**5 shkresa**	

Punoi: Grupi i Auditimit

U konstatua se nga komisionet e posaçme *nuk janë zbatuar rigorozisht* kërkesat e VKM 05. dt.06.01.2020 dhe paketën e akteve nënligjore në vijim; si edhe nga Drejtoria e Rindërtimit për vijimin e proçedurave për përfitimin e fondeve pa verifikuar dhe plotësuar dosjet e marra në dorëzim nga komisionet e posaçme, në moszbatim të detyrave funksionale sipas fushës së veprimtarisë dhe përgjegjësitë përcaktuar në VKB nr. 37 datë 14.01.2021 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz dhe Regulloren e Brendshme Kapitulli IV neni 25.

I. Nga ana e Bashkisë Kamëz janë dërguar rregullisht lista e objekteve për ekspertizë të thelluar në Institutin e Ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në rrugë elektronike, rezultoi se vetëm në vitin 2022 janë dërguar **10** shkresa me praktika të plota për **16** objekte, konform përcaktimeve në VKM nr. 5 datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar; VKM nr. 26 datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara"; Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore";

Nr	Shkresa	Numër objektesh të vlerësuara nga IN
1	Nr. 2010 dt. 07.03.2022	**7** - objekte individuale
2	Nr. 2834 dt. 05.04.2022	

3	Nr. 3230 dt 14.04.2022	
4	Nr. 3795 dt. 29.04.2022	
5	Nr. 4774 dt. 27.05.2022	**6** - objekte publike
6	Nr. 4779 dt. 30.05.2022	
7	Nr. 6139 dt. 05.07.2022	
8	Nr. 7152 dt. 11.08.2022	**3** – objekte Kolektive (pallate)
9	Nr. 7496 dt. 24.08.2022	
10	Nr. 8201 dt. 13.09.2022	
10 shkresa		**16 objekte**

Punoi: Grupi i auditimit

Bashkia Kamëz lidhur me masat për hartimin e listave të familjeve të prekura nga fatkeqësia natyrore tërmeti i 26 Nëntorit 2019, gjatë vitit 2022 ka miratuar Vendime në Këshillin Bashkiak me përmbajtje: lista emërore, vlerën e pagesës së qerasë, burimin e financimit (MFE), dokumentacionin që duhet të dorëzojë çdo aplikues, njësitë zbatuese të këtij vendimi: Njësitë Administrative, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Sociale, Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, Zyra e Emergjencave Civile.

Nr. VKB	Datë	Objekti i Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz – viti 2022	Nr. i subjekteve të trajtuar	Vlera e fondit të kërkuar/lekë
Banesa individuale				
33	11.03.2022	Miratimi e një shtese në listen e VKB nr. 147/2020 dhe nr. 22/2021 të subjekteve që përfitojnë nga Granti i RiN t të shtëpive individuale të vlerësuara "për shembje" pas Akt ekspertizes së thelluar nga IN		-
34	11.03.2022	Miratimi e një shtese në listen e VKB nr. 116/2021 të subjekteve që përfitojnë nga Granti i RiN t të shtëpive individuale të vlerësuara "për shembje" pas Akt ekspertizes së thelluar nga IN	2	-
49	19.04.2022	Miratimi e një shtese në listen e VKB nr. 97/2021 të subjekteve që përfitojnë nga Granti i RiN t të shtëpive individuale të vlerësuara "për shembje" pas Akt ekspertizes së thelluar nga IN	2	-
53	09.05.2022	Miratimi i listës nga Granti i rikonstruksionit të nivelit DS3, banorëve të ish-stallave Bathore	55	-
58	19.05.2022	Miratimi e një ndryshimi/shtese në listen e VKB nr. 97/2021 dhe nr. 94/2011 të subjekteve që përfitojnë nga Granti i RiN t të shtëpive individuale të vlerësuara nga "për shembje" në "për rikonstruksion" pas Akt ekspertizes së thelluar nga IN-	1	-
67	17.06.2022	Miratimi e një ndryshim në listen e V-KB nr. 54/2020 dhe 87/2020 të subjekteve që përfitoj-në nga Granti i RiN t të shtëpive individuale të vlerësuara "për shembje" pas Akt ekspertizes së thelluar nga IN, nga DS1/2/3 në DS5	3	-
95	19.07.2022	Miratimi e një ndryshim në listen e VKB nr. 67/2022 të subjekteve që përfitojnë nga Granti i RiN t të shtëpive individuale të vlerësuara "për shembje" pas Akt ekspertizes së thelluar nga IN, nga DS4 në DS5	2	-
117	29.09.2022	Miratimi e një ndryshim në listen e VKB nr. 54/2020 dhe nr. 88/2020 të subjekteve që përfitojnë nga Granti i RiN t të shtëpive individuale të vlerësuara "për shembje" pas Akt ekspertizes së thelluar nga IN, nga DS5 në DS4	1	-

Banesa kolektive				
11	28.01.2022	Miratimi i listës së subjekteve nga programi i rindërtimit për objektet kolektive(pallatet e Valiasit)	35	-
14	03.02.2022	Miratimi i listës së subjekteve nga programi i rindërtimit për objektet kolektive(pallatet e Valiasit)	40	-
27	11.03.2022	Miratimi i listës së subjekteve nga programi i rindërtimit për objektet kolektive(pallatet e Valiasit)	15	-
50	19.04.2022	Miratimi i listës së subjekteve nga programi i rindërtimit për objektet kolektive(pallatet e Valiasit) pas Akt Ekspertizes së IN	4	-
101	27.07.2022	Miratimi i listës së subjekteve nga programi i rindërtimit për objektet kolektive(pallatet e Valiasit) pas Akt Ekspertizes së IN	5	-
Shfuqizim vendimesh të mëparshme dhe vendime për riklasifikime				
31	11.03.2022	Shfuqizim i listës së subjekteve përfitues nga programi i rindërtimit për banesat kolektive	6	-
51	19.04.2022	Shfuqizim i VKB nr. 103/2021 për riklasifikim të 1 subjekti përfitues nga (2+1) në (3+1)	1	-
71	17.06.2022	Shfuqizim i VKB nr. 14/2022 për riklasifikim të 1 subjekti përfitues në (2+1)	1	-
100	27.07.2022	Shfuqizim i VKB nr. 14/2022 për skualifikim të 1 subjekti përfitues	1	-
Marrëveshje për kalimin e pronësisë sipas shtojcës D dhe Ç				
52	19.04.2022	Miratimi i marrëveshjes paraprake për kalimin e pronësisë për objektet kolektive (pallatet e Valiasit) nga Bashkia Kamëz tek përfituesi	-	-
Subjektet e skualifikuara në objektet kolektive/Rikualifikim				
69	17.06.2022	Miratimin e subjekteve aplikuese të cilët janë skualifikuar nga KPR i programit të rindërtimit për objektet kolektive (pallatet e Valiasit)	4	-
19	**Vendime**	**Lista sipas nevojave për përftim granti**	**178**	**-**

Punoi: Grupi i auditimit

- Nga auditimi i inforM onit dokumentar rezultoi se nga Bashkia Kamëz gjatë vitit 2022 janë dërguar në Ministrinë për Rindërtim **5** shkresa me objekt "Listat sipas nevojave për grant nga fondi i rindërtimit të familjeve të dëmtuara nga tërmeti" për 170 objekte të dëmtuara në vlerën 291,059,789.8 lekë;

Shkresa	VKB	Objekti i shkresës	Numri i përfituesve	Vlera totale e grantit (lekë)
1648 dt.23.02.2022	101/2021 127/2021	Kërkesë për grante rikonstruksioni i ndërtesave individuale me nivel DS4 pas Akt Ekspertizes së IN	22	34,579,789.8
1650 dt. 23.02.2022	106/2021 129/2021	Kërkese per grante riN për banesa individuale me nevel demtimi DS1, DS2 DS3	3	630,000
1651 dt. 23.02.2022 ≠ 1822 dt. 02.03.2022	115/2021 116/2021 107/2021 128/2021etj	Kërkesë për grante për ndërtesat individuale që e kanë zgjedhur të bëjnë vet rindërtimin e banesës	35	88,600,000
4952 dt.02.06.2022	56/2020 53/2022	Kërkesë për grante Rikonstruksioni banesa kolektive (ish stallat)	55	24,750,000
6042 dt. 04.07.2022		Kërkesë për grante për ndërtesat individuale që e kanë zgjedhur të bëjnë vet rindërtimin e banesës	55	142,500,000
5	**Kërkesa**	**Lista sipas nevojave për përftim granti**	**170**	**291,059,789.8**

Punoi:Grupi i Auditimit

II. Lidhur me përfituesit e bonusit të qirasë, në Bashkinë Kamëz janë miratuar me VKB aktet e mëposhtme:

Nr. VKB	Data	Objekti i Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz – viti 2022	Nr. i familjeve të trajtuara	Vlera e qirasë mujore në lekë
3	17.01.2022	Miratimi i pagesës së qerasë sipas vlerës së tregut për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti	6	112,000
30	11.03.2022	Miratimi i pagesës së qerasë sipas vlerës së tregut për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti	4	810,000
46	19.04.2022	Miratimi i pagesës së qerasë sipas vlerës së tregut për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti	7	130,000
63	17.06.2022	Miratimi i pagesës së qerasë sipas vlerës së tregut për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti	3	60,000
4	**Vendime**	**Lista përfundimtare të miratuara për bonusin e qirasë gjatë vitit 2022**	**20**	**1,112,000**

Punoi:Grupi i Auditimit

Nga auditimi i VKB-ve mbi procesin e Rindërtimit të miratuara, *rezultoi* se në aktet e miratuara në Këshillin Bashkiak lidhur me miratimin e përfituesve nga programet e rindërtimit për objektet e dëmtuara individuale apo kolektive dhe ato për përfituesit e bonusit të qirasë, **u konstatua** mungesë e inforM onit statistikor në përmbajtjen e tyre, konkretisht: *nuk ishte cilësuar* në mënyrë të përmbledhur numri i familjeve/personave përfitues nga programet e rindërtimit sipas çdo niveli apo të qirasë dhe vlera totale e përllogaritur; inforM on i cili gjendet në listën emërore bashkëngjitur VKB-së. Kjo në moszbatim të Vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë" neni 4 pika 4, Shtojca 1 Model 3 dhe përcaktimeve në Kodin e Proçedurave Administrative; ndërsa për subjektet përfituese nga granti i rindërtimit për rikonstruksionin apo ndërtimin e objekteve të dëmtuara në listen emërore të përfituesve, *nuk është vendosur* vlera e masës së dëmshpërblimit të përllogaritur sipas mënyrës së miratuar (me anëtarë familje/sip banimi apo preventiv sipas rastit), në moszbatim të Vendimit nr. 5 datë 06.01.2020, Kreu II pika 8; Kreu IV pika 2 dhe tabelës A, si dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë "Metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz" miratuar me Vendimin nr. 4119 datë 11.05.2022 kapitulli IV nenet 18 e 20 pika 7.

- Listat e hartuara me përfituesit nga Subvencionimi i qirasë janë në përditësim të vazhdueshëm. Komisioni për hartimin e listave të përfituesve nga subvencionimi i qirasë, bazohet në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr. 8 datë 07.12.2019 të KM "Për përdorimin e proçedurës së përshpejtuar për subvecionin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore tërmetit të datës 26.11.2019" i ndryshuar me Aktin Normativ nr. 37 datë 24.12.2020.

Viti	Numri i aplikuesve	Numri i përfituesve/pagesave
2020	628	564
2021	+29	617
2022	+20	496
Totali	**677**	**1677**

Burimi:Bashkia Kamëz/DSEC

Mbi shpërndarjen e fondit "subvencionim i bonusit të qirasë" për çdo muaj në vitet 2020, 2021 e 2022 pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Muaji i pagesës	Nr. i familjeve trajtuar në 2020	Fonde të nevojshme për 1 muaj 2020	Nr. i familjeve trajtuar në 2021	Fonde të nevojshme për 1 muaj 2021	Nr. i familjeve trajtuar në 2022	Fonde të nevojshme për 1 muaj 2022
Dhjetor 2019	96	**1,373,000**				
Janar	152	2,192,000	573	8.452.000	494	9,078,000
Shkurt	171	2,445,000	590	10,983,000	492	9,067,000
Mars	209	2,987,000	609	11,311,000	496	9,099,000
Prill	217	3,207,000	616	11,291,000	476	9,782,000
Maj	215	3,089,000	617	11,333,000	446	8,277,000
Qershor	224	3,202,000	593	10,951,000	352	6,536,000
Korrik	278	2,446,000	594	10,978,000	325	6,030,000
Gusht	450	6,468,000	595	11,019,000	294	5,634,000
Shtator	481	6,818,000	599	11,113,000	149	2,824,000
Tetor	526	7,698,000	583	10,790,000	147	2,800,000
Nëntor	564	8,452,000	586	11,091,000	140	2,644,000
Dhjetor	531	7,786,000	585	10,766,000	141	2,680,000
Totali		**56,790,000** **58,163,000**		**130,078,000**		**70,807,000**
Totali 01.12.2019-31.12.2022						**259,048,000**

Burimi:Bashkia Kamëz/DSEC

Referuar të dhënave në tabelë, jepet një inforM on mbi numrin e përfituesve nga bonusi i qirasë dhe vlera e tij. Kjo proçedurë është në zbatim të Aktit Normativ nr. 8 datë 07.12.2019 "Për përdorimin e proçedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019" me një afat kohor prej një viti (12 muaj) i ndryshuar me AN[8] nr. 37 datë 24.12.2020.

- Me ndryshimin e nenit 7 të AN nr. 8 datë 07.12.2019 "Për përdorimin e proçedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019", lehtëson familjet e dëmtuara të cilat janë strehuar në objekte banimi me qira, pasi subvencionimi i qirasë për to zgjat në një afat që lidhet me përfundimin e ndërtimit të objekteve të reja të banimit; por nga ana tjetër nuk është shoqëruar me një shtesë apo ndryshim të një akt ligjor /nënligjor që të kushtëzojë njësinë zbatuese që është FSHZH dhe nëpërmjet saj Operatorët Ekonomikë [OE] që kanë qenë fitues në tenderat për Rindërtimin, për të respektuar rigorozisht afatet kohore të përcaktuara në kontratë, me qëllim shmangien e rritjes (shtimit) të vlerës së fondit për Subvencionimin e qirasë, pra për të përdorur me ekonomicitet dhe eficencë fondet e Rindërtimit.
- Gjithashtu nga auditimi *rezulton* se për çdo akt të miratuar në Këshillin Bashkiak, është respektuar edhe afati për konfirmim të ligjshmërisë së tij nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

- Grupet e punës në terren kanë plotësuar formularët duke klasifikuar paraprakisht nivelin e dëmtimit të objekteve në DS1, DS2, DS3, DS4 e DS5; praktikat e tyre janë dërguar për ekspertizë të thelluar në IN dhe në bazë të aktekspertizës janë përpiluar listat emërore me përfituesit për grant të cilat pasi miratohen në Këshillin Bashkiak, paraqiten me kërkesë në KSHR. Numri i përfituesve nga Grantet jepet në tabelën më poshtë:

[8] AN –Akt Normativ

Formulari Tip	Bashkia Kamëz		
	Numri total i përfituesve	Numri i Subjekteve të likuiduar në vitin 2022	Vlera e fondit të shpërndarë në vitin 2022
DS1		23	1,026,000
DS2		28	3,542,000
DS3		28	6,480,000
DS4 Rikonstruksion		1	759,549
DS4-DS5		3 në masën 40% 33 në masën 60% 74 në masën 100%	241,740,000
Totali	**211**	**190**	**253,547,549 lekë**

Burimi :Bashkia Kamëz/DR

Nga auditimi *rezulton se* nga 211 aplikues përfitues janë likuiduar 190 subjekte nga Bashkia Kamëz; Duhet theksuar se përllogaritja e dëmit të shkaktuar nga tërmeti dhe e konvertuar në lekë, është mbështetur në përcaktimet dhe vlerat në Vendimin nr. 5 datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model".

- Nga Bashkia Kamëz janë dërguar në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit [KSHR] shkresat me objekt "Kërkesë për grante" të specifikuara sipas formularëve [DS] të klasifikuar sipas nivelit të dëmtueshmërisë.

Formulari Tip	**Vlera e likuiduar Bashkia Kamzë**		
	2020	**2021**	**2022**
DS1 DS2 DS3	331,762,000	120,652,000	11,048,000
DS4"rikonstruksion"	-	-	759,549
DS4-DS5 "shembje"	-	119,740,000	241,740,000
Totali	**331,762,000**	**240,392,000**	**253,547,549**

Burimi: Bashkia: Kamëz/DR

- Planifikimi dhe shpenzimi i fondeve nga Buxheti i Shtetit për Rindërtimin në Bashkinë Kamëz gjatë 3 viteve 2020, 2021 dhe 2022, pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Artikulli	**2020**			**2021**			**2022**		
	Plan	**Fakt**	**Dif.**	**Plan**	**Fakt**	**Dif.**	**Plan**	**Fakt**	**Dif**
Llog. 602									
Llog. 604									
Llog. 606	340,220,000	331,762,000	8,458,000	352,374,476	280,926,476	71,448,000	485,296,699	407,060,649	78,236,050
Llog. 230				57,161,081	57,138,287	22,794	18,092,648	6,131,002	11,961,646
Llog. 231				962,140,083	679,870,498	282,269,585	1,387,545,245	1,217,301,343	170,243,902
Totali	**340,220,000**	**331,762,000**	**8,458,000**	**1,371,675,640**	**1,017,935,261**	**353,740,379**	**1,890,934,592**	**1,630,492,994**	**260,441,598**
	97.5%			**74.2%**			**86.2%**		

Burimi: Bashkia Kamëz/DFK

Nga inforM oni i pasqyruar në tabelë, *rezulton* se *për vitin 2020* janë planifikuar 340,220,000 lekë për fonde nga buxheti i rindërtimit dhe janë shpenzuar 331,762,000 lekë ose 97.5% e tyre; *për vitin 2021* janë planifikuar 1,371,675,640 lekë dhe shpenzuar 1,017,935,261 lekë ose 74.2%;

për vitin 2022 janë planifikuar 1,890,934,592 lekë dhe shpenzuar 1,630,492,994 lekë ose 86.2%.

Nga auditimi *rezulton* se vlera e fondeve të planifikuara dhe të shpenzuara kanë ardhur në rritje, por në raport me vlerën e planifikimit përdorimi i tyre ka ardhur në rënie.

Grupi i auditimit është i mendimit se, nëse në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit si anëtarë të tij të ishin edhe kryetarët e Bashkive të prekura nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, jo vetëm Kryetari i Bashkisë Tiranë, do të ishin përcjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë, të detajuara dhe në kohë reale gjithë problematikat dhe nevojat e secilës bashki; kjo do të sillte gjithashtu hartimin e planeve të punës dhe monitorimin e zbatimit të tyre me efikasitet.

Pretendimet e Subjektit: Drejtoria e Rindërtimit Bashkia Kamëz në observacionin e dërguar mbi konstatimet e përcjella nga grupi i auditimit në Akt verifikimin nr. 2 datë 29.12.2023 dhe në RPA dërguar me anë të shkresës nr.873/7, datë 29.01.2024, administruar në protokollin e Bashkisë Kamëz me nr.882 prot., datë 31.01.2024, paraqet shpjegime si më poshtë vijon:
-Përsa i përket dokumentacionit të përshkruar në situatën nr.1, ju sqarojmë si më poshtë vijon:
Në lidhje me shtojcat dhe sistemin e pikëzimit, megjithëse nuk janë kriter i domosdoshëm sipas Aktit Normativ nr.9 datë 06.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", dhe akteve nënligjore të tjera, dalë për zbatim të tij, për subjektet që të marrin statusin "I kualifikuar", janë marrë masa për plotësimin e tyre si për dosjet aktuale dhe ato në vazhdim.
-Në lidhje me mungesën e konfirmimit të pronësisë nga ASHK, në mungesë të titullit të pronësisë ju sqarojmë Se: Gjatë shqyrtimit të dosjeve të aplikuesve, u vu re mungesa e dokumentit të pronësisë për objektet e dëmtuara. Nisur nga ky fakt, si edhe duke marrë në konsideratë dhe situatën e përgjithshme të problematikave të ndërtimeve në territorin e Bashkisë Kamëz, u pa e arsyeshme rregullimi me anë të Vendimit të Këshillit Bashkiak, si masë për të lehtësuar përballimin e pasojave të gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Në Vendimin nr. 90 datë 03.08.2020 "Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i njësisë administrative dhe lagjeve si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfituar nga programet e rindërtimit" parashikohet, pranimi si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit vërtetimi i lëshuar nga Kryetari i Fshatit dhe Administratori i Njësisë Administrative apo Lagjes, në cilësinë e dokumentit që vërteton posedimin e ligjshëm dhe që subjekti ka banuar në banesën e dëmtuar ditën e rënies së tërmetit, si dhe kontratat përkatëse me operatorët e furnizimit me energji elektrike apo ujë të pijshëm, të cilat, sipas VKB-së së sipërcituar, duhet të jenë 5 vjeçare nga momenti i nënshkrimit dhe asnjë rast të mos jenë të nënshkruara pas datës 26.11.2019.
-Për sa më sipër, angazhohemi në marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve.
Duke shpresuar në marrjen në konsideratë të këtyre argumenteve,
Ju falenderojmë!
Qendrimi i Grupit të auditimit: Lidhur me pretendimet tuaja mbi konstatimet e përcjella në Akt verifikimin nr. 2 datë 29.12.2023 dhe në Projekt Raportin e Auditimit, ju sjellim në vëmendjen tuaj si vijon: - Lidhur me pretendimin në paragrafin e parë, ju rikujtojmë se konstatimi ynë është mbështetur mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ju dhe konkretisht nga inforM oni shkresor dhe dosjet e përcjella nga komisionet e posaçme. Mungesa e nëshkrimit të aplikuesit vë në dyshim prezencën e tij në çastin e aplikimit, i cili në rast se nuk ka qenë fizikisht prezent, duhej të lëshonte autorizim nga institucioni i noterit; dokumenti vërtetues i pronësisë është kriteri i rëndësishëm në Aktin normativ nr. 5/2020. Për këtë arsye ju sjellim në vëmendjen tuaj se VKB-të nuk kanë peshën ligjore të një Ligji, VKM apo Akti Normativ, por janë instrumenta për të përshtatur zbatimin e akteve ligjore në kushtet karakteristike të territorit ku ushtron fuqinë e tij, në rastin konkret në territorin e Bashkisë Kamëz. Ka patur kohë mjaftueshëm nga momenti i aplikimit, deri në kalimin e fondeve në llogaritë bankare të secilit përfitues pa e cënuar zbatimin e kritereve ligjore; ndërsa pikëzimi nuk cënon kualifikimin por radhën e klasifikimit të të kualifikuarve të përcaktuar qartë në aktin normativ nr. 5. datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" pika 16 dhe 17. Grupi i auditimit vlerëson faktin që Drejtoria e Rindërtimit ka marrë masat për përmirësimin cilësor të punës së saj, në zbatim rigoroz edhe të Rregullores së Brendshme institucionale, miratuar me Vendimin nr. 4119 datë 11.05.2022. Pretendimi juaj ***nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit***.

Titulli i gjetjes: Mbi disa pasaktësi të konstatuara nga auditimi i zbatimit të rregullave dhe proçedurave të përcaktuara për përfituesit nga programi i granteve të rindërtimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të dala për menaxhimin e situatës së fatkeqësisë natyrore-tërmetit të 26 Nëntorit 2019, nga auditimi rezultoi si më poshtë:
Situata: **1**. Nga verifikimi i dosjeve të 21 aplikuesve të klasifikuar si përfitues nga granti i rindërtimit dhe 4 aplikuesve të kualifikuar nga komisioni i ankimimit, rezultuan këto mangësi apo parregullsi: në 7 raste formulari i pikëzimit i pa plotësuar apo pjesërisht i plotësuar, në 4 raste mungonte konfirmimi i pronësisë nga ASHK në mungesë të titullit të pronësisë, në 19 raste mungonte nënshkrimi i aplikuesve. Kjo si rezultat se nga ana e komisioneve të posaçme

nuk janë zbatuar rigorozisht kërkesat e VKM nr. 05, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" dhe, paketës së akteve nënligjore në vijim; si dhe Drejtoria e Rindërtimit nuk ka ushtruar kontroll mbi dosjet e aplikuesve të kualifikuar për fonde nga granti i rindërtimit, në moszbatim të detyrave funksionale sipas fushës së veprimtarisë dhe përgjegjësitë përcaktuar në VKB nr. 37 datë 14.01.2021 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz dhe Regulloren e Brendshme të Bashkisë Kamëz.

2. Nga auditimi i VKB-ve të miratuara mbi procesin e Rindërtimit, rezultoi se në aktet e miratuara në Këshillin Bashkiak lidhur me miratimin e listës së përfituesve nga programet e rindërtimit për objektet e dëmtuara individuale apo kolektive dhe ato për përfituesit e bonusit të qirasë, rezultuan me mungesë të inforM onit statistikor në përmbajtjen e tyre, konkretisht: nuk ishte shprehur në mënyrë të përmbledhur numri i familjeve /personave përfitues nga programet e rindërtimit sipas çdo niveli apo atyre të bonusit të qirasë si edhe vlera totale e përllogaritur; inforM oni i detajuar i të cilëve gjendej në aneksin bashkëlidhur VKB-së. Për sa konstatuar nuk është zbatuar Vendimi nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë" neni 4 pika 4, Shtojca 1 Model 3 dhe përcaktimeve në Kodin e Proçedurave Administrative;

- Ndërsa për subjektet përfituese nga granti i rindërtimit për rikonstruksionin apo ndërtimin e objekteve të dëmtuara në listen emërore të përfituesve, nuk është vendosur vlera e masës së dëmshpërblimit të përllogaritur sipas mënyrës së miratuar (me anëtarë familje/sip banimi apo preventiv sipas rastit), vlera totale e përfituesve bashkë me listën emërore, është vendosur në aneksin bashkëlidhur VKB-së së miratuar, në moszbatim të Vendimit nr. 5 datë 06.01.2020, Kreu II pika 8; Kreu IV pika 2 dhe tabelës A, si dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë "Metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz" miratuar me Vendimin nr. 4119 datë 11.05.2022, neni 20 - detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të përgjithshëm, neni 25 - detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit dhe personelit të Drejtorisë së Rindërtimit.

3. Nga inforM oni i pasqyruar në tabelën e planifikimit dhe realizimit të fondeve, rezulton se: *për vitin 2020* janë planifikuar 340,220,000 lekë për fonde nga buxheti i rindërtimit dhe janë shpenzuar 331,762,000 lekë ose 97.5% e tyre; *për vitin 2021* janë planifikuar 1,371,675,640 lekë dhe shpenzuar 1,017,935,261 lekë ose 74.2%; *për vitin 2022* janë planifikuar 1,890,934,592 lekë dhe shpenzuar 1,630,492,994 lekë ose 86.2%. Nga analiza e të dhënave rezulton se vlera e fondeve të planifikuara dhe atyre të shpenzuara kanë ardhur në rritje, por në raport me vlerën e planifikimit përdorimi i tyre ka ardhur në rënie.

Kriteri: Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligji nr.22/2018 'Për strehimin social'; Akt normativ nr. 6, datë 30.11.2019 'Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019'; Akt normativ nr. 7, datë 30.11.2019 'Për një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Akt normativ nr. 8, datë 7.12.2019 "Për përdorimin e proçedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019"; Akt normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; Vendim nr. 751, datë 29.11.2019 "Për disa shtesa në Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të këshillit të ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Kamëz dhe Tiranë"; VKM nr. 878, datë 24.12.2019, "Për përbërjen, organizimin e veprimtarive dhe rregullat e funksionimit të KSHR"; VKM nr. 5, datë 6.1.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model"; VKM nr. 6, datë 6.1.2020 "Për kushtet, kriteret dhe proçedurat për zbatimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike"; VKM nr.26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara";

Akt Normativ nr. 37 datë 24.12.2020 për një ndryshim në Aktin Normativ nr. 8 datë 07.12.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e Proçedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qerasësh banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019".(ndryshim i nenit 7); Vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë" neni 4 pika 4, Shtojca 1 Model 3 dhe përcaktimeve në Kodin e Proçedurave Administrative; Rregullore e Brendshme e Bashkisë.

Ndikimi/Efekti: Moszbatimi me korrektësi nga ana e Bashkisë Kamëz i çdo kërkese ligjore/nënligjore për Rindërtimin gjatë fazave të ndryshme të proçedurave, duke riskuar të cenojë parimin e transparencës dhe mosdiskriminimit të komunitetit në rastin e situatës së jashtëzakonshme të krijuar nga fatkeqësitë natyrore;

Shkaku: Moszbatimi me korrektësi i akteve ligjore/nënligjore në fuqi lidhur me proçedurat dhe menaxhimin e fondeve të Rindërtimit.

Rëndësia: E mesme

Sa më sipër për veprimet apo mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
(1) Komisioni i posaçëm i NJA 1-2 : N.K kryetare komisioni, P.M, M.Sh, E.S, J.P; (2) Komisioni i posaçëm i NJA Paskuqan: E.B kryetar, M.Sh, L.D, Xh.D, F.Sh; (3) Drejtoria e Rindërtimit: F.Ç Drejtor, D.Gj përgjegjëse, Specialistët-A.L, L.T, M.P; (4) Drejtori i Përgjithshëm E.Gj.

2.2.6 Burimi i krimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

I. Burimi i krijimit të të ardhurave.

Për vitin 2022 burimet e financimit të Bashkisë Kamëz, ndahen në 3 kategori (*Të ardhurat nga burimet e veta, Transferta nga Buxheti Qëndror, Trashëgimi nga viti i shkuar*), trajtuar si më poshtë vijon:

A. Të ardhura nga burimet e veta (zënë 39.4 % të të ardhurave të përgjithshme).

Sipas inforM onit në evidencën e të ardhurave (rakorduar me thesarin) marrë nga Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit.

Planifikimi për vitin 2022 është **1,585,352,062** Lekë

Realizimi faktik për vitin 2022 është **1,055,658,107** Lekë.

Realizimi faktik për vitin 2021 është **792,636,482** Lekë.

Realizimi faktik i vitit 2022 krahasuar me vitin 2021 në përqindje është + 33 %, në vlerë absolute është 263,021,625 lekë më shumë.

Planifikimi për vitin 2022 është 200 % e realizimit faktik për vitin 2021, në vlerë absolute 792,715,580 lekë më i lartë.

Planifikim për vitin 2022 nuk është bërë bazuar në analiza të plota midis drejtorive (analiza të realizimeve historike dhe pritshmërive reale të argumentuara**).**

B. Trashëgimi nga viti i shkuar (zënë 1.57 % të të ardhurave të përgjithshme).

Për vitin 2022 Bashkia Kamëz vetëm 1.57 % të nevojave për financim e ka mbuluar nga të ardhurat e trashëguara. Në kontabilitetin e Bashkisë ka një listë analitike për evidentimin e këtij lloji të ardhurash (të ardhurat e trashëguara).

I/1 Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Në Bashkinë Kamëz bazuar në paketën fiskale strukturat për mbledhjen e të ardhurave janë:

Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore (në vijim DTTV); Drejtoria e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit (në vijim DPKZHT); Drejtoria e kadastres, bordit të kullimit pyjeve e kullotave; Drejtoria e transportit dhe licencave; Drejtoria e shërbimeve publike; UKK Sh.A.
Struktura Organizative është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 79, datë 26.01.2022 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz për vitin 2022", me ndryshime.
DTTV është pjesë e strukturës organizative të miratuar dhe ka në varësi të saj 5 (pesë) sektorë që paraqiten si më poshtë:
Për vitin 2022, kjo drejtori ka pasur këtë përbërje:
-Drejtor (z. E.B);
-Sektori i terrenit i përberë nga 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës, 14 specialist dhe 1 përgjegjës sektori, zj. G.D;
-Sektori i vlerësimit të detyrimit dhe menaxhimit të borxhit, i përbërë nga 3 (tre) punonjës, 2 specialist dhe 1 përgjegjës sektori, zj. L.K;
-Sektori i taksave familjare i përbërë nga 4 (katër) punonjës, 3 specialist dhe 1 përgjegjës sektori, z. E.S;
-Sektori i mbrojtjes konsumatorit i përbërë nga 6 (gjashtë) punonjës, 5 specialist dhe 1 përgjegjës sektori, z. F.LL;
-Sektori i analizës dhe kontabilizimit të detyrimeve i përbërë nga 4 (katër) punonjës, 3 specialist dhe 1 përgjegjës sektori, zj. R.D .
Është krijuar struktura vendore e apelimit tatimor, ku me VKB nr. 42, datë 18.11.2019, është miratuar rregullore mbi organizimin e strukturës vendore të apelimit administrativ të taksave dhe tarifave vendore.
Vendimet e Këshillt Bashkiak janë publikuar në platformën online "Vendime.al", dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz.
Organizimi i veprimtarisë së DTTV bëhet duke u mbështetur në sistemin që manaxhon bazën e të dhënave në Bashkinë Kamëz.

I.2. Administrimi sistemit të taksave e tarifave vendore:

Sistemi i manaxhimit të bazës së të dhënave emërtohet TAIS **(Microsoft Dynamics Nav 32013 R2)** (në vijim "Sistemi"). Ky sistem përpunon të dhënat e bazave të të dhënave, "Kamza Live" dhe "Kamza Taksa Biznes".
Auditimi i "Sistemit" është vlerësuar i rëndësishëm, për shkak të rëndësisë së veçantë të shërbimit që ofron. Ky sistem administron Regjistrin Elektronik për Kategorinë Biznes dhe Familjar, në nivel lokal.
Siguria e Informacionit është bërë gjithnjë më e rëndësishme për institucionet e administratës shtetërore që administrojnë ose kanë në përdorim një sistem manaxhimi të dhënash, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit.
Siguria e InforM onit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e inforM onit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. *Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të cilët janë: "Mjedisi i sigurisë së inforM onit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria*

e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria" [9].

1. Titulli i gjetjes: Baza e të dhënave që Bashkia Kamëz përdor për administrimin e taksave dhe tarifave vendore nuk funksionon bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi për "Bazat e të Dhënave Shtetërore".

Situata: Bashkia Kamëz ka krijuar dhe administron *Bazë* të dhënash shtetërore, krijimin dhe administrimin e bazave të të dhënave nuk e kryen bazuar në kuadrin rregullator në fuqi. Ky institucionnuk ka paraqitur kërkesë për regjistrimin në regjistrin kombëtar të bazave të të dhënave shtetërore pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së InforM onit në vijim (AKSHI), i cili është autoriteti rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore në vijim (ARK). Baza e të dhënave kijuar nga Bashkia Kamëz sa i përket funksionimit, organizimit, ndërveprimit me sisteme të tjera të ngjashme dhe të dhënave të cilat përpunon (regjistrim përpunim dhe gjenerim raporte për evidenca) nuk funksionon bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi për "Bazat e të Dhënave Shtetërore". Për krijimin dhe administrimin e tyre është e detyrueshme mbështetja në ligj apo në VKM.

Mbi përputhshmërinë e "Sistemit të manaxhimit të bazës së të dhënave për të ardhurat" në Bashkinë Kamëz me kuadrin ligjor në fuqi.

Auditimin i "**Sistemit**" është vlerësuar i rëndësishëm, për shkak të shërbimit që ofron. Ky sistem administron "Regjistrin Elektronik" për tatimpaguesit në kategorinë Biznes dhe Familjar, në nivel lokal. Në përgjigjen e kërkesës paraqitur Bashkisë Kamëz nga grupi auditimit nuk përmendet kush realizon proceset të cilat nuk janë në kompetencën e njohurive të stafit përdorues, për procesin e optimizimit të bazës së të dhënave apo të procesve të përmenduara më sipër. InforM oni në përgjigje të kësaj kërkese për përdoruesit dhe pika të tjera të saj, paraqitur nga Bashkia Kamëz nuk është i plotë.

Ndër informacionet që mungojnë janë konkretisht:

Dokumentacionin teknik të bazës së të dhënave shtetërore, që përmban:

masat e marra për sigurinë e bazës së të dhënave shtetërore, nivelin e sigurisë së bazës së të dhënave shtetërore, masat e marra për mbrojtjen e të dhënave personale, shërbimet elektronike të ofruara;

Klasifikimin e bazës së të dhënave;

Mënyrën e arkivimit të të dhënave: listën e të dhënave që i nënshtrohenarkivimit, standardet e aplikuara në bazën e të dhënave, të dhënat në lidhje me monitorimin e bazës së të dhënave dhe statistikave operacionale, bazën ligjore për ndryshimin e përbërjes së të dhënave; datën e fillimit të ndryshimit të përbërjes së të dhënave, çdo ndryshim të nevojshëm që lidhet me ndryshimin e përbërjes së të dhënave;

Aksesimi i Log-eve të Sistemit dhe të Transaksioneve;

Analiza e Kontrolleve të Sigurisë dhe të Aksesit;

Shqyrtimi i Fjalëkalimeve dhe i IP-ve të Aksesit;

Vlerësimi i Protokolleve dhe i Rregullave të Menaxhimit të të Dhënave;

Analiza e Veprimeve të Stornimit dhe Procesverbalet e Mbajtura;

Përdorimi i Mjeteve të Tjera;

Informacion mbi mjete të tjera të auditimit dhe të analizës së databazës që janë në përdorim ose të disponueshme;

Procedurat e ruajtjes dhe rikthimit të të dhënave në raste fatkeqësish (Back-up Plan);

Siguria dhe Kriptimi;

Politika e Ruajtjes së të Dhënave dhe Menaxhimi i të Dhënave të Përgjithshme;

[9] Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

Pra inforM oni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me administrimin dhe menaxhimin e sistemit të bazës së të dhënave që administron veprimtarinë e DTTV- së nuk është i plotë;
Kriteri: Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore" neni 3; Ligji nr. 2/2017, datë 26.01.2017, "Për sigurinë kibernetike" neni 4; Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore" Kreun II "Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave; Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar" nenet 2, 3,.5, 6....20...27,28..; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar nenet 25, 27, 28, 31; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, "Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore" i ndryshuar; Vendimi nr. 710, datë 21.08.2013, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së inforM onit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", (ndryshuar me VKM nr. 755, datë 26.10.2016); Kreun II, pikën k, të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së inforM onit", (ndryshuar me VKM nr. 36, datë 24.01.2018; nr. 88, datë 14.02.2018; nr. 448, datë 26.7.2018; nr. 872, datë 24.12.2019); pika 4, "Kërkesat e sigurisë" shkronja b, të "Rregullores për Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike" miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; pika 4, gërma a, të "Rregullores për menaxhimin e log-eve digitale në administratën publike", miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).
Ndikimi/Efekti: Mos pasqyrim i qartë i objektivave të bashkisë lidhur zhvillimet teknologjike dhe zbehje e ndikimit të strukturave TIK në vendimmarrje. PasiGnë bazën e të dhënave shtetërore.
Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore dhe nënligjore për bazën e të dhënave shtetërore .
Rëndësia: E lartë.

Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Komponentëve klientë ("Përdoruesit e sistemit") me kuadrin ligjor në fuqi.
Përdoruesit" janë pjesë (softëare) e sistemit që përdor Bashkia Kamëz për manaxhimin e të ardhurave. Përdoruesit janë instaluar në kompjuterat personal në vijim "PC" që janë në përdorim të punonjësve të Drejtorisë. InforM oni që grumbullohet dhe përpunohet nga përdoruesit për kategoritë biznes dhe familjarë, ka të bëjë me rregjistrimin, modifikimin, përllogarijten e detyrimeve për taksat e tarifat vendore, si dhe për arkëtimin e të ardhurave nga vjelja e tyre. Sistemi nëpërmjet raporteve që gjeneron i mundëson drejtimit, (sipas pozicioneve të strukturës organizative të miratuardhe funksioneve të drejtorisë) organizimin dhe monitorimin e punës për popullimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të sistemit.
Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive, shkeljeve si dhe moszbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që e shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjësinë e zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, proçesi, apo aktiviteti. Për të garantuar kryerjen e kontrolleve efektive, si dhe për të ruajtur ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/transaksioni, përgjegjësitë duhet të ndahen në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin (marrjen e vendimit), zbatimin, dhe kontrollin. Nga auditimi i veprimtarisëtë tyre u konstatua se:

2. Titulli i gjetjes: Ndërthurja e veprimtarisë së DTTV Kamëz me sistemin e manaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në pesë komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. DTTV nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem.

Situata: Bashkia Kamëz nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem.

A. Struktura e Tekonologjisë së InforM onit në vijim "IT" nuk organizohet në nivel drejtorie por në nivel sektori brenda **Drejtorisë së Prokurimit Publik dhe IT,** (aktualisht sektor brenda Drejtorisë së Mediave dhe InforM onit) dhe përbëhet nga 4 punonjës (Përgjegjës sektori, 3 specialist). Sektori i IT kryen kryesisht procesin Help desk në këtë institucion.

B. DTTV nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem.

C. **Ndërthurja e veprimtarisë së DTTV Kamëz me sistemin e manaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në pesë komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.** Përkatësisht, Drejtoria nuk angazhohet në procesin e monitorimit të sistemit, nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis raporteve të gjeneruara nga sistemi me formatet e përpunuara në excel nga operatorët, nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të bazës së të dhënave, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga sistemi në evidencat format excel dhe më pas shkresore për raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.

D. Nuk ka inforM on për administrimin e përdoruesve, bashkëveprimin me burimet njerëzore për procedurat e gjenerimit në sistem të përdoruesve të rinj, përdoruesve që ndërrojnë pozicion pune apo që largohen nga detyra. Nuk ka inforM on për procedurën që ndiqet për përdorues të cilët janë larguar nga detyra apo kanë ndryshuar pozicion në strukturë (A janë aktiv në sistem apo jo ?).

E. Bashkia Kamëz, procese të rëndësishme si faturimi i detyrimeve në sistem apo delegim dhe ndryshim kompetencash për përdoruesit *i bën bazuar nëkontratën pa nr prot. datë 05.02.2022 për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit elektronik të taksave dhe tarifave vendore lidhur ndërmjet palëve Bashkia Kamëz dhe OE "Bussines Information System Software". Për proceset e përmendura më sipër nuk ka informacon sa i përket:*
Protokollimit të veprimtartive si **gjenerim apo ndryshim** i detyrimeve dhe të dhënave që përcaktojnë bazën e taksimit në sistem konform përcaktimeve në Paketën Fiskale apo **delegim dhe ndryshim kompetencash** për përdoruesit ...etj.

F. Informacioni i Sistemit të manaxhimit të të dhënave nuk përputhet me evidencat zyrtare mbi të cilat DTTV planifikon dhe raporton., të cilat janë të trajtuara më hollësisht në vijim të këtij materiali, kontretisht në gjetjen nr.6, gjetjen nr. 8, gjetjen nr. 9, gjetjen nr.11. gjetjen nr.13.

G. Struktura e kategorizimit të sistemit për bizneset dhe popullatën është e ndryshme nga paketa fiskale e miratuar.

H. Raportet që prodhon ky sistem dhe që përpunohen më pas në formatin excel nga sektorët për të ndërtuar evidenca nuk protokollohen, raporti i debitorëve për abonentët familjarë, raporti i debitorëve për kategorinë biznes, raporti i evidencës së të ardhurave, etj., të cilat janë evidentuar përgjatë materialit në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

I. Nuk ka asnjë rakordim midis drejtorive në lidhje me:
- Realizimet e të ardhurave që kanë përgjëgjësi të manaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB-në nr. 137, datë 22.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz".
- Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk rakordojnë me DTTV lidhur me:
  - Kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Kamëz për informacion sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve.
  - "A janë të rregjistruar këto subjekte në sistemin e DTTV" dhe
  - "A kanë detyrime të pashlyera?".

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4 pika 26,neni 5...., neni 11,...;Udhëzimi e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, **neni 9, neni 35, neni 41;** ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika ç; ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar", VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores "*Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*", i ndryshuar, Manuali për MFK i miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 108 datë 17.11.2016, kapitulli III, Rregulloren e brendshme të bashkisë miratuar me aktin nr. 4119 prot. datë 11.05.2022, neni 36.
Ndikimi/Efekti: Cënim i sigurisë, hyrje të paautorizuara dhe risk humbje të të dhënave, mos pasqyrim i saktëi situatës së njësisë.
Shkaku: Mungesa e kuadrit rregullator për funksionimin e sistemit apo përshkrimt të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem.
Rëndësia: E lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, **znj. G.D** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Terrenit, **znj. L.K** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit të Detyrimit dhe Menaxhimit të Borxhit, **z. E.S** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave Familjare, **znj. R.D** Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe Kontabilizimit të Detyrimeve, **znj. R.H** me detyrë Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe **z. M.G** me detyrë Pergjegjësi i Sektorit të IT.

3. Titulli i gjetjes: Nuk zbatohen rregullat e integritetit të bazës së të dhënave dhe constraints(të kufizuarat).
Situata: DTTV nuk ka inforM on në lidhje me monitorimin e bazës së të dhënave dhe statistikave operacionale, zbatimin e rregullave të integritetit të bazës së të dhënave dhe constraints për të parandaluar, për shembull, regjistrimin e dyfishtë të taksapaguesve, modifikimin e të dhënave, vendosjen automatike të gjobave, **mos lejimin për ndryshime të paautorizuara** të të dhënave. *Nuk ka monitorim për veprimet e stornimit që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifat vendore (lista e veprimeve të stornimit sipas natyrës së veprimit); Procesverbalet e Stornimit: Procesverbalet e mbajtura në lidhje me veprimet e stornimit (Credit Note), veprime të cilat janë detyra funksionale të kësaj drejtorie.*
Procesi i popullimit të bazës së të dhënave në DTTV dhe procesi i përpunimit dhe përgatitjes së evidencave kryhet nga të njëjtit përdorues.
Gjenerimi i raporteve për subjektet bëhet nga sistemi nëpërmjet kërkesës që përdoruesit aplikojnë në sistemin e manaxhimit të të dhënave.
Për periudhën në auditim nuk ka një protokollim të momentit të gjenerimit për raportet të cilat shërbejnë përpërgatijen e evidencave të cilat përdoren për raportim në drejtimin e Bashkisë Kamëz dhe përgatitjen e pasyrave financiare. Mungon rakordimi analitik dhe i dokumentuar midis sektorëve dhe kontabilitetit. Kontabiliteti përdor për veprimtarinë e tij evidencën e vënë në dispozicion nga DTTV e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin excel i inforM onit të marrë nga raporti i përfituar prej sistemit (format excel i përpunueshëm). Procesi i përpunimit nga raporti i sistemit në formatin excel bëhet manualisht duke ulur eficencën, nivelin e cilësisë dhe sigurinë e inforM onit të përpunuar.
Marrë parasysh, sensitivitetin e trajtimit të raporteve dhe qëllimin e ndërtimit të sistemit të manaxhimit të të dhënave (grumbullimi, përpunimi, ruajtja e informacionit, dhe gjenerimi i raporteve të sakta, të plota, të sigurta dhe në kohë për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Kamëz me cilësi dhe konform standarteve të përcaktuara në kuadrin rregullator). Ky proces nuk është efektiv, eficent dhe i sigurt.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 5, neni 11,..neni 22,.....; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligji nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 ,"Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë", i ndryshuar,Manuali i Manaxhimit Financiar dhe kontrollit, kapitulli III, komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollitmiratuar me Urdhërin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016, Rregullore e brendshme të bashkisë miratuar me aktin nr. 4119 prot. datë 11.05.2022, neni 36.
Ndikimi/Efektiviteti: InforM oni i përpunuar nuk ka cilësi, siguri dhe saktësi.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit ligjor në fuqi mbi monitorimin proceseve dhe ndarjen e detyrave .
Rëndësia: E lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.Bme detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, **znj. G.D** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Terrenit, **znj. L.K** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit të Detyrimit dhe Menaxhimit të Borxhit, **z. E.S** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave Familjare, **znj. R.D** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe Kontabilizimit të Detyrimeve dhe **z. M.G** me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të IT.

Mbi kontrollin e cilësisë së të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve

4. Titulli i gjetjes: Procesi për përllogaritjen e detyrimeve tatimore nuk është i saktë.
Situata: Në sistemin e DTTV rezultojnë mungesa sipas kategorizimeve për nënkategoritë e taksave /tarifave dhe përjashtimet nga detyrimi për to krahasuar me paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Kamëz.
Bashkia Kamëz nuk ka formularë të miratuar për aplikim lidhur me kërkesat për regjistrim, ndryshim të dhënash ekzistuese apo çregjistrim të subjekteve. Burimi i të dhënave (lloji i aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj.) që shërbejnë për popullimin e bazës së të dhënave në sistemin e DTTV nuk është i plotë. Të dhënat e nevojshme për pëcaktimin e bazës së taksës janë të mangëta dhe nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues të njehsuar me origjinalin. Në DTTV procesi për përllogaritjen e detyrimeve sipas Paketës Fiskale nuk është i saktë.
Planifikimi për Taksa dhe tarifa vendore të cilat janë burimi kryesor në realizimin e të ardhurave të veta nuk është kryer bazuar në numrin e subjekteve sipas sistemit, analizën e rezultatit historik, pritshmërive të vitit korrent dhe kordinimit midis drejtorive që mbulojnë realizimin e tyre.
Në dispozicion të grupit të auditimitështë vendosur vetëm informacion identifikues për subjektet që administron sistemi. Përpunimi i inforM onit është bërë duke krahasuar evidencat për raportim në formë shkresore ose format excel të DTTV dhe inforM onit identifikues së subjektit në sistemin e DTTV.
Në paketën fiskale të Bashkisë Kamëz nuk identifikohen taksa dhe tarifa vendore të përcaktuara për pajisjet automatike të cilat krijojnë aktivitet dhe gjenerojnë të ardhura si: ATM, pajisje elktronike, lojra për fëmije, ekranet dixhital të reklamimit, karikues për mjetet lëvizëse (që janë të vendosura në hapsira publike apo biznes privat, pranë institucioneve të ndryshme etj) edhe pse janë të identifikueshme nuk janë të përfshira në takstat dhe tarifat vendore.
Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;

Ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", Neni 2 pika 13: "Subjekt" është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, që ka cilësinë e tregtarit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, shoqëritë tregtare dhe degët e shoqërive të huaja, Neni 2 pika 16. "Veprimtari" është veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar në mënyrë të vazhdueshme nga subjektet; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar,neni 4, pika 7; Udhëzimi nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3, pika 4.

Ndikimi/Efekti: Mungesa në sistem e kategorizimeve ose pasaktësia e tij, çojnë në planifikim dhe faturim jo të saktë për taksa e tarifa vendore. Pasaktësia e paketës fiskale çon në mosplanifikim të disa kategori biznesesh.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit ligjor në fuqi

Rëndësia: E lartë

Mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve

InforM onin që popullon bazën e të dhënave organizohet sipas llojit dhe kategorive:

1. Biznes sipas llojeve, Biznesi Madh (BM), Biznes i Madh Vip (BMV), Biznes i Vogël (BV), OJF, Transport,kategorizohet në kategoritë mëposhtë:
   - Prodhim
   - Shërbim
   - Profesion i lirë
   - Tregëti

Taksat dhe tarifat vendore që administron ky sistem për kategorinë biznes paraqiten si më poshtë:

Taksa mbi Ndertesën Biznes, Taksa e Truallit, Taksa e Tabelës, Taksa e Reklames, Taksa e Fjetjes në Hotel, Tarifa e Përkohshme e Infrastrukturës Arsimore, Tarifë e Pastrimit Biznes, Tarifë Ndriçimi, Tarifë Gjelbërimi...

2. Familje

Familje që kanë në pronësi/përdorim banesa private, toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

5. Titulli i gjetjes: Nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve.

Situata: Bashkia Kamëz nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve

Veprimtaria e DTTV bazohet në proceset që manaxhojnë:

- Kërkesa për rregjistrim të subjekteve të reja,
- Ndryshime të të dhënave rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet egzistuese,
- Kërkesat për çrregjistrim, pezullim të subjekteve egzistuese.

Bashkia Kamëz nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve, pasi ky kontroll nuk është pjesë vetëm e aktivitetit të këtij institucioni por një ndërthurje midis Degës Rajonale të Tatimeve në vijim (DRT), Qëndrës Kombëtare të Biznesit në vijim (QKB) dhe sektorit të kontrollit në terren pranë DTTV. Sistemi nuk ka ndërveprim me QKB dhe DRT. Komunikimi midis DTTV dhe QKB është vetëm në rrugë shkresore dhe e- mail.

Sektori i terrenit është hallka e vetme për të përcaktuar përputhjen midis të dhënave të deklaruara vullnetarisht nga subjekti në QKB, të dhënat faktike në terren dhe të dhënave që administron DTTV në dosjen e subjektit.

Mungon Gjurma e auditimit dhe nuk ka element kontrolli mbi vërtetësinë e të dhënave në regjistrin elektronik të subjekteve.
Popullimi i sistemit me kërkesa për rregjistrim të subjekteve të reja, ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet egzistuese **nuk realizohet bazuar në përcaktimet e cituara në manualin e manaxhimit financiar dhe kontrollit kapitulli III, dhe duke rakorduar inforM onin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.**
Në kategorinë Biznes dhe familjarë nuk ka përputhje në numër subjektesh me evidencat statistikore të paraqitura nga DTTV, trajtuar më gjerësisht në gjetjen nr.6, përgjatë materialit.
DTTV nuk ka një sektor për popullimin (regjistrimin, ndryshimin e të dhenave dhe çrregjistrimin e subjekteve) të bazës së të dhënave, por ky proces dhe përpunimi e përgatitja e evidencave kryhet edhe nga përdorues të cilat janë njëkohësisht dhe përgjegjësa sektori .
Akt konstatimet nga sektori i terrenit nuk janë të rifreskuara periodikisht (çdo vit) dhe nuk shprehin qartë objektin për të cilin është kërkuar mbajtja e këtij akt konstatimi konkretisht:

- **Kërkesat për regjistrim të subjekteve të reja - Akt konstatimet e mbajtura mbi kërkesat për rregjistrimet e reja.**

DTTV për çdo aplikim për regjistrim të subjekteve të reja i kërkon sektorit të terrenit verifikimin për konfirmimin e të dhënave të deklaruara vullnetarisht në QKB apo në sportele.
Akt konstatimet e mbajtura nuk japin inforM on të plotësa i përkët të dhënave të nevojshme për pëcaktimin e bazës së taksës dhe nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues të njehsuar me origjinalin. Për përputhjen midis llojit të aktivitetit të deklaruar dhe dokumentacionit të administruar në praktikën për aplikim të subjektit, adresën e plotë ku ushtrohet ky aktivitet, sipërfaqen që administron, gjëndjen debitore që shfaqin aktivitete të mëparshme të administruara prej tij në sistemin e DTTV dhe paqartësinë me masat e marrra për rastet debitore.
Rregjistrimi i subjekteve të reja në sistem kryhet bazuar në akt konstatimet nga Sektori i kontrollit të taksave dhe tarifave. Akt konstatimet nuk përcaktojnë përputhjen midis inforM onit të deklaruar vullnetarisht nga subjekti në QKB me informacionin faktik në terren. Kjo ndikon cilësinë e të dhënave që popullojnë bazën e sistemit të DTTV, planifikim dhe në përgatitjen e evidencave të qarta sa i përket identifikimit të subjektit dhe përcaktimit tënjoftim detyrimit për tu paguar lidhur me taksat dhe tarifat vendore" ndërkohë që të dhënat për këto subjekte janë lehtësisht të verifikueshme në terren apo nga drejtoritë që administrojnë inforM on për kryqëzimin e këtij informacioni.
Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 5, neni 11,...; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 1, **neni 2** gërmat a, ç, **neni 5** gërmat a, d, dh, f, g, gj, h, i, **neni 6** pikat 1, 2, 3, neni 12 **gërmat** a, b, dh..., **neni 13** gërma b, neni 15, **neni 23** pika 1, 4, neni 26, neni 27,neni 28 pika 1, **neni 29**, neni 31, neni 40, neni 41, neni42, **neni 43 pika1, 2, 3, neni 44, neni 45,** neni 47 , **neni 48** pika 1, **neni 57** pikat 4**, 5**, **nenet 60, 61, 62**, neni 65 pika 5, nenet 68, 69 , **neni 70 pika 2, neni 71/1** pika 5 ; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, nenet 28-40, **neni 42**, **neni 43** gërma d, **neni 59**; Manuali i Manaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhërin e MFE nr. 108, datë17.11.2016; Udhëzimi nr. 26, datë 16.12. 2014**;** Udhëzimi nr. 655/1 datë 06.02.2007, "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale dhe të raportimit të sistemit të takses vendore;. VKB - në nr.137, datë 22.12.2021 "Për Sistemin Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz"; Rregullore e brendshme e bashkisë.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e dokumentacionit ose pasaktësia e tij, çojnë në evidencave të pasakta sa i përket **identifikimit të subjektit dhe** përllogaritjes të saktë të detyrimeve për taksa e tarifa vendore.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit ligjor në fuqi. Akt konstatime nuk kryhen brenda afateve të përcaktuara në ligj, nuk janë të plota dhe nuk përcaktojnë përputhjen midis informacionit të deklaruar vullnetarisht nga subjekti me inforM onin faktik në terren. Popullimi i sistemit **duke mos rakorduar informacionin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.**
Rëndësia: E lartë.

Më poshtë paraqitet inforM oni vënë në dispozicion nga DTTV krahasuar me të dhënat në sistemin Kamza Taksa Biznes
Subjekte që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë sipas llojit dhe kategorizimit:

Numri i subjekteve sipas llojit 2022

Nr.	Emërtimi	Numër Subjektesh
1	Biznes i Vogël	3,018
2	Biznes i Madh	478
3	Biznes Vip	61
4	Transport	255
5	OJF	8
6	Individ	23
Totali		**3,843**

Për vitin 2022 sipas llojit të biznesit të paraqitur në tabelën më sipër kanë ushtruar **aktivitet 3843** subjekte.

Numri subjekteve Kategorizimit

Nr.	Kategoria	Biznes i Vogël	Biznes i Madh	Biznes Vip	Totali
1	Prodhim	231	58	2	291
2	Profesion i lirë	87	8	0	95
3	Shërbim	1,192	207	43	1,442
4	Tregti	1,508	205	16	1,729
Totali		**3,018**	**478**	**61**	**3,557**

Për vitin 2022, sipas kategorizimit të paraqitur në tabelë më sipër kanë ushtruar aktivitet 3,557 subjekte.

Subjekte të mbyllura, çregjistruara, pezulluara

Nr.	Kategoria	Biznes i Vogël	Biznes i Madh	Transporti	Totali
1	Të ç'regjistruara	107	22	7	136
2	Të pezulluara	168	4	11	183
Totali		**275**	**26**	**18**	**319**

Për vitin 2022, sipas llojitkanë çregjistruar dhe pezulluar aktivitetin në QKB 319 subjekte.
Për vitin 2022, sipas llojitkanë çregjistruar aktivitetin në QKB Biznes i Madh (BM) 22 subjekte, Biznes i vogel (BV) 107 subjekte, Transport 7 subjekte.

DTTV evidence sipas llojit të biznesit për vitin 2022 Biznes i Madh (BM) 478 subjekte, Biznes i Madh Vip (BMV) 61 subjekte, Biznes i Vogel (BV) 3,018 subjekte, Transport 255 subjekte, Ojf 8 subjekte, Individ 23 subjekte. Në total për vitin 2022 kanë ushtruar **aktivitet 3,843** subjekte
DTTV evidence Për vitin 2022, sipas kategorisë:
Prodhim Biznes i Madh (BM) 58 subjekte, Biznes i Madh Vip (BMV) 2 subjekte, Biznes i vogël (BV) 231 subjekte.Total prodhim 291 subjekte.

Shërbim Biznes i Madh (BM) 207 subjekte, Biznes i Madh Vip (BMV) 43 subjekte, Biznes i vogel (BV) 1192 subjekte. Total shërbim 1,442 subjekte.
Tregëti Biznes i Madh (BM) 205 subjekte, Biznes i Madh Vip (BMV) 16 subjekte, Biznes i vogël (BV) 1508 subjekte. Total tregëti 1,729 subjekte.
Profesion i lirë Biznes i Madh (BM) 8 subjekte, Biznes i vogël (BV) 87 subjekte. Total profesion i lirë 1,729 subjekte.
Në total për vitin 2022 kanë ushtruar **aktivitet 3,557** subjekte.

DTTV evidencë subjekte të çregjistruara, pezulluara

Për vitin 2022, sipas llojitkanë çregjistruar aktivitetin në QKB Biznes i Madh (BM) 22 subjekte, Biznes i vogël (BV) 107 subjekte, Transport 7 subjekte.
Për vitin 2022, sipas llojitkanë pezulluar aktivitetin në QKB Biznes i Madh (BM) 4 subjekte, Biznes i vogël (BV) 168 subjekte, Transport 11 subjekte.

DTTV sistem Kamza Taksa Biznes administron inforM on për **4,558 subjekte** nga të cilët:
Subjekte **aktiv për vitin 2022 janë 3595**, Subjekte të reja janë [10]712 për vitin 2022, Subjekte të pezulluara 469 (periU 2017 - 31.12.2022) dhe 205 vetëm për vitin 2022, Subjekte të mbyllura 614 (periU 2015 - 31.12.2022) dhe 205 vetëm për vitin 2022 (theksojmë se bazuar në inforM onin e marrë nga DTTV, baza e të dhënave Kamza Taksa Biznes është në funksion prej vitit 2021 dhe si bazë ka informacionin e transferuar nga baza e të dhenave e mëparshme Kamza Live e cila ka administurar informacionin për taksapaguesit deri më 31.12.2020).

Taksa tarifa vendore që administrohen nga SistemiDTTV kategoria Biznes	Numri i subjekteve aktive sipas evidencave të DTTV për vitin 2022	Numri i subjekteve mbi të cilët është përllogaritur në sistemin e DTTV detyrim sipastaksa /tarifa vendore për vitin 2022	Diferenca në numër subjektesh midis subjekteve aktiv në evidencn e DTTV dhe subjekteve për të cilët është bërë përllogaritja e detyrimit për taksa/tarifa vendore për vitn 2022
Të ardhura nga taksa e ndërtesës biznes	3,843	3,604	239
Takse Tabele (identifikuese)	3,843	3,299	544
Takse Reklame	3,843	170	3,673
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi	3,843	3,818	25
Të ardhura nga tarifë ndriçimi nga Biznesi	3,843	3,549	294
Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi	3,843	3,581	262
Takse e perkoheshme (Infras. Arsimore)	3,843	3250	593

Në paketën Fiskale të vitit 2022 të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Kamëz, ndahen në 2 kategori si më poshtë:

- **Biznes**
- **Familjar**

Kategoritë e mësipërme ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

- Biznes i Madh (BM); biznes i Madh Vip (BMV) Biznes i Vogël (BV); Tregtarët Ambulant.
- Familje që kanë në pronësi/përdorim banesa private, toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Nga auditimi i evidencave mbi planifikimin dhe realizimin vjetor të të ardhurave, paketës fiskale të miratuar dhe taksave e tarifave vendore që administron sistemi i DTTV u konstatua se:

6. Titulli i gjetjes: Numri i subjekteve sipas sistemit tatimor është i ndryshëm me numrin e subjekteve të raportuar në evidencë, nuk ka gjurmë auditimi për të bërë vlerësimin e saktësisë së përllogaritjes së detyrimeve.

10

Situata:Diferencë midis evidencës së DTTV dhe InforM onit të administruar nga sistemi lidhur me numrin e bizneseve që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Kamëz dhe planifikimin e taksave dhe tarifave vendore.

Duke krahasuar të dhënat e evidencave të DTTV dhe sistemit të DTTV konstatohet se ka mospërputhje midis tyre në numrin e subjekteve taksapagues, planifikim dhe realizim.

DTTV evidence sipas llojit të Biznesit për vitin 2022 kanë ushtruar **aktivitet 3,843** subjekte.

DTTV evidence sipas kategorisë për vitin 2022 kanë ushtruar **aktivitet 3,557** subjekte.

DTTV evidence subjekte të çregjistruara, pezulluara sipas llojitpër vitin 2022, kanë çregjistruar apo pezulluar aktivitetin në QKB 319 subjekte.

DTTV sistem Kamza Taksa Biznes administron inforM on për **4,558 subjekte** nga të cilët:

Subjekte **Aktiv për vitin 2022 janë 3,595**, Subjekte të rejajanë 712 për vitin 2022, Subjekte të pezulluara 469 (periU 2017-31.12.2022) nga të cilat 205 vetëm për vitin 2022, Subjekte të mbyllura 614 (periU 2015-31.12.2022) nga të cilat 205 vetëm për vitin 2022.

DTTV në planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk i planifikon dhe faturon detyrim secilit prej subjekteve për të gjitha taksat dhe tarifat e miratuara por vetëm për një pjese të tyre sipas tabelës së mësipërme. Për taksën e reklamës nga 3,843 subjekte të rregjistruar vetëm për 170 prej tyre planifikohet dhe faturohet kjo taksë, taksa tabele identifikuese nga 3,834 subjekte të rregjistruar vetëm për 3,299 prej tyre planifikohet dhe faturohet kjo taksë etj, tarifa përinfrastrukturën arsimore nga 3,834 subjekte të rregjistruar vetëm për 3,250 prej tyre planifikohet dhe faturohet kjo taksë.

Po analizojmë një prej tyre**, taksa mbi ndërtesën për vitin 2022 për kategorinë Biznes** është planifikuar në vlerën **65,291,287** lekë dhe është realizuar në vlerën **51,494,670** lekë, ose në masën 78.87 %, nga auditimi i faturimeve të subjekteve debitore në sistemin e DTTV për këtë taksë u konstatua se:

-DTTV Kamëz taksën mbi ndërtesën e ndan nga subjekti që ushtron aktivitet dhe e faturon pranë pronarit që ka në pronësi pasurinë ku zhvillohet aktiviteti. Kjo ndarje e bën të pamundur evidentimin dhe mbledhjen e këtij detyrimi.

Nga krahasimi i të dhënave sipas tabelës më sipër rezulton se:

Numri i subjekteve aktivë për vitin 2022 sipas evidences është 3,843, ndërsa numri i subjekteve që është ngarkuar kjo taksë sipas sistemit të DTTV është 3,604 (diferenca 293 subjekte nga totali sipas evidencës).

Plani të ardhurave për vitin 2022 sipas evidencës është llogaritur vetëm për 3,604 subjekte, ndërsa planifikimi dhe faturimi për 293 subjekte sipas sistemit të DTTV mungon.

Nga verifikimi i dosjeve të tatimpaguesve rezulton se nuk ka dokument që vërteton bazën e taksës (sipërfaqen në m^2).

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; neni 5, neni 11,...; Ligji nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat";Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar" i ndryshuar;Manuali i Manaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitmiratuar me Urdhërin e MFE nr. 108 datë 17.11.2016; Udhëzimi nr. 655/1, datë 06.02.2007, "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale dhe të raportimit të sistemit të takses vendore, Rregulloren e brendshme të bashkisë miratuar me aktin nr. 4119 prot. datë 11.05.2022, neni 36.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e kategorizimit dhe monitorimit të sistemit sjell evidenca te pasakta.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi

Rëndësia: E lartë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.B me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, **znj. G.D** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Terrenit, **znj. L.K** me Përgjegjësja i Sektorit të Vlerësimit të Detyrimit dhe Menaxhimit të Borxhit, **z. E.S** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave Familjare dhe **znj. R.D** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe kontabilizimit të Detyrimeve.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore

7. Titulli i gjetjes: Nuk është kryer një planifikim i saktë i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ku t'i referohet kërkesave reale të institucionit.

Situata: Për vitin 2022 paketa fiskale për taksat dhe tarifat vendore në Bashkisë Kamez është miratuar meVKB - në nr.137, datë 22.12.2021 "Për Sistemin Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz".

Për kategorinë e taksapaguesve Biznes

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi,

Për vitin 2022 (sipas inforM onit të marrë nga evidencat e vëna në dispocion të grupit të auditimit nga DTTV), në Bashkinë Kamëz kanë zhvilluar aktivitet **3,843** subjekte dhe kanë mbyllur aktivitetin **319** subjekte.

Edhe fakti që realizimi i disa të ardhurave kalon vlerën 100%, shpjegohet me mos ndarjen e pagesave për llogari të vitit buxhetor, nga ato për llogari të detyrimeve të prapambetura.

Për vitin 2022, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore gjithsej, nga 1,585,352 mije lekë, të parashikuara, janë realizuar në vlërën 1,055,658 mijë lekë, ose 66.59%, me një mosrealizim në vlerën 529,694 mijë lekë, sipas të dhënave në pasqyrën më poshtë:

Realizimi i të Ardhurave për periudhën 01 Janar 2022 -31 Dhjetor 2022

Lekë

Nr.	Emërtimi	Plani 12 Mujori2022	Fakti 12 mujor 2022	Realizimi ne % 12 m
I	**Drejtoriae Taksave e Tarifave Vendore**	**537,448,302**	**325,151,901**	**60.50%**
	Të ardhura nga Biznesi	**267,918,302**	**182,657,428**	**68.18%**
1	Taksë ndërtese	65,291,287	51,494,670	78.87%
2	Tarifë pastrimi të mbetjeve	77,814,695	72,746,925	93.49%
3	Taksë tabele	344,453	378,120	109.77%
4	Taksa reklame	4,148,922	3,922,231	94.54%
5	Taksë e truallit për qëllime biznesi	7,070,611	6,142,948	86.88%
6	Tarifë shërbimi	763,642	780,484	102.21%
7	Taksë hotelerisë	167,890	176,500	105.13%
8	Debitor viti	61,800,000	5,248,131	8.49%
9	Taks e gjelbërt	15,923,368	15,902,414	99.87%
10	Taksa mbi tokën	8,487,200	3,723,628	43.87%
11	Taksë tregjeve dhe zënie hapësirave publike	385,735	76,360	19.80%
12	Taksë e përkohshme e rrjetit kabllor, ajror dhe nëntoksor	1,054,442	257,285	24.40%
13	Taksë therje të bagëtive të imta e të trasha	3,182,700	0	-
14	Tarifë ndriçimi	9,996,971	10,122,961	101.26%
15	Taksa e kalimit të pronësisë	3,278,181	2,748,771	83.85%
16	Taksa vendore biznez i vogël (tatim fitimi)	0	1,258,799	-
17	Tarifë vendore për infrastrukturën arsimore	8,208,205	7,671,392	93.46%
18	Të ardhura nga gjobat për mos pagim në afat	0	5,809	0.00%
19	**Taksa dhe tarifa lokale (familjarët)**	**269,530,000**	**142,494,473**	**52.87%**
a	Ndërtesa	72,000,000	42,531,621	59.07%
b	Pastrim	108,000,000	59,585,083	55.17%
c	Taksa e truallit për qëllime banimi	1,000,000	0	-
d	Taksë e gjelbërt	14,400,000	8,357,377	58.04%
e	Tarifë ndriçimi	3,600,000	2,164,736	60.13%
f	Tarifë vendore per infrastrukturën arsimore (familjare)	18,000,000	9,670,906	53.73%
g	Taksa dhe tarifa lokale (familjarët) debitor	52,530,000	20,184,750	38.43%
20	**Legalizimet**	**179,600,000**	**33,429,757**	**18.61%**
a	Taksë e ndikimit të legalizimeve debi	177,600,000	32,328,464	18.20%
b	Taksë e ndikimit të legalizimeve	2,000,000	1,101,293	-
II	**Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit**	**652,638,000**	**559,344,432**	**85.71%**
1	Leje ndërtimi, leje zhvillimi	630,000,000	546,139,329	86.69%
2	Leje përdorimi	3,900,000	304,894	7.82%
3	Tarifa (piketim strukture, themele, karabina, sist. i jashtëm)	18,738,000	12,900,209	68.85%

III	**Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave**	**3,465,000**	**795,828**	**22.97%**
1	Shitje Toke	3,465,000	795,828	22.97%
IV	**Drejtoria Transportit & Liçensave**	**62,043,900**	**63,869,600**	**102.94%**
1	Taksë regjistrimi automjetesh	42,000,000	46,200,495	110.00%
2	Leje transporti transporti taksi	1,860,000	2,088,950	112.31%
3	Leje transporti transporti udhetarësh	3,075,800	2,954,500	96.06%
4	Leje transporti transport mallrash	3,720,500	3,058,655	82.21%
5	Leje Aktiviteti	2,800,600	2,504,000	89.41%
6	Autorizim për tregti karburanti me pakicë	6,200,000	6,817,000	109.95%
7	Parkim i rezervuar	1,987,000	230,000	11.58%
8	Të tjera tarifa administrative	400,000	16,000	0.00%
V	**Drejtoria Sherbimeve pulike**	**23,383,000**	**7,107,005**	**30.39%**
1	Shërbime Funerale	7,383,000	5,163,000	69.93%
2	Tarifë nga MKZ	16,000,000	1,944,005	12.15%
VI	**Ndër. Ujesjellës -Kanalizimeve**	**73,360,800**	**0**	**-**
3	K.U.N familje debi	51,652,800	0	-
4	K.U.N biznes debi	21,708,000	0	-
VII	**Të Tjera**	**55,000,000**	**61,150,553**	**111.18%**
1	Taksë e deleguar të ardhura nga TAP	35,000,000	31,241,330	89.26%
2	Gjoba Inspektoriati Ndërtimor	3,000,000	3,562,264	118.74%
3	Gjoba Policia Bashkiake	500,000	0	-
4	Të ndryshme + bileta shërbimi	7,000,000	2,090,050	29.86%
5	Të ardhura nga kopshtet e çerdhet	9,500,000	8,203,179	86.35%
6	Taksa e akteve dhe e pullës	0	133,200	-
7	Debitor Bashkia (KLSH)	0	6,313,882	-
8	Sponsorizime	0	5,496,432	-
9	Të ardhura nga qira për troje	0	442,310	-
10	Të ardhura nga qira për ndërtesë	0	3,104,080	-
13	Khim pagese Operatori i Shpëndarjes	0	553,425	-
14	Grante nj. Vendore nga pjesmarrja në taksën e rentës minerare	0	10,401	-
	Totali	**1,586,939,002**	**1,050,849,076**	**66.22%**
	0.1 % që do të derdhet në K. e Qarkut	-1,586,940		-
	Të tjera (Gj.Civile, taks pulle, dep. Të tjera në ruajtje, ..)	0	4,809,031	-
	Mbeten të ardhura Bashkisë	**1,585,352,062**	**1,055,658,107**	**66.59%**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Në këtë planifikim të ardhurash, të ardhurat nga taksatduke përfshirë dhe taksat e ndara janë planifikuar në vlerën 1,109,441,421 lekë dhe janë realizuar në vlerën 790,221,889 lekë, ose në masën 71,23 %, ndërsa të ardhurat jo tatimore (peshën kryesore e zënë tarifat vendore), janë planifikuar në vlerën 475,910,641 lekë dhe janë realizuar në vlerën 265,436,218 lekë, ose në masën 55.77%.

Në mënyrë të përmbledhur:

Lekë

Nr.	**Viti 2022**	**12 Mujori2022**	**12 mujor 2022**	**në % 12 m**
	Të Ardhura nga burimet e veta	**1,585,352,062**	**1,055,658,107**	**66.59%**
1	Të ardhurat nga Taksat Vendore	1,029,163,240	710,020,892	68.99%
2	Të ardhurat nga taksat e ndara	80,278,181	80,200,997	99.90%
3	Të ardhura nga tarifa vendor	457,097,581	230,712,365	50.47%
4	Të ardhura të tjera	18,813,060	34,723,853	184.57%

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Për vitin 2022, të ardhuratnga taksat e tarifat vendore gjithsej që arkëtohen nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, nga 537,448 mije lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 261,706 mijë lekë, ose 61 %, **me një mosrealizim 212,296 mijë lekë**.

Sa më sipër konstatohet se në planin e të ardhurave me mosrealizim të dukshëm dhe që ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave për periudhën objekt auditimi, janë debitorët e vitit për biznesin, taksë ndertese, taksë trualli, taksa dhe tarifa lokale (familjarët)..etj.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon

negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar sakt burimin e të ardhurave.
Nga DTTV nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.
Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2022 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.
Në këtë konteks është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Kamëz që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut.
Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimi e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II, pika 2, gërma "a" dhe "b", Kreu III, pika 32.
Ndikimi/Efekti: Mos planifikimi i saktë i të ardhurave të pritshme nga taksat dhe tarifat vendore ndikon në hartimin e buxhetit të bashkisë, në angazhimet që parashikohen të ndërmerren gjatë vitit buxhetor. Për të ardhurat të cilat vijnë nga detyrimet prapambetura nga taksave dhe tarifave të cilat janë të paplanifikuara, shpërndahen sipas zërave por nuk ka një ndarje të ardhurave nga detyrimet e prapambetura dhe ato aktuale duke mos pasqyruar qartë se cili është burimi i tyre duke ndikuar në nivelin e realizimit të plan-faktit të të ardhurave vjetore të Bashkisë Kamëz.
Shkaku: Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
Rëndësia: E lartë.

Po analizojmë me zgjedhje disa nga taksat e tarifat:
Taksa dhe tarifa lokale (familjarët).
Me vendim të Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 137, datë 23.12.2021 "Për Sistemin Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz", për vitin 2022 është miratuar taksë ndërtese për familjaret 2,000 lekë në vit për çdo familje, tarifë pastrimi 3,000 lekë, arsimi 500 lekë, gjelbërimi 400 lekë, ndriçimi 100 lekë për çdo familje (vlera totale 6,000 lekë).
Janë përcaktuar Lehtësira dhe perjashtime sipas paketës fiskale 2022,
Pika C.5 të VKB-së nr. 137 datë 22.12.2021, kemi nënkategorinë:

Nr.	Kategori		Niveli i pagesës tarifave	Niveli pagesës (Lekë/Vit)	DTTV	UKK	Total	Shënime
1	Invalidet e punës, të verbërit, para-tetra plegjikët		30%	1,800	171	240	411	
2	Kryefamiljaret gra		30%	1,800	626	109	735	
3	Kryefamiljarët pensionist		30%	1,200	1,062	865	1927	Përjashtohen nga taksa e pasurisë

4	Te pa - aftët kryefamiljar		30%	1,800	80	46	126	
	Familjet që jetojnë në emigracion	Me Banes	0 Lekë	2,000	1,404	1,179	2,583	
		Pa Banes	0 Lekë	0	865		865	
6	Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike		0 Lekë	0	247	271	518	Përjashtohen nga taksa e pasurisë

Sipas të dhënave nga drejtoria e financës dhe kontabilitetit, planifikimi vjetor i taksave dhe tarifave lokale për vitin 2022, është269,530 mijë lekë është realizuar 142,494 mijë lekë (sipas arkëtimeve në bashki dhe akt rakordimeve me agjentin tatimor UKK), ose 52.87 % e planit vjetor.

Agjenti UKK SHA, bazuar në aktmarrvëshjen nr. 409 prot. datë 18.01.2022, ndërmjet institucioneve Bashkia Kamëz - UKK SHA, planifikon dhe arkëton taksat vendore për 21,065 familje, ndërsa 19,952 familje janë të planifikuara në sistemin e DTTV, pra në total 41,257 familje.

Kjo marrëveshje, bazohet në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 132, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të Pasurisë së Paluajtshme "Ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e inforM onit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës",VKB nr. 137, datë 22.12.2021 "Për sistemin e taksave e tarifave vendore në Bashkinë Kamëz".

Sipas sistemit të gjendjes civile numri i familjeve në territorin e bashkisë për vitin 2022 është 39,779 familje.

Pra janë planifikuar 1,478 familje më shumë, të cilat sipas përgjegjësit të sektorit të taksave familjare janë ose dublime ose janë familje pa gjendje civile në Kamëz por janë banor me kontrate uji.

Për arkëtimet nga UKK në llogaritë e veta, është rakorduar sipas tabelës:

Viti 2022		
Nr.	**Muaji**	**Data e akt rakordmit**
1	Janar	Nr.814prot. datë 12.04.2022
2	Shkurt	Nr.814/1 prot. datë12.04.2022
3	Mars	Nr. 814/2 prot. datë12.04.2022
4	Prill	Nr. 814/3 prot. datë10.06.2022
5	Maj	Nr. 814/3 prot. datë 10.06.2022
6	Qershor	Nr. 814/4 prot. datë 09.08.2022
7	Korrik	Nr. 814/4 prot. datë 09.08.2022
8	Gush	Nr. 814/5 prot. datë 09.09.2022
9	Shtator	Nr. 1047 prot. datë 08.06.2023
10	Tetor	Nr. 1047/1 prot. datë 08.06.2023
11	Nëntor	Nr. 1047/2 prot. datë 08.06.2023
12	Dhjetor	Nr. 1047/3 prot. datë 08.06.2023

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

8. Titulli i gjetjes: Mungesa e një regjistri të plotë të taksapaguesve të kategorisë familjare, mosndjekja e zbatimit të kontratës nga agjenti tatimor.

Situata:

a. Rakordimi mbi numrin real të abonentëve që administron UKK sha nuk është i saktë.

Për periudhën 2022 nuk është hartuar një plan apo strategji, vjetore apo afatshkurtër (më shumë se një vit), për të evidentuar familjet e pa rregjistruara të agjenti tatimor UKK, në mënyrë që të ndiqet arkëtimi i tyre jashtë agjentit tatimor, pra nga vetë administrata e taksave dhe tarifave vendore.

DTTV ka hartuar regjistër të taksapaguesve familjar por ende ka mos rakordim duke mos evidentuartaksapaguesit familjar të cilët nuk kanë marrëdhënie me UKK. Drejtoria e Taksave

dhe Tarifave Vendore ka lënë jashtë mbikëqyrjes së saj këtë kontingjent taksapaguesish familjar.
Nuk ka të dhëna për familjarët të cilët nuk kanë marrëdhënie me UKK. Për këta taksapagues nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, duhet të ndiqeshin procedurat ligjore për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me paketën fiskale.
Rakordimi mbi nivelin e arkëtimevepër muajt janar, shkurt dhe mars 2022 është bërë me datë 12.04.2022, për muajt prill dhe maj është bërë me datë 10.06.2022, për muajt qërshor dhe korrikështë bërë me datë 09.08.2022, për muajn gusht është berë me datë 09.09.2022, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetorështë bërë me datë 08.06.2023.
b. Evidencat e DTTV nuk përputhen me raportet e sistemit të DTTV dhe detyrimet nuk janë pasqyruar korrekt nëpasqyrat financiare.
Grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion të saktë dhe të qenësishëm për situatën e menaxhimit, identifikimit, rregjistrimit dhe vjeljes së të ardhurave për debin tatale për taksat familjare pasi ka pasaktësi në përcaktimet e numrit të familjeve që shërbejnë si bazë për përllogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat, për të cilat DTTV nuk ka marrë asnjë masë për ndjekjen e etapave që parashikon legjislacioni në fuqi për vjeljen e tyre.
Kriteri: Aktmarrvëshjen nr. 409 prot., datë 18.01.2022, ndërmjet institucioneve Bashkia Kamëz - UKK SHA, neni 10 pika 1, "Rakordimet", ku cilësohet: Bashkia Kamëz brenda datës 15 të çdo muaji pasardhës ngarkon DTTV të bëjnë rakondime përkatëse me agjentin tatimor mbi të ardhurate arkëtuara në përputhje me nenet 5 dhe 6 të kësaj marrëveshje, duke mbajtur aktrakordimin dypalësh sipas dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim.
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; neni 5, neni 11,...; Ligji nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat";Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar", i ndryshuar;Manualin e Manaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitmiratuar me Urdhërin e MFE nr. 108 datë 17.11.2016; Udhëzimi nr. 655/1, datë 06.02.2007, "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale dhe të raportimit të sistemit të takses vendore"; aktmarrvëshjea nr. 409 prot., datë 18.01.2022, ndërmjet institucioneve Bashkia Kamëz - UKK sha, neni 10 pika 1.
Ndikimi/Efektiviteti: Mos evidentim i taksapaguesve dhe mos arkëtim i të ardhurave prej tyre, çojnë në mungesën e të ardhurave në buxhetin e bashkisë.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit ligjor në fuqi si dhe paketës fiskale.
Rëndësia: E lartë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.S me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Taksave Familjare.

Të ardhurat e arkëtuara nga UKK për llogari të BashkisëKamëz bazuar në rakordimet dypalëshe për vitin 2022 paraqiten:

Lekë

Viti 2022									
Nr.	**Muaji**	**Debi e mbartur**	**Tarifa e Ndricimit**	**Taksa e gjelbërimi**	**Tarifa e pastrimit**	**Taksë ndërtese**	**Taksë arsimi**	**Totali**	**Data Pagesës në bank (financa)**
1	Janar	157,610	124,345	473,038	3,367,688	2,392,868	545,719	7,061,268	22.04.2022
2	Shkurt	119,758	142,462	560,244	3,989,080	2,845,690	645,219	8,302,452	14.06.2022
3	Mars	175,559	138,028	533,776	3,800,884	2,695,397	615,860	7,959,504	25.07.2022
4	Prill	107,289	131,780	506,884	3,611,859	2,581,203	584,731	7,523,747	26.07.2022
5	Maj	178,106	133,073	532,034	3,793,034	2,701,567	612,234	7,950,048	24.08.2022
6	Qershor	111,207	139,897	541,736	3,863,588	2,764,307	624,692	8,045,427	20.09.2022

7	Korrik	187,771	153,166	569,847	4,055,930	2,918,470	658,128	8,543,312	25.10.2022
8	Gusht	88,948	137,531	515,803	3,676,988	2,631,532	595,783	7,646,586	02.11.2022
9	Shtator	79,391	135,837	513,562	3,657,834	2,613,015	590,322	7,589,961	07.12.2022
10	Tetor	80,778	147,580	516,622	3,680,180	2,632,954	595,824	7,653,937	09.03.2023
11	Nëntor	54,285	147,804	556,874	3,968,159	2,847,035	642,392	8,216,549	27.03.2023
12	Dhjetor	120,175	151,233	556,939	3,968,859	2,851,185	642,764	8,291,156	05.04.2023
Total arkëtime nga UKK		1,460,877	1,682,736	6,377,357	45,434,085	32,475,222	7,353,669	94,783,946	-
Komisioni në përqindje		0.025	0.025	0.025	0.025	0.025	0.025	0.025	-
Komisioni në vlerë		36,522	42,068	159,434	1,135,852	811,881	183,842	2,369,599	-
Total Paguar		1,424,355	1,640,668	6,217,923	44,298,233	31,663,341	7,169,827	92,414,347	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Të ardhurat e arkëtuara nga UKK për llogari të BashkisëKamëz bazuar në rakordimet dypalëshe për korrik - nentor2021 paraqiten:

Lekë

Viti 2021			
Nr.	**Muaji**	**Totali**	**Data Pageses**
1	Korrik	8,493,952	25.01.22
2	Gusht	8,072,844	14.02.22
3	Shtator	7,895,392	11.02.22
4	Tetor	7,753,653	25.03.22
5	Nëntor	8,581,604	15.04.22
6	Dhjetor	8,458,263	

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Mos zbatim ikushteve të kontratës të lidhur midis bashkisë dhe agjentit tatimor UKK sha.

Nga UKK sha, pagesa për muajin korrik 2021, eshtë bërë më datë 25.01.2022, për muajin gusht 2021, eshtë bërë më datë 14.02.2022, për muajin shtator 2021, eshtë bërë më datë 11.02.2022, për muajin tetor 2021, është bërë më datë 25.03.2022, për muajin nëntor 2021, është bërë më datë 15.04.2022, për muajin tetor 2022 për, është bërë më datë 09.03.2023, për muajin nëntor 2022, është bërë më datë 27.03.2023, sa më sipër nga Bashkia Kamëz duhet të zbatoheshin penalitete. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar,Neni 7 pika2, ku cilesohet, *Agjenti i mbajtjes së tatimit ka edhe këto detyra plotësuese, shkronjab) të paguajë tatimin në Buxhetin e Shtetit, në datën e përcaktuar në ligj;* Neni 117,ku cilesohet, *Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo ai i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme: a) Gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast se e ka mbajtur, llogaritur dhe deklaruar tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën, por nuk e ka transferuar atë në Buxhetin e Shtetit. Ky dënim aplikohet për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike;*me aktmarrvëshjen nr. 409 prot. datë 18.01.2022, ndërmjet institucioneve Bashkia Kamëz - UKK SHA, neni 10 pika 2, "Rakordimet", ku cilësohet: *Pagesat për Bashkinë Kamëz bëhen Brenda Vitit Fiskal, Agjenti Tatimor derdh në buxhetin e Bashkisë Kamëz të ardhurat e arketuara dhe rakorduara sipas vlerave në vijim.*

Numri i abonentëve/familjeve të faturuar, arkëtuar dhe debitor paraqitet sipas tabelës.

Lekë

Viti 2022										
		UK Kamëz			**Drejtoria TTV**			**Total (UKK + DTTV)**		
Nr.	**Muaji**	**Nr. abonent Faturuar**	**Nr. abonent Arkëtuar**	**Nr. abonent Debitor**	**Nr. abonent Faturuar**	**Nr. abonent Arkëtuar**	**Nr. abonent Debitor**	**Nr. abonent Faturuar**	**Nr. abonent Arkëtuar**	**Nr. abonent Debitor**
1	Janar	21,098	12,606	8,492	20,192	316	19,876	41,290	12,922	28,368
2	Shkurt	21,098	13,857	7,241	20,192	214	19,978	41,290	14,071	27,219
3	Mars	21,098	13,541	7,557	20,192	205	19,987	41,290	13,746	27,544
4	Prill	21,098	13,328	7,770	20,192	261	19,931	41,290	13,589	27,701
5	Maj	21,098	13,534	7,564	20,192	238	19,954	41,290	13,772	27,518
6	Qershor	21,081	13,527	7,554	20,192	177	20,015	41,273	13,704	27,569
7	Korrik	21,064	13,739	7,325	20,192	188	20,004	41,256	13,927	27,329
8	Gusht	21,054	13,535	7,519	20,192	316	19,876	41,246	13,851	27,395

9	Shtator	21,051	13,606	7,445	20,192	178	20,014	41,243	13,784	27,459
10	Tetor	21,034	13,488	7,546	20,192	187	20,005	41,226	13,675	27,551
11	Nentor	21,027	13,922	7,105	20,192	245	19,947	41,219	14,167	27,052
12	Dhjetor	20,973	14,025	6,948	20,192	361	19,831	41,165	14,386	26,779
Mesatarja		**21,065**	**13,559**	**7,506**	**20,192**	**241**	**19,952**	**41,257**	**13,800**	**27,457**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Vlera efaturuar, arkëtuar dhe debitor paraqitet sipas tabelës.

Lekë

Viti 2022										
		UKKamez			**Drejtoria TTV**			**Total (UKK + DTTV)**		
Nr.	**Muaji**	**Vlera faturuar**	**Vlera arkëtuar**	**Vlera debi**	**Vlera faturuar**	**Vlera arkëtuar**	**Vlera debi**	**Vlera faturuar**	**Vlera arkëtuar**	**Vlera debi**
1	Janar	9,541,996	6,884,737	2,657,260	8,896,250	2,370,550	6,525,700	18,438,246	9,255,287	9,182,960
2	Shkurt	9,555,101	8,094,891	1,460,210	8,896,250	1,928,600	6,967,650	18,451,351	10,023,491	8,427,860
3	Mars	9,524,539	7,760,516	1,764,023	8,896,250	1,896,550	6,999,700	18,420,789	9,657,066	8,763,723
4	Prill	9,493,566	7,335,653	2,157,913	8,896,250	2,347,850	6,548,400	18,389,816	9,683,503	8,706,313
5	Maj	9,505,513	7,751,296	1,754,217	8,896,250	1,999,415	6,896,835	18,401,763	9,750,711	8,651,052
6	Qershor	9,449,142	7,844,291	1,604,851	8,896,250	1,656,100	7,240,150	18,345,392	9,500,391	8,845,001
7	Korrik	9,412,857	8,329,729	1,083,128	8,896,250	1,470,700	7,425,550	18,309,107	9,800,429	8,508,678
8	Gusht	9,411,940	7,455,421	1,956,519	8,896,250	2,204,150	6,692,100	18,308,190	9,659,571	8,648,619
9	Shtato	9,385,418	7,400,212	1,985,206	8,896,250	1,985,100	6,911,150	18,281,668	9,385,312	8,896,356
10	Tetor	9,403,753	7,462,589	1,941,165	8,896,250	1,624,450	7,271,800	18,300,003	9,087,039	9,212,965
11	Nëntor	9,347,958	8,011,135	1,336,823	8,896,250	2,539,750	6,356,500	18,244,208	10,550,885	7,693,323
12	Dhjetor	9,333,381	8,083,877	1,249,505	8,896,250	3,573,150	5,323,100	18,229,631	11,657,027	6,572,605
Totali		**113,365,167**	**92,414,347**	**20,950,820**	**106,755,000**	**25,596,365**	**81,158,635**	**220,120,167**	**118,010,712**	**102,109,455**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

9. Titulli i gjetjes: Mos kontabilizimi i të dhënave nga sistemi i taksave në pasqyrat financiare.

Situata: Vlera e debisë(sipas pasqyrave financiare) më datë 31.12.2021 është 201,973,700 lekë, me datë 31.12.2022 është 297,508,794 lekë.

Në sistemin e drejtorisëtaksave & tarifavevendore vlera e debisë me datë 31.12.2022 është në vlerën 771,305,000 lekë **e cila konsiderohet të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Kamëz.**

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4 pika 26,neni 5...., neni 11,...;Udhëzimi e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, **neni 9, neni 35, neni 41;** ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika ç; ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar", VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores "*Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*", i ndryshuar, Manuali për MFK i miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 108 datë 17.11.2016, kapitulli III, Rregulloren e brendshme të bashkisë miratuar me aktin nr. 4119 prot. datë 11.05.2022, neni 36.

Ndikimi/Efekti: Risk i humbjes së të dhënave si dhe mos pasqyrim i saktë i situatës të njësisë.

Shkaku: Mos hedhje e të dhënave nga sistemi i taksave në pasqyrat financiare, për detyrimet e abonentëve familjarë.

Rëndësia: E lartë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet që legalizohen

Bazuar në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2006 "Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje", i ndryshuar, ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 27 "*Taksa e ndikimit në infrastrukture", pika 3, germa "c", ku*

cilësohet; Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 (zero pikë pesë) për qind e vlerës së investimit.
Kjo taksë është miratuar edhe me Vendim të Këshillit Bashkiak Kamez bashkë memiratimin e paketës fiskale.
Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga DrejtoriaVendore e ASHK Kamëz-Vorë, u auditua dokumentacioni për vitin 2022, i paraqitur nga Drejtoria TTV. Nga DVASHK, janë dërguar listat për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI).
Për vitin 2022, janë paisur me leje legalizimi 1,254 objekte informale (bazuar në listat që bashkia administron), me siperfaqe totale 304,280 m 2, ku 274,050 m^2 janë siperfaqe ndërtimipër banim, ndërsa 9,206 m^2 janë siperfaqe ndërtimi për biznes (shërbime) dhe 21,024 m^2 janë siperfaqe ndërtimi të kombinuar.

Emërtimi	Sipërfaqe m^2	Numër objekte
Banim	287,394	1,202
Shërbim	17,269	50
Objek fetar	1,561	2
Totali	**304,280**	**1,254**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Nga qershori 2014 deri më datë 31.12.2022, janë paisur me leje legalizimi 14,763 objekte.
Taksa e ndikimit në infrastrukturë është paguar për 6,155 objekte.
Vlera e debisë më datë 31.12.2022 është 297,508,794 lekë, për 8,608 objekte.
Në tabelë paraqiten të dhënat në vite për objektet e legalizuara:

Lekë

Vitet	Numër objektesh legalizuar	Vlera e llogaritur për pagesë	Vlera e arkëtuar	Vlera debi date 31.12.2022
2014 - 2022	14,763	608,548,909	311,040,115	297,508,794

10. Titulli i gjetjes: Mbi menaxhimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.
Situata: Mbi masat marra për faturimin dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi, të pajisura me leje legalizimi nga DVASHK -Kamez-Vore.
Vlera debitore progresive **është 297,509,794 lekë për 8,608 subjekte e cila konsiderohet të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Kamëz.** (nga të cilat 1084 subjekte për vlerën 42,580 mijë lekë krijuar në vitin 2022).
Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga DTTV -Kamëz, nuk janë marrë masat për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t'i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare,... etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale.
Kriteri:
Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Kamëz në vlerën 297,508,794 lekë.
Shkaku: Mos kryerja e akt-rakordimeve midis Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kamëz dhe ASHK Rajonale Kamëz-Vorë, për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve.
Rëndësia: E lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.Bme detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, **znj. L.K** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit të Detyrimit dhe Menaxhimit të Borxhit dhe **znj. R.D** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe Kontabilizimit të Detyrimeve.

Transferimi i të dhënave nga baza e të dhënave Kamza Live në bazën e të dhënaveKamza Taksa Biznes

Bashkia Kamëz dhe DTTV ka në administrim sistemin e manaxhimit të të dhënave **TAIS (Microsoft Dynamics Nav 32013 R2)** (në vijim "Sistemi). Data e themelimit të bazës së të dhënave është30.09.2013 (projekt nga USAID), vënë në shërbim në vitin 2014. Nëpërmjet sistemit**,** DTTV- ja realizon **postimin e detyrimeve** të planifikuara nga inspektorët e sektorit të terenit dhe **rakordimin e arkëtimeve të pagesave** që bëhen në Bankat e nivelit të dytë , ndjekjen e subjekteve debitorë **nga** sektori i analizës dhe kontabilizimit të detyrimeve. Nga inforM oni i marrë nga DTTV rezulton se Bashkia Kamëz administron dy baza të dhënash të cilat ndërveprojnë midis tyre nëpërmjet sistemit, konkretisht **"Baza e të dhënave Kamza Live" (**në vijim Kamza Live) **dhe "Baza e të dhënave Kamza Taksa Biznes" (**në vijim Kamza Biznes).

Sipas inforM onit nga DTTV"Kamza Live" ka funksionuar deri më datë 31.12.2020. Nga Viti 2021 DTTV administrimin e taksave dhe tarifave vendore e ka bërë nëpërmjet të njëjtit sistem por si bazë të dhënash përdor Kamza Taksa Biznes. Transferimi i të dhënave nga Kamza Live në Kamza Taksa Biznes është kryer nëpërmjet kompanisë së kontraktuar për "mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit elektronik të taksave e tarifave vendore" sipas kontratës nr. 8967 prot. datë 06.11.2020, midis Bashkisë Kamëz Përfaqesuar nga Zv. Kryetari i Bashkisë z. H. B. subjektit "I.SHPK përfaqësuar nga administratori z. D. G. Nëkontratë nuk është e përcaktuar krijimi i një baze të re të dhënash "Kamza Taksa Biznes", dhe procesi i transferimit të të dhënave nga baza e të dhënave "Kamza Live" në bazën e të dhënave "Kamza Taksa Biznes".

Nga shqyrtimi i strukturës të detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Kamëz (sipas evidencave të raportuara në pasqyrat financiare në vite (llogaria 468) progressive), informacionit për 5,668 subjekte që administron Kamza Live për vitin 2020, informacionit për 3254 subjekte që administron Kamza Taksa Biznes për vitin 2020, evidencë për njoftim bllokim në Bankat e nivelit të dytë për viti 2022u konstatua se:

11. Titulli i gjetjes: Transferimi i të dhënave nga baza e të dhënave Kamza Live në bazën e të dhënaveKamza Taksa Biznes nuk është i plotë dhe konform kuadrit rregullator në fuqi për krijimin, dërgimin, marrjen, mbrojtjen, ruajtjen, protokollimin, arkivimin e bazës së të dhënave.

Situata: **Nuk ka asnjë dokumentim për procesin e transferimit** të të dhënave nga baza e të dhënave Kamza live në bazën e të dhënave Kamza Taksa Biznes.

Mungon protokollimi dhe njohja e drejtorisë së financës për listën e të dhënave që ju nënshtruantransferimit, listave të të dhënave të cilat do të arkivohen (evidentim, protokollim dhe arkivim i kartelave dhe listës emërore dhe vlerave debitore për subjektet që nuk u transferuan dhe subjekteve të cilat janë subjekt arkivimi).

Nuk ka asnjë dokumentim për Standardet e aplikuara në bazën e të dhënave për këtë proces; Të dhënat në lidhje me monitorimin e bazës së të dhënave dhe statistikave operacionale të këtij procesi; Bazën ligjore për ndryshimin e përbërjes së të dhënave, datën e fillimit të ndryshimit të përbërjes së të dhënave apo çdo ndryshim të nevojshëm që lidhet me ndryshimin e përbërjes së të dhënave; Të dhënat e personit përgjegjës për kryerjen e këtij procesi, roli i personit përgjegjës, të drejtat e personit përgjegjës, afatin e vlefshmërisë së të drejtave të personit përgjegjës, statusi i vlefshmërisë së të drejtave, nivelin e përgjegjësisë së personit përgjegjës.

Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor

Struktura e detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Kamëz sipas evidencave të raportuara në pasqyrat financiare në vite (llogaria 468) progresive dhe për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Lekë

Taksat dhe Tarifat Vendore	Gjendja e debitoreve për taksa dhe tarifa vendore sipas viteve në lekë (sipas raportimeve në pasqyrat financiare)				Debia Kamza Livenë lekë	Debia Kamza Taksa Biznes në lekë	Debia në listat për bllokim në bankat e niv të dytë 2022
	2019	2020	2021	2022	2020	2022	2022
	96,008,364.62	**113,329,862**	**121,835,012**	**85,866,370**	**174,631,661**	**99,093,059**	**53,884,057**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Më poshtë pasqyrohen në trajtë narrative të dhënat e evidencave të DTTV, sistemit të DTTVdhe listës emërore të subjekteve debitore të dërguar në Bankat e nivelit të dytë për bllokim te vlërës që këto subjekte i detyrohen Bashkisë Kamëz.

DTTV në sistem Kamza Live **për vitin 2020** administron informacion për **5,668 subjekte**.

DTTV sistem Kamza Live viti 2020 Vlera Debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për datë 31.12.2020 është **174,631,661 lekë, kjo vlerë ju përket 1,376 subjekteve.**

DTTV sistem Kamza Taksa Biznes për vitin 2020 administron informacion për **3,254 subjekte**.

DTTV sistem Kamza Taksa Biznes vitin 2022 Vlera Debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2022 është **99,093,059 lekë, kjo vlerë ju përket 400 subjekteve.**

DTTV evidencë viti 2019 Vlera Debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2019 është **96,008,364.62 lekë, kjo vlerë ju përket 502 subjekteve**.

DTTV evidencë viti 2020 Vlera Debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2020 është **113,329,862 lekë, kjo vlerë ju përket 430 subjekteve**.

DTTV evidencë viti2021 Vlera Debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2021 është **121,835,012 lekë, kjo vlerë ju përket 444 subjekteve.**

DTTV evidencë viti 2022 Vlera Debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2022 është **85,866,370 lekë, kjo vlerë ju përket 395 subjekteve.**

DTTV evidencë Bankë viti 2022 Vlera Debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2022 të dërguar në Bankat e nivelit të dytë për bllokim te vlërës që këto subjekte i detyrohen Bashkisë Kamëz është **53,884,057 lekë, kjo vlerë ju përket 390 subjekteve.**

Nga intervistat me Drejtorin e DTTV rezulton se:

Sipas DTTV detyrimin vjetor për sa më sipër paraqitet në financë nëpërmjet evidencave vjetore dhe mbart vlerën progresive të detyrimit për subjektet. Në vitin 2020 është bërë transferimi i të dhënave nga baza e të dhenave ekzistuese Kamza Live drejt bazës së të dhënave Kamza Taksa Biznes si nevojë për performancë më të lartë në procesim dhe optimizim të te dhënave që aadministronte Kamza Live. *Në këtë transferim të të dhënave nuk janë përfshirë subjektet me status mbyllur pezulluar çrregjistruar ndër vite. Të dhënat për këto subjekte do të manaxhohen nëpërmjet ndërveprimit të Bazës së re me Kamza Live-in por nuk ka asnjë spjegim lidhur me këtë ulje në raportimin për vitin 2020.*

Sipas Financës regjistrimet në pasqyrat financiare bëhen vetëm bazuar në evidencat zyrtare të cilatparaiqten nga DTTV. Sa më sipër konstatohet se:

Mospërputhje në numrin e subjekteve taksapagues midis dy bazave të të dhënave, vlerën debitore te tyre në pasqyrat financiare dhe Vlera Debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2022 të dërguar në Bankat e nivelit të dytë për bllokim te vlërës që këto subjekte i detyrohen Bashkisë Kamëz**.**

a. Në bazën e të dhënave Kamza Taksa Biznes për vitin 2020 nuk janë transferuar 2,414 subjekte. Debitore me status aktiv në "Kamza Live" më datë 31.12.2020 janë1,376 subjekteve debitor vlera debitore e të cilëve në vitin më 31.12.2020 **është 174,631,661 lekë**. Në pasqyrat financiare, vlera debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për

vitin 2020 është raportuar 113,329,862 lekë, kjo vlerë ju përket 430 subjekteve (kjo vlerë ju përket vetëm subjekteve debitorë me status aktiv) .

Nga grupi auditimit janë kryer disa testime për të verifikuar procesin e përpunimit të informacionit që bën sektori i borxhit të përfituar nga sistemi në format PDF drejt formatit excel. Informacioni i përpunuar në formatin excel (regjistri i borxhit) përdoret për të përgatitur evidencat që paraqiten në kontabilitet dhe njoftimet për bllokim detyrimi në bankat e nivelit të dytë, etj. DTTV e në evidencën që paraqitet për kontabilitet paraqet detyrimi progresiv ndërsa në listat për njoftim bllokim detyrimi shkon si vlerë progresive e detyrimit të subjekteve. Detyrimi progesiv për evidencat në kontabilet trajtohet si përllogaritje e detyrimeve vjetore të paraqitura në evidenca respektivisht për çdo vit.

b. Nga auditimi i procesit rezulton se nuk rakordon vlera e detyrimit vjetor të subjekteve në sistemin e DTTV me atë të paraqitur në evidencat për raportim në kontabilitet.

Rezultatet e këtij testimi paraqiten si më poshtë:

DTTV sistem Kamza Taksa Biznes për vitin 2022. Vlera Debitore e subjekteve aktivë në "Kamza Taksa Biznes" për taksa dhe tarifa vendore më datë 31.12.2022 është **99,093,059 lekë, kjo vlerë ju përket 400 subjekteve (sipas sistemit). Subjekte pasive çregjistruar 133 subjekte me vlerë 53,606,637.34 (sipas evidencave të paraqitura nga sektori i borxhi).** Në pasqyrat financiare, vlera debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore më datë 31.12.2022 është raportuar **85,866,370 lekë, kjo vlerë ju përket 395 subjekteve**. Në **evidencë Bankë viti 2022**vlera debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2022 të dërguar në Bankat e nivelit të dytë për bllokim te vlërës që këto subjekte i detyrohen Bashkisë Kamëz është **53,884,057 lekë, kjo vlerë ju përket 390 subjekteve.**

Grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion të saktë dhe të qenësishëm për situatën e menaxhimit, identifikimit, rregjistrimit dhe vjeljes së të ardhurave në DTTV Kamëz për debin tatale pasi ka pasaktësi në përcaktimet e të dhënave që shërbejnë si bazë për përllogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat, gjithashtu ka debitorë aktiv për të cilat DTTV nuk ka marrë asnjë masë për ndjekjen e etapave që parashikon legjislacioni në fuqi për vjeljen e tyre (bazuar në diferencat midis listës për bank dhe listës debi).

Më poshtë janë paraqitur etapat që parashikon kuadri ligjor në fuqi për vjeljen e detyrimeve dhe parashkrimi i detyrimeve si pasojë e shmangjes nga ndjekja e etapat që parashikon kuadri ligjor në fuqi për vjeljen e detyrimeve.

Etapat e parashikuara në legjislacion për vjeljen e detyrimeve janë si më poshtë:

mbështetur në nenin 89, pika 2, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",

Procedura e detajuar e mbledhjes me forcë e detyrimit tatimor përcaktohen në Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore". (referuar me poshte si U.M Nr. 17) Duhet me çdo kushttë ndiqen të gjitha hapatmbledhjes së detyrimeve të taksave e tarifave vendore. Ky udhëzim i rendit procedurat për mbledhjen me masa shtrënguese të detyrimeve tatimore ne kreun III si më poshtë vijon :

Hapat dhe procedurat që ndiqen nga drejtoritë e taksave dhe tarifave vendore apo strukturat administrative tatimore të ngjashme me to, për mbledhjen e detyrimeve të papaguara të taksave e tarifave vendore:

U.M Nr. 17 pika 1, Njoftimi dhe kërkesa për të paguar.
U.M Nr. 17 pika 1/1.1, Bllokimi i shitjes së aktiveve.
U.M Nr. 17 pika 1/1.2, Konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit.
U.M Nr. 17 pika 1/1.3,Kallëzimi për ndjekje penale.
U.M Nr. 17 pika 2, Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesit.
U.M Nr. 17 pika 2, Urdhëri i ekzekutimit
U.M Nr. 17 pika 3, Masa e sigurimit të detyrimit tatimor.

U.M Nr. 17 pika 3,Njoftimi për vendosjen e barrës hipotekore.
U.M Nr. 17 pika 4, Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë
U.M Nr. 17 pika 5.1,E drejta e mbledhjes së detyrimit tatimor palës së tretë

Parashkrimi

Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".
Neni 73, E drejta e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe e drejta e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditore.
Nga DTTV Kamëz rezulton se nuk janë ndjekur hapat ligjor për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura, duke lënë hapësira për parashkrimin e detyrimeve dhe të ardhura të munguara për bashkinë.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; neni 5, neni 11,...; Ligji nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat";Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni ..22/5..;Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë" i ndryshuar";Manualin e Manaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitmiratuar me Urdhërin e MFE nr. 108 datë.17.11.2016; nenin 22 të VKM nr. 945, datë 2.11.2012për Miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore"; VKMnr. 357, datë 24.04.2013 për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e dokumentit elektronik në republikën e shqipërisë"; Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standarteve proceduriale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore".

Ndikimi/Efekti: Informacioni pa saktë për pozicionin financiar të bashkisë.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. H.B Ish-Zëvendës Kryetar i Bashkië, **z. E.B** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, **znj. G.D** me detyrë Përgjegjësja i Sektorit të Terrenit, **znj. L.K** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit të Detyrimit dhe Menaxhimit të Borxhit, **z. E.S** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave Familjare dhe **znj. R.D** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe Kontabilizimit të Detyrimeve.

Taksa e hotelit

Për vitin 2022 kjo taksë është planifikuar në vlerën 167,890 lekë dhe është realizuar në vlerën 176, 500 lekë, ose në masën 105 %.

12. Titulli i gjetjes: Parregullsi në mbajtjen e të dhënave (regjistrave për akomodimin e personave) për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e hotelerisë.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, aplikimi i tarifës bëhet sipas deklarimeve të vetë subjekteve, duke mos ushtruar kontroll nga sektori i terrenit nëse deklarimi i subjektit ose regjistrimi në librat përputhet me numrin e pushuesve dhe numrin e dhomave për hotel.
Nuk ka inforM on për llojin e hotelit (hotel me 4-5 yje, bujtinë, fjetine....) pasi edhe niveli i taksës varet nga lloji i hotelit.
Nga verifikimi i dokumentacionit (verifikim me zgjedhje) u konstatua se në ***6 raste*** në dosjet e subjekteve tatimpagues ka mangësi në dokumentacion:

Lekë

Nr.	Subjekti	NIPTI	Lloji i Aktivitetit	Adresa	Vlera e arkëtuar 2022 sipas Dr. Financës (Taksë Hoteli)	Data e pagesës

1	B.K	M.....A	Hoteleri dhe Bar-Kafe	Rr. Donald Tramp, Frutikulture, Kamez	15,000	10.10.22
2	A.Q	K.....A	Hoteleri dhe Bar-Kafe	Bulevardi Blu, Kthesa e Valiasit	10,000	07.03.22
3	G.Gj	K.....Ë	Hoteleri dhe Bar-Kafe	Bathore	12,000	20.04.22
4	P.K	K.....T	Hoteleri dhe Bar-Kafe	Kamëz	12,000	28.04.22
5	NY LB & H	L.....T	Hoteleri dhe Bar-Kafe	Rr. Demokracia, Bathore 6, Kamez	10,000	12.04.22
6	A.K	L.....O	Hoteleri dhe Bar-Kafe	Kamez, Lagje 7, Bulevardi Blu	-	-

Referuar tabelës rezulton se ***<u>në 6 raste:</u>***

- Në dosje nuk ka dokumentacion që vërteton numrin e netëve të qëndrimit në hotel, nuk janë ushtruar kontrolle në lidhje me mbajtjen dokumentacionit (fatura me çmim fjetje dhe vlerën e taksës)të p**e**rsonave që kanë fjetur, për një natë, të dhëna këto që do të ndikonin në rritjen e të ardhurave.
- Pagesat janë bërë nji herë në vit dhe jo brenda datës 5 të çdo muaji (deklarim dhe derdhje e kesaj takse), sipas parashikimeve të pikës 6 dhe 7, të nenit 26, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ku cilësohet; *6. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës. 7. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës*

Të gjitha këto mangësi bëjnë që kjo taksë të mos jetë arkëtuar saktë për numrin e personave që akomodohen në strukturat akomoduese të Bashkisë Kamëz, kryesisht kjo në sezonin veror ku numri i personave që akomodohen në hotele është më i lartë, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kamëz.

<u>Kriteri:</u> Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;neni 26 pika 6 dhe pika 7; VKB nr. 137 datë 22.12.2022 për "Sistemin e taksave dhe tarifat vendore në Bashkinë Kamëz", pika A.4 "Taksa e fjetjes në hotel".

<u>Ndikimi/Efekti:</u> Mos përcaktimi i saktë për taksën për subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hotelerisë.

<u>Shkaku:</u> Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

<u>Rëndësia:</u> E lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. G.D me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Terrenit, **z. K.N, z. E.D, znj. XH.M, znj. M.GJ , znj. R.M** dhe **z. G.P** me detyrë Inspektor të Zonës.

Kategorizimi i subjekteve në sistem

Nga grupi auditimit janë kryer disa testime për të verifikuar procesin e klasifikimit të informacionit që bën sektori terrenit për subjektet sipas kategorizimit (biznes i vogël, biznes i madh.....) bazuar në paketën fiskale të bashkisë.

<u>13. Titulli i gjejtes:</u> Subjekte biznes i madh dhe janë trajtuar për taksat dhe tarifat vendore si biznes i vogël.

<u>Situata:</u> Nga auditimi i procesit rezulton se nuk rakordon vlera e detyrimit vjetor të subjekteve në sistemin e DTTV me kategorizimin e subjektit sipas paketës fiskale.

Rezultatet e këtij testimi (për 13 subjekte) paraqiten si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emri isubjektit	NIPTI	Data e hapjes ne QKB	Statusi ne QKB	Tarifimi Sistem	Pergjegjesia tatimore	Data e kalimit si BM	Lloji i aktivitetit	Tarifuar ne sistem	Sa duhet te tarifohet	Diferenca
1	M SHPK	L.....N	22/04/16	Aktiv	BV	BM	24/01/20	Tregti me pakice te prod. terapeutik	142,309	287,709	145,400

2	I.T	K.....D	03/04/07	Pezulluar	BV	BM	24/01/20	Punime rifiniturash,hekur	46,372	226,972	180,600
3	A.B	L.....G	30/01/19	Aktiv	BV	BM	02/11/20	FarM	166,840	337,500	170,660
4	R.C	M.....H	05/11/20	Aktiv	BV	BM	01/12/20	Projektim dhe zbatim i vep	79,780	260,380	180,600
5	T.D	L.....O	22/10/14	Aktiv	BV	BM	02/11/20	Tregti me pakice te …..	295,602	527,802	232,200
6	E.H	L.....F	02/05/19	Çregjistruar	BV	BM	24/01/20	Agjent i Shoqërisë EasyPay …..	36,308	101,108	64,800
7	G.H	M.....V	07/08/20	Pezulluar	BV	BM	17/12/20	Bar-Kafe	73,430	131,450	57,720
8	A.Xh	L.....F	07/04/16	Pezulluar	BV	BM	01/12/20	Rimbushje elektronike….	20,880	93,800	72,920
9	S.D	L.....E	11/04/15	Çregjistruar	BV	BM	09/01/17	Shitje me shumice te birres	23,925	88,725	64,800
10	B.T	L.....A	26/03/19	Çregjistruar	BV	BM	24/01/20	Shitje e birrës	26,820	91,620	64,800
11	E.H	L.....F	02/05/19	Çregjistruar	BV	BM	08/02/21	Bar-Kafe	19,488	84,288	64,800
12	A.D	L.....D	22/08/18	Akttiv	BV	MB	07/05/19	Tregti materiale N	328,302	558,602	230,300
13	D.H	K.....N	02/08/08	Akttiv	BV	MB	07/05/19	Tregti ushqimore	196,516	458,716	262,200
Totali									**1,456,572**	**3,248,672**	**1,791,800**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

U përzgjodhën në mënyrë rastësore 13 subjekte nga sistemi dhe u ndoq procesi i planifikimit të detyrimeve për taksa e tarifa vendore. Rezultatet e testimit të këtij procesi për 13 subjektet e përzgjedhura në trajtë narrative shprehen si më poshtë:

Detyrimi progresiv i evidentuar në sistem për këto 13 subjekte rezulton se nuk përputhet me detyrimin që duhet të llogaritej sipas kategorizimit në paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Kamëz.

Nga 3,248,672 lekë që duhet të planifikoheshin janë planifikuar 1,456,572 lekë, diferenca prej 1,791,800 lekë është e ardhur e munguar për Bashkine Kamëz.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; VKB nr. 137 datë 22.12.2022 për "Sistemin e taksave dhe tarifat vendore në Bashkinë Kamëz"; nenin 36 të rregullores së brendshme të bashkisë miratuar me aktin nr. 4119 prot. datë 11.05.2022.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kamëz në vlerën 1,791,800 lekë.

Shkaku: Përllogaritje e gabuar e taksave dhe tarifave vendore.

Rëndësia: E lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. G.D me detyrë Përgjës i Sektorit të Terrenit dhe **z. Z.L , z. A.A** me detyrë Inspektorë të Terrenit.

14. Titulli i gjetjes: Plotësimi i dosjeve të tatimpaguesve me dokumentacion.

Situata: Nga auditimi rezultoi se janë hapur dosje individuale për subjektet e biznesit të vogël dhe të biznesit të madh që ushtrojnë aktivitet në territorin gjeografik të Bashkisë Kamëz.

Nga grupi auditimit janë kryer disa testime për të verifikuar procesin e plotësimit të dosjeve me dokumentacion.

Rezultatet e këtij testimi (për 36 subjekte) paraqiten si më poshtë:

Nr.	Subjekti	Nipti	Aktiviteti	Adresa	Shenime
1	G	K.....T	Tregti Karburanti	Rr. Demokracia Bathore	Nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e nderteses, truallit, reklamës…
2	D	L.....G	Tregti Karburanti	Kryqezimi Valias	Nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e ndërteses, truallit, reklamës…. Kontrata e qirasë fotokopje e palexueshme
3	G SHPK	L.....A	Bar kafe Bilardo	Babrru qender	-
4	K	M.....M	Shitje me pakice e karburantit	Rr. Berisha lagje nr 5	Nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e ndërtesës, truallit, reklamës….
5	O SHPK	J.....I	Tregti karburanti	Bul. Blu	Nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e reklamës…
6	O SHPK	K.....Ë			Dhënë me qira O. SHPK
7	V	K.....K	Tregti Karburanti	Rr. Demokracia Bathore	Nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e reklamës…
8	T	K.....Q	Tregti karburanti	Rr. Demokracia Bathore	Pezulluar 2020
9	K	J.....P	Tregti Karburanti	Paskuqan	Nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e

					ndërtesës, truallit, reklamës…
10	D SHPK	K.....Q	Tregti Karburanti	Babrru qender	Nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e reklamës..
11	D oil	K.....Q	Tregti Karburanti	Paskuqan	Nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e ndërtesës, truallit, reklamës...
12	A	L.....H	Tregti Karburanti	Rr. Berisha	Nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e ndërtesës, truallit, reklamës…
13	D	K.....Q	Tregti Karburanti	Rr. Demokracia Bathore	Nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e reklamës, Akt konstatimi i fundit i vitit 2014
14	Sh. K	L.....S	Tregti Karburanti	Qender Laknas	Nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e ndërtesës, truallit, reklamës…
15	M.P	K.....Q	Tregti me pakice te artikujve ushqimore dhe fruta peri	Rr. Skenderbeu	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në system..
16	Gj.N	L....Q	Tregti te pulave te pjekura, qofteve , zgare	Rr. Berisha	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në system..
17	M.P	M....C	Byrektore ,sanduic etj,tregeti me pakice te pijeve freskuese e	Bul. Nene Tereza	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në system..
18	M.S	K....O	Sherbime rrobaqepsie	Rr. Berisha	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në system..
19	V.T	L....D	Lokal dasmash dhe dhenie makinash me qera.	Rruga Azem Galica, Kamez	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
20	L.T	L....C	Bar - Kafe. Mezeri. Qender interneti.	Paskuqan 1, Rruga Demokracia,	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
21	G	K....T	Tregti Karburanti	Rr. Demokracia Bathore	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
22	S.D	L....Q	Tregti me pakice te materialeve te N t	Bul. Blu. Kamez	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
23	E.D	K.....V	Tregtimin e artikujve te ndryshem industriale, sherbime rrobaqepsie.	Rruga Skenderbeu, Kamez	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
24	I	L....K	kerrkim, zbulim, prodhim, tregetim mineralesh kromi, shfrytezim mineral	Frutikulture	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
25	F.A	K.....D	Varrezë për automjete, bar kafe.	Bul. Blu. Kamez	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
26	E.Ç	L.....A	Bar-kafe	Kamez Valias i Ri, Rruga Jon	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
27	S. T	L....S	Lavazh	KAMEZ Rruga Skenderbeu	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
28	F. K	L....S	Punime druri….	Bul. Blu	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
29	K.B	L....O	Tregti me shumice dhe pakice kryesisht per roba dhe kepuce te perdorura	Rr. Lidhja e prizrenit	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
30	F.M	M....H	Sherbime parukerie.	Rr. Demokracia Bathore	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
31	N.K	L....Q	Bar-kafe	Rr. Demokracia	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
32	L.R	M....S	Ushtrirni i aktivitetit tregtar te automjeteve.	Bul. Blu. Kamez	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
33	R.F	L....A	Tregtim te artikujve ushqimore si dhe transporti i tyre	Babrru Qender Rruga Demokracia	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
34	V.Ç	L....B	Kancelari, fotokopje dokumentash etj	Bathore Bathore, Lagjja nr 4, Rruga Demokracia,	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem
35	D SHPK	L....B	Hoteleri, Bar Restorant dhe hapesire rere import- eksport, tregetim , montim	KAMEZ; Rruga Skënderbe	Në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

U përzgjodhën në mënyrë rastësore 35 subjekte për verifikimin e dokumentacionit në dosje dhe planifikimit/arkëtimit për taksa e tarifa vendore. Rezultatet e testimit të këtij procesi për 36 subjektet e përzgjedhura në trajtë narrative shprehen si më poshtë:

Dosjet nuk janë të paisura me fletën e inventarit.

Në **7** raste nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e ndërtesës, truallit, tabelës për qëllim reklamimi …etj; në **4** raste nuk ka dokumentacion që vërteton sipërfaqen e tabelës për qëllim reklamimi; në **21** raste në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem (*për ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifat vendore), pra ndryshimet në sistem janë berë pa dokumentacion vërtetues pa rocesverbalet e ndryshimit në lidhje me veprimet e stornimit (Credit Note).* Nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis informacionit nga sistemi dhe procesit të popullimit të bazës së të dhënave.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar", nenet 29, 36, 69, 75...; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat";VKB nr. 137 datë 22.12.2022 për "Sistemin e taksave dhe tarifat vendore në Bashkinë Kamëz";

Ndikimi/Efekti: Mos përcaktim i saktë ngarkesave për taksat dhe tarifat vendore.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që, të plotësojë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dosjet e subjekteve si biznes i madh dhe i vogël me qëllim përllogaritjen e saktë të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. G.D me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Terrenit, **znj. M.Q** me detyrë Specialist i Menaxhimit të Borxhit, **z. Z.L , z. A.A** me detyrë Inspektorë Terreni.

Tarifat për subjektet që marrin leje zhvillimi

Për vitin 2021 kanë aplikuar dhe paisur me leje ndërtimi 151 subjekte për ndërtime me funksione të ndryshme si objekte banimi, shërbimi rikonstruksione etj.

Për vitin 2022 kanë aplikuar dhe paisur me leje ndërtimi 102 subjekte për ndërtime me funksione të ndryshme si objekte banimi, shërbimi rikonstruksione etj.

15. Titulli i gjetjes: Mos arkëtmi i detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore nga subjektet për të gjitha lejet e marra.

Situata: Subjektet ndërtuese të paisura me leje ndërtimi, që kanë ushtruar veprimtari ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Kamëz, nuk janë paisur me çertifikatë regjistrimi për adresë dytësore për çdo kantier ndërtimi.

Nga grupi i auditimit u verifikuan me zgjedhjenga lista e lejeve të ndërtimit subjektet:

Nr.	Subjekti	NIPT	Leje N Viti 2021	Leje N Viti 2022	DTTV Kamëz	QKB
1	A	L.....F	3	2	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz
2	A	L.....R	10	17	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz
3	A	L.....K	4		Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz
4	D	L.....L	8	3	Ka1 adresë dytesore në Kamëz	Ka1 adresë dytesore në Kamëz
5	E	K.....A	7	2	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz
6	F	L.....A	18	5	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz
7	H	L.....R	4	3	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz
8	K	L.....V	7	6	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz	Nuk ka adresa dytesore ne Kamëz

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Nga verifikimi rezulton se nuk janë hapur adresa dytësore as në QKB dhe as në sistemin e DTTV.

Nga inforM oni i marrë në drejtorinë e Financës e Kontabilitetit, rezulton se nuk janë arkëtuar detyrimet për tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim...) për të gjitha lejet e marra. Edhe në rastet kur janë bërë pagesa është paguar vetëm tarifa e pastrimit dhe nuk janë paguar tarifat gjelbërim, ndriçim...
Rezultatet e testimit të këtij procesi për **4** subjektet e përzgjedhura në trajtë narrative shprehen si më poshtë:
- Subjekti Ahmeti Construksion me NIPT- L.....R, është subjekt ndërtues për 10 leje ndërtimi në vitin 2021 dhe 17 leje ndërtimi në vitin 2022, ndërsa sipas të dhënave (arkëtimeve në Drejtorinë e Financës) ka paguar detyrimet (vetëm për tarifë pastrimi) për 5 leje ndërtimi për vitin 2021 dhe 11 leje ndërtimi për vitin 2022.

Lekë

Subjekti	Lloji i tarifës	Vlera e paguar	Detyrimi sipas paketës fiskale	Diferenca viti 2021, 2022
Ahmeti Construksion	Tarifë pastrimi	501,677	2,700,000	2,198,323
Ahmeti Construksion	Tarifë gjelbërimi	50,000	1,350,000	1,300,000
Ahmeti Construksion	Tarifë ndriçimi	5,000	135,000	130,000
Totali		**556,677**	**4,185,000**	**3,628,323**

Vlera prej 3,628,323 lekë është e ardhur e munguar për Bashkinë Kamëz.
Sipas të dhënave në QKB dhe në sistemin e DTTV, nuk ka të regjistruara adresa sekondare për ndërtimet në territorin e Bashkisë Kamëz.

- Subjekti K. – L.me NIPT- L.....V, është ndërtues për 6 leje ndërtimi në 2021 dhe 6 leje ndërtimi në vitin 2022 ndërsa sipas të dhënave (arkëtimeve në Drejtorinë e Financës) ka paguar detyrimet (taksë pastrimi) për 1 leje ndërtimi, ndërsa në vitin 2022 nuk ka bërë asnjë pagesë.

Lekë

Subjekti	Lloji i tarifës	Vlera e paguar	Detyrimi sipas paketës fiskale	Diferenca viti 2021, 2022
K"SHPK	Tarifë pastrimi	62,166	1,300,000	1,237,834
K"SHPK	Tarifë gjelbërimi		650,000	650,000
K"SHPK	Tarifë ndriçimi		65,000	65,000
Totali		**62,166**	**2,015,000**	**1,952,834**

Vlera prej 1,952,834 lekë është e ardhur e munguar për Bashkinë Kamëz.
Sipas të dhënave në QKB dhe në sistemin e DTTV, nuk ka të regjistruara adresa sekondare për ndërtimet në territorin e Bashkisë Kamëz.

- Subjekti F.2010 me NIPT- L.....A, është ndërtues për 18 leje ndërtimi në 2021 dhe 5 leje ndërtimi në vitin 2022 ndërsa sipas të dhënave (arkëtimeve në Drejtorinë e Financës) ka paguar detyrimet (taksë pastrimi) për 4 leje ndërtimi në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 ka paguar detyrimet (taksë pastrimi) për 9 leje ndërtimi.

Lekë

Subjekti	Lloji I tarifës	Vlera e paguar	Detyrimi sipas paketes fiskale	Diferenca viti 2021, 2022
Fati 2010	Tarifë pastrimi	520,000	2,300,000	1,780,000
Fati 2010	Tarifë gjelbërimi	-	1,150,000	1,150,000
Fati 2010	Tarifë ndriçimi	-	115,000	115,000
Totali		**520,000**	**3,565,000**	**3,045,000**

Vlera prej 3,045,000 lekë është e ardhur e munguar për Bashkinë Kamëz.
Sipas të dhënave në QKB dhe në sistemin e DTTV, nuk ka të regjistruara adresa sekondare për ndërtimet në territorin e Bashkisë Kamëz.

Subjekti D. konstruksionme NIPT- L.....L, është ndërtues për 8 leje ndërtimi në 2021 dhe 3 leje ndërtimi në vitin 2022 ndërsa sipas të dhënave (arkëtimeve në Drejtorinë e Financës) ka paguar detyrimet (taksë pastrimi) për 5 leje ndërtimi në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 ka

paguar detyrimet (taksë pastrimi) për 3 leje ndërtimi.

Lekë

Subjekti	Lloji I tarifës	Vlera e paguar	Detyrimi sipas paketes fiskale	Diferenca viti 2021, 2022
D. konstruksion	Tarifë pastrimi	575,000	1,100,000	525,000
D. konstruksion	Tarifë gjelbërimi	-	550,000	550,000
D.konstruksion	Tarifë ndriçimi	-	55,000	55,000
Totali		**575,000**	**1,705,000**	**1,130,000**

Vlera prej 1,130,000 lekë është e ardhur e munguar për Bashkinë Kamëz.
Sipas të dhënave në QKB dhe në sistemin e DTTV, ka të regjistruar **1** adresë sekondare për ndërtimet në territorin e Bashkisë Kamëz.
Kriteri: Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, në shkronjën "b" të nënpikës 1.3 të pikës 1 në nenin 9, shkronjën "a" të pikës 5 të nenit 35, shkronjën "f" të nenit 54 ; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore. pikën 10 të nenit 3 dhe pikën 2 të nenit 18. Ligji nr. 9920, "Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,nenin 40,...nenin 43; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", neni 19, 22, ...43;VKB nr. 55, datë 20.12.2019 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz" i ndryshuar,VKB nr. 137 datë 22.12.2022 për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz"; Rregulloren e brendshme te Kashkisë Kamëz.
Ndikimi/Efekti: Veprime me efekt financiar negativ në Buxhetin e Bashkisë Kamëz.
Shkaku: Neglizhencë në zbatimin e kuadrit ligjor.
Rëndësia: E lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. G.D me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Terrenit dhe **z. Z.L , z. A.A** me detyrë Inspektor Terreni.

Nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1751/1 prot, datë 29.02.2024 administruar në KLSH në praktikën nr. 873/7 prot datë 04.03.2024 nga E.B , G.B , L.K, E.S, R.D , Z.L , A.A , M.Q , K.N, E.D, XH.M , M.GJ , G.P , R.M , ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si me poshtë.
Pretendimi i subjektit:
Nga observuesit pretendohet në lidhje me gjetjet nr. nr. 1-3, nr. 6, nr. 7, nr. 9, nr. 11, nr. 12, nr. 10, nr. 13 dhe nr. 15, të Projektraportit të auditimit për të cilat janë paraqitur pretendimet thuajse të njëjta me ato të cilat janë paraqitur edhe për aktkonstatimet.
Ndëqërkohë që ndër të tjera pretendohet përsa i përket Gjetjes Nr. 7 ju shpreheni se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Kamez nuk ka planifikuar saktë të ardhurat duke mos ndarë të ardhurat e vitit nga debia. Sipas evidencës së dërguar nga ju vet në faqen 92 dhe 93 duket qartë së "zëri" i debisë është i ndarë nga zërat e tjerë të të ardhurave. Sa më sipër, Kërkojmë rishikimin e kësaj gjetje.
Gjithashtu pretendohet përsa i përket Gjetjes Nr. 7 ju shpreheni se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Kamez nuk ka planifikuar saktë të ardhurat duke mos ndarë të ardhurat e vitit nga debia. Sipas evidencës së dërguar nga ju vet në faqen 92 dhe 93 duket qartë së "zëri" i debisë është i ndarë nga zërat e tjerë të të ardhurave. Sa më sipër, Kërkojmë rishikimin e kësaj gjetje.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në lidhje me pretendimin për gjetjen nr. 7, dhe të tjera, për mosndarjen e të ardhurave të vitit korrent dhe pagesat për debinë e krijuar ndër vite, ***sqarojmë se,*** *fakti që realizimi i disa të ardhurave kalon vlerën 100%, shpjegohet me mos ndarjen e pagesave për llogari të vitit buxhetor, nga ato për llogari të detyrimeve të prapambetura. Sipas evidencës së DTTV në asnje rast për asnje taksë / tarife nuk ka ndarje të pagesave për llogari të vitit buxhetor, nga ato për llogari të detyrimeve të prapambetura, debia thjesht është planifikuar në vlerën 61,800,000 lekë dhe realizuar në masën 8.49%. Ndërkohë që konkretisht për kategorinë*

Familjar vlera e debisë (sipas pasqyrave financiare) më datë 31.12.2021 është 201,973,700 lekë, me datë 31.12.2022 është 297,508,794 lekë ndërsa në sistemin e drejtorisë se taksave & tarifave vendore vlera e debisë me datë 31.12.2022 është në vlerën 771,305,000 lekë. ***Në*** *bazën e të dhënave Kamza Taksa Biznes për vitin 2020 nuk janë transferuar 2,414 subjekte. Debitore me status aktiv në "Kamza Live" më datë 31.12.2020 janë 1,376 subjekteve debitore vlera debitore e të cilëve në vitin më 31.12.2020* ***është 174,631,661 lekë****. Në pasqyrat financiare, vlera debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2020 është raportuar 113,329,862 lekë, kjo vlerë ju përket 430 subjekteve (kjo vlerë ju përket vetëm subjekteve debitorë me status aktiv).* ***DTTV evidencë viti 2022*** *Vlera Debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2022 është* ***85,866,370 lekë, kjo vlerë ju përket 395 subjekteve. DTTV sistem Kamza Taksa Biznes për vitin 2022.*** *Vlera Debitore e subjekteve aktivë në "Kamza Taksa Biznes" për taksa dhe tarifa vendore më datë 31.12.2022 është* ***99,093,059 lekë, kjo vlerë ju përket 400 subjekteve (sipas sistemit).***

Përsa i përket gjetjeve nr. 1-3, n.r 6, nr. 9, nr. 11, nr. 12, nr. 10, nr. 13, sqarojmë se janë paraqitur të njëjtat pretendime të cilat janë paraqitur edhe për aktkonstatimet, që janë trajtuar në projektraportin e auditimit.

Pretendimet e Subjektit:

Në lidhje me gjetjen nr. 15, pretendohet për llogaritjen e tarifës për lejet e ndërtimit, konkretisht:

Ne gjetjen nr. 15 ju shpreheni se këto subjekte janë pajisur me leje ndërtimi për vitin 2021 dhe vitin 2022 dhe nuk i kanë paguar ato. Sjellim në vëmendjen tuaj që Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është njohur me shkresën Nr. 873/1 datë 10.10.2023 "Program Auditi" ku shprehet se PeriU e auditimit është : nga data 01.01.2022-31.12.2022 pra i gjithe viti 2022 dhe jo viti 2021 sic ju jeni shprehur në Projekt-Raport kjo edhe për faktin se duhet ti përmbahemi prarimit të gjesë së gjykuar "res judicata" pasi DTTV është kontrolluar dhe gjykuar njëherë nga institucioni juaj për vitin 2021.

Sa me sipër, do tju luteshim ti përmbaheshit programit të auditimit të cilin ju vet e keni përpiluar.

Bashkëlidhur VKB Nr. 167, Datë 23.12.2020 dhe VKB Nr. 55, Datë 20.12.2019

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimet e paraqitura sqarojmë se: Tarifat per lejet e N t (pastrim, gjelberim, ndricim) jane miratuar me VKB nr. 137 datë 22.12.2021, perkatesisht pika C.1.3, C.2.3 dhe C.3.3.

Sipas paketes fiskale cilesohet:

- Ne piken 3. A

- Subjekte N : llogaritja e tarifes se pastrimit te filloj me zbardhjen e lejes deri ne momentin e e dorezimit nga subjekti ne strukturat e bashkise te kerkeses per leje shfrytezimi.

- Subjekte N : llogaritja e tarifes se gjelberimit te filloj me zbardhjen e lejes deri ne momentin e dorezimit nga subjekti ne strukturat e bashkise te kerkeses per leje shfrytezimi.

Bazuar ne paketen fiskale per lejet e dhena ne vitin 2021 ose perpara vitit 2021 (lejet me afat mbi

nje vit), vazhdon tarifimi deri ne momentin e dorezimit nga subjekti, ne strukturat e bashkise te kerkeses per leje shfrytezimi.

Sa më sipër pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit pasi, nuk ka fakte, prova dhe referenca ligjore apo dokumentacion shtesë nga sa janë paraqitur gjatë auditimit në terren apo në observacionet e dërguara.

Menaxhimi i aseteve për vitin 2022.

Sipas ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë

ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t'u transferoheshin. Për Bashkinë Kamëz, lista e pronave është miratuar me VKM nr. 775, datë 05.09.2013 'Për Miratimin e listës Përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të qarkut Tiranë' dhe VKM-së nr. 454, datë 22.06.2011 "Për Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Paskuqan, të Qarkut Tiranë". Nga totali prej rreth 2000 pasuri që i janë transferuar Bashkisë Kamëz, përfshirë zonën e Paskuqanit, janë dërguar për çertifikim 93 pasuri, nga të cilat vetëm 47 janë çertifikuar.

16. Titulli i gjetjes: Inventarët e pasurive të paluajtshme për Bashkinë Kamëz nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive.
Situata: Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuar me VKM nr. 775/2013, për Bashkinë Kamëz dhe VKM nr. 454/2011, për ish-komunën Paskuqan, nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Kamëz nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Kamëz-Vorë mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. trapaluajtshme të Bashkisë Kamëz është i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet se:
"Bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe inforM onin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji".

- Statusi	- Njesia Administrative - Paskuqan	- Bashkia Kamez	- Kamez + Paskuqan
- Të Nisura	- 24	- 69	- 93
- Të Çertifikuara	- 14	- 33	- 47

Në këtë inventar, për **pronat me funksioni perdorimi "administrate**", me numër rendor nga 1-3, rezulton se nuk janë kryer evidentime në terren dhe verifikime juridike si dhe nuk janë regjistruar në kadastër pasuritë sipas tabelës si më poshtë:

- - K	- - Lloji i prones	- - Emri i prones	- ip.Totalem²	- Nga sip.Totale sandertese - ne m²	- - Funksioni	- - Institucioni qe eperdor
- 066	- Truall +ndertese	- Agjenci Bankare, lagje nr.4	- 9.8	- 49.7	- Sherbim bankar	- Dega e BKT objekti nen pallat
- 066	- Truall+ ndertese	- Agjencia Sigurimeve Shoqerore	- 8	- 46	- Administrate	- Objekti nenpallat kati i pare
- 066	- Truall +ndertese	- Radiostacioni lagje nr.5 Kamez	- 800	- 15,828	- Azil	- ATSH

Pronat me funksion "ekonomik", me numër rendor nga 25-30, të cilat janë objekte kryesishttë natyrës magazina bujqësore, janë bërë shënime në inventar se janë të privatizuar, por nuk është konfirmuar statusi juridik, nëse regjistrimet e këtyre privatizimeve janë pasqyruar në kadastër, nëse janë objekt i ushtrimit të së drejtës së parablerjes në rast shitjeje me ankand si dhe nëse ngatotali i sipërfaqeve të privatizuar rezultojnë diferenca që mund të jenë të regjistrueshme për Bashkinë Kamëz.

Sa u përket pasurive për të cilat Bashkia Kamëz i ka regjistruar në DVASHK Kamëz -Vorë, sipas natyrës së funksionit rezultojnë: 12 shkolla, 3 kopshte, 3 gjimnaze, 3 qendra shëndetësore, 5 sheshe, 1 rezervuarë, 1 Pallati i Kulturës, 6 pasuri të llojit truall ndërsa 14 pasuri të tjera janë tëllojit shkëmbore, pemëtore, arë etj.
Pasuritë e llojit truall, pyll dhe livadh janë kontabilizuar sipas çmimeve të referencës përcaktuara në VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Në lidhje me fondin pyjor, me VKM nr.433 datë 08.06.2006 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit", ndryshuar me VKM nr.684 datë 02.09.2020 janë transferuar në Bashkinë Kamëz 7 ekonomi pyjore/kullosore. Këto pasuri nuk janë regjistruar në DVASHK Kamëz-Vorë dhe nga ana e bashkisë, sektori i pyjeve nuk janë marrë masa për të miratuar plane mbarështimi për menaxhimin e tyre me qëllim dhënien në përdorim, sipas parashikimeve të ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet" dhe Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

- r.	- Ekonomia	- Nen/n gastra	- Siperfaqja	- Kategori a/ perdorimi
	- pyjore/kullosore	- Nr.	- ha	-
-	- Zall Her-Priske	- 71/a	- 23.78	- Pyll
-	- Zall Her	- 72/a	- 29.77	- Pyll
-	- Zall Her	- 73/a	- 20.13	- Pyll
-	- Zall Her	- 74/a	- 22.23	- Pyll
-	- Zall Her	- 75/a	- 25.71	- Pyll
-	- Zall Her	- 77/a	- 15.44	- Pyll
-	- Zall Her	- 78/a	- 18.2	- Pyll

Produkti përfundimtar për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Kamëz është përgatitur nga konsorciumi i kompanive të kontraktuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe është dorezuar pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërorë të Kadastrës Kamëz-Vorë, për miratimin përfundimtar dhe çertifikimin e produktit.

- Auditimi mbi shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për dhënie me qira të aseteve të bashkisë.

Bashkia Kamëz ka lidhur 7 kontrata qiraje, nga të cilat 4 kontrata kanë për objekt sipërfaqet brenda Pallatit të Kulturës, 2 kontrata kanë për objekt sipërfaqe përkatësisht pyjore dhe tokë pa fryt, ndërsa 1 kontratë ka për objekt dhënien me qira të stadiumit për aktivitetet e klubit sportiv Kastrioti, e konkretisht:

Kontrata me nr.25 rep, 126 kol datë 24.01.2019 mes Bashkisë Kamëz dhe shoqerisë "B.P",me objekt dhënien me qira të pasurisë së llojit "zallishte", nr.154, vol.200 zk 2372 me sipërfaqe 12,400 m2, me afat 20 vjeçar;
Kontrata nr.792 rep, nr.630 kol datë 01.04.2019, mes Bashkisë Kamëz dhe P.S..., e cila ka si objekt dhënien me qira të pasurisë shtetërore ambientebrenda pallatit të kulturës të llojit "ndërtese" me sipërfaqe 110 m^2, me afat 10 vjeçar, kundrejt vlerës prej 24,200 lekë/muaj në emër të subjektit "P.S ";
2/akontratame nr.2281 datë 04.03.2021, mes Bashkisë Kamëz dhe subjektit"P.S ", me objekt dhënien me qira të pasurisë shtetërore ambiente brenda pallatit të kulturës të llojit "ndërtesë"

pjesa e nëndheshme, me siperfaqe 101.4 m^2, në administrim të Bashkisë Kamëz, me vlerë 300 lekë/ m^2/muaj;
Kontratame nr. 4584 prot., datë 19.06.2020 mes Bashkisë Kamëz dhe "T.B ...", rinovuar me kontratën nr.7155/1 prot., datë 21.07.2021, me objekt dhënien me qira të sipërfaqes prej 165 m^2 brenda Pallatit të Kulturës, kundrejt çmimit 530 lekë/m^2;
Kontrata nr. 4546 datë 29.04.2021, lidhur mes Bashkisë Kamëz dhe **shoqërisë "G" SHPK,** me objekt dhënien në perdorim të fondit pyjor/kullosor kombëtar me sipërfaqe 0.8530 ha kundrejt vlerës 375,320 lekë ha/ vit,
Kontratanr.5155 prot. datëe 08.07.2020 lidhur mes Bashkisë Kamëz dhe KS "K.", *me objekt "Vënie në dispozicion të Stadiumit të Kamzës për ndeshjet e sezonit futbollistik 2020 - 2021 të Kategorisë Superiore "*
Kontrata nr.1623 prot. datë 25.02.2020 lidhur mes Bashkisë Kamëz dhe O. Bank, *me objekt "dhënie me qira e një objekti me sipërfaqe 1.5 m^2, ambjent brenda pallatit të kulturës*në të cilin është vendosur ATM", me vlerë 20, 000 lekë në muaj.

Nga Bashkia Kamëz janë dhënë me qira pa kundërshpërblim 2 ambiente ku janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi e konkretisht:

Kontrata pa kundërshpërblim	Palët	Objekti	Kohëzgjatja	Rinovimi
Marrëveshje Bashkëpunimi, nr. 6185 prot., dt. 07.07.22, nr. 5699 prot. dt. 25.07.23	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor - Bashkia Kamëz	Vënia në dispozicion e ambjenteve të Bashkisë Kamëz, dy poste pune (sportele) për ofrimin e shërbimit pa pagesë në fushën e transportit.	1 vit, fillon nga momenti i nënshkimit të kontratës	Nr. 5699 prot., datë 25.07.2023, afati 1 vit nga momenti i nënshkimit të kontratës
Aktmarrëveshje, nr. 11112 prot., datë 25.11.2022	Shoqëria "Xhilaga Academy" - Bashkia Kamëz	Përdorimi pa pagesë dhe mirëmbajtja e palestrës së shkollës 9-vjeçare "Ahmet Zogu". Nga ora 18:00-20:00 në ditët e hënë, e mërkurë dhe të premte	Afati 1 vjeçar	

Ndikimi/Efekti: Mos njohja e gjendjes faktike të pronave të institucionit.
Shkaku: Mos marrja e masave për inventarizimin e pasurisë dhe regjistrimin e tyre në ASHK.
Rëndësia: E lartë.

17. Titulli i gjetjes: Drejtoria e Kadastrës nw Bashkinë Kamëz, si njësi monitoruese nuk ka monitoruar ecurinë e zbatimit të kontratave të qirasë.
Situata: Për periudhën objekt auditimi njësia monitoruese e kontratave të qirasë është Drejtoria e Kadastres...., sipas urdhërit nr. 233 datë 29.03.2019, i ndryshuar. Kjo drejtori nuk ka të dokumentuar zbatimin e këtij urdhëri,nuk administrohet një regjistër i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qera, ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në m^2, numri dhe data e kontratës, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qerasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajit kalendarik, zbatimi i kushteve të kontratës....etj.
Për subjektin "(S.S) P.S " konstatohet se pagesa nuk kryhen brenda intervaleve kohore, çdo muaj, të parashikuar në kontratë. Për vitin 2022 ka paguar vlerën për 12 muaj si dhe detyrimet për nëntor dhjetor të vitit 2021. Në muajin shkurt 2022 është likuiduar detyrimi për nëntor dhjetor 2021 dhe janar shkurt mars 2022, në qershor 2022 është likuiduar detyrimi prill, maj, qershor 2022, në shtator 2022, është likuiduar detyrimi për korrik gusht shtator 2022 dhe në dhjetor 2022 është likuiduar detyrimi për tetor nëntor dhjetor 2022.
Sa më sipër është vepruar në mospërputhje me nenin 6 të kontratës nr. 2281 prot. datë 04.03.2021 dhe nenin 6 të kontratës 792 rep, 630 kol datë 01.04.2019 dhe kontratës nr. ***7569 datë 26.08.2022*** ku cilësohet "pagesa e qirasë do të jetë mujore dhe do të paguhet brenda datës 10 të fillimit të çdo muaji".
Për pagesat jashtë afatit duhej të aplikohej penaliteti bazuar në detyrimet kontraktuale sipas nenit 5, pika 5.10 të kontratës nr. 792 rep, 630 kol. datë 01.04.2019.

Llogaritja e kamat vonesave për moslikudim në afat:

Objekti	Siperfaqe	Qiraja/ mujore	Detyrim 2022	Dite/ vonese	Kamata (1 dite =54.62 leke)	Detyrim + Kamate	Arketuar 2022		DIFERENCA dtyrim/pagese+(kamate)
	m2	vlere	vlere	dite	vlere	vlere	vlere	date	vlere
	e mbartur nga v.2021		*118,240*						
Sip.211 m2Pallati Kultures	211	54,620	54,620	39	2,130	56,750	-	-	2,130
			54,620	8	437	55,057	163,860	18.02.22	437
			54,620	-	-	54,620	109,240	18.02.22	0
			54,620	-	-	54,620	-	-	0
			54,620	28	1,529	56,149	-	-	1,529
			54,620	17	929	55,549	163,860	27.06.22	929
			54,620	52	2,840	57,460	-	-	2,840
			54,620	21	1,147	55,767	-	-	1,147
			54,620	107	5,844	60,464	163,860	01.09.22	5,844
			54,620	77	4,206	58,826	-	-	4,206
			54,620	36	1,966	56,586	-	-	1,966
			54,620	6	328	54,948	163,860	16.12.22	328
Shuma 2022			**773,680**		**21,356**	**795,036**	**764,680**		**21,356**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Referuar tabelës dhe nga të dhënat e marra nga ditari i të ardhurave rezulton se subjekti P.S duhet të paguaj **kamatvonesa në vlerën 21,356 lekë.**

Për subjektin "T.B ", konstatohet se ndonëse i ka shlyer detyrimet në total, pagesa nuk kryhen brenda intervaleve kohore, çdo muaj, sipas parashikimeve në kontrate.
Nga auditimi i kontrates me nr. 4584 prot., datë 19.06.2020, e rinovuar me kontratën nr. 6680 datë 21.07.2022, mes Bashkisë Kamëz dhe shoqërisë "T.B ", rezultonse në muajingusht 2022 është likuiduar detyrimi për korrik, gusht 2022,në nentor 2022 është likuiduar detyrimi për shtator tetor 2022, ndërsa në dhjetor 2022 është likuiduar detyrimi për nëntor dhjetor 2022.
Sa më sipër është vepruar në mospërputhje me nenin 6 dhe nenin 7 të kontratës nr. 4584 prot., datë 19.06.2020, nr. 6680 prot. datë 21.07.2022.

Llogaritja e kamat vonesave për moslikudim në afat:

	Siperfaqe	Qiraja/ mujore	Detyrim 2022	Dite/ vonese	Kamata (1 dite =87.45 leke)	Detyrim + Kamate	Arketuar 2022		DIFERENCA (Detyrim+kamate)
Objekti	m2	vlere	vlere	dite	vlere	vlere	vlere	date	vlere
		Debi nga viti 2021	131,175	-	-	131,175	-		
Sip.165 m2Pallati Kultures	**165**	87,450	87,450	16	1,399	88,849	87,450	26.01.22	1,399
			87,450	8	700	88,150	87,450	18.02.22	700
			87,450	21	1,836	89,286	87,450	31.03.22	1,836
			87,450	18	1,574	89,024	87,450	28.04.22	1,574
			87,450	17	1,487	88,937	87,450	27.05.22	1,487
			87,450	6	525	87,975	87,450	16.06.22	525
			87,450	12	1,049	88,499	87,450	22.08.22	1,049
			87,450	20	1,749	89,199	87,450	30.08.22	1,749
			87,450	27	2,361	89,811	174,900	07.11.22	2,361
			87,450	23	2,011	89,461	87,450	13.12.22	2,011
			87,450	3	262	87,712	87,450	13.12.22	262
			87,450	-	-	87,450	-	-	0
Shuma			**1,180,575**	**171**	**14,954**	**1,195,529**	**1,049,400**		**14,954**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Referuar tabelës dhe nga të dhënat e marra nga ditari i të ardhurave rezulton se subjekti T.B duhet të paguaj **kamatvonesanë vlerën 14,954 lekë.**
Ndikimi/Efekti: Veprime me efekt financiar negativ në Buxhetin e Bashkisë Kamëz.
Shkaku: Neglizhencë në zbatimin e kuadrit ligjor.
Rëndësia: E lartë.

Taksa e tokës bujqësore

Për vitin 2022, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore gjithsej që arkëtohen nga Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, nga 8,487 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 3,724 mijë lekë ose 43.87 %.

18. Titulli i gjetjes: Mungesë bashkëpunimi midis drejtorive dhe institucioneve për saktësimi i tokës arë.
Situata: Nga auditimi rezulton se pasqyrat financiare të bashkisë, Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave nuk ka përfshirë debitorët e taksë së tokës që më datë 31.12.2022 rezultojnë në vlerën 56,704,963 lekë. Referuar nenit 23, të Ligjit nr. 9632, "Për sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektar në pronësi ose përdorim të taksapaguesit, e cila vërtetohet sipas dokumentacionit AMTP ose nga të dhëna të marra nga formulari nr. 6, që disponon Bashkia ose duke ngritur grupe pune për verifikim të sipërfaqeve në vend të tokave që disponojnë qytetarët.
Për vitin 2022 sipas VKB nr. 137, datë 22.12.2022 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz" i ndryshuar, është përcaktuar në vlerën 4,500 lekë/ha/vit, kjo si tokë e kategorisë së tretë. Nga të dhënat Bashkia Kamëz disponon 2399 ha tokë bujqësore, sipas formularit nr.6 rezulton e ndarë për 2599 familje për sipërfaqen 2129 ha. Planifikimi i taksës së tokës nga viti në vit është bërë pa patur një databazë të saktë për ndryshimet që kanë ndodhur në pakësim të kësaj sipërfaqe nga ndërtimet e reja dhe ato informale si dhe transaksionet që janë kryer ndër vite për shitblerjen e saj duke ndryshuar pronarë për pasojë numri i familjeve debitore nga viti në vit vjen në rritje (ndarë tokë për 2599 familje dhe me datë 31.12.2022 rezultojnë debitorë 6924 familje në vlerën 56,704,963 lekë)dhe kjo vlerë ka ardhur në rritje nga një vit në tjetrin.
Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave nuk ka bashkëpunuar për inforM on me DPKZHT Bashkia Kamëz, për sipërfaqet që kanë kaluar për ndërtim objektesh dhe nuk ka inforM on nga ASHK për ato sipërfaqe toke që kanë transaksione për shitje tokash apo për regjistrim të lejeve të ndërtimit. Nga të dhënat e Drejtoria e Kadastres, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave sipas listave që administron kjo drejtori rezultojnë se janë debitorë më datë 31.12.2021 për Taksë Toke, 6924 familje në vlerën 56,704,963 lekë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.
Kriteri: Ligji nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë",VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar;Udhëzimin nr.13 datë 26.04.2018 Për zbatimin e ketij vendimi; Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 233 datë 29.03.2019, i dryshuar; Kontratën me nr. 792 rep, 630 kol. datë 01.04.2019,kontratën nr. 4584 prot., datë 19.06.2020,Kontratën nr.1623 prot. datë 25.02.2020; ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar neni 23...; dhe VKB nr. 137, datë 22.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz" i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti: Veprime me efekt financiar negativ në Buxhetin e Bashkisë Kamëz.
Shkaku: Neglizhencë në zbatimin e kuadrit ligjor.
Rëndësia: E lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. F. S. me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Bordit të Kullimit dhe **znj. D. S.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të MTPM-së.

Taksa dhe tarifa drejtoria e transportit

Lekë

Nr.	Emertimi	VITI 2021			VITI 2022		
		Plan	Fakt	% reali	Plan	Fakt	% realizi

				zim			m
1	**Takse regjistrimi automjetesh** (Bazuar mbi nr. e mjeteve me adrese Kamez te cilet paguajne taksen vjetore te qarkullimit rrugor prane DRSHTRRT, 18% e vleres/mjet)	40,000,000	39,952,759	**99**	42,000,000	46,200,495	**110 %**
2	**Leje transportitaksi** (pajisja me licence taksi, licencim i ri, rinovim dhe dublikate)	1,460,500	2,463,000	**169**	1,860,000	2,528,005	**136 %**
3	**Leje transportiudhetaresh** (Pajisja me licence te specializuar dhe çertificatene linjat qytetese dhe rrethqytetese)	2,960,500	3,183,870	**108**	3,075,800	2,687,650	**87 %**
4	**Leje transporti transport mallrash** (Pajisja me licence dhe çertifikate transport malli per te trete dhe certifikate per perdorim vetjak)	3,550,000	1,635,419	**46**	3,720,500	2,514,450	**68 %**
5	**Leje Aktiviteti** (Leje ushtrim aktivitetit per, servis, autoservis, gomisteri, lavazh, sherbime funerale, treg inerte, autoshkolla, treg dru-zjarri, leje 24 ore)	2,320,100	1,030,033	**40**	2,800,600	211,000	**7.5 %**
6	**Autorizim per tregti karburanti** (pajisja me Autorizim tregti me pakice per pikat e karburantit dhe pikat e gazit)	6,010,000	5,418,776	**90**	6,200,000	6,817,000	**110 %**
7	**Parkim i rezervuar**(Tarifa e parkimit ne sherbim te aktivitetit per bizneset)	1,900,000	420,000	**22**	1,987,000	2,895,000	**145 %**
8	**Te tjera tarifa administrative**(Tarifa sherbimi)	200,000	43,000	**22**	400,000	16,000	**4 %**
Totali		**58,401,100**	**54,146,857**	**93**	**62,043,900**	**63,869,600**	**103 %**

Burimi i të dhënave Bashkia Kamëz

Për vitin 2022 të ardhurat sipas evidencave dhe të dhënave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit nga ana e drejtorise se licencave & transportit në total përputhen me të ardhurat sipas drejtorisë së financës e kontabilitetit në vlerën 63,869,600 lekë, ndërsa të analizuara zë për zë nuk përputhen.
- Sipas drejtorisë së financës dhe kontabilitetit të ardhurat nga "parkim i rezervuar" janë në vlerën 230,000 lekë ndërsa sipas drejtorisë licencave janë në vlerën 2,895,000 lekë.
- Sipas drejtorise se financës dhe kontabilitetit të ardhurat nga "leje aktiviteti" janë në vlerën 2,504,000 lekë ndërsa sipas drejtorisë licencave janë në vlerën 211,000 lekë.

Kjo për shkak se nuk është rakorduar midis dy drejtorive, për kontabilizimin e saktë të detyrimeve.

Mbi tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.

Sipas Drejtorisë së Licencave, Transportit .... për vitin 2022, janë planifikuar taksa e tarifa për:
-39 subjekte të karburanteve dhe gazit të lëngshëm, nga të cilat:
-32 stacione tregti karburanti dhe
- 7 stacione tregti gaz i lëngshëm.

Aplikimi i tarifës për lejet dhe autorizimet për subjektet që tregtojnë hidrokarbure.

Drejtoria e Transportit dhe e Licencave pranë Bashkisë Kamëz është Autoriteti përgjegjës për dhënien e lejeve për subjektet që tregetojnë karburant dhe GLN, e cila përgjigjet dhe për mbledhjen e tarifave që aplikohen.
Ushtrimi i veprimtarive në këtë fushe kryhet vetëm nga persona juridik pasi të jenë pajisur me liçencat dhe autorizimet përkatëse, bazuar në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", neni 4.
Këto licenca jepen nga organet vendore sipas juridiksionit përkatës, me afate 1 dhe 5 vjeçare, me të drejtë përsëritje, për subjektet që zhvillojnë veprimtarinë e tregtimit të nënprodukteve të naftës në territorin e tyre.
Duke u bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga drejtoria e transportit (regjistrat dhe dosjet), lejeve e licencavekonstatohet se aktualisht janë 37 subjekte që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Kamëz dhe Njësisë Administrative Paskuqan aktivitet të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre si me poshtë:

<u>Subjekte që tregëtojnë karburant dhe gaz në territorin e Bashkisë Kamëz</u>

Nr.	Emër	Mbiemër	Subjekti	NUIS	Nr.	Emër	Mbiemër	Subjekti	NUIS
1	R .	H.	K .	J....P	20	R	N	O SHPK	K....Ë
2	R .	H.	K.	J....P	21	A	M	G SHPK	L....A
3	E.	J.	S.	K....V	22	K	K	K	K....S
4	F.	M.	L.	L....I	23	E	B	B. SHPK	L....O
5	Nj.	K .	Q NJ	L....E	24				L....O
6	F.	K.	PK	L....O	25	N	V	V.	K....K
7	A.	C.	T.	L....C	26	A	Ç	A A SHPK	L....H
8	A.	C.	T.	L....C	27	E	F	E.2018	L....1R
9	B.	L.	T.	L....C	28	Sh	K	K.	L....S
10	S.	GJ.	D.	K....Q	29	H	B	D.	L....G
11	F.	K.	S.	K....V	30	L	A	Ll	L....P
12	L.	O.	SH.	K....N	31	L	A	Ll	L....P
13	H.	D.	D.Oil SHPK	K....Q	32	L	A	Ll	L....P
14	H.	D.	D. Oil SHPK	K....Q	33	O SHPK		A.N	J....I
15	L.	A.	A.P	K....U	34	O SHPK		G.G	J....I
16	Y.	S.	S.P	L....O		35	B	M	R
17	D.	G.	G.C	K....T	36	A	P		L....G
18			G.C	K....T	37	R	H	K	J....P
19			G. C	K....T					

19. Titulli i gjetjes: Mbi masat marra për faturimin dhe arkëtimin e taksës për subjektet debitore në fushën e tregëtisë së karburantit dhe GLN në territorin e Bashkisë Kamëz.

Konstatim: Nga auditimi i detyrimeve nga taksat për subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtisë së karburantit dhe GLN në territorin e Bashkisë Kamëz rezultojnë 14 subjekte debitorë më datën 31.12.2022, në vlerën **2,864,000 lekë.** Në mënyrë të hollësishme të dhënat paraqiten si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emer	Mbiemer	Subjekti	Adresa	Nuis	detyrim	pagesa	diferenca
						2022	2022	2022
1	A.	Ç.	A. SHPK	Kamez Rr.Berisha	L....H	404,000	0	404,000
2	L.	A.	A.P	Pask. Rr Demokracia	K....U	202,000	202,000	0
3	H.	D.	D. SHPK	Pask.2 Rr Demokracia	K....Q	202,000	202,000	0
4	H.	D.	D. SHPK	Babrru qender	K....Q	202,000	202,000	0
5	H.	B.	D.	Valias	L....G	222,000	222,000	0
6	E.	F.	E.	Bul.N.Tereza	L....R	202,000	0	202,000
7	D.	G.	G.	Bul.N.Tereza	K....T	202,000	202,000	0
8			G.	Kamez Rr.Berisha	K....T	202,000	202,000	0
9			G.	Pask.-1 Rr Demokracia	K....T	202,000	202,000	0
10	A.	M	G SHPK	Pask.Rr Demokracia	L....A	202,000	0	202,000
11	O.O	ish G.G	O.	Kamez ish R.N	J....I	202,000	317,000	0
12	O.O	Ish R. N	O.	Bathore	J....I	202,000	252,000	0
13	Sh.	K.	K.	N.Tereza laknas	L....S	604,000	202,000	402,000
14	R.	H.	K.	Paskuqan	J....P	404,000	0	404,000
15	Luan	A.	Ll.	Bathore	L....P	202000	202,000	0
16	R.	N.	O SHPK	Kamez	K....E	424,000	0	424,000
17	B.	M.	R.	Babrru qender	J....I	52,000	0	52,000
18	Kompleksi	S.	S.P	Rr Skenderbeu	L....O	202,000	0	202,000
19	F.	K.	S.	N.Tereza Laknas	K....V	202,000	202,000	0
20	A.	C.	T.	Kamez Rr.Berisha	L....C	104,000	0	104,000
21	A.	P.		Babrru qender	L....G	52,000	0	52,000
22	A.	K.		Rr.Skenderbeu		104,000	0	104,000
23	A.	K.		Rr.Berisha		104,000	0	104,000
24	M.	K.	A.	B.Blu Kamez		104,000	0	104,000
25	A.	M.	B.	Rr.Demokracia80		104,000	0	104,000
Totali								**2,864,000**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Per procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni, 89, 90...e vazhdim; Udhëzimi i përbashkët nr. 17, datë 20.06.2022, i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore"; UMF nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e

Shqipërisë" i ndryshuar; VKB nr. 137 datë 22.12.2022, "Për sistemin e taksave dhe tarifat vendore ne Bashkinë Kamez", gërma "f", pika 1.1/b.

Pajisja me autorizime e subjekteve që trëgtojne hidrokarbure dhe derivatet e tyre.

20. Titulli i gjetjes: Mungesë të ardhurash, nga mos lëshimi i liçensave/autorizimeve të subjekteve që tregtojnë karburante.
Konstatim: Duke u bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Transportit, Lejeve dhe Licensave konstatohet se për vitin 2022, në territorin e Bashkisë Kamëz ushtrojnë aktivitet 35 subjekte që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, nga të cilat:
-8 subjekte nuk janë të pajisura me autorizimet përkatëse si më poshtë:

Lekë

Nr.	Subjekti	Nuis	Adresa	Aktiviteti	Detyrim
1.	S.P	L....O	Rr.Skenderbeu	Treg.Karburant	202,000
2.	O. SHPK	K....E	Kamez B.N.Tereza	Treg.Karburant	202,000
3.	G. SHPK	L....A	Babrru Rr.demokracia	Treg.Karburant	202,000
4.	A. SHPK	L....H	Kamez Rr.Berisha	Treg.Karburant	202,000
5.	E.	L....R	Bul.N.Tereza	Treg.Karburant	202,000
6.	K.	J....P	Paskuqan	Treg.Karburant	202,000
7.	R.	J....I	Paskuqan	Treg.Gazi	52,000
8.	A.P	L....G	Paskuqan	Treg.Gazi	52,000
Totali					**1,316,000**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Mos pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, për vitin 2022, ka reflektuar dhe në **mungesë të ardhurave në Buxhetin e Bashkisë Kamëz në vlerën 1,316,000 lekë.** Në lidhje me këtë situata nga Drejtoria e Transportit Lejeve dhe Liçensave nuk janë marrë masat e duhura administrative për aplikimin e gjobave ndaj këtyre subjekteve, për më tepër nuk i është drejtuar Inspektioriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial për marrjen e masa përkatës por këto subjekte ende vazhdojnë aktivitetin.

21. Titulli i gjetjes: Edhe për Subjektet që janë paisur me autorizime ka patur periudhe kohore që kanë ushtruar aktivitet pa autorizim.
Situata: Nga analiza që u bë nga historiku i planifikimit bazuar në dokumentacionin dhe të dhënat nga drejtoria e Liçensave rezulton se në intervale të ndryshme kohore subjektet kanë ushtruar aktivitetin pa autorizimin përkatës.

Lekë

Subjekti					PeriU Aktivitet pa Autorizim				Vlera e pa arketuar		
Nr.	Emer	Mbiemer	Emri tregetar	Nuis	nga	deri	PeriU		Autorizim	Tarife sherbimi	Total
					date		vite	muaj	vlere	vlere	vlere
1.	R.	H.	K .	J....P	11.07.2021	21.01.2022		6	100,000	2,000	102,000
2.	R.	H.	K.	J....P	18.10.2021	21.01.2022		3	50,000	2,000	52,000
3.	F.	K.	P.	L....O	04.01.2022	28.03.2022		2	33,333	2,000	35,333
4.	H.	D.	D. SHPK	K....Q	10.11.2022	29.12.2022		8	133,333	2,000	135,333
5.	E.	B.	B.SHPK	L....O	26.09.2019	03.08.2021	1		200,000	2,000	202,000
6.				L....O	02.08.2022	01.12.2022		3	50,000	2,000	52,000
7.	N.	V.	V.	K....K	02.02.2022	08.11.2022		9	150,000	2,000	152,000
8.	A.	Ç.	A.SHPK	L....H	20.10.2020	04.03.2022	3		600,000	2,000	602,000
					19.10.2022	40.03.2022	2		400,000	2,000	402,000
9.	E.	F.	E.	L....R	19.12.2022	19.12.2023	1		200,000	2,000	202,000
10.	L.	A.	LL ..	L....P	08.08.2021	08.11.2022		3	50,000	2,000	52,000
11.	B.	M .	R.	J....I	27.06.2022	26.06.2023	2		10,000	2,000	12,000
12.	A.	P.	A.P	L....G	27.06.2022	26.06.2023	2		10,000	2,000	12,000
13.	L.	A.	LL.	L....P	25.03.2021	24.03.2023	3		600,000	6,000	606,000
Totali											**2,618,666**

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Referuar tabelës rezulton se **<u>në 13 raste</u>** në periudhë dhe intervale kohë të ndryshme nuk është aplikuar në kohë për pajisjen me Autorizime të subjekteve në fushën e tregëtisë së karburanteve.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 4, pika 2; VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhenien e liçensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar me VKM nr. 344, date 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma "b", pika 9 dhe 15; VKB nr. 137 datë 22.12.2022, "Për sistemin e taksave dhe tarifat vendore ne Bashkinë Kamëz", gërma "f", pika 1.1/b.

Ndikimi/Efekti: Veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Kamëz.

Shkaku: Neglizhencë në zbatimin e kuadrit ligjor.

Rëndësia: E lartë.

<u>22. Titulli i gjetjes:</u> Mos pajisja me leje aktiviteti 24 orësh e subjekteve me objekt aktiviteti tregti karburanti në Bashkinë Kamëz.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet me objekt aktiviteti tregti karburanti rezulton se për vitin 2022 nuk janë pajisur me leje aktiviteti 24 orëshe 33subjektendërkohë që ushtrojnë aktivitet "non stop".

Nr.	Subjekti	Nuis	detyrimi 2022	Nr.	Subjekti	Nuis	detyrimi 2022
1.	A. SHPK	L....H	20,000	18.	K	J....P	20,000
2.	A.P	K....U	20,000	19.	K	J....P	20,000
3.	B. SHPK	L....O	20,000	20.	K	J....P	20,000
4.	B. SHPK	L....O	20,000	21.	L.	L....I	20,000
5.	D. SHPK	K....Q	20,000	22.	Ll.	L....P	20,000
6.	D. SHPK	K....Q	20,000	23.	Ll.	L....P	20,000
7.	D.	L....G	20,000	24.	Ll.	L....P	20,000
8.	D.	K....Q	20,000	25.	O. SHPK	K....Ë	20,000
9.	E.	L.....R	20,000	26.	P.	L.....O	20,000
10.	G.	K....T	20,000	27.	Q NJ	L....E	20,000
11.	G.	K....T	20,000	28.	SH	K....N	20,000
12.	G.	K....T	20,000	29.	S.P	L.....O	20,000
13.	G SHPK	L....A	20,000	30.	S.	K....V	20,000
14.	O.O	J....I	20,000	31.	S.	K....V	20,000
15.	O.O	J....I	20,000	32.	V.	K....K	20,000
16.	K	K....S	20,000	33.	Ll.	L....P	20,000
17.	K.	L....S	20,000				
			340,000				**320,000**
Totali			**660,000**				

Burimi i të dhënave: Bashkia Kamëz.

Si rezultat i mosaplikimit të tarifës leje aktiviteti "24 orësh" për vitin 2022, nga Drejtoria e Transportit, Licencave e Lejeve **ka mungesë të ardhurash për Buxhetin e Bashkisë Kamëz në vlerën 660,000 lekë.** Gjithashtu nga kjo drejtori nuk janë marrë masa për aplikimin e gjobës për ushtrimin e aktivitetit pa paisur me lejen përkatëse.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, VKB nr. 137, datë 22.12.2022, "Për sistemin e taksave dhe tarifat vendore në Bashkinë Kamëz", gërma "f", pika 1.1/e: "Mos pajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh" dhe pika. C.7."Tarifa për dhenien e lejeve "Non stop".

Ndikimi/Efekti: Veprime me efekt financiar negativ në Buxhetin e Bashkisë Kamëz.

Shkaku: Neglizhencë në zbatimin e kuadrit ligjor.

Rëndësia: E lartë.

23. Titulli i gjetjes: Subjekte që zhvillojnë aktivitet për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj dhe janë të pa evidentuara nga Drejtoria e Transportit, Licencave e Lejeve.

Situata: Drejtoria e Transportit, Licencave e Lejeve nuk administron një regjistër të saktë dhe të azhornuar për evidentimin e subjekteve që zhvillojnëaktivitet për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, i cili duhet të ketë minimalisht emrin e subjektit, vendndodhja, NIPT, datën e pagesës, afatin e vlefshmërisë së licencës, datën kur duhet rinovuar licenca etj.

Kjo ka sjellë mos njohjen dhe mos ndjekjen e afateve të subjekteve për përsëritjen e liçensës dhe arkëtimin e tarifës për këto liçensa.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Transportit, Licencave e Lejeve rezulton se nuk është paraqitur një pasqyrë reale mbi aktivitetin e subjekteve që tregëtojnë karburant me adresa aktiviteti në territorin e Bashkisë Kamëz.

Nga verifikimi rezulton se ka subjekte që zhvillojnë këtë aktivitet pa u identifikuar dhe regjistruar në regjistrin e të dhënave që administron drejtoria e liçensave (nuk janë paisur me autorizime), konkretisht: Subjekti Ll.me NIPT L.....P me e Administrator L. A. me adresë sekondare: Kamëz, Rruga "Skenderbeu" ZK nr. 1649 nr.pas.27/39 i cili ushtron aktivitetin "Tregeti Karburanti" shtuar këtë adrese sekondare(regjistruar në QKB) më datë 25.03.2021. Për këtë subjekt nuk janë parashikuar të ardhuara në planin e të ardhurave për vitin 2022.

Duke bërë perllogaritjet si rezultat i mosregjistrimittë subjektit Ll.D., dhe mos paisjes me autorizim vitet 2021, 2022, **ka sjellë te ardhuara të munguara në vlerën 404,000 lekë.**

Nuk ka dokumentacion tjetër nga Bashkia Kamëz që të vërtetojë se janë marrë masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar (as vetë, as nëpërmjet bashkëpunimit duke informuar dhe kërkuar nga institucionet e tjera që përcakton kuadri rregullator ne fuqi), deri në ri paraqitjen e dokumentacionit të plotë nga ana e subjekteve përkatëse.

Nga Bashkia Kamëz nuk konstatohet asnjë shkresë ku të njoftohet me listë subjektesh, vendndodhje, etj., Inspektorati Shteteror Përgjegjës (Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë), për bllokimin e përkohshëm të veprimtarisë së këtyre subjekteve të pa liçensuar, apo për propozimin pranë ministrisë përgjegjëse të hidrokarbureve, për fillimin e procedurave të heqjes së liçensës së tregtimit me pakicë në stacionet e karburanteve apo njësitë e tregtimit të lëndeve djegëse.

Në pikën nr. 6, të VKM nr. 970, datë 02.12.2015, përcaktohet se autoriteti liçensues, bashkia, në përputhje me parashikimet ligjore, ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar, deri në ri paraqitjen e dokumentacionit të plotë për subjektet e pa liçensuar të cilët zhvillojnë aktivitet.

Për shkak të mos ushtrimit të kompetencave ligjore nga Bashkia Kamëz, subjektet as nuk kanë paguar tarifën e liçensimit as nuk janë pezulluar (pezullimi jo nga bashkia, por nëpërmjet kërkesës së bashkisë organeve të caktuara për këtë qëllim), e për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara ne buxhetin e njësise vendore.

Aktualisht në Bashkinë Kamëz zhvillojnë aktivitet 16 subjekte me liçensë të pa rinovuar dhe 16 subjekte të pa paisur me liçensë.

Në paketën fiskale të njësisë vendore, struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit dhe vjeljen e pagesës për këtë tarifë është Drejtoria e Transportit Lejeve e Liçensave. Brenda kësaj drejtorie janë caktuar për ndjekjen e këtij procesi personat përkatës, të cilët janë inspektorët e transportit si vijon. Në rregulloren e brendshme të Bashkisë Kamëz, neni 34 "Drejtoria e Transportit ....." përcaktohet se midis të tjerash, detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit të transportit janë:

-Në zbatim te legjislacionit ndjek procedurat për dhenien e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve dhe të GLN.

-Regjistrimin e licencave autorizimeve ....dhe karburanteve në regjistrin kombëtar të liçensimit.
Kriteri: VKM nr. 970, datë 02.12.2015, i ndryshuar; Pika nr. 6, nr. 6.1 nr. 12. Pika 3, e nenit 25, të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar; Pika nr. 3 e nenit nr. 25 të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999; Rregulloren e Brendshme e Bashkisë Kamëz (Vendim nr. 4119 datë 11.05.2022, Kryetarit të Bashkisë) neni 34; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; VKB nr. 137, datë 22.12.2022, "Për sistemin e taksave dhe tarifat vendore në Bashkinë Kamëz".
Ndikimi/Efekti: Mosevidentimi dhe mosregjistrimi i subjekteve sjell mungesë të ardhurash.
Shkaku: Neglizhencë në zbatimin e kuadrit ligjor.
Rëndësia: E lartë.

24. Titulli i gjetjes: Dhënia e Autorizimeve për subjektet që tregëtojnë karburante, gaz të lëng-shëm të naftës, pa plotësuar kriteret e parashikuara në aktet ligjore.
Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se në ***3 raste*** në dosjet e subjekteve që janë paisur me autorizimpër tregëtimin e karburantit dhe të GLN janë konstatuar mangësi në dokumentacion:

Nr.	Subjekti	Nipti	Lloji i tregtise	Vendndodhja	Autorizim		
					Bashkia Kamez	dt. leshimit	dt. perfundimit
	Emri/ tregetar			Zona	Nr.	date	date
1	K SHPK	J.....P	Treg. Karburanti	Kamez	**035/01**	21.01.2022	20.01.2027
2	K SHPK	J.....P	Treg. Karburanti	Bathore	**036/01**	21.01.2022	20.01.2027
3	P.	L.....O	Treg. Karburanti	Bathore	**038/03**	28.03.2022	03.01.2023

U analizuan me zgjedhje 8 dosje me praktikat për paisjen me karburant të subjekteve dhe u konstatua se në dokumentacionin e administruar në dosjeka mangësi:
Subjekti K SHPK me NIPT- J.....P, me vendndodhje në Kamëz është paisur me Autorizim nr. 035/01 lëshuar në datë 21.01.2022 me afat 5 vjeçar (rinovim)

-kërkesat të pa plotësuara me llojin e dokumentacionit pa inventar dosje;
-pa nënshkrimin e personit përgjegjës për marrjen e dokumentacionit;

Subjekti K SHPK me NIPT- J.....P, me vendndodhje Rr. N.Tereza Kamëz)ZK 3993 nr. pas.11/467 paisur me Autorizim nr. **036/01,** lëshuar në datë 21.01.2022, me afat 5 vjeçar (rinovim)

-kërkesat të pa plotesuara me llojin e dokumentacionit pa inventar dosje;

Subjekti "P. " Rr. Demokracia Bathore me NIPT L.....O me adresë Bathore paisur me Autorizim nr. **038/03,** lëshuar më datë 28.03.2022 me afat 1 vjeçar (rinovim).

-Polica e sigurimit për pergjegjësinë civile ndaj të tretëve për treguesit e naftës dhe të gazit mungonnë dosje administrohet policë kaluar afatin kohor të vlefshmërisë (19.01.2021 - 18.01.2022);
-Vërtetimi nga DPT (DRT-DSHT) nr. 323 datë 31.01.2022 vërteton se subjekti është debitor në vlerën ***1.051.177 lekë*** (në përgjegjësitë tatimore T/Fitim, T/Burim /Kontr /Sig /shoq/shend/TAP);

Duke ju referuar praktikave të mësipërme organi që ka përgjegjësi për dhënien e licencave, Drejtoria e Licencave nuk ka ushtruar kontroll për të dhënat dhe treguesit e paraqitur në dokumentacionin e personit juridik kërkues.
Gjithashtu nuk ka analizuar vërtetimin e DPT që subjekti "P. " është debitor në vlerën 1.051.177 lekë, detyrime tatimore (në pergjegjësite tatimore T/Fitim, T/Burim /Kontr /Sig /shoq/shend/TAP);
Kriteri: Vendimi nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" (ndryshuar me

VKM nr. 344, datë 19.04.2017) (i përditesuar),Kreu II, Procedura për dhënien e liçensave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatoret fundorë, pika 2. paragrafi f) dhe g).
Ndikimi/Efekti: Mungesë dokumentacioni në subjektet e liçensuar.
Shkaku: Neglizhencë në zbatimin e kuadrit ligjor.
Rëndësia: E mesme.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. **z. SH.L** me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Liçensave dhe Transportit,
2. **z. K. H** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Liçensave,
3. **z. F.L, z. A.Gj** me detyrë Specialist të Liçensave.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
2.3.2. Plotësiae shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.
2.3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

- **Për Vlerësimin e raportimit financiar, u kërkua dhe u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm*:***

1. Pasqyrat financiare të vitit 2022 të Bashkisë Kamëz;
2. Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, i arkës, magazinës, pagave (borderotë), të veprimeve të ndryshme, debitorëve , kreditorëve, furnitorëve, etj
3. Praktika e Inventarizimit të aktiveve, regjistri i aktiveve;
4. Urdhër shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur;
5. Akt rakordimet me degën e thesarit Tiranë;
6. Dokumentacion mbështetës për vendimet gjyqësore, investimet, shpenzimet e të ardhurat etj.

- **Hartimi i pasqyrave financiare**

Bashkia Kamëz për vitin ushtrimor 2022 ka plotësuar pasqyrat financiare të konsoliduara sipas formateve nga 1-8 për çdo njësi përbërëse të saj: aparati i bashkisë dhe 2 njësitë e varësisë dhe ato të konsoliduara, të cilat i ka dorëzuar në Degën e Thesarit Tiranë dhe regjistruar me nr. 787/227 prot., në datën 29.03.2023.
Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuara pasqyrat si vijon:
Format 1 - Pasqyra e Pozicionit Financiar,
Format 2 - Pasqyra e Performancës Financiare,
Format 3 - Pasqyra e Flukseve Monetare,
Format 4 - Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto,
Format 5 – Pyetësori dhe Shënime Shpjeguese,
Format 6 - Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit,
Format 7/a - Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me kosto historike,
Format 7/b – Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me vlera neto,
Format 8 - Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave.
Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022 janë bërë

duke kryer paraprakisht regjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara gjatë secilit vit ushtrimor; kontabiliteti mbahet në programin ***Microsoft Excel***:

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare konsoliduar	Administrata dhe Njësitë e Varësisë	Data e dorëzimit në Degën e Thesarit Tiranë
Bashkia Kamëz	Bashkia Kamëz (administrata)	Prot. Nr.2792 dt. 28.03.2023
	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	
	Ndërmarrja e Pastrim, Gjelbërim e Treg	

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga sektori i financës dhe janë nënshkruar nga NA dhe NZ; janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë për vitin ushtrimor 2022 me shkresën nr. 2792 prot., datë 28.03.2023 dhe me nr. 787/227 prot., datë 29.03.2023 të Degës së Thesarit Tiranë, në respektim të afatit ligjor.;

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:**

Për vitin ushtrimor 2022 rezulton verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë të ektstrakteve të bankës (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total, mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditar i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i inforM onit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse regjistrimet kantabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
- mbështetjen në dokumente justifikuese, të vërtetuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike, deri në mbyllje të ushtrimit të mëparshëm;

Nëse informacioni kontabël mundëson në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazim i lëvizjes së ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:
- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e informacionit bazë dhe justifikues;

- Në këtë njësi publike, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në programin "Microsoft Excel";
- Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Eshtë mbajtur libri i madh apo libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletëkontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë te hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të proçedurave të prokurimit, aktmarrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- **Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar, Pohimet mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të njësisë për aktivitetin ekonomiko –financiar të vitit 2022. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga sektori i financës së Drejtorisë Financës dhe Kontabilitetit. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatuan se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet

	Viti 2021	- Viti 2022
Aktivet	14,575,329,293 lekë	16,251,537,123 lekë
Pasivet	1,575,254,374 lekë	1,533,305,357 lekë
Aktivet neto	13,000,074,919 lekë	14,718,231,766 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën 1,929,672,791 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 441,505,075 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 92,056,770 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 1,185,348,367 lekë dhe “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 210,762,579 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën e 441,505,075 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 është në shumën 461,947,066 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr. 3 “Pasqyra e Flukseve Monetare”(cash-floë), në shumën 365,109,932 lekë (340,758,076+558,101+23,793,755), që sipas metodës direkte. përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	441,505,075	461,947,066	-20,441,991
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		**441,505,075**	**461,947,066**	**(-)20,441,991**

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 441,505,075 lekë, përbëhet nga fondet e planifikuara për vitin 2022, por të papërdorura kryesisht nga llog.600, llog.602 dhe llog. 231 në shumën 303,920,712 lekë, si dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 137,194,411 lekë. Llog.466 “Mjetet në ruajtje” përbën garancinë e punimeve e cila e shpërndarë sipas viteve është: *për vitin 2021* ka vlerën 61,600,632 lekë, është ngurtësuar gjatë vitit 2022 me 7,624,013 lekë dhe shtuar në shumën 83,217,792 lekë.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u krediturar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2021-2020
31	Materiale	22,403,563	1,285,567	-21,117,995
32	Objekte inventari/Inventarimët	69,653,208	29,971,935	-39,681,273
33	Prodhime, punime e shërbimene proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri	0	0	0
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provigjone për zhvlerësim e inventarit(-)	0	0	0
Totali		**92,056,770**	**31,257,502**	**(-) 60,799,268**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të konsoliduar Kamëz në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 92,056,770 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 22,403,563 lekë dhe nga llogaria kontabel 32 “Objekte/inventari imët” në vlerën 69,653,208 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit, vlerë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën

(-)60,799,268 lekë.

Nr	Gjendja analitike e llog. 312 viti 2021					Daljet viti 2022	Gjendja 31.12.2022
	Emërtimi	Njësia	Numri	Çmimi për njësi	Vlera		
Bashkia Kamëz							
1	Bileta 50 lekë	Copë	3111	1.2	3,733.2		3733.2
	Bileta 100 lekë	-//-	8421	1.8	15,157.8		15157.8
	Bileta 200 lekë	-//-	4378	1.3	5,694.4		5694.4
Nëntotali I			***15,910***		***24,585.4***		***24,585.4***
2	Blloqe parkimi	-//-	837	156	130,572		130,572
3	Akt Kontrolle	-//-	6	1080	6,480	6,480	0
4	Procesverbale	-//-	32	1080.563	34,578		34,578
Nëntotali II		***-//-***	***875***		***171,630***		***165,150***
Nëntotali			***16,785***		***196,215.4***	***6,480***	***189,735.4***
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike							
1					***0***	-	***21,214,974***
Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit dhe Tregu							
1		-//-			***1,089,352***	*90,499*	***998,853***
Totali		**-**	**-**	**-**	**1,285,567.4**		**22,403,562.4**

Llogaria 312 "Materiale", në fillim të vitit 2022 ka vlerën 20,228,967 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	1,285,567
Hyrje gjatë vitit 2022	21,214,974
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	6,480
Gjendja në 31.12.2022	22,403,563

Llogaria 327 "Objekte inventari", në fund të vitit 2022 ka vlerën 9,881,008 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime.

Gjendja e llog. 327			
Gjendja e 31.12.2021	Shtesa viti 2022	Pakësime viti 2022	Gjendja në 31.12.2022
Bashkia Kamëz			
29,346,317	43,247,846	6,793,954	65,800,209
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike			
-	2,578,781	-	2,578,781
Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit dhe Tregu			
625,618	648,600	-	1,274,218
29,971,935	**46,475,227**	**6,793,954**	**69,653,208**

Lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	29,971,935
Hyrje gjatë vitit 2022	46,475,227
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	6,793,954
Gjendja në 31.12.2022	69,653,208

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve, llog 63 evidentuar në pasqyrën e performancës financiare. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit". Titullari i ka nxjerrë Urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve që klasifikohen të dëmtuara.[11]

Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme"&"Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2021-2020
	Llogari të arkëtueshme	**1,322,542,778**	**933,282,839**	**389,259,939**
411	Klientë e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	
431	Tatime e taksa	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	0		
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0		
435	Sigurime Shoqërore	0		
436	Sigurime Shëndetësore	0		
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0		
44	Institucione te tjera publike	0		
466	*Kreditore per mjete ne ruajtje*	*137,194,411*	*61,600,632*	*75,593,779*
468	Debitorë te ndryshëm	721,927,838	716,700,299	5,227,539
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	463,420,529	154,981,908	308,438,621
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)	0	0	
	Të tjera aktive afatshkurtra	**210,762,579**	**641,971,535**	**(-)431,208,956**
409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	380,800,000	(-)380,800,000
486	Shpenzime të periUve të ardhshme	210,762,579	261,171,535	(-)50,408,956
	Totali	**1,533,305,357**	**1,575,254,374**	**(-)41,949,017**

- **"Llogari të arkëtueshme"** për vitin 2022 është në shumën 1,322,542,778 lekë dhe në vitin 2021 është 933,282,839 lekë me një diferencë prej 389,259,939 lekë. Kjo shtesë ka ardhur si rezultat i rritjes së llog. 466 "kreditorë për mjete në ruajtje" me shumën 75,593,779 lekë; rritjes së llog. 468 "debitorë të ndryshëm" me shumën 5,227,539 lekë për mospagesa ndaj kreditorëve dhe rritjes së llog. 4342 "të tjera operacione me shtetin (debitor)" me shumën 308,438,621 lekë.;
- **"Të tjera aktive afatshkurtra"** për vitin 2022 është në shumën 210,762,579 lekë dhe që përbëhet nga llog. 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"; për vitin 2021 është në shumën 641,971,535 lekë dhe që përbëhet nga llog. 481 "shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime" në shumën 380,800,000 lekë dhe llog. 486 "Shpenzime të periUve të ardhshme" në shumën 261,171,535 lekë;

[11] Trajtohet në mënyrë të detajuar në rubrikën për procesin e inventarizimit të aktiveve

Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 61,600,632 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 137,194,411 lekë, gjendje e cila përfaqëson vlerën e garancisë 5 % të vlerës totale të investimeve të bashkisë.Analiza e kësaj llogarie është si më poshtë:

Numri i investimeve	Gjendje 31.12.2021	Shtesa 2022	Pakësime 2022	Gjendje 31.12.2022	Numri
34	60,360,042	78,719,607	6,150,213	132,929,436	33
Të ndryshme					
6	1,240,590	4,498,185	1,473,800	4,264,975	5
40	**61,600,632**	**83,217,792**	**7,624,013**	**137,194,411**	**38**

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në fund të vitit 2021 është 716,700,299 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 721,927,838 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Debitor në numër
Gjendja në 01.01.2022	716,700,299	420
Shtesa gjatë vitit 2022	61,322,225	66
Pakesime gjatë vitit 2022	56,094,686	44
Gjendja në 31.12.2022	721,927,838	442
Diferenca	**5,227,539**	**22**

Nga analiza rezulton se vlera e kësaj llogarie ka ardhur në rritje me 5,227,539 lekë në vlerë, por edhe në numër prej 22 debitorësh, duke e çuar në 442 numrin e debitorëve dhe në shumën **721,927,838 lekë**. Shuma e detyrimeve debitohet në llog. 468 "debitorë të ndryshëm" dhe kreditohet në llog. 4341 "të tjera operacione me shtetin (kreditor)".

Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (debitor)", në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 154,981,908 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën 463,420,529 lekë, me një diferencë prej 308,438,621 lekë; shtuar llog. 486 "shpenzime të periUve të ardhshme" në shumën 210,762,579 lekë, arrin në humën e 184,251,587 lekë; kjo shumë kuadron me shumën e llogarive të pagueshme në pasiv si në tabelë:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408	327,280,557
Detyrime personelit llog 42	51,129,014
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	3,842,220
Sigurime shoqërore llog.435	13,616,854
Sigurime shëndetësore llog.436	1,888,678
Organizma të tjerë shtetërorë	0
Kreditorë të ndryshëm llog.467	276,425,785
Totali	**674,183,108**

Llogaria 486 "Shpenzime të periUve të ardhshme" në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 261,171,535 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 210,762,579 lekë. Diferenca prej (-)504,058,956 lekë tregon për pakësim të llogarisë nga pagesat e kryera debitorëve në shumën 128,437,827 lekë për "investimet" e kryera dhe 88,419,120 lekë për zërin "mallra e shërbime" për shërbimin e pastrimit të qytetit, si dhe shtim të vlerës gjatë vitit 2022 me shumën 111,186,041 lekë për "investimet" dhe në shumën 55,261,950 lekë për "shërbime". Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Vlera e kësaj llogarie, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera "mallra dhe shërbime", por të pa financuara në vitin ushtrimor. Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2019, pika 42 ku cilësohet: "Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, "shërbime" apo "investime" të kryera, por të pa financuara".

Institucioni	Llog.486	Gjendja 31.12.2021	Pakesime Viti 2022	Shtesa Viti 2022	Gjendja 31.12.2022

2166001	Bashkia Kamez	4864100	0	0		0
2166001	Bashkia Kamez	4864200	88,419,120	88,419,120	55,261,950	55,261,950
2166001	Bashkia Kamez	4864400	172,752,415	126,005,580	108,753,794	155,500,629
Totalli llog. 486			261,171,535	214,424,700	164,015,744	210,762,549

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. Aktivet afatgjata

Objektivat e auditimt janë që të sigurohemi se: Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; inforM onet e subjektit janë të plota dhe korrekte.

Në Formatin 1 "Pozicioni Financiar", "Aktivet afatgjata" paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e Ilog.231). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 12,568,470,983 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 14,321,864,332 lekë; Ndërsa në Formatin 7/b "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata" (kosto historike), paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 13,534,796,952 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 15,566,684,583 lekë, të cilat janë pasqyruar më poshtë sipas llogarive analitike.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale", përbëhen nga llog.202 "Studime dhe kërkime", në fund të vitit 2021 në vlerën 104,285,997 lekë dhe në fund të vitit 2022 është 116,296,426 lekë, me një diferencë prej 12,010,429 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata" (kosto historike), paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 182,876,537 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 212,748,889 lekë, ku diferenca prej 29,872,352 lekë i përket projekteve shtesë të vitit 2022, analizuar si vijon:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	104,285,997
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	29,872,352
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	17,861,923
Gjendja në 31.12.2022 (D)	116,296,426

Në Formatin 7/b "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata" (vlera neto), llog.202 "studime e kërkime" paraqitet si më poshtë**:**

Emërtimi i Aktivit Llog. 202	Gjendja më 31.12.2021	Shtesa gjate vitit 2022	Amortiz. Akum.	Gjendja më 31.12.2022
Studime e projektime	182,876,537	29,872,352	78,590,540	212,748,889

Kjo vlerë rakordon me vlerën e regjistrit të Aktiveve për llog. 202 të vitit 2022.

Llog. 202 Studime e projektime	Numri 31.12.2021	Numri viti 2022	Totali
Bashkia Kamez	59	5	**64**
NJA Paskuqan	20	-	**20**
Totali	**79**	**5**	**84**

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 "Aktivet Afatgjata Materiale" në Formatin 1 (Aktivi i bilancit), paraqiten me vlerën neto për vitin ushtrimor 2022 në vlerën 10,749,861,577 lekë; në vitin paraardhës 2021, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 9,274,142,982 lekë, me një shtim të AAM-ve me 1,475,718,594 lekë Sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata" (kosto historike) paraqiten ne mbyllje të vitit 2021 në vlerën

13,351,920,415 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 15,353,935,694 lekë. Kjo Ilogari sintetike e analizuar paraqitet: nga ndryshimi i llog. 212 nga 3,074,380,233 lekë në vitin 2021 dhe 4,276,953,366 lekë në vitin 2022 me nje diferencë në rritje 1,202,573,133 lekë më shumë; në llog. 213 në fund të vitit 2021 me 7,801,263,547 lekë shtuar në 2022 më shumën 722,289,879 lekë; llog, 214 pakësuar me shumën (-)3,152,775 lekë; nga shtimi i llog. 215 me 27,651,600 lekë dhe lëvizjeve në llog.218 me shtime, pakësime brenda dhe jashte sistemit në shumën totale 52,653,442 lekë.

21	2.Aktive Afatgjata materiale	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
		10,749,861,577	**9,274,142,982**	**1,475,718,595**
210	Toka, Troje, Terrene	58,990,966	58,990,966	0
211	Pyje, Plantacione	125,677,932	132,292,559	-6,614,627
212	Ndertesa e Konstruksione	3,482,709,070	2,426,646,125	1,056,062,945
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	6,832,233,985	6,447,422,661	384,811,324
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	8,514,352	11,698,813	-3,184,461
215	Mjete Transporti	52,011,149	33,190,449	18,820,700
216	Rezerva Shteterore	0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	189,724,123	163,901,410	25,822,713
24	Aktive afatgjata te demtuara	0	0	0
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	0	0	0

Llog.210 "Toka, troje, terrene" paraqitet në mbyllje të viteve 2021 e 2022 në vlerë të pandryshuar 58,990,966 lekë; si dhe në Formatin 7/a e 7/b "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata" paraqitet në të njëjtën vlerë 58,990,966 lekë. Sipas vlerës bruto paraqitet:

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog.210	Gjendja 31.12.2021	Shtesa/pakësime gjatë vitit 2022	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2022
1	Toka, Troje, Terene	58,990,966	0	0	58,990,966
Totali Bashkia Kamëz		**58,990,966**	**0**	**0**	**58,990,966**

Llog. 211 "Pyje, plantacione" paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 125,677,932 lekë; në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 132,292,559 lekë, me një diferencë prej (-)6,614,627 lekë. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i llogaritjes së amortizimit, vlera e akumuluar e të cilit është 37,601,814, ndërsa amortizimi për vitin 2022 është 6,614,627 lekë. Në Formatin 7/a e 7/b "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata" paraqiten në të njëjtën vlerë 1,596,452 lekë. Analiza e llog.211 si më poshtë:

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 211	Gjendja 31.12.2021	Shtesa/pakësime gjatë vitit 2022	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2022
1	Pyje, Plantacione	163,279,747	0	37,601,814	125,677,932
Totali Bashkia Kamëz		**163,279,747**	**0**	**37,601,814**	**125,677,932**

Llog.212 "Ndërtesa Konstruksione" në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën neto 2,426,646,125 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,482,709,070 lekë, me një shtim prej 1,056,062,945 lekë. Ndërsa në Formatin 7/a "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata" (kosto historike) paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,074,380,233 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 4,276.953,366 lekë, me një vlerë të shtuar në shumën 1,202,573,133 lekë që përfaqëson vlerën e investimeve të përfunduara; në Formatin 7/b "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata'' (vlera neto) paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2.426,646,125 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,482,709,070 lekë; Diferenca 1,056,062,945 lekë përfaqëson vlerën e shtesës duke zbritur vlerën e amortizimit (1,202,573,139-146,510,188). Analiza e llog.212 si më poshtë:

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog.212	Gjendja 31.12.2021	Shtesa/pakësime gjatë vitit 2022	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2022
1	Ndërtime e Konstruksione	3,074,380,233	1,202,573,133	794,244,296	3,482,709,070
Totali Bashkia Kamëz		**3,074,380,233**	**1,202,573,133**	**794,244,296**	**3,482,709,070**

Llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto të saj 6,447,422,661 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 6,832,233,985 lekë me një shtim në vlerën 384,811,324 lekë; Ndërsa në Formatin 7/a "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata" (kosto historike) paraqitet në mbylije të vitit 2021 në vlerën 7,801,263,547 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 8.523.553.426 lekë, ku diferenca prej 722,289.879 lekë përbën vlerën e investimeve të bëra në vitin 2022; në Formatin 7/b "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata" (vlera neto) paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,447.422,661 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,832,233,985 lekë; Diferenca 384,811,324 lekë përfaqëson shtesën duke zbritur vlerën e amortizimit (722,289,879- 337,478,555), pasi gjatë vitit 2022, ka patur vetëm shtesë të vlerës së llog.213. Analiza e llog. 213 si më poshtë:

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 213	Gjendja 31.12.2021	Shtesa/pakësime gjatë vitit 2022	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2022
1	Rrugë, rrjete, vepra ujore	6,447,422,661	**722,289,879**	1,691,319,441	6,832,233,985
	Totali Bashkia Kamëz	**6,447,422,661**	**722,289,879**	**1,691,319,441**	**6,832,233,985**

Konstatim: Nga analiza e llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" rezulton se referuar klasifikimit ekonomik kontabël/nomenklaturës së llogarive të planit kontabël, ka të listuar objekte inventare të klasifikuara gabim, të cilat janë: në inventarin e Bashkise Kamëz - "Ndërtim lulishte para pallatit të kulturës" viti i krijimit 2011 dhe kosto historike 3,492,744 lekë, "Lulishte te Bashkia" vit krijimi 2012 dhe kosto historike 300,793 lekë; NJA Paskuqan - "Lulishte para komunës Paskuqan" me kosto historike 478,946 lekë dhe "Gjelbërim ambienti në Paskuqan nr. 2" me kosto historike 240,000 lekë të cileve u mungon viti i krijimit si aktiv, duhej të ishin regjistruar në llog. 212 ose llog. 211 në varësi të asaj çfarë përfaqëson secili rast (lulishte apo pyje /kullota). Pra në total vlera e regjistruar gabim në llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" është 4.512,483 lekë. Pra llog.213 është mbivleresuar në shumën 4,512,483 lekë, dhe llog.212 dhe/ose llog 211 në total janë nënvlerësuar me po këtë vlerë. Duhet theksuar fakti që vlera neto kontabël e secilit aktiv në veçanti nuk ndryshon, pasi koeficenti i amortizimit në këtë rast është i njëjtë **me 5 %.**

Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 11,698,813 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 8,514,352 lekë me një diferencë prej (-)3,184,461 lekë; Ndërsa në formatin 7/a paraqitet në vlerën bruto në mbyllje të vitit 2021 prej 32,779,204 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 29,626,429 lekë. Diferenca prej 3,152,775 lekë përfaqëson vlerën e atyre aktiveve të nxjerra jashte përdorimit. Analiza e gjendjes së llog. 214 me ndryshimet nga viti 2021 në 2022 paraqitet si vijon:

nr	Emërtimi i Aktiveve – llog. 214	Gjendja 31.12.2021	Shtesa/pakësim gjatë vitit 2022	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2022
1	Instalime teknike, makineri, pajisje	11,698,813	3,152,775	21,112,077	8,514,352
Totali Bashkia Kamëz		**11,698,813**	**3,152,775**	**21,112,077**	**8,514,352**

Llogaria 215 "Mjete transporti". Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Kamëz më datë 31.12.2021 në shumën 33,190,449 lekë dhe në 31.12.2021 në

shumën 52,011,149 lekë, ku diferenca 18,820,700 lekë (shtim) është vlera e krijuar nga blerja e 6 mjeteve duke zbritur amortizimin (27,651,600-8,830,900); Ndërsa në formatin 7/a lëvizjet e llogarisë janë si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	73,349,343
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	27,651,600
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	0
Gjendja në 31.12.2021 (D)	101,000,943

Bashkia Kamëz ka në pronësi të saj dhe në gjendje aktive 18 mjete transporti dhe lista përmbledhëse e tyre pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Njësitë që i kanë automjetet në administrim	Numri i automjeteve	Vlera totale
1	**Bashkia Kamez**	7	49,732,859
2	NJA Paskuqan	1	2,881,200
3	NPGJT	7	36,644,884
4	NSHP	3	11,742,000
Totali Bashkia Kamez		**18**	**101,000,943**

Nga analiza e llog. 215 rezulton vlera bruto e saj ka ndryshuar në vlerë në rritje prej 27,615,600 lekë.[12]

Llogaria kontabël 218 "Inventar ekonomik". Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga Bashkia Kamëz. Sipas pasqyrave financiare të Kamëz, gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2021 paraqitet në vlerën 163,901,410 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 189,724,123 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 25,822,713 lekë, e cila përbëhet: nga shtesat në shumën 71,951,683 lekë, pakësime 19,298,241 lekë për nxjerrje jashtë përdorimit dhe me amortizim prej 65,427,211 lekë (163,901,410+71,951,683-46,128,970).

Nr	Njesite administrative	Gjendja 31.12.2021	Shtesa 2022	Pakesime	Gjendja 31.12.2022
1	Bashkia Kamez	175,856,126	47,357,295	16,902,545	206,310,876
2	NJA Paskuqan	42,219.967	20,640,082	2,395,696	60,464,353
3	NPGJT	12 cope			1,733,784
4	NSHP	41 cope			3,684,306
Totali Bashkia Kamez					**272,193,318**

Nga analiza e llog. 218 "inventar ekonomik**" u konstatua** se, kategoria "pajisje kompjuterike" nuk është ndarë si kategori më vete duke pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit. Por nga verifikimi i analizës se llogarisë dhe rregjistrit të inventareve rezultoi se llogaritja e amortizimit për pajisjet kompjuterike është llogaritur saktë prej 25% të vlerës së mbetur.

nr	Emërtimi i Aktiveve - llog. 218	Gjendja 31.12.2021	Shtesa/pakësim gjatc vitit 2022	Amortizim akumuluar	Gjendja 31.12.2022
1	Inventar ekonomik	272,193,318	25,822,713	82,469,195	272,193,317
	Totali Bashkia Kamëz	**219,539,875**			**272,193,317**

Vlera neto e AAM në fund të vitit 2021 është 1,627,034,153 lekë dhe në fund të vitit 2022 është 1,622,960,884 lekë, ku diferenca prej (-)4,073,269 lekë, përfaqëson vlerën e amortizimeve dhe kostove historike [kosto historike - amortizim i akumuluar].

[12] Analiza e detajuar pasqyrohet ne Aneksin 3/1

Levizjet Llog. 218 "Inventar ekonomik" per vitin 2022, vlera ne lekë	
Celie me 01.01.2022	163.901,410
Blerje me pagese (D)	71,951.683
Dalje (K)	19.298.241
Gjendja me 31.12.2022	189.724.123

Llog. 28 "Caktime" në mbyllje të viteve 2021 dhe 2022 paraqitet me të njëjtën vlerë prej 1,928,337,500 lekë, që përfaqëson vlerën e aksioneve të "Ujesjelles Kanalizime Kamez"-ShA. Kjo vlerë është e njëjtë me atë të llog. 26 "Pjesëmarrje në Kapitalin e vetë" të pasqyrës Format 1.

Llog 209 & 219 "Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Kamëz në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 2,228,030,472 lekë; Në mbyllje të vitit 2022 paraqiten në vlerën 2,772,189,080 lekë, ku rezulton se kjo vlerë është shtuar për 566,609.624 lekë dhe pakësuar për shumën 22,451,016 lekë.[13]

Pasqyra statistikore nr. 7/b "Akivet afatgjata me vlerë neto"

Përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 "Për proçedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Kamëz, janë si më poshtë:

*ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje	5%
*inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi)	20%
*për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi)	25%
*për mjetet e transportit	20%
*për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare)	15%

Llogaria 230 dhe 231"Investime" për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2021, paraqiten në shumën 1,261,704,503 lekë dhe për vitin 2022 në shumën 1,527,368,829 lekë, me një diferencë (shtim) prej 265,664,326 lekë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 1,527,368,829 lekë.

Nr.	Emertimi i Llog	Gjendja fillim viti 2022	Debi	Kredi	Gjendja me 31.12.2022	Diferenca
1	Aktive Afatgjata jomateriale	0	-	-	0	0
2	Aktive Aftagjata materiale	1,261,704,503	2,242,581,665	1.976,917,339	1,527,368,829	265,664,326
Totali		**1,261,704,503**	-	-	**1,527,368,829**	**265,664,326**

Investimet e kryera gjatë vitit 2022 janë në proces. Për investimet referuar Udhëzimit të MFE nr. 8 dt.09.03.2018 "Për proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, veprimet kontabël ndjekin keto hapa: me çeljen e fondeve - debitohet llog. 520 dhe kreditohet llog. 476; me konstatimin e shpenzimit - debitohet llog. 231 dhe kreditohet llog. 404; në momentin e pagesave- debitohet llog. 404 dhe kreditohet llog. 520; në fund te vitit ushtrimor për fondet e përdorura për investimet në proces debitohet llog. 476 dhe kreditohen llog. 720 dhe llog. 4342 për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por tëfinancuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues; me perfundimin e investimit te konfirmuar me aktin e marrjes në

[13] Analiza e detajuar tabela në Aneksin 3/1/1

dorëzim të investimit dhe likuidimin total të vlerës së kontratës bëhet kapitalizimi i aktivit në debi të llog. 21 (përcaktohet artikulli kontabël) dhe kredi të llog. 231; me kapitalizimin e aktivit - debitohet llog. 476 dhe kreditohet llog. 105; kreditohet llog. 1011 dhe debitohet llog.105. Pra *<u>të drejtat</u> duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre dhe <u>detyrimet</u> të evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e ndodhjes si shpenzim pavarësisht nga data e pagesës.* Në mënyrë analitike aktivet afatgjata materiale në proces paraqiten si më poshtë:

Nr.	PERSHKRIMI	2313100	2300Q0	2312118
		Rikonstruksion rruge	projekte	ndertime
1	Rindcrtimi 1 shkolles 9-vjeçare "Demokracia" parapagim 10 % sipas kontrates	-		172,476,282
2	Ndcrtim 1 rrjetit ujesjellcs ne zonen Fushe Kamez lik sit nr 5 pjesor	62,874,807	-	-
3	Ndcrtim 1 rrjetit KHZ dhe fumzimi me uje 1 zones Valias i Ri lik.sit nr 5 pjesor	296,566,250	•	-
4	Mbikqyres Nd Rjeti KUZ dhe fumizmi me uje 1 zones Valiasi I Ri lik.pjesor	1,710,234	-	-
5	Ndërtim rruga "Harku 1 Triumfit " Valiasi 1 Ri lik pjesor	28,838 947	-	•
6	Rindcrtimi 1 godines Adminstrative .ne zonen e re per zhvillim tc detyruar ne Fshatin Valias Bashkia .Kaniza lik sit nr 4	-	-	126,533,700
7	Rindertim 1 shkolles 9 vj ecare Lidhja e Prizren it	*	-	96,211,785
8	Ndertim rruga demokracia loti III Bathore lik sit nr 1	42,521,550	-	-
9	Rindertim I shkolles 9-vjecare "Halit Coka "	-	-	94,081,290
10	NdrrugBubullima+Librazhd+segparalcl +ndricim rruga Zallmner ,sit nr 1	11,413,020	-	-
II	Mbikqyrje jiN 1 shkolles 9-vjecare Demokracia "Valiasi i ri	-	-	1,302,530
12	Rikonstruksion 1 shkolles se mesme Gramoz Palushi Babrru Paskuqan ,parapagim 10 % sipas kontrates	-	-	19,618,970
13	Rindertim I shkolles 9-vjecare "Azem Hajdari " ,Njesia Administrative Babrru ,Bashkia Kamez parapagim 10% sipas kontrates	-	-	46,360,012
14	Rindertim I shkolles 9-vjecare "Azem Hajdari" ,Njesia Administrative Babrru ,Bashkia Kamez parapagim 10% sipas kontrates	-	-	56,662,238
15	Rindertim i shkolles 9-vjecare "Azem Hajdari" Zall Mner Kamez. parapagim 10% sipas kontrates	-	-	26,806,478
16	Ndcrtimi rruga OSBE Bulevardi "Nene Tereza " lik sit nr 2 pjesor	48 753.276	•	-
17	RiN 1 shkolles 9-vjecare "Lidhja Prizrenit "Njesia Administrative Babrru ,Bashkia Kamez Mbikqyres lik pjesor	-	*	900,000
18	Rikonstruksioni 1 shkolles se mesme Gramoz Palushi Babill Paskuqan ,sit m 1	•		23,209,884
	viti 2022	**492,678.084**	**0**	**664,163,169**
IQ	Rindertim 1 Godines Adminsitrative ne zonen e re per zhvillinun le detyruar ne tshatin valias	•		42,631,579
20	Ndertim Rrjeti ujesjeilesit ne zonen Fushe Kamez	139.927,200		
21	Ndertim Rrjeti KUZ dhe funiizim me uji I zones Valias 1 ri	177.526.402		
22	Ndertim rruga Montreal Kamez 5	10.442.395		
	shuma llog. 231viti 2021	**327,895,997**		**42,631,579**
Totali llog. 231 në dt. 31.12.2022		**820.574,081**		**706,794,748**

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme dhe paraqesin detyrimet deri më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të

muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/ ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	327,280,557	365,434,834	(-)38,154,277
42	Detyrime ndaj personelit	51,19,014	34,686,473	16,442,541
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	3,842,220	2,739,526	1,102,694
435	Sigurime shoqërore	13,616,854	9,343,692	4,273,162
436	Sigurime shëndetësore	1,888,678	1,296,421	592,257
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	137,194,411	61,600,632	75,593,779
467	Kreditorë të ndryshëm	276,425,785	383,452,497	(-)107,026,712
4341	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)	721,927,838	716,700,299	5,227,539
	Gjendja në fund të periudhës	**1,533,305,357**	**1,575,254,374**	**(-)41,949,017**
	Të tjera pasive afatshkurtra			
C	**FONDI NETO/FONDET (A-B)**	**14,718,231,766**	**13,000,074,919**	1,718,156,847
D	**FONDI I KONSOLIDUAR**	**14,718,231,766**	**13,000,074,919**	1,718,156,847
101	Fonde bazë	13,739,806,621	11,756,771,598	1,983,035,023
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	365,109,932	403,989,913	-38,879,982
E	**TOTALI I PASIVIT (B+C)**	**16,251,537,123**	**14,575,329,293**	**1,676,207,830**

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund të vitit 2021 është 365,434,834 lekë lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është 327,280,557 lekë me një diferencë (-)38,154,277 lekë; ndërsa gjendja e llog. 401-408 paraqet faturat e palikuiduara ndaj të tretëve nga Bashkia Kamëz deri më 31.12.2022. Nga analiza e gjendjes së kësaj llogarie rezultoi se janë 26 fatura të palikujduara në llog 404 në vlerën 124,323,951 lekë dhe 21 fatura të llogarise 401 në vlerën 4,892,740 lekë, të cilat janë bashkëngjitur aktit.

Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit", sipas pasqyrave financiare të paraqitura nga Bashkia Kamëz, paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në shumën 34,686,473 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 51,129,014 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 16,442,541 lekë. Vlera e llog.42 përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431, "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa", paraqitet në vitin 2021 në vlerën 2,739,526 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,842,220 lekë me një diferencë (shtim) prej 1,102,694 lekë; vlera e llog. 431 përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar në Janar të vitit pasardhës. Vlera rakordon me vlerën sipas listëpagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimi mbi pagën.

Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" dhe **llogaria 436** "Sigurime shëndetësore" paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 9,343,692 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,616,854 lekë për sig. Shoq; në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,296,421 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është pasqyruar 1,888,678 lekë. Gjendja e këtyre llogarive përfaqëson vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar. Vlera 11,066,199 lekë përbën 15% të pagës bruto paguar nga punëdhënësi; sig shëndetësore ndahen 1.7% punëdhënësi dhe 1.7% punëmarrësi. Nga ditari i pagesave rezultoi se vlera e përbashkët e këtyre 2 llogarive është 11.833,571 lekë dhe që përbën 16.7% nga punëdhënësi të pages bruto [1.7% sig.shend + 15% sig.shoq] nders 11.2 %

(9.5 %+1.7% ne total jane 4,195,341 të paguara nga punëmarrësi. Rezulton se llogaritë janë plotësuar në vlera të sakta dhe se ka informacion analitik për çdo llogari.

Nr.	Pagat Dhjetor 2022	Paga	Sig.Shop	Tatimi mbi page
1	Punonjesit e Bashkise në total	42,147,460	12,600,944	3,427,969

Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 61,600,632 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 137,194,411 lekë, gjendje e cila përfaqëson vlerën e garancisë 5% të vlerës totale të investimeve të bashkisë.
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", përfshin faturat e palikuiduara si detyrime ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të papaguara për mungesë fondesh. Gjendja në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 383,452,497 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 276,425,785 lekë me nje diference (-)l 07,026,712 lekë.

Lëvizjet e llogarisë 467	
Gjendja në 01.01.2022	383,452,497
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	55,261.950
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	112.676.179
Gjendja në 31.12.2022	276,425,785

Vet analiza e llog. 467 "kreditorë të ndryshëm" paraqitet si më poshtë:

Bashkia (aparati)

Emertimi	Gjendja 31.12.2021	shtesa viti 2022	paksime viti 2022	Gjendja në 31.12.2022
OSHE +uje	3,310,478.0		3,310,478.0	0
Filiali I Postes-Sha	40,810.0		40,810.0	0
Alb Telekomi	119,480.0		119,480.0	0
Nd.Ujesjellesit Kamez	385,734.0		385,734.0	0
Detyrime per shperblim lindje	8,961,000.0			8,961,000.0
Pagesa pastrimi dhjetor 2019	108,819,677.0	55,261,950.0	108,819,677.0	55,261,950.0
Totali	**121,637,179.0**	**55,261,950.0**	**112,676,179.0**	**64,222,950.0**

N.SH.P

Emertimi	Gjendja 31.12.2021	shtesa viti 2022	paksime viti 2022	Gjendja në 31.12.2022
Shpenzime per mirembajtjen e parqeve, tregjeve, parkingjeve dhe shesheve				585,600
Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave				120,000
Marrje me qera automjetesh F.1				151,000
Totali				**856,600**

N.P.GJ.T

Emertimi	Gjendja 31.12.2021	shtesa viti 2022	paksime viti 2022	Gjendja në 31.12.2022
Shpenzime per energji				583,656
Shpenzime per internet				8,400
Totali				**592,056**

Llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit", paraqitet me tepricë kreditore në vlerën 365,109,932 lekë në mbyllje të vitit 2022 dhe në vlerën 403,989,913 në mbyllje të vitit 2021 me një diferencë (pakësim) në vlerën 38,879,982 lekë; dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Vlera e saj është e barabartë me diferencën e të ardhurave me shpenzimet, që Bashkia Kamëz trashëgon për t'u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me Degën e thesarit Tiranë mbi fondet që trashëgohen.

Pasqyra Format 2 "Performanca financiare" dhe analiza e llogarive te të "Ardhurat" dhe "Shpenzimet"

Kjo pasqyrë ka rubrikën A – Të Ardhurat dhe Rubrikën B- Shpenzimet.

Nr. Llogarije	P E R S H K R I M IIOPERACIONEVE	VITI USHTRIMOR	VITI I MËPARSHËM
b	c	1	2
A	**TE ARDHURAT**	2,571,310,165	2,243,591,444
70	***I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET***	817,536,691	548,951,939
700	**1.Tatimi mbi te Ardhurat**	**32,500,129**	**5,812,702**
7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
7001	Tatim mbi Fitimin	0	74,141,328
7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	1,258,799	5,812,702
7009	*Te tjera Tatime mbi teardhurat*	0	0
702	**2.Tatimi mbi Pasurine**	**100,268,306**	**75,807,733**
7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	97,519,632	75,130,841
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshe	2,748,675	239,069
7029	Te tjera tatime mbi Pasurine	0	437,823
703	**3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit**	**684,635,056**	**467,261,304**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar(TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Takse mbi sherbimet specifike	0	0
7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	684,635,056	467,261,304
704	**4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare**	**0**	**0**
7040	Takse doganore per mallrat e importit	0	0
7041	Takse doganore per mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte	0	0
7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare	0	0
705	**5.Taksee rruges**	**0**	**0**
708	**6.Te tjera Tatime e Taksa kombëtare**	**133,200**	**70,200**
709	**7.Gjoba e Kamat vonesa**	**0**	**0**
75	***II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE***	**0**	**0**
750	NGA TE PUNESUARIT	0	0
751	NGA PUNEDHENESI	0	0
752	NGA TE VETPUNESUARIT	0	0
753	NGA FERMERET	0	0
754	NGA SIGURIMET VULLNETARE	0	0
755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE	0	0
756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE	0	0
71	***III.TE ARDHURA JO TATIMORE***	**232,394,076**	**237,144,392**

710	**1.Nga ndermarrjet dhe pronesia**	15,101,989	0
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare	0	0
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	15,101,989	0
711	**2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare**	**210,290,207**	
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	191,482,141	229,194,239
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	**8,223,670**	2,677,000
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale	0	0
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	0	0
7114	Te ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime ezhdemtime	10,584,396	3,284,486
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje	0	0
719	**3.Te tjera te ardhura jo tatimore**	**7,001,880**	**1,988,667**
76	***IV.TE ARDHURA FINANCIARE***	0	0
760	Nga interesat e huadhenies se brendshme	0	0
761	Nga interesat e huadhenies se Huaj	0	0
765	Nga interesat e depozitave	0	0
766	Nga kembimet valutore	0	0
72	***V.GRANTE KORENTE***	**1,521,379,397**	**1,457,495,113**
720	**1.Grant korent i Brendshëm**	**1,521,379,397**	
7200	Nga Buxhetiper NJQP(Qendrore)	0	0
7201	Nga Buxhetiper NJQP(Vendore)	1,052,462,437	1,298,020,663
7202	Nga Buxhetiper pagesa te posacme te ISSH		
7203	Nga Buxhetiper mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim I pritshem nga buxheti	463,420,529	154,981,908
7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	5,496,432	4,492,542
7209	Te tjera grante korente te brendshme	0	0
721	**2.Grant korent I Huaj**	**0**	**0**
	Nga Qeveri te Huaja		
	Nga Organizata Nderkombetare	0	0
	VI.TE ARDHURA TE TJERA	**0**	**0**
781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi	0	0
782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra	0	0
783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata	0	0
784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme	0	0
787	Terheqje nga seksioni Iinvestimeve	0	0
73	***VII. NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE***	**0**	**0**

Nga pasqyrat rezultojnë se rubrika e të "Ardhurave" paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,243,591,444 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,571,310,165 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 327,718,721 lekë që tregon për përmirësim të vjeljes së taksave e tarifave. Analiza e llogarive të të Ardhurave paraqitet si më poshtë vijon:

- <u>Llog. 70</u> "të ardhura nga taksa e tatime" paraqitet në bilanc të vitit 2022 në vlerën 817,536,691 lekë, e cila kuadron me akt rakordimin me thesarin;

Llog. 7002"tatim mbi biznesin e vogël" paraqitet në vitin 2022 në vlerën 1,258,799 lekë ;

Llog. 702 "Tatim mbi pasurinë" paraqitet në vitin 2022 në vlerën 100,268,306 lekë;

Llog. 703/5 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie" paraqitet në vlerën 684,635,056 lekë dhe përfaqëson taksën e pastrimit, taksën e gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj;

Llog. 708 "Te tjera tatime e taksa kombëtare"paraqitet në vlerën 133,200 lekë;
- **Llog. 71** "të ardhurat jotatimore" paraqitet në bilanc në vlerën 232,394,076 lekë.
Llog. 7109 "të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia" paraqitet në vlerën 15,101,989 lekë dhe përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe pyjet;
Llog. 711 "tarifë administrative dhe të ardhura sekondare" në vlerën 210,290,207 lekë, që përbëhet nga: **llog. 7110** "Tarifa administrative dhe rregullatore" në vlerën e 191,482,141 lekë, **llog. 7111** "të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh" në vlerën 8,223,670 lekë dhe **llog. 7115** "gjoba, kamatvonesa dhe zhdëmtime" në vlerën 10,584,396 lekë;
- **Llog. 72** "Grante korrente"/ **llog. 720** "Grant korrent i brendshëm" paraqitet në vitin 2022 në vlerën 1,521,379,397 lekë dhe përbëhet nga: **llog. 7201** "Nga buxheti për NJQP" në vlerën 1,052,462,437 lekë, **llog. 7206** "Financim i pritshëm nga buxheti" në vlerën 463,420,529 lekë dhe **llog 7207** "sponsorizime të brendshme" në vlerën 5,496,432 lekë;
Llog. 7206 "financim i pritshëm nga buxheti" në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 463,420,529 lekë , e cila kuadron me shumën e gjendjes së llog. 4342 "operacione me shtetin (të drejta)"

Rubrika B –SHPENZIMET

B	SHPENZIMET	2,206,200,232	1,839,601,531
600	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**583,940,550**	**447,783,723**
6001	Paga, personel i përhershëm	583,940,550	447,783,723
6002	Paga personel i Përkohshëm		
6003	Shpërblime		
6009	Shpenzime të tjera për personelin		
601	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**94,883,633**	**71,077,680**
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	85,501,408	64,057,174
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	9,382,225	7,020,506
602	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**299,445,659**	**277,530,986**
602	Mallra dhe sherbime të tjera	0	0
6020	Materiale zyre e të përgjithëshme	23,203,216	14,219,320
6021	Materiale dhe shërbime speciale	15,214,346	11,823,973
6022	Sherbime nga të tretë	184,592,397	198,261,954
6023	Shpenzime transporti	18,601,084	12,466,925
6024	Shpenzime udhetimi	8,016,910	0
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	6,784,620	5,569,636
6026	Shpenzime për qeramarrje	9,823,910	9,442,865
6027	Shpenzime për detyrime për kompësime legale	15,852,363	9,343,500
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime te tjera operative	17,356,813	16,402,813
603	**IV.SUBVECIONE**	**0**	**0**
6030	Subvecione për diference çmimi		
6031	Subvecione për të nxitur punësimin		
6032	Subvecione për të mbuluar humbjet		
6033	Subvecione për sipërmarrjet individuale	0	0
6039	Subvecione të tjera	0	0
	V.TRANSFERIME KORENTE	1,288,729,658	1,046,852,621
604	**1.Transferime korente të brendshme**	**10,286,800**	**103,110,660**
6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë	0	75,497,547
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	1,473,800	729,000
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetsore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	8,813,000	26,884,113
605	**2.Transferimekorenteme jashte**		
6051	Transferime për Organizatat Ndërkombetare	0	0
6052	Transferime për Qeveritë e Huaja	0	0
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurese të huaja	0	0

6059	Transferime të tjera korrente me jashtë shtetit		
606	**3.Transferimeper Buxhetet familjare e Individe**	**1,278,442,858**	**943,741,961**
6060	Transferta te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,278,442,858	943,741,961
	VI.SHPENZIME FINANCIARE		0
65	**1.Shpenzime Financiare te brendshme**		
650	Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte		0
651	Interesa për huamarrje te tj. Brendshme		
652	Interesa Letra tjera vlerë Qeverisë		0
656	Shpenz.nga kembimet valutore		0
66	**2.Shpenzime Financiare te jashtme**		0
660	Interesa për huamarrje nga Qeveritë e Huaja	0	0
661	Interesa për financime nga Institucionet ndërkombëtare	0	0
662	Interesa për huamarrje të tjera jashtme	0	0
	VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	0	0
681	Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytezimit	0	0
682	Vlera e mbetur e AAGJ, të nxjerra jashtë përdorimit e të shitura	0	0
683	Shuma të parashikuara të shfrytëzimit	0	0
686	Shuma të parashikuara për aktivet financiare	0	0
63	***VIII. NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT***	**-60,799,268**	-3,643,479
	IX. SHPENZIME TE TJERA	0	0
85	**TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES**	365,109,932	403,989,913
	(Rezultati i Veprimtarise se vitit Ushtrimor)		

- **Llog. 600** "paga dhe përfitime e punonjësve" paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 583,940,550 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përbëhet nga "paga personeli i përhershëm", "shpërblime".
- **Llog. 601** "kontribute të sigurimeve" në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 94,883,633 lekë , kurezulton e pasqyruar ne dy llogari te veçanta (sigurime shoqerore dhe sigurime shendetsore)pasqyruar në llog. 6010 "kontribut i sigurimeve shoqërore" ne vlerën 85,501,408 lekë dhe llog. 6011" kontribut i sigurimeve shëndetsore" ne vlerën 9,382,225 lekë ;
- **Llog. 602** "blerje mallra e shërbime" në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 299,445,659 lekë dhe përbëhet nga vlerat e llogarive si më poshtë:

Llog. 6020 "materiale zyre të përgjithshme" në vlerën 23,203,216 lekë;
Llog. 6021 "materiale dhe shërbime speciale" në vlerën 15,214,346 lekë;
Llog. 6022 "shërbime nga të tretë" në vlerën 184,592,397 lekë;
Llog. 6023 "shpenzime transporti" në vlerën 18,601,084 lekë;
Llog. 6024 "shpenzime udhëtimi" në vlerën 0 lekë;
Llog. 6025 "shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme" në vlerën 14,801,530 lekë;
Llog. 6026 "shpenzime për qiramarrje" në vlerën 9,823,910 lekë;
Llog. 6027 "Shpenzime per detyrime per kompensile legale" në vlerën 15,852,363 lekë;
Llog. 6029 "shpenzime të tjera operative" në vlerën 17,356,813lekë.

Konstatim. Nga verifikimet e llogarive të vlerave të bilancit rezultoi që në bilancin e konsoliduar tek nënllog. 6024 "udhëtim e dieta" është rregjistruar (lapsus) vlera 8,016,910 lekë që i përket nënllog. 6025 "shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme", vlerë e cila tek bilanci i vetë Ndërmarrjes së pastrim gjelbërim e treg (NPGJT) është rregjistruar në nënllogarinë e saktë (6025), dhe gabimi është bërë gjatë transferimit të inforM onit për hartimin e bilancit të konsoliduar. Por kjo nuk ka ndikuar në vlerën totale të llog. 602 "mallra e sherbime".

- **"Transferime korrente"/ llog. 606** " transferime për buxhetet familjare e individë" në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 1,278,442,858 lekë; ku përbëhet nga llog. 6061 që përfshin: pagesat për PAK, Ndihmë ekonomike, Ndihmë raste emergjente e të ndryshme, ndihmë për fatkeqesi natyrore, bonus qiraje për të pastrehë etj,.

- **Llog. 63** "ndryshimi i gjendjes së inventarit" në vlerën (-) 60,799,268 lekë, e cila është e barabartë me diferencën e klasës 3 të formatit 1 të bilancit;
- **Llog. 85** "teprica ose deficiti i periudhës (rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor)" në vlerën 365,109,932 lekë, vlerë e cila rakordon me diferencën mes të ardhurave dhe shpenzimeve.
- **Formati 5** "shënime shpjeguese" është plotësuar korrekt sipas rubrikave përkatëse;
- **Formati 8** "numri i punonjësve dhe fondi i pagave" është plotësuar saktë, duke dhënë një pasqyrim të plotë të shpërndarjes së fondit të pagave sipas kërkesave të formatit.

Ku tek Formati 8 i bilancit Fondi i pagave gjithsej është i barabarte me llog 6001 Paga personeli te Formati 2 i Bilancit;
Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore te Formati 8 i Bilacit është i barabartë me pagesat e kryera për këtë llogari që janë të pasqyruara në evidencën e realizimit të shpenzimeve me thesarin si dhe është pasqyruar në ditarin e bankës (llog. 435+llog. 436).
Tatimi mbi të ardhurat te Formati 8 i Bilacit është i barabartë me pagesat e kryera për këtë llogari që janë të pasqyruara në evidencën e realizimit të shpenzimeve me thesarin si dhe është pasqyruar në ditarin e bankës (llog. 431).

Nr	Numri Mesatar Vjetor I Punonjseve	NUMRI I PUNONJSEVE			FONDI I PAGAVE DHE KONTRIBUTET					
		Ndryshuar gjate vitit								
		Pranu ar Te rinj	Larguar	Gjendje Fund te vitit 2022	Fondi pagave gjithesej	Shperblime suplementar	Ndihma Shoq.te menjehersh me	Kontributi sig.shoq.& shendetesor e	Shperbl ime Te tjera	Tatimi mbi te ardhurat
a	**b**	**1**	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**
	Nr.i punonjseve gjithesej (1+2+3+4+5)	399	54	1,006	583,940,550	0	0	153,701,125	0	32,141,975
1	D r e j t u e s	6	2	52	51,549,628	0	0	14,285,301	0	5,062,638
2	Spec.arsim te larte	105	9	422	294,615,185	5	6	90,055,371	0	22,128,035
3	T e k n i k e	4	0	7	4,558,829	0	0	1,271,913	0	365,196
4	Nepunes te thjeshte	113	13	222	103,774,102	0	0	16,077,269	0	2,271,390
5	Punetore	171	30	303	129,442,806	0	0	32,011,270	0	2,314,716
6	Punonjes te perkohshem	0	0	0		0	0		0	0

Nga auditimi i listëpagesave e periudhës janar-dhjetor 2022 (borderotë), rezultuan konform rregullave të përcaktuara, të cilat plotësohen mbi bazën e listëprezencave mujore të hartuara dhe të nënshkruar nga menaxherët e secilës njësi të strukturës, nga menaxheri i burimeve njerëzore është hartuar përmbledhësja mujore e nënshkruar edhe nga Kryetari i bashkisë, në përputhje me ligjin 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës" i ndryshuar.
- Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit mbi sigurimet shoqërore të punonjësve në Bashkinë Kamëz, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8434 datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat"i ndryshuar, ligjit nr. 9136 datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetsore në RSH";
- Sipas listëpagesave është zbatuar struktura konform vendimeve të miratuara;
- Listëpagesat janë të nënshkruara nga specialistja e pagave dhe drejtori i Financës;
- Eshtë përgatitur përmbledhësja e listëpagesave me nënshkrimin e Drejtorit të Financës dhe Kryetarit të Bashkisë;

Titulli i gjetjes: *Mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare*

Situata: I. *Pasqyra Format 1 "Pasqyra e Pozicionit Financiar" - Aktivet & Pasivet*
Pasqyra Format 7/a,b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historikedhe vlera neto)
1. Nga analiza e llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" rezulton se referuar klasifikimit ekonomik kontabël/nomenklaturës së llogarive të planit kontabël, ka të listuar objekte

inventare të klasifikuara gabim, të cilat janë: në inventarin e Bashkise Kamëz - "Ndërtim lulishte para pallatit të kulturës" viti i krijimit 2011 dhe kosto historike 3,492,744, "Lulishte te Bashkia" vit krijimi 2012 dhe kosto historike 300,793; NJA Paskuqan - "Lulishte para komunës Paskuqan" me kosto historike 478,946 dhe "Gjelberim ambienti në Paskuqan nr. 2" me kosto historike 240,000 të cileve u mungon viti i krijimit si aktiv, duhej të ishin regjistruar në llog. 212 ose llog. 211 në varësi të asaj çfarë përfaqëson secili rast (lulishte apo pyje /kullota). Pra në total vlera e regjistruar gabim në llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" është në shumën 4.512,483. Pra llog.213 është mbivlerësuar në vlerën 4,512,483 dhe llog.212 dhe llog 211 janë nënvlerësuar respektivisht për shumën 4,272,483 dhe 240,000. Duhet theksuar fakti që vlera neto kontabël e secilit aktiv në veçanti nuk ndryshon, pasi koeficenti i amortizimit në këtë rast është i njëjtë me 5%;

2. Nga analiza e llog. 218 "inventar ekonomik" rezultoi se, kategoria "pajisje kompjuterike" nisur nga karakteristikat specifike të aktivit, nuk është ndarë si kategori më vete llog. 218/1, duke pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit. Por nga verifikimi i analizës se llogarisë dhe rregjistrit të inventareve rezultoi se llogaritja e amortizimit për pajisjet kompjuterike është llogaritur saktë prej 25% të vlerës së mbetur.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar; Ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 "Për proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022; UMF nr. 26, dt. 27.12.2007"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj"; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 "Për miratimin e planit kontabël"; UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për sponsporizimet", i ndryshuar me ligjin nr.8282, datë 21.01.1998, ligjin Nr. 9040, datë 27.03.2003 dhe ligjin Nr. 9807, datë 20.09.2007; VKM nr. 500, datë 14.08.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore"; VKM nr. 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" i ndryshuar;VKM nr. 610, datë 24.07.2013 "Për miratimin e shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin";VKM nr. 165, datë 02.03.2016 "Për grupimin e Njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore"; Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"; Ligjit nr.10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Udhëzimi nr. 21/2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve"; Udhëzimin nr.16, datë 20.07,2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike

Ndikimi/Efekti: Mosklasifikim i disa vlerave në llogaritë përkatëse sipas klasifikimit kontabël ka ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me rakordimin aktiv-pasiv të bilancit dhe jo vetëm, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara;

Shkaku: Kontabilizim i gabuar në 2 raste në llogari apo në vlerë të llogarive nga ana e Sektorit të financës në llogaritë e pasqyrave financiare;

Rëndësia: E mesme

3.4 Auditim mbi administrimin e aseteve, proçedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në ASHK

I. Drejtimet kryesore të auditimit mbi proçedurën e inventarizimit janë:
- Njohja dhe zbatimi i Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 për marrjen e masave të nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi;
- Përgjegjësia e Titullarit të Njësisë Publike (Kryetari i Bashkisë) në cilësinë e NA, për miratimin e rregullave specifike dhe proçedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kerkesat e këtij udhëzimi;
- Përgjegjësia e Nëpunësit zbatues NZ dhe menaxherëve të të gjitha niveleve të Njësisë Publike mbi aktivet e njësisë;
- Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve në Bashkinë Kamëz

Në zbatim të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:
- Baza rregullatore mbi të cilën ushtron funksionet e saj Bashkia Kamëz: Rregullorja e brendshme e miratuar, Rregullore për Menaxhimin e Aktiveve (nëse ka), Manuali i Proceseve të Punës (nëse ka), Manuali i Parandalimit të Konfliktit të Interesit,etj
- Strukturën organizative dhe organigramën e institucionit me ndryshimet për vitin 2022; dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
- Shkresat e përcaktimit të NA dhe NZ në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Shkresat për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik [GMS]; planin vjetor dhe procesverbalet e takimeve;
- Strategji dhe Regjistër Risku; Regjistri i Aseteve të Bashkisë Kamëz.

Nga auditimi i dokumentacionit të venë në dispozicion nga Bashkia Kamëz, në përgjigje të kërkesave të përshkruara më lart lidhur me Proçedurën e inventarizimit të aktiveve, grupi i auditimit referuar Udhëzimit nr. 30 date 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë publike", të gjitha njësitë e sektorit publik kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.
Nga auditimi në Bashkinë Kamëz, u kërkuan praktikat e proçedurave të inventarizmit për vitet 2021 dhe 2022.
1. Referuar Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", praktika e proçedurës së Inventarizimit përmban:
- Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e NA për krijimin e komisioneve të verifikimit fizik, vlerësimit dhe asgjesimit të aktiveve; *[zbatuar]*
- Përmbledhëse Inventare të 5(pesë) Njësive Administrative: në llogaritë 327, 218, 214, 212, 215; *[zbatuar]*
- Relacioni ose Raporti përmbyllës përpiluar dhe nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të Verifikimit Fizik dhe vlerësimit paraprak të Inventareve; *[zbatuar]*
- Bazuar në Raportin e Komisionit të verifikimit fizik të inventareve, vijohet me Komisionin e vlerësimit të vlerave materiale për asgjesim; *[zbatuar]*
- Komisionin e asgjësimit të vlerave materiale, zbatimi i proçedurave të tyre monitorohen nga NZ; *[Pjesërisht zbatuar]*
2. Praktika shkresore për ngritjen e komisioneve për dy vite 2021 dhe 2022 dhe statusi i çdo faze të proçedurës së Inventarizimit të Bashkisë Kamëz, Njësisë Qendrore Administrative dhe Njësisë Administrative Pakuqan është si më poshtë vijon:

Viti	Urdhrat Brendshëm Komisionet e Inventarit Fizik	Urdhrat Brendshëm Komisionet eVlerësimit	Relacioni	Urdhrat Brendshëm Komisionine Asgjesimit	Relacioni	Vlera e aktiveve vlerësuar asgjesim	Statusi Proçedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit
2021	UB. 600 dt. 15.11.2021		-	UB. 601 dt. 18.11.2021	-	-	**Pjesërisht zbatuar**
2022	UB. 914 dt. 24.11.2022		R. nr.149 dt. 19.12.2022	UB. 915 dt. 24.11.2022	R.12008 dt. 31.12.2022	**25,454,246 lekë**	**Pjesërisht zbatuar**

Punuar: Grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit që iu vu në dispozicion grupit të auditimit, një përmbledhje inforM oni të detajuar të praktikës së proçedurës së inventarizimit, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Viti	Anëtarët e Komisioneve	Objekt Inventarizimi	Nr. Anëtare	Vlerësimi mbi zbatimin/statusi
2021 I-II	**Komisioni i Inventarit Fizik dhe i Vlerësimit të Aktiveve**			
●	**Kryetari i Komisionit**	**Bashkia dhe NJA Paskuqan**	**1**	UB. 600 dt.15.11.2021
	V.S			
●	**Anëtarët e Komisionit**	**Objekte Inventarizimi**	**4**	Realizuar
	L.M	Zyrat		
	F.P	Shkollat		
	D.B	Kopshte & çerdhe		
	B.H	Qendra Kulturore		
		Zyrat e lagjeve		
III	**Komisioni për Nxjerrje Jashtë Përdorimit**			
●	**Kryetari i Komisionit**		**1**	UB. 601 dt. 15.11.2021
	A.P			
●	**Komisioni për jashtë përdorimi**			
	M.A			Realizuar
	U.E			
	A.C			
	SH.K			
IV	**Komisioni për Ekzekutim/asgjesim të Aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit**			
	Nuk ka			**Nuk ka**
2022 I -II	**Komisioni i Inventarit Fizik dhe i Vlerësimit të Aktiveve**			UB. 914 dt. 24.11.2022
●	**Kryetari i Komisionit**	**Bashkia dhe NJA Paskuqan**		
	V.S			Realizuar
●	**Anëtarët e Komisionit**	**Objekte Inventarizimi**		
	SH.K	Zyrat	**3**	
	A.P	Shkollat		
	H.N	Kopshte & çerdhe		
	M.G	Qendra Kulturore	**3**	
		Zyrat e lagjeve		
III- IV	**Komisioni për Nxjerrje Jashtë Përdorimit & Komisioni për Ekzekutim/asgjesim të Aktiveve**			
●	**Kryetari i Komisionit**		**1**	UB. 915 dt. 24.11.2022
	A.D			
●	**Anëtarët e Komisionit**		**4**	Joe plotë

	D.N			
	L.M			
	E.E			
	F.U			
	Nuk ka			**Nuk ka**

Burimi: Bashkia Kamëz/Punoi: Grupi i auditimit

Nga sa më lart rezulton se komisionet e inventarizimit plotësojnë kriteret e Udhëzimit 30/2011 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" pikat 6,;

- Bashkia Kamëz ka hartuar dhe miratuar Rregullore "Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe "*Strategjia e menaxhimit të riskut të Aktiveve të Bashkisë Kamëz*" miratuar me VKB nr. 36 datë 20.03.2020, konform Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" pikat 6,7,8,9;
- Nxjerrja e aktiveve të dëmtuara për jashtë përdorimit/asgjesimit, është miratuar me VKB nr. 168 datë 21.12.2022 dhe nr. 195 prot., datë 21.12.2022 "Për miratimin e efekteve financiare ekonomike të nxjerrjes jashtë përdorimit të pajisjeve me vlerë 21,071,255 lekë dhe të materialeve me vlerë 4,382,991 lekë";
- NZ ka ndjekur përmbylljen e procesit të inventarizimit për vitin 2022, duke hartuar përmbledhsen e inventareve për llog. 214, llog 218, llog. 327, si dhe regjistrin e aktiveve afatgjata për llog. 202, llog 212, llog. 213, llog 215.

Konstatim: Urdhrat e Brendshëm të titullarit nuk kanë të përcaktuar afatin për përmbushjen e detyrës nga ana e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, duke riskuar për vonesa dhe zvarritje të proçedurës së inventarizimit, në moszbatim të Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" pika 73, 74;

Për asgjesimin e aktiveve të vlerësuara të dëmtuara konform pikës 101 të kreut IV të Udhëzimit nr. 30/2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", nga ana e titullarit të bashkisë nuk ka dalë asnjë akt administrativ i cili në vijimësi të akteve për proçedurën e inventarizimit për vitin ushtrimor 2022, të përcaktonte edhe *vendndodhjen* ku do të asgjesoheshin aktivet e vlerësuara *të dëmtuara për asgjesim*, në varësi të llojit dhe destinacionit të tyre. Meqënëse as në rregulloren "Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve*" nuk është përcaktuar* si kriter, në asnjë nen të veçantë apo në nenet 9 e 9/1 të saj.

Konstatim: Komisionet e krijuara me Urdhrin e Brendshëm të titullarit për asgjesimin e aktiveve të vlerësuara për asgjesim/ shkatërrim të tyre, në Relacionin nr. 12008 datë 31.12.2022, nuk kanë përcaktuar vendndodhjen ku janë asgjesuar aktivet e dëmtuara të vlerësuara për asgjesim si dhe krijuar dokumentin vërtetues të kësaj etape të proçedure (fotografuar procesin e ekzekutimit të tyre), në moszbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" pika 103, 107, 108, 109, 111 dhe 118;

- Bashkia Kamëz për vitin 2022 (dhe vitet paraardhëse) ka realizuar Inventarizimin e aktiveve të njësisë
duke mos i përmbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore *lidhur me ekzekutimin e nxjerrjes jashtë përdorimit*.;
- Grupi i Menaxhimit Strategjik funksionon pa hartuar nje plan vjetor dhe grafik takimesh
- Bashkia Kamëz *nuk ka përmbyllur proceset* e Inventarizimit dhe *hartimin* e regjistrit të aktiveve të
njësisë për ato të përftuara me VKM.

II. Inventarizimi i AAGJM dhe ndjekja e proçedurave për pajisjen me titull pronësie të tyre.

Bashkia Kamëz ka hartuar regjistrin e aktiveve për vitin 2022, të klasifikuar sipas llogarive përkatëse.

Qarku Tiranë	Bashkia Kamëz	NJA Kamëz	Kamëz, Bathore, Laknas, Valias, Frutikulturë, Bulçesh, Zall Mner	Sip= 37.18m²
		NJA Paskuqan	Paskuqan, Babrru Qëndër, Kodër Kuqe, Shpat, Fushë Kërçikëve, Kodër Babrru, Paskuqan Fushë, Paskuqan Kodër	Nr. popullsisë v.2022=145,851

Struktura përgjegjëse në Bashkinë Kamëz për menaxhimin e aseteve, me vendimin nr. 262 datë 15.03.2022 dhe me nr. 262 prot., dt.15.03.2022 është krijuar Drejtoria e Menaxhimit të Tokës Përmirësimit në Mjedis, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave (DMTPMBKPK)

Struktura e DMTPMBK/Pozicioni	Emër	Mbiemër	Profili Arsimor
Drejtori	-	-	-
Përgjegjësi MTPM	D.	S.	Ing.Mjedisi
Specialist MTPM	H.	D.	Drejtësi
Specialist MTPM	-	-	-
Specialist MTPM	M.	H.	Agronomi
Specialist MTPM	E.	S.	Prodhim Bimor
Përgjegjësi i BK	F.	S.	Mësuesi&Drejtësi
Specialist i BK	H.	H.	Agronomi
Punonjës i BK & Pyjeve	R.	K.	Ing.Pyjesh
Specialist Jurist i MTPM	E.	M.	Drejtësi & Adm. Publik

Burimi: DBNJ/Bashkia Kamëz

Konstatim: *Deri më 31.12.2022* nga ana e Bashkisë Kamëz nuk rezulton të jetë bërë verifikim në terren dhe vlerësim për të gjitha asetet e Bashkisë. Rezulton se janë pajisur me titull pronësie vetëm 6 objekte ("4 objekte "truall", 1 objekt "truall + godinë" dhe 1 objekt "godinë") për të cilat nuk është bërë vlerësim. Referuar VKM nr. 775 datë 05.09.2013 "*Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të Qarkut të Tiranës*", situata deri në 31.12.2022 lidhur me administrimin, menaxhimin apo përdorimin e aseteve është si më poshtë:

Numri i Pronave sipas listës	Nr. Rendor në listë Në pronësi	Nr	Destinacioni i përdorimit	Nr. rendor në listë përdorim	Nr	Destinacioni i përdorimit
1809	12	1	Për programe në fushën arsimore	83,84, 101-742	644	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave apo objekteve të çdo lloji
	20-24	5	Për programe në fushënb kulturore e sportive			
	41	1	Për varrezt publike			
	42, 72-82, 85-100, 756-940	213	Infrastrukturë(sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)			
	941-951	11	Për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës kanalizimeve			
	43-52, 55, 62-71, 743, 744, 751, 755, 1447-1634	213	Për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit(toka jo produktive dhe kanale të treta			
	1635	1	Sistemi i transformimit dhe shpërndarjes së energjisë			

			elektrike Bashkia Kamëz			
	1636	1	Burime ujore në territori të bashkisë kamëz			
	1637, 1638	2	Burime natyrore dhe minerare			
	1639-1644	6	Bujqësi dhe uhqim			
	1645-1809	165	Prona të veçanta			

- Me Urdhrin e kryetarit nr. 351 datë 06.06.2023 me nr. 351 prot., datë 06.06.2023 "Ngritjen e grupit të punës për verifikimin, saktësimin, inventarizimin, plotësimin dhe përditësimin e pronave shtetërore të transferuara me VKM në pronësi ose përdorim të Bashkisë Kamëz, si dhe pronave që nuk janë transferuar me VKM", në referim dhe zbatim edhe të rekomandimeve të lëna nga KLSH në RPA.

Nr	Anëtarët e Grupit punës	Profili Arsimor	Pozicioni në strukturën organizative
1	O.Y	Inxhinier Gjeodet	Specialist Sektori i kadastrës
2	M.H	Agronomi e përgjithshme	Specialist Sektori i kadastrës
3	E.O	Juriste	Jurist, Sektori i BKPK
4	H.H	Agronomi /ekspert mjedisi & pyje	Specialist Sektarori i BKPK
5	R.K	Inxhinieri pyjesh	Specialist Sektarori i BKPK

Nga verifikimi i inforM onit që grupit të auditimit iu vu në dispozicion nga Drejtoria e MTPM & Bordi i kullimit në Bashkinë Kamëz, lidhur me pronat që ka në pronësi dhe përdorim të përftuara me VKM nr. 317 datë 10.06.1995 dhe VKM nr. 775 datë 05.09.2013, rezultoi si më poshtë:

Pronat e Bashkisë Kamëz të verifikuara nga Grupi i Punës viti 2023						
Njesite Administrative/fshatra	Pronesi	Proces certifikimi	Perdorim	NA	Totali për Njesi	Totali i pronave
Kamëz	14	1	449		794	
Laknas	4	6	16		91	
Valias	8	6	4		35	
Frutikulturël	1		141		143	
Bulçesh	1				2	
Bathore	4		35		39	
Zall Mner	1				2	
Paskuqan	10				10	
Babrru	3				3	
Totali	**46**	**13**	**645**	**415**	**1119**	**1809**

Punoi: Grupi i auditimit

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimit verbal **rezultoi** se deri në 31.12.2022 Bashkia Kamëz nuk ka marrë masa konkrete për verifikimin në terren të të gjitha pronave dhe regjistrimin e tyre sipas statusit aktual juridik dhe destinacionit të përdorimit, por verifikimet kanë qenë sporadike të paprogramuara sipas një grafiku; ndërsa me daljen e Urdhrit të Kryetarit, grupi i punës gjatë vitit 2023 ka arritur të verifikojë në terren 1,119 prona nga 1,809 që janë gjithsej.

- Si rezultat i rekomandimeve të lëna nga KLSH në RPA, në vitin 2023 u morrën masa për verifikimin dhe regjistrimin e të gjitha pronave të kaluara në pronësi apo përdorim me VKM në Bashkinë Kamëz. Grupi i punës është në proces verifikimi në terren dhe klasifikimit të tyre sipas gjendjes aktuale.

Për ato prona të cilave iu janë përbyllur proçedura e marrjes së titullit të pronësisë, po i nënshtrohen procesit të vlerësimit, për tu kontabilizuar nga Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit.

Konstatim: Bashkisë Kamëz së bashku me njësitë Administrative (ish komunat) i kanë kaluar në pronësi gjithsej 1,809 prona me Vendime të Këshillit të Ministrave dhe si pjesë e reformës, të cilat nuk janë pajisur me dokumentin e pronësisë të regjistruar në ish-ZVRPP-në Kamëz sot ASHK. Proçedura e pajisjes me Certifikatë pronësie nga ASHK shoqërohet edhe me vlerësimin e secilit objekt, vlerë e cila pas rregjistrimit në ASHK regjistrohet në regjistrin e aktiveve afatgjata të Bashkisë me vlerën e saj kontabël si dhe kontabilizohet në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse 210 "toka, troje, terrene", 211 "pyje, kullota, plantacione", dhe 212 "godina e konstruksione" (sipas klasifikimit). Deri në 31.12.2022 këto objekte nuk kanë patur një vlerë kontabël, dhe si të tilla *nuk janë pasqyruar në kontabilitet*. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar; Ligji nr. 8743/2001 "*Për pronat e paluajtshme të shtetit*" i ndryshuar me Ligjin nr. 9558/2006; Ligjin nr. 33/2012 "*Për regjistrimin e pronave të paluajtshme*" i ndryshuar me Ligjin nr. 9/2016, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 për "*Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore*" (i ndryshuar).

Konkluzion: Regjistrimi i aseteve të Bashkisë dhe Proçedura e Inventarizimit të Aktiveve.

1. Urdhrat e Brendshëm të titullarit nuk kanë të përcaktuar afatin për përmbushjen e detyrës nga ana e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, duke riskuar për vonesa dhe zvarritje të proçedurës së inventarizimit, në moszbatim të Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" pika 73,

2. Komisionet e krijuara me Urdhrin e Brendshëm të titullarit për asgjesimin e aktiveve të vlerësuara për asgjesim/shkatërrim të tyre, në Relacionin nr. 12008 datë 31.12.2022, nuk kanë përcaktuar vendndodhjen ku janë asgjesuar aktivet e dëmtuara të vlerësuara për asgjesim si dhe dokumentin vërtetues (fotografuar) të procesit të ekzekutimit të tyre, në moszbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" pika 103, 107, 108, 109, 111 dhe 118;

3. Bashkia Kamëz ka hartuar dhe miratuar Rregullore "Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe "*Strategjia e menaxhimit të riskut të Aktiveve të Bashkisë Kamëz*" miratuar me VKB nr. 36 datë 20.03.2020. Nga auditimi rezultoi se në nenet 9 dhe 9/1 nuk është vendosur si kriter përcaktimi në procesverbalin që mbahet nga komisioni i *vendndodhjes* ku do të kryhet ekzekutimi i vendimit për asgjesimin e aktiveve për jashtë përdorimit. Në moszbatim kjo të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" pika 103, 107, 108, 109, 111 dhe 118.

4. Lidhur me asetet e transferuara me VKM në Bashkinë Kamëz rezultoi se deri në 31.12.2022 Bashkia Kamëz nuk ka marrë masat për verifikimin në terren të pronave dhe regjistrimin e tyre sipas statusit aktual juridik dhe destinacionit të përdorimit.

Kjo proçedurë nga ana e Bashkisë ka nisur mbas dërgimit të RPA të KLSH-së. Kështu me Urdhrin e kryetarit nr. 351 datë 06.06.2023 me nr. 351 prot., datë 06.06.2023 për "Ngritjen e grupit të punës për verifikimin, saktësimin, inventarizimin, plotësimin dhe përditësimin e pronave shtetërore të transferuara me VKM në pronësi ose përdorim të Bashkisë Kamëz si dhe pronave që nuk janë transferuar me VKM".

5. Bashkisë Kamëz së bashku me njësitë Administrative (ish komunat) i kanë kaluar në pronësi gjithsej 1,809 prona me Vendime të Këshillit të Ministrave dhe si pjesë e reformës, të cilat nuk janë pajisur me dokumentin e pronësisë të regjistruar në ish-ZVRPP-në Kamëz sot ASHK. Proçedura e pajisjes me Certifikatë pronësie nga ASHK shoqërohet edhe me vlerësimin e secilit objekt, vlerë e cila pas rregjistrimit në ASHK regjistrohet në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël si dhe kontabilizohet në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse 210, 211 dhe 212 (sipas klasifikimit). Deri në 31.12.2022

këto objekte nuk kanë patur një vlerë kontabël, dhe si të tilla *nuk janë pasqyruar në kontabilitet*.
Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar; Ligji nr. 8743/2001 "*Për pronat e paluajtshme të shtetit*" i ndryshuar me Ligjin nr. 9558/2006; Ligjin nr. 33/2012 "*Për regjistrimin e pronave të paluajtshme*" i ndryshuar me Ligjin nr. 9/2016, VKM nr. 500/2001 datë 14.08.2001 për "*Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore*" (i ndryshuar).

Titulli i gjetjes: *Mbi proçedurën e Inventarizimit të aktiveve.*

Situata: 3. Urdhrat e Brendshëm të titullarit nuk kanë afat për përmbushjen e detyrës nga ana e komisionit të inventarizimit, duke duke riskuar për vonesa dhe zvarritje të proçedurës së inventarizimit, në moszbatim të Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" pika 73, 74;

4. Bashkia Kamëz ka hartuar dhe miratuar Rregullore "Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe "Strategjia e menaxhimit të riskut të Aktiveve të Bashkisë Kamëz" miratuar me VKB nr. 36 datë 20.03.2020. Nga auditimi rezultoi se në nenet 9 dhe 9/1 nuk është vendosur si kriter përcaktimi në procesverbalin që mbahet nga komisioni i *vendndodhjes* ku do të kryhet ekzekutimi i vendimit për asgjesimin e aktiveve për jashtë përdorimit, gjë e cila u konstatua edhe në procesverbalin e përpiluar nga komisioni i asgjesimit. Në moszbatim kjo të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" pika 103, 107, 108, 109, 111 dhe 118;

5. Lidhur me asetet e transferuara me VKM në Bashkinë Kamëz rezultoi se deri në 31.12.2022 Bashkia Kamëz nuk ka marrë masat për verifikimin në terren të pronave dhe regjistrimin e tyre sipas statusit aktual juridik dhe destinacionit të përdorimit. Kjo proçedurë nga ana e bashkisë ka nisur mbas dërgimit të RPA të KLSH-së. Kështu me Urdhrin e kryetarit nr. 351 datë 06.06.2023 me nr. 351 prot., datë 06.06.2023 për "Ngritjen e grupit të punës për verifikimin, saktësimin, inventarizimin, plotësimin dhe përditësimin e pronave shtetërore të transferuara me VKM në pronësi ose përdorim të Bashkisë Kamëz si dhe pronave që nuk janë transferuar me VKM", ka rezutuar me verifikimin e 1,119 pronave nga 1,809 në total.
- Bashkisë Kamëz së bashku me njësitë Administrative (ish komunat) i kanë kaluar në pronësi gjithsej 1809 prona me Vendime të Këshillit të Ministrave dhe si pjesë e reformës, të cilat deri në 31.12.2022 nuk janë pajisur me dokumentin e pronësisë të regjistruar në ish-ZVRPP-në Kamëz sot ASHK Vorë Kamëz. Proçedura e pajisjes me Certifikatë pronësie nga ASHK shoqërohet edhe me vlerësimin e secilit objekt, vlerë e cila pas rregjistrimit në ASHK regjistrohet në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël, si dhe kontabilizohet në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse- 210 "toka, troje, terrene", 211 "Pyje, kullota, plantacione" dhe 212 "Ndërtime e konstruksione" (sipas klasifikimit). Deri në 31.12.2022 këto objekte duke mos patur një vlerë kontabël,*nuk janë pasqyruar në kontabilitetin e njësisë.* Për pasojë tre llogaritë kontabël të mësipërme, nuk paraqesin vlerën e tyre reale, për shkak të mungesës së 1,809 pronave.
Kriteri: Ligji nr.10296/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar; "Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin" miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016; Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"; Udhëzimi nr. 21/2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve"; Udhëzimin nr.16, datë 20.07,2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar

dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"; Ligji nr. 8743/2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar me Ligjin nr. 9558/2006; Ligjin nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pronave të paluajtshme" i ndryshuar me Ligjin nr. 9/2016. VKM Nr.500, datë 14.08.2001 "Mbi inventarizimin e pasurive të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore".

Impakti/Efekti: Nga Bashkia Kamëz deri në 31.12.2022 rezulton të mos jenë përmbushur detyrimet lidhur me proçedurën e inventarizimit veçanërisht të aktiveve të përftuara me VKM, gjë që riskon efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm mbi aktivet e njësisë.

Shkaku: Gjatë periudhës nën auditim Nëpunësi Autorizues, GMS me Koordinatorin MFK dhe Koordinatorin e Riskut dhe Nëpunësi Zbatues , nuk kanë treguar vëmendjen dhe përgjegjshmërinë e duhur në përmbushjen e detyrimeve ligjore/nënligjore lidhur me proçedurën e inventarizimit të të gjitha aktiveve të Njësisë.

Rëndësia: E mesme

Sa më sipër trajtuar, ngarkohen me përgjegjësi: (1) Z. R.S , Kryetar i Bashkisë; (2) Znj.V.S, Drejtore e DFK, (3) Z. E.B , Drejtor i DMTPMBK; (4) Z. A.D , në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Asgjësimit të Aktiveve në vitin 2022.

2.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

(2.4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve; -2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara; -2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit; 2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues)).

2.4.1.P rogramimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të ëteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

-Në mënyrë të përmbledhur realizimi i prokurimeve për periudhën e auditimit, 01.01.2022 deri 31.12.2022 rezultoi si më poshtë.

Në total, për periudhëm e auditimit **01.01.2022 – 31.12.2022** janë realizuar **139** procedura prokurimi me vlerën limit të kontratës **3,974,227,516.07** lekë pa TVSH dhe janë lidhur kontrata në vlerën **3,748,954,725.38** lekë pa TVSH ose **94.33** % e fondit limit të kontratës, respektivisht të ndara sipas buxhetit dhe llojit të prokurime, rezulton:

Prokurime nga buxheti i Bashkisë Kamëz.

Sipas llojit të procedurës:

- 35 (tridhjetë e pesë) procedura prokurimi e llojit "**E hapur**" me vlerën limit të kontratës **1,641,112,974** lekë pa TVSH dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **1,458,298,447** lekë pa TVSH ose **88.86** %, nga ku, sipas tipit të kontratës:

- **30 (tridhjetë)** procedura të tipit të kontratës "Për punë publike" me vlerën limit të kontratës **1,568,926,306** lekë pa TVSH dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **1,395,276,438** lekë pa TVSH ose **88.93** %.
- **5 (pesë)** procedura të tipit të kontratës "Mall" me vlerën limit të kontratës **72,186,668** lekë pa TVSH dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **63,022,009** lekë pa TVSH ose **87.30** %.

- 11 (njëmbëdhjetë) procedura prokurimi e llojit "**E hapur e thjeshtuar**" me vlerën limit të kontratës **45,856,330** lekë pa TVSH dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **25,442,994** lekë pa TVSH ose **55.48** %, nga ku, sipas tipit të kontratës:

- **1 (një)** procedura të tipit të kontratës "**Për punë publike**" me vlerën limit të kontratës **10,143,704** lekë pa TVSH dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **3,504,368** lekë pa TVSH ose **34.54** %.
- **7 (shtatë)** procedura të tipit të kontratës "**Mall**" me vlerën limit të kontratës **26,927,517** lekë pa TVSH dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **20,882,381** lekë pa TVSH ose **77.55** %.
- **3 (tre)** procedura të tipit të kontratës "**Shërbime**" me vlerën limit të kontratës **8,785,109** lekë pa TVSH dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **1,056,245** lekë pa TVSH ose **12.02** %.

Prokurime nga buxheti i Rindërtimit.

Sipas llojit të procedurës:

- 19 (nëntëmbëdhjetë) procedura prokurimi e llojit "**Marrëveshje kuadër**" me vlerën limit të negociuar të kontratës **2,262,349,307** lekë pa TVSH dhe vlera e kontraktuar është **2,243,480,308** lekë pa TVSH ose **99.16** %, nga ku, sipas tipit të kontratës:

- **7 (shtatë)** procedura të tipit të kontratës "**Për punë publike**" me vlerën limit të kontratës **1,836,651,003** lekë pa TVSH dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **1,387,498,124** lekë pa TVSH ose **75.54** %.
- **12 (dymbëdhjetë)** procedura të tipit të kontratës "**Shërbime**" me vlerën limit të kontratës **43,440,893** lekë pa TVSH dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **39,916,973** lekë pa TVSH ose **91.88** %.

Prokurime me blerje të vogla.

- 74 (shtatëdhjetë e katër) procedura prokurimi e llojit "**Blerje me vlerë të vogël**" me vlerën limit të kontratës **24,908,605,.07** lekë pa TVSH dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **21,732,976.38** lekë pa TVSH ose **87.25** %, nga ku, sipas tipit të kontratës:

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato elektronike marrë nga sistemi i APP, përzgjodhi për auditim **14** procedura prokurimi, ku në vijim popasqyrojmë situatat dhe Rekomandimet përkatëse mbi problematikat e konstatuara, si më poshtë:

Titulli i Gjetjes nr. 1*: Në zbatim të programit të auditimit u audituan procedurat e prokurimit publik ku u konstatua se **11 (njëmbëdhjetë)** procedura nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz dhe Njësia e Prokurimit, nuk janë respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik në hartimin e kritereve të përgjithshme të Pranim/Kualifikimit, në mos*

përpëthje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"të ndryshuar dhe, Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

1. Procedura e prokurimit me objekt: "***Rikonstruksion shkolla e mesme "Gramoz Palushi", Babrru, Njësia Administrative Paskuqan***".

Përshkrimi i situatës 1: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "*Rikonstruksion shkolla e mesme "Gramoz Palushi", Babrru, Njësia Administrative Paskuqan*" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion shkolla e mesme "Gramoz Palushi", Babrru, Njësia Administrative Paskuqan"*		
1. Urdhër Prokurimi Nr 8337 Datë 19.09.2022 REF- 42269-09-19-2022 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**I kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)" Marrveshe kuadër	**3.1 Njësia e Prokurimit** SH.XH S.S S.V	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** **Faza e parë:** Urdhër 8337/1 datë 19.09.2022 E.GJ , Kryetar F.M (zëvendësohet me H.M) L.M **Faza e dytë:** Urdhër 9500 datë 17.10.2022 E.GJ , Kryetar H.M
5. Fondi Limit (pa tvsh) 200,201,279 lekë	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** 196,189,707lekë BOE N. SHPK	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 4,011,572 lekë ose 2%
8. Data e hapjes së tenderit Data 30.09-2022	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender 3 BOE b) S'kualifikuar 1 BOE, c) Kualifikuar 2 BOE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 10133 prot. datë 02.11.2022 me afat 5 muaj.	**15. Vlera e kontratës (pa tvsh)** 196,189,707 lekë	

u konstatuan problematika si vijon:

a) AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":

Nga auditimi mbi vendosjen e kritere të planim/kualifikimit u konstatua:

1. Për pikën 2.3.3 AK ka kërkuar që, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **100 persona.**

Sipas grupit të auditimit:

Numri i personave, nuk është argumentuar nga NJP vendosja e tyre, në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës. Sasia shumë e madhe e punonjësve të operatorëve ekonomik, menjëherë ngushton tej mase konkurrencën, pasi shumë pak OE në sektorin e ndërtimit, në Republikën Shqiptare, nuk disponojnë kaq numër të lartë punonjësish. Pra menjëherë AK, indirekt vështirëson pjesëmarjen e operatorëve ekonomik, duke drejtuar ofertuesit drejt B. it të operatorëve ekonomik, me qëllim arritjen e numrit të punonjësve.

3. Për pikën 2.3.6 AK ka kërkuar që, Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

-1 (një) punonjës që disponon certifikatënsi **"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen eshëndetit në punë"**në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier".

-Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar **një mjek** të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim.

Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licencë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë.

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontratapër këtë shërbim, licenca përkatëse , si dhe faturën e këtij shërbimi, personat dhe shërbimet e specializuara, që

merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015).
Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë. (Kriteri u modifikua me shtojcën nr. 2, datë 26.09.2022.
Sipa grupit të auditimit, është vendosur kriter në DST me bazë ligjore të shfuqizuar.
4. Për pikën 2.3.9 AK ka kërkuar që, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ndër të tjera (1) Impiant Betoni auomatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, Cope 1. (2) Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, Cope 1.
Sipa grupit të auditimit, *konstatohen kërkesa kualifikuese shum të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës.*
Vendosja e Impiant Betoniauomatik me mikser dhe, Nyje inertesh, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni, Nyje inertesh. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë në tender.
-Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit dhe inerteve në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht per skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit.
5. ***Në pikën 4.2 të DT,*** *tek kriteret e përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar që AK do të vlerësojë ofertën ekonomikisht më e favorshme, bazuar në* ***kosto****. (-****Koha e zbatimit të kontratës*** *me* ***30 pikë; - Çmimi më i ulët*** *me* ***60 pikë; -Cilësia*** *me* ***10 pikë****).*

Sa mësipër, për një vlerësim sa më objektiv sipas peshës specifike, duhet të përcaktohen pikët për çdo kriter dhe nënkriter, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë.

b)-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO (Faza 1).
Dorëzimi i ofertave u realizua më 30.09.2022, ku kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik, si më poshtë:

1	BOE N. SHPK	K.....C/K....1
2	BOE R.	L....A/K....Q
3	BOE A. SHPK	K....F/K....A

Faza e dytë:
-KVO me datë 17.10.2022 ka mbajtur proces verbal mbi hapjen e ofertave për tenderin: "Rikonstruksion shkolla e mesme "Gramoz Palushi", Babrru, Njësia Administrative Paskuqan".

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta ekonomike	Vlerësimi (Faza2)	Rënditja/Pikët
1	**BOE N. SHPK**	**196,189,707**	**Kualifikuar**	**1**

2	BOE R. SHPK	198,196,226	kualifikuar	2

Vlerësimi sipas grupit të auditimit:

1. Nga auditimi i dokumentacionit të BOE N. SHPK & "N" SHPK, konstatohet që ka ky operator ka paraqitur grafikum e punimeve për 4 (katër) muaj (në përputhje me afatin e përcaktuar në shtojcën 1 të DT).
2. Nga auditimi i dokumentacionit të BOE U.SHPK & R.SHPK, konstatohet që ka ky operator ka paraqitur grafikum e punimeve për 8 (tetë) muaj (4 muaj më shumë se afati i përcaktuar në shtojcën 1 të DT), e megjithëatë nga KVO është vlerësuar me 15 (pesembëdhjetë) pika nga 30 pikë maksimale përcaktuar në DT.

Në gjykimin e audituesit, ky operator duhej të vlerësohej me zero pikë dhe jo me 15 pikë.
Gjithashtu, në gjykimin e grupit të auditimit, vlerësimi mbi çmimim, duhej që nga KVO, të bëhej me interpolim.
Sa më sipër vlerësimi do te ishte si vijon:

Kriteri	**Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender**	
	BOE N. SHPK & "N" SHPK	BOE U.SHPK & R.SHPK
x- Çmimi	45[196,189,707 lekë]	50 [198,196,226 lekë]
y-Koha e zbatimit	30	0
z-Metodologjia	10	10
TOTALI (x+y+z)	**85**	**60**
Renditja	**1**	**2**

Pavarësisht nga vlerësimi me pikë, KVO duke vlerësuar në renditje në vendin e parë BOE N. SHPK & "N" SHPK ka vepruar në përputhje me Neni 99, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si nenit 84, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

-KVO, për një vlerësim sa më objektiv sipas peshës specifike, duhet të përcaktohen pikët për çdo kriter dhe nënkriter, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë.

2. Procedura e prokurimit me objekt: "***Rindërtim shkolla 9-vjeçare, "Azem Hajdari" Babrru, Njësia Administrative Paskuqan***".

Përshkrimi i situatës 2: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksion shkolla e mesme "Rindërtim shkolla 9-vjeçare, "Azem Hajdari" Babrru, Njësia Administrative Paskuqan" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Rindërtim shkolla 9-vjeçare, "Azem Hajdari" Babrru, Njësia Administrative Paskuqan" REF-32182-06-08-2022*		
1. Urdhër Prokurimi Nr 5126 Datë 07.06.2022 REF- 32182-06-08-2022 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**I kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)" Marrveshe kuadër	**3.1 Njësia e Prokurimit** SH.XH S.S S.V	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** **Faza e parë:** Urdhër 5126/1 datë 07.06.2022 E.GJ , Kryetar L.M , anëtar A.GJ , anëtar **Faza e dytë:** Urdhër 6623 datë 21.07.2022 H.M , kryetar E.M , anëtare A.D , anëtare
5. Fondi Limit (pa tvsh) 496,070,422 lekë	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** 492,290,400lekë BOE E. SHPK	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 3,780,022 lekë ose 0.76 %
8. Data e hapjes së tenderit Data 02.06-2022	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender 4 BOE b) S'kualifikuar 4 BOE, c) Kualifikuar 3 BOE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		

14. Lidhja e kontratës 7336 prot. datë 17.08.2022 me afat 10 muaj.	**15. Vlera e kontratës (pa tvsh)** 492,290,400 lekë

u konstatuan problematikat si vijojnë:

a) AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve të përgjithshme të Pranim/kualifikimit":

Nga auditimi i vendosjes së kritereve të pranim/kualifikimit u konstatua:

2. Për pikën 2.3.3 AK ka kërkuar që, OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **180 persona**. Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

Sipas grupit të auditimit: *Numri i personave, nuk është argumentuar nga NJP vendosja e tyre, në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës. Sasia shumë e madhe e punonjësve të operatorëve ekonomik, menjëherë ngushton tej mase konkurrencën, pasi shumë pak Operator Ekonomik në sektorin e ndërtimit, në Republikën Shqiptare, nuk disponojnë kaq numër të lartë punonjësish. Pra menjëherë AK, indirekt vështirëson pjesëmarjen e operatorëve ekonomik, duke drejtuar ofertuesit drejt B. it të operatorëve ekonomik, me qëllim arritjen e numrit të punonjësve.*

3. Për pikën 2.3.7 AK ka kërkuar që, OE ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

-1 (një) punonjës që disponon certifikatënsi **"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen eshëndetit në punë"** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier".

-OE për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar 1(**një) mjek** të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim.

Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licencë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë.

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontratapër këtë shërbim, licenca përkatëse , si dhe faturën e këtij shërbimi, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015). Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.

Sipas grupit të auditimit ky kriter është vendosur me bazë ligjore të shfuqizuar.

4. Për pikën 2.3.10 AK ka kërkuar që, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ndër të tjera *(1) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, (2) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton.*

Sipas grupit të auditimit: *AK ka përcaktuar kërkesa të ekzagjeruara në lidhje me disponimin emakinerive/pajisjeve apo kanë kërkuar makineri/pajisje të pa-argumentuara sipas numrit dhe llojit të tyre dhe që nuk janë në përputhje me punimet objekt kontrate. Nuk ka asnjë analizë teknike ku sasia e makinerive/pajisjeve të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre apo grafikun e punimeve.*

Këto kërkesa janë në kundërshtim me sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Gjithashtu nga NjP është kërkuar që OE të plotësojë, si vijon:

Nr	*Lloji i Makinerive*	*Statusi*	*Sasia*
21	*Impiant Betoni auomatik me mikser (e pajisur me leje*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*

	mjedisore kodi III.1.B)		
22	*Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*

Sipas grupit të auditimit: *Sa më sipër, konstatohen kërkesa kualifikuese shumë të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës.*
Sic vërehet janë kërkuar Impiant Betoniauomatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi si dhe, Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar.
Vendosja e Impiant Betoniauomatik me mikser dhe, Nyje inertesh, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni, Nyje inertesh. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë në tender.
Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit dhe inerteve në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht per skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit.

5. ***Në pikën 4.2 të DT,*** *tek kriteret e përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar që AK do të vlerësojë ofertën ekonomikisht më e favorshme, bazuar në* ***kosto****. (-****Koha e zbatimit të kontratës*** *me* ***30 pikë; - Çmimi më i ulët*** *me* ***60 pikë; -Cilësia*** *me* ***10 pikë****).*

Sa mësipër, për një vlerësim sa më objektiv sipas peshës specifike, duhet të përcaktohen pikët për çdo kriter dhe nënkriter, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë.

Theksojmë se, bazuar në dispozitat e sipërcituara, kriterei për shpalljen e ofertës fituese në rastin e procedurës konkrete objekt auditimi do të duhet të ishte automatikisht ai i ofertës ekonomikisht më e favorshme bazuar në **çmimin** si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.
Nga ana tjetër, referuar kriterit të përzgjedhur në mënyrë të gabuar nga NJP, atij të "*ekonomikisht më e favorshme në bazë të kostos*", edhe sikur të merret e miëqenë vendosja e këtij kriteri, rezulton se në perbërjen e tij ka elementë të pabazuar në ligj dhe cënues të mundësisë së konkurrencës efektive.
Konkretisht në DST është përcaktuar:
b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO (Faza 1).
Dorëzimi i ofertave u realizua më 20.06.2022, ku kanë marrë pjesë 7 (shtatë) OE/BOE, si dhe vlerësimi i OE/BOE rezultoi si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	NIPTI	vlerësimi
1	**OE T. SHPK**	**K.....M**	**Kualifikuar**
2	**OE A. SHPK**	**K.....L**	**Kualifikuar**
3	**BOE A.SHPK & GJ. SHPK**	**L.....R/J.....H**	**Skualifikuar**

4	BOE "A. SHPK & N. SHPK	J.....D/L.....D	Skualifokohet
5	BOE E. SHPK	K.....P/K.....A	**Kualifikuar**
6	OE P. SHPK	K....M	skualifikoaur
7	OE S.SHPK	J....G	skualifikuar

Faza e dytë:

-KVO me përbërje (H.M , Kryetar; E.M dhe A.D , anëtar me Urdhër nr. 6623 prot., datë 21.07.2022) me datë 22.07.2022 ka mbajtur proces verbal për hapjen e ofertave për objektin: "Rindërtim shkolla 9-vjeçare, "Azem Hajdari" Babrru, Njësia Administrative Paskuqan".

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta ekonomike	Vlerësimi (Faza2)
1	OE T. SHPK	495,000,000	Kualifikuar
2	OE A. SHPK	494,120,800	kualifikuar
3	**BOE E. SHPK**	**492,290,400**	**Kualifikuar**

vijon:

Kriteri	**Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender**		
	OE T. SHPK	OE A. SHPK	BOE E. SHPK
x- Çmimi	30	35	50
y-Koha e zbatimit	10	10	30
z-Metodologjia	10	10	10
TOTALI (x+y+z)	**50**	**55**	**90**
Renditja	**2**	**3**	**1**

Konstatohet se nga KVO në procesverbalin e datës 25.07.2022 mbi vlerësimin e Fazës së II-të për OE të kualifikuar, vlerësimi jepet në pikët totale pa përdoren formulën sipas pikës 4.2 të DT.

<u>Vlerësimi sipas grupit të auditimit:</u>

Në gjykimin e grupit të auditimit, vlerësimi mbi çmimim, duhej që nga KVO, të bëhej në mëyrë individuale nga çdo anëtar i KOV-së, me **interpolim linear ose sipas formulës në DT**.

Sa më sipër vlerësimi do te ishte si vijon:

1. BOE "E" SHPK & "B" SHPK, ka paraqitur ofertën me vlerë më të ulët **492,290,400 lekë** dhe duhej të vlerësohej me **60 pikë maksimale** dhe jo me **50 pikë**.

-Afati i kontratës është paraqitur **9.5 muaj**, duke u vlerësuar me **30 pikë maksimale**.

2. OE A. SHPK, ka paraqitur ofertën me vlerë **494,120,800** lekë dhe është vlerësuar me **35 pikë.** Nga llogaritja e bërë nga grupi i auditimit, rezulton se duhej të ishte vlerësuar me **59.77 pikë** dhe jo me 35 pikë [492,290,400 lekë : 494,120,800 lekë x 60 pikë=**59.77 pikë**].

-Afati i kontratës është paraqitur **10 muaj**, duke u vlerësuar me **10 pikë**.

Nga llogaritja e bërë nga grupi i auditimit, rezulton se duhej të ishte vlerësuar me **28.50 pikë** dhe jo me **10 pikë** [9.5 muaj : 10 muaj x 30 pikë=**28.50 pikë**].

3. OE T" SHPK, ka paraqitur ofertën me vlerë **495,000,000 lekë** dhe është vlerësuar me **30 pikë**.

Nga llogaritja e bërë nga grupi i auditimit, rezulton se duhej të ishte vlerësuar me 59.67 pikë dhe jo me 30 pikë [492,290,400 lekë : 495,000,000 lekë x 60 pikë =**59.67 pikë**].

-Afati i kontratës është paraqitur **10 muaj**, duke u vlerësuar me **10 pikë**.

Nga llogaritja e bërë nga grupi i auditimit, rezulton se duhej të ishte vlerësuar me **28.50 pikë** dhe jo me **10 pikë** [9.5 muaj : 10 muaj x 30 pikë=**28.50 pikë**].

Kriteri		**Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender**		
	Kriteret e vlerësimit, sipas DT (pikë)	BOE E. SHPK	OE A. SHPK	OE T. SHPK
x- Çmimi	60	60	59.67	59.77
y-Koha e zbatimit	30	30	28.5	28.5
z-Metodologjia	10	10	10	10
TOTALI (x+y+z)	**100**	**100**	**98.17**	**98.27**

Renditja		1	2	3

Konkluzion mbi vlerësimin me pikë:
Pavarësisht nga vlerësimi me pikë sipas formulës në DT, nuk ndryshon renditja e vendit të parë për BOE "E" SHPK & "B" SHPK, ndërkohë që ndryshon renditja e vendit të dytë dhe të tretë.
Në qoftë se AK dhe NjP për kriteret vlerësuese do të përcaktonte ***peshen specifike të secilit kriter/nënkriter*** *dhe konkretisht* ***pikët*** *që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm, sipas* ***Formulës në dokumentet standarde të tenderit, nga KVO do bëhej një vlerësim më i saktë, në zbatim të*** *nenit 45 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" pika 8 i cili përcakton: "Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa* ***më objektive dhe të shprehen në shifra****. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha specifike (sa pikë do të ketë çdo kriter) nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë".*
KVO duke vlerësuar në renditje në vendin e parë BOE "E" SHPK & "B" SHPK ka vepruar në përputhje me Neni 99, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si nenit 84, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

3. Procedura e prokurimit me objekt: "***Ndërtim rruga "Albanët" + rrugicat Valias + rruga "Këmbanat"".***

Përshkrimi i situatës 3: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksion shkolla e mesme "Ndërtim rruga "Albanët" + rrugicat Valias + rruga "Këmbanat"" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim rruga "Albanët" + rrugicat Valias + rruga "Këmbanat"", Bashkia Kamëz		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 6141 Prot., datë 05.07.2022 Titullari i AK: R.S **2. Lloji i Procedurës** **"**Procedurë e Hapur – Punë Publike"	**3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit.** Njesia e prokurimit SH.XH, Personi i ngarkuar S.S , anëtare S.V , anëtare, jurist	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr. 6141/1 Prot., datë 05.07.2022 **E.GJ** , kryetar L.M , anëtar E.D , anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 62,386,798 lekë REF-35464-07-05-2022	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** OE "N" SHPK me vlerë **60,926,830** lekë	**7. Diferenca me fondin limit(pa tvsh)** 1,459,968 lekë pa TVSH ose masën 2.35 %
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 21.07.2022 Njoftimi i kontratës: Buletini nr. 95, datë 12.07.2022	**9. Burimi Financimit** Buxheti i bashkisë	**10. Operatoret Ekonomike** **a)** Pjesëmarrës në tender 3 OE **b)** Skualifikuar 2 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **Nuk ka**	**12. Përgjigje Ankesës** Nuk ka	**13. Përgjigje** Nuk ka
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Sherbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 7691 prot., datë 31.08.2022	**15. Vlera kontratës (me tvsh)** 73,112,196 lekë me TVSH	**16. Afati i kontratës në ditë** Parashikuar 119 ditë

u konstatuan problematikat si vijojnë:

a) AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve të përgjithshme të Pranim/kualifikimit":
Nga auditimi i vendosjes së kritereve të pranim/kualifikimit u konstatua:

1. AK për kriterin 2.3.4 ka kërkuar që, OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, ndër të tjera me **1(një) inxhinier mekanik.**

Sipas grupit të auditimit: - *Në gjykimin e grupit të auditimit, vendosja e kriterit për **1 (një) inxhinier mekanik** është kërkesë e tepërt dhe e panevojshme, pasi referuar llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime mekanikë të cilat kanë nevojë për asistencën e inxhinierit mekanik. Preventiv nuk ka vendosje barrierave metaike. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe, nenit 39, pika 6, germa (c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe, **ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit.***

2. AK për kriterin 2.3.7 ka kërkuar që, OE duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione të arsimit profesional si dhe të figurojne në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Mars 2022 – Maj 2022**, ndër të tjera: **1 (nje) Saldator** dhe **3 (tre)Mekanik.**

Sipas grupit të auditimit, kërkesa për një saldator dhe tre inxhinier mekanik, *kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv dhe, rezulton kriter i tepërt dhe i panevojshëm.*

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

-Sipas procesverbali Nr. 1 (i hapjes së ofertave të tenderit), datë 21.07.2022, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 (tre) OE, përkatësisht:

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***
1	"N" SHPK	60,926,830
2	"L" SHPK	62,008,150
3	N. SHPK	62,068,900

Nga KVO, janë mbajtur:

-Proces verbal nr. 2, datë 25.07.2022 "Mbi korrigjimin e preventivave të paraqitur nga OE".

-Proces verbal nr. 3, datë 26.07.2022 "Mbi llogaritjen e ofertave anomalisht të ulëta të paraqitur nga OE".

-Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr 4, dat ë 27.07.2022, KVO-ja ka kryer në SPE, vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Vlerësimi***
1	**"N" SHPK**	**60,926,830**	**Kualifikuar**
2	"L" SHPK	62,008,150	skualifikuar
3	N. SHPK	62,068,900	skualifikuar

Referuar procesverbalit përkatës si dhe njoftimit të fituesit, rezulton se fillimisht KVO-ja, pasi ka kualifikuar 1 (një) OE nga ato pjesëmarrës në garë, ka kërkuar nga OE i renditur i pari ("N" SHPK) dorëzimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet e bëra.

Nga ana tjetër, KVO ka skualifikuar 2 (dy) OE me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"L" SHPK:*** *Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.*
2. ***"N " SHPK:*** *Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.*

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se KVO ka respektuar afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 21.07.2022, KVO dhe në zbatim të detyrimit ligjor është kryer vlerësimi në datë 27.10.2022 (është kryer brenda 15 ditëve).

Vlerësimi nga grupi i auditimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionuit në dosje si dhe në SPE të OE "N" SHPK, rezulton se dokumentet e paraqitura janë sipas kritereve e përgjithshme të pranim/kualifikimit dhe,

kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara në DT dhe kualifikimi i këtij OE është i drejtë dhe në përputhje me nenin 92, pika 3 të ligjit 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" si dhe nenin 38 dhe 82 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Vlerësimi është bërë në përputhje me LPP.

4. Procedura e prokurimit me objekt: "***Ndërtim Rr. Frutikulturë (Rr. pungul me Rrugën Azem Galica + Rr. "Isuf Gervalla" + Rr. "Brezaret"".***

Përshkrimi i situatës 4: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksion shkolla e mesme "Ndërtim Rr. Frutikulturë (Rr. pungul me Rrugën Azem Galica + Rr. "Isuf Gervalla" + Rr. "Brezaret" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim Rr. Frutikulturë (Rr. pungul me Rrugën Azem Galica + Rr. "Isuf Gervalla" + Rr. "Brezaret")", Bashkia Kamëz REF:33106-06-16-2022		
1. **Urdhër Prokurimi:** Nr. 5463 Prot., datë 16.06.2022 **2. Lloji i Procedurës** **"**Procedurë e Hapur – Punë Publike" me elkronikë	**3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Njesia e prokurimit -SH.XH, Përgjegjëse -S.S , anëtare -S.V , anëtare, jurist	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr. 5463/1 Prot., datë 16.06.2022 - E.GJ Kryetar - A.GJ , anëtar - L.M , anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 85,269,315 lekë	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** OE "V " SHPK me vlerë **83,862,373** lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit(pa tvsh)** 1,406,94 lekë pa TVSH ose ë masën 1.6%
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 04.07.2022	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Kamëz	**10. Operatoret Ekonomike** **a)** Pjesëmarrës në tender 4 OE **b)** Skualifikuar 3 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **Nuk ka**	**12. Përgjigje Ankesës** Nuk ka	**13. Përgjigje** Nuk ka
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Sherbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 8073 prot., datë 09.09.2022	**15. Vlera kontratës (me tvsh)** 99,889,585 **lekë**	**16. Afati i kontratës në ditë** Parashikuar 168 ditë pune nga data e lidhjes së kontratës.

u konstatuan problematikat si vijojnë:

a) AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve të përgjithshme të Pranim/kualifikimit":

Nga auditimi i vendosjes së kritereve të pranim/kualifikimit u konstatua:

1. AK për kriterin 2.3.2 ka kërkuar që, OE duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Nr.	**Kategoria**	**Klasifikimi**	**Emertimi i kategorise**
PUNIME TE PERGJITHSHME N			
4.	NP-7	A	Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
PUNIME SPECIALE N			
9.	NS-9	B	Punime strukturore speciale

Sipas grupit të auditimit, ky kriter nuk është vendosur në përputhje me natyrës e kontratës.

2. AK për kriterin 2.3.4 ka kërkuar që, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, **1 (një) Inxhinier Mekanik.**

Sipas grupit të auditimit: *Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe, nenit 39, pika 6, germa (c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

-Sipas procesverbali Nr. 1 (hapja e ofertave të tenderit) hartuar nga NjP dhe KVO më datë 04.07.2022, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 (katër) OE, me renditje, përkatësisht:

Nr	*Shoqëria OE/BOE*	*Oferta Lekë PA TVSH*
1	**OE "V " SHPK**	**83,241,321**
2	OE "C " SHPK	83,862,373
3	OE "A"SHPK	84,032,200
4	OE "A " SHPK	67,424,962

Nga KVO, janë mbajtur:

-Sipas Proces verbal nr. 2, mbajtur nga KVO më datë 06.07.2022 "Mbi korrigjimin e preventivave të paraqitur nga OE", renditja provizore sipas vlerës së ofertës rezulton si vijon:

Nr	*Shoqëria OE/BOE*	*Oferta Lekë PA TVSH*	*Renditja*
1	OE "A " SHPK	67,424,962	1
2	OE "V " SHPK	83,241,321	2
3	OE "C " SHPK	83,862,373	3
34	OE "A"SHPK	84,032,200	4

-Sipas Proces verbal nr. 3, mbajtur nga KVO më datë 26.07.2022 "Mbi llogaritjen e ofertave anomalisht të ulëta të paraqitur nga OE".

-Sipas proces verbalit të vlerësimit nr. 4, mbajtur nga KVO më datë 27.07.2020 në procedurën e prokurimit janëkualifikuar 3 (tre) OE dhe është skualifikuar 1(një) OE, si më poshtë:

Nr	*Shoqëria OE/BOE*	*Oferta Lekë PA TVSH*	*Kualifikim/skualifikim*
1	**OE "V " SHPK**	**83,241,321**	**Kualifikohet**
	Dokumentacioni i paraqitur plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të DT		
2	**OE "C " SHPK**	**83,862,373**	**Kualifikohet**
	Dokumentacioni i paraqitur plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të DT		
3	**OE "A"SHPK**	**84,032,200**	**Kualifikohet**
	Dokumentacioni i paraqitur plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të DT		
4	OE "A " SHPK	67,424,962	Skualifikohet
	OE "A " SHPK me ofertë ekonomike 67,424,962 për arsyet e mëposhtme: Nga verifikimi i dokumentacionit orgjinal dhe të noterizuar të dorëzuar nga operatori i renditur i pari, rezultoi se, një pjesë e dokumentacionit provues për Operatorin ekonomik "A " SHPK, nuk është paraqitur në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, përkatësisht: -Licencë NZ. 2846/19 Shoqëria "A " SHPK; - Listëpagesit e kontributëve të sigurimeve shoqërore, shëndëtësore dhe tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi; - Kontrata pune individuale për A. X., A. J., A. G., L.M., H. Xh., I.S., K., A. M., B.T., H. P., M. B., M. B., A. D.; - ISO 9001 2015, ISO 14001 2015, ISO 45001 2018;		

Vlerësimi nga grupi i auditimit:

-Nga shqyrtimi i dokumentacionuit në dosje si dhe në SPE të OE "V " SHPK, OE "C "SHPK dhe OE "A" SHPK rezulton se, dokumentet e paraqitura janë sipas kritereve e përgjithshme të pranim/kualifikimit dhe, kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara në DT dhe kualifikimi i këtij BOE është i drejtë dhe në përputhje me nenin 92, pika 3 të ligjit 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" si dhe nenin 38 dhe 82 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Vlerësimi është bërë në përputhje me LPP. *-Skualifikimi i OE "A " SHPK është i drejtë, pasi nuk plotëson të gjitha kritret e DT.*

Për ktë procedurë prokurimi me nr. 8073 prot., datë 09.09.2022 është lidhur kontrata për punë publike, ndërmjet Bashkisë Kamëz, përfaqësuar nga znj. U.E me detyrë Zv/Kryetar dhe OE "V " SHPK me administrator Z. S.H . Kontrata ka vlerën 99,889,585.20 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të punimeve 168 ditë pune nga data e lidhjes së kontratës dhe, garanci punimesh 24 muaj.

5. Procedura e prokurimit me objekt: "***Ndërtimi i Pedonales dhe zonave rekreative të Parkut të Liqenit Paskuqan"*** Bashkia Kamëz.

Përshkrimi i situatës 5: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Ndërtimi i Pedonales dhe zonave rekreative të Parkut të Liqenit Paskuqan" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtimi i Pedonales dhe zonave rekreative të Parkut të Liqenit Paskuqan", Bashkia Kamëz.REF-32850-06-14-2022		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 5404 Prot., datë 14.06.2022 **2. Lloji i Procedurës** **"**Procedurë e Hapur – Punë Publike" me elkronikë	**3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Njesia e prokurimit -SH.XH, Personi i ngarkuar -S.S , anëtare -S.V , anëtare, jurist **Hartuesit e Kritereve të Veçanta** 1. R.B Pjesa teknike 2. SH.XH, Pjesa Juridike	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr. 5404/1 Prot., datë 14.06.2022 - E.GJ , kryetar - F.M , anëtar - L.M , anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 209,703,648 lekë	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** BOE U.& "N" SHPK **198,978,984** lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit(pa tvsh)** 10,724,664 lekë pa TVSH ose ë masën 5.1
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 14.06.2022 Bëhet: Data e hapjes: 30.06.2022	**9. Burimi Financimit** Buxheti i bashkisë	**10. Operatoret Ekonomike** **a)** Pjesëmarrës në tender 1 OE **b)** Skualifikuar 1 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **Nuk ka**	**12. Përgjigje Ankesës** Nuk ka	**13. Përgjigje** Nuk ka
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Sherbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës 6999 prot., datë 03.08.2022	**15. Vlera kontratës (me tvsh)** 238,774,780.**8 lekë**	**16. Afati i kontratës në ditë** Parashikuar 8 muaj

u konstatuan problematikat si vijojnë:

a) AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve të përgjithshme të Pranim/kualifikimit":

Nga auditimi i vendosjes së kritereve të pranim/kualifikimit u konstatua:

1. AK për pikën 2.3.3. ka kërkuar që, OE duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme ndër të tjera për kategoritë (**NP- 7 B Ujësjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje).**

Sipas grupit të auditimit: - *Nga auditimi konstatohet, se vendosja e këtij kriteri për kategorinë e licencës "**NP- 7 B** Ujësjellesa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje" është kërkesë e tepërt dhe e panevojshme, pasi referuar llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, të cilat kanë nevojë për këtë kategori licence.*

2. AK për pikën 2.3.7. ka kërkuar që, OE ofertues duhet të ketë **1 (një) mjek të përgjithshëm** të punësuar pranë shoqerisë ose të kontraktuar nga shoqeria...

Sipas grupit të auditimit: *Konstatohet vendosja e një kriteri kualifikues të shfuqizuar.*

3. AK për pikën 2.3.11, ka kërkuar që, OE, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje ndër të tjera, mjetet dhe pajisjet (1) **Rrul asfalti cilinder cilinder minimumi 5-8 ton**, (2) **Fabrikë Betoni(e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)**, (3) **Fabrikë asfalti** (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B, (4) **Nyje Inerte** (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B:

Sa më sipër, konstatohen kërkesa kualifikuese shumë të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës.

Siç vërehet janë kërkuar mjete si: Rrul asfalti cilinder cilinder minimumi 5-8 ton, 1 copë (ndërkohë që është kërkuar edhe Rrul asfalti cilinder cilinder minimumi 8 ton, 2 copë), Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), etj, *në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar.*

Vendosja e Nyje prodhim betoni, Fabrikë asfalti dhe Nyje inerte, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni, Asfalti dhe Nyje inertesh. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marre me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), *do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij*, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. *Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë ne tender*. Gjithashtu AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore **Kodi III 1 B** lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e këtyre dokumentave përben kusht për skualifikim.

Vendosja e kriterit nga NjP ku: Fabrikat dhe nyja inerte jane kerkuar si kriter për realizimin e punimeve në afat dhe me cilesi, konkretisht punimet e shtresave, asfaltit, betonimeve, korsise se biçikletave, në gjykimin e audituesit nuk bazohet në faktin nëse OE ka në pronësi apo me qera këto, nyje, cilësia dhe afati janë parashikuar në DT (Shtojca 16 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)) Nen 19 (Raportimi i Grafikut të Zbatimit), pika 19.1 ku theson se: "Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve „. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit.

4. AK për pikën 2.3.13. ka kërkuar që, OE duhet të paraqesë **një kontrate të lidhur me një laborator** për këtë objekt, i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit për analizat e materialeve (1) Beton i fresket sipas standardeve te meposhtme ose te përditësuara, (2) Beton i ngurtesuar sipas standardeve te meposhtme ose te përditësuara, (3) Perzierje Bituminoze sipas standardeve te meposhtme ose te përditësuara, (4) Materiale

Rrugore sipas standardeve te meposhtme ose te përditësuara, (5) Gnatyral sipas standarteve te meposhtme ose te perditesuara:
Sipas grupit të auditimit: *Vendosja e kriterit nga NjP ku thuhet: OE duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një laborator për këtë objekt, i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit për analizat e mëposhtme, në gjykimin e audituesit nuk qëndron dhe është e tepërt, sepse kryerja e analizave është parashikuar në DT (Shtojca 16 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK), neni 13 "Testimet dhe Inspektimet".*

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.
-Sipas procesverbali Nr. 1 (i hapjes së ofertave të tenderit), datë 30.06.2022, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 (tre) OE, me renditje, përkatësisht:

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***
1	BOE "U." SHPK	198,978,984
2	OE "U." SHPK	206,050,393

Nga KVO, janë mbajtur:
-Proces verbal nr. 2, datë 01.07.2022 "Mbi korrigjimin e preventivave të paraqitur nga OE".
-Proces verbal nr. 3, datë 06.07.2022 "Mbi llogaritjen e ofertave anomalisht të ulëta të paraqitur nga OE".
-Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr 4, datë 07.07.2022, KVO-ja ka kryer në SPE, vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Vlerësimi***
1	BOE "U." SHPK	198,978,984	**Kualifikuar**
2	OE "U." SHPK	206,050,393	skualifikuar

Referuar procesverbalit përkatës si dhe njoftimit të fituesit, rezulton se fillimisht KVO-ja, pasi ka kualifikuar 1 (një) OE nga ato pjesëmarrës në garë, ka kërkuar nga OE i renditur i pari BOE "U." SHPK) dorëzimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet e bëra.
Nga ana tjetër, KVO ka skualifikuar 1 (një) OE me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

3. ***"U." SHPK:*** *Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.*

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se **KVO ka respektuar afatet** ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 30.06.2022, KVO dhe në zbatim të detyrimit ligjor është kryer vlerësimi në datë 14.07.2022 (është kryer brenda 15 ditëve).

Vlerësimi nga grupi i auditimit:
Nga shqyrtimi i dokumentacionuit në dosje si dhe në SPE të BOE "U." SHPK, rezulton se dokumentet e paraqitura janë sipas kritereve e përgjithshme të pranim/kualifikimit dhe, kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara në DT dhe kualifikimi i këtij BOE është i drejtë dhe në përputhje me nenin 92, pika 3 të ligjit 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" si dhe nenin 38 dhe 82 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Vlerësimi është bërë në përputhje me LPP.
Për ktë procedurë prokurimi me nr. 6999 prot., datë 03.08.2022 është lidhur kontrata për punë publike, ndërmjet Bashkisë Kamëz, përfaqësuar nga znj. U.E me detyrë Zv/Kryetar dhe BOE "U." SHPK përfaqësuar nga OE U.SHPKme administrator Z. A.Ç. Kontrata ka vlerën 238,774,780 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të punimeve 8 muaj nga data e pajisjes me leje ndërtimi dhe, garanci punimesh 24 muaj.

6. Procedura e prokurimit me objekt: "***Ndërtim trotuare + Ndriçim Rruga "Jon" + Rruga "Fushë Arrëz"***".

Përshkrimi i situatës 6: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksion shkolla e mesme "Ndërtim trotuare + Ndriçim Rruga "Jon" + Rruga "Fushë Arrëz"" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Ndërtimtrotuare + Ndriçim Rruga "Jon" + Rruga "Fushë Arrëz".* Nr. Ref: 41685-09-14-2022.		
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit Nr. 8206 prot., datë 14.09.2022 Lloji i procedurës: "E hapur" elektronike	**2 Njësia e Prokurimit** 1. SH.XH 2. S.S 3. S.V	**3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Ngritur me Nr. 8206/1 prot., datë 14.09.2022** 1. E.GJ 2. L.M 3. E.M
4. Fondi Limit (pa TVSh) 32,500,000lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 30,695,793lekë Fitues: OE"L" ShA	**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 1,804,207 lekë ose 5.55 %
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 05.10.2022 **7/2 Data e vlerësimit në SPE:** Data 27.10.2022 **7/3 Kohëzgjatja e kontratës:** 90 ditë pune	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Kamëz	**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër **7 B/OE** b) S'kualifikuar **5 B/OE,** c) Kualifikuar **2 B/OE**
10.Ankimime **AK**-s'ka/ka**; -Jo** **APP–**s'ka/ka**;-Jo** **KPP**-s'ka/ka;-**Jo**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit:** Data:15.11.2022	**12.Data e lidhjes së kontratës:** Data: 14.12.2022**me afat 90 ditë**

u konstatuan problematikat si vijojnë:

a) AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve të përgjithshme të Pranim/kualifikimit":

Nga auditimi i vendosjes së kritereve të pranim/kualifikimit u konstatua:

1. AK për pikën 2.3.2. ka kërkuar që, OE duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme, ndër të tjera, për kategoritnë "**NP- 7 B Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje".**

Sipas grupit të auditimit: *Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar në projekt preventiv dhe, aq më tepër kjo kategori licence nuk lidhet me zëra pune që lidhen me punime në rrjetin e kanalizimeve.*

2. AK për pikën 2.3.6 ka kërkuar që, OE duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

-1 (një) punonjës përgjegjës, pjesë e stafit të shoqerisë, duhet të jetë i pajisur me certifikaten tëTrajnimit për ***"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në Punë",*** në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327, datë 18.12.2021 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe, VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për niratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier""...

Sipas grupit të auditimit: *Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet. Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë*

punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë". Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar.

3. AK për kriterin 2.3.7 ka kërkuar që, OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, ndër të tjera 1(një) **saldator** dhe 1(një) **mekanik**.

Sipas grupit të auditimit, ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Sipas procesverbalit nr. 1, datë 05.10.2022, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 B/OE, për të cilët, referuar procesverbaleve përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	**"K &C" SHPK**	**25,649,988**	**Kualifikuar**
2	**"L" SHPK**	25,810,575	Skualifikuar
3	**"L" ShA**	**30,695,793**	**Kualifikuar**
4	**"N " SHPK**	31,805,538	Skualifikuar
5	**"K" SHPK**	31,849,701	Skualifikuar
6	**"B" SHPK**	31,851,498	Skualifikuar
7	**"S" SHPK**	32,323,232	**Kualifikuar**

Referuar procesverbalit përkatës si dhe njoftimit të fituesit, rezulton se fillimisht KVO-ja, pasi ka kualifikuar 3 (tre) B/OE [1. "K" SHPK; 2. "L" ShA; 3. "S" SHPK nga ato pjesëmarrës në garë, ka kërkuar nga BOE i renditur i pari ("K" SHPK me ofertën ekonomike më të vogël në vlerën 25,649,988 lekë) dorëzimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet e bëra brenda datës 31.10.2022.

Nga ana tjetër, KVO ka skualifikuar 4 (shtatë) B/OE me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

4. ***"B" SHPK:*** *Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.*
5. ***"K" SHPK:*** *Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.*
6. ***"N " SHPK:*** *Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.*
7. ***"L " SHPK:*** *Operatori ekonomik nuk ka permbushur kriterin e disponibilitetit per kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, ka paraqitur vetem 1 nga 2 që kërkohen në DT; nuk ka përmbushur kriterin e disponibilitetit të transportier për mjete të rënda; te rrul vibrues ngjeshje shtresash dhe asfalti 4 cope ka paraqitur vetem 3; nuk ka përmbushur kriterin e disponibilitetit semafor kantieri për punime në rruge; kriterin e disponibilitetit nivelues betoni; disponibilitetit autobot për zhbllokim kanalizimesh pajisur me pompë presioni dhe pompë vakumi vetëshkarkuese e pajisur dhe me depozitë për transport të ujit të pastër dhe mbetjeve të tjera; sondë për zhbllokim dhe pastrim kanalizimeve, të shiut dhe tubacioneve të ndryshme".*

-KVO me datë 07.10.2022, ka mbajtur proces verbal nr. 2 "Mbi korrigjimin e preventivave të paraqitur" nga OE garues, ku pasi u bë korrigjimi i preventivave rendtja provizore sipas vlerës së ofertës, rezultoi:

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	**"K" SHPK**	**25,649,988**	**Kualifikuar/ Skualifikuar**
2	**"L " SHPK**	25,810,575	Skualifikuar
3	**"L" ShA**	**30,695,793**	**Kualifikuar/ Fituesi**
4	**"N " SHPK**	31,805,538	Skualifikuar
5	**"K" SHPK**	31,849,701	Skualifikuar
6	**"B" SHPK**	31,851,498	Skualifikuar
7	**"S" SHPK**	32,323,232	Kualifikuar

-KVO me datë 26.10.2022, ka mbajtur proces verbal nr. 3 "Mbi llogaritjen e ofertave anomalisht të ulëta të paraqitur nga OE" nga OE garues, ku KVO ka kaluar fazën e vlerësimit për 2(dy) OE, përkatësisht:

Nr	*Shoqëria OE/BOE*	*Oferta Lekë PA TVSH*
1	**"L" ShA**	**30,695,793**
2	**"S" SHPK**	32,323,232

Në këtë fazë BOE "K" SHPK është Skualifikuar me argumentin se, ka braktisur garn dhe nuk ka paraqitur dokumentet e tenderit sipas DST, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave (05.10.2021).
KVO me datë 27.10.2022, ka mbajtur proces verbal nr. 4, mbi tenderin me procedurë të hapur me
Në vijim, në datën 01.11.2022 KVO-ja, pasi ka konstatuar se BOE i renditur i pari ("K" SHPK) nuk i është përgjigjur kërkesës për dorëzimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet, i ka dërguar të njëjtën kërkesë OE të rradhës, OE "L" ShA.
-KVO me datë 01.11.2022, ka mbajtur proces verbal nr. 4/1 ka renditur OE të parin "L" SHPKme ofertë 30,695,793 lekë, duke i kërkuar të dorëzojë fizikisht pranë Bashkisë Kamëz dokumentacionin provues në zbatim të nenit 26/2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
-Raporti përfundimtar mbi vlerësimin ekonomik të tenderit është hartuar me datë 22.11.2022.
Në këto kushte, KVO ka skualifikuar BOE "K" SHPK dhe ka shpallur fitues, OE "L" ShA me ofertë **30,695,793 lekë pa TVSh**.
-Për objektin "Ndërtim trotuare + Ndriçim rruga "Jon" + rruga "Fushë Arrës" është lidhur kontrata për punë publike me nr. 11346 prot., datë 05.12.2022 ndërmjet Bashkisë Kamëz përfaqësuar nga Znj. R.S me detyrë Zv/Kryetare dhe, shoqërisë "L" Sh.A përfaqësuar nga Znj. R.K, me vlerë **36,834,951 lekë me TVSH** dhe afat të realizimit të punimeve 90 ditë.

Për sa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 23 nga znj. E.M , është paraqitur observacioni në Bashkinë Kamëz me nr. 1688 prot.,datë 27.02.2024, dorëzuar në KLSH nga Bashkia Kamëz me nr. 1751/1 prot., datë 29.02.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024. Gjitshtu për këtë akt konstatim është paraqitur observacion në rrugë elektronike nga z. E.GJ . Përmbajtja e observacionit për të dy observuesit është e njëjtë, duke pretenduar si më poshtë:
Pretendimet e subjektit (znj. E.M dhe z. E.GJ):
Në lidhje me vlerësimin e ofertave, ku konstatohet se mosparaqitja e dokumenteve të BOE i renditur i pari ("K" SHPK), për dorëzimin provues të vetëdeklarimit, dhe se nga KVO duhet të konstatohej tërheqje apo braktisje e procedurës administrative (garës) nga BOE, duke e klasifikuar si rast të nenit 83, pika 3/a të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 30, pika 6/a të VKM nr. 258 datë 19.05.2021 ku citohen se "AK konfiskon sigurimin e ofertës në rast të : a) tërheqjen e ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave", ju paraqesim kundërshtimet tona të mbështetura ligjërisht, duke mospranuar qëndrimet e grupit të audituesve si më poshtë vijon:
-Në lidhje me konkluzionin e audituesve të KLSH për trajtimin e braktisjes nga gara, sqarojmë se në përfundim të vlerësimit të ofertave, KVO i ka dërguar BOE "K" SHPK, kërkesë nëpërmjet SPE, për dorëzim dokumentacioni provues, në përputhje me parashikimet e Rr.P.P., në pikën 6 të nenit 26 ku citohet se "*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*".

Sqarojmë se BOE "K" SHPK, nuk është përgjigjur kërkesës së KVO për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar, duke detyruar Komisionin të vazhdojë procedurën prokuruese dhe të kalojë në ofertën e renditur e dyta, sipas nenit 97/1 të LPP.
-Ju sqarojmë se Bazuar në nenin 76 pika 3/ë "Kriteret detyruese për skualifikim" të LPP citon "Operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e inforM onit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kritereve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit".
Referuar më bazës ligjore, KVO ka s'kualifikuar BOE K" SHPK, dhe i ka kërkuar dokumentacionin provues OE "L" SHPK, duke rivlerësuar procedurën e
prokurimit. Pra sipas LPP, sqarojmë se faza e dorëzimit të dokumentacionit provues, është ende fazë vlerësimi ofertash dhe operatorësh ekonomik dhe nuk është rast konfiskimi oferte.
Referuar nenit 76 pika 3/ë "Kriteret detyruese për skualifikim" të LPP ku citohet se: "Operatori ekonomik nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit". Pra mos dorëzimi i dokumenteve citohet si arsye detyruese s'kualifikimi.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me sa është pretenduar, audituesi sqaron se:
-**Së pari:** Nga auditimi i zhvillimit të procedurës, në dosjen fizike të prokurimit nuk ndodhej dokumenti i kërkuar nga KVO, për dorëzim dokumentacioni provues për BOE "K" SHPK dhe, audituesi e ka të pamundur të auditojë në kërkesat që realizon NjP dhe KVO në sistemin elektronik SPE.
-**Së dyti:** Pranojmë faktin që, faza e dorëzimit të dokumentacionit provues, është ende fazë vlerësimi ofertash dhe operatorësh ekonomik dhe nuk është rast konfiskimi oferte dhe, për këtë argument grupi i auditimit **merr në konsideratë observacionin**, referuar gjithashtu edhe dokumentit të njoftimit nga KVO, si vijon:


Kërkesat

Kërkesë	Procedurë për Tendera	Përgjigjja	Data e Përgjigjes	Krijuar nga
Kërkesë për paraqitje të dokumentave fizikisht.	Ndërtim trotuare + Ndriçim Rruga "Jon" + Rruga "Fushë Arrëz"			luan marku
Kërkesë për paraqitje të dokumentave fizikisht	Ndërtim trotuare + Ndriçim Rruga "Jon" + Rruga "Fushë Arrëz"			luan marku

Mbyll

Konstatim nga grupi i auditimit se, në lidhje me mosparaqitjen e BOE i renditur i pari ("K" SHPK), për dorëzimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet, **KVO duhet të konstatonte tërheqjen apo braktisen e procedurës administrative** (garës) nga BOE të jetë tërhequr përpara këtij afati, në zbatim të nenit 83.

pika 3/a të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 30, pika 6/a të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, ***do të reflektohet në Raportin Përfundimtar të auditimit***.

7. Procedura e prokurimit me objekt: "***Ndërtim rrugët (Rr. "William Shekspir" + Rr."Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" + Rr. "Isuf Gërvalla"+Rr. "Brezaret" +Rr. "Daniel Alia"***".

Përshkrimi i situatës 7: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Nërtim rrugët (***Rr. "William Shekspir" + Rr. "Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" +Rr. "Isuf Gërvalla"+ Rr. "Brezaret"+ Rr. "Daniel Alia***" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim rrugët (Rr. "Ëilliam Shekspir" + Rr."Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" +Rr. "Isuf Gërvalla"+ Rr. "Brezaret"+ Rr. "Daniel Alia")", Bashkia Kamëz		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 5732 Prot., datë 23.06.2022 **2. Lloji i Procedurës** **"**Procedurë e Hapur – Punë Publike" me elkronikë	**3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Njesia e prokurimit -SH.XH, Personi i ngarkuar -S.S , anëtare -S.V , anëtare, jurist	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr. 5732/1 Prot., datë 23.06.2022 - E.GJ , kryetar - L.M , anëtar -E.L, anëtar KVO ka ndryshuar me urdhrin nr. 6489 prot., datë 18.07.2022. - E.GJ , kryetar (zëvendësohet me F.M) - L.M , anëtar -E.L, anëtar (zëvendësohet me E.D)
5. Fondi Limit (pa tvsh) 55,493,000 lekë **REF-34091-06-23-2022**	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** OE "E" SHPK me vlerë **54,393,320** lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit(pa tvsh)** 1,099,680 lekë pa TVSH ose ë masën 1.98 %
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 11.07.2022	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Kamëz	**10. Operatoret Ekonomike** **a)** Pjesëmarrës në tender 4 OE **b)** Skualifikuar 3 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **Nuk ka**	**12. Përgjigje Ankesës** Nuk ka	**13. Përgjigje** Nuk ka
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Sherbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 3673 prot., datë 31.08.2022	**15. Vlera kontratës (me tvsh)** 65,271,984 **lekë**	**16. Afati i kontratës në ditë** Parashikuar 115 ditë pune nga data e lidhjes së kontratës.

u konstatuan problematikat si vijojnë:

a) AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve të përgjithshme të Pranim/kualifikimit":

Nga auditimi i vendosjes së kritereve të pranim/kualifikimit u konstatua:

1. Për pikën 2.3.2 nga AK është kërkuar që, OE duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, ndëe të tjera: **NP-7 A** Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.

Sipas Grupit të Auditimit, ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar në projekt preventiv dhe, aq më tepër kjo kategori licence nuk lidhet me zëra pune që lidhen me punime në rrjetin e kanalizimeve.

2. Për pikën 2.3.5 AK ka kërkuar që, OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, **1 (një) Inxhinier Mekanik**.

Sipas Grupit të Auditimit: *Nga auditimi konstatohet, se vendosja e kriterit për 1 (një) inxhinier mekanikë është kërkesë e tepërt dhe e panevojshme, pasi referuar llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime mekanikë të cilat kanë nevojë për asistencën e inxhinierit mekanik. Preventiv nuk ka vendosje barrierave metaike. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim*

me 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe, nenit 39, pika 6, germa (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe, ***ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit.***

3. Për pikën 2.3.9 AK ka kërkuar që, OE duhet te paraqese **nje kontrate te lidhur** për kryerjen e analizave me një laborator i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, ndër të tjera për materialet (1) **Beton i fresket sipas standardeve të mëposhtme ose të përditësuara**, (2) Beton i ngurtesuar sipas standardeve të meposhtme ose të përditësuara, (3) **Perzierje Bituminoze sipas standardeve të meposhtme ose të përditësuara,** (4) **Materiale Rrugore sipas standardeve të meposhtme ose të përditësuara.**

Sipas grupit të auditimit: *Vendosja e kriteritit nga NjP, nuk qëndron dhe është e tepërt, sepse kryerja e analizave është parashikuar në DT (Shtojca 16 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK), neni 13 "Testimet dhe Inspektimet". Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lidhjen e kontratës me një laborator të akredituar.*

4. Për pikën 2.3.10 AK ka kërkuar që, OE pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, ndër të tjera, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme (1) **Fabrike asfaltobetoni** e pajisur me lejet perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi (2) **Nyje prodhim inertesh** e pajisur me leje perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi. :

Sipas grupit të auditimit: *Sa më sipër, konstatohen kërkesa kualifikuese shumë të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës.*

Sic vërehet janë kërkuar mjete si: Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), Nyje prodhim Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), në mënyrë të pajustifikuar dhe të paargumentuar.

Vendosja Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), Nyje prodhim Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Fabrikë asfaltobetoni dhe Nuje prodhim inertesh. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marre me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë ne tender. Gjithashtu AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të asfaltobetonit dhe prodhim inertesh në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore **Kodi III 1 B** lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e këtyre dokumentave përben kusht për skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

-Sipas procesverbali Nr. 1 (i hapjes së ofertave të tenderit), datë 18.07.2022, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 (katër) OE, me renditje, përkatësisht:

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***
1	OE N.	53,824,040
2	OE "E" SHPK	54,393,320
3	OE "E" SHPK	55,073,626
4	OE "K" SHPK	55,308,532

Nga KVO, janë mbajtur:
-Proces verbal nr. 2, datë 20.07.2022 "Mbi korrigjimin e preventivave të paraqitur nga OE".
-Proces verbal nr. 3, datë 26.07.2022 "Mbi llogaritjen e ofertave anomalisht të ulëta të paraqitur nga OE".
-Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr 4, datë 27.07.2022, KVO-ja ka kryer vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikim/skualifikim***
1	OE "K" SHPK	55,308,532	skualifikohet
2	OE N. SHPK	53824,040	skualifikohet
3	OE "E" SHPK	55,073,626	skualifikohet
4	**OE "E" SHPK**	**54,393,320**	**Kualifikohet**

Vlerësimi nga KVO:
Operatorë ekonomik të kualifikuar: OE "E" SHPK, pasi plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit dhe është identifikuar si oferta e sukseshme.
Opertorë ekonomik të skualifikuar: OE "K" SHPK; OE N. SHPK dhe OE "E" SHPK për arsyen se Operatorët Ekonomik *nuk kanë paraqitur sigurimin e ofertës*.
Referuar procesverbalit përkatës si dhe njoftimit të fituesit, rezulton se fillimisht KVO-ja, pasi ka kualifikuar 1(një) OE nga ato pjesëmarrës në garë, ka kërkuar nga OE i renditur i pari (me ofertë më të vogël) "E" SHPK, NUIS J....L me vlerë të ofertës ekonomike 54,393,320 lekë pa TVSH dorëzimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet e bëra.

Vlerësimi nga grupi i auditimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionuit në dosje si dhe në SPE të OE "E" SHPK, rezulton se dokumentet e paraqitura janë sipas kritereve e përgjithshme të pranim/kualifikimit dhe, kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara në DT dhe kualifikimi i këtij OE është i drejtë dhe në përputhje me nenin 92, pika 3 të ligjit 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" si dhe nenin 38 dhe 82 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Gjithashtu skualifikimi është i drejtë. Vlerësimi është bërë në përputhje me LPP dhe në gjykimin e grupit të auditimit.

Për ktë procedurë prokurimi me nr. 3673 prot., datë 31.08.2022 është lidhur kontrata për punë publike, ndërmjet Bashkisë Kamëz, përfaqësuar nga znj. U.E me detyrë Zv/Kryetar dhe OE "E" SHPK me administrator Z. S.Ç. Kontrata ka vlerën 65,271,984 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të punimeve 115 ditë pune nga data e lidhjes së kontratës dhe, garanci punimesh 24 muaj.

8. Procedura e prokurimit me objekt: "***Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit" Njësia Administrative Babrru, Paskuqan"***.

Përshkrimi i situatës 8: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Lidhja e Prizrenit" Njësia Administrative Babrru, Paskuqan" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Lidhja e Prizrenit" Babrru Paskuqan". REF-33011-06-15-2022*		
1. Urdhër Prokurimi Nr 5414 Datë 15.06.2022	**3.1 Njësia e Prokurimit** SH.XH, përgjegjëse e NjP S.S , anëtar S.V , anëtare	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** **Faza e parë:** Urdhër 5414/1 datë 15.06.2022 E.GJ , Kryetar L.M , anëtar F.M , anëtar **Faza e dytë:** Urdhër 6622 datë 21.07.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit **"**I kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)" Marrveshe kuadër		

		E.GJ , Kryetar F.M , anëtar Englantina Disha, anëtare
5. Fondi Limit (pa tvsh) 283,206,705 lekë	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** 281,000,000lekë BOE "R" & "N" SHPK	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 2,206,705 lekë ose 0.77 %
8. Data e hapjes së tenderit Data 27.06.2022 Bëhet me datë 04.07.2022 pas modifikimit të DT. Njoftimi i kontratës nga AK, është bërë me nr. 5414/2 prot., datë 15.06.2022	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender 2 BOE b) Kualifikuar 2 BOE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 7130 prot. datë 10.08.2022 me afat 10 muaj.	**15. Vlera e kontratës (pa tvsh)** 281,000,000 lekë	

u konstatuan problematikat si vijojnë:

a) AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve të përgjithshme të Pranim/kualifikimit":

Nga auditimi i vendosjes së kritereve të pranim kualifikimit u konstatua:

1. Për pikën 2.3.4 AK ka kërkuar që, OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **140 persona...**

Sipas grupit të auditimit: *Numri i personave, nuk është argumentuar nga NJP vendosja e tyre, në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës. Sasia shumë e madhe e punonjësve të operatorëve ekonomik, menjëherë ngushton tej mase konkurrencën, pasi shumë pak Operator Ekonomik në sektorin e ndërtimit, në Republikën Shqiptare, nuk disponojnë kaq numër të lartë punonjësish. Pra menjëherë AK, indirekt vështirëson pjesëmarjen e operatorëve ekonomik, duke drejtuar ofertuesit drejt B. it të operatorëve ekonomik, me qëllim arritjen e numrit të punonjësve.*

2. Për pikën 2.3.7 AK ka kërkuar që, OE ofertues duhet të ketë të punësuar personel të kualifikuar/çertifikuar të paktën;

a. 1 (një) inxhinier që të disponojë Çertifikatën e trajnimit si "***Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"***, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shendetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier", e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/ Certifikate si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë* **Mars 2022- Maj 2022**.

b. OE për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar 1(**një) mjek të përgjithshëm** ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim.

Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë.

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontratapër këtë shërbim, licensa përkatëse , si dhe faturen e ketij sherbimi, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015). Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.

Për përmbushjen e këtyre kriteve, operatori duhet të paraqesë diplomë/ Çertifikatat e cituara më sipër dhe kontrate pune dhe të fıgurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Sipas grupit të auditimit: *Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet*

shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet. Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë". Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar.

3. Për pikën 2.3.8 AK ka kërkuar që, OE pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ndër të tjera (1) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 15-20 ton, (2) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton, (3) Kamioncine deri ne 3.5 ton, (4) Impiant Betoni auomatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) dhe, (4) Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B):

Sipas grupit të auditimit: *-Sa më sipër rezulton se AK ka përcaktuar kërkesa të ekzagjeruara në lidhje me disponimin emakinerive/pajisjeve apo kanë kërkuar makineri/pajisje të pa-argumentuara sipas numrit dhe llojit të tyre dhe që nuk janë në përputhje me punimet objekt kontrate. Nuk ka asnjë analizë teknike ku sasia e makinerive/pajisjeve të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre apo grafikun e punimeve.*

Këto kërkesa janë në kundërshtim me sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

-Sa më sipër, konstatohen kërkesa kualifikuese shumë të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës.

Sic vërehet janë kërkuar Impiant Betoni auomatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi si dhe, Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar.

Vendosja e Impiant Betoni auomatik me mikser dhe, Nyje inertesh, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni, Nyje inertesh. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë në tender.

Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit dhe inerteve në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht per skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit.

4. Në pikën 4.2 të DT, *tek kriteret e përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar që AK do të vlerësojë ofertën ekonomikisht më e favorshme, bazuar në* ***kosto****. (-****Koha e zbatimit të kontratës*** *me* ***30 pikë; - Çmimi më i ulët*** *me* ***60 pikë; -Cilësia*** *me* ***10 pikë****).*

Sa mësipër, për një vlerësim sa më objektiv sipas peshës specifike, duhet të përcaktohen pikët për çdo kriter dhe nënkriter, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë.

Theksojmë se, bazuar në dispozitat e sipërcituara, kriterei për shpalljen e ofertës fituese në rastin e procedurës konkrete objekt auditimi do të duhet të ishte automatikisht ai i ofertës ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

Nga ana tjetër, referuar kriterit të përzgjedhur në mënyrë të gabuar nga NJP, atij të "ekonomikisht më e favorshme në bazë të kostos", edhe sikur të merret e miëqenë vendosja e këtij kriteri, rezulton se në perbërjen e tij ka elementë të pabazuar në ligj dhe cënues të mundësisë së konkurrencës efektive.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO (Faza 1).

"Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit" Njësia Administrative, Babrru Paskuqan".

Dorëzimi i ofertave u realizua më 04.07.2022, ku kanë marrë pjesë 2(dy) OE/BOE, si më poshtë dhe, në vijim KVO më datë 07.07.2022, përfundoi vlerësimin e ofertave bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto sipas rendësisë, duke bërë vlerësimin e pikëve të operatorëve si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	NIPTI	Vlerësimi
1	BOE R.SHPK & "N" SHPK	L.....A/K.....I	Kualifikuar
2	BOE U.SHPK & "U." SHPK	K.....Q/J.....O	Kualifikuar

Faza e dytë:

-KVO me përbërje (E.GJ , Kryetar; F.M , E. D., anëtar me Urdhër nr. 6622 prot., datë 21.07.2022) me datë 21.07.2022 ka mbajtur proces verbal për hapjen e ofertave për objektin: "Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit" Njësia Administrative, Babrru Paskuqan".

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta ekonomike	Vlerësimi
1	BOE R.SHPK & "N" SHPK	281,000,000	Kualifikuar
2	BOE U.SHPK & "U." SHPK	283,000,000	Kualifikuar

KVO, pas shqytimit të dokumenteve, ka bërë vlerësimin e fazës së II-të me **pikë** sipas tabelës si vijon:

Kriteri	**Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender**	
	BOE R.SHPK & "N" SHPK	BOE U.SHPK & "U." SHPK
x- Çmimi	50	35
y-Koha e zbatimit	30	30
z-Metodologjia	10	10
TOTALI (x+y+z)	**90**	**75**
Renditja	**1**	**2**

Konstatohet se nga KVO në procesverbalin e datës 25.07.2022 mbi vlerësimin e Fazës së II-të për OE të kualifikuar, vlerësimi jepet në pikët totale pa përdoren formulën sipas pikës 4.2 të DT.

Vlerësimi sipas grupit të auditimit:

Në gjykimin e grupit të auditimit, vlerësimi mbi çmimim, duhej që nga KVO, të bëhej në mëyrë individuale nga çdo anëtar i KOV-së, me **interpolim linear ose sipas formulës në DT**.
Sa më sipër vlerësimi do te ishte si vijon:
1. BOE R.SHPK & "N" SHPK, ka paraqitur ofertën me vlerë më të ulët **281,000,000 lekë** dhe duhej të vlerësohej me **60 pikë maksimale** dhe jo me **50 pikë maksimale**.
-Afati i kontratës është paraqitur **12 muaj**, duke u vlerësuar me **30 pikë maksimale**.
Nga llogaritja e bërë nga grupi i auditimit, rezulton se duhej të ishte vlerësuar me **25 pikë** dhe jo me **30 pikë** [12 muaj : 10 muaj x 30 pikë=**25 pikë**].
2. BOE U.SHPK & "U." SHPK, ka paraqitur ofertën me vlerë **283,000,000** lekë dhe është vlerësuar me **35 pikë.**
-Nga llogaritja e bërë nga grupi i auditimit, rezulton se duhej të ishte vlerësuar me **59.57 pikë** dhe jo me **35 pikë** [281,000,000 lekë : 283,000,000 lekë x 60 pikë=**59.57 pikë**].
-Afati i kontratës është paraqitur **12 muaj**, duke u vlerësuar me **30 pikë**.
Nga llogaritja e bërë nga grupi i auditimit, rezulton se duhej të ishte vlerësuar me **25 pikë** dhe jo me **10 pikë** [10 muaj : 12 muaj x 30 pikë=**25 pikë**].

Kriteri		**Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender**	
	Kriteret e vlerësimit, sipas DT (pikë)	BOE R.SHPK & "**N**" SHPK	BOE A. SHPK
x- Çmimi	60	60	59.57
y-Koha e zbatimit	30	25	25
z-Metodologjia	10	10	10
TOTALI (x+y+z)	**100**	**95**	**94.57**
Renditja		**1**	**2**

Konkluzion mbi vlerësimin me pikë nga grupi i auditimit:
*Pavarësisht nga vlerësimi me pikë sipas formulës në DT, nuk ndryshon renditja e vendit të parë për BOE R.SHPK & "N" SHPK, ndërkohë që ndryshon renditja e vendit të dytë. Vlerësimi për BOE U.SHPK & "U." SHPK do të ishte me **94.57 pikë** dhe jo me **75 pikë** siç është vlerësuar nga KVO.*
*Në qoftë se AK dhe NjP për kriteret vlerësuese do të përcaktonte **peshen specifike të secilit kriter/nënkriter** dhe konkretisht **pikët** që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm, sipas **Formulës në dokumentet standarde të tenderit, nga KVO do bëhej një vlerësim më i saktë, në zbatim të** nenit 45 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" pika 8 i cili përcakton: "Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa **më objektive dhe të shprehen në shifra**. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha specifike (sa pikë do të ketë çdo kriter) nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë".*
KVO duke vlerësuar në renditje në vendin e parë BOE "E" SHPK & "B" SHPK ka vepruar në përputhje me Neni 99, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si nenit 84, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Kontrata e punimeve me objekt: "Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Lidhja e Prizrenit" Njësia Administrative, Babrru Paskuqan" është nënshkruar me nr. 7130 prot. datë 10.08.2022, midis AK Bashkisë Kamëz, përfaqësuar nga Zv/Kryetar Znj. U.E dhe BOE "R" SHPK(81%) & "N" SHPK (19%), përfaqësuar nga OE R.SHPK me administratori Z. Renido Petritaj, bazuar në në prokurën e posaçme nr. 2252 rep., nr. 677 kol., datë 29.06.2022 dhe kontratës së bashkëpunimit nr. 2250 rep., nr. 675 kol., datë 29.06.2022. Vlera e kontratës është 281,000,000 lekë pa TVSH me afat realizimi 10 muaj dhe garanci punimesh 24 muaj.

9. Procedura e prokurimit me objekt: "***Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari" Zall-Mner Bashkia Kamëz"***.

Përshkrimi i situatës 9: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari" Zall-Mner Bashkia Kamëz" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari" Zall-Mner" REF-44809-10-07-2022*		
1. Urdhër Prokurimi Nr 9050 Datë 06.10.2022 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**I kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)" Marrveshe kuadër	**3.1 Njësia e Prokurimit** SH.XH, përgjegjëse e NjP S.S , anëtar S.V , anëtare	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** **Faza e parë:** Urdhër 9050/1 datë 06.10.2022 E.B , Kryetar L.M , anëtar H.M , anëtar KVO ka ndryshuar: Urdhër 9912 datë 27.10.2022 E.B , Kryetar G.B , anëtar H.M , anëtare **Faza e dytë:** Urdhër 11505 datë 09.12.2022 H.M , Kryetar E.M , anëtare A.D , anëtare
5. Fondi Limit (pa tvsh) 269,364,773 lekë	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** 269,064,786.92lekë BOE "K" & "U" SHPK	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 299,986.08 lekë ose 0.11 %
8. Data e hapjes së tenderit Data 20.10.2022 Bëhet me datë 27.10.2022 pas modifikimit të DT.	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE b) Kualifikuar 2 BOE c) Skualifikuar 2 BOE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 11885 prot. datë 10.12.2022 me afat 5 muaj.	**15. Vlera e kontratës (pa tvsh)** 269,064,786.92,000,000 lekë	

u konstatuan problematikat si vijojnë:

a) AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve të përgjithshme të Pranim/kualifikimit":

Nga auditimi i vendosjes së kritereve të pranim/kualifikimit u konstatua:

1. Për pikën 2.3.11 AK ka kërkuar që, OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **100 (njëqind)** punonjës, me kohë të plotë, për periudhën **3 (tre) muajt e fundit** e vertetuar kjo me:

a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri ipunonjësve për secilin muaj.
b) b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Sipas grupit të auditimit: *Numri i personave, nuk është argumentuar nga NJP vendosja e tyre, në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës. Sasia shumë e madhe e punonjësve të operatorëve ekonomik, menjëherë ngushton tej mase konkurrencën, pasi shumë pak Operator Ekonomik në sektorin e ndërtimit, në Republikën Shqiptare, nuk disponojnë kaq numër të lartë punonjësish. Pra menjëherë AK, indirekt vështirëson pjesëmarjen e operatorëve ekonomik, duke drejtuar ofertuesit drejt B. it të operatorëve ekonomik, me qëllim arritjen e numrit të punonjësve.*

2. Për pikën 2.3.6 AK ka kërkuar që, OE duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- **1 (një)** punonjes pergjegjes, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit për ***"Pergjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në Punë",*** e dhëne nga një organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, i cili duhet të figurojë në listëpagesë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diploma/certifikata

3. Për pikën 2.3.10 AK ka kërkuar që, Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (një) mjek** të përgjithshëm të punësuar/ ose në marrëdhenie kontraktore, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë dhe të jetë pjesë e stafit të shoqërisë në periudhën e zhvillimit të procedurës prokurimit. Në rastin e J.V cdo anëtar duhet të ketë të punësuar një Mjek të Përgjithshëm. Kjo gjithnjë referuar VKMNr. 108, datë 09.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", i ndryshuar me VKM Nr.632, date 15.07.2015, ku parashikohen mënyrat e sigurimit të shërbimeve mjekësore, në bazë të numrit të punonjësve që punëdhënësit kanë të punësuar në subjektet e tyre, dhe sipas sektorëve të industrisë, të përcaktuara në këtë VKM.

Sipas grupit të auditimit: *Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet. Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë". Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar.*

4. Për pikën 2.3.10 AK ka kërkuar që, OE pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ndër të tjera "Fabrikë Prodhimi Betoni":

Sipas grupit të auditimit: *Sa më sipër, konstatohen kërkesa kualifikuese shumë të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës. Siç vërehet janë kërkuar Impiant Betoniauomatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar.*

Vendosja e Impiant Betoniauomatik me mikser, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë në tender. Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht per skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit.

5. Në pikën 4.2 të DT, *tek kriteret e përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar që AK do të vlerësojë ofertën ekonomikisht më e favorshme, bazuar në* ***kosto****. (-****Koha e zbatimit të kontratës*** *me* ***30 pikë; - Çmimi më i ulët*** *me* ***60 pikë; -Cilësia*** *me* ***10 pikë****).*
Sa mësipër, për një vlerësim sa më objektiv sipas peshës specifike, duhet të përcaktohen pikët për çdo kriter dhe nënkriter, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë.
Theksojmë se, bazuar në dispozitat e sipërcituara, kriterei për shpalljen e ofertës fituese në rastin e procedurës konkrete objekt auditimi do të duhet të ishte automatikisht ai i ofertës ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.
Nga ana tjetër, referuar kriterit të përzgjedhur në mënyrë të gabuar nga NJP, atij të "ekonomikisht më e favorshme në bazë të kostos", edhe sikur të merret e miëqenë vendosja e këtij kriteri, rezulton se në perbërjen e tij ka elementë të pabazuar në ligj dhe cënues të mundësisë së konkurrencës efektive.
b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO (Faza 1).
Dorëzimi i ofertave u realizua më 27.10.2022, ku kanë marrë pjesë 4 (katër) OE/BOE, si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	NIPTI
1	OE A. SHPK	K.....L
2	BOE "K" SHPK & U.SHPK	K.....C/K.....Q
3	OE "K" SHPK	K.....A
4	OE "N" SHPK	K....C

-KVO-ja me shkresën me nr. 10225 prot., datë 03.11.2022, i drejtohet DPP dhe IT dhe NjP me kërkesë për sqarim lidhur me shtojcën 15, pika1.
-Në vijim NjP me shkresën me nr. 10225 prot., datë 04.11.2022, sqaron KOV-në seofertat ekonomike dorëzohen në fazën e dytë dhe sigurimi i ofertës do të paraqitet nga OE të kualifikuar për të paraqitur oferë për kryerjen e shërbimeve për objektin në fazën e dytë.
KVO më datë 24.11.2022, përfundoi vlerësimin e ofertave bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto sipas rendësisë, duke bërë vlerësimin e pikëve të operatorëve si më poshtë:
KVO ka kualifikuar dhe skualifikuar si vijon:

Nr	Operatori Ekonomik	NIPTI	Vlerësimi
1	**OE A. SHPK**	**K.....L**	**Kualifikuar**
	Dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanata të DT		
2	**BOE "K" SHPK & U.SHPK**	**K.....C/K.....Q**	**Kualifikuar**
	Dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanata të DT		
3	**OE "K" SHPK**	**K.....A**	**Skualifikuar**
	Skualifikohet për arsyet e mëposhtme: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 100 (njëqind) punonjes, me kohë të plotë, për periudhën 3 (tre) muajt e fundit e vertetuar kjo me: a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj. b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni		
4	**OE "N" SHPK**	**K.....C**	**Skualifikuar**
	Dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanata të DT		

Faza e dytë:

-KVO me përbërje (H.M Kryetar, E.M dhe A.D , anëtarë, sipas Urdhërit nr. 11505 prot., datë 09.12.2022) me datë 09.12.2022 ka mbajtur proces verbal , për hapjen e ofertave për objektin: Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari" Zall-Mner Bashkia Kamëz.

Nr	Operatorët	Oferta (lekë pa TVSH)	Renditja
1	**BOE "K" SHPK & U.SHPK**	**269,064,786.92**	**1**
2	OE A. SHPK	269,164,796.85	2

KVO, pas shqytimit të dokumenteve, ka bërë vlerësimin e fazës së II-të me **pikë** sipas tabelës si vijon:

Kriteri	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender	
	BOE "K" SHPK & U.SHPK	OE A. SHPK
x- Çmimi	45	35
y-Koha e zbatimit	30	30
z-Metodologjia	10	10
TOTALI (x+y+z)	**85**	**75**
Renditja	**1**	**2**

Konstatohet se nga KVO në procesverbalin e datës 09.12.2022 mbi vlerësimin e Fazës së II-të për OE të kualifikuar, vlerësimi jepet në pikët totale pa përdoren formulën sipas pikës 4.2 të DT.

Vlerësimi sipas grupit të auditimit:

Në gjykimin e grupit të auditimit, vlerësimi mbi çmimim, duhej që nga KVO, të bëhej në mëyrë individuale nga çdo anëtar i KOV-së, me **interpolim linear ose sipas formulës në DT**.

Sa më sipër vlerësimi do te ishte si vijon:

1. BOE "K" SHPK & U.SHPK, ka paraqitur ofertën me vlerë më të ulët **269,064,786.92 lekë** dhe duhej të vlerësohej me **60 pikë maksimale** dhe jo me **45 pikë maksimale**.

-Afati i kontratës është paraqitur **5 muaj**, duke u vlerësuar me **30 pikë maksimale**.

2. OE A. SHPK, ka paraqitur ofertën me vlerë **269,164,796.85 lekë** dhe është vlerësuar me **35 pikë.**

-Nga llogaritja e bërë nga grupi i auditimit, rezulton se duhej të ishte vlerësuar me **59.97 pikë** dhe jo me **35 pikë** [269,064,786.92 lekë : 269,164,796.85 lekë x 60 pikë = **59.97 pikë**].

Kriteri		Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender	
	Kriteret e vlerësimit, sipas DT (pikë)	BOE "**K**" SHPK & U.SHPK	BOE A. SHPK
x- Çmimi	60	60	59.97
y-Koha e zbatimit	30	30	30
z-Metodologjia	10	10	10
TOTALI (x+y+z)	**100**	**100**	**99.97**
Renditja		**1**	**2**

***Konkluzion mbi vlerësimin me pikë nga grupi i auditimit**:*

*Pavarësisht nga vlerësimi me pikë sipas formulës në DT, nuk ndryshon renditja e vendit të parë për BOE "K" SHPK & U.SHPK, dhe për operatorin e dytë. Vlerësimi për BOE "K" SHPK & U.SHPK do të ishte me **100 pikë** dhe jo me **85 pikë** dhe, për OE A. SHPK do të ishte me **99.97 pikë** dhe jo me **75 pikë,** siç është vlerësuar nga KVO.*

*Në qoftë se AK dhe NjP për kriteret vlerësuese do të përcaktonte **peshen specifike të secilit kriter/nënkriter** dhe konkretisht **pikët** që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm, sipas **Formulës në dokumentet standarde të tenderit, nga KVO do bëhej një vlerësim më i saktë, në zbatim të** nenit 45 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" pika 8 i cili përcakton: "Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa **më objektive dhe të shprehen në shifra**. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha specifike (sa pikë*

do të ketë çdo kriter) nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë".
KVO duke vlerësuar në renditje në vendin e parë BOE "K" SHPK & U.SHPK ka vepruar në përputhje me Neni 99, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si nenit 84, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

-KVO, për një vlerësim sa më objektiv sipas peshës specifike, duhet të përcaktohen pikët për çdo kriter dhe nënkriter, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë.
Në zbatim të marrëveshjes kuadër nr. 11181/2022, është lidhur Kontrata për punë publikë me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari" Zall-Mner Bashkia Kamëz" me nr. 11885 prot. datë 20.12.2022, midis AK Bashkisë Kamëz, përfaqësuar nga Zv/Kryetar Znj. R.S dhe BOE "K" SHPK(78%) & "U" SHPK (22%), përfaqësuar nga OE "K" SHPK me administratori Z. Q.K, bazuar në kontratës së bashkëpunimit nr. 274 rep., nr. 147 kol., datë 25.10.2022. Vlera e kontratës është 269,064,786.92 lekë pa TVSH me afat realizimi 5 muaj dhe garanci punimesh 24 muaj.

10. Procedura e prokurimit me objekt: "***Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamëz"***.

Përshkrimi i situatës 10: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamëz" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamëz".*		
1. Urdhër Prokurimi Nr 944 Datë 02.02.2022 REF- 18549-02-03-2022 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**I kufizuar (në kuadër të procesit të riN)" Marrëveshje kuadër	**3.1 Njësia e Prokurimit** SH.XH S.S S.V	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** **Faza e parë:** Urdhër 944/1 datë 02.02.2022 E.GJ , Kryetar F.M L.M **Faza e dytë:** Urdhër 9500 datë 17.10.2022 F.M , Kryetar E.D , anëare E.M
5. Fondi Limit (pa tvsh) 382,257,411 lekë	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** 380,257,411 lekë BOE " A" & "E" SHPK & "I " SHPK	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 2,000,000 lekë ose 0.52%
8. Data e hapjes së tenderit Data 15.02.2022	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender 8 BOE b) S'kualifikuar 6 BOE, c) Kualifikuar 2 BOE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës 3183 prot. datë 13.04.2022 me afat 10 muaj.	**15. Vlera e kontratës (pa tvsh)** 380,257,411 lekë	

u konstatuan problematikat si vijojnë:

a) AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve të përgjithshme të Pranim/kualifikimit":
Nga auditimi i vendosjes së kritereve të pranim/kualifikimit u konstatua:
1- Është kërkuar që Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 150 persona. Argumentimi i bërë me një shkresë që disponohet në dosjen e prokurimit nuk është teknik dhe i pabazuar në Manuale e N.

2- Në pikën 2.3.5 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 1 inxhinier ndërtimi, një topograf, një ing mekanik, një ing elektrik, një ing. Hidroteknik dhe një arkitekt, të cilët duhet të jenë në licencën profesionale, si dhe staf mbështetës një ing tjetër ndërtimi, një ing mjedisi, një ing tjetër elekrik dhe 2 teknikë ndërtimi. Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me natyrën dhe volumin e punimeve në objektin që prokurohet (një ing ndërtimi, një ing elekrik, një ing mjedisi dhe 2 teknikët e N).
3- Është kërkuar një mjek i përgjithshëm. Ky kriter nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet;
4- Në pikën 2.3.10 janë kërkuar mjete për realizimin e punimeve si: Trajler per transport mjetesh, Autobot uji 2 copë, Impiant Betoni automatik **me mikser**, Depozitë Uji (30.000 Litra), Rul vibrusminimumi 8 ton, 2 copë; Kamion me kosh per punime ne lartesi; Sonde shpimi me diameter Ø 1000 mm; Autobot per largimin e ujrave te zeza; Konteiner stacioner. Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me natyrën dhe volumin e punimeve në objektin që prokurohet (një Ing ndërtimi, një Ing elekrik, një Ing mjedisi dhe 2 teknikët e N).
5. ***Në pikën 4.2 të DT,*** *tek kriteret e përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar që AK do të vlerësojë ofertën ekonomikisht më e favorshme, bazuar në* ***kosto****.* ***(-Koha e zbatimit të kontratës*** *me* ***30 pikë; - Çmimi*** *më i ulët* ***me 60 pikë****;* ***-Cilësia*** *me* ***10 pikë).***
Sa mësipër, për një vlerësim sa më objektiv sipas peshës specifike, duhet të përcaktohen pikët për çdo kriter dhe nënkriter, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë.
Theksojmë se, bazuar në dispozitat e sipërcituara, kriteri për shpalljen e ofertës fituese në rastin e procedurës konkrete objekt auditimi do të duhet të ishte automatikisht ai i ofertës ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim, si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.
b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO (Faza 1).
Dorëzimi i ofertave u realizua më 15.02.2022, ku kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomikë, si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik
1	**OE "4 A-M"**
2	**BOE "A" & "E" SHPK & "I" SHPK**
3	BOE "A " & "K" SHPK
4	OE "E"
5	BOE E. SHPK & "L" SHPK
6	BOE "G" SHPK & "S" SHPK
7	OE "K" SHPK
8	BOE :S" SHPK & "Z" SHPK

Nga verifikimi i procesverbalit të shqyrtimit të ofertave për Lotin I dhe Raporti Përmbledhës, u konstatua se janë skualifikuar OE si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik
1	BOE "A " & "K" SHPK
2	OE "E"
3	BOE E. SHPK & "L" SHPK
4	BOE "G" SHPK & "S" SHPK
5	OE "K" SHPK
6	BOE :S" SHPK & "Z" SHPK

përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. **BOE "ASHPK**

Arsyeja:

- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 të seksionit 2.3 "Për kapacitetin teknik" të Kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur, nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për përvojën e mëparshme të ngjashme.
  a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
  b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

2. Operatori ekonomik **"E"SHPK,**

Arsyeja:

- Nuk ka paraqitur asnjë dokumentet të kërkuar në DST

3. **B.O.E. "E"** SHPK, & **"B"** SHPK, **&** "**L**" SHPK

Arsyeja:

- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.8 të ërcaktuar në DT, pasi deklarata e paraqitur në sistem në lidhje me Drejtuesin Teknik të punimeve i cili duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt, nuk është firmosur dhe vulosur nga Adminisratori I shoqërisë "B" SHPK;

4. **B.O.E. "G"SHPK & "S"SHPK**

Arsyeja:

- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 të seksionit 2.3 "Për kapacitetin teknik" të Kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur, nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për përvojën e mëparshme të ngjashme.
  a)punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
  b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- Anëtraët "MCE" SHPK, "A" ShPK anëtarë të BOE "G" SHPK & "S" SHPK, nuk kanë plotësuar deklaratën dhë shtojcat e kërkuara sipas DST

5. Operatori ekonomik **"K'SHPK,**

- Nuk ka paraqitur asnjë dokumentet të kërkuar në DST.

6. B.O.E. "S"SHPK, & "Z"SHPK,

Arsyeja:

- Ofertuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për përvojën e mëparshme të ngjashme.
  a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
  b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Pika "a", plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në B. . Anëtarët e tjerë të B. it do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B. . Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një B. i, kanë të

njëjtën përqindje pjesmarrje në B. , vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbushë këtë kusht.
Kurse pika "b", duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e B. it në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B. .
B.O.E. S.SHPK & "Z" SHPK kanë lidhur marrveshje bashkëpunimi: Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë është e ndarë në përqindje si mëposhtë:

- 90% "S"SHPK
- 10% "Z" SHPK

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
Pika "a", plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në B. . Anëtarët e tjerë të B. it do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B. .
Operatori Ekonomik "S"SHPK, ka paraqitur vetëm një punë të ngjashme me objekt: "Shkolla Dom Nikoll Kacorri" me vlerë 138,662,258.25 lekë pa tvsh.
Kontrata koncesionare për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë nuk hyn në punët e ngjashme pasi sipas VKM nr.42, datë 16.1.2008 " Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" kjo kontratë futet në kategorinë "NP-4".
Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë,autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.
Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.
Pra rrugët nuk përfshijnë element të ngjashëm me objektet arsimore e njëjta gjë vlen për kontratën rikualifikimi i sheshit italia dhe rikonceptim i parkut të lojrave të fëmijëve dhe parkim publik 2 kate nën tokë në rrugën e Elbasanit.
Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet që duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e B. it në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B. .
B.O.E.S.& "Z" SHPK, kanë paraqitur kontratat si më poshtë:
"Z"SHPK,- Rikonstruksioni i Konviktit "Kristo Isak" Kamëz, me vlerë **25,637,421** lekë.
"Z" SHPK, - Shkolla 9-vjeçare Shtodhër dhe Shkolla e mesme "26 Marsi" - me vlerë **116,022,429** lekë.
"Z"SHPK, - Ndërtim Pallati – me vlerë **232,146,526** lekë.
"Z"SHPK,- Ndërhyrje për stabilizimin e çarjeve në shkollën e mesme "Dilaver Nezha" – me vlerë **28,767,586** lekë.
S.- Shkolla "Dom Nikoll Kaçorri" me vlerë **138,622,580** lekë.

Total i këtyre punëve të ngjashme nga B.O.E. është 541,196,542 lekëku vlera monetare

totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Gjithashtu, kjo pikë duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e B. it në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B. .
Janë kualifikuar OE si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës të kualifikuar
1	OE "A" SHPK
2	BOE "A" & "E" SHPK & "I" SHPK

Nga verifkikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga grupi i auditimit, rezuloi si më poshtë:
1. BOE "ASHPK, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është skualifikuar me të drejtë (eksperienca e ngjashme nuk është siç është përcaktuar në DT).
2. Operatori ekonomik "E"SHPK, nuk ka paraqitur asnjë dokumentet të kërkuar në DST
3. BOE "E" SHPK, & "B" SHPK, & "L" SHPK, deklarata e paraqitur në sistem në lidhje me Drejtuesin Teknik të punimeve të OE "B" SHPK, ing. I. K., I cili duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt, nuk është firmosur dhe vulosur nga Adminisratori i shoqërisë "B" SHPK.
4. BOE "G"SHPK & "S"SHPK**,** nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është skualifikuar me të drejtë (eksperienca e ngjashme nuk është siç është përcaktuar në DT)**.**
5. Operatori ekonomik "K" SHPK, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është skualifikuar me të drejtë (mjetet, numri i punonjësve nuk janë sipas kritereve të përcaktuara në DT).
6. BOE "S"SHPK, & "Z"SHPK, është skualifikuar me të drejtë për arsyet e paraqitura nga KVO.
- Nga audiimi i dokumentacionit të paraqitur në sistem nga OE të kualifikuar nga KVO dhe konkretisht OE "A" SHPK dhe BOE "A" & "E" SHPK & "I" SHPK, rezulton se janë kualifikuar me të drejtë, pasi i plotësonin kriteret e vendosura në DT.
Me shkresën pa nr. Prot, datrë 01.03.2022, kryetari i KVO-së z. E.GJ ka njoftuar përfundimin e procedurës së Fazës së parë.

FAZA II-të

Me shkresën nr. 2016, datë 07.03.2022 është hartuar Formulari I Njoftimit të OE të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në të cilin janë identifikuar Operatorët Ekonomikë të suksesshëm.
Me procesverbalin datë 07.03.2022 të KVO-së Dhe NjP-së, janë miratuar ftesat për kandidatët që janë kualifikuar në fazën e parë.
Me procesverbalin datë 10.03.2022 për lidhjen e draftmarrëveshjes për kandidaët që janë kualifikuar në Fazën e I-rë, palë në marrëveshjen kuadër me object "Rindëertimi I shkollës 9 vjeçare "Demokracia", është konkluduar me dy draftmarrëveshje me kuadër me dy OE të kualifikuar, respektivisht me nr. 2074 prot., datë 10.03.2022 dhe nr. 2053 prot., datë 10.03.2022.
Me shkresat nr. 2698 prot., datë 01.04.2022 dhe nr. 2712 prot., datë 01.04.2022 janë bërë "Ftesat për Ofertë" respektivisht BOE "A" & "E" SHPK & "I" SHPK dhe OE "A" SHPK.
Me shkreën nr. 2931 prot, datë 07.04.2022 është ngritur KVO për Fazën e Dytë me përbërje F.M , E.D dhe E. M.
Është mbajtur Procesverbali i hapjes së ofertave me datë 07.04.2022, në të cilin është cilësuar lista e dokumenteve të paraqitura nga OE "A" SHPK dhe BOE "A" & "E" SHPK & "I" SHPK.
Po në darën 07.04.2022 është mbajtur Procesverbali i vlerësimit të ofertave sipas të cilit janë paraqitur ofertat si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës të kualifikuar	Oferta ekonomike
1	OE "A" SHPK	382,25,411
2	BOE "A" & "E" SHPK & "I" SHPK	380,257,411

KVO, pas shqytimit të dokumenteve, ka bërë vlerësimin me pikë sipas tabelës si vijon:

Kriteri	Operatorët ekonomikë të lualifikuar në tender	
	BOE "A" & "E" SHPK & "I" SHPK	OE "A" SHPK
x- Çmimi	50 [380,257,411 lekë]	35 [382,257,411 lekë]
y-Koha e zbatimit	30	30
z-Metodologjia	10	10
TOTALI (x+y+z)	**90**	**75**
Renditja	**1**	**2**

Vlerësimi sipas grupit të auditimit:

1. Nga auditimi i dokumentacionit të OE "4 AM" SHPK, konstatohet që ka ky operator ka paraqitur grafikum e punimeve për 10 (dhjetë) muaj (në përputhje me afatin e përcaktuar në shtojcën 1 të DT).
2. Nga auditimi i dokumentacionit të BOE "A" & "E" SHPK & "I" SHPK, konstatohet që ka ky operator ka paraqitur grafikum e punimeve për 10 (dhjetë) muaj, (në përputhje me afatin e përcaktuar në shtojcën 1 të DT).

Në gjykimin e grupit të auditimit, vlerësimi mbi çmimim, duhej që nga KVO, të bëhej me interpolim, sipas formulës së përcaktuar në DT (380,257,411/382,257,411 x 60 pikë).
Sa më sipër vlerësimi do te ishte si vijon:

Kriteri	Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender	
	BOE "A" & "E" SHPK & "I" SHPK	OE "A" SHPK
x- Çmimi	60 [380,257,411 lekë]	59.69 [382,257,411 lekë]
y-Koha e zbatimit	30	30
z-Metodologjia	10	10
TOTALI (x+y+z)	**100**	**99.69**
Renditja	**1**	**2**

Pavarësisht nga vlerësimi i llogaritur gabim nga KVO, në renditje në vendin e parë qëndron përsëri BOE "A" & "E" SHPK & "I" SHPK.

Me shkresën pa nr. Prot, datrë 07.04.2022, kryetari I KVO-së znj. F.M ka njoftuar përfundimin e procedurës së Fazës së dytë.
Raporti përmbledhës i miratuar nga Zv/Kryetar znj. U.E është më datë 11.04.2022, ku janë bashkëlidhur edhe pikët e vendosura mbi çmimin + kohën e zbatimit + metodologjinë e operatorëve nga KVO, ku rezulton me renditjen përfundimtare bazuar në renditjen e pikëve, si vijon:
1. BOE "A" & "E" SHPK & "I" SHPK me 90 pikë.
2. OE A. SHPK me 75 pikë.
-Bashkia Kamëz me shkresën me nr. 3079/1 prot., datë 11.04.2022 i dërgon APP formularin e njoftimit të fituesit për procedurën e prokurimit me objekt: Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamëz.
Kontrata e punimeve me objekt: "Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamëz" nënshkruhet me nr. 3183 prot. datë 1304.2022, midis AK Bashkisë Kamëz, përfaqësuar nga Zv/Kryetar Znj. U.E dhe BOE " A" & "E" SHPK & "I" SHPK përfaqësuar nga Z. Sh.M., S.Ç dhe F.M.. Vlera e kontratës është 380,257,411 lekë pa TVSH me afat realizimi 10 muaj dhe garanci punimesh 24 muaj.

11. Procedura e prokurimit me objekt: "***Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Halit Çoka (ish Elez Isufi)"***.

Përshkrimi i situatës 11: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Halit Çoka (ish Elez Isufi)" me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Halit Çoka (ish Elez Isufi)", Bashkia Kamëz", Nr. REF-18488 datë 02-02-2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 943, datë 02.02.2022 2. Lloji i Procedurës – "E kufizuar" në kuadër të procesit të riN.	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Prokurimi Nr. 943, datë 02.02.2022 Njësia e Prokurimit 1. SH.XH, (Personi përgjegjës), Jurist 2. S.S, inxhinier 3. S.V , Jurist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 943/1 prot., datë 02.02.2022 E.GJ , Kryetar E.J, zëvendësuar me z. L.M F.M
5. Fondi Limit i përafërt (pa TVSh) 437,807,824 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "A.G" & "N.C 2012" SHPK me ofertë 435,807,800 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 3138 prot. datë 13.04.2022, me afat 10 muaj nga data e lidhjes së kontratës.	7. Diferenca me fondin limit 2,000,024 lekë, ose 0.45 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14.02.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit, Fondet e riN	
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

u konstatuan problematikat si vijojnë:

Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:

1- Është kërkuar që Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 150 persona. Argumentimi i bërë me një shkresë që disponohet në dosjen e prokurimit nuk është teknik dhe i pabazuar në Manuale e N.

2- Në pikën 2.3.5 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 1 inxhinier ndërtimi, një topograf, një ing mekanik, një ing elektrik, një ing. Hidroteknik dhe një arkitekt, të cilët duhet të jenë në licencën profesionale, si dhe staf mbështetës një ing tjetër ndërtimi, një ing mjedisi, një ing tjetër elekrik dhe 2 teknikë ndërtimi. Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me natyrën dhe volumin e punimeve në objektin që prokurohet (një ing ndërtimi, një ing elekrik, një ing mjedisi dhe 2 teknikët e N).

3- Është kërkuar një mjek i përgjithshëm. Ky kriter nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet;

4- Në pikën 2.3.10 janë kërkuar mjete për realizimin e punimeve si: Trajler per transport mjetesh, Autobot uji 2 copë, Impiant Betoni automatik **me mikser**, Depozitë Uji (30.000 Litra), Rul vibrusminimumi 8 ton, 2 copë; Kamion me kosh per punime ne lartesi; Sonde shpimi me diameter Ø 1000 mm; Autobot per largimin e ujrave te zeza; Konteiner stacioner. Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me natyrën dhe volumin e punimeve në objektin që prokurohet (një ing ndërtimi, një ing elekrik, një ing mjedisi dhe 2 teknikët e N).

5. ***Në pikën 4.2 të DT,*** *tek kriteret e përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar që AK do të vlerësojë ofertën ekonomikisht më e favorshme, bazuar në* ***kosto*** ***(-Koha e zbatimit të kontratës*** *me* ***30 pikë; - Çmimi*** *më i ulët* ***me 60 pikë****; -****Cilësia*** *me* ***10 pikë).***

Sa mësipër, për një vlerësim sa më objektiv sipas peshës specifike, duhet të përcaktohen pikët për çdo kriter dhe nënkriter, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë.

Gjithashtu, konstatohet se kriteri i caktuar nga njësia e prokurimit për shpalljen e ofertës fituese, ai i "***ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto***" është në kundërshtim meVKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", **neni 45 pika 3**, kucitohet se: " *Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në* ***çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave***.".
Theksojmë se, bazuar në dispozitat e sipërcituara, kriteri për shpalljen e ofertës fituese në rastin e procedurës konkrete objekt auditimi do të duhet të ishte automatikisht ai i ofertës ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim, si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

Mbi vlerësimin e ofertave

Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se është përdorur procedurë "E kufizuar," (Narrëveshje kuadër-Procesi i RiN). Ky prokurim është kryer me dy faza, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", neni 42, pika 6.
Në dosje administrohet procesverbali për hapjen, datë 14.02.2022 procesverbali i shqyrtimit të ofertave, datë 21.02.2022. Nisur nga verifikimi në SPE dhe Proceverbalet e hapjes dhe shqyrtimit të ofertave, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 10 OE, si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës
1	OE "A" SHPK
2	BOE "A.G" SHPK & "N.C" SHPK
3	BOE "A SHPK
4	OE "E" SHPK
5	BOE "E" SHPK & B' SHPK & "L.C" SHPK
6	BOE "E" SHPK & "V" SHPK
7	BOE "G" SHPK & "S" SHPK
8	OE "GJ" SHPK
9	OE "I" SHPK
10	OE "K" SHPK
11	BOE :S" SHPK & "Z" SHPK

Burimi i të dhënave: SPEPunoi: KLSH

Nga verifikimi i procesverbalit të shqyrtimit të ofertave për Lotin I dhe Raporti Përmbledhës, u konstatua se janë skualifikuar OE si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës
1	BOE "A SHPK
2	OE "E" SHPK
3	BOE "E" SHPK & B' SHPK & "L.C" SHPK
4	BOE "E" SHPK & "V" SHPK
5	BOE "G" SHPK & "S" SHPK
6	OE "I" SHPK
7	OE "K" SHPK
8	BOE :S" SHPK & "Z" SHPK

dhe për arsyet e mëposhtme:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

2. **BOE "ASHPK**

Arsyeja:

- Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.
- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 të seksionit 2.3 "Për kapacitetin teknik" të Kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur, nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për përvojën e mëparshme të ngjashme. a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë

së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

4. Operatori ekonomik **"E"SHPK,**

Arsyeja: Nuk ka paraqitur asnjë dokumentet të kërkuar në DST

5. **B.O.E. "E"** SHPK, & **"B"** SHPK, **&** "**L**" SHPK

Arsyeja:

- Nuk ka paraqitur licencën e projektimit sipas kontratës me kompaninë E.
- Licenca e projektimit e operatorit ekonomik L nuk eshte vlefshme sipas kërkesave të DST.
- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 të seksionit 2.3 "Për kapacitetin teknik" të Kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur, nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për përvojën e mëparshme të ngjashme.

6. **B.O.E. "E"**SHPK **& V** SHPK

Arsyeja:

- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 të seksionit 2.3 "Për kapacitetin teknik" të Kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur, nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për përvojën e mëparshme të ngjashme.

Operatori ekonomik "E"SHPK, ka paraqitur si punë të ngjashme këto kontrata:

Operatori ekonomik **"E"**SHPK, 45%. Objekti: "Vendosja e mbikalimeve në aksin rrugor Thuman-Milot dhe Kukës-Morinë". Nuk futet tek punët e ngjashme.

Operatori ekonomik **"E"**SHPK, 60%. Objekti i kontratës: "Rikualifikimi i hapësirave midis kuartallit nga Rruga "Skëndërbej" deri në Rrugën "Mars 91" e hapësira deri tek Rruga e Portit, si dhe sistemimi i ujërave të bardha tek Ura e Dajlanit (Faza I) + Loti II". Nuk futet tek punët e ngjashme.

Operatori ekonomik **"E"**SHPK, 60%. Objekti: "Rikonstruksion dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën e mesme "Ismail Qemali" me vlerë 121,181,236lekë me tvsh. Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë.

Operatori ekonomik **"E"**SHPK,. Objekti: "Ndërtimi rruga Demokracia loti II". Nuk futet tek punët e ngjashme.

Operatori ekonomik **"E"**SHPK, 88.2%. Objekti: "Rikontruksion i pjesshëm i shkollës së mesme të përgjithshme Andon Zako Çajupi" me vlerë 143,721,578 lekë me tvsh. Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë.

Operatori ekonomik **"E"**SHPK, Objekti: "Rivitalizimi i sheshit publik para hyrjes të portit" faza III. Nuk futet tek punët e ngjashme.

Vlera monetare totale e punëve të kryera, **e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është më e vogël se dyfishi i vlerës të fondit limit të kontratës që prokurohet.**

5. **B.O.E. "G" SHPK & "S" SHPK**

Arsyeja:

- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 të seksionit 2.3 "Për kapacitetin teknik" të Kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur, nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për përvojën e mëparshme të ngjashme.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, BOE ka paraqitur si punë të ngjashme për këto objekte:

Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë është e ndarëG 51% dhe S 49%.

Punët e ngjashme B. i i Operatorëve ekonomik **"G" SHPK.** dhe **"S" SHPK.**

Operatori ekonomik “G” SHPK. Objekti: “Rikualifikim Urban i Zonës përreth Qytezës së fëmijve Korçë”me vlerë 368,063,408. Vlera e situacionit për punimet e ngjashme është 42,657,288 lekë . Autoriteti Kontraktor: Bashkia Korçë.
Operatori ekonomik “G” SHPK. . Objekti: “Rikonstuksioni i rrugës Ago Çeli, Rrugës së re dhe Rikonceptim i palestrës” me vlerë 117,059,057 lekë pa tvsh. Vlera e situacionit për punimet e ngjashme konkretisht Palestra është 71,777,631. Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tepelenë.
Operatori ekonomik “G” SHPK. Objekti: “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Krujtje” me vlerë 52,442,290 lekë pa tvsh. Autoriteti Kontraktor Bashkia Lushnje.
Operatori ekonomik “G” SHPK. Objekti: “Rijetëzimi i Ansamblit Urban të Qëndrësë Konispol” me vlerë 64,665,200 lekë pa tvsh. Autoriteti Kontraktor Bashkia Konispol.
Operatori ekonomik “S” SHPK. Objekti: “Rikonstruksioni i shkollës Thanas Bozo, ndërtimi i Palestrës dhe terrrenet sportive” me vlerë 63,798,435 lekë pa tvsh. Autoriteti Kontraktor: Bashkia Lushnje.
Operatori ekonomik “S” SHPK. Objekti: “Rikonceptim dhe rikonstruksion i hyrjes së qytetit Poliçan” me vlerë50,319,734 pa tvsh. Vlera e situacionit për punimet e ngjashme konkretisht Palestra është 3,893,750 lekë pa tvsh. Autoriteti Kontraktor Bashkia Poliçan.
Operatori ekonomik “S” SHPK. Objekti: “ Rikonstruksioni i shkollës së mesme profesionale “Thoma Papapano” me vlerë 102,720,489 pa tvsh. Autoriteti Kontraktor Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
Operatori ekonomik “G” SHPK, 90%. Objekti: “Rikonstruksion i shkollës së mesme Shaban Collaku” me vlerë 65,893,167 lekë pa tvsh. Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz.
Operatori ekonomik “G” SHPK, 90%. Objekti: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare 4 Dëshmorët” me vlerë 37,316,867 lekë pa tvsh. Autoriteti Kontraktor: Bashkia Lushnje.
Operatori ekonomik “S” SHPK. 95%. Objekti: “ Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare nr. 3 + ambiente sportive” me vlerë 74,775,580 lekë pa tvsh. Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kurbin.
Operatori ekonomik “S” SHPK. Objekti: “ Rikonstruksioni i shkollës Karbunare e vogël” me vlerë 60,434,476 lekë pa tvsh. Autoriteti Kontraktor Bashkia Lushnje.
Operatori ekonomik “G” SHPK. Objekti: “Rikualifikim Urban i Sheshit Livadhja” me vlerë të situacionit për punimet e ngjashme konkretisht “Qendra kulturore Livadhja” është 19,096,30 lekë pa tvsh. Autoriteti Kontraktor Bashkia Finiq.
Vlera monetare totale e punëve të kryera, **e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është më e vogël se dyfishi i vlerës të fondit limit të kontratës që prokurohet.**
Total i këtyre punëve të ngjashme është**254,150,914.96** lekë
Që operatori të kualifikohet duhet të paraqes punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet që duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e B. it në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B. .

6. B.O.E. “S”SHPK, & “Z”SHPK,
Arsyeja:

- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 të seksionit 2.3 “Për kapacitetin teknik” të Kritereve të vecanta të kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur, nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për përvojën e mëparshme të ngjashme. a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose
b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që

prokurohet.
Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Pika "a", plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në B. . Anëtarët e tjerë të B. it do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B. . Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një B. i, kanë të njëjtën përqindje pjesmarrje në B. , vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbushë këtë kusht.
Kurse pika "b", duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e B. it në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B. .
B.O. E. S & Z kanë lidhur marrveshje bashkëpunimi: Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë është e ndarë nëpërqindje si mëposhtë:
•90%S
• 10% Z
Sipas kritereve të vecantatë DST, pika 2.3 Kapaciteti teknik përcaktohet:
2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:
Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme
a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,ose
b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

<u>Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.</u>
Pika /a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në B. *. Anëtarët e tjerë të B. it do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B. . Në rastin kur operatoret ekonomik, anëtarë të një B. i, kanë* ***të njëjtën përqindje pjesmarje në B. , vendosin me marveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbushë këtë kusht****.Kurse pika /b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e B. it* ***në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B.*** *.*
Operatori Ekonomik "S"SHPK, ka paraqitur vetëm një punë të ngjashme me objekt: "Shkolla Dom Nikoll Kacorri" me vlerë 138,662,2582.25 lekë pa tvsh. Kontrata koncesionare për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë nuk hyn në punët e ngjashme pasi sipas VKM nr.42, datë 16.1.2008 " Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" kjo kontratë futet në kategorinë "NP-4".
Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurU, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë,autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurU, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Pra rrugët nuk përfshijnë element të ngjashëm me objektet arsimore e njëjta gjë vlen për kontratën rikualifikimi i sheshit italia dhe rikonceptim i parkut të lojrave të fëmijëve dhe parkim publik 2 kate nën tokë në rrugën e Elbasanit.

Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet që duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e B. it në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B. .
B.O.E.S.& "Z"SHPK, kanë paraqitur kontratat si më poshtë:
"Z"SHPK,- Rikonstruksioni i Konviktit "Kristo Isak" Kamëz, me vlerë **25,637,421** lekë.
"Z"SHPK, - Shkolla 9-vjeçare Shtodhër dhe Shkolla e mesme "26 Marsi" - me vlerë **116,022,429** lekë.
"Z"SHPK, - Ndërtim Pallati – me vlerë **232,146,526** lekë.
"Z"SHPK,- Ndërhyrje për stabilizimin e çarjeve në shkollën e mesme "Dilaver Nezha" – me vlerë **28,767,586** lekë.
S.- Shkolla "Dom Nikoll Kaçorri" me vlerë **138,622,580** lekë.
Total i këtyre punëve të ngjashme nga B.O.E. është 541,196,542 lekë.
Pravlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Pra kjo pikë duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e B. it në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në B. .
7. Operatori ekonomik **"I"SHPK,**
Arsyeja: Nuk ka paraqitur asnjë dokumentet të kërkuar në DST.
8. Operatori ekonomik **"K" SHPK.**
Arsyeja: Nuk ka paraqitur asnjë dokumentet të kërkuar në DST.

- Janë kualifikuar OE si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës
1	OE "A" SHPK
2	BOE "A.G" SHPK & "N.C" SHPK
3	OE "GJ" SHPK

Nga verifkikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE **nga grupi i auditimit**, rezuloi si më poshtë:
1. BOE "A SHPK, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është skualifikuar me të drejtë (sigurimi i ofertës dhe eksperienca e ngjashme nuk është siç është përcaktuar në DT).
2. Operatori ekonomik "E"SHPK, nuk ka paraqitur dokumentet e kërkuara në DT
3. B.O.E. "E" SHPK, & "B" SHPK, & "L" SHPK, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është skualifikuar me të drejtë (mungon në SPE licenca e projektimit sipas kontratës me kompaninë E" SHPK, si dhe nu plotëson si përvojën e mëparshme të ngjashme).
4. B.O.E. "E" SHPK & V SHPK, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është skualifikuar me të drejtë (eksperienca e ngjashme nuk është siç është përcaktuar në DT).
5. B.O.E. "G" SHPK & "S" SHPK**,** nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është skualifikuar me të drejtë (eksperienca e ngjashme nuk është siç është përcaktuar në DT)**.**
6. OE "I"SHPK, nuk ka paraqitur dokumentet e kërkuara në DT
7. Operatori ekonomik "K" SHPK, nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet e kërkuara në DT.
8. B.O.E. "S"SHPK, & "Z"SHPK, është skualifikuar me të drejtë për arsyet e paraqitura nga KVO.

- Nga audiimi i dokumentacionit të paraqitur në sistem nga OE të kualifikuar nga KVO dhe konkretisht OE "A" SHPK, BOE "A.G" SHPK & "N.C" dhe OE "GJ" SHPK, rezulton se janë kualifikuar me të drejtë, pasi i plotësonin kriteret e vendosura në DT.
Me shkresën pa nr. Prot, datrë 21.02.2022, KVO-së ka njoftuar përfundimin e procedurës së Fazës së parë.
- Pas përfundimit të fazës së vlerësimi, (sipas Vendimi të KPP-së), është bërë ankesë nga OE S.SHPK në datën 25.02.2022 në KPP me objekt kundërshtimin e vendimit të KVO-së, mbi skualifikmin e ofertës së BOE S.SHPK & "Z" SHPK, nga kjo procedurë rokurimi.
- Në datën 25.02.2022 KPP urdhëroi pezullimin e procedutrës së prokurimit dhe dërgimin e të gjithë dokumentacionit të administruar nga AK.
- Në datën 28.02.2022 me anë të shkresës nr. 147/1, datë 28.02.2022 protokolluar në KPP me nr. 379/2, datë 28.02.2022, OE S.SHPK ka paraqitur kërkesë për tërheqje nga ankesa për këtë procedurë prokurimit.
- Me Vendimin nr. 209/2022, datë 01.03.2022, KPP ka vendosur të përfundojë procedimin adminisrativ për këtë procedurë prokurimi dhe ka lejuar AK të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.

FAZA II-të

Me shkresën nr. 1946, datë 04.03.2022 është hartuar Formulari I Njoftimit të OE të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në të cilin janë identifikuar Operatorët Ekonomikë të suksesshëm.
Me procesverbalin datë 04.03.2022 të KVO-së Dhe NjP-së, janë miratuar ftesat për kandidatët që janë kualifikuar në fazën e parë.
Me procesverbalin datë 09.03.2022 për lidhjen e draftmarrëveshjes për kandidaët që janë kualifikuar në Fazën e I-rë, palë në marrëveshjen kuadër me object "Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare Halit Coka (ish Elez Isufi)", është konkluduar me re draftmarrëveshje me kuadër me tre OE të kualifikuar, respektivisht me nr. 2017 prot., datë 09.03.2022, nr. 2052 prot., datë 09.03.2022 dhe nr. 2018 prot., datë 09.03.2022.
Me shkresat nr. 2715 prot., datë 01.04.2022, nr. 2714 prot., datë 01.04.2022 dhe nr. 2713 prot., datë 01.04.2022 janë bërë "Ftesat për Ofertë" respektivisht OE "GJ" SHPK, BOE "A.G" SHPK dhe N.C" SHPK dhe OE "A" SHPK.
Me shkresën nr. 2932 prot, datë 07.04.2022 është ngritur KVO për Fazën e Dytë me përbërje F.M , E.D dhe E.M..
Është mbajtur Procesverbali I hapjes së ofertave me datë 07.04.2022, në të cilin është cilësuar lista e dokumenteve të paraqitura nga OE "A" SHPK dhe BOE "A.G" SHPK dhe N.C" SHPK dhe OE "GJ" SHPK, si dhe i vlerësimit të ofertave sipas të cilit janë paraqitur ofertat si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës të kualifikuar	Oferta ekonomike
1	OE "A" SHPK	437,807,824
2	BOE "A.G" SHPK dhe N.C" SHPK	435,807,800
3	OE "GJ" SHPK	437,805,000

Nga AK sipas DT është kërkuar që OE/BOE ofertues të dorëzojnë dokumentet, si vijon:

- Përshkrimi i ofertës, sipas shtojcë 3
- Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas shtojcës 4
- Sigurim oferte sipas shtojcë 5
- Grafiku i punimeve
- Metodologjia

KVO, pas shqytimit të dokumenteve, ka bërë vlerësimin me pikë sipas tabelës si vijon:

Kriteri	Operatorët ekonomikë të lualifikuar në tender

	BOE "A.G" SHPK dhe N.C" SHPK	OE "A" SHPK	OE "GJ"
x- Çmimi	50 [435,807,800 lekë]	35 [437,807,824 lekë]	35 [437,805,000 lekë]
y-Koha e zbatimit	30	30	30
z-Metodologjia	10	10	10
TOTALI (x+y+z)	**90**	**75**	**75**
Renditja	**1**	**2**	**3**

Vlerësimi sipas grupit të auditimit:

1. Nga auditimi i dokumentacionit të OE "4 AM" SHPK, konstatohet që ka ky operator ka paraqitur grafikum e punimeve për 10 (dhjetë) muaj (në përputhje me afatin e përcaktuar në shtojcën 1 të DT).

2. Nga auditimi i dokumentacionit të BOE "A.G" SHPK dhe N.C" SHPK, konstatohet që ka ky operator ka paraqitur grafikum e punimeve për 10 (dhjetë) muaj, muaj (në përputhje me afatin e përcaktuar në shtojcën 1 të DT).

1. Nga auditimi i dokumentacionit të OE "GJ" SHPK, konstatohet që ka ky operator ka paraqitur grafikum e punimeve për 10 (dhjetë) muaj (në përputhje me afatin e përcaktuar në shtojcën 1 të DT).

Në gjykimin e grupit të auditimit, vlerësimi mbi çmimim, duhej që nga KVO, të bëhej me interpolim, sipas formulës së përcaktuar në DT (435,807,800/437,807,824 x 60 pikë për OE A. SHPK dhe 435,807,800/437,805,000 x 60 pikë për OE "GJ" SHPK).

Sa më sipër vlerësimi do te ishte si vijon:

Kriteri	**Operatorët ekonomikë të lualifikuar në tender**		
	BOE "A.G" SHPK dhe N.C" SHPK	OE "A" SHPK	OE "GJ" SHPK
x- Çmimi	60 [435,807,800 lekë]	59.72 [437,807,824 lekë]	35 [437,805,000 lekë]
y-Koha e zbatimit	30	30	30
z-Metodologjia	10	10	10
TOTALI (x+y+z)	**100**	**99.7259**	**99.7263**
Renditja	**1**	**3**	**2**

Pavarësisht nga vlerësimi i llogaritur gabim nga KVO, në renditje në vendin e parë qëndron përsëri BOE "A.G" SHPK dhe N.C" SHPK.

Me shkresën pa nr. Prot, datrë 07.04.2022, KVO ka njoftuar përfundimin e procedurës së Fazës së dytë.

Raporti përmbledhës i miratuar nga Zv/Kryetar znj. U.E është më datë 11.04.2022, ku janë bashkëlidhur edhe pikët e vendosura mbi çmimin + kohën e zbatimit + metodologjinë e operatorëve nga KVO, ku rezulton me renditjen përfundimtare bazuar në renditjen e pikëve, si vijon:

1. BOE "A.G" SHPK dhe "N.C" SHPK me 90 pikë.
2. OE A. SHPK me 75 pikë dhe OE "GJ" SHPK me 75 pikë.

-Bashkia Kamëz me shkresën me nr. 3080 prot., datë 11.04.2022 i dërgon APP formularin e njoftimit të fituesit për procedurën e prokurimit me objekt: Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Halit Çoka" (ish Elez Isufi), Bashkia Kamëz.

Kontrata e punimeve me objekt: "Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Halit Çoka (ish Elez Isufi), Bashkia Kamëz" nënshkruhet me nr. 3138 prot. datë 13.04.2022, midis AK Bashkisë Kamëz, përfaqësuar nga Zv/Kryetar Znj. U.E dhe BOE "A.G" SHPK dhe N.C" SHPK përfaqësuar nga Z. B.B. dhe E.K . Vlera e kontratës është 435,807,800 lekë pa TVSH me afat realizimi 10 muaj dhe garanci punimesh 24 muaj.

Sa më sipër është vepruar jo në përputhje me *kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve, si vijon (Titulli i* ***gjetjes nr. 1*** *trajtuar për* ***11 situata****):*
Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK (specialisti i fushës), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ***neni 78, pika 2*** *"hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*
- ***Në çdo rast****, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "Kriterei për shpalljen e ofertës fituese". Janë konstatuar shkelje të* ***nenit 87 pika 2 dhe 4****,të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: "2- Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke*
përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale... dhe 4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që inforM onet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese...". Gjithashtu, konstatohet se kriteri i caktuar nga
*njësia e prokurimit për shpalljen e ofertës fituese, ai i "****ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto****" është në kundërshtim meVKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* ***neni 45 pika 3****, kucitohet se: " Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në* ***çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave****.".*
Theksojmë se, bazuar në dispozitat e sipërcituara, kriterei për shpalljen e ofertës fituese në rastin e procedurës konkrete objekt auditimi do të duhet të ishte automatikisht ai i ofertës ekonomikisht më e favorshme bazuar në ***çmimin*** *si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.*
Nga ana tjetër, referuar kriterit të përzgjedhur në mënyrë të gabuar nga NJP, atij të "ekonomikisht më e favorshme në bazë të kostos", edhe sikur të merret e miëqenë vendosja e këtij kriteri, rezulton se në perbërjen e tij ka elementë të pabazuar në ligj dhe cënues të mundësisë së konkurrencës efektive. ***Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit dhe Zv/Kryetare e Bashkisë Kamëz, Znj. U.E.***
Përgjegjësia për zv/Kryetaret (si persona të autorizuar) Znj. U.E, rrjedh nga neni ***73*** *i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", si dhe neni* ***21*** *i ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", pika 1, pika 2 dhe 5, ku respektivisht thuhet:*
-Pika 5 e nenit 73 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citoj se: "Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
-Ligji Nr. 162/2020:
Pika 1: "Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj....

*Pika 5: Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën **mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij**.*
Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike".

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"të ndryshuar; ligjitNr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti: Hartimi i Dokumenteve Standarde të tenderit, kriteret e përgjithshme të pranim/kualifikimit, kriteret teknike nga DST duke mos respektuar kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"të ndryshuar; ligjitNr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Shkaku: Kryerja e procedurave të prokurimit pa u respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik, hartimit të DST, të kritereve të përgjithshme të kualifikimit, kritereve teknike duke mos respektuar kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"të ndryshuar; ligjitNr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Rëndësia: I lartë.

Sa më sipër (gjetja nr. 1, trajtuar për 11 situata), për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi:

1. Znj. **U.E**, në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Kamëz si person i iautorizuar për ndjekjen dhe zbatimin e procedurës së prokurimit [Prokurimi nr. 1; nr.2; nr.3; nr.4; nr.5; nr.6; nr.7; nr. 8; nr.9; nr. 10;nr. 11].
2. Znj. **SH.XH**, në cilësinë e përgjegjësit të Njësisë së Prokurimit [Prokurimi nr. 1; nr.2; nr.3; nr.4; nr.5; nr.6; nr. 7; nr. 8; nr.9; nr. 10; nr. 11].
3. Z. **S.S**, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit [Prokurimi nr. 1; nr. 2; nr.3; nr.4; nr.5; nr.6; nr. 7; nr. 8; nr.9; nr. 10; nr. 11;].
4. Znj. **S.V** , në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit [Prokurimi nr. 1; nr. 2; nr.3; nr. 4; nr.5; nr.6; nr. 7; nr. 8; nr.9; nr, 10; nr. 11].

*Lidhur me problematikat e trajtuara në projekt raportin e auditimit, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024), pa paraqitur observacionet nga personat e takuar, në lidhje me hartimin e kritereve Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik për procedurën e prokurimit: "**Rikonstruksion shkolla e mesme "Gramoz Palushi**", Babrru, Njësia Administrative Paskuqan" jeni shprehur si vijon:*
1. Pretendimi i subjektit:
*- për **pikën 2.3.3 është kërkuar që,** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **100 persona,** dhe kjo është në përputhje me natyrën dhe volumin e punës, ku do të kryhen punimet...*
1.1. Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në lidhje me argumentimin Tuaj, konstatohet se norma teknike (punëtoria) është mare si mesatare për çdo kapitull të preventivit dhe, nuk është trajtuar në mënyrë të veçantë për volumet e punës sipas zërave të punëve për çdo kapitull, bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N dhe të analizave teknike të tyre" dhe në normën teknike për zërat e punës me Analizë çmimi trajtuar sipas VENDIM Nr.514, date 15.8.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N" dhe, kjo mënyrë llogaritje e bërë nga NjP ka shkaktuar një pasaktësi në përcaktimin e fuqisë punëtore.

Në gjykimin e audituesit, volumet konvertohen në orë pune totale bazuar në punëtorinë dhe kjo shumatore pjesëtohet me ditët e punës së kryer për një muaj dhe kjo shumë pjesëtohet me tetë orë pune. Mendojmë se në këtë mënyrë llogaritet me saktësi fuqia punëtore. Një dokument i tillë i llogaritur sipas preventivit për tender, nuk administrohet në dosjen e prokurimit dhe, kjo situatë është diskutuar me NjP gjatë auditimit në subjektin Bashkia Kamëz. Sa trajtuar, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë**.

2. Pretendimi i subjektit:

*Për **pikën 2.3.6** AK ka argumenton se kërkesa për "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**" është vendosur sipas përcaktimeve të LPP dhe Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me cështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....".*

Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të cënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet. Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, AK ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë". Sa më sipër, konstatohet **kriter kualifikues i shfuqizuar** dhe në këto kushte observacioni nuk merret në konsideratë.

3. Pretendimi i subjektit:

*Në lidhje me**pikën 2.3.9 që** për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ndër të tjera (1) Impiant Betoni auomatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi Q III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, Cope 1. (2) Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, Cope 1, është bërë referuar dhe rekomandimit të APP-së nr.8197 prot.. datë 03.09.2018 pika 9.*

3.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Vendosja e Impiant Betoni auomatik me mikser dhe, Nyje inertesh, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni, Nyje inertesh. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë në tender.

-Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit dhe inerteve në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht për skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit. Sa më sipër observacioni **nuk merret në konsideratë**.

4. Pretendimi i subjektit:

*Për **pikën 4/4.2 të DT,** tek kriteret e përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar që AK do të vlerësojë ofertën ekonomikisht më e favorshme, bazuar në **kosto**. **(-Koha e zbatimit të kontratës** me **30 pikë; - Çmimi** më i ulët **me 60 pikë**; **-Cilësia** me **10 pikë).***

Për sa më sipër, ne si Njësi Prokurimi, mendojmë se kemi dhënë të gjithë argumentet e nevojshëm shpjeguese...

Vendosja e këtij kriterit nga ana e NjP është bërë referuar VKM nr. 225 , date 12.04.2021 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 199, datë 04.03.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kritereve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marreveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e riN" , të ndryshuar dhe dokumentet standarde të procedurës në kuadër të procesit të riN, si dhe të Aktit Normativ Nr. 9, Datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

4.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

NjP për procedurat e prokurimit me dy faza dhe vlerësimi me pikë, ka përcaktuar pikët vetëm kriteret bazë, bazuar në kuadrin rregullator në fushën e prokurimit, por në gjykimin e audituesit, për një vlerësim sa më objektiv **sipas peshës specifike (kërkesë e parashikuar në DST)**, duhet të përcaktohen pikët për çdo **kriter** dhe **nënkriter**, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë. Sa trajtuar, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë.**

Lidhur me problematikat e trajtuara në projekt raportin e auditimit, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024), pa paraqitur observacionet nga personat e takuar, në lidhje me hartimin e kritereve Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik për procedurën e prokurimit: "**Rindërtim shkolla 9-vjeçare, "Azem Hajdari" Babrru, Njësia Administrative Paskuqan**" jeni shprehur si vijon:

1. Pretendimi i subjektit:

*Për **pikën 2.3.3 është kërkuar që,** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **180 persona,** dhe kjo është në përputhje me natyrën dhe volumin e punës, ku do të kryhen punimet... Analiza teknike ka qenë pjesë e dosjes, pasi është administruar në dosje.*

1.1. Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me argumentimin Tuaj, konstatohet se norma teknike (punëtoria) është mare si mesatare për çdo kapitull të preventivit dhe, nuk është trajtuar në mënyrë të veçantë për volumet e punës sipas zërave të punëve për çdo kapitull, bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N dhe të analizave teknike të tyre" dhe në normën teknike për zërat e punës me Analizë çmimi trajtuar sipas VENDIM Nr. 514, date 15.8.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N" dhe, kjo mënyrë llogaritje e bërë nga NjP ka shkaktuar një pasaktësi në përcaktimin e fuqisë punëtore.

Në gjykimin e audituesit, volumet konvertohen në orë pune totale bazuar në punëtorinë dhe kjo shumatore pjesëtohet me ditët e punës së kryer për një muaj dhe kjo shumë pjesëtohet me tetë orë pune. Mendojmë se në këtë mënyrë llogaritet me saktësi fuqia punëtore. Një dokument i tillë i llogaritur sipas preventivit për tender, nuk administrohet në dosjen e prokurimit dhe, kjo situatë është diskutuar me NjP gjatë auditimit në subjektin Bashkia Kamëz. Sa trajtuar, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë**.

2. Pretendimi i subjektit:

Nuk merren ne kosiderate shpjegimet ne lidhje me :

Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar ***një mjek të përgjithshëm*** *ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim.*

-Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë.

-Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licensa përkatëse , si dhe faturen e ketij sherbimi, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015).

-Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.

2.2. Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", ***shfuqizohet.*** *Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë".* Sa më sipër, konstatohet **kriter kualifikues i shfuqizuar**. Sa trajtuar, observacioni **nuk merret në konsideratë**, pasi është kriter i vendosur me bazë ligjore të shfuqizuar.

3. Pretendimi i subjektit:

-Në lidhje me ***pikën 2.3.10 që*** *për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ndër të tjera: (1) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, (2) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton, vendosja e këtij kriterit nga ana e njësisë së prokurimit është bërë referuar dhe rekomandimit të APP-së nr.8197 prot.. datë 03.09.2018 pika 9 ,ku rekomandohet që në rastet e punëve publike, që kanë nevojë për volume të konsiderueshme të materialeve të N (beton apo asfalt) dhe në rastet kur, ofertuesi nuk i ka në pronësi impiantet automatike të prodhimit të materialeve të nevojshme për realizimin e punime vetë N të objektit, të kerkojnë nga ofertuesi që t'i disponojnë ato me qira apo të kenë kontrata furnizimi për materialet, me disponuesit e impianteve.*

- Nga KLSH nuk merren në konsideratë shpjegimet në lidhje me kërkesën:

Impiante Betoni automatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), në pronesi/qera ose Kontrate Furnizimi (Copë 1) dhe, Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), në pronësi/qera ose Kontrate Furnizimi (Copë 1).

3.3. Qëndrimi i grupit të auditimit:

-Sa më sipër rezulton se AK ka përcaktuar kërkesa të ekzagjeruara në lidhje me disponimin e makinerive/pajisjeve apo kanë kërkuar makineri/pajisje të pa-argumentuara sipas numrit dhe llojit të tyre dhe që nuk janë në përputhje me punimet objekt kontrate. Nuk ka asnjë analizë

teknike ku sasia e makinerive/pajisjeve të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre apo grafikun e punimeve. Këto kërkesa janë në kundërshtim me sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
- konstatohen kërkesa kualifikuese shumë të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës. Sic vërehet janë kërkuar Impiant Betoni auomatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi si dhe, Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar.
-Vendosja e Impiant Betoni auomatik me mikser dhe, Nyje inertesh, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni, Nyje inertesh. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë në tender.
Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit dhe inerteve në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht per skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit.
Sa më sipër observacioni **nuk merret në konsideratë**.

4. Pretendimi i subjektit:

*Për **pikën 4.2 të DT,** tek kriteret e përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar që AK do të vlerësojë ofertën ekonomikisht më e favorshme, bazuar në **kosto**. Sipas rëndësisë: (**-Koha e zbatimit të kontratës** pikët **30**, **- Çmimi më i ulët** pikët **60**, **-Cilësia** pikët **10).***
Vendosja e këtij kriterit nga ana e NjP është bërë referuar VKM nr. 225 , date 12.04.2021 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 199, datë 04.03.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kritereve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marreveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e riN" , të ndryshuar dhe dokumentet standarde të procedurës në kuadër të procesit të riN, si dhe të Aktit Normativ Nr. 9, Datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

4.1. Qëndrimi i grupit të auditimit:

NjP për procedurat e prokurimit me dy faza dhe vlerësimi me pikë, ka përcaktuar pikët vetëm kriteret bazë, pa asnjë lloj argumentimi.
Në gjykimin e audituesit, për një vlerësim sa më objektiv **sipas peshës specifike (kërkesë e parashikuar në DST)**, duhet të përcaktohen pikët për çdo **kriter** dhe **nënkriter**, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë. Sa trajtuar, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë.**

Lidhur me problematikat e trajtuara në projekt raportin e auditimit, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024 (protokolluar në KLSH me nr.

873/7 prot., datë 04.03.2024), pa paraqitur observacionet nga personat e takuar, në lidhje me hartimin e kritereve Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik për procedurën e prokurimit: "**Ndërtim rruga "Albanët" + rrugicat Valias + rruga "Këmbanat"** jeni shprehur si vijon:

1. Pretendimi i subjektit:

Në observacionin paraqitur nga Ju, ndër të tjera sqaroni se, në lidhje me kriterin e përcaktuar tek Kapaciteti teknik pika 2.3.4, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

*• **Inxhinier mekanik** 1(një) dhe A.K në lidhje me kërkesën mbi pjesën e Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik pika 2.3.7, duhet të paraqesë 1 (një) **Saldator** dhe 3 (tre) **Mekanik**.*

Sa më sipër, paraqesim shpjegimet si vijon:

*Kërkesa për pasjen e **1 (një) inxhinieri mekanik** në personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë është vendosur për arsye se duke parë zërat e preventivit pasi në preventive ka Punime të sinjalistikës dhe të barrierave metalike si dhe numri i lartë i mjeteve ose makinerive të kërkuar për kryerjen e punimeve.*

*Kërkesa për pasjen e **1 (një) Saldator** si staf teknik është kërkuar duke parë zërat e preventivit pasi në preventive ka Punime të sinjalistikës dhe të barrierave metalike si dhe numri i lartë i mjeteve ose makinerive të kërkuar për kryerjen e punimeve.*

*Kërkesa për pasjen e **1 (një) Mekanik** si staf teknik është kërkuar duke parë zërat e preventivit pasi në preventiv ka punime të sinjalistikës dhe të barrierave metalike si dhe numri i lartë i mjeteve ose makinerive të kërkuar për kryerjen e punimeve.*

1.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

- Nga auditimi konstatohet, se vendosja e kriterit për 1(një) inxhinier mekanik është kërkesë e tepërt, pasi referuar llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime të barrierave siç pretendoni që duhet të kryhen nga inxhinier mekanik, lidhur me vendosjen e barrierave metaike (shiko preventivin e punimeve). Në PZ dhe në preventiv janë parashikuar punime të sinjalistikës për vijëzime dhe vendosje tabelash, që nuk kanë nevojë për inxhinier mekanik, aq më tepër për tre inxhinier mekanik. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar në projekt preventiv. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe, nenit 39, pika 6, germa (c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" prandaj observacioni **nuk merret në konsideratë**.
- Nga auditimi konstatohet, se vendosja e kriterit për 1(një) saldator dhe 3(tre) inxhinier mekanik është kërkesë e tepërt, pasi referuar llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime të barrierave siç pretendoni (shiko preventivin e punimeve), që duhet të kryhen nga **saldatori** dhe aq më tepër **inxhinieri mekanik**, lidhur me vendosjen e barrierave metaike. Në PZ dhe në preventiv janë parashikuar punime të sinjalistikës për vijëzime dhe vendosje tabelash, që nuk kanë nevojë për për saldator dhe as inxhinier mekanik. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe, nenit 39, pika 6, germa (c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Sa më sipër trajtuar observacioni **nuk merret në konsideratë**.

Lidhur me problematikat e trajtuara në projekt raportin e auditimit, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024), ka paraqitur observacionet nga personat e takuar, n*ë lidhje me*

hartimin e kritereve Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik për procedurën e prokurimit: ***"Ndërtim Rr. Frutikulturë (Rr. Pingulme Rrugën Azem Galica + Rr. "Isuf Gërvalla" + Rr. "Brezaret""*** *si vijon:*

1. Pretendimi i subjektit:

Lidhur me kriterin 2.3.2 mbi licensat NP-7 dhe NS-9, ju argumentoni si vijon:
Nuk merren në konsideratë shpjegimet në lidhje me Licencën NP-7A dhe NS-9A:
Ju qëndrojmë shpjegimeve si vijon:
-NP-7A Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje
Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune të kategorisë si punime KUB, kanale, konkretisht në preventiv është parashikuar për rrugën ***Nd. Rr. Bubullima*** *An. Ngritje pusete + kapak gize + pastrim tubacioni me makineri, copë 6 në vlerë 105,000 lekë;* ***Nd. Rr. Keshilli i Europes*** *An. Ngritje pusete + kapak gize + pastrim tubacioni me makiner, copë 8, në vlerë 140,000 lekë).* ***Nd. Rr. Ersekë*** *An. Ngritje pusete + kapak gize + pastrim tubacioni me makiner copë 10, në vlerë 175,000 lekë, si rezultat operatori ekonomik të jetë i licensuar për keto punime. Emertimi jo i plotë i ketij kategorizimi nuk ndryshon kuptimin e kategorizimit. Nga ana e NjP është një lapsus në shkrimin e emërtimit të kësaj kategorie.*
-N.S-9A Punime strukturore special.
Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune të kategorisë "Punime strukturore speciale", të cilat shtrojnë të nevojshme që OE të jetë i licensuar për kategorinë NS-9. Klasifikimi i kësaj kategorie është bërë lapsus nga ana e NjP pasi në DST kategoria N.S-9 "B" por ne proces verbalin e argumentimit është hedhur e saktë kategorizimi i kësaj kategorie "A".
Punime strukturore speciale janë parashikuar në preventiv konkretisht zëri me An. Nr. 2/111/2 Murë betoni C 12 / 15 (themel, zogël betoni).

1.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pas u njoh me argumentet e paraqitura në observacion sqaron se:
- **së pari**, nga auditimi konstatohet, se vendosja e këtij kriteri për kategorinë e licencës "NP- 7 **A** (Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje) vërehet se emërtimi i këtij kategorizimi nuk është i saktë, referuar VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" emërtimi është "Ujësjellesa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje", pra, nuk shprehet për kanalizime, pasi këto punime kategorizohen në një kategori tjetër.
-**së dyti**, vendosja e këtij kriteri është kërkesë e tepërt dhe e panevojshme, pasi referuar llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, të cilat kanë nevojë për këtë kategori licence. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar në projekt preventiv dhe, aq më tepër kjo kategori licence nuk lidhet me zëra pune që lidhen me punime në rrjetin e kanalizimeve.
-**së treti**, punimet që ju pasqyroni si: për rrugën **Nd. Rr. Bubullima** An. Ngritje pusete + kapak gize + pastrim tubacioni me makiner, copë 6 në vlerë 105,000 lekë; **Nd. Rr. Keshilli i Europes** An. Ngritje pusete + kapak gize + pastrim tubacioni me makiner, copë 8, në vlerë 140,000 lekë). **Nd. Rr. Ersekë** An. Ngritje pusete + kapak gize + pastrim tubacioni me makiner copë 10, në vlerë 175,000 lekë, nuk rezulton të jenë objekte që i përkasin kësaj kontrate për punë publike.
- **së katërti**, nga auditimi konstatohet, se vendosja e këtij kriteri për kategorinë e licencës "NS- 9 (B) **(**Punime strukturore speciale) referuar VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" parashikohet për sa vijon: "Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për trasmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me

parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotave të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilota ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratori nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. qëndrueshmërinë dhe konsolidimin e terreneve". Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe, nenit 39, pika 6, germa (c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Sa më sipër trajtuar observacioni **nuk merret në konsideratë**.

2. Pretendimi i subjektit:

Lidhur me *kërkesën për pasjen e* ***1(një) inxhinieri mekanik,*** *sqarojmë se* AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Në preventivin e Punimeve ka zëra pune si: Gërmim dheu, Germim dheu, shtyllat dhe pusetat + transp..... ; si dhe zëra të tjerë të cilët shtrojnë domosdoshmërinë dhe nevojën për prezencën e inxhinierëve të kërkuar.

Kërkesa për pasjen e ***1(një) inxhinieri mekanik në personelin kryesor, drejtues teknik*** *në licencën e shoqërisë është vendosur për arsye se duke parë zërat e preventivit pasi në preventiv ka Punime të sinjalistikës dhe të barrierave metalike si dhe numri i lartë i mjeteve ose makinerive të kërkuar për kryerjen e punimeve.*

2.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

- Nga auditimi konstatohet, se vendosja e kriterit për një inxhinier mekanik është kërkesë e tepërt, pasi referuar llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime të barrierave siç pretendoni (shikoni preventivin e punimeve), që duhet të kryhen nga një inxhinier mekanik, lidhur me vendosjen e barrierave metaike. Në PZ dhe në preventiv janë parashikuar punime të sinjalistikës për vijëzime dhe vendosje tabelash, që nuk kanë nevojë për për inxhinier mekanik. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar në projekt preventiv. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe, nenit 39, pika 6, germa (c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Sa më sipër trajtuar observacioni **nuk merret në konsideratë**.

3. Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me* ***pikën 2.3.8 që*** *për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet* ***(1) Makineri prerese asfalti / Bobcat me freze, (2) Fabrike asfaltobetoni e pajisur me lejet perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi, (3) Nyje prodhim inertesh*** *e pajisur me leje perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi, sqarojmë se:*

Autoriteti Kontraktor argumenton se vendosja e këtij kriterit nga ana e njësisë së prokurimit është bërë referuar dhe rekomandimit të APP-së nr. 8197 prot.. datë 03.09.2018 "Mbi problematikat e kanstatuara gjatë monitorimit të dokumenteve të tenderit dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë , shërbime" pika 9 , përcakton: Në rastet e

punëve publike, ***<u>që kanë nevojë për volume të konsiderueshme të materialeve të N (beton apo asfalt) dhe në rastet kur, ofertuesi nuk i ka në pronësiimpiantet automatike të prodhimit të materialeve të nevojshme për realizimine punimevetë N të objektit, të kerkojnë ngaofertuesi që t'idisponojnë ato me qira apo të kenë kontrata furnizimi për materialet, me disponuesit e impianteve.</u>***

Fabrikat dhe nyja inerte jane kërkuar si kriter për realizimin e punimeve në afat dhe me cilësi, konkretisht punimet e shtresave, asfaltit, betonimeve, korsise se biçikletave.

*Ju sqarojme se Autoriteti Konstaktor e ka vendosur specifikisht (**Në pronësi/qera ose Kontratë Furnizimi),** në mënyrë që AK të shmangë diskriminimin dhe të rrisë konkurrencën. Njëkohësisht, të garantohen kërkesat për cilësinë dhe afatet e zbatimit.*

Në asnjë rast prodhuesit nuk i kërkohet të heqë dore nga aktiviteti i tij me qellim lenien ne përdorim qeramarresit. Ne rastet që qeramarresi dhe qeradhenesi nuk e kanë të levërdisshme dhenien me qera të nyjes, ***parashikohet lidhja e një kontrate furnizimi,*** *ku prodhuesi merr përsipër furnizimin me materialet sipas kërkesave të qeramarrësit, duke vijuar normalisht aktivitetin e tij. Kodi III 1B është kerkese ligjore për funksionimin e nyjeve per mbrojtjen e mjedisit.*

<u>3.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>

-Sa më sipër rezulton se AK ka përcaktuar kërkesa të ekzagjeruara në lidhje me disponimin emakinerive/pajisjeve apo kanë kërkuar makineri/pajisje të pa-argumentuara sipas numrit dhe llojit të tyre dhe që nuk janë në përputhje me punimet objekt kontrate. Nuk ka asnjë analizë teknike ku sasia e makinerive/pajisjeve të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre apo grafikun e punimeve. Këto kërkesa janë në kundërshtim me sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

- konstatohen kërkesa kualifikuese shumë të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës. Sic vërehet janë (1) Fabrike asfaltobetoni e pajisur me lejet perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi, (2) Nyje prodhim inertesh e pajisur me leje perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi, në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar.

Vendosja e (1) Fabrike asfaltobetoni e pajisur me lejet përkatëse sipas legjistlacionit në fuqi, (2) Nyje prodhim inertesh e pajisur me leje përkatëse sipas legjistlacionit nëe fuqi, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë në tender.

Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit dhe inerteve në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave përbën kusht për skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit.

Sa më sipër observacioni **nuk merret në konsideratë**. Nga grupi i auditimit **merret në konsideratë** argumenti i paraqitur mbi *Makinerinë prerese asfalti / Bobcat me freze që*

përdoret për ngritje e pusetës për të prerë asfaltin në formën e pusetës (katrore) që të mos dëmtohet asfalti.

Lidhur me problematikat e trajtuara në projekt raportin e auditimit, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024), pa paraqitur observacionet nga personat e takuar, *në lidhje me hartimin e kritereve Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik për procedurën e prokurimit: "**Ndërtimi i Pedonales dhe zonave rekreative të Parkut të Liqenit Paskuqan**" jeni shprehur si vijon:*

1. Pretendimi i subjektit: *Lidhur me kriterin 2.3.4 mbi licensat **NP-7**, ju argumentoni si vijon: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime ne rrjetin e kanalizimeve, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.*

1.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas u njoh me argumentet e paraqitura në observacion sqaron se:

- së pari, nga auditimi konstatohet, se vendosja e këtij kriteri për kategorinë e licencës "NP- 7 **A** (Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje) vërehet se emërtimi i këtij kategorizimi nuk është i saktë, referuar VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" emërtimi është "Ujësjellesa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje", pra, nuk shprehet për kanalizime, pasi këto punime kategorizohen në një kategori tjetër.

-së dyti, vendosja e këtij kriteri është kërkesë e tepërt dhe e panevojshme, pasi referuar llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, të cilat kanë nevojë për këtë kategori licence. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar në projekt preventiv dhe, aq më tepër kjo kategori licence nuk lidhet me zëra pune që lidhen me punime në rrjetin e kanalizimeve.

Sa më sipër trajtuar observacioni **nuk merret në konsideratë**.

2. Pretendimi i subjektit: *Për **pikën 2.3.7** Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, argumenton se kërkesa për **1 (një) mjek** të përgjithshëm është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në baze Vendimit Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë".*

2.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", ***shfuqizohet.*** *Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë".* Sa më sipër, konstatohet **kriter kualifikues i**

shfuqizuar. Sa trajtuar, observacioni **nuk merret në konsideratë**, pasi është kriter i vendosur me bazë ligjore të shfuqizuar.

3. Pretendimi i subjektit:

*Në lidhje me**pikën 2.3.11 që** për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet (1) **Rrul asfalti** cilinder cilinder minimumi 5-8 ton, (2) **Fabrikë Betoni** (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), (3) **Fabrikë asfalti** (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B, (4) **Nyje Inerte** (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B, sqarojmë se: Autoriteti Kontraktor argumenton se vendosja e këtij kriterit nga ana e njësisë së prokurimit është bërë referuar dhe rekomandimit të APP-së nr. 8197 prot.. datë 03.09.2018 "**Rekomandim mbi problematikat e kanstatuara gjatë monitorimit të dokumenteve të tenderit dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë, shërbime",** pika 9, ku rekomandohet që në rastet e punëvepublike, që kanë nevojë për volume të konsiderueshme të materialeve të N (beton apo asfalt) dhe në rastet kur, ofertuesi nuk i ka në pronësiimpiantet automatike të prodhimit të materialeve të nevojshme për realizimin e punimeve të N të objektit, të kerkojnë ngaofertuesi që t'idisponojnë ato me qira apo të kenë kontrata furnizimi për materialet, me disponuesit e impianteve. **Fabrikat dhe nyja inerte janë kërkuar si kriter për realizimin e punimeve në afat dhe me cilësi, konkretisht punimet e shtresave, asfaltit, betonimeve, korsise së bicikletave.***

3.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

-Sa më sipër rezulton se AK ka përcaktuar kërkesa të ekzagjeruara në lidhje me disponimin emakinerive/pajisjeve apo kanë kërkuar makineri/pajisje të pa-argumentuara sipas numrit dhe llojit të tyre dhe që nuk janë në përputhje me punimet objekt kontrate. Nuk ka asnjë analizë teknike ku sasia e makinerive/pajisjeve të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre apo grafikun e punimeve. Këto kërkesa janë në kundërshtim me sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

- konstatohen kërkesa kualifikuese shumë të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës. Sic vërehet janë (1) Rrul asfalti cilinder cilinder minimumi 5-8 ton, (2)Fabrikë Betoni(e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), (3) Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B, (4) Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B, në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar dhe, nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë në tender.

Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit dhe inerteve në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht per skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrikës së betonit.

Sa më sipër observacioni **nuk merret në konsideratë**.

4. Pretendimi i subjektit: *Për **pikën 2.3.13 të DT,** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **një kontrate të lidhur me një laborator** për këtë objekt, i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit për analizat e materialeve (1) Beton i fresket sipas standardeve te meposhtme ose te përditësuara, (2) Beton i ngurtesuar sipas standardeve te meposhtme ose te përditësuara, (3) Perzierje Bituminoze sipas standardeve te meposhtme ose te përditësuara, (4) Materiale Rrugore sipas standardeve te meposhtme ose te përditësuara, (5) Gnatyral sipas standarteve te meposhtme ose te përditësuara.*

Autoriteti Kontraktor argumenton se vendosja e këtij kriteri nga ana e NjP është vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, "Per prokurimin publik", sipas të cilit: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Nga ana tjetër, njësia e prokurimit gjykon se vendosja e këtij kriteri në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomik pjesmarrës. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetitkontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapacitetve dhe mundësive të operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Në rastin konkret është e drejta e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me cilësinëe materialeve, që do të përdoren për realizimin e objektit. Për sa më sipër, ne si Njësi Prokurimi. mendojmë se kemi dhënë të gjithë argumentet e nevojshëm shpjeguese në lidhje me gjetjet e KLSH.

5.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Vendosja e kriterit nga NjP ku thuhet: OE duhet të paraqesë një kontrate të lidhur me një laborator për këtë objekt, i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit për analizat e mëposhtme, në gjykimin e audituesit nuk qëndron dhe është e tepërt, sepse kryerja e analizave është parashikuar në DT (Shtojca 16 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK), neni 13 "Testimet dhe Inspektimet". Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikues në lejen mjedisore të fabrikës së betonit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe, nenit 39, pika 6, germa (c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Sa më sipër trajtuar, observacioni **nuk merret në konsideratë.**

Lidhur me problematikat e trajtuara në projekt raportin e auditimit, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024), pa paraqitur observacionet nga personat e takuar, në lidhje me hartimin e kritereve Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik për procedurën e prokurimit: "**Ndërtim trotuare + Ndriçim Rruga "Jon" + Rruga "Fushë Arrëz""** jeni shprehur si vijon:

1. Pretendimi i subjektit:

*Lidhur me kriterin 2.3.2 mbi licensat **NP-7 Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje**, ju argumentoni si vijon: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik"; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të*

Prokurimit Publik", si dhe mbështetur në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. ***Emërtimi jo i plotë i këtij kategorizimi nuk ndryshon kuptimin e kategorizimit.*** *Nga ana e njësisë është një lapsus në shkrimin e emërtimit të kësaj kategorie.*

1.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas u njoh me argumentet e paraqitura në observacion sqaron se:

- **së pari**, nga auditimi konstatohet, se vendosja e këtij kriteri për kategorinë e licencës "NP- 7 **A** (Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje) vërehet se emërtimi i këtij kategorizimi nuk është i saktë, referuar VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" emërtimi është "Ujësjellesa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje", pra, nuk shprehet për kanalizime, pasi këto punime kategorizohen në një kategori tjetër.

-**së dyti**, vendosja e këtij kriteri është kërkesë e tepërt dhe e panevojshme, pasi referuar llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime "Ujësjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje", të cilat kanë nevojë për këtë kategori licence. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar në projekt preventiv dhe, aq më tepër kjo kategori licence nuk lidhet me zëra pune që lidhen me punime në rrjetin e kanalizimeve.

Sa më sipër trajtuar observacioni **nuk merret në konsideratë**.

2. Pretendimi i subjektit: Njësia e Prokurimit lidhur me **kriterin 2.3.7 ka kërkuar që,** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, ndër të tjera **1(një) saldator dhe 1(një mekanik)** është shprehur si vijon:

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar. Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar sipas pikës 2.3.4, (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzektuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. *Dhe konkretisht kerkesa për pasjen e* ***1 (një) Saldator*** *është vendosur pasi duke analizuar zërat e preventivit kemi zëra të tilla si ngritje puseta dhe kapak gize, Fiksimi i kapëkëve të gizës kërkon që në objekt të jetë prezenca e 1 (një) Saldator (nuk është ndërtim i ri pusete por ekzistuese).*

Kërkesa për pasjen e ***1 (një)Mekanik*** *është vendosur pasi duke parë zërat epreventivitka zëra si Punime të sinjalistikës dhe të barrierave metalike si dhe duke parë dhe numrin e mjeteve ose makinerive të kërkuar për kryerjen e punime kërkon që ne objekt të jetë prezenca e 1 (një) Mekaniku.*

2.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: - Vendosja e kriterit pikea 2.3.7, për një saldator dhe për një inxhinier mekanik është kërkesë e tepërt, pasi referuar PZ,llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime që lidhen me saldatorin dhe punën e inxhinierit mekanik. Në PZ dhe në preventiv janë parashikuar punime të sinjalistikës për vijëzime dhe vendosje tabelash, dhe aq më tepër siç pretendoni ju për punime ***si ngritje puseta dhe kapak gize, fiksimi i kapëkëve të gizës kërkon që në objekt të jetë prezenca e 1 (një)Saldator (nuk është ndërtim i ri pusete por ekzistuese),*** që nuk kanë nevojë për për saldator dhe inxhinier mekanik, por thjesht për një punonjës të specializuar. Në preventiv nuk as një pune që ka

nevojë për saldim apo asistencën e inxhinierit mekanik, Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe, nenit 39, pika 6, germa (c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Sa më sipër trajtuar observacioni **nuk merret në konsideratë**.

Lidhur me problematikat e trajtuara në projekt raportin e auditimit, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024), pa paraqitur observacionet nga personat e takuar, në lidhje me hartimin e kritereve Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik për procedurën e prokurimit: "**Ndërtim rrugët (Rr. "William Shekspir" + Rr. "Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" + Rr. "Isuf Gërvalla"+Rr. "Brezaret" +Rr. "Daniel Alia"** jeni shprehur si vijon:

1. Pretendimi i subjektit: *Lidhur me kriterin **2.3.2** mbi licensat **NP-7**, ju argumentoni si vijon:* N.P. 7: përfshin: Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. *Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.*

Vendosja e këtij kriteri nga ana e njësisë së prokurimit,duke marrë shkas dhe nga tipologjia e punimeve konkrete, që do të realizohen (të përfshira në preventivine punimeve), Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime në rrjetin e kanalizimeve dhe ujesjellesit, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Konkretisht në preventiv janë parashikuar Shuma Nr. 2 ***"Punime në KUB***", në shumën 745,542 lekë;; Shuma Nr. 4 "***Punime KUB***" , në shumën 5,157,471 lekë; Shuma Nr. 5 ***"Punime KUZ",*** shuma 8,027,725 lekë.

1.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pas u njoh me argumentet e paraqitura në observacion sqaron se:

- së pari, nga auditimi konstatohet, se vendosja e këtij kriteri për kategorinë e licencës "NP- 7 **A** (Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje) vërehet se emërtimi i këtij kategorizimi nuk është i saktë, referuar VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" emërtimi është "Ujësjellesa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje", pra, nuk shprehet për kanalizime, pasi këto punime kategorizohen në një kategori tjetër.

-së dyti, vendosja e këtij kriteri është kërkesë e tepërt dhe e panevojshme, pasi referuar llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, të cilat kanë nevojë për këtë kategori licence. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar në projekt preventiv dhe, aq më tepër kjo kategori licence nuk lidhet me zëra pune që lidhen me punime në rrjetin e kanalizimeve.

Sa më sipër trajtuar observacioni **nuk merret në konsideratë**.

2. Pretendimi i subjektit:

*Vendosja e këtij kriterit nga ana e njësisë së prokurimit për 1 (një) **inxhinier mekanik**, është bërëreferuar numrit të mjeteve, që opëratori ekonomik duhet të disponojë, dhe është*

konsideruar i nevojshëm për mirëmbajtjen e makinerive në kantier dhe jashtë kantierit për furnizimin dhe transportin e materialeve të nevojshme për objektin që prokurohet.

2.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

- Nga auditimi konstatohet, se vendosja e kriterit për një inxhinier mekanik është kërkesë e tepërt, pasi referuar llojit të punimeve si dhe preventivit, nuk janë parashikuar punime të barrierave siç pretendoni ju, që duhet të kryhen nga një inxhinier mekanik, lidhur me vendosjen e barrierave metaike. Në PZ dhe në preventiv janë parashikuar punime të sinjalistikës për vijëzime dhe vendosje tabelash, që nuk kanë nevojë për për inxhinier mekanik. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe, nenit 39, pika 6, germa (c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Sa më sipër trajtuar observacioni **nuk merret në konsideratë**.

3. **Pretendimi i subjektit:** *Për **pikën 2.3.9 të DT, ku OE** duhet të paraqesë **një kontrate të lidhur me një laborator** për këtë objekt, i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit për analizat e materialeve* **nje kontrate te lidhur** për kryerjen e analizave me një laborator i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit, ndër të tjera për materialet (1) **Beton i fresket sipas standardeve te meposhtme ose te përditësuara**, (2) Beton i ngurtesuar sipas standardeve të mëposhtme ose të përditësuara, (3) **Perzierje Bituminoze sipas standardeve të meposhtme ose të përditësuara, (4) Materiale Rrugore sipas standardeve të meposhtme ose të përditësuara,** paraqesim argumentin si vijon:

Në lidhje sa më sipër, parashtrojmë se kërkesa e autoritetit kontraktor për dorzimin nga ana e Operatoreve ekonomik të një kontrate të lidhur me nje laborator të akredituar për kryerjen e analizave të betoneve, materialeve të tjera rrugore etj, që do të përdoren në objekt. Njësia e prokurimit gjykon se vendosja e këtij kriteri në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomik pjesmarrës. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetitkontraktorë për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapacitetve dhe mundësive të operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës.Në rastin konkret është e drejta e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me cilësinëe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit.

3.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Vendosja e kriterit nga NjP ku thuhet: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një kontrate të lidhur me një laborator për këtë objekt, i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit për analizat e mëposhtme, në gjykimin e audituesit nuk qëndron dhe është e tepërt, sepse kryerja e analizave është parashikuar në DT (Shtojca 16 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK), neni 13 "Testimet dhe Inspektimet". Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe, nenit 39, pika 6, germa (c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Sa më sipër trajtuar, observacioni **nuk merret në konsideratë.**

4. Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me**pikën 2.3.10 që** për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe (1) Fabrike asfaltobetoni e pajisur me lejet perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi (2) Nyje prodhim inertesh e pajisur me leje perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi, sqarojmë se:*

Vendosja e këtij kriterit nga ana e njësisë së prokurimit është bërë referuar dhe pikës nr. 9 të Rekomandimit të APP-së nr. 8197 prot.. datë 03.09.2018, "Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime", ku rekomandohet që:.. në rastet e punëvepublike, që kanë nevojë për volume të konsiderueshme të materialeve të N (beton apo asfalt) dhe në rastet kur, ofertuesi nuk i ka në pronësiimpiantet

automatike të prodhimit të materialeve të nevojshme për realizimine punimevetë N të objektit, të kerkojnë ngaofertuesi që t'idisponojnë ato me qira apo të kenë kontrata furnizimi për materialet, me disponuesit e impianteve...
Referuar konstatimit tuaj, që është kërkuar që Fabrikë asfaltobetoni dhe Nyje prodhim inertesh të jenë të paisura me kodin III.1 B konstatohet se në DST është kërkuar që të jenë të paisur me lejet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi pa përcaktuar kategori të lejeve.
4.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:
-Sa më sipër rezulton se AK ka përcaktuar kërkesa të ekzagjeruara në lidhje me disponimin emakinerive/pajisjeve apo kanë kërkuar makineri/pajisje të pa-argumentuara sipas numrit dhe llojit të tyre dhe që nuk janë në përputhje me punimet objekt kontrate. Nuk ka asnjë analizë teknike ku sasia e makinerive/pajisjeve të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre apo grafikun e punimeve. Këto kërkesa janë në kundërshtim me sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
- konstatohen kërkesa kualifikuese shumë të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës. Sic vërehet janë (1) Makineri prerese asfalti / Bobcat me freze, (2) Fabrikë asfaltobetoni e pajisur me lejet perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi, (3) Nyje prodhim inertesh e pajisur me leje perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi, në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar. Vendosja (1) Fabrikë asfaltobetoni e pajisur me lejet perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi (2) Nyje prodhim inertesh e pajisur me leje perkatese sipas legjistlacionit ne fuqi, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë në tender.
Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit dhe inerteve në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht per skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit.
Sa më sipër observacioni **nuk merret në konsideratë**.

Lidhur me problematikat e trajtuara në projekt raportin e auditimit, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024), pa paraqitur observacionet nga personat e takuar, në lidhje me hartimin e kritereve Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik për procedurën e prokurimit: "**Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Lidhja e Prizerenit"** jeni shprehur si vijon:
1. Pretendimi i subjektit:
*Lidhur me pikën **2.3.4 AK ka kërkuar që**, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **140 persona,** paraqesim argumentet si vijon: Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i*

punonjësve, afati i realizimt te kontrates, orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje ***Mars 2022- Maj 2022*** *tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Numri i punonjësve nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te N t", i ndryshuar dhe akteve nenligjore ne zbatmi të tij.*

2.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me argumentimin Tuaj, konstatohet se norma teknike (punëtoria) është mare si mesatare për çdo kapitull të preventivit dhe, nuk është trajtuar në mënyrë të veçantë për volumet e punës sipas zërave të punëve për çdo kapitull, bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N dhe të analizave teknike të tyre" dhe në normën teknike për zërat e punës me Analizë çmimi trajtuar sipas Vendimin Nr.514, date 15.8.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N" dhe, kjo mënyrë llogaritje e bërë nga NjP ka shkaktuar një pasaktësi në përcaktimin e fuqisë punëtore.

Në gjykimin e audituesit, volumet konvertohen në orë pune totale bazuar në punëtorinë dhe kjo shumatore pjesëtohet me ditët e punës së kryer për një muaj dhe kjo shumë pjesëtohet me tetë orë pune. Mendojmë se në këtë mënyrë llogaritet me saktësi fuqia punëtore. Një dokument i tillë i llogaritur sipas preventivit për tender, nuk administrohet në dosjen e prokurimit dhe, kjo situatë është diskutuar me NjP gjatë auditimit në subjektin Bashkia Kamëz. Sa trajtuar, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë**.

3. Pretendimi i subjektit:

NjP argumenton se: AK argumenton se kërkesa për ***"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen eshëndetit në punë"*** *është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: "Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me cështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....". Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e N si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të cënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.*

-AK argumenton se kërkesa që Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar ***1(një) mjek*** *të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga*

jashtë këtë shërbim. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë.Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontratapër këtë shërbim, licensa përkatëse , si dhe faturen e ketij sherbimi, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" ndryshuar me vendimin nr. 632, datë 15.7.2015). Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.

*-AK argumenton se kërkesa për **1 (një) mjek** të përgjithshëm është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në baze Vendimit Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë",me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 "Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", neni 12/2 që parashikon shprehimisht se "marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës").*

3.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet. Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të

plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë". Sa më sipër, konstatohet **kriter kualifikues i shfuqizuar**.

4. Pretendimi i subjektit:

*NjP për pajisjet (1) **Kamion vetëshkarkues** me kapacitet mbajtës15-20 ton, (2) **Kamion vetëshkarkues** me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton, (3) **Kamioncinë** deri në 3.5 ton, (4) **Impiant Betoni** auomatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) dhe, (4) **Nyje inerte** (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), paraqet argumentet si vijon:*

Kriteri është vendosur sipas pikës 4, të Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas natyrës se projektit. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të detyres se projektimit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të N dhe analizat teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapesirat fizike rreth objektit mundesive te manovrimit me mjete te renda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes, etj.

4.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

-AK ka përcaktuar kërkesa të ekzagjeruara në lidhje me disponimin emakinerive/pajisjeve apo kanë kërkuar makineri/pajisje të pa-argumentuara sipas numrit dhe llojit të tyre dhe që nuk janë në përputhje me punimet objekt kontrate. Nuk ka asnjë analizë teknike ku sasia e makinerive/pajisjeve të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre apo grafikun e punimeve. Këto kërkesa janë në kundërshtim me sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

-Sa më sipër, konstatohen kërkesa kualifikuese shumë të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës. Siç vërehet janë kërkuar Impiant Betoniauomatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi si dhe, Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar. Vendosja e Impiant Betoniauomatik me mikser dhe, Nyje inertesh, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni, Nyje inertesh. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë në tender. Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit dhe inerteve në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht per skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit. Sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë**.

5. Pretendimi i subjektit:

*Për **pikën 4.2 të DT,** tek kriteret e përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar që AK do të vlerësojë ofertën ekonomikisht më e favorshme, bazuar në **kosto**. Sipas rëndësisë: (**-Koha e zbatimit të kontratës** pikët **30**, **- Çmimi më i ulët** pikët **60**, **-Cilësia** pikët **10).***

Vendosja e këtij kriterit nga ana e NjP është bërë referuar VKM nr. 225 , date 12.04.2021 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 199, datë 04.03.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kritereve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marreveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e riN" , të ndryshuar dhe dokumentet standarde të procedurës në kuadër të procesit të riN, si dhe të Aktit Normativ Nr. 9, Datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

5.1. Qëndrimi i grupit të auditimit:

NjP për procedurat e prokurimit me dy faza dhe vlerësimi me pikë, ka përcaktuar pikët vetëm kriteret bazë, pa asnjë lloj argumentimi.

Në gjykimin e audituesit, për një vlerësim sa më objektiv **sipas peshës specifike (kërkesë e parashikuar në DST)**, duhet të përcaktohen pikët për çdo **kriter** dhe **nënkriter**, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë. Sa trajtuar, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë.**

Lidhur me problematikat e trajtuara në projekt raportin e auditimit, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024), pa paraqitur observacionet nga personat e takuar, në lidhje me hartimin e kritereve Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik për procedurën e prokurimit: "**Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari" Zall-Mner Bashkia Kamëz"** jeni shprehur si vijon:

1. Pretendimi i subjektit: *Lidhur me pikën **2.3.4 AK ka kërkuar që**, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **100 persona,** punonjës, me kohë të plotë, për periudhën **3 (tre) muajt e fundit** e vertetuar kjo me:*

-Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.

-Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

1.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, konstatohet se norma teknike (punëtoria) është mare si mesatare për çdo kapitull të preventivit dhe, nuk është trajtuar në mënyrë të veçantë për volumet e punës sipas zërave të punëve për çdo kapitull, bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N dhe të analizave teknike të tyre" dhe në normën teknike për zërat e punës me Analizë çmimi trajtuar sipas Vendimin Nr.514, date 15.8.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N" dhe, kjo mënyrë llogaritje e bërë nga NjP ka shkaktuar një pasaktësi në përcaktimin e fuqisë punëtore.

Në gjykimin e audituesit, volumet konvertohen në orë pune totale bazuar në punëtorinë dhe kjo shumatore pjesëtohet me ditët e punës së kryer për një muaj dhe kjo shumë pjesëtohet me tetë orë pune. Mendojmë se në këtë mënyrë llogaritet me saktësi fuqia punëtore. Një dokument i tillë i llogaritur sipas preventivit për tender, nuk administrohet në dosjen e prokurimit dhe, kjo situatë është diskutuar me NjP gjatë auditimit në subjektin Bashkia Kamëz. Sa trajtuar, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë**.

2. Pretendimi i subjektit: *NjP argumenton se: AK argumenton se kërkesa për 1(një) punonjës **"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen eshëndetit në punë"** është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me cështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë....." Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e N si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të cënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.*

2.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4

gërma “b” thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, shfuqizohet. Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, AK ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”. Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar.

3. Pretendimi i subjektit: *NjP për pajisjet ndër të tjera “Fabrik Prodhimi Betoni” duke argumentuar: Fabrika e prodhimit të betonit në Pronesi / Kontratë Qeraje / Kontratë Furnizimi të jenë e pajisur me QKL Kodi III.1.B. Në rastet kur janë me kontrate furnizimi, ky dokument disponohet nga personat e tretë dhe shoqëron kontraten e furnizimit me OE. Vendosja e këtij kriterit nga ana e NjP është bërë referuar dhe rekomandimit të APP-së nr. 8197 prot.. datë 03.09.2018 pika 9 ,ku rekomandohet që në rastet e punëvepublike, që kanë nevojë për* ***volume të konsiderueshme të materialeve të N (beton apo asfalt)*** *dhe në rastet kur, ofertuesi nuk i ka në pronësiimpiantet automatike të prodhimit të materialeve të nevojshme për realizimine punimevetë N të objektit, të kerkojnë ngaofertuesi që t’i disponojnë ato me qira apo të kenë kontrata furnizimi për materialet, me disponuesit e impianteve. Në këtë objektnuk është kërkuar impiant Betoniautomatikme mikser apo nyje prodhimi betoni.*

3.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Sa më sipër, konstatohen kërkesa kualifikuese shumë të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës. Sic vërehet janë kërkuar Impiant Betoniauomatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar.

Vendosja e Impiant Betoniauomatik me mikser, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni. Në rast se një operator ekonomike tregtarë i cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qera linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marre pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qera linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori tregtare do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtare që do të marrë pjesë në tender.

Gjithashtu nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht per skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikuese në lejen mjedisore të fabrisës së betonit. Sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë**.

4. Pretendimi i subjektit:

Për ***pikën 4.2 të DT,*** *tek kriteret e përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar që AK do të vlerësojë ofertën ekonomikisht më e favorshme, bazuar në* ***kosto****. Sipas rëndësisë: (****-Koha e zbatimit të kontratës*** *pikët* ***30****,* ***- Çmimi më i ulët*** *pikët* ***60****,* ***-Cilësia*** *pikët* ***10).***

Vendosja e këtij kriterit nga ana e NjP është bërë referuar VKM nr. 225 , date 12.04.2021 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 199, datë 04.03.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kritereve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marreveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e riN" , të

ndryshuar dhe dokumentet standarde të procedurës në kuadër të procesit të riN, si dhe të Aktit Normativ Nr. 9, Datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

4.1. Qëndrimi i grupit të auditimit:

NjP për procedurat e prokurimit me dy faza dhe vlerësimi me pikë, ka përcaktuar pikët vetëm kriteret bazë, pa asnjë lloj argumentimi.

Në gjykimin e audituesit, për një vlerësim sa më objektiv **sipas peshës specifike (kërkesë e parashikuar në DST)**, duhet të përcaktohen pikët për çdo **kriter** dhe **nënkriter**, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë. Sa trajtuar, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë.**

Lidhur me problematikat e trajtuara në projekt raportin e auditimit, Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024), pa paraqitur observacionet nga personat e takuar, në lidhje me hartimin e kritereve Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik për procedurat e prokurimit: "**Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamëz"** dhe "**Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Halit Coka (ish shkolla Elez Isufi**" jeni shprehur si vijon:

1. Pretendimi i subjektit: *Lidhur me pikën **2.3.4 AK ka kërkuar që**, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **150 persona,** punonjës, me kohë të plotë, për periudhën **3 (tre) muajt e fundit**, NjP sqaron se: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin thuhet: "Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës,që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument qe vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 150 persona duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi objektit qe do te ndertohet, është plotesisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar ne VKMNr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% te kostos.*

-Nga NJP është kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projekt idene ne termat e references, volume e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e N. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të N, elektrik, mekanik, Topograf / Gjeodet dhe, hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

-Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

*-A.K në lidhje me kërkesën mbi pjesën e Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik pika **2.3.7,** ka kërkuar AK argumenton se kërkesa për 1 (një) mjek të përgjithshëm është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në baze Vendimit Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë",me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 "Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", neni 12/2 që parashikon shprehimisht se "marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës".*

*-NjP për pikën 2.3.10 ka kërkuar mjete për realizimin e punimeve si: Trajler per transport mjetesh, Autobot uji 2 copë, Impiant Betoni automatik **me mikser**, Depozitë Uji (30.000 Litra), Rul vibrusminimumi 8 ton, 2 copë; Kamion me kosh per punime ne lartesi; Sonde shpimi me diameter Ø 1000 mm; Autobot per largimin e ujrave te zeza; Konteiner stacioner.*

*-Në lidhje me përcaktimin e e kriterit për shpalljen e ofertës fituese dokumentet standarde të procedurës së prokurimit, kriteri i vlerësimit të ofertës fitueseështë përcatuar në seksionin 4/4.2 " Oferta ekonomikisht më e favorshme" **(-Koha e zbatimit të kontratës** me **30 pikë; -Çmimi** më i ulët **me 60 pikë**; **-Cilësia** me **10 pikë).***

2.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

-Në lidhje me argumentimin Tuaj, konstatohet se norma teknike (punëtoria) është mare si mesatare për çdo kapitull të preventivit dhe, nuk është trajtuar në mënyrë të veçantë për volumet e punës sipas zërave të punëve për çdo kapitull, bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N dhe të analizave teknike të tyre" dhe në normën teknike për zërat e punës me Analizë çmimi trajtuar sipas Vendimin Nr.514, date 15.8.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N" dhe, kjo mënyrë llogaritje e bërë nga NjP ka shkaktuar një pasaktësi në përcaktimin e fuqisë punëtore.

Në gjykimin e audituesit, volumet konvertohen në orë pune totale bazuar në punëtorinë dhe kjo shumatore pjesëtohet me ditët e punës së kryer për një muaj dhe kjo shumë pjesëtohet me tetë orë pune. Mendojmë se në këtë mënyrë llogaritet me saktësi fuqia punëtore. Një dokument i tillë i llogaritur sipas preventivit për tender, nuk administrohet në dosjen e prokurimit dhe, kjo situatë është diskutuar me NjP gjatë auditimit në subjektin Bashkia Kamëz. Sa trajtuar, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë**.

-Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me natyrën dhe volumin e punimeve në objektin që prokurohet (një ing ndërtimi, një ing elekrik, një ing mjedisi dhe 2 teknikët e N).

-Ky kriter nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet dhe, është vendosur mbi një bazë ligjore të shfuqizuar.
-Kriteret mbi pajisjet dhe mjetet, janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me natyrën dhe volumin e punimeve në objektin që prokurohet (një Ing ndërtimi, një Ing elekrik, një Ing mjedisi dhe 2 teknikët e N).
NjP për procedurat e prokurimit me dy faza dhe vlerësimi me pikë, ka përcaktuar pikët vetëm kriteret bazë, pa asnjë lloj argumentimi.
-Në gjykimin e audituesit, për një vlerësim sa më objektiv **sipas peshës specifike (kërkesë e parashikuar në DST)**, duhet të përcaktohen pikët për çdo **kriter** dhe **nënkriter**, në mënyrë profesionale nga një grup pune me përbërje nga specialistë të fushës, në mënyrë që të shmanget subjektivizimi në procesin e vlerësimit në fazën e dytë. Sa trajtuar, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë.**

12. Nga auditimi i prokurimit me objekt: **"Ndërtim rrugët Rr. Erzeni, Rr. Marubi, Rr. Valbona, Rr. Tomorri",** me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimitme objekt: "Ndërtim Rrugët Rr. Erzeni +Rr. Marubi + Rr. Valbona + Rr. Tomorri"		
1.Urdhër Prokurimi Nr.6760, Datë 26.07.2022 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur- Punë Publike	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 6760 datë 26.07.2022 1. SH.XH 2. S.V 3. S.S(Inxh. ndërtimi)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.6760/1 datë 26.07.2022 1. E.GJ j, Kryetar 2. L.M , Anëtar 3. A.GJ , Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 59,577,725 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) BOE K dhe Sterkaj SHPK me ofertë ekonomike në vlerën 55,639,430 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 3,938,295 Lekë
8. Data e hapjes së tenderit 11.08.2022	9. Burimi Fincimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b) S'kualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-; APP–KPP- s'ka	12. Përgjigje nga AK-s'ka	13. Përgjigje nga APP apo AKKP S'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 8892, datë 03.10.2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 66, 767, 316 lekë	16. Likuiduar deri në -
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) ditë pune	19. Zgjatja e kontratës

U konstatua si vijon:

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kritereve të kualifikimit të vendosura jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet.
Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:
Hartimi i kritereve dokumentuar me procesverbalin nr. s'ka, datë 26.07.2022. AK për aftësinë teknike dhe profesionale ka kërkuar:
Pika 2.3.3 AK kërkon disa lloje licencash që duhet të disponojë OE që do të kryejë punimet e N, ku një ndër këto është: licenca e llojit NP-12 A "Punime të inxhinierisë së mjedisit" referuar VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Kjo licencë, në mënyrë të thjeshtuar përfshin procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte - Sipas preventivit të punimeve nuk rezulton të ketë punime që kërkojnë këtë kategori licence, pra

nuk është argumentuar kërkesa për këtë lloj licence, pra mbjellja e pemëve dhe fidanë nuk është argument për kërkesën e kësaj licence. Sjellim në vëmendje këtu rekomandimet e APP me shkresat nr.7998 prot., datë 24.12.2021 dhe nr.6732 prot., datë 21.10.2020; licenca e llojit NP– 4 C "Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurU, linja tramvaji, metro,hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale". Për këtë lloj licence mjafton kategoria B duke qenë se kategoria B mbulon punime në një vlerë prej 21-50 m dhe punimet në preventiv për këtë kategori janë nën 50 m pasi një pjesë e punimeve janë elektrike apo kanalizimesh, për të cilat nga AK janë kërkuar licencat përkatëse NP-7 dhe NP-11.

Pika 2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave *[-1 (një) Inxhinier Ndërtimi; -1 (një) Inxhinier Hidroteknik; -1 (një) Inxhinier Elektrik; -1 (një)Inxhinier Gjeodet/Topograf/Maksheder*]. Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetë deklarimit sipas shtojcës 8.

OE i kualifikuar dhe irenditur i pari pas vlerësimit te ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar për inxhinieret e mësipërm.

Ky kriter është argumentuar për kërkesën e këtyre inxhinierëve **por jo periU e fundit kur duhet të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë**, dhe se ky konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetë deklarimit,çka përbënnjë element që rrit mundësinë e abuzimit të O.E, pasi O.E i renditur i pari pas dhënies së mundësisë nga AK për plotësimin e këtij kushti vetëm me formularinshtojca 8 sipas vetë deklarimit, mund të shtojë punonjës në listë pagesën e muajit përkatës (duke paguar vetëm një gjobë për deklarim të vonuar në sistemin e tatimeve) dhe të kualifikohet për procedurën.

Numri i shoferëve i kërkuar nga AK nuk është në harmoni me numrin e mjeteve të kërkuara në pikën 2.3.11, pra AK në kriteret e kërkuara shtyn OE fitues në abuzim me punonjësit, duke i vënë në drejtim 1 shoferi afërsisht 2 mjete.

Pika 2.3.11. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 Ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	2
2	Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-20 Ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
3	KamioncI me kapacitet mbajtes 3.5-5 Ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	2
4	Kamion me vinc mbi 18 ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
5	KamioncI me kapacitet mbajtes 1-2 Ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
6	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qira	Cope	2
7	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
8	Eskavator me zinxhire mbi 20 Ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	2
9	Minieskavator	Ne pronesi ose me qira	Cope	3
10	Automjet vinç i pajisur edhe me me kosh për punime në lartesi me krah deri 15 m	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
11	Autobetoniere vetengarkuese min 2 m3	Ne pronesi ose me qira	Cope	2
12	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qira	Cope	2
13	Autopompe Betoni me krah mbi 55 mt	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
14	Rimorkiator per transportimin e mjeteve te renda me kapacitet min 20 Ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
15	Autobitumatrice	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
16	Asfaltoshtruese	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
17	Autobot Uji	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
18	Grejder	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
21	Rrul ngjeshes gome cilinder minimumi 17 ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	2
22	Rrul ngjeshes gome cilinder me dhembeza minimumi 15 ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
23	Rrul asfalti cilinder cilinder minimumi 8 ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	2
24	Rrul asfalti cilinder cilinder minimumi 5-8 ton	Ne pronesi ose me qira	Cope	1
25	Makineri Vijezimi me boje bikomponente	Ne pronesi ose me qira	Copë	1
26	Saldatrice	Ne pronesi ose me qira	Copë	1
27	Betoniere	Ne pronesi ose me qira	Copë	3
28	Vibrator Betoni	Ne pronesi ose me qira	Copë	3
29	Fabrikë Betoni(e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	Ne pronesi/qira ose Kontrate Furnizimi	Copë	1
30	Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	Ne pronesi/qira ose	Copë	1

		Kontrate Furnizimi		

Referuar procesverbalit të argumentimit të kërkesës për mjetet e mësipërme, konstatohet se kjo kërkesë nuk është shoqëruar me analizë teknike, duke bërë përllogaritjet referuar peshës së materialeve, rrugë në ditë, afatin konkret për transportin e secilit material, pra kur duhet të jenë në kantier materialet, për të arritur në përfundimin se duhet një mjet i një llojit të caktuar, me kapacitet mbajtës specifik.
Kërkohen 2 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës njëri mbi 20 ton dhe tjetri 10-20 ton, si dhe kamion me vinç me kapacitet mbajtës mbi 18 ton, ndërkohë që një OE mund të ketë një kamion vetëshkarkues me vinç me kapacitet mbajtës mbi 18 ton dhe e përmbush qëllimin e kërkesës së dy mjeteve.
Për dy kamionët vetëshkarkues me kapacitet mbajtës siç u përmend më lart, numri i tyre dhe kapaciteti mbajtës nuk është argumentuar teknikisht. Pra në asnjë rast nuk është përllogaritur pesha në ton e materialeve të mësipërme, për të nxjerrë vlerësimin se duhet kamion me kapacitet mbajtës 10-20 ton. Gjithashtu, nuk është përcaktuar sasia e orëve të punës për çdo zë pune, e cila të sjellë vlerësimin dhe përcaktimin e numrit të mjeteve të nevojshëm për zbatimin e projektit. Pra nuk është bërë një përcaktim konkret dhe me analizë teknike se cilat do të jenë materialet që do të transportohen me kamionin vetëshkarkues, sa është pesha totale e materialeve, sa peshë mund të transportojë kamioni në një rrugë, sa rrugë në ditë mund të bëjë, dhe në bazë të kësaj përcaktohet sa ton mund të transportojë kamioni në një ditë pune (8 orë) dhe me pas në 1080 orë pune për 135 ditë punë, për të arritur në përcaktimin e numrit të kamionëve.
-Nuk argumentohet numri i 3 vibratorëve betoni në raport me volumin dhe afatin e punimeve që do të kryhen nga ky mjet.
Në pikën 2.3.11 ndër të tjera është kërkuar:

29	Fabrikë Betoni(e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	Ne pronesi/qira ose Kontrate Furnizimi	Copë	1
30	Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	Ne pronesi/qira ose Kontrate Furnizimi	Copë	1

Nga AK është kërkuar fabrikë betoni (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi si dhe, Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, në mënyrë të pajustifikuar e të paargumentuar.
Vendosja e Fabrikës betonit dhe asfaltit, është një kërkesë e paargumentuar nga NJP, e cila nuk është në përputhje me parimet e nxitjen e operatorëve, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare dhe favorizojnë OE që disponojnë Nyje prodhim betoni, Nyje inertesh. Në rast se një operator ekonomiki cili do të marrë pjesë në tender, duhet të marrë me qira linjën e prodhimit të prodhuesit (në rast se prodhuesi nuk do të marrë pjesë në tender), do të thotë se prodhuesi duhet të heqë dore nga aktiviteti i tij, për periudhën e përfundimit të kontratës, duke ia dhëne me qira linjën e prodhimit një operatori tregtar në rast se operatori ekonomik do të marrë pjesë në tender. Kërkesa e kompanisë tregtare ndaj një prodhuesit është e pamundur për tu realizuar. Prandaj kriteri diskriminon çdo operator tregtar që do të marrë pjesë në tender.
Gjithashtu, nga AK, kërkohet për fabrikën e prodhimit të betonit dhe inerteve në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga QKB, në rast se është me qira duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, QKB, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës. Mosparaqitja ose pavlefshmëria e këtyre dokumenteve përbën kusht për skualifikim. Pra, vendosen kërkesa mbi kërkesa të kërkesave, duke e vendosur si kriter kualifikues në lejen mjedisore të fabrikës së betonit.
Në pikën 2.3.4 kërkohet që OE ofertues duhet të ketë licencë III2 A "Shërbime ekspertize lidhur me ndikimin në mjedis" është një kërkesë e panevojshme nga AK, pasi çdo projekt i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis, përpara se ai të miratohet dhe kjo fazë është

ezauruar përpara zbatimit të tij. Zbatimi i masave të përcaktuara në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, është objekt monitorimi nga struktura në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Vlerësimi i ofertave.

Me Urdhër Nr.6760/1 datë 26.07.2022 të zv/ Kryetarit të Bashkisë U.E, është ngritur KVO i cili përbëhet nga E.GJ , Kryetar, L.M dhe A.GJ , Anëtar. Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.s'ka, datë 28.09.2022 për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave drejtuar titullarit të AK/nëpunësit të autorizuar për miratim. *Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.* Në ketë tender kanë marrë pjesë 4 OE, përkatësisht:

1- BOE D.-05 SHPK & XH SHPK me ofert ekonomike 49,962,985 lek pa TVSH ose 59,955,582 lekë me TVSH

2- BOE K & S.SHPK me oferë ekonomike 55,639,430 lekë pa TVSH ose 66,767,316 lek me TVSH.

3-OE L SHPK me ofertë ekonomike 57,662,834 lekë pa TVSH ose 69,195,401 lekë me TVSH.

4-OE S. 2Fa SHPK me ofertë ekonomike 58,502,300 lekë pa TVSH ose 70,202,760 lekë me TVSH.

KVO ka mbajtur raportin përmbledhës të procedurës më datë 28.09.2022.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

OE/BOE	**Arsye e s'kualifikimit**
L SH.A	Mungojne punonjesit e specializuar si me poshte 6 (gjashte) Shofere Kamioni 4 (kater) Eskavatorist 3 (tre) Automakinist
XH.SHPK &D. SHPK	1. Mungon dokumentacioni i deklaruar në formularin përmbledhës i vetëdeklarimit për autobitumatriçe (deklaratë çdoganimi); 2. Mungon dokumentacioni i deklaruar në formularin përmbledhës i vetëdeklarimit për asfaltoshtruese (faturë TVSH 21.11.2008; 3. Mungon dokumentacioni i deklaruar në formularin përmbledhës i vetëdeklarimit për autobot uji me targë AA639OD; 4. Mungon dokumentacioni i deklaruar në formularin përmbledhës i vetëdeklarimit për Rrul ngjeshës gome cilindër 17 ton, faturë TVSH 04.12.2017; 5. Mungon dokumentacioni i deklaruar në formularin përmbledhës i vetëdeklarimit për Rrul cilindër minimumi 8 ton; 6. Mungon kontrata e furnizimit me fabrikën e prodhimi asfalti e pajisur me leje mjedisore me nr. rep 3900, datë 19.08.2021 e deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit; 7. Mungon kontrata e furnizimit me beton dhe inerte me nr. rep 3205, datë 14.07.2021 e deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit;

Skualifikimi qëndron. Janë kualifikuar për fazën e vlerësimit dy O.E, pasi dokumenatcioni i paraqitur prej tyre është në përputhje me kriteret e përgjithshme e të vecanta të kualifikimit: BOE K & Sertkaj SHPK me oferë ekonomike 55,639,430 lekë pa TVSH; OE Sireta 2Fa SHPK me ofertë ekonomike 58,502,300 lekë pa TVSH.

Nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, të dy operatorët i plotësojnë kriteret e përgjithshme e të vecanta (sipas deklaratave për përmbushjen e tyre).

KVO ka kualifikuar e shpallur fitues BOE "K" SHPK & "S." SHPK me ofertën ekonomike 55,639,430 lekë pa TVSH ose 66,767,316 lek me TVSH,se është identifikuar si oferta e suksesshme.

Kriteri: Neni 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; neni 77 të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik".

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit.

Ndikimi: Ul konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë**.** Aplikimi i kritereve të rënduara të cilat çojnë direkt ose indirekt në mospjesëmarrjen e OE.
Rëndësia: E lartë

*Për Projekt Raportin e Auditimit, konkretisht për Akt Konstatimin nr. 8, datë 29.12.2023 (protokolluar në Bashkinë Kamëz me nr. 9838/14 prot., datë 29.12.2023) mbi procedurën e prokurimit me objekt: "**"Ndërtim rrugët Rr. Erzeni, Rr. Marubi, Rr. Valbona, Rr. Tomorri"**", është ridërguar nga subjekti obervacioni me shkresë nr. 1751/1 datë 29.02.2024, protokolluar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 873/7 Prot., datë 04.03.2024.* *Ky observacion rezulton të jetë i njëjtë me obervacionin e dërguar më parë nga subjekti për këtë akt- konstatim (konkretisht me shkresë nr. 224 prot.,datë 09.01.2024, prokolluar në KLSH me nr. 873/6 prot., datë 11.01.2024), për të cilin grupi i auditimit ka mbajtur qendrimin e tij.* *Në kushtet kur ky obervacion nuk ka fakte të tjera shtesë, **nuk merret në konsideratë** dhe mbetet i pandryshuar për Raportin Përfundimtar të Auditimit.*

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
1. NJP, me përbërje: zj. SH.XH, zj. S.V dhe z. S.S.

13. Nga auditimit i procedurës së prokurimit me objekt: **"Blerje makinë MZSH" për vitin 2022",** me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje makinë MZSH" për vitin 2022		
Urdhër prokurimi nr. 4384, datë **16.5.2022**	**NJHDT**: SH.XH S.V S.S	**KVO:** 4684/1, datë **16.05.2022**
Lloji i procedurës "e hapur"		
Fondi limit 10,900, 000 lekë.		Operatorët ekonomikë Pjesëmarrës në tender 2 S'kualifikuar 1 Kualifikuar 1
Burimi i fIncimit: Buxheti Shtetit	**OE fitues**: "S 32" SHPK	
Data e hapjes së tenderit: **01/06/2022**	**Vlera e fituar:** 10,728,000 lekë	
	Diferenca me fondin limit 172,000 lekë	**Likuiduar plotësisht**
Ankimime në AK: s`ka		
Monitorim APP s'ka	**Lidhja e kontratës** Nr. 5928, datë 29.06.2022 **12,873,600 lekë me TVSH**	Afati 10 ditë, nga data e lidhjes së Kontratës

\\\\
U konstatua si vijon:
Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në vendosjen e e specifikimeve teknike të paargumentuara, hartimin e fondit limit, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mos përmbushjes së kritereve dhe specifikimeve teknike.
Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua si më poshtë vijon:
Hartimi i specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit:
Me shkresë Nr.3381 prot. datë 20.04.2022, z. Bardhyl Gjana, Shefi I Sektorit të MZSH-së ka kërkuar miratimin e kërkesës me objekt "**Blerje makinë MZSH**", miratuar nga Kryetari i Bashkisë.
Me Urdhrin nr.3581/1, datë 20.04.2022, i miratuar nga ZV. Kryetari i Bashkisë zj. U.E, është ngritur grupi i punës për përgatitjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike nga komisioni: z. V.Ç(Bachelor në FIncë-Bankë), z.A.GJ – (Bachelor në Inxhinieri Elektrike/Master Profesional Elektroenergjitikë), dhe z. ErjonSaraçi (Bachelor në Inxhinieri Agrare). Për hartimin e specifikimeve teknike, komisioni nuk rezulton të ketë mbajtur një procesverbal me numër dhe datë, si dhe argumentimin përkatës lidhur me çdo njërën prej

specifikimeve të kërkuara për makinë MSZH (bërë pjesë e DST shtojca 5). Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre, në përmbushje të pikës 2 të nenit 78 të*VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

- Gomat e mjetit janë kërkuar në gjendje të mirë, pra specifikim jo konkret dhe i vështirë për t'u vlerësuar nga komisioni i marrjes në dorëzim të automjetit, ndërkohë që për gomat duhet të ishte përcaktuar thellësia e konsumit të tyre, element i cili tregon gjendjen fizike të gomave dhe për më tepër është specifikim i matshëm. Gjithashtu sa i përket gomave të automjetit, nuk është kërkuar etiketa shoqëruese e tyre, e cila tregon plotësimin e standardeve europiane/amerikane të cilësisë, si dhe bën klasifikimin e tyre në bazë të konsumit të karburantit, fërkimit në lagështirë dhe zhurmës që gjenerojnë gjatë ecjes.
- Nuk është përcaktuar kapaciteti i rezervuarit të shkumës dhe materiali përbërës i rezervuarit. Për më tepër është lënë opsionale varianti i disponimit të depozitës së shkumës, pjesë e rëndësishme e funksionimit dhe realizimit të qëllimit të mjetit zjarrfikës, atë të shuarjes së zjarreve nga materiale të lëngshme ose lëngje të ngurtësuar, të tilla si nafta, dylli, llaku, vajrat dhe yndyrnat minerale, etj.
- Nuk është përcaktuar sasia e ujit/minutë që jep pompa kundër zjarrit.
-Nuk është përcaktuar norma e shkarkimit (norma euro) në ajër të ndotësve të gaztë, si të monoksidit të karbonit (CO), oksideve të azotit të shprehura si ekuivalent i dyoksidit të azotit (NO2) dhe hidrokarbureve në total (THC), përfshirë lëndë të ngurta pezull (PM).
- Nuk është vendosur përcaktimi se sa orë pune duhet të ketë automjeti zjarrfikës, që janë tregues kryesorë sa i takon gjendjes teknike të një mjeti teknologjik, pasi një automjet zjarrfikës mund të kryejë lëvizje në distanca të vogla, por mund të ketë punuar për një kohë të gjatë.

Ndërkohë, ky komision me procesverbalin datë 27.04.2022, ka përcaktuar fondin limit në shumën 10,900,000 lekë, bazuar në tre oferta të marra nga OE "C" SHPK, "P" SHPK, dhe U.SHPK. Nga verifikimi në QKB[14], rezulton se shoqëria "C" SHPK, dhe U.SHPK nuk janë të licencuara për tregtimin e automjeteve. Marrja e ofertës ekonomike për një mall të caktuar nga një subjekt i pa licencuar për shitjen e këtij malli, mund të ndikojë negativisht në çmimin real të ofruar nga këto subjekte.

Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 të nenit 3, shkronjën "a" të pikës 3 në nenin 36, pikën 1 të nenit 37, pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", pikën 1 dhe 2 të nenit 40, pikën 2 të nenit 44, nenin 12 dhe 13 dhe 76të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: Grupi i punës "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit" me përbërje: z. Va.**Ç** , z. A.**Gj**, dhe z. E.**S**.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër nr 4684/1, datë 16.05.2022 është ngritur KVO i përbërë nga z. L.M (Kryetar), z. K.H (Anëtar) dhe zj. A.S (Anëtar). Nga KVO është mbajtur procesverbali për hapjen e tenderit, procesverbali për vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave datë 24.06.20222, drejtuar titullarit të AK për miratim.

[14] https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/,

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

Nr.	OE	Oferta	Vlerësimi i KVO
1	*"S "* SHPK	10,728,000 lekë pa TVSH	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	"E " SHPK	10,855,000 lekë pa TVSH	**S`kualifikuar pasi:** dokumentacion administrativ-ligjor si dhe teknik kualifikues i paraqitur nuk është i plotë dhe i saktë si është kërkuar në DST

- Skualifikimi i O.E "E " SHPK qëndron, pasi nuk ka paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara në DST.

-Lidhur me vlerësimin e O.E fitues "*S* " SHPK: ka deklaruar për ofrimin e garancisë me afat 1 vit për defekte të mundshme, por OE në këtë deklaratë nuk ka përcaktuar qartë të gjitha kushtet e garancisë teknike të mjetit, sikurse kërkuar në DST. Gjithashtu në bazë të verifikimit në QKB, O.E nuk ka një licencë me titull "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe të rimorkiove", me kodin VII.3.B.1 / a, b, c, ç dhe d. Pra OE fitues ka dhënë një deklaratë për kryerjen e një veprimi, për të cilën nuk është i licencuar që ta kryejë. Pra, KVO duhet të kishte verifikuar përmbushjen e kësaj kërkese nga ana e O.E fitues, *ku edhe në germën h), pika 1, shtojca 7 të DST, përcaktohet se "ofertuesi kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi", ose/edhe të kishte kërkuar sqarime nga NJP lidhur me qartësimin e këtij kriteri të vendosur.*

Nga ana e KVO për vlerësimin e specifikimeve teknike të OE pjesëmarrës janë mjaftuar nga dokumenti me emërtimin"Katalog mjetit", ku në interpretim të drejtë të këtij dokumenti po analizojmë disa të dhëna:

Pompa e ujit*: "Pompa është e standardit EU (STROZ) hidraulik me presion 8-12 bar. Sistemi i pompës se ujit është i lidhur me një baraban (tub gome) me diametër 20-30 mm dhe gjatësi mbi 25 m (te jete i standardit te presionit te larte) i cili është i vendosur ne anën e djathtë".*

Siç vihet re në deklarimin e mësipërm as OE ofertuesi nuk e ka të qartë as vetë diametrin e tubit të gomës që ofron pasi e jep me diametër nga 20-30, gjithashtu nuk ka të qartë as gjatësinë, pasi shprehet mbi 25 ml sikurse kërkohet në specifikimet teknike, madje kërkon që tubin e gomës të jetë i cilësisë se lartë (nuk e dimë kujt ja kërkon këtë element).

-Me poshtë po paraqesim specifikimet e kërkuara nga AK dhe ato të ofruara nga OE fitues sipas dokumentit me emërtim "Katalog mjeti" në SPE.

SPECIFIKIME TEKNIKE	Shtojca 5. FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
Tipi Imjetit: **Zjarrfikëse + Pajisjet** **Mjeti dhe pajisjette jenesipas përcaktimit te berenga VKM nr. 520, datë 25.07.2019 " Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", pika 15, te nenit 16.** **Mjeti të jetë ekuivalent me mjetin Prodhim Perëndimor (Europian)** **KabI**: Dopiokabine **Lloji I karburantit**: Diesel **Kamio**: Manual **Ngjyra:** E kuqe **Aksi i pasmem** : Dopjogome **Viti i prodhimit**: **2008 e larte** **Depozita e ujit**: mbi 2000 L **Kapaciteti I Kabinës**: jo me pak se 4+1 ndenjëse **Volumi i motorrit:** 4000-4500 (cm^3)	**Tipi I mjetit:** Zjarrfikëse + Pajisjet **KabI**: Dopiokabine **Lloji I karburantit**: Diesel **Kamio**: Manual **Ngjyra**: E kuqe **Aksi i pasmem** : Dopjogome **Viti i prodhimit**: 2008 **Depozita e ujit:** 2000 L **Kapaciteti I Kabinës:** 4+1 ndenjëse **Vellimi i motorrit**: 4249 (cm3) **Shasia** në gjendje të mire

Shasia në gjendje të mire **Gomat :** Të pershtatur te jenene gjendje te mire **Sistemi i drejtimit**: Në gjendje të mire pune dhe me timon në krahun e majtë. **Sistemi i frenimit**:Sistem ABS Në gjendje të mire punetë dy llojeve të frenave,frena e parkimit dhe frenat retarder. **Automjeti** duhet të jete i kompletuar me sinjalistiken e nevojshme të përshtatshme për Zjarrfikëse sipas modelit Europiansi dhe sistemet e sinjalizimit Akustik dhe pamorë. **Automjeti** duhet te kete autoporlant . **Automjeti** duhet te kete mbi kabinë 2 kafaz të fiksuar për mbajtjen e shkallëve të ndryshme si dhe aksesor të ndryshëm. **Automjeti** duhet te jete me prize hyrese me tension 220Volt per te bere furnizimin ne disa priza te brendshmene makine per perdorimin e pajisjeve. **Automjeti** duhet te kete 2(dy) dalje per lidhe tubash nga ana e pasme dhe nga 1(nje) dalje nga pjeset anesore të lidhura me pompen e ujit. **Automjeti** ne pjesen e pasme te jete me jastik ajri qe te ulet dhe ngrihet ne baze te terrenit me pult komandimi. **Automjeti** ne anen e pasme te tij te kete te montuar nje prozhektor kulle me ulje-ngritje mekanike. **Automjeti** ne anen e djathtete tij duhet te kete te montuar fiksuset e aparateve AP3. (PSE MOS TA KET NE ANEN E MAJT) **Automjeti** te kete 3 (tre) grila ne anen e majte , 3 (tre) grila ne anen e djathte ku ne brendesi te tyre te jene te montuar sirtar te levizshem per vendosjen e aksesoreve te mjetit dhe 1 (nje) grile ne anen e pasme te pompa. **Automjeti** në anen e pasme te tij duhet te kete te montuar shkallen e cila sherben per ngjitjen mbi kabine. **Automjeti** duhet te kete te montuar nje mbledhes tubi mekanik. **Estetike:**Ana e jashtme dhe e brendshme të jenë në gjendje të mirë(pa gërvishtje, goditje) **Pompa e ujit** :Pompa duhet te jete e standartit **EU (STROZ)** hidraulik me presion 8-12 bar. Sistemi i pompes se ujit duhet te jete i lidhur me nje baraban (tub gome) ***me diameter 20-30 mm dhe* gjatesi mbi 25 *m (te jete i standartit te presionit te larte) i cili te jete i vendosur ne anen e djathtë te automjetit* .** **Pompa të jetë pjesë e mjetit zjarrfikës dhe në funksion, të gjitha daljet e pompës duhet të jenë të Standartit Europian.(STROZ)** **Automjeti zjarrfikës duhet të jetë i pajisur me :** Tuba te ndryshem te standartit Europian STORZ (50 mm, 65 mm) 150 ml Tub 100 mm gome per thithje uji 1 (nje) Hedhese te ndryshme uji 4 (kater) Degezues te ndryshem(4 cope) Qafpate me dy dalje ne koke sipas CE 1 (nje) Çeles per hapjen e hidranteve 1 (nje) Perzires shkume 1 (nje) Hedhes shkume profesional 1 (nje)	**Gomat** : Të pershtatura dhe ne gjendje te mire **Sistemi i drejtimit**: Në gjendje të mire pune dhe me timon në krahun e majtë. **Sistemi i frenimit:** Sistem ABS Në gjendje të mire pune të dy llojeve të frenave,frena e parkimit dhe frenat retarder. **Automjeti** është i kompletuar me sinjalistiken e nevojshme të përshtatshme për Zjarrfikëse sipas modelit Europian si dhe sistemet e sinjalizimit Akustik dhe pamorë. **Automjeti** ka autoporlant . **Automjeti** ka mbi kabinë 2 kafaz të fiksuar për mbajtjen e shkallëve të ndryshme si dhe aksesor të ndryshëm. **Autotmjeti** është me prize hyrese me tension 220 Volt per te bere furnizimin ne disa priza te brendshme ne makine per perdorimin e pajisjeve. **Automjeti** ështe i pajisur me 2(dy) dalje per lidhe tubash nga ana e pasme dhe nga 1(nje) dalje nga pjeset anesore të lidhura me pompen e ujit. **Automjeti** ne pjesen e pasme është me jastik ajri qe te ulet dhe ngrihet ne baze te terrenit me pult komandimi. **Automjeti ne** anen e pasme te tij ka te montuar nje prozhektor kulle me ulje-ngritje mekanike. Automjeti ne anen e djathte te tij ka te montuar fiksuset e aparateve AP3. **Automjeti** ka 3 (tre) grila ne anen e majte , 3 (tre) grila ne anen e djathte ku ne brendesi te tyrejanë te montuar sirtar te levizshem per vendosjen e aksesoreve te mjetit dhe 1 (nje) grile ne anen e pasme te pompa. **Automjeti** në anen e pasme te tij ka te montuar shkallen e cila sherben per ngjitjen mbi kabine. Automjeti ka te montuar nje mbledhes tubi mekanik. **Estetike**:Ana e jashtme dhe e brendshme janë në gjendje të mirë(pa gërvishtje, goditje) **Pompa e ujit** :Pompa është e standartit EU (STROZ) hidraulik me presion 8-12 bar. Sistemi i pompes se ujit është i lidhur me nje baraban (tub gome**)** ***me diameter 20-30 mm dhe gjatesi mbi 25 m (te jete i standartit te presionit te larte) i cili është i vendosur ne anen e djathtë te automjetit* .** Pompa është pjesë e mjetit zjarrfikës dhe në funksion, të gjitha daljet e pompës janë të Standartit Europian.(STROZ) Automjeti zjarrfikës është i pajisur me : Tuba te ndryshem te standartit Europian STORZ (50 mm, 65 mm) 150 ml Tub 100 mm gome per thithje uji 1 (nje) Hedhese te ndryshme uji 4 (kater) Degezues te ndryshem (4 cope) Qafpate me dy dalje ne koke sipas CE 1 (nje) Çeles per hapjen e hidranteve 1 (nje) Perzires shkume 1 (nje) Hedhes shkume profesional 1 (nje) Shkalle mekanike portative me gjatesi minimale 15

Shkalle mekanike portative me gjatesi minimale 15 m 1(nje) Shkume 100 (minimum litra) Aparat frymemarres AP3 te kompletuar (3 cope) Kostume per temperatura super te larta material alumin te reja 2(cope) Karrel manual me dy goma qe perdoret per shtrirjen e tubave ne largesi dhe ne terrene te veshtira 1 (nje) Preres elektrik (tip trapani) 1 (nje) Tub 70 mm per furnizimin me uje 1(nje) Gershere mekanike per prerjen e fijeve te hekurit deri neΦ14 Top per hedhjen e ujit me dy hyrje dhe nje dalje I cili te jete I komandueshem1(nje) Litar per zbritjen nga lartesite me kontroll mekanik minimalisht 2 cope. Kuti të Ndihmës së shpejte Leva të ndryshme për hapje konstruksionesh Çelsa te ndryshem per lirim dhe shterngim tubash Kuti çlesash hekzagonal dhe te ndryshem me kriket. Tub per shkeputjen e levave te energjise elektrike (qe nuk percjell energjine) Aksesore te ndryshem si Sopata, Lopata, cekice, pinca, celesa, fshesa. **Afati i levrimit**: **Brenda 10 (dhjete) diteve nga data e nenshkrimit te kontratës.** Ne cmim perfshihen te gjitha shpenzimet per taksa doganore. Automjeti duhet te dorezohet i targuar ne Shqiperi me gjithe dokumentacionin teknik dhe ligjorper levizjen e tij (Leje qarkullimi Shqiptare).	m 1(nje) Shkume 100 (minimum litra) Aparat frymemarres AP3 te kompletuar (3 cope) Kostume per temperatura super te larta material alumin te reja 2(cope) Karrel manual me dy goma qe perdoret per shtrirjen e tubave ne largesi dhe ne terrene te veshtira 1 (nje) Preres elektrik (tip trapani) 1 (nje) Tub 70 mm per furnizimin me uje 1(nje) Gershere mekanike per prerjen e fijeve te hekurit deri ne Φ14 Top per hedhjen e ujit me dy hyrje dhe nje dalje I cili te jete I komandueshem 1(nje) Litar per zbritjen nga lartesite me kontroll mekanik minimalisht 2 cope. Kuti të Ndihmës së shpejte Leva të ndryshme për hapje konstruksionesh Çelsa te ndryshem per lirim dhe shterngim tubash Kuti çlesash hekzagonal dhe te ndryshem me kriket. Tub per shkeputjen e levave te energjise elektrike (qe nuk percjell energjine) Aksesore te ndryshem si Sopata, Lopata, cekice, pinca, celesa, fshesa. Përfaqësuesi i Ofertuesit S. R.

Pra, KVO është mjaftuar vetëm me të dhënat e mësipërme për të kualifikuar dhe paraqitur titullarit të AK për shpallje fitues të OE pjesëmarrës, ndërkohë që nga të dhënat e mësipërme dokumenti i paraqitur nga OE fitues është tejet konfuz në lidhje me plotësimin e specifikimeve teknike

Sa më sipër KVO minimalisht i lind detyrimi për të kërkuar sqarimet e nevojshme nga OE për sa ka deklaruar lidhur me plotësimin e specifikimeve të vendosura nga AK.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mospërputhje me përcaktimet e bëra me pikën 4 të nenit 87 me pikat 1 dhe 3 të nenit 92 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" I ndryshuar, si dhe në mospërputhje me pikën 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Në përfundim, OE "S ", nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", KVO duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit. Për më tepër që në këtë rast edhe në zbatim të përcaktimit në shkronjën "b" të pikës 2 të nenit 93 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, oferta nuk është e përshtatshme, nga KVO duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit.

Për sa më sipër mban përgjegjësi:

-KVO, e përbërë nga: z.L.M , z. K.H dhe zj. A.S

Zv. Kryetare e AK/ nëpunësi i autorizuar Zj. U.E.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes, konkretisht: *pika 4 të nenit 87me pikat 1 dhe 3 të nenit 92të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" I ndryshuar; pikën 2 të nenit 82të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të*

prokurimit publik", i ndryshuar; pika 3 të nenit 3, shkronjën "a" të pikës 3 në nenin 36, pikën 1 të nenit 37, pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik"; pikat 1dhe 2 të nenit 40, pikën 2 të nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", si dhe neni 21 i ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në vendosjen e specifikimeve teknike, si dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: *anëtarët e grupit për përllogaritjen e fondit limit e specifikimeve tekniket, anëtarët e KVO, nëpunësi i autorizuar për procedurën.*
Ndikimi: Ulja e efiçencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik **.**
Rëndësia: E lartë

Për Projekt Raportin e Auditimit, konkretisht për Akt Konstatimin nr. 9, datë 29.12.2023 (protokolluar në Bashkinë Kamëz me nr. 9838/13 prot., datë 29.12.2023) mbi procedurën e prokurimit me objekt: ***"Blerje makinë MZSH"****, nuk është dërguar nga Bashkia Kamëz observacion. Në këto kushte, qëndrimi i grupit të auditimit mbetet siç është trajtuar në observacionin me nr. 155 prot.,datë 09.01.2024, administruar në KLSH me nr. 873/6 prot., datë 11.01.2024 duke* ***mos marrë në konsideratë argumentet*** *dhe mbetet i pandryshuar për Raportin Përfundimtar të Auditimit.*

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
1. Grupi i punës "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit" me përbërje: z. V.Ç, z. A.GJ , dhe z. E.S .
2. KVO-në me përbërë : z. L.M , z. K.H dhe zj. A.S .
3. Zv. Kryetare e AK/ nëpunësi i autorizuar Zj. U.E.

14. Nga auditimi i prokurimit me objekt: **"Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshteve, 2022"** me këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje pellet për ngrohjen e kopshteve dhe shkollave" për vitin 2022</td></tr>
<tr><td>Urdhër prokurimi
Nr. 1067, datë 04.02.2022</td><td rowspan="2">Njësia e Hartimit të Dokumeteve të Tenderit:
1.SH.XH
2.S.V
3.S.S</td><td rowspan="2">Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:
Urdhër Nr.1067/1, datë 04.02.2022 si dhe nr. 1524 Prot., datë 18.02.2022 (për një ndryshim Kryetari i KVO Z. E.GJ zëvendësohet me Z. A.D)
1.A.D
2.L.M
3.E.D</td></tr>
<tr><td>Lloji i procedurës "E hapur e thjeshtuar"</td></tr>
<tr><td>Fondi limit (pa TVSH)
2,325, 060 lekë.</td><td rowspan="3"></td><td rowspan="3">Operatorët ekonomikë
a)Pjesëmarrës në tender 2
b)S'kualifikuar 1
c)Kualifikuar 1</td></tr>
<tr><td>Burimi i fIncimit: Buxheti I Shtetit</td><td>OE fitues: "A& P" SHPK</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Data e hapjes së tenderit: 18/02/2022</td><td>Oferta Fituese (pa TVSH):
2,304,000 lekë</td></tr>
<tr><td>Diferenca me fondin limit
21,060 lekë</td><td>Likuiduar plotësisht</td></tr>
<tr><td>Ankimime në AK: s`ka</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Monitorim APP s'ka</td><td>Lidhja e kontratës
Nr. 2399, datë 25.03.2022
2,764,800 lekë (me TVSH)</td><td>Afati 5 ditë, nga data e lidhjes së Kontratës</td></tr>
</table>

U konstatua si vijon:
Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në vendosjen e kritereve dhe specifikimeve teknike, hartimin e fondit limit, specialistit të fushës në objektin e prokuruar, si dhe mos dokumentim i specifikimeve teknike në vlerësimin e ofertave.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua si më poshtë vijon:

Përcaktimi i kërkesave për pelet dhe Hartimi i fondit limit

Me shkresë Nr. s'ka, datë 25.01.2022, z. A.D , Drejtor i Arsimit, Rinisë e Sportit ka kërkuar miratimin e kërkesës me objekt "Blerje peleti për ngrohjen e shkollave dhe kopshteve" për sasinë 90 ton. Në kërkesën në fjalë, nuk dokumentohet nevojat përkatëse për pelet e shkollave dhe kopshteve, në momentin e kërkesës, koha në të cilën u nevojitet kjo sasi (sjellim në vëmendje që data e lidhjes së kontratë është 25.03.2023, periudhë kur përfundon nevoja për ngrohje që është 15 Nëntor -15 Mars), llojit të kaldajës që disponojnë secila, si dhe hapësirat përkatëse të magazinimit në secilën prej tyre.

Grupi i punës "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit", i ngritur me Urdhër Nr. s'ka, datë 25.01.2022, me përbërje: z. A.P , znj. F.P , znj. O.G , është miratuar nga Zv/Kryetar i Bashkisë, zj. U.E në cilësinë e nëpunësit të autorizuar. Nisur nga inventari i dosjes fizike të kësaj procedure, ku mungonin në listë procesverbalet përkatës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit, pasi është kërkuar nga grupi i auditimit, AK ka vendosur në dispozicion:

1-një procesverbal pa nr. i datës 31.01.2022, sipas të cilit është përllogaritur fondi limit mbi bazën e tre ofertave të tre operatorëve ekonomikë (në vijim O.E), konkretisht: "P " SHPK me ofertën ekonomike çmimi/njësi (ton) 25,600 lekë; "4S" SHPK me ofertën ekonomike cmimi/njësi (ton) 25,800 lekë; "A " SHPK me ofertën ekonomike çmimi/njësi (ton) 26,102 lekë. Vlera e përllogaritur e fondit limit për 90 ton është 2,325,060 pa TVSH. Ndërkohë për dy O.E, nga kërkimi i bërë në QKB, "P " SHPK dhe "4S" SHPK rezultojnë se nuk ka në fushën e aktivitetit të tyre "prodhim e tregtim peleti". Marrja e ofertës ekonomike për një mall të caktuar nga një subjekt që nuk ka në fushën e aktivitetit objektin e prokurimit, mund të ndikojë negativisht në çmimin real të ofruar nga këto subjekte. Gjithashtu, grupi i punës për hartimin e fondit limit nuk ka kërkuar përditësimin e të dhënave (nevojat aktuale të shkollave e kopshteve për pelet, gjendja ne magazinë e sasisë së mallit),në mospërputhje me pikën 4 të nenit 12, si dhe nenin 13 të *VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

2-një shkresë pa nr., dhe datë, mbi specifikimet teknike të paargumentuara, i firmosur vetëm nga një anëtar i grupit të punës, z. A.P , i cili nuk rezulton të jetë specialist i fushës/ profesion mësuesi gjuhë -letërsi.). Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre, në përmbushje të pikës 2 të nenit 78 dhe pika 2 e nenit 74 të*VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Për sa më lart, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:

z. A.D në cilësinë e drejtuesit të Drejtorisë së Arsimit (kërkuesi i blerjes)

z. A.P , zj. F.P , zj. O.G , në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit".

-ZV. Kryetari i Bashkisë Kamëz zj.U.E, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar.

Hartimi i kritereve dokumentuar me procesverbalin nr. s'ka, datë 04.02.2022, nga NJP

Nga AK nuk është kërkuar që O.E ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/fragmentet e katalogut ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të artikullit me qëllim që AK të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Nga AK nuk është kërkuar që O.E ofertues duhet të paraqesë raportet e testimit nga laboratorë të certifikuar me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara për mallrat objekt prokurimi. Dëshmia me rezultatet e testimeve zyrtare duhet të jetë lëshuar jo më parë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e zhvillimit të tenderit.

Nga AK nuk është përcaktuar që malli duhet të jetë i paketuar me ambalazhim plastik rezistent ndaj procesit të transportit dhe shpërndarjes nëpër objekte. Në ambalazhin e mallit duhet të pasqyrohet qartë me shkrim lloji i mallit, specifikimet kryesore teknike, *(psh. Vlera kalorike, Gjatësia, përmbajtja e lagështisë etj.)* emërtimi dhe prodhuesi.
Nuk është argumentuar afati i caktuar për dorëzimin e mallit në destinacion, konkretisht afati 5 ditor i vendosur në DST, afat i cili në vlerësimin e grupit të auditimit është i shkurtër.
Nuk është përcaktuar një grafik i qartë i lëvrimi i mallit, specifikisht adresat e shkollave dhe kopshteve, sasia përkatëse që do të dërgohet në secilën prej tyre, si dhe mënyra e transportit të mallit deri në magazinimin e plotë të peletit.
Sikurse argumentuar me lart, për kriteret e vendosura, që nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, konkretisht në mospërputhje *me nenin 23 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe pikës 2 dhe 3 dhe 6 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* mban përgjegjësi NJP me përbërje: SH.XH, S.V , S.S

Vlerësimi i ofertave

Me urdhër nr 1067/1, datë 04.02.2022 është ngritur KVO i përbërë nga E.GJ (Kryetar), L.M (Anëtar) dhe E.D (Anëtar), i ndryshuar më datë 18.02.2022, ndryshohet Kryetari i Komisionit, i cili zëvendësohet me z. A.D . Nga KVO është mbajtur raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave datë 03.03.2022, drejtuar titullarit të AK për miratim.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

Nr.	OE	Oferta (lekë pa TVSH)	Vlerësimi i KVO
1	*"A* " SHPK	2,304,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2	"S " SHPK	2,241,000	S`kualifikuar pasi: mostra e paraqitur nuk përmbush specifikimet teknike, konkretisht pika 2.3.2 e DST

Procedura për marrjen në dorëzim të mostrave dhe verifikimin e tyre nëse janë dorëzuar sipas specifikimeve teknike të DST nuk dokumentohet në procesverbalin përkatës të KVO, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Nr., 2 datë 02.05.2019 "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE" të APP. Nënshkrimi i KVO për vlerësimin e mostrave nuk vërteton nëse ato janë sipas specifikimeve teknike.
Për sa më lart mban përgjegjësi KVO me përbërje: z. A.D , z.L.M , zj. E.D .
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes, konkretisht: pikën 4 të nenit 12, neni 2, neni 13, pikat 1 dhe 2 të nenit 40, pikën 2 të nenit 44, nenit 73 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; pika 3 të nenit 3, shkronjën "a" të pikës 3 në nenin 36, pikën 1 të nenit 37, pikën 1 të nenit 79, nenin 21 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik"; pika 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Nr.2, datë 02.05.2019 "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE" të APP.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në vendosjen e specifikimeve teknike, kritereve të kualifikimit, hartimit të fondit limit, specialistin e fushës në objektin e prokurimit, si dhe në vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: *anëtarët e grupit për përllogaritjen e fondit limit e specifikimeve tekniket, anëtarët eNJP, anëtarët e KVO, si dhe nëpunësi i autorizuar për procedurën.*
Ndikimi: Ulja e efiçencës dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike.
Rëndësia: E lartë

*Për Projekt Raportin e Auditimit, konkretisht për Akt Konstatimin nr.10, datë 29.12.2023 (protokolluar në Bashkinë Kamëz me nr. 9838/12 prot., datë 29.12.2023) mbi procedurën e prokurimit me objekt: "**Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshteve, 2022**", është*

ridërguar nga subjekti obervacioni me shkresë nr. 1731 datë 28.02.2024, protokolluar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 873/7 Prot., datë 04.03.2024. Ky observacion rezulton të jetë i njëjtë me obervacionin e dërguar më parë nga subjekti për këtë akt- konstatim (konkretisht me shkresë nr. 224 prot.,datë 09.01.2024, prokolluar në KLSH me nr. 873/6 prot., datë 11.01.2024), për të cilin grupi i auditimit ka mbajtur qendrimin e tij.
Në kushtet kur ky obervacion nuk ka fakte të tjera shtesë, ***nuk merret në konsideratë*** *dhe mbetet i pandryshuar për Raportin Përfundimtar të Auditimit.*

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i Kontratës Nr. 2399 Prot., datë 25.03.2022 dhe, mungesa e monitorimit të saj.
Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, lidhur me zbatimin e kontratës dhe marrjes në dorëzim të mallit, u konstatua si më poshtë vijon:
Marrja në dorëzim dhe zbatimi i kontratës. Kontrata Nr.2399 datë 25.03.2022 e lidhur midis O.E fitues dhe AK (nëpunësi i autorizuar zj. U.E), përcakton ndër të tjera grafikun e ekzekutimit, sasinë **90 ton** dhe afatin prej 5 ditësh (pra brenda datës 31.03.2022). Me urdhrin nr.2399/2 datë 25.03.2022 të ZV.Kryetarit të Bashkisë Kamëz znj.U.E, është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, me përbërje si vijon: z.A.P , zj.F.Pdhe znj. E.E . Grupi i punës, ka mbajtur procesverbalin më datë 08.04.2022, sipas së cilit furnizimi është dorëzuar sipas preventivit dhe specifikimeve teknike, ndërkohë evidentohet që sasia e dorëzuar është **62.4 ton**, në 10 objekte shkolla e kopshte.
Grupi i auditimit ka kërkuar arsyet efurnizimit të kësaj sasie, sasia aktuale e dorëzuar nga kjo kontratë dhe pagesat e kryera për këtë kontratë dhe i janë vënë në dispozicion:
-Urdhër shpenzimi Nr. 590 datë 16.05.2022 dhe fatura nr.55 datë 08.04.2022, në vlerën 1,597,440 pa TVSH ose 1,916,928 me TVSH, për **62.4 ton**, e cila është dhe pagesa e vetme për këtë kontratë;
-Shkresa Nr. 2399/3 datë 04.04.2022, mbajtur midis O.E fitues dhe grupit të marrjes në dorëzim sipas së cilës "për shtyrjen e afatit të dorëzimit të 90 ton pelet, nga ata **04.04.2022** deri **08.04.2022** me arsyetimin se do të shpërndahet në disa objekte mësimore, si dhe është rënë dakord që sasia prej 62.4 ton të shpërndahet në datat e mësipërme kurse pjesa tjetër **27.6 ton** në periUt 15 nëntor - 15 dhjetor 2022. Gjithashtu shtyrja bëhet për efekt magazinimi";
-Shkresa Nr. 10422 datë 09.11.2022, e "O.E" fitues, i cili bën me dije se në zbatim të kontratës duhet të sillnin edhe 27.6 ton pelet, por për arsye familjare është drejt mbylljes së aktivitetit dhe nuk mund të furnizojnë me sasinë sipas kontratës, duke kërkuar marrjen në konsideratë për shmangien e penaliteteve të parashikuara në ligj e kontratë.
-Shkresa Nr. 10422/1 datë 09.11.2022 e, z. A.D , Drejtor i Arsimit, Rinisë e Sportit përmes së cilës përcjell njoftimin e kompanisë "A& P" SHPK, drejtuar Drejtorit të Prokurimeve Z. L.M dhe Drejtorit të Çështjeve Ligjore z. L.D .
-Procesverbal nr. s'ka, i datës 08.04.2022 mbi shpërndarjen e peletit në shkolla e kopshte, si dhe situacioni i pagesës ku data e furnizimit rezulton 08.04.2022.
Zgjatja e afatit të lëvrimit të mallrave është një nga kushtet thelbësore të një kontrate furnizimi mallrash dhe si e tillë nuk lejohet, në kuptim të germës a), pika 4 e nenit 127 i LPP. Përpos kësaj, rastin konkret zgjatja e afatit është bërë nga grupi i marrjes në dorëzim, i cili nuk e ka kompetencën ligjore për sa kohë nuk ka një amendim apo modifikim kontrate nga AK, duke favorizuar kështu O.E fitues. Gjithashtu, arsyeja tjetër e përmendur nga ky grup "mungesa e ambientit të magazinimit" është një element që AK duhet të ishte në dijeni për hapësirën, pasi nuk ka ndryshuar asgjë në këto 30 ditë, nga urdhri i prokurimit deri në pretendimi i grupit të marrjes në dorëzim për shtyrje afati.
Nga Zv/Kryetare zj. U.E, ka lidhur kontratën me O.E fitues, nuk është ngritur komisioni përkatës për monitorimin e zbatimit të Kontratës Nr. 2399, datë 25.03.2022, sikurse dhe raportimin në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) në lidhje me problematikat e hasura në

zbatim të kontratës, në mospërputhje të nenit 124 e 125 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik", si dhe neneve 106 e 107 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Nuk dokumentohet asnjë raport i zbatimit të kontratës në fjalë apo modifikim kontrate *në mbështetje të nenit 127 të LPP*, edhe pse kontrata rezulton të jetë ende ***e pazbatuar***, nga 90 ton për të cilën është lidhur ajo, është shpërndarë vetëm 62.4 ton, si dhe në mos përmbushje të nenit 6.1 të Kontratës në fjalë si dhe nenit 1.2.3 "Modifikimi" KPK në DST, midis ("Furnizuesi do të jetë përgjegjës për furnizimin e të gjitha mallrave .....në përputhje me DST). Gjithashtu, AK nuk ka dërguar në APP kërkesën për mos përmbushje të detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit, për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike, brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë, *në mos përmbushje të nenit 108 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*".
Pavarësisht arsyeve të O.E fitues, të cilat nga Grupi i Auditimit konsiderohen jo të qenësishme dhe objektive, (rezulton aktiv sipas ekstraktit në QKB)[15], nga AK nuk janë mbajtur penalitetet, në mospërputhje me nenin 17 të Kontratës Nr. 2399, datë 25.03.2022:
-Penaliteti i vonesës prej 8 ditësh (01.04.2022-08.04.2022), llogaritur në vlerën **88,473.6 lekë me TVSH (**për sasinë prej 90 ton, në vlerën 2,764,800 lekë me TVSH). Kjo vlerë përbën dëm ekonomik për buxhetin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz.
-Penaliteti për vonesën (08.04.2022-15.12.2023) në mos përmbushjen e kontratës/ mosdorëzimin për pjesën e mbetur të furnizimit (për sasinë 27.6 ton, në vlerën 847,872 lekë me TVSH), në vlerën 2,163,769 lekë**.** Në vlerësimin e grupit të auditimit, penaliteti s'mund të jetë më shumë **se 25% e vlerës së kontratës**, ndaj penaliteti që duhet mbajtur është **në vlerën 691,200 lekë**. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik për buxhetin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz.
-Sigurimi i Kontratës Nr. 16 datë 23.03.2022, në vlerën **27,900.2** lekë për efekt të mos përmbushjes së kontratës).

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes, konkretisht: nenit 124 e 125, pika 4 e nenit 127 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik"; neneve 106, 107 e 108 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"; Kontrata Nr.2399 datë 25.03.2022.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në zbatimin e monitorimin e kontratës.
Ndikimi: Ulja e efiçencës dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike.
Rëndësia: E lartë

*Për Projekt Raportin e Auditimit, konkretisht për Akt Konstatimin nr.10, datë 29.12.2023 (protokolluar në Bashkinë Kamëz me nr. 9838/12 prot., datë 29.12.2023) mbi procedurën e prokurimit me objekt: "**Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshteve, 2022**", është ridërguar nga subjekti obervacioni me shkresë nr. 1731 datë 28.02.2024, protokolluar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 873/7 Prot., datë 04.03.2024.*
Ky observacion rezulton të jetë i njëjtë me obervacionin e dërguar më parë nga subjekti për këtë akt- konstatim (konkretisht me shkresë nr. 224 prot.,datë 09.01.2024, prokolluar në KLSH me nr. 873/6 prot., datë 11.01.2024), për të cilin grupi i auditimit ka mbajtur qendrimin e tij.
*Në kushtet kur ky obervacion nuk ka fakte të tjera shtesë, **nuk merret në konsideratë** dhe mbetet i pandryshuar për Raportin Përfundimtar të Auditimit.*

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi: z. A.P , zj. F.P , zj. O.G , në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit".

[15] qkb.gov.al/umbraco/Surface/Documents/GenerateSimpleExtract

KVO me përbërje: z. A.D , z. L.M , zj. E.D .
Zv.Kryetari i Bashkisë Kamëz, zj. U.E, si nëpunësi i autorizuar për procedurën dhe lidhës i kontratës.
Grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga: z. A.P , zj. F.P dhe zj. E.E ;
Drejtori i FIncës dhe Kontabilitetit zj. V.S;

Titulli i gjetjes nr. 2*:* Në zbatim të programit të auditimit u audituan procedurat e prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave për punë publike, ku u konstatua se në **2 (dy) raste** [1(një) procedurë prokurimi dhe 1(një) kontratë për punë publike], nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, nuk është kryer oponenca teknike, në mos përpëthje me Ligjin Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të N", të ndryshuar.

1. Procedura e prokurimit me objekt: "***Ndërtim Rr. Frutikulturë (Rr. pingul me Rrugën Azem Galica + Rr. "Isuf Gervalla" + Rr. "Brezaret***"", zhvilluar sipas urdhër prokurimit me nr. 5463 prot., datë 16.06.2022, me fond limit 85,269,315 lekë dhe fitues operatorin ekonomik "V " SHPK, u konstatua si vijon:
Përshkrimi i situatës 1: PZ është haruar nga Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve me staf teknik projektues (Ing. Konstruktor E.M , Ing. GjeoinformatikE.L, Ing. Preventivus H.M , Ing. Topograf R.H) dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kamëz Z. R.S . Preventivi i punimeve është hartuar nga Ing. H.M dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kamëz.
-Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, **nuk** rezulton të jetë kryer **oponencë teknike**, në lidhje me procedurën e sipërcituar, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik.

2. Nga auditimi i zbatimit të kontratës për punë publike me objekt: "***Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza"***, me nr. 7477 prot., datë 23.08.2022, me fituesin BOE "B" & "N" SHPK me vlerë të kontratës 72,285,722 lekë, u konstatua si vijon:
Përshkrimi i situatës 2: Projekti i zbatimit (projekt ide) është hartuar nga AK Bashkia Kamëz nga stafi teknik projektues me përbërje: Ing. B.K., Ing.E.L, Ing. E.M ,Ing. Preventivues H.M ,. ST dhe relacioni teknik, janë hartuar nga dhe Ing. H.M , Ing.E.L, Ing. R. H. Raporti Teknik është përgatitur ga: Ing. H.M , Ing. F.M dhe Ing. R. H.
Për ndërtimin e investimit me objekt: "Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza" nga Titullari i Bashkisë Kamëz është miratuar Leje Rindërtimi Infrastrukturore me Nr. 3558, datë 02.12.2021, bazuar në Vendimin nr. 4475, datë 18.11.2022 veprim ky sipas, nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
-Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, **nuk** rezulton të jetë kryer **ponencë teknike**, në lidhje me procedurën e sipërcituar, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik.

Sa më sipër trajtuar për mos kryerjen e oponencës teknike, shprehur nëgjetjen nr. 2 me përshkrimin e dy situatave, është në kundërshtim me:
-Pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të N*", i ndryshuar, sipas të cilit: "*Oponenca teknike për projektet e N të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e N, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik*", në kundërshtim me nenin 41, pika 1, germa "c" .

-VKM nr. 610, datë 22.9.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve".
Nga ana tjetër, miratimi i projektit të zbatimit, nga ana e Bashkisë Kamëz, nuk i referohet një oponence teknike dhe, në mungesë të kësaj të fundit, është në kundërshtim me pikën 3 të VKM Nr. 1055, datë 22.12.2010 "*Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të N*", sipas të cilës: "*Të gjitha projektet e veprave të N, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike...*".
Për sa më sipër, referuar pikës 4 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010, kërkesa për oponencë teknike bëhet nga investitori, çka nënkupton edhe përgjegjësinë e këtij të fundit në rast mosveprimi.
Në kuptim të ligjit nr. 107/2014, referuar nenit 52 të tij, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike, pavarësisht se nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative të sanksionueshme me gjobë.
Miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponence teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të N në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e N.
***Sa më sipër (gjetja nr. 2, trajtuar për 2 situata), për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi**: Znj. **U.E**, në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Kamëz si personi i i autorizuar për ndjekjen dhe zbatimin e procedurës së prokurimit dhe zbatimit të kontratës [Situata nr. 1; nr.2].*
Kriteri: Ligji Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të N", të ndryshuar, neni 6, germa (a) ndërtimet publike;
Ndikimi/Efekti: Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike.
Shkaku: Neglizhencë e Bashkisë Kamëz .
Rëndësia: E lartë

Konstatim:
Në zbatim të programit të auditimit u audituan procedurat e prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave për punë publike, ku u konstatua se në **1(një) rast** përllogaritja e vlerë së kontratës është rritur në mënyrë të argumentuar, në procedurën e prokurimit me objekt "***Ndërtimi i Pedonales dhe zonave rekreative të Parkut të Liqenit Paskuqan***", në mos përpëthje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "***Ndërtimi i Pedonales dhe zonave rekreative të Parkut të Liqenit Paskuqan"***, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtimi i Pedonales dhe zonave rekreative të Parkut të Liqenit Paskuqan", Bashkia Kamëz.REF-32850-06-14-2022		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 5404 Prot., datë 14.06.2022	**3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Njesia e prokurimit -SH.XH, Personi i ngarkuar -S.S , anëtare -S.V , anëtare, jurist **Hartuesit e Kritereve të Veçanta** 1. R.B Pjesa teknike 2. SH.XH, Pjesa Juridike	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr. 5404/1 Prot., datë 14.06.2022 - E.GJ , kryetar - F.M , anëtar - L.M , anëtar
2. Lloji i Procedurës **"**Procedurë e Hapur – Punë Publike" me elkronikë		

5. Fondi Limit (pa tvsh) 209,703,648 lekë	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** BOE U.& "N" SHPK **198,978,984** lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit(pa tvsh)** 10,724,664 lekë pa TVSH ose ë masën 5.1
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 14.06.2022 Bëhet: Data e hapjes: 30.06.2022	**9. Burimi FIncimit** Buxheti i bashkisë	**10. Operatoret Ekonomike** **a)** Pjesëmarrës në tender 1 OE **b)** Skualifikuar 1 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **Nuk ka**	**12. Përgjigje Ankesës** Nuk ka	**13. Përgjigje** Nuk ka
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Sherbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës 6999 prot., datë 03.08.2022	**15. Vlera kontratës (me tvsh)** 238,774,780.**8 lekë**	**16. Afati i kontratës në ditë** Parashikuar 8 muaj

u konstatuan problematika si vijon:

Konstatim: -Grupi i auditimit, nga auditimi i "zërit4 (An) Spërkatje me emulsion bituminoz 1l/m^2" konstaton se është preventivuar në volumin 3,998 m^2 me çmim 171 lekë në vlerën 683,658 lekë.
Referuar analizës së çmimeve nr. 3.244 për zërin [5 (3.229/3) Shtresë binderi t=7 cm, i ruluar] si dhe zërit [6(3.224/1) Shtresë asfaltobetoni, t=4cm, i ruluar]në VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 "*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N dhe të analizave teknike të tyre*" mbi analizën për zërin konkret "Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m^2"rezulton se zëri ipunimit (Zëri 4 (An) Spërkatje me emulsion bituminoz 1l/m^2) është i përfshirë si nënzë pune, në zërat e punës "Shtresë binderi" dhe "Shtresë asfaltobetoni".Nisur nga ky fakt, i njëjti zë pune "Spërkatje me emulsion bituminoz 1 l/m^2" nuk mund të parashikohet dy herë në preventiv, përkatësisht si zë më vete dhe si nën zë pune në zërat "Shtresë binderi" dhe "Shtresë asfaltobetoni", prandaj ky zë pune nuk duhej të ishte vendosur, për pasojë rritje e fondit limit në mënyrë fiktive, në shumën **683,658 lekë pa TVSH** (3998 m^2 x 171 lekë).
-Nga auditimi i "zërit1 (3.101/a) Gërmim dheu me eskavator zingjir 0.5 m3, në kanale gjerësi dei 2 m, tok zak, kat IV..." Seksioni VIII-Punime KUB, u konstatua se, është preventivuar në volumin **5,751** m^3 me çmim 212 lekë.
Referuar PZ për gjatësinë **586** ml (Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=315 mm) + **39** puseta b/a (40x60x100) cm, në gjykimin e grupit të auditimit, volumi rezulton [586 ml x 0.24 m^2] + [0.5 m3 x 39 puseta] = **161** m3 dhe jo 5751 m3 siç është preventivuar.
Pra, diferenca prej 5912 m3, është pasqyruar në preventiv, me pasojë rritje e fondit limit në mënyrë fiktive, në shumën **1,253,344 lekë pa TVSH** (5912 m2 x 212 lekë).
-Sa më sipër është në kundërshtim meManualin e çmimeve, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N dhe të analizave teknike të tyre", i ndryshuar.
Nga auditimi rezultoi gjithashtu, se në **seksionin VII-Sinjalistika** të preventivit, është parashikuar zëri i punës "An. Pistona për ndalimin e qarkullimit në pedonale" në vlerën **1,540,000 lekë** pa TVSh (4 x 385,000 lekë), zë i cili (nuk ndodhen në manualin e çmimeve) dhe në dosje nuk ndodhet asnjë analizë çmimi, në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 dheNeni 76" Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit", dhe, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2, ku cilësohet:
"Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'ireferohet një ose më shumë alternativavetë renditura si mëposhtë:
çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a. çmimet e tregut;ose/dhe

b. çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç. çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

"Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet". *Pra, pasqyrimi i çmimet pa analizë të argumentuar, në kuptim të legjislacionit të mësipër cituar, ngarkon me përgjegjësi shoqërinë projektuese* "T." SHPK.

Sa më sipër trajtuar, konstatihet rritje e përllogaritjes së kontratës për punë publike në shumën 3,477,002 lekë pa TVSh në mënyrë të pa argumentuar, por, nisur nga zhvillimi i procedurës së prokurimit me FL në shumën 209,703,648 lekë, ku konstatohet se BOE U.SHPK & "N" SHPK janë shpallur fitues me ofertën ekonomike në shumën 198,978,984 lekë, pra me diferencë prej 10,724,664 lekë, në gjykimin e grupit të auditimit rritja e fondit limit në shumën 3,477,002 lekë nuk konsiderohet me rrisk të lartë. Por gjithsesi, u gjykua si përshkruhet si gjetje, pasi në 3 (tre) zëra pune, është vepruar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 dheNeni 76" Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit", dhe, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2.

Konkluzion i përgjithshëm mbi hartimin e kritereve të përgjithshme të pranim/kualifikimit, hartuar nga Njësia e Prokurimit, për procedurat e prokurimit trajtuar sa më sipër (Gjetjet nga 1 në 14):

Nga auditimi i **14** (katërmbëdhjetë) procedurave të prokurimit me objekt "Punë publike/Mallra", me vlerë të FL **2,587,063,960** lekë pa TVSH dhe, kontrata të lidhura në vlerën **2,552,138,835** lekë pa TVSH të zhvilluara gjatë vitit 2022 në Bashkinë Kamëz, konkretisht për procedurat:

1-*"Rikonstruksion shkolla e mesme "Gramoz Palushi", Babrru, Njësia Administrative Paskuqan",*

2-*"Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari"",*

3-*"Ndërtim rruga "Albanët" + rrugicat Valias + rruga "Këmbanat",*

4-*"Ndërtim Rr. Frutikulturë (Rr. pungul me Rrugën Azem Galica + Rr. "Isuf Gervalla" + Rr. "Brezaret",*

5-*"Ndërtimi i Pedonales dhe zonave rekreative të Parkut të Liqenit Paskuqan",*

6-*"Ndërtimtrotuare + Ndriçim Rruga "Jon" + Rruga "Fushë Arrëz" zhvilluar me datë 27.10.2022 sipas urdhër prokurimit nr. 8206 prot., datë 14.09.2022 me FL në vlerën 32,500,000 lekë, fituar nga OE "L" SHPK me vlerë kontrate 30,695,793 lekë.*

7-*"Nërtim rrugët (Rr. "Ëilliam Shekspir" + Rr."Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" +Rr. "Isuf Gërvalla"+ Rr. "Brezaret"+ Rr. "Daniel Alia"",*

8-*"Nërtim rrugët "Lidhja e Prizrenit" Njësia Administrative Babrru, Paskuqan",*

9-*"Nërtim rrugët "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari" Zall-Mner Bashkia Kamëz",*

10. "*Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamëz*

11. *"Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Halit Çoka (ish Elez Isufi)",*

12. "Ndërtim rrugët Rr. Erzeni, Rr. Marubi, Rr. Valbona, Rr. Tomorri",

13. "Blerje makinë MZSH" për vitin 2022",

14. "Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshteve",

është konstatuar se NJP jo vetëm ka hartuar kërkesa për kualifikim të cilat nuk stimulojnë pjesëmarrjen e OE në garë, por janë kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe Dokumentet e Tenderit të

hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, *ku ndër më kryesore janë*:
- NjP në **4 (katër)** raste ka kërkuar që OE duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë e cila të përfshijë kategorinë **NP-7 (A) Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje**, kriter i cili nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv.
- NjP në **2 (dy)** raste ka kërkuar që në personelin kryesor, drejtues në licencën e shoqërisë OE të ketë **1 inxhinier makanik**, kriter i cili nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv.
- NjP në **1 (një)** rast ka kërkuar që në personelin kryesor, drejtues në licencën e shoqërisë OE të ketë **1 saldator dhe 1 mekanik**, kriter i cili nuk lidhet me natyrën e punimeve të parashikuar në projekt preventiv.
- NjP në **6 (gjashtë) raste** ka kërkuar që për realizimin e kontratës, duhet të disponojë (1) **Impiant Betoni auomatik me mikser** (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi dhe (2) **nyje inerte** (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi.

Kërkesa të ekzagjeruar me natyrën dhe objektin e kontratës.
- NjP në **2 (dy) raste** ka kërkuar që për realizimin e kontratës, duhet të disponojë (1) **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton** dhe (2) **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton** në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi.
- NjP në **4 (katër)** raste ka kërkuar që AK të vlerësojë ofetën ekonomike më favorshme, bazuar në **kosto** dhe, jo në **çmim**, duke mos krijuar kushte për një vlerësim objektiv të OE/BOE pjesëmarrës në garë, spas peshës specifike për çdo **kriter** dhe **nënkriter**.
- NjP në **2 (dy)** raste ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një **kontrate të lidhur me një laborator** për këtë objekt, i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit për analizat e materialeve (Beton i freskët dhe i ngurtësuar, përzirje bituminoze, materiale rrugore, gur natyror). Ky kriter është i tepërt, sepse kryerja e analizave është parashikuar në DT (Shtojca 16 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK), neni 13 "Testimet dhe Inspektimet".
- NJP në **3 (tre)** raste ka kërkuar që OE ofertues duhet të ketë **1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar** dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për periU të ndryshme. Konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar.
- NJP në të gjitha rastet ka kërkuar një numër të pa-argumentuar të makinerive/pajisjeve. Nuk ka asnjë analizë teknike ku **sasia e makinerive/pajisjeve** të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volume e tyre apo grafikun e punimeve.

<u>Auditim mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për tenderat me blerje me vlera të vogël.</u>

-Në mënyrë të përmbledhur realizimi i prokurimeve "Blerje me vlere të vogël" për periudhën e auditimit, 01.01.2022 deri 31.12.2022 rezultoi si më poshtë.

Në total, për periudhëm e auditimit janë realizuar **74** (shtatëdhjetë e katër) procedura prokurimi e llojit "Blerje me vlerë të vogël" me vlerën limit të kontratës **24,908,605.07** lekë pa TVSH dhe vlera e negociuar dhe e kontraktuar është **21,732,976.38** lekë pa TVSH ose **87.25 %**, nga ku, sipas tipit të kontratës:

Në zbatim të pikës së programit të auditimit, u shqyrtuan me përzgjedhje procedurat elektronike të prokurimit dhe dokumentacionit në dosjet e prokurimit, për 6 (gjashtë) procedura të llojit "Blerje me vlerë të vogël" me fond fimit në shumën **5,641,700** lekë pa TVSH dhe me kontrata të lidhura në shumën **4,636,661.53** lekë pa TVSH ose **82.18 %** e fondit limit, ku, në vijim popasqyrojmë situatat dhe Rekomandimet përkatëse mbi problematikat e konstatuara, si vijon:

Audimi u mbështet mbi dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Urdhri për ngritjen e Komisionit për Blerjet e Vogla të Bashkisë Kamëz.
2. Regjistri i Planifikimit dhe i Realizimeve për Prokurimet me Vlerë të Vogël për vitin 2022.
3. Dosjet e procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël.

Me urdhërin nr. 119 Prot., datë 06.01.2022 nga ana e Zv/Kryetari të Bashkisë Kamëz, Z. P.Gj është krijuar Komisioni për Prokurimin me Vlerë të Vogël i përbërë nga: (1) SH.XH, Kryetare, (2) S.V , anëtare dhe (3) S.S, anëtarë.

Titulli i gjetjes 1: Blerje me vlerë nën 100.000 lekë pa TVSH, u konstatuar situata emergjente dhe pa mbajtur procesverbalin përkatës.
Situata: Konstatohet se janë realizuar procedura të llojit "*Kolaudim punimesh",* ku për vitin 2022 janë kryer gjithsej 10 procedura prokurimi nën kufirin 100,000 lekë.
Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*"; Udhëzimi nr. 5 datë 25.06.2021, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj në mjete elektronike", pika 20 .
Ndikimi: Shmangie nga rregullat e prokurimit publik.
Shkaku: Moszbatim të kuadrit rregullator të fushës.
Rëndësia: E lartë.

Për sa më sipër është dërguar observacioni me nr. 1751/1 prot., datë 29.02.2024 nga Bashkia Kamëz, protokolluar në KLSH me nr.873/7 Prot. më datë 04.03.2024 në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr.873/7 Prot. e datës 29.01.2024 nga ana e së cilës pretendohet se:

Pretendimi i subjektit:

Subjekti i qëndron sërish shpjegimeve të dhëna :
"Njësia e Prokurimit merr hapat për zhvillimin e procedurës për kolaudimin e punimeve referuar vlerave maksimale dhe minimale përcaktuar sipas manualit të tarifave dhe sipas kohës kur bëhet kërkesa nga Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve.
Sa më sipër, nga ana e njësisë nuk kemi shmangien nga procedurat standarte të prokurimit.
Nga ana tjetër, ju informojmë se ka patur raste të herë pas hershëm ku kolaudimi me vlerë të vogël nën 100.000 lekë është ngarkuar në regjistrin e parashikimeve në llojin e procedurës "blerje me vlerë të vogël" nga 100.000-1.000.000 lekë, por ***nuk është publikuar*** *nga ana e APP si zë në regjistër me justifikim "rishikoni vlerën e fondit, pasi kjo procedurë duhet të parashikohet blerje nën 100.000 lekë". Aktualisht nuk mund të gjenerohen nga sistemi (SPE), përgjigjet e APP për rastet e sipërpërmendura për vitin 2022, dhe ne e kemi të pamundur ta provojmë me dokument."*

Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH-së:

Lidhur me pretendimin tuaj, ju risqarojmë se :
Nga ana juaj nuk është paraqitur një arsyetim dhe dokumentacion shtesë që të mbështesë qëndrimin e APP ndaj jush dhe si e tillë nga ana e grupit të auditimit nuk merret në konsideratë.

Titulli i gjetjes 2: Mungesa e dokumentacionit në procedurën e prokurimit të blerjeve të vogla.
Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, u konstatua se:
-Në procedurën e prokurimit "Blerje uniforma për policinë bashkiake" mungon dokumentacioni i OE fitues "A " P.F (kontrata për shërbime të mëparshme të ngjashme) mosparaqitja e së cilës përbën kusht për skualifikim siç shprehet edhe në ftesën për ofertë.
-Në procedurën e prokurimit "Blerje uniforma për punonjësit zjarrëfikës" , nga OE i shpallur fitues "N.H p.f." SHPK rezultoi se, nuk janë paraqitur dokumentet e mëposhtëm referuar

Kërkesave për kualifikim te hartuara nga KVO (kontrata për shërbime të mëparshme të ngjashme i dhe Certifikatë e fiskalizuar).
-Në procedurën e prokurimit "Blerje ujë të pijshëm për kopshtet dhe çerdhet në juridiksonin e Bashkisë Kamëz", nga dokumentacioni i paraqitur nga OE fitues "L " si dhe verifikimi në sistemin elektronik SPE mungon: (kopje e çertifikatës elektronike të fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave).
- Në procedurën e prokurimit "Shërbim interneti" nga dokumentacioni i paraqitur nga OE fitues rezulton se ka mangësi në pikën e fundit të ftesës për ofertë të AK shprehet se "...OE duhet të ketë stafin e realizimit të shërbimit jo më pak se 2 ekspertë të kualifikuar në sigurimin teknik për ofrimin e shërbimit". Nga ana e OE nuk janë paraqitur dokumente që vërtetojnë kualifikimin e ekspertëve për sigurimin teknik.
-Në procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje Printer + Skaner + Fotokopje", nga dokumentacioni i paraqitur nga OE fitues "E." SHPK si dhe nga verifikimi në sistemin elektronik SPE mungon (Kopje të certifikatës elektronike të fiskalizimit) dhe (kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Certifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim).
Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" neni 82, pika 2.
Ndikimi: Shpallja fitues e OE të cilët nuk përmbushin kushtet dhe nuk paraqesin dokumentacionin e kërkuar në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator.
Shkaku: Mos zbatim të kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.
Rëndësia: E Lartë

Për sa më sipër është dërguar observacioni me nr. 1751/1 prot., datë 29.02.2024 nga Kryetari i Bashkisë, z. R.S. protokolluar në KLSH me nr.873/7 Prot. më datë 04.03.2024 në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr.873/7 Prot. e datës 29.01.2024 nga ana e së cilës pretendohet se:
Pretendimi i subjektit:
Në lidhje me konstatimin se OE N.H duhej skualifikuar pasi nuk ka paraqitur çertifikatën e fiskalizuar KVO e ka konstatuar si shërbim të realizuar pasi si dëshmi është paraqitur akt marrëveshja datë 20.01.2022 lidhur ndërmjet N.H P.F dhe A.SHPK mbi zgjidhjen softuerike, ndër të tjera nënshkrimi elektronik dhe lëshimi i faturave elektronike.
Paraqitja e kësaj aktmarrëveshje dhe paraqitja e faturave të fiskalizuara automatikisht të çon në logjikën se ky operator e ka çertifikatën e fiskalizuar, pasi si do të priste faturë të fiskalizuar në qoftëse nuk do të ishte i pajisur me një çertifikatë të tille ?
Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH-së:
Lidhur me pretendimin tuaj, ju sqarojmë se :
Pavarësisht kundërshtimit tuaj ju ritheksojmë se aktmarrëveshja dhe çertifikata e fiskalizuar janë dy dokumenta krejt të ndryshëm, për më tepër paraqitja këtij dokumentacioni është një nga kriteret kyçe për kualifikimin e OE e parashikuar kjo dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 82, pika 2. dhe si rrjedhojë ***nuk merret në konsideratë****.*
Pretendimi i subjektit:
Ne i qëndrojmë shpjegimeve të dhëna ku ritheksojmë se:
Në lidhje me konstatimin se OE "L " në procedurën e prokurimit Blerje ujë të pijshëm për kopshtet dhe çerdhet në jurdiksionin e Bashkisë Kamëz" OE duhej skualifikuar pasi nuk ka paraqitur kopje të çertifikatës elektronike të fiskalizimit, ju sqarojmë se:
KVO ka konstatuar si shërbim të realizuar pasi OE ka paraqitur si dëshmi aktmarrëveshjen datë 21.01.2022 lidhur ndërmjet "L " Sh.A." dhe "Infosoft Software Developer" mbi zgjidhjen softuerike, në update të sistemit fInciar në përputhje me ligjin nr. 87/2019 "Për

faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"
Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH – së:
Lidhur me pretendimin tuaj, ju sqarojmë se :
Pavarësisht kundërshtimit tuaj ju ritheksojmë se aktmarrëveshja dhe çertifikata e fiskalizuar janë dy dokumenta krejt të ndryshëm, për më tepër paraqitja këtij dokumentacioni është një nga kriteret kyçe për kualifikimin e OE e parashikuar kjo dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 82, pika 2. dhe si rrjedhojë ***nuk merret në konsideratë****.*

Titulli i gjetjes 3: Kualifikimi dhe shpallja fitues e Operatorit ekonomik pa plotësuar kriteret e vendosura të DST.
Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, u konstatua se:
-Në procedurën e prokurimit "Blerje uniformash për punonjësit zjarrëfikës" nga dokumentacioni i paraqitur nga OE fitues "N.H " PF rezulton që në dokumentacionet e paraqitura si dhe verifikimi në sistemin elektronik të APP dhe sistemin elektronik të QKB, OE fitues në objektin e veprimtarisë së tij nuk ka të përfshirë objektin e proçedurës së prokurimit të kryer (Uniforma për punonjësit zjarrfikës), e cila përbën automatikisht skualifikim nga gara.
Së dyti, certifikata e konformitetit ISO 9001:2015 e paraqitur nga OE fitues e cila nuk ka të përfshirë në fushën e saj të aktivitetit objektin e prokurimit, rezulton se gjithashtui ka përfunduar vlefshmëria përpara nisjes së proçedurës dhe në dosjen e prokurimit gjendet vetëm nje fotokopje ku si e tillë quhet e pavlefshme.
-Në procedurën e prokurimit "Blerje ujë të pijshëm për kopshtet dhe çerdhet në juridiksonin e Bashkisë Kamëz" nga dokumentacioni i paraqitur nga OE fitues "L " Sh.a rezulton që çertifikatat e konformitetit (për sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN ISO 9001:2015 dhe për sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore EN ISO 22000:2005) të lëshuara nga "A" SHPK si institucion i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit janë të pavlefshme për arsye se vlefshmëria e certifikatës së akreditimit ka përfunduar më datë 28.03.2022 pra 1 muaj para fillimit të kësaj procedure prokurimi.
Së treti, në ftesën për ofertë nga KVO specifikohen qartë dhe nivelet që analizat fiziko-kimike duhet të kenë, ku konstatohet se ka mospërputhshmëri mes specfikimeve që kërkon KVO dhe faktit që shfaqet në analizat fiziko-kimike përkatësisht mes elementeve të "Ca", "TDS" dhe "Fortësisë".
Sipas KVO elementi **Ca** specifikohet të jetë **16** mg/l ndërkohë që në analizat fiziko-kimike është **17,53** mg/l. TDS specifikohet të jetë **60** mg/l ndërkohë që në analizat fiziko-kimike është **110** mg/l.
Fortësia specifikohet të jetë **3** mg/l ndërkohë që në analizat fiziko-kimike është **3.29** mg/l.
-Në procedurën e prokurimit "Shërbim interneti" nga dokumentacioni i paraqitur nga OE fitues rezulton që ka parregullësi në kriterin "Kontratë për shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuara **gjatë tre viteve të fundit** të aktivitetit të operatorit vërtetuar me dokumentacion përkatës (kontrata ose fatura)." Në dokumentacionin e dorëzuar nga OE është një kontratë e lidhur në dhjetor të 2018 pra që tejkalon këtë afat.
Së dyti, në Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për shërbime publike të komunikimeve elektronike, ky OE ofron vetëm shërbim telefonie, të ofruar nëpërmjet rrjeteve publike fikse, ndërkohë që në ftesën për ofertë nga AK është përcaktuar që OE duhet të ofrojë këtë shërbim edhe për rrjete tokësore me fibër optike, transmetimi të dhënave dhe shërbim aksesi në internet.
Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" neni 82, pika 2, si dhe Specifikimet teknike të DST.

Ndikimi: Shpallja fitues e OE të cilët nuk përmbushin kushtet dhe paraqesin dokumentacionin e kërkuar në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator.
Shkaku: Mos zbatim të kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.
Rëndësia: E Lartë

Për sa më sipër është dërguar observacioni me nr. 1751/1 prot., datë 29.02.2024 nga Bashkia Kamëz protokolluar në KLSH me nr.873/7 Prot. më datë 04.03.2024 në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr.873/7 Prot. e datës 29.01.2024 nga ana e së cilës pretendohet se:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me konstatimin se OE fitues "N.H " SHPK duhej skualifikuar pasi ka paraqitur çertifikatën ISO 9001:2015 të skaduar theksojmë se:
*KVO e ka **konsideruar si devijim të vogël i cili nuk ndikon në ofertë**. Oferta konsiderohet e vlefshme dhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakterisitikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.*

Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH-së:

Lidhur me pretendimin tuaj, ju risqarojmë se :
Çertfiikata ISO 9001:2015 konsiderohet si një dokumentacion ligjor i cili përcakton, vlerëson dhe klasifikon produktet dhe shërbimet duke siguruar zbatimin dhe kriteret e kushteve bazuar në standarted europiane. Si e tillë dhe nga ana e KVO është konsideruar si një dokumentacion i domosdoshëm në DST dhe jo një devijim, si për rrjedhojë qëndrimi juaj **nuk merret në konsideratë**.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me konstatimin se OE fitues "L " Sh.A duhej skualifikuar pasi ka paraqitur çertifikatën ISO 9001:2015 dhe EN ISO 22000:2005 nga një institucion i akredituar, të cilit i ka skaduar çertifikata e akreditimit theksojmë se :
KVO ka konstatuar se OE disponon çertifikata EN-ISO 9001:2015 me vlefshmëri deri më datë 28.03.2024 dhe ISO 9001:2015 me vlefshmëri deri më datë 06.07.2024 si rezultat janë konsideruar të vlefshëm. Fakti që institucionit të akredituar, i ka skaduar çertifikata e akreditimit, nënkupton që ky institucion nuk mund të akreditojë më çertifikata, por çertifikatat e sipëcituara janë të vlefshme pasi janë me afat deri në 2024.

Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH-së:

Lidhur me pretendimin tuaj, ju risqarojmë se :
Nga ana e grupit të auditimit konstatimi vlen jo për vlefshmërinë e çertfiikimit nga ana e "A " por për çertfikimin specifik për OE fitues në këtë rast.
Së dyti nga ana juaj nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion shtesë që të legjitimojë se OE disponon çertifikata EN-ISO 9001:2015 me vlefshmëri deri më datë 28.03.2024 dhe ISO 9001:2015 me vlefshmëri deri më datë 06.07.2024 për këtë arsye **nuk merret në konsideratë**.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me konstatimin se OE fitues L shfaq mospërputhje ndërmjet treguesve të analizave të kërkuara dhe atyre të paraqitura shpjegojmë se:
A.K ka ngritur grupin e punës të marrjes së mallit në dorëzim ku kanë në përbërje ekspertë të fushë. Duke marrë në konsideratë edhe kontrata të mëparshme të lidhura me këtë OE ku ky OE ka qenë i sukseshëm.

Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH-së:

Së pari, në dosjen e audituar nga grupi i auditimit është konstatuar vetëm urdhri i lëshuar për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit (përkatësisht Nr.4206/1 Prot. e datës 12.05.2022) dhe jo ndonjë procesverbal i mbajtur që të theksohet se specifikimet e mallit janë në përputhje të plotë me ato të kërkuara në DST.

Së dyti, nga ana e KVO në ftesën për ofertë specifikohet qartë dhe nivelet që analizat fiziko-kimike duhet të kenë ku (....të mos jenë më të larta se këto të dhëna) ku vetë mospërmbushja e këtyre specifikimeve përbën kusht pë skualifikim.
Qëndrimi juaj bie në kundërshtim me specifikimet e caktuara nga KVO, për këtë arsye argumentimi juaj **nuk merret në konsideratë**.

Titulli i gjetjes 4: Moszbatim i ligjshmërisë në zbatimin e detyrimit kontraktual.
Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, u konstatua se:
-Në procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje Printer + Skaner + Fotokopje", nga dokumentacioni i paraqitur nga OE fitues "E." SHPK në ftesën për ofertë është specifikuar që afati i lëvrimit të mallit do të jetë **brenda 2 ditëve, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës**. Nga data e lidhjes së kontratës dhe proces verbalit të mbajtur mbi marrjen në dorëzim ka një diferencë prej 4 ditësh, pra 2 ditë llogariten si penalitet.
Kriteri: Neni 7, pika 1, të kontratës së lidhur me nr. 5464 Prot. e datës 16.06.2022.
Ndikimi: Diferenca mes afatit të lidhjes së kontratës dhe marrjes në dorëzim duke tejkaluar afatin e lëvrimit të mallit llogaritet si penalitet ndaj AK.
Shkaku: Keq interpretim i kushteve të kontratës.
Rëndësia: E Lartë

Për sa më sipër është dërguar observacioni me nr. 1751/1 prot., datë 29.02.2024 nga Bashkia Kamëz protokolluar në KLSH me nr.873/7 Prot. më datë 04.03.2024 në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr.873/7 Prot. e datës 29.01.2024 nga ana e së cilës pretendohet se:
Pretendimi i subjektit:
Ne u qëndrojmë shpjegime të mëparshme si më poshtë vijon:
*Në lidhje me konstatimin se afati i lëvrimit në ftesën për ofertë **2 ditë** dhe diferenca ndërmjet datës së procesverbalit të marrjes në dorëzim të shërbimit dhe datës së lidhjes së kontratës është prej **4 ditësh** ku 2 llogariten si penalitet ju informojmë se referuar nenit 3 të kontratës është parashikuar që afati kohor i realizimit të kontratës është **12 muaj** nga data e lidhjes së kontratës sispas kërkesës dhe nevojës së AK.*
Shërbimi është i parashikuar si i shtrirë në kohë dhe si i tillë nuk mund të llogaritet penalitet, pasi kontrata ka afat 1 vjeçar nga data e lidhjes.
Qëndrimet e audituesve shtetërorë të KLSH – së:
Lidhur me pretendimin tuaj, ju risqarojmë se :
Konstatimi nga ana e grupit të auditimit specifikohet për afatin e lëvrimit të mallit dhe jo për kohëzgjatjen e zbatimit të saj i cili është një moment tjetër në procedurën e realizimit të prokurimit, për këtë arsye argumentimi juaj **nuk merret në konsideratë**.

Titulli i gjetjes 5: Skualifikim i padrejtë i i operatorit ekonomik pjesëmarrës.
Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, u konstatua se:
-Në procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim interneti", u konstatuan parregullësi në zbatimin e procedurës së prokurimit, në rastin e skualifikimit të operatorit ekonomik "K." SHPK. Në këtë procedurë prokurimi fondi limit i përcaktuar është 999,000 lekë pa TVSH e barabartë me ofertën e këtij OE.
Ky operator është skualifikuar në mënyrë të padrejtë nga procedura e prokurimit për arsye se në procesverbalin e mbajtur, fondi limit është përcaktuar 995,000 lekë pa TVSH pra me 4,000 lekë më pak se fondi limit i caktuar duke e cilësuar ofertën e OE "K." mbi vlerën e fondit limit.
Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" neni 82, pika 2.

Ndikimi: Ndryshimi i fondit limit në procesverbal sjell skualifimin e padrejtë të operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit.
Shkaku: Ndyshim i fondit limit.
Rëndësia: E Lartë

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohen me përgjegjësi personat si vijon:
1. Znj. U.E, në cilësinë e zv.Kryetarit të Bashkisë Kamëz si nëpunës autorizues.
2. Znj. SH.XH, në cilësinë e Kryetarit të KVO me Blerje të Vogla.
3. Znj. S.V , në cilësinë e anëtarit të KVO me Blerje të Vogla.
4. Z. S.S, në cilësinë e anëtarit të KVO me Blerje të Vogla.

2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit, në Bashkinë Kamëz, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t'u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës së kontratës, llojit të punimeve të N, zërave të punimeve të N me risk të madh në zbatimin e veprave, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqituara në tabelë:
Mbështetur sa më sipër, është kryerauditimi i zbatimit të punimeve për periudhën e auditimit 2022, për 6 (gjashtë) kontrata zbatimi me shumë totale **413,544,139 lekë me TVSH,** me të dhëna sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Objekti	Kontraktori	Date e lidhjes kontratës	Vlera e kontratës me TVSH
1	Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza	BOE N. SHPK & "B" SHPK	05.05.2022	72,285,722
2	Rruga "Roskovec", segmenti 1,2 + Rr. "Florida" + Rr. "Rekjaviku" + Rr. "Berlin"+ Rr. "Skrapari" + Seg. Te rruga "Xhorxh Bush" + Seg. 1 te Blv. "Donald Tramp" + seg. 2 te Blv "Donald Tramp" + seg. 3 te Blv "Donald Tramp" + seg. 4 te Blv. "Donald Tramp" + Rr. "Altruisti" Rr. "Drita"	OE "SH" SHPK	01.08.2022	58,316,780
3	Rikonstruksion i rrugës Skënderbeu	OE "A" SHPK	23.08.2022	83,718,202
4	Rr. "Ëilliam Shekspir" + Rr. "Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" + Rr. "Toni Bler" + Rr. "Iball" + Rr. "Daniel Alia"	OE "E" SHPK	31.08.2022	65,271,984
5	Nd. Rr. "Albanët" + Rrugicat në Valias + Rr. "Këmbanët" + Trotuaret në Rr. "Amsterdam", Valias i Ri	OE "N" SHPK	31.08.2022	73,112,196
6	Rr. "Shëngjegji" + Rr. "Ali Pashë Gucia" + Rr. "Arbëria"+ seg. Pingul me Rr. "Selishtë" + Rr. "Kamëz"	OE "B." SHPK & "GJ" SHPK	17.10.2022	60,839,255
	Shuma në lekë me TVSH			**413,544,139**

Në zbatim të pikës së programit të auditimit, mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u shqyrtua dokumentacioni tekniko-ligjor i ndodhur në dosjet e zbatimit ku, në vijim popasqyrojmë Problematikat dhe Rekomandimet përkatëse si më poshtë:

1. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "**Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza",**me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza" Bashkia Kamëz.		
14.Lidhja e kontratës Nr. 7477 Prot., datë 23.08.2022 BOE N. SHPK & "B" SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 72,285,722 lekë me TVSh	**16.Likuiduar:** Sit. 1 në vlerën 23,658,384lekë me TVSH Sit. 2(përfundimtar) në vlerën 48,627,276lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Sit përf në vlerën 48,627,276 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 05.05.2022 Përfundimi punimeve: 23.10.2022	**19. Zgjatja e kontratës** 9 ditë pune
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "I " SHPK	Licenca Nr: MK.1641/12	Kontratë nr. 3870/2 prot., datë 05.05.2022
21. Kolaudatori i punimeve OE "L "SHPK	Licenca Nr: MK.1830/4	Kontratë nr. 12035 prot., datë 23.12.2022
22.Akt Kolaudimi. Datë: 30.12.2022	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** Me datë 20.01.2023. Nga Kryetari i Bashkisë Kamëz është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit me nr. 444 datë 20.01.2023. Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, si dhe nga komisioni me përbërje: R. H., EI Dusha dhe H.M .	

ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:

Titulli i gjetjes nr. 1: Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin "Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza", në mos respektim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të N", të ndryshuar.

Përshkrimi i situatës:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të N, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Kamëz, në vlerën **772,800 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

-Zëri 5(An-1) Trotuar, me pllaka betoni me ngjyra të kombinuara (30x30 + 15x15) për trotuare t=6cm [*Punime trotuari*].

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 5,946 m^2 pllaka, me çmim 1,600 lekë pa TVSH.

Libreza e masave pasqyron volumin 5,946.20 m^2 pllaka, të detajuara për 60 seksione.

Konstatohet se, në pasqyrimin e volumit të këtij zëri pune në librezë janë bërë gabime, pasi janë zbritur 85 m^2 (sipërfaqe që zënë pemët) por, në fakt nga Projekti i Zbatimit (Planimetria e gjelbërimit) si dhe nga auditimi në fakt, u konstatua se janë 253 pemë dhe jo 85 pemë siç është pasqyruar në librezë. Nga rillogaritja e bërë nga audituesi, konstatohet volum pune i realizuar:

Sipas librezës së masave:

-Trotuar me sipërfaqe të përgjithshme 6,031.2 m2 – 85 m2 pemë dhe puseta = 5,946.2 m2.

Sipas grupit të auditimit:

-Trotuar me sipërfaqe të përgjithshme 6,031.2 m2 – 253 m2 pemë dhe puseta = 5,778.2 m2.

-Sipërfaqe për 253 pemë, është 253 m2

Pra, për zërin "Trotuar, me pllaka betoni me ngjyra të kombinuara (30x30 + 15x15) për trotuare t=6cm" rezulton volum pune i kryer 5,778.2 m2 dhe jo 5,946.2 m2 siç është situacionuar.

Sa më sipër trajtuar, diferenca prej 168 m^2 është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimevenë vlerën **<u>268,800 lekë pa TVSH</u>** [168 m^2 x 1,600 lekë].

-Zëri 2 (An-142) Bojë bikomponente (pastë) për kalim këmbësorësh me ngjyrë të kuqe dhe shirita të bardhë sipas detajit [*Punime në sinjalistikën*].

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 280 m2 vijëzime me bojë antirrëshkitëse (pastë), me çmim 1,800 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron volumin 280 m2 vijëzime.Nga auditimi në fakt, rezulton se, ky zë punë është realizuar thjesh me bojë bikomponente dhe jo me bojë antirreshkitëse me trashësi 2 mm me ngjyrë sipas detajit, pra është realizuar në mospërputhje me specifikimet teknike.

Sa më sipër trajtuar, është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimevenë vlerën **504,000** lekë pa TVSH [280 m2 x 1,800 lekë].

Bazuar në faktin se punimet e N janë në periudhë garancie, AK Bashkia Kamëz, duhet ti kërkojë sipërmarrësit të punimeve BOE N. SHPK (67%) & "B" SHPK (33%), përfaqësuar nga OE "B" SHPK, realizimin e zërit "Zëri 2 (An-142) Bojë bikomponente (pastë) për kalim këmbësorësh me ngjyrë të kuqe dhe shirita të bardhë sipas detajit" në përputhje me kushtet e kontratës si dhe specifikimeve teknike. Në rast të kundërt, mosrealizimi sipas specifikimeve teknike do të konsiderohet dëm ekonomik në vlerën prej **504,000 lekë**.

***Sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi**: **Z. I.D ,** *në cilësinë e mbikëqyrësit*.*

<u>Kriteri</u>: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të N" e konkretisht Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 7477 prot., datë 23.08.2022; - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3870 prot., datë 05.05.2022.

<u>Ndikimi/Efekti</u>: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Kamëz.

<u>Shkaku</u>: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara.

<u>Rëndësia</u>: I lartë.

2. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "***Rruga "Roskovec", segmenti 1,2 + Rr. "Florida" + Rr. "Rekjaviku" + Rr. "Berlin"+ Rr. "Skrapari" + Seg. Te rruga "Xhorxh Bush" + Seg. 1 te Blv. "Donald Tramp" + seg. 2 te Blv "Donald Tramp" + seg. 3 te Blv "Donald Tramp" + seg. 4 te Blv. "Donald Tramp" + Rr. "Altruisti" Rr. "Drita"",*** me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rruga "Roskovec", segmenti 1,2 + Rr. "Florida" + Rr. "Rekjaviku" + Rr. "Berlin"+ Rr. "Skrapari" + Seg. Te rruga "Xhorxh Bush" + Seg. 1 te Blv. "Donald Tramp" + seg. 2 te Blv "Donald Tramp" + seg. 3 te Blv "Donald Tramp" + seg. 4 te Blv. "Donald Tramp" + Rr. "Altruisti" Rr. "Drita" Bashkia Kamëz.		
14.Lidhja e kontratës Nr. 6910 Prot., datë 01.08.2022 OE "SH" SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 58,316,780 lekë me TVSh.	**16.Likuiduar:** Sit. 1 në vlerën 20,011,842lekë me TVSH Sit. 2(përfundimtar) në vlerën 38,304,938lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Sit përf në vlerën 38,304,938 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 11.08.2022 Përfundimi punimeve: 08.03.2023	**19. Zgjatja e kontratës** ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE "B " SHPK	Licenca Nr: MK.2205/5 Licenca Nr: MK.3230/9	Kontratë nr. 7108 prot., datë 09.08.2022
21. Kolaudatori i punimeve PF "M "	Licenca Nr: MK.3671/1	Kontratë nr. 3138/1 prot., datë 07.04.2023
22.Akt Kolaudimi. Datë: 13.04.2023	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** Me datë 20.04.2023. Nga Kryetari i Bashkisë Kamëz është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit me nr. 489 datë 20.04.2023. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve,	

	kolaudatori i punimeve, si dhe nga komisioni me përbërje: Ramadan Hysa, EI Dusha dhe Nderim Pasha.

ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:

Titulli i gjetjes nr. 2: Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin "Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza", në mos respektim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të N", të ndryshuar.

Përshkrimi i situatës:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të N, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Kamëz, në vlerën **195,763 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

A. Objekti: Ndërtim "Roskovec" seg. 1, 2 Kamëz 1.

-Zëri 9 (3.288) F.V Hekur betoni i zakonshëm Ø>10 mm [*Punime në rrugë*].

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 1.470 ton Fe, me çmim 106,741 lekë pa TVSH.

Libreza e masave pasqyron volumin 1.470 ton Fe.

Nga auditimi i realizimit të këtij zëri pune në objekt tek muret e betonit, si dhe nga auditimi i pasqyrimit në librezën e masave, konstatohet se vendosja e hekurit nuk është e argumentuar dhe justifikuar si zë pune i maskuar. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM Nr.2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të N", Pika 8.3 ku theksohet: "*Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi sigurohet nga sipërmarrësi për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, që mund të jenë objekt diskutimi në të ardhmen dhe që pasqyrojnë masat mbrojtëse e të kontrollit të cilësisë së materialeve e të punimeve, etj. Kopje të mjaftueshme i dorëzohen mbikëqyrësit çdo javë*".

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër volumi i këtij zëri të pa argumentuar në vlerën **156,909 lekë** (1.470 ton x 106,741 lekë).

C. Objekti: Ndërtim "R." seg. Kamëz 1.

-Zëri 9(3.288) F.V Hekur betoni i zakonshëm Ø>10 mm [*Punime në rrugë*].

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 0.36 ton Fe, me çmim 106,741 lekë pa TVSH.

Libreza e masave pasqyron volumin 1.470 ton Fe.

Nga auditimi i realizimit të këtij zëri pune në objekt tek muret e betonit, si dhe nga auditimi i pasqyrimit në librezën e masave, konstatohet se vendosja e hekurit nuk është e argumentuar dhe justifikuar si zë pune i maskuar. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM Nr.2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të N", Pika 8.3 ku theksohet: "*Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi sigurohet nga sipërmarrësi për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, që mund të jenë objekt diskutimi në të ardhmen dhe që pasqyrojnë masat mbrojtëse e të kontrollit të cilësisë së materialeve e të punimeve, etj. Kopje të mjaftueshme i dorëzohen mbikëqyrësit çdo javë*".

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve është përfituar tepër volumi i këtij zëri të pa argumentuar në vlerën **38,854 lekë** (0.36 ton x 106,741 lekë).

-Zëri 9 (2.109/2) Shtresë betoni trotuari [*Punime trotuare*].

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 52 m^3 beton, me çmim 8,545 lekë pa TVSH.

Libreza e masave pasqyron volumin 52 m^3, të detajuara për 14 piketa në krahun e djathtë dhe 11 piketa në krahun e majtë me thellësi 10 cm.

Nga auditimi në fakt rezulton se ky zë pune nuk është realizuar sipas "**Zëri 9 (2.109/2) Shtresë betoni trotuari"** të situacionuar në vlerën prej 444,340 lekë, por është realizuar sipas zërit "**3.320 Pllaka me 6 cm beton, pllaka**" me çmim **1,305 lekë**, referuar VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 "*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të N dhe të analizave teknike të tyre*". Por nga fakti vërtetohet se ky zë pune nuk është kryer me shtresën e betonit, rezulton se sipërfaqja prej 444.9 me është realizuar me kosto prej **1,065 lekë**. Pra, ky

zë pune në Trotuar në rrugën "Zyhri" Kamëz 2 është realizuar në vlerën **473,818.5 lekë** [444.9 m2 x 1,065 lekë]. Sa më sipër trajtuar, nuk është realizuar në përputhje me kushtet e kontratës dhe me specifikimet teknike.

Sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi**: Z. A.A, * *në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve*.

Kriteri: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të N" e konkretisht Kreu II, Pika 3; - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6910 prot., datë 01.08.2022; - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 7108 prot., datë 09.08.2022.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Kamëz.

Shkaku: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia: I lartë.

3. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "**Rikonstruksion i rrugës Skënderbeu" Bashkia Kamëz,**me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion i rrugës Skënderbeu" Bashkia Kamëz.		
14.Lidhja e kontratës Nr. 7477 Prot., datë 23.08.2022 OE "A" SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 83,718,202 lekë me TVSh	**16.Likuiduar:** Sit. 1 në vlerën 50,648,640.02lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 28,462,641.80lekë me TVSH Sit. (përfundimtar) në vlerën 3,275,790.04lekë pa TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Sit përf në vlerën 3,275,790.04 lekë pa TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 21.11.2022 Përfundimi punimeve: 10.03.2023	**19. Zgjatja e kontratës** S'ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "N" SHPK	Licenca Nr: MK.3119/8	Kontratë nr. 8479 prot., datë 21.09.2022
21. Kolaudatori i punimeve OE "B"SHPK	Licenca Nr: MK.2205/5	Kontratë nr. 3353 prot., datë 18.04.2023
22.Akt Kolaudimi. Datë: 18.04.2023-15.05.2023	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** Me datë 15.05.2023. Nga Kryetari i Bashkisë Kamëz është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit me nr 532 datë 15.05.2023. Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, si dhe nga komisioni me përbërje: R.H., EI D. dhe H.M .	

ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:

Titulli i gjetjes nr. 3:Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin "Rikonstruksion i rrugës Skënderbeu" Bashkia Kamëz, në mos respektim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të N", të ndryshuar.

Përshkrimi i situatës:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të N, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Kamëz, në vlerën **227,732 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Punime ndërtimi për trotuarin

Nga auditimi në objekt mbi realizimin e punimeve të N për trotuarin, përkatësisht për sipërfaqen e trotuarit të shtruar me pllaka (15x15 cm dhe 30x30 cm) për trotuar t=6 cm, imitim bardh e zi rezultoi se, në volumet e situacionuara dhe të librezuara, nuk janë zbritur sipërfaqet që zënë 160 copë *pemë*. Nga rillogaritja e bërë, rezultojnë diferenca në volume, të argumentuara si vijon:

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
3(3.An-8)	Mbushje cakëlli 15 cm përhapur e ngjeshur me makineri	m^3	1800	612	612	594.66	**17.34** cm^3 [0.85 x 0.85 x 0.15] x 160 pemë	31,212
4(3.208)	Shtresë cakulli t=10 cm, makadam, përhapur e ngjeshur me makineri	m^2	200	4078	4078	3962.4	**115.6** m^2 [0.85 x 0.85 x 160 copë]	23,120
5(3.212/b)	Shtresë stabilizanti në trotuar t=10 cm	m^2	200	4078	4078	3962.4	**115.6** m^2 [0.85 x 0.85 x 160 copë]	23,120
7(An-1)	Trotuar me pllaka betoni....	m^2	1300	4078	4078	3962.4	**115.6** m^2 [0.85 x 0.85 x 160 copë]	150,280
	Total në lekë pa TVSH							**227,732**

Sa më sipër trajtuar, sipërmarrësi i punimeve shoqëria "A" SHPK ka përfituar në mënyrë të pa drejtë shumën prej **227,732 lekë pa TVSH.** ***Sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi: Z. V.B.,*** *në cilësinë e mbikëqyrësit.*

Kriteri: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të N" e konkretisht Kreu II, Pika 3; - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 7477 prot., datë 23.08.2022; - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 9479 prot., datë 21.09.2022.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Kamëz.

Shkaku: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia: I lartë.

4. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "***Rr. "William Shekspir" + Rr. "Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" + Rr. "Toni Bler" + Rr. "Iball" + Rr. "Daniel Alia" Bashkia Kamëz,*** me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rr. "William Shekspir" + Rr. "Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" + Rr. "Toni Bler" + Rr. "Iball" + Rr. "Daniel Alia" Bashkia Kamëz.		
14.Lidhja e kontratës Nr. 7673Prot., datë 31.08.2022 OE "E" SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 65,271,984 lekë me TVSh. Prev i ripunuar 65,271,972 lekë me TVSH	**16.Likuiduar:** Sit. 1 në vlerën 18,265,140lekë me TVSH Sit. 2(përfundimtar) në vlerën 47,006,832lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Sit përf në vlerën 47,006,832 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 23.11.2022 Përfundimi punimeve: 28.04.2023	**19. Zgjatja e kontratës** ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE "A. & S." SHPK	Licenca Nr: MK.1865/9 Licenca Nr: MK.0189/10	Kontratë nr. 7824 prot., datë 06.09.2022
21. Kolaudatori i punimeve OE "L " SHPK	Licenca Nr: MK.3671/1	Kontratë nr. 3305/1 prot., datë 13.04.2023
22.Akt Kolaudimi. Datë: 22.05.2023	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** Me datë 05.06.2023. Nga Kryetari i Bashkisë Kamëz është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit me nr. 579 datë 05.06.2023. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve,	

	kolaudatori i punimeve, si dhe nga komisioni me përbërje: A.D , E.D dhe Nderim Pasha.

ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:

Titulli i gjetjes nr. 4: Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin "Rr. "William Shekspir" + Rr. "Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" + Rr. "Toni Bler" + Rr. "Iball" + Rr. "Daniel Alia"", në mos respektim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të N", të ndryshuar.

Përshkrimi i situatës: Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të N, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike për zërin "Zëri 2 (An-142) Bojë antirrëshkitëse 2 mm me ngjyrë" me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Kamëz, në vlerën **120,000** lekë pa TVSH, argumentuar, si vijon:

Objekti "D. A." (Punime në sinjalistikën dhe sistemim urban).

Zëri 2 (An-142) Bojë antirrëshkitëse 2 mm me ngjyrë.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 80 m^2 vijëzime me bojë antirrëshkitëse, me çmim 1,500 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron volumin 80 m^2.Nga auditimi në fakt, rezulton se, ky zë punë është realizuar thjesh me bojë bikomponente dhe jo me bojë antirreshkitëse me trashësi 2 mm me ngjyrë, pra është në mospërputhje me specifikimet teknike. Sa më sipër trajtuar, është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimevenë vlerën**120,000 lekë pa TVSH** [80 m2 x 1,500 lekë]. ***Sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi: Znj. I. M. ,*** *në cilësinë e mbikëqyrësit.*

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të N" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 7673 prot., datë 31.08.2022.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 7824 prot., datë 06.09.2022.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Kamëz.

Shkaku: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia: I lartë.

5. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "***Nd. Rr. "Albanët" + Rrugicat në Valias + Rr. "Këmbanët" + Trotuaret në Rr. "Amsterdam", Valias i Ri" Bashkia Kamëz,*** me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Nd. Rr. "Albanët" + Rrugicat në Valias + Rr. "Këmbanët" + Trotuaret në Rr. "Amsterdam", Valias i Ri" Bashkia Kamëz.		
14.Lidhja e kontratës Nr. 7691 Prot., datë 31.08.2022 OE "N" SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 73,112,196 lekë me TVSh.	**16.Likuiduar:** Sit. 1 në vlerën 40,530,937.20lekë me TVSH Sit. (përfundimtar) në vlerën 32,571,292.20lekë pa TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Sit përf në vlerën 32,571,292.20 lekë pa TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 22.11.2022 Përfundimi punimeve: 18.04.2023	**19. Zgjatja e kontratës** S'ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "M.C.E" SHPK	Licenca Nr: MK.3119/8	Kontratë nr. 8057 prot., datë 09.09.2022
21. Kolaudatori i punimeve PF "M "	Licenca Nr: MK.3119/8	Kontratë nr. 4008/2 prot., datë 16.05.2023
22.Akt Kolaudimi.	**23.Akt i marrjes në dorëzim:**	

Datë: 09.06.2023-16.06.2023	Me datë 12.07.2023. Nga Kryetari i Bashkisë Kamëz është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit me nr632 datë 12.07.2023. Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, si dhe nga komisioni me përbërje: R.H., E. D.dhe H.M .

ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:

Titulli i gjetjes nr. 5*:* Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin *"Nd. Rr. "Albanët" + Rrugicat në Valias + Rr. "Këmbanët" + Trotuaret në Rr. "Amsterdam", Valias i Ri*", në mos respektim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të N", të ndryshuar.

Përshkrimi i situatës:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të N, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Kamëz, në vlerën **360,000 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Rruga "Albanët" Valias (Trotuare) "Punime trotuari".

Zëri 8(3.605) Shtresë pllake t=6cm mbi shtresë betoni.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 5,347.87 m^2 pllaka, me çmim 1,200 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron volumin 5,347.87 m^2 pllaka, të detajuara sipas seksioneve.

Konstatohet se, në pasqyrimin e volumit të këtij zëri pune në librezë janë bërë gabime, pasi nuk sipërfaqet që zënë pemët, dhe nga auditimi në fakt mbi realizimin e këtij zëri pune, nga auditimi i Projektit të Zbatimit (Planimetria e objektit), u konstatua se janë 120 m2 që znë pemët e mbjella të cilat nuk janë zbritur në zërin "Shtresë pllake t=6cm mbi shtresë betoni".

Sipas librezës së masave:

-Trotuar me sipërfaqe të përgjithshme rezulton 5,347.87 m2 pllaka.

Sipas grupit të auditimit:

-Trotuar me sipërfaqe të përgjithshme5,228 me pllaka (5,347.87 m2 pllaka – 120 m2 pemë).

Pra, për zërin "Shtresë pllake t=6cm mbi shtresë betoni" rezulton volum pune i kryer 5,228 m2 dhe jo 5,347.87.2 m2 siç është situacionuar dhe librezuar.

Sa më sipër trajtuar, diferenca prej 120 m^2 është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimevenë vlerën **144,000 lekë pa TVSH** [120 m^2 x 1,200 lekë].

Punime në sinjalistikën

Zëri (An-138) Vizime me bojë bikomponentë pastë për këmbësorë (Rruga Albanët).

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 121.5 m2 vijëzime me bojë antirrëshkitëse (pastë), me çmim 200 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron volumin 121.5 m2 vijëzime. Nga auditimi në fakt, rezulton se, ky zë punë është realizuar thjesh me bojë bikomponente dhe jo me bojë antirreshkitëse me trashësi 2 mm me ngjyrë sipas detajit, pra është realizuar në mospërputhje me specifikimet teknike.

Sa më sipër trajtuar, është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimevenë vlerën **24,300** lekë pa TVSH [121.5 m2 x 200 lekë].

Zëri 2(An-138) Vizime me bojë bikomponentë pastë për këmbësorë (Rruga Valias i Ri).

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 20 m2 vijëzime me bojë antirrëshkitëse (pastë), me çmim 1,800 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron volumin 20m2 vijëzime.Nga auditimi në fakt, rezulton se, ky zë punë është realizuar thjesh me bojë bikomponente dhe jo me bojë antirreshkitëse me trashësi 2 mm me ngjyrë sipas detajit, pra është realizuar në mospërputhje me specifikimet teknike.

Sa më sipër trajtuar, është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimevenë vlerën **36,000** lekë pa TVSH [20 m2 x 1,800 lekë].

Zëri 2(An-138) Vizime me bojë bikomponentë pastë për këmbësorë (Ndërtim kunete dhe trotuare nga 1 anë + ndriçimi i rrugës "Amsterdam Kamëz").
Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 86.5 m2 vijëzime me bojë antirrëshkitëse (pastë), me çmim 1,800 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron volumin 86.5m2 vijëzime.Nga auditimi në fakt, rezulton se, ky zë punë është realizuar thjesh me bojë bikomponente dhe jo me bojë antirreshkitëse me trashësi 2 mm me ngjyrë sipas detajit, pra është realizuar në mospërputhje me specifikimet teknike.
Sa më sipër trajtuar, është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimevenë vlerën **155,700** lekë pa TVSH [86.5 m2 x 1,800 lekë]. Bazuar në faktin se punimet e N janë në periudhë garancie, AK Bashkia Kamëz, duhet t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve OE "N" SHPK, realizimin e zërit "(An-138) Bojë bikomponente (pastë) për kalim këmbësorësh me ngjyrë të kuqe dhe shirita të bardhë sipas detajit" në përputhje me kushtet e kontratës si dhe specifikimeve teknike. Në rast të kundërt, mosrealizimi sipas specifikimeve teknike do të konsiderohet dëm ekonomik në vlerën **216,000 lekë**. ***Sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi**: **Z. P.M,** **__*** *__ë cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.*
Kriteri: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të N" e konkretisht Kreu II, Pika 3; -Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 7691 prot., datë 31.08.2022; - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 8057 prot., datë 09.09.2022.
Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Kamëz.
Shkaku: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara.
Rëndësia: I lartë.

6. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "***Rr. "Shëngjegji" + Rr. "Ali Pashë Gucia" + Rr. "Arbëria"+ seg. Pingul me Rr. "Selishtë" + Rr. "Vlorë") Bashkia Kamëz,*** me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Ndërtim rrugët (Rr. "Shëngjegji" + Rr. "Ali Pashë Gucia" + Rr. "Arbëria"+ seg. Pingul me Rr. "Selishtë" + Rr. "Vlorë") Bashkia Kamëz.		
14.Lidhja e kontratës Nr. 9450 Prot., datë 17.10.2022 BOE "B" SHPK & "GJ" SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 60,839,255 lekë me TVSh. Prev i ripunuar 60,829,387.78 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar:** Sit. 1 në vlerën 9,088,564.76lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 28,533,165.05lekë me TVSH Sit. 3 në vlerën 24,453,283.04 lekë me TVSH Sit. 4(përfundimtar) në vlerën 7,842,939.69lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar -Sit përf në vlerën 7,842,939.69 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 24.11.2022 Përfundimi punimeve: 10.05.2023	**19. Zgjatja e kontratës** ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "N" SHPK	Licenca Nr: MK.1846/7	Kontratë nr. 9499 prot., datë 17.10.2022
21. Kolaudatori i punimeve PF"M "	Licenca Nr: MK.3671/1	Kontratë nr. 3305/1 prot., datë 13.04.2023
22.Akt Kolaudimi. Datë: 22.05.2023	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** Me datë 01.06.2023. Nga Kryetari i Bashkisë Kamëz është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit me nr. 573 datë 01.06.2023. Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, si dhe nga komisioni me përbërje: R. H., E.D dhe H.M .	

ku rezultoi, si vijon:

Konstatim: Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të N, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara për zërin e punimeve "Zëri 9(3.288) F.V Hekur betoni i zakonshëm Ø>10

mm" në objektin "Sh. Gj." Bathore 4, në vlerën 830,765.246 lekë pa TVSH, por nga shqyrtimi i observacionit të mbikëqyrësit të punimeve "N" SHPK, kryesisht dokumenteve (Detaj i armimit të murit rrethues, librezës së masave, fotografive, etj) grupi i auditimit merr në konsideratë argumentet dhe provat të cilat vërtetojnë vendosjen e hekurit në murin rrethues.

2.5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.

2.5.2. Auditim mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me nr. 973/1 prot; datë 10.10.2023, i ndryshuar, me objekt: "Auditim mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, *prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022,* u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- *Dokumentacioni në sistemin "e-lejet";*
- *Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;*
- *Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë e fIncës;*
- *Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë juridike;*
- *Dokumente të tjera nga arkiva, etj.*

Bashkia Kamëz ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 02, datë 27.07.2022, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së N, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Çertifikatës së Përdorimit

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Kamëz, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2022 deri në 31.12.2022**, ka pasur **841 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni,leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe çertifikata përdorimi, etj., përkatësisht **142** aplikime për leje zhvillimi, **100** aplikime për leje ndërtimi, **72**aplikime për çertifikata përdorimi, **23** aplikime për ndryshime projekti gjatë N, **200** aplikime për deklarata paraprake për kryerje punimesh, **7** aplikime për ndryshim funksioni, **45** aplikime për rikonstruksione dhe **39** aplikime për leje infrastrukture, të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Aneksin 5 (Tabela nr. 2)**.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DKTZH, Bashkia Kamëz, leje ndërtimi për ndërtim të ri me siparfaqe më të madhe se 250 m^2 janë miratuar **30 leje**, leje ndërtimi për ndërtim të ri sipërfaqe me të vogël se 250 m^2 janë miratuar **28 leje,** ndërsa leje përdorimi janë miratuar **57 leje**, të pasqyruara në Aneksin Nr. 5 (Tabela Nr. 1).

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të N janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtmë të lejeve të N për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m^2 dhe çertifikata përdorimi:

Në lidhje auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të N dhe çertifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

Titulli i gjetjes 1: Mosrespektimi i kondicioneve urbane.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të N u konstatua se në **5 (pesë)** raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë hapësirat e dedikuara për parkim në raport me numrin e banorëve, distancat nga ndërtimet e tjera dhe nga kufiri i pronës, tipologjia e lejuar e N e përcaktuar në dokumentat e planifikimit, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat me 1 kat nëntokë me adresë në rruga "Roma" Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "M " SHPK, me licencë nr. 2961/6, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4594 Prot; datë 27.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk janë respektuar hapësirat për parkim, pasi referuar Nenit 29 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Kamëz, pika 1, nënpika c), hapësira minimale e dedikuar për parkim është 15 m^2/familje ose apartament. Sipërfaqja totale faktike e parkimit është 1106 m^2, ndërkohë që sipërfaqja sipas dispozitave të sipërcituara do të duhej të ishte 1440 m^2.
- Fasada jug-perëndimore e objektit nuk përmbush kriterin për t'u konsideruar "faqe kallkan", sipas përcaktimeve të Nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar me Vendim nr. 457, datë 29.06.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"" të ndryshuar, pika 3. Në planvendosjen e miratuar për këtë objekt, ka një shënim "faqe kallkan" për vetëm një pjesë të fasadës jug-perëndimore të objektit (pjesa që vendoset përballë objektit ekzistues 2 kat). Ky shënim nuk merret në konsideratë, pasi baza ligjore e sipërcituar shprehet qartësisht mbi ekzistencën e dritareve në faqet e konsideruara kallkan. Si rrjedhojë, ky objekt nuk respekton distancat urbane nga ndërtimet e tjera dhe nga kufiri i pronës.
- Objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga ndërtesat e tjera, më konkretisht, nga objekti 4 kate në pjesë jugore, pasi, referuar Nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar me Vendim nr. 457, datë 29.06.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" të ndryshuar, pika 1. Nga përllogaritja konstatohet se distanca minimale e lejuar është 15 metra, ndërsa distanca e miratuar është 13 metra.

2. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat dhe 2 kat nëntokë, me adresë në rruga "B. Shkurti" Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues shoqëria "A " SHPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4321 Prot., datë 04.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, KSHR = 9.1% dhe KSHP = 30%. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenin 40 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",* i ndryshuar, pika 2, si dhe në kundërshtim me Nenin 17 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Kamëz, pika 3, 4 dhe 5.

3. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi, 7, 8, dhe 9 kate me 2 kate nëntokë ", me adresë në rrugën "B. Shkurti" Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "S " SHPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4551 Prot., datë 07.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, KSHR = 9.1% dhe KSHP = 30%. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenin 40 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",* i ndryshuar, pika 2, si dhe në kundërshtim me Nenin 17 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Kamëz, pika 3, 4 dhe 5.

4. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 1, 8 dhe 9 kat, me 1 kat nëntokë, me zhvillues shoqëria "B " SHPK & Shoqëria "D" SHPK,për të cilën është marrë Vendimi Nr. 3770, datë 15.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:

- Referuar VKM-së 408, datë 13.5.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, Neni 34, pika 2, përcaktohet se distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m. Objekti që do të ndërtohet në lartësinë e 9 kateve nuk respekton distancën me objektin ekzistues në lartësinë e 8 kateve, pasi distanca ndërmjet tyre është më e vogël se 19 metra.
- Referuar VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, Neni 35, pika 1, objekti në lartësinë e 9 kateve do të duhej të respektonte distancën minimale nga kufiri i pronës prej 10 metra. Në planvendosjen e miratuar konstatohet se distanca është më e vogël se 10 metra.

7. Leje N për dy objekte banimi dhe shërbimi 9 kate me 1 kat nëntokë, me zhvillues Shoqëria "P." SHPK, në adresën rruga "B. Shkurti", Lagjia Laknas, Kamëz, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4108, datë 16.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:

- Në bazë të përcaktimeve të PDV-së së miratuar për njësinë strukturore 1.7.9; 1.7.6 Laknas, tipologjia e njërit prej objekteve duhet të jetë objekt logjistikë, ndërsa objekti tjetër banim 7-9 kate. Në mospërputhje me PDV-në, planvendosjen është miratuar për realizimin e **dy objekteve të banimit** të zhvilluar në lartësinë e **9 kateve**.

Kriteri: VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",* i ndryshuar, neni 40, pika 2; neni 34, pika 2, 3; neni 35, pika 1; Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Kamëz, neni 17, pika 3, 4 dhe 5; neni 29, pika 1, nënpika c); Plani i Detajuar Vendor për njësinë strukturore 1.7.9;1.7.6 Laknas.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i parametrave urban ndikon në zhvillimin e kontrolluar urban, duke cënuar parametra të përcaktuar në legjislacion dhe rregullore, si dhe duke ndikuar negativisht në standartet ndërtimore, kushtet e sigurisë, higjenës, ato mjedisore dhe urbanistike.

Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Kamëz.

Rëndësia: E mesme.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të N të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Znj. M.H** , Nën/Kryetari i Bashkisë Kamëz *(për miratimin e lejeve 1, 2, 3, 4, 7)*;
- **Z. E.B ,** në funksionin e drejtorit të DKZHT, *(për miratimin e lejeve 1, 2, 3, 4, 7)*;
- **Znj. I.GJ** , në funksionin e përgjegjësit të Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve *(për miratimin e lejeve 1, 2, 3, 4, 7)*;
- **Znj. A.R** , në funksionin e specialistit pranë Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve *(për miratimin e lejeve 1, 2, 7)*;
- **Znj. K.L** , në funksionin e specialistit pranë Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve *(për miratimin e lejeve 2, 3, 7)*;
- **Znj. F.R**, në funksionin e specialistets pranë KZHT *(për miratimin e lejeve 4, 7)*.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot; datë 04.03.2024, është observuar nga funksionarët e DPKZHT, Bashkia Kamëz (Znj. M.H ; Z. E.B ; Znj. F.R; Znj. I.GJ ; Znj. K.L ; Znj. A.R), me anë të shkresës nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024, si më poshtë vijon:

1. Pretendimi i subjektit:

-Në lidhje me konstatimin se fasada nuk mund të konsiderohet faqe kallkan, shprehen se: "Në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane, ju sqarojmë se, faqja kallkan është ruajtur plotësisht midis dy faqeve objekt i propozuar - objekt dy kat kufitar. Në fashaturën ku fillon çarja e fasadës duke krijuar dritare të pastra objekti, nuk përballet më objektin dy kat por me kufirin e pronës me distancë 19.8 m nga e cila rrjedh e drejta e projektimit të objektit të propozuar sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar".

-Në lidhje me konstatimin se objekti i miratuar në lejen nr. 1 nuk respekton distancat urbane, shprehen se: "Përsa i përket objektit të referuar si 4 kat nga i cili nuk ruhen distancat urbane objekt objekt, ju bëjmë me dije se, referuar arkivës së lejeve të miratuara që Drejtoria e PZHT-së disponon për lejet e N të miratuara, objekti nuk rezulton të jetë ndërtuar me leje ndërtimi apo disponon certifikatë përdorimi dhe rrjedhimisht objekti ruan distancën nga kufiri i pronës mbështetur në nenin 34, pika 4."

1.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

-Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se, në citimet ligjore në lidhje me faqet kallkan, nuk ka asnjë përcaktim ku të shprehet se këto fasada mund të respektojnë pjesërisht distancat nga ndërtimet e tjera ose nga kufiri i pronës. Nga shqyrtimi i projektit ndërtimor, kjo fasadë është e unifikuar dhe në një plan. Distanca midis faqeve kalla është më pak se 5 (pesë) metra, në kundërshtim me nenin 34 pika 3 të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullres së zhvillimit të territorit".

Drejtoria e PZHT-së lidhur me objektet kufitare në rastin e subjektit "M " SHPK nuk ka argumentuar me fakte/dokumente, se objektet kufitare janë ndërtuar pa leje ndërtimi dhe që nuk disponojnë certifikatë përdorimi.

-Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se, inforM oni mbi statusin e objektit merret nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në rrugë zyrtare. Drejtoria e PZHT duhet të kishte kërkuar informacion nga kjo agjenci, si dhe të bënte këtë dokument pjesë së procedurës së aplikimit, ose, së paku, pjesë të observacioneve.

2. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me mosrespektimin e KSHP dhe KSHR, shprehen se: *"Leja eN është dhënë në përputhje me Planin e Detajuar Vendor, të miratuar me Vendim nr.7367/1, datë 26.07.2021. Sipas pikës 7, të Vendimit nr.01, datë 27.07.2022, për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kamëz: Planet e detajuar vendore dhe lejet e N t të miratuara në zbatim të dokumentave të planifikimit, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi. Për rrjedhojë KSHR dhe KSHP sipas PDV-së së lartpërmendur i cili qëndron në fuqi dhe me planin e ri vendor të 2022.". Ju bëjmë me dije se KSHR dhe KSHP janë të përcaktuara në tabelën e treguesve të zhvillimit në PDV-në e miratuar.*

2.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se, konstatimi ka të bëjë me mos-evidentimin e KSHP dhe KSHR në dokumentat e praktikës së aplikimit, pasi ato nuk janë përcaktuar në asnjë prej dokumentave në sistemin e-lejet, pra nuk dihet vlera faktike e këtyre parametrave. Sa argumentuar nga Ju, **merret në konsideratë** dhe, kjo do të reflektohet në Raportin përfundimtar të auditimit, por gjithsesi theksojmë se KSHP dhe KSHR duhet të dokumentohen në dokumentet e ngarkuara në sistemin e-lejet.

3. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me mosrespektimin e distancave nga kufiri i pronës, shprehen se: *"Në rastet se zhvillimi i propozuar përballet me strukturë ekzistuese, të ndërtuar tërësisht apo pjesërisht pa leje ndërtimi apo në shkelje të kushteve të lejes së miratuar nga autoriteti vendor i zhvillimit, propozimi për zhvillim përjashtohet nga detyrimi për të respektuar distancat me pjesën informale. Në këto raste, struktura e re e propozuar do të*

respektojë distancat vetëm me lejen e miratuar në rastet kur përballet me situatë të formuar, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij neni, apo me kufirin e pronës në rastet kur përballet me objekte të ndërtuara tërësisht pa leje, sipas përcaktimeve të nenit 35. Në çdo rast, duhet të garantohet kalimi i mjeteve si ambulancat apo zjarrfiksat". Në këto kushte në praktikën e shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimi, për vendimmarrje në lidhje me respektimin e distancave objekt – objekt, informacionin mbi objektet e ndërtuara me leje ndërtimi dhe të pajisura me certifikatë përdorimi është marrë në konsideratë informacioni i brendshëm që drejtora disponon sipas fushës së verimit.

3.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, Neni 35, pika 1, përcaktohet se: *"Distanca minimale e lejuar e N nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së N me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të N plus 1m."* Për objektin në lartësinë e **9 kateve** distanca minimale që duhet respektuar nga kufiri i pronës është **10 metra**. Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nuk pasqyrohen të dhëna të objekteve me të cilat kufizohet, që vërtetojnë që objektet nuk janë të pajisur me leje ndërtimi ose janë të realizuara jashtë lejes. Për sa më sipër, trajtuar mbas shqyrtimit të argumenteve si dhe dokumenteve shtesë përcjellë nga ana Juaj, **pretendimet merren pjesërisht në konsideratë.**

4. Pretendimi i subjektit (Situata **7** të gjetjes **1**):

Në lidhje me Lejen e N për "Dy objekte banimi dhe shërbimi 9 kate me 1 kat nëntokë", me zhvillues Shoqëria "P." SHPK, në adresën rruga "B. Shkurti", Lagjia Laknas, Kamëz, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4108, datë 16.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, ju bëjmë me dije se sipas Planit të Detajua Vendor, të miratuar me Vendimin nr. 7367/1, datë 26.07.2021, **asnjëri nga objektet e aplikimit në fjalë nuk propozohet objekt logjistik.**

4.1 Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se:

Në bazë të përcaktimeve të PDV-së së miratuar për njësinë strukturore 1.7.9; 1.7.6 Laknas, tipologjia e njërit prej objekteve duhet të jetë objekt logjistikë, ndërsa objekti tjetër banim 7-9 kate. Në gjykimin e grupit të auditimit, miratimi i lejes për realizimin e **dy objekteve të banimit** të zhvilluar në lartësinë e **9 kateve**, është në mospërputhje me PDV-në dhe, planin e vendosjes për lejendërtimi.

Titulli i gjetjes 2: Mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të N dhe zhvillimit u konstatua se në **6 (gjashtë) raste,** projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat me 1 kat nëntokë me adresë në rruga "Roma" Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "**M** " SHPK, me licencë nr. 2961/6, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4594 Prot., datë 27.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjektit dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), për të gjithë hartuesit e projekteve ndërtimor, siç janë çertifikata e regjistrimi në QKB ose ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika ë). Të vetmet subjekte që e kanë ngarkuar këtë dokumentacion në sistemin *e-lejet* janë hartuesi i projektit konstruktiv dhe studimit sizmiko-gjeologjik;

- Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projekteve: konstruktiv; studimi sizmiko-gjeologjik; studimi gjeologo-inxhinierik; veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika g;
- Deklarata e përgjegjësisë profesionale për hartuesit e studimit gjeologo-inxhinierik dhe rilevimit topografik, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika e;
- Licenca profesionale e hartuesit të rilevimit topografik, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika g;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë në formatin DËG, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika ç.

2. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat dhe 2 kat nëntokë, me adresë në rruga "B. Shkurti" Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues shoqëria "**A** " SHPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4321 Prot; datë 04.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Mungon licenca profesionale për hartuesin e projektit të mbrojtjes nga zjarri, veprime në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-sënr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika ë;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë në formatin DËG, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika ç.

3. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi, 7, 8, dhe 9 kate me 2 kate nëntokë ", me adresë në rrugën "B. Shkurti" Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "**S** " SHPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4551 Prot; datë 07.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për hartuesit e projekteve arkitektonik, konstruktiv dhe të raportit të auditimit të eficencës së energjisë, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"* të ndryshuar, pika 1, nënpika ë);
- Deklarata e hartuesit të projektit arkitektonik dhe e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, veprim ky në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"* të ndryshuar, pika 1, nënpika e;
- Polica e sigurmit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, gjithashtu, afati i policës së hartuesit të studimit sizmik dhe atij gjeologjik është jashtë afatit, në raport me datën e aplikimit, veprime këto në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"*, të ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika g;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë në formatin DËG, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, pika 1, nënpika ç.

4. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 1, 8 dhe 9 kat, me 1 kat nëntokë, me zhvillues shoqëria "B " SHPK & Shoqëria "**D**" SHPK,për të cilën është marrë Vendimi Nr. 3770, datë 15.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Planvendosje e miratuar dhe rilevimi topografik nuk janë të plotësuara me të gjitha të dhënat e nevojshme, pasi nuk janë pasqyruar të gjitha numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet. Gjithashtu, nuk pasqyrohen distancat nga kufiri i pronës, distancat ndërmjet objekteve ekzistuese dhe objektit që do të ndërtohet, sipas përcaktimeve të Nenit 15 të VKM-

së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 1, gërma (c) *"plani i vendosjes së N mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese".*

6. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 1-2-8-9 kate + 1 kat nëntokë, me zhvillues Shoqëria "A" SHPK, në adresën Bulevardi "Nënë Tereza" Lagjia nr.1, Kamëz, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 3831, datë 13.05.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk janë pasqyruar të gjitha numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet, sipas përcaktimeve të Nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 1, gërma (c) *"plani i vendosjes së N mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese"*.

9. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 1, 3, 7 dhe 8 kat me 1 kat nëntokë, me zhvillues shoqëria "**SH**" SHPK, në adresën rruga "Nënë Tereza", Kamëz, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4435, datë 29.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:

- Planvendosje e miratuar dhe rilevimi topografik nuk janë të plotësuara me të gjitha të dhënat e nevojshme, pasi, në orientimin verior të objektit që do të zhvillohet, pozicionohet një tjetër objekt me të cilin kufizohet, në planvendosjen e miratuar nuk janë pasqyruar numrat e kateve të objekteve të këtyre objekteve, sipas përcaktimeve të Nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 1, gërma (c) *"Plani i vendosjes së N mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese".*

Kriteri: VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"*, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika (c), (ç), (e), (ë), (g).

Ndikimi/Efekti: Mangësitë në projektin ndërtimor, në dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi dhe zhvillimi, ndikojnë në cilësinë dhe garatimin e ndërtimeve sipas standarteve, kushteve higjeno-sanitare dhe të sigurisë, nga subjekte të cilat duhet të plotësojnë kriteret e ushtrimit të profesionit, sipas legjislacionit në fuqi.

Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Kamëz.

Rëndësia: E mesme.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të N të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: **Znj. M.H** , Nën/Kryetari i Bashkisë Kamëz *(për miratimin e lejeve 1, 2, 3, 4, 6, 9)*; **Z. E.B ,** në funksionin e drejtorit të DKZHT, *(për miratimin e lejeve 1, 2, 3, 4, 6, 9)*; **Znj. I.GJ** , në funksionin e përgjegjësit të Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve *(për miratimin e lejeve 1, 2, 3, 4, 7)*; **Znj. A.R** , në funksionin e specialistit pranë Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve *(për miratimin e lejeve 1, 2, 3, 4, 6, 9)*; **Znj. K.L** , në funksionin e specialistit pranë Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve *(për miratimin e lejeve 3, 9)*; **Znj. F.R**, në funksionin e specialistets pranë KZHT *(për miratimin e lejeve 4, 6)*.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot; datë 04.03.2024, është observuar nga funksionarët e DPKZHT, Bashkia Kamëz (Znj. M.H ; Z. E.B ; Znj. F.R; Znj. I.GJ ; Znj. K.L ; Znj. A.R), me anë të shkresës nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024, si më poshtë vijon:

1. Pretendimi i subjektit: *Për sa i përket pikës 1, "Vertetimet e regjistrimit në Qëndren Kombëtare të Biznesit (QKB) për hartuesin e projektit arkitektonik" sjellim në vëmendjen Tuaj se, bazuar në nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, ...dokumentacionet që vërtetojnë statusin aktiv të subjektit dhe regjistrimit në QKB, janë dokumentacione plotësuese sipas përcaktimit të nenit 15/ë.*

-Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së N.

1.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se:

- së pari, dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjektit dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) është dokumentacion i kërkuar në bazën ligjore të sipërcituar nga Ju, dhe jo plotësues. Prania e këtij vërtetimi ul mundësitë e hartimit të projekteve nga subjekte të cilat nuk gëzojnë të drejtën e ushtrimit të profesionit, sipas legjislacionit shqipëtar.

- së dyti, konstatimi ka të bëjë me mungesën e deklaratave të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projekteve të sipërcituara, edhe jo me mungesën e projekteve ose planit të rilevimit. Në lidhje me pretendimin se, SPZHT i është drejtuar institucionit përgjegjës UPT-IGJEUM, duke justifikuar kështu mungesat në dokumentacion, shprehemi se, ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, pasi, pikërisht në këtë praktikë, SPZHT ka kërkuar plotësimin e praktikës (me anë të shpresës me Nr. 4594/1 Prot; datë 16.11.2022) me deklaratën e përgjegjësisë profesionale të hartuesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, edhe pse është marrë mendimi i AKM-së. Observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

Titulli i gjetjes 3: Përllogaritje e gabuar e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (**TNI**) nga objektet me leje ndërtimi.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të N u konstatua se në **9 (nëntë) raste,** Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk është përllogaritur e saktë, sipas përcaktimeve të Nenit 46, pika 1 dhe 2, të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, ku theksohet:

*1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi **dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri** që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.*
*2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paguhet **përpara dorëzimit të dokumentit të lejes** së N nga autoriteti përgjegjës i planifikimit.*

Nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, pika 1 dhe 2, ku theksohet:

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së N.....
2. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) për qind deri 8 (tetë) për qind të çmimit të shitjes për metër katror….

Sipas specialistëve të DPZHT, taksa e ndikimit në infrastrukturë është llogaritur në zbatim të VKB Nr. 29, datë 16.03.2021 "Për një ndryshim në VKB nr. 167 datë 23.12.2020", në referencë të Projekt Vendimit nr. 26, datë 11.3.2021 të paraqitur në Këshillin Bashkiak**,** ku në pikën 2 të tij thuhet: "*Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e N, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 përqind të **çmimit të shitjes për metërkatror të sipërfaqeve të shfrytëzueshme***."

Më konkretisht, llogaritjet janë bërë si vijon:

1. Për Lejen e N me objekt "Godinë banimi dhe shërbimi 9 kat me 1 kat nëntokë me adresë" në rruga "Roma" Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues dhe ndërtues shoqërinë "**M**" SHPK, me licencë nr. 2961/6, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4594 Prot., datë 27.12.2022 të

Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Vlera e TNI-së është përllogaritur në vlerën **20,989,280 lekë,** për sipërfaqen e shfrytëzueshme me çmim 52,000 lekë/m^2.
2. Për Lejen e N me objekt "Godinë banimi dhe shërbimi 9 kat dhe 2 kat nëntokë", me adresë në rruga "B. Shkurti" Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues shoqëria "**A** " SHPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4321 Prot., datë 04.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Vlera e TNI-së është përllogaritur në vlerën **40,195,792 lekë,** për sipërfaqen e shfrytëzueshme me çmim 52,000 lekë/m^2.
3. Për Lejen e N me objekt "Objekt banimi dhe shërbimi, 7, 8, dhe 9 kate me 2 kate nëntokë", me adresë në rrugën "B. Shkurti" Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "**S** " SHPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4551 Prot., datë 07.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Vlera e TNI-së është përllogaritur në vlerën **73,178,872 lekë,** për sipërfaqen e shfrytëzueshme me çmim 52,000 lekë/m^2.
4. Për Lejen e N me objekt "Godinë banimi dhe shërbimi 1, 8 dhe 9 kat, me 1 kat nëntokë", me zhvillues shoqëria "**B " SH& Sh"D**" SHPK,për të cilën është marrë Vendimi Nr. 3770, datë 15.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Vlera e TNI-së është përllogaritur në vlerën **12,808,224 lekë,** për sipërfaqen e shfrytëzueshme me çmim 52,000 lekë/m^2.
5. Për Lejen e ndërtimi me objekt "Godinë banimi dhe shërbimi 1,7 dhe 8 kat, me 1 kat nëntokë", me zhvillues Shoqëria "E" SHPK & Shoqëria "**L** " SHPK, në adresën Rruga "Teuta" Lagjia nr. 7, Bathore, Bashkia Kamëz, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4286, datë 08.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Vlera e TNI-së është përllogaritur në vlerën **9,082,736 lekë,** për sipërfaqen e shfrytëzueshme me çmim 52,000 lekë/m^2.
6. Për Lejen e N me objekt "Godinë banimi dhe shërbimi 1-2-8-9 kate + 1 kat nëntokë", me zhvillues Shoqëria "**A**" SHPK, në adresën Bulevardi "Nënë Tereza" Lagjia nr.1, Kamëz, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 3831, datë 13.05.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Vlera e TNI-së është përllogaritur në vlerën **23,742,160 lekë,** për sipërfaqen e shfrytëzueshme me çmim 52,000 lekë/m^2.
7. Për Lejen e N me objekt "Dy objekte banimi dhe shërbimi 9 kate me 1 kat nëntokë", me zhvillues Shoqëria "**P**" SHPK, në adresën rruga "B. Shkurti", Lagjia Laknas, Kamëz, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4108, datë 16.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Vlera e TNI-së është përllogaritur në vlerën **37,555,544 lekë,** për sipërfaqen e shfrytëzueshme me çmim 52,000 lekë/m^2.
8. Për Lejen e N me objekt "Godinë banimi dhe shërbimi 9 kate dhe 1 kat nëntokë", me zhvillues shoqëria "**E**" SHPK, në adresën rruga "Gryka e Kacanikut ", Lagjia Laknas, Kamëz, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4155, datë. 15.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Vlera e TNI-së është përllogaritur në vlerën **27,420,016 lekë,** për sipërfaqen e shfrytëzueshme me çmim 52,000 lekë/m^2.
9. Për Lejen e N me objekt "Godinë banimi dhe shërbimi 1, 3, 7 dhe 8 kat me 1 kat nëntokë", me zhvillues shoqëria "**SH**" SHPK, në adresën rruga "Nënë Tereza", Kamëz, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4435, datë 29.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Vlera e TNI-së është përllogaritur në vlerën **9,045,920 lekë,** për sipërfaqen e shfrytëzueshme me çmim 52,000 lekë/m^2.
Sa më sipër, llogaritja e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) për sipërfaqen e shfrytëzueshme me çmim 52,000 lekë/m^2 rezulton në shumën 254,018,544 lekë.
-Kjo mënyrë llogaritje nuk është në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 46 *Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja,* si dhe me nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. Në asnjë paragraf të dispozitave të mësipërme nuk thuhet sipërfaqe e **shfrytëzueshme**, por siperfaqe për **metërkatrorë**.

Gjithashtu sqarojmë se TNI është taks ndërtimi në infrastrukturë që paguhet para fazës së marrjes së lejes së N, e cila ka të bëjë me sipërfaqen e N për ndikimin në infrastrukturë dhe jo me fazën e shitjes ose kalim pronësie.
Kriteri: Ligji 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, Neni 46. Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, Neni 27, pika 1.
Ndikimi/Efekti: Llogaritja e gabuar e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë ndikon negativisht në buxhetin e Bashkisë Kamëz.
Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Kamëz.
Rëndësia: E lartë

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të N të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Znj. M.H** , Nën/Kryetari i Bashkisë Kamëz *(për miratimin e lejeve 1-9)*;
- **Z. E.B ,** në funksionin e drejtorit të DKZHT, *(për miratimin e lejeve 1-9)*;
- **Znj. I.GJ** , në funksionin e përgjegjësit të Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve *(për miratimin e lejeve 1, 2, 3, 9)*;
- **Znj. F.R**, në funksionin e specialistets pranë KZHT *(për miratimin e lejeve 4, 5, 6, 7, 8)*.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar kundërshtitë e paraqitura nga funksionarët e DPZHT Bashkia Kamëz me shkresë nr. 226 prot, datë 09.01.2024 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nuk ka asnjë element të ri nga ato të shprehura në fazën e akt-konstatimeve.

Titulli i gjetjes 4: DPKZHT dhe Bashkia Kamëz nuk kanë kërkuar mendimin e autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të N.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të N u konstatua se në **3 (tre) raste** Bashkia Kamëz dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të N. Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, Neni 21, pika 6, DPKZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të N. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:
1. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat me 1 kat nëntokë me adresë në rruga "Roma" Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "**M** " SHPK, me licencë nr. 2961/6, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4594 Prot., datë 27.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Nuk është rikërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit, mbi identifikimin e linjave dhe projekteve të këtij operatori, pas ndryshimeve të projektit sipas mendimit fillestar të këtij operatori.
2. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat dhe 2 kat nëntokë, me adresë në rruga "B. Shkurti" Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues shoqëria "**A** " SHPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4321 Prot., datë 04.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Vendore përkatëse të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK). DPKZHT ka kërkuar mendimin e Drejtorisë Vendore Kamëz-Vorë të ASHK-së. Kjo drejtori është përgjigjur se: *"...ZK 8320 nuk është nën juridiksionin tonë si zonë kadastrale dhe është tërësisht jashtë kompetencave të drejtorisë sonë ASHK Kamëz-Vorë*

të ofrojë shërbimin...”. DPKZHT nuk ka kërkuar mendimin e Drejtorisë Vendore përkatëse, duke e miratuar lejen e N pa miratimin e këtij autoriteti.
- Në sistemin elektronik të lejeve, mungon mendimi i Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.
- Nuk është respektuar mendimi i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE). Ky autoritet është shprehur se *“Brenda sheshit të N (ABCD) nuk ka linja që administrohen nga drejtoria OSSH Tiranë. Për furnizimin me energji elektrike investitori do të ndërtojë kabinë elektrike me izolacion 20 kV në kuotën 0.00.”*. DPKZHT nuk i ka kërkuar aplikantit ndryshimin e projektit sipas mendimit të OSHEE.

3. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi, 7, 8, dhe 9 kate me 2 kate nëntokë ", me adresë në rrugën “B. Shkurti” Kamëz, Bashkia Kamëz, me zhvillues dhe ndërtues shoqëria “**S** ” SHPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 4551 Prot; datë 07.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Vendore përkatëse të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK). DPKZHT ka kërkuar mendimin e Drejtorisë Vendore Kamëz-Vorë të ASHK-së. Kjo drejtori është përgjigjur se: *“...ZK 8320 nuk është nën juridiksionin tonë si zonë kadastrale dhe është tërësisht jashtë kompetencave të drejtorisë sonë ASHK Kamëz-Vorë të ofrojë shërbimin...”*. DPKZHT nuk ka kërkuar mendimin e Drejtorisë Vendore përkatëse, por e ka miratuar lejen e N pa miratimin e këtij autoriteti.
- Në sistemin elektronik të lejeve, mungon mendimi i Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.
- Nuk është respektuar mendimi i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE). Ky autoritet është shprehur se *“Brenda sheshit të N (ABCD) nuk ka linja që administrohen nga drejtoria OSSH Tiranë. Për furnizimin me energji elektrike investitori do të ndërtojë kabinë elektrike me izolacion 20 kV në kuotën 0.00.”*. DPKZHT nuk i ka kërkuar aplikantit ndryshimin e projektit sipas mendimit të OSHEE.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*, i ndryshuar, Neni 21 *“Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor”*, pika 6.

Ndikimi/Efekti: Mos-marrja dhe mos-respektimi i mendimit të autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të N, rrit mundësitë e zhvillimit të objekteve në kundërshtim me kondicionet urbane, si dhe nuk jep siguri të lartë në lidhje me respektimin e kushteve të sigurisë dhe higjeno-sanitare.

Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Kamëz.

Rëndësia: E lartë

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të N të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Znj. M.H** , Nën/Kryetari i Bashkisë Kamëz *(për miratimin e lejeve 1, 2, 3)*;
- **Z. E.B ,** në funksionin e drejtorit të DKZHT, *(për miratimin e lejeve 1, 2, 3)*;
- **Znj. I.GJ** , në funksionin e përgjegjësit të Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve *(për miratimin e lejeve 1, 2, 3)*;
- **Znj. A.R** , në funksionin e specialistit pranë Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve *(për miratimin e lejeve 1, 2)*;
- **Znj. K.L** , në funksionin e specialistit pranë Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve *(për miratimin e lejes 3)*.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 873/7 prot; datë 04.03.2024, është observuar nga funksionarët e DPKZHT, Bashkia Kamëz (Znj. M.H ; Z. E.B ; Znj. F.R; Znj. I.GJ ; Znj. K.L ; Znj. A.R), me anë të shkresës nr. 1751/1 prot; datë 29.02.2024, si më poshtë vijon:

1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me mungesën e marrjes së mendimit nga ASHK, shprehen se: *"Ju bëjmë me dije se DPZHT ka njoftuar AKSH-in me e-mail për hapjen në sistemet e-lejet të opsionit për të dërguar për mendim dosjet e caktuara në ASHK Tirana - Veri" paraqitur në foto.*



1.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me argumentimin Tuaj, shprehemi se, SPZHT do të duhej të kërkonte mënyra të tjera për të marrë mendimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana-Veri. Gjithashtu, do të duhej të njoftonte AKSH-in për problematikën e evidentuar.

Për sa më sipër, trajtuar mbi situatat, mbas shqyrtimit të argumenteve si dhe dokumenteve shtesë përcjellë nga ana Juaj, **pretendimet merren pjesërisht në konsideratë.**

Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të N:

1. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të N u konstatua se në **5 (pesë)** raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë hapësirat e dedikuara për parkim në raport me numrin e banorëve, distancat nga ndërtimet e tjera dhe nga kufiri i pronës, tipologjia e lejuar e N e përcaktuar në dokumentat e planifikimit, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike.

2. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të N dhe zhvillimit u konstatua se në **6 (gjashtë)** raste, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me:

- Mungesën e dokumentacionit që vërteton statusin aktiv të subjektit dhe regjistrimin në (QKB), për hartuesit e projekteve ndërtimor;
- Mungesën e policës së sigurimit të përgjegjësisë profesionale;
- Mungesën e deklaratës së përgjegjësisë profesionale;
- Mungesën e licencës profesionale;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë në formatin DWG;
- Planvendosje e miratuar dhe rilevimi topografik nuk janë të plotësuara me të gjitha të dhënat e nevojshme;

3. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të N u konstatua se në **3 (tre)** raste Bashkia Kamëz dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të N. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me:

- Nuk është rikërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit, mbi identifikimin e linjave dhe projekteve të këtij operatori, pas ndryshimeve të projektit sipas mendimit fillestar të këtij operatori.
- Nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Vendore <u>përkatëse</u> të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).
- Mungon mendimi i Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.

- Nuk është respektuar mendimi i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE).

2.6. Mbi organiizmin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).

2.6.1. Auditim mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa lejeve hvillimore2.6.2. Auditimi mbi ekzekutimet e vendimeve të IMTV, për subjektet të cilët kanë kryer kundërvatje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

2.6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërine kushteve të ejeve tëN si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

I. Auditim mbi plotësimin e kritereve arsimore për punonjësit e IVMT

Të përgjithshme:

Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në lidhje me organizimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007,"*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme".* Në strukturën e miratuar me Vendimin Nr. 4119 prot., datë 11.05.2022, "Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz", IVMT ka në përbërje **15 (pesëmbëdhjetë)** pozicione pune, nga të cilët **1 (një)** Kryeinspektor **13 (trembëdhjetë)** inspektor dhe **1 (një)** specialist jurist të paraqitura në formë tabele si vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i arsimit/dega	Data emërimit në detyrë	Aktualisht në punë apo larguar, data
1	A.L	Kryeinspektor	Administrim Biznesi	22.02.2021	Në punë
2	R. D	Inspektor	I Mesëm	09.09.2020	Në punë
3	A. Ç	Inspektor	Drejtësi (M/Profesional)	23.09.2020	Në punë
4	A.Ç	Inspektor	Drejtësi (M/Shkencor)	01.11.2019	Në punë
5	B. Ll	Inspektor	Menaxhim ndërmarrjesh	03.08.2022	Në punë
6	L. S	Inspektor	Drejtësi (M.Shkencor)	07.02.2022	Në punë
7	E. H	Inspektor	Administrim Biznesi	15.02.2022	Në punë
8	A. M	Inspektor	I Mesëm	03.09.2019	Në punë
9	B. P	Inspektor	Drejtësi (Bachelor)	04.01.2017	Në punë
10	D. S	Inspektor	Drejtësi (M.Shkencor)	03.02.2021	Në punë
11	Sh. A	Inspektor	I Mesëm	10.10.2019	Në punë
12	U. Ç	Inspektor	Administrim Publik	10.10.2019	Në punë
13	E. B	Inspektor	Drejtësi	02.06.2021	Në punë
14	B. D	Inspektor	Drejtësi	19.08.2021	Në punë
15	E. L	Specialist Jurist	Drejtësi	19.03.2021	Në punë

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore, Bashkia Kamëz

Për periudhën objekt auditim 01.01.2022 deri 31.12.2022, IVMT është drejtuar nga Kryeinspektor A.L , i cili rezulton me arsim të lartë në degën administrim-biznesi.

Arsimimi i 3 (tre) inspektorëve **Z. R.D, Z. A.M dhe Z. Sh.A** të IVMT Kamëz është në mospërputhshmëri me kriteret e përcaktuara në **ligjin Nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e N", i ndryshuar me ligjin Nr.183/2014 "Për inspektimin e N" neni 11** "Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit", ku përcaktohet se: "*Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjes vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së N, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogje ologjisë dhe mjedisit.*

Mungesa e stafit të kualifikuar, sidomos atij inxhinierik përbën mungesë cilësore për mbarëvajtjen e punës së inspektoratit, pasi nuk kanë kualifikimet e nevojshme për të kryer akte kontrolli apo për të përcaktuar dhe përshkruar teknikisht situatat e konstatuara gjatë inspektimit.

II. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IVMT, për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IVMT.

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se me shkresat nr. 2730 prot., datë 04.04.2022, nr. 6377 prot., datë 14.07.2022 dhe nr. 575 prot., datë 20.01.2023 janë përcjellë të dhënat statistikore pranë IKMT- së. InforM oni periodik 3(tre) – mujor për IKMT, nuk është përgatitur sipas afateve të përcaktuara në nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar i cili përcakton se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave "b", "c", "ç", "d", "dh", të këtij neni.

-Kryeinspektori ka përgatitur planin vjetor të punës nr. 214 prot., datë 11.01.2022, i cili nuk ka në përmbajtje të tij prioritetet, objektivat, indikatorët e performancës dhe aktivietetet/masat që do të mundësojnë realizimin e tyre por përmban përshkrimet e detyrave të kryeinspektorit dhe inspektorëve.

-Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, nuk janë miratuar planet mujore të punës, veprim ky në mospërputhje me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë *mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore",* që përcakton se:

b) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore:

ii) kryen kontrolle në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike;

Në formë tabele paraqiten vendimet e marra nga IVMT Kamëz për vitin 2022 paqyruar si më poshtë:

Nr.	Lloji i aktit	2022
1	PV/Akte kontrolli	17
2	PV/Akte konstatimi	47
3	Vendime gjobe	35
4	Vendime pezullimi	29
5	Vendime prishje	10
6	PV ekzekutimi të prishjeve	-
7	Kallëzime penale	6
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	0
9	InforM on periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	3
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	1
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	0

Burimi: IVMT Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, gjatë kontrollit të ushtruar përgjatë vitit 2022, janë mbajtur gjithsej **47** akte konstatimi.

-Për **12** raste, rezulton se janë mbajtur procesverbale për objektet e dëmtuara nga tërmeti. Për aktet e konstatimit të cilat janë mbajtur për objektet e dëmtuara nga tërmeti, rezulton të ketë vendime dhe procesverbale ekzekutimi për prishjet e këtyre objekteve.

-Për **35** rastet e tjera, është nxjerrë vendimi i gjobës në përputhje me *nenin 5, pika b, "Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore" të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"* i ndryshuar.

-Për **10** vendime për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, nuk është mbajtur asnjë procesverbal për ekzekutimin e vendimit të prishjes së këtyre ndërtimeve, ***në mospërputhje me nenin 5 pika "d" të ligjitnr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.***

-Kryeinspektori ka nxjerrë **29** vendime për pezullim punimesh.

-Përgjatë periudhës objekt auditimi, kryeinspektori i IVMT-së, ka përcjellë **6** Kallëzime Penale ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimore pa leje nga organet përkatëse.

III. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IVMT lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të N si dhe, bashkëpunimi me Drejtorinë dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se IVMT Kamëz i ushtron funksionet e veta **jo në përputhje të plotë me ligjin Nr. 9780, Datë 16.07.2007** "*Për inspektimin e N*" i ndryshuar, me qëllim mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet e paligjshme si dhe kontrollin ndërtimeve të pajisura me leje.

Për periudhën objekt auditimi, u konstatua të ketë **939** aplikime në sistem për leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe certifikata përdorimi ndër të cilat rezultojnë të miratuara **505** leje, pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i lejes	Numri i aplikimeve	Numri i miratimeve
1	Certifikatë përdorimi	**72**	**57**
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	**200**	**93**
3	Leje infrastrukture	**39**	**29**
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	**50**	**28**
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	**27**	**14**
6	Leje për ndryshim funksioni	**7**	**4**
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë N	**23**	**10**
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	**5**	**3**
9	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së N	**16**	**11**
10	Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	**18**	**7**
11	Leje zhvillimi	**142**	**75**
12	Njoftim për fillim punimesh	**109**	**80**
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	**66**	**6**
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2	**77**	**41**
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	**50**	**30**
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	**11**	**3**
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	**27**	**14**

Burimi: IVMT Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Kryeinspektorika miratuar **17** akte kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, ndër të cilat vetëm **8** për lejet e dhëna përgjatë periudhës objekt auditimi, ***ku konstatohet mungesa e një bashkëpunimi eficent, midis IVMT-së dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit***, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, N, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit në Bashkinë Kamëz në kundërshtim me pikën (3) të nenit 51 në Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, i cili përcakton se:***Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.***

Titulli i Gjetjes nr. 1: IVMT Bashkia Kamëz ka ushtruar funksionet e veta jo në përputhshmëri të plotë me detyrimet që përcakton ligji për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme dhe ai për planifikimin e territorit.

Situata:

-Arsimimi i 3 (tre) inspektorëve të IVMT – së është në mospërputhshmëri me kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit Nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e N", i ndryshuar;

-InforM oni periodik 3(tre) – mujor për IKMT, nuk është përgatitur sipas afateve të përcaktuara në nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar;
-Plani vjetor i punës nr. 214 prot., datë 11.01.2022, nuk ka në përmbajtje të tij prioritetet, objektivat, indikatorët e performancës dhe aktivietetet/masat që do të mundësojnë realizimin e tyre por përmban përshkrimet e detyrave të kryeinspektorit dhe inspektorëve;
-Kryeinspektori, nuk ka miratuar planet mujore të punës, veprim ky në mospërputhje me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore";
-Për **10** vendime për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, nuk është mbajtur asnjë procesverbal për ekzekutimin e vendimit të prishjes së këtyre ndërtimeve;
-Nga kontrolli i dokumentacionit, konstatohet mungesa e një bashkëpunimi eficent, midis IVMT-së dhe DPZHT-së, për shkëmbimin e inforM onit mbi lejet e zhvillimit, N, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit, në mospërputhje me pikën (3) të nenit 51 në Ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar.
Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar; Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore".
Impakti: Mos zbatim i kuadrit ligjor në fushën e inspektimit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme.
Shkaku: Personeli i pakualifikuar dhe neglizhencë në kryerjen e detyrës nga IVMT.
Rëndësia: E lartë

Titulli i Gjetjes nr. 2: Bashkia Kamëz nuk ka bërë arkëtimin e të gjitha masave administrative të vendosura nga IVMT.

Situata 1. Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Kamëz për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si vijon:

Subjekte kundërvajtës të konstatuar
IVMT, Bashkia Kamëz

Emërtimi	Gjoba viti 2022		Arkëtuar		Vendim Gjykate		Diferenca	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
Gjoba KLSH	15	900,000	15	900,000			-	-
Gjoba IVMT	35	7,155,755	17	2,170,338	1	302,400	17	4,683,017
Gjoba gjithsej	**50**	**8,055,755**	**32**	**3,070,338**	**1**	**302,400**	**17**	**4,683,017**

Burimi: IVMT Kamëz, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me arkëtimin e gjobave të vendosura nga IVMT, konstatohet se bashkia nuk ka marrë të gjitha masat për arkëtimin e tyre.
Për periudhën objekt auditimi janë arkëtuar **17** gjoba në vlerën **2,170,338 lekë** dhe janë të pa arkëtuara **17** gjoba në vlerën **4,683,017 lekë,** duke **sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej 4,683,017 lekë.**

Sa më sipër, u konstatua se për të gjitha praktikat IVMT, DTTV-ja, dhe Drejtoria Juridike nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Kamëz në vlerën prej **4,683,017 lekë,** në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", i ndryshuar, neni 16/a që përcakton se: "Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit".
Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se nuk është bërë asnjë kërkesë për të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit të gjobave, veprim ky në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 *"Për Kundërvajtjet Administrative"* neni 9, 22 dhe neni 30 (4) i cili përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:
a) kryetari i bashkisë;
b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative.
Në zbatim të VKB nr. 113 datë 19.11.2021, është ngarkuar Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kamëz, për vjeljen e gjobave të vendosura nga IVMT.
Vlen të theksojmë se në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 *"Për Kundërvajtjet Administrative"* neni 22 (1) i cili përcakton se:
Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligji.
Sipas të dhënave të administruara në komunikimet elektronike me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se kjo drejtori***e ka të pamundur të zbatojë masa shtrënguese për gjobat administrative pasi nuk gjen mbështetjen e duhurligjore.***
DTTV, për zbatimin dhe funksionimin e saj mbështetet në përcaktimet ligjore të bëra Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë"* dhe Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar. Në këto ligje përcaktohet mënyrae mbledhjes me forcë të detyrimeve nga administrata tatimore referuar ***taksave dhe tarifave, vetëm për subjektet tregtare.***
Nga kontrolli i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DTTV, nuk rezultoi të ketë asnjë korrespodencë shkresore apo elektronike midis DTTV dhe Drejtorisë Juridike mbi pamundësinë e saj për ndjekjen e të gjitha rrugëve ligjore, me qëllimin arkëtimin e gjobave.
Vlen të theksojmë se në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 *"Për Kundërvajtjet Administrative"*, neni 46 përcakton se: "Me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe, ***dënimi administrativ, i nxjerrë nga organi i administratës publike, i cili nuk ekzekutohet me kalimin e dy viteve nga data e nxjerrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, parashkruhet.***
Për rrjedhojë, mos marrja e asnjë mase nga ana e DTTV –së mund të sjellë mos ekzekutim dhe parashkrim të këtyre gjobave.
Gjithashtu, në ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 *"Për Kundërvajtjet Administrative"*, neni 44 përcakton se: "Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga detyra".
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtuan me zgjedhje procedurat e ndjekura nga IMTV për ndërtimet informale të ndërtuara pa leje ndërtimi dhe për objektet në shkelje të lejes së N.

Situata 2.

I. Dosja e subjektit A.B

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 11.05.2022, Inspektorët e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, pranë Bashkisë Kamëz, **B.P** dhe **D.S,** kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) **A.B** me adresë: Rruga 'Shejnaze Juka', Babrru, Paskuqan, u konstatuan punime pa leje përkatëse.

Inspektorët e IVMT, me procesverbalin nr. 17, datë 11.05.2022, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse, veshje e mureve me sistem kapot.

Me vendimin nr. 22, datë 16.05.2022 nga kryeinspektori është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën ***prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë***.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

- VKB nr. 113 datë 19.11.2021, ka ngarkuar Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kamëz, për vjeljen e gjobave të vendosura nga IVMT. Pasi është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë, konstatohet se nga IVMT-ja, arkëtimi i detyrimit, nuk është shoqëruar me kamatë vonesë bazuar në masën e gjobës, në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit Nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" i ndryshuar.

Situata 3.

II. Dosja e subjektit SH.XH.H

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 28.12.2021, nga Inspektorët e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, pranë Bashkisë Kamëz, **B.P** dhe **D.S,** kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) **SH.XH.H** me adresë: Rruga 'Mustafa Xhani', Babrru, Paskuqan, u konstatua ndërtim pa leje.

Inspektorët e IVMT, me procesverbalin nr. 07, datë 28.12.2021, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për ndërtim pa leje (konstruksion metalik).

Me vendimin nr. 23, datë 05.01.2022 nga kryeinspektori është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën ***prej 1,027.616 (një milion e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë***.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë..

-Në dosje mungon procesverbali për ekzekutimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm nga Kryeinspektori, ku për ekzekutimin e këtij urdhri duhet të ngarkohen inspektoret e IVMT-së, në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjitnr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

- VKB nr. 113 datë 19.11.2021, ka ngarkuar Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kamëz, për vjeljen e gjobave të vendosura nga IVMT. Pasi është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë, dhe nga ana e tij nuk është marrë asnjë masëpër të arkëtuar gjobën brenda afateve të përcaktuara në ligj, konstatohet se **nuk është vijuar me procedurën e mbledhjes me forcë të detyrimit** në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në Ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 *"Për Kundërvajtjet Administrative"* neni 31 pika (2) i cili përcakton se:

Për gjobat e vëna nga organet shtetërore, të cilat, sipas parashikimit të ligjit të posaçëm, kanë struktura për mbledhjen me forcë të detyrimeve, urdhri i ekzekutimit vihet në zbatim me urdhër të titullarit nga strukturat e ngarkuara për mbledhjen me forcë të detyrimeve,

dhe neni 9 i cili përcakton se: Vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, ***për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarimor, sipas këtij ligji.***

Situata 4.

III. Dosja e subjektit M.A.Sh

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 16.12.2022, nga Inspektorët e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, pranë Bashkisë Kamëz, **A.Ç** dhe **D.S,** kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) **M.A.SH** me adresë: Rruga 'Mërkuri', Lagjja nr. 7, Bathore, u konstatuan punime pa leje përkatëse.

Inspektorët e IVMT, me procesverbalin nr. 09, datë 16.12.2022, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse, mure me blloqe betoni.

Me vendimin nr. 11, datë 23.12.2022 nga kryeinspektori është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën ***prej 277,456 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë***.

Me shkresën nr. 11797 prot., datë 19.12.2022 i kanë dërguar për njoftim zj. M.A.SH, procesverbalin nr. 09 datë 16.12.2022 "*Për Konstatimin e Kundërvajtjes"*

Me shkresën nr. 11797/1 prot., datë 19.12.2022, i kanë dërguar për njoftim zj. M.A.SH, Vendimin nr. 02 datë 16.12.2022"*Për pezullimin e punimeve"*.

Me shkresën nr. 12008 prot., datë 23.12.2022 i kanë dërguar për njoftim zj. M.A.SH, Vendimin nr. 11 datë 23.12.2022"*Për dënim me gjobë"*.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë

- VKB nr. 113 datë 19.11.2021, ka ngarkuar Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kamëz, për vjeljen e gjobave të vendosura nga IVMT. Pasi është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë, dhe nga ana e tij nuk është marrë asnjë masëpër të arkëtuar gjobën brenda afateve të përcaktuara në ligj, konstatohet se **nuk është vijuar me procedurën e mbledhjes me forcë të detyrimit** në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në Ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 *"Për Kundërvajtjet Administrative"* neni 31 pika (2) i cili përcakton se:

Për gjobat e vëna nga organet shtetërore, të cilat, sipas parashikimit të ligjit të posaçëm, kanë struktura për mbledhjen me forcë të detyrimeve, urdhri i ekzekutimit vihet në zbatim me urdhër të titullarit nga strukturat e ngarkuara për mbledhjen me forcë të detyrimeve,

dhe neni 9 i cili përcakton se: Vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, ***për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarimor, sipas këtij ligji.***

Kriteri:

Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar; Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore", Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative".

Impakti: Mos zbatim i kuadrit ligjor në fushën e inspektimit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme.

Shkaku: Personeli i pakualifikuar dhe neglizhencë në kryerjen e detyrës nga IVMT dhe DTTV.

Rëndësia: E lartë

Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi: (1. z. **A.L** , në cilësinë e Kryeinspektorit të IVMT-së; 2. zj. **R.H**, në cilësinë e Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore; 3. z. **E.B** , në cilësinë e Drejtorit të DTTV- së; 4. z. **E.B** , në cilësinë e Drejtorit të DPZHT-së; 5. z. **E.L ,** në cilësinë e juristit të IVMT-së).

Nga përfaqësuesit e Bashkisë Kamëz, **z. J.D ,** me shkresën nr. 873/7 prot., datë 04.03.2024, janë paraqitur observacione përkatësisht si në vijim:

Pretendimi i subjektit:

1.Sa i përket pikës **I**, për auditimin mbi plotësimin e kritereve arsimore për punonjësit e IVMT, në lidhje me arsimin e tre inspektorëve, theksojmë se punësimi ka ndodhur më parë për shkak të vështirësive që ka për punësimin në këtë pozicion pune, duke qenë se është i vështirë rekrutimi në këtë pozicion pune, pasi nuk pranojnë të punësohen, por duhet theksuar se nuk janë punësuar në vazhdim punonjës pa arsim të lartë sipas kërkesave ligjore, gjithashtu ju informojmë se njëri nga tre inspektorët që keni konstatuar me arsim jo sipas kritereve ligjore, është diplomuar dhe ka dorëzuar kopje të gjithë dokumenteve pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore konkretisht punonjësi me detyrë inspektor z. A.M .

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit pasi shqyrtoi observacionet e sjella sqarojnë se:

-Përsa i përket kritereve të arsimimit, vlen të ritheksojmë se në **ligjin Nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e N", i ndryshuar, neni 11** "Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit", përcakton se: "Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjes vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së N, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

-Në observacionet tuaja, ju keni paraqitur dokumentacion shtesë mbi diplomimin e një prej inspektorëve të IVMT-së, konkretisht z. A.M .

Për sa më sipër, **grupi i auditimit e merr në konsideratë** dhe ka kryer reflektimin në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Pretendimi i subjektit:

2. Sa i përket pikës **II** për auditimin mbi ekzekutimin e vendimeve me gjobë të IVMT, për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara ku nga ana juaj është konstatuar se, janë vjelë vetëm 9 (nëntë) gjoba dhe se janë të pa arkëtuara 26 (njëzet e gjashtë gjoba): paraqesim listën e pagesave të gjobave të IMT për vitin 2022; (*të marra nga Dr. fIncës deri në muajin dhjetor 2023)*. Theksojmë se për vitin 2022 janë të paguara; 15 (pesëmbëdhjetë) vendime me gjobë të rekomanduar nga KLSH, +16 (gjashtëmbëdhjetë) vendime me gjobë = 31 vendime me gjobë të ekzekutuara plotësisht; + 3 (tre) subjekte të dënuar me vendim me gjobë të cilët kanë nënshkruar Akt-Marrëveshje për pagesë me këste, pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore; gjithsej 34 (tridhjetë e katër) subjekte debitorë të cilët kanë paguar në mënyrë vullnetare.

Pra, dalim në konkluzionin se, nuk janë 26 vendime të pa arkëtuara, por 15 vendime me gjobë të cilat janë në proces për t'u vjelë, për këto 15 vendime do të procedohet me marrjen e masave sipas ligjeve në fuqi për ekzekutimin e tyre.

Në lidhje me konstatimin tuaj të përshkruar në situatën nr.2 sa i përket dosjes së subjektit A.B ku keni theksuar se nuk është vijuar me procedurën e mbledhjes me forcë të detyrimit; ju informojmë se, detyrimi i këtij subjekti është ekzekutuar, (*ku është paraqitur në listën e pagesave, marrë nga Dr. financës deri në muajin dhjetor 2023*).

-Në lidhje me konstatimin tuaj sa përket mos përcjelljes së inforM onit periodik pranë IKMT brenda afateve që përcakton Neni 5 germa (f) e Ligjit Nr.9780 datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*" *i ndryshuar* ; evidentojmë faktin se gjatë vitit 2022 është përcjellë ky inforM on sipas afateve ligjore dhe se tejkalimi i këtij afati ka ndodhur vetëm për tremujorin tretë të vitit 2022, për arsye se IKMT ka ushtruar kontroll gjatë muajit shtator pranë IMT, ku jemi njoftuar me anë të shkresës nr.3786/1prot., datë 29.08.2022, protokolluar në Bashki me nr.7701 datë 01.09.2022.

Sa i përket konstatimit tuaj për mos ekzekutimin e vendimeve për prishjen e objekteve, IMT ju ka informuar gjatë periudhës së auditimit me anë të shkresave që kemi dërguar pranë IKMT për mbështetje me mjete si dhe shkresat drejtuar organeve përkatëse për miratimin e një fondi, për pajisjen me mjetet e nevojshme për ekzekutimin e këtyre vendimeve, duke qenë se ne si institucion nuk disponojmë mjete për të realizuar ekzekutimin e tyre.
Sa i përket mungesës së kërkesave për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit theksojmë se përderisa në zbatim të VKB Nr.113 datë 19.11.2021, ka qenë e ngarkuar Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kamëz, për vjeljen e gjobave të vendosura nga IVMT Bashkia Kamëz.
Pra, gjendemi përpara faktit se për periudhën e auditimit ka qenë kompetente Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e cila ka në përbërjen e saj struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve të IVMT-së Bashkia Kamëz., pra, duke qenë se të dy institucionet janë në varësi të Bashkisë Kamëz dhe se IVMT nuk ka kontrata me shërbimin përmbarimor privat apo shtetëror.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, grupi i auditimit pasi shqyrtoi observacionet e sjella sqarojnë se:
-Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Kamëz për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, u konstatua se niveli i arkëtimeve ishte i ulët.
Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga IVMT dhe Drejtoria e FIncës u konstatua se ishin arkëtuar **9** gjoba në vlerën **1,248,930 lekë** dhe rezultonin të pa arkëtuara **26** gjoba në vlerën **5,604,425 lekë.**
Në observacionet tuaja, ju keni paraqitur dokumentacion shtesë për arkëtime të reja të gjobave. Për sa më sipër, **grupi i auditimit e merr në konsideratë** dhe ka kryer reflektimin në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.
-Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, mbi tejkalimin e afateve të përcaktuara në nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", për inforM onin periodik pranë IKMT-së, grupi i auditimit sqaron se observacioni **nuk merret në konsideratë** pasi pretendimi juaj referuar rastit konkrete nuk gjen mbështetje ligjore.
-Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, mbi mungesën e fondeve për ekzekutimin e vendimeve të prishjes, grupi i auditimit pasi shqyrtoi observacionet e sjella sqarojnë se në ligjin nr. 107/2014 neni 52 (6) përcakton se: ***"Për prishjen e ndërtimeve përmban edhe detyrimin e prishjes së menjëhershme të N dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit ".***
Për sa më sipër, observacioni **nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.
-Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, mbi kërkesat për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit, grupi i auditimit pasi shqyrtoi observacionet e sjella sqarojnë se Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 *"Për Kundërvajtjet Administrative"* neni 9, 22 dhe neni 30 (4) i cili përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:
a) kryetari i bashkisë;
b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative.
Për sa më sipër, observacioni **nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

Pretendimi i subjektit:

3. Sa i përket pikës III për auditimin mbi zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të N; Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, do të ushtrojë kontrolle të vazhdueshme në gjithë territorin e Bashkisë Kamëz, për ndërtimet e zhvilluara me ose pa leje ndërtimi, si dhe do t'i kërkojë bashkëpunim Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Kamëz, në mënyrë që të mbajë nën monitorim të vazhdueshëm të gjitha subjektet e pajisura me leje ndërtimi, duke filluar nga piketimi i objektit deri në mbylljen e tij, për mos devijimin e lejes së N të miratuar nga D.P.ZH.T, si dhe nëse gjen shkelje të marrë masa në zbatim të kompetencave si dhe në referim të bazës ligjore si më poshtë vijon.
Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*" *i ndryshuar*; Ligjin Nr.107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar*; Ligji Nr.8402, datë 10.9.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të N"* i përditësuar; VKM nr.408 datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*" *i ndryshuar me VKM Nr.457 datë 29.06.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 408 2015"*; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*";
Sa u përket ndërtimeve pa leje theksojmë se, në territorin juridiksional /administrativ të Bashkisë Kamëz, Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit ka ushtruar kontrolle të vazhdueshme në gjithë territorin e Bashkisë Kamëz, për ndërtimet e zhvilluara pa leje, me leje ose ne tejkalim të lejes së dhënë, dhe ka mbajtur rast pas rasti procedurat sipas bazës ligjore të sipërcituar.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
-Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në lidhje me, akt kontrollet dhe bashkëpunim me DPZHT, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.
Për sa më sipër, observacioni **nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

2.7. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

2.7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.
2.7.2. Realizimi programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.
2.7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm.

Auditimi i fundit në Bashkinë Kamëz është kryer në vitin 2022, për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2021. Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar sipas shkresës përcjellëse Nr. 1023/12, datë 25.04.2023, regjistruar në Bashkinë Kamëzme shkresë Nr. 3548 prot. datë 26.04.2023. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimitjanë rekomanduar gjithsej:
a. Janë rekomanduar **26 masa organizative**;
b. Janë rekomanduar **7 masa për shpërblim dëmi me vlerë 2,167,771 lekë*;***
c. Është rekomanduar **1 masë për eleminimin e efekteve negative të përdorimit të fondeve publike;**
d. Janë rekomanduar **6 masa për uljen e borxhit tatimor;**
e. Janë rekomanduar **13 masa disiplinore*;***

Titulli i gjetjes: Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit të KLSH, në Bashkinë Kamëz.

Situata:
Grupi i auditimi zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSh-së ku rezulton se, nga Bashkia Kamëz janë marrë masa lidhur me zbatimin e rekomandimeve, përkatësisht:
Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve dërguar me shkresën Nr. 1023/12, datë 25.04.2023, rezulton se:
Bashkia Kamëz për zbatimin e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 3972/1 prot., datë 15.05.2023, brenda afatit ligjorë të **20 ditëve, si** dhe ka hartuar "Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve", duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.
Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor**, Bashkia Kamëz për zbatimin e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7672/1 datë 12.10.2023, brenda afatit ligjorë.
Relacioni mbi zbatimin e rekomandimeve është paraqitur në mbledhjen e **Këshillit Bashkiak** të datës 22.05.2023 dhe të datës 20.09.2023
Është hartuar plani i veprimit për zbatimin e rekomandimveme nr. 3972 prot., datë 12.05.2022, ku është përcaktuar struktura dhe punonjësit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Rezulton se nga 53 rekomandime të lëna në total, janë pranuar plotësisht të gjitha.
Masa Organizative
- Nga 26 masa organizative; 9 rekomandime janë zbatuar, 10 rekomandime janë pjesërisht të zbatuara, 7 rekomandime janë në proces zbatimi.

Masa Shpërblim Dëmi
- Nga 7 masa për shpërblim dëmi; 6 rekomandimei janë zbatuar dhe 1 rekomandim është pjesërisht i zbatuar.

Masa për eleminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike
- Nga 1 masë për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike edhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike; 1 rekomandim është i zbatuar.

Masa për uljen e borxhit tatimor
- Nga 6 masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore; 6 rekomandime janë pjesërisht të zbatuara.

Masa Disiplinore
- Nga 13 masa disiplinore; 13 rekomandime janë zbatuar.

Në përfundim rezulton se:
Janë zbatuar gjithsej 29 rekomandime: 9 rekomandime nga masa organizative ; 6 rekomandime nga masa për shpërblim dëmi; 1 rekomandim nga masa për eleminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike; 13 rekomandime nga masa disiplinore.
Janë pjesërisht të zbatuara 17 rekomandime: 10 rekomandime nga masa organizative; 1 rekomandim nga masa për shpërblim dëmi; 6 rekomandime masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore
Janë në proces zbatimi 7 rekomandime: 7 rekomandime nga masa organizative.
Janë të pa zbatuara: 0 rekomandime.
Në total janë rekomanduar gjithsej **53 masa,** të cilat janë pranuar nga subjekti. Nga të pranuara janë zbatuar 29 masa ose 54.7 %, 0 masa të pazbatuara ose 0% dhe 24 masa pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi ose 45.3%.

Përmbledhëse e zbatimit të rekomandimeve

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusii zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar

			plotësisht	pjesërisht	zbatimi	
1.	Organizative	26	9	10	7	-
2.	Shpërblimdëmi	7	6	1		-
3.	Për eleminimin e efekteve negative të përdorimit të fondeve publike	1	1	-	-	
4.	Përuljen e borxhit tatimor	6	-	6	-	
5.	Masadisiplinore	13	13	-	-	-

Kriteri: Neni 15, gërma j) dhe neni 30 pika 2 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi plotësisht i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit të kryer në Bashkinë Kamëz ka sjellë mungesë të ardhurash nga mos shpërblimi i dëmit, si dhe nga mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore. Gjithashtu, mos zbatimi i plotë i rekomandimeve ndikon në uljen e efektivitetit të shërbimeve institucionale, si dhe në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Kamëz.
Shkaku: Mos ndjekja e të gjitha procedurave nga ana e njësive përgjegjëse, të Bashkisë Kamëz, për të bërë të mundur zbatimin plotësisht të rekomandimeve të lëna.
Rëndësia: E lartë

2.8. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

Në zbatim Programit të Auditimit me me nr. 873/1 prot, datë 10.10.2023, i ndryshuar, pika 8 "Të ndryshme të dala gjatë auditimit", **u krye auditimi i ankesës së z. B. D. administrator i "B" SHPK,** protokolluar dhe administruar në KLSH me nr. 820 Prot., datë 25.09.2023, me lëndë "Ankesë" në lidhje me lejen e zhvillimit dhe N të një kompleksi blegtoral dhe agroturizmi.

Në këtë ankesë citohet:
Shoqëria "B" SHPK ka lidhur në datën 24.01.2019 kontratë qiraje me Bashkinë Kamëz me nr. 258 Rep dhe nr. 126 Kol për marrjen e sipërfaqes së tokës të llojit "zallishtë" me nr. 157 pasurie, vol. 3, faqe 200, ZK 2372 më sipërfaqe 12.400 m^2 nga ku janë pajisur dhe me lejen e zhvillimit dhe N të një kompleksi blegtoral dhe agroturizmi si më poshtë vijon:
Me vendimin nr. 08 me Nr. identifikimi 123 me nr. 902 Prot., datë 13.02.2019 është lëshuar nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Drejtoria e Vlerësimit Mjedisor Vendimi për VMN paraprake në favor të "B" SHPK.
Nga Bashkia Kamëz është lëshuar në favor të "B" SHPK miratimi për lejen e zhvillimit nr. 801 datë 02.05.2019 si dhe miratimi për lejen e N nr. 932 datë 27.06.2019.
Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është ngritur një kërkesë padi me palë paditëse banorët e Njësisë Administrative Laknas si dhe nga Shoqata e Bujqësisë Organike dhe me palë të paditur Bashkinë Kamëz dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, *me objekt pavlefshmërinë absolute të lejes së zhvillimit* nr. 801 datë 02.05.2019 lëshuar nga Bashkia Kamëz, *pavlefshmërinë absolute të lejes së N* nr. 932 datë 27.06.2019 lëshuar nga Bashkia Kamëz si dhe *pavlefshmërinë absolute të VNM* lëshuar në favor të "B" SHPK nga ana e AKM.
Pretendimi i palës paditëse vjen për faktin se ndërtimi i objektit sipas akteve administrative objekt gjykimi cënon rëndë të drejtat dhe interesat e tyre si banorë të zonës pasi leja është dhënë për tu zhvilluar mbi një pyll që është pronë e Bashkisë Kamëz dhe, shfrytëzohet nga banorët si zonë e gjelbër pushimi dhe qëndrimi nga ku përfshihet edhe prerja e pemëve të cilat janë mbi 35 vjeçare.
Me vendimin nr. 127 regj. datë 30.10.2019 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

Me vendimin nr. 83 regj. datë 11.12.2020 Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 127 regj. datë 30.10.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë.
Me vendimin nr. 1259 regj. datë 30.07.2021 Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 83 regj. datë 11.12.2020 të Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 127 regj. datë 30.10.2019 të Gjykatë Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
Në lidhje me themelin e çështjes Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 825 regj. datë 16.03.2022 ka vendosur pranimin e kërkesës për pavlefshmërinë absolute të akteve administrative të lëshuara nga Bashkia dhe AKM.
Kundër vendimit të shkallës së parë ka ushtruar të drejtën e ankimimit Avokatura e Shtetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit si dhe "B" SHPK, ndërkohë që Bashkia Kamëz nuk ka ankimuar dhe nuk ka qenë prezente as në seancat gjyqësore të shkallës së parë.
Përgjatë gjithë procesit gjyqsor "B" SHPK ka mbajtur korrespondenca të vazhdueshme me Bashkinë Kamëz ku shprehin dhe shqetësimin dhe kërkesën për inforM on nga bashkia me pretendimin se demonstrohet me fakte shkelja e ligjshmërisë nga ana e tyre (ku përfshihet dhe kërkesat pa përgjigje për ti vënë në dispozicion faturën për pagesën e qirasë sipas kontratës).
Përkatësisht shkresat:
Shkresa e dërguar datë 24.11.2022 drejtuar Bashkisë Kamëz
Shkresa e dërguar datë 19.12.2022 drejtuar Bashkisë Kamëz
Shkresa e dërguar datë 11.01.2023 nga Bashkia Kamëz drejtuar "B" SHPK *(kthim përgjigje ku shprehet se mosfillimi i punimeve dhe pezullimi i lejes së N vijnë nga pamundësia e vazhdimit të proçedurave të mëtejshme deri në shpalljen e një vendimi gjyqsor të formës së prerë*)
Shkresa e dërguar datë 18.01.2023 drejtuar Bashkisë Kamëz
Shkresa e dërguar datë 20.01.2023 drejtuar Bashkisë Kamëz

Grupi i auditimit të KLSH-së, kërkoi informacion nga Bashkia Kamëz në lidhje me objektin e kërkesës së bërë nga ana e "B" SHPK, me administrator B. D.
Bashkia Kamëz vuri në dispozicion dokumentet, si vijon:
1. Njoftim i dërguar nga ana e "B" SHPK drejtuar Prefekturës së Qarkut Tiranë dhe Bashkisë Kamëz me nr. 203 Prot. e datës 13.01.2020.
2. Kthim-përgjigje nga ana e Bashkisë Kamëz me nr. 203/1 Prot. e datës 15.01.2020.
3. Shkresën e dërguar nga ana e "B" SHPK drejtuar Bashkisë Kamëz me datë 24.11.2022 protokolluar me Nr. 11197 Prot. datë 01.12.2022
4. Kthim-përgjigje nga ana e Bashkisë Kamëz me nr. 11197/1 Prot. e datës 13.12.2022.
5. Shkresën e dërguar nga ana e "B" SHPK drejtuar Bashkisë Kamëz me datë 19.12.2022 protokolluar me Nr. 11915 Prot. datë 21.12.2022
6. Kthim-përgjigje nga ana e Bashkisë Kamëz me nr. 11915/1 Prot. e datës 11.01.2023.
7. Ankesa e dërguar nga ana e "B" SHPK drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale B. D. dhe për Dijeni Kryetarit të Bashkië Kamëz, R.Sprotokolluar me nr. 3071 Prot datë 05.04.2023.
8. Ankesa e dërguar nga ana e "B" SHPK drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit O.M dhe për dijeniKryetarit të Bashkië Kamëz, R.S protokolluar me nr. 4123 Prot datë 19.05.2023.
9. E-mailet në lidhje me korrespondencën e mbajtur mes Bashkisë Kamëz dhe "B" SHPK
10. Vendimin nr. 127 regj. datë 30.10.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ku Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

(Protokolluar pranë Bashkisë Kamëz me nr.6792 Prot. datë 08.11.2019)

11. Vendimin nr. 83 regj. datë 11.12.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë ku Gjykata ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 127 regj. datë 30.10.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë. (Protokolluar pranë Bashkisë Kamëz me nr.6792 Prot. datë 08.11.2019)
12. Vendimin nr. 825 regj. datë 16.03.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ku Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës për pavlefshmërinë absolute të akteve administrative të lëshuara nga Bashkia dhe AKM.(Protokolluar pranë Bashkisë Kamëz me nr.2568 Prot. datë 30.03.2022)

Konstatim:

Pas kryerjes së verifikimeve të dokumentacionit të vënë në dispozicion Zyrën e Protokollit në Bashkinë Kamëz, Grupi i auditimit, duke vlerësuar rëndësinë dhe qëllimin e ankesës së bërë nga shoqëria "B" SHPK, ku me datë 24.01.2019 ka lidhur kontratë qiraje me Bashkinë Kamëz me Nr. 258 Rep dhe Nr. 126 Kol për marrjen e sipërfaqes së tokës të llojit "Zallishtë" me Nr.157 pasurie, vol. 3, faqe 200, ZK 2372 më sipërfaqe 12,400 m 2 ku nga Bashkia Kamëz është pajisur me leje zhvillimi me Nr. 801 datë 02.05.2019, me leje ndërtimi Nr. 932 datë 27.06.2019 për objektin "kompleks blegtoral dhe agroturizmi" dhe, VNM lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), ***bën me dije se nuk mund të kryej auditim mbi pavlefshmërinë absolute të lejes së zhvillimit, të lejes së N si dhe VNM-në lëshuar nga AKM***, në favor të shoqërisë "B" SHPK (kërkuar nga banorët e zonës Laknas), pasi çështja është duke u gjykuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas Vendimit me Nr. 825 regj. datë 16.03.2022, në zbatim të Vendimit me Nr. 1259 regj, datë 30.07.2021 të Gjykatës së Lartë ku ka vendosur prishjen e vendimit me Nr. 83 regj. Datë 11.12.2020 të Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 127 regj. datë 30.10.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në këto kushte, referuar ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", neni 36, paragrafi 3-të i cili përcakton shprehimisht se: ***"Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile e cila është duke u gjykuar nga gjykata****".*
Për këtë arsye, grupi i auditimit nuk mund të dalë me një konkluzion.

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin fInciar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të tij, si më poshtë vijon:
Bashkia Kamëz nuk ka hartuar plan veprimi për kontrollin e brendshëm dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij Plani. Nuk janë hartuar programe trajnimi për ruajtjen dhe ngritjen e nivelit profesional të punonjësve, si dhe njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin fInciar dhe kontrollin rezultojnë të jenë jo në nivelin e duhur. Në dosjet e personelit ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Evidentohen problematika në hartimin e regjistrit të konsoliduar të risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Kamëz si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre. Nga auditimi rezultoi se drejtori me risk si DTTV nuk kanë hartuar regjistër risku. Bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Mungojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës dhe nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për aktivitetin e kontrollit. Gjurma e auditimit nuk përfshin të gjitha proceset kryesore të punës.
Sistemi i raportimit nuk jep inforM on për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Nga auditimi u konstatua mungesa një sistemi deklarimi efikas dhe të përpiktë, duke përfshirë nivelet dhe afatet për deklarimin, llojet e deklaratave që i dorëzohen menaxhimit, format e deklaratave për rastet e zbulimit të gabimeve, të parregullsive, të abuzimit, të mashtrimit ose të përvetësimit.
Bashkia Kamëz nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këtë bashki.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin fInciar dhe kontrollin*", i ndryshuar; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*"; Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordItorit të menaxhimit fInciar dhe kontrollit dhe koordItorit të riskut në njësitë publike*"; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të FIncave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 12-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.**
<u>1.1. Rekomandimi:</u> Nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, KoordItori i Riskut dhe KoordItori i MFK -së të merren masa për:
-Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performancë, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
-Hartimin e procedurave të shkruara mbi rregullat e raportimit, i cili nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në çështjet fInciare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performancë dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva.

-Përditësimin e regjistrit të konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.
-Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.
-Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Kamëz përgjatë vitit 2022, u konstatua se:
Burimet në dizpocion të strukturës audituese kanë mungesë të përvojës së punës në profesion dhe në auditim, ku konstatohet se janë rekrutuar 2 (dy) audituese të cilat nuk kanë eksperiencë në punë si auditues të brendshëm dhe nuk ka filluar procesin e certifikimit për 1 (një) audituese, veprime në kundërshtim me përcaktimin e bëra në Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 12-33 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Kamëz dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masat e duhura që, në vijimësi, emërimi i punonjësve të rinj në strukturën e NJAB të bëhet në përputhje me kuadrin regullativ ligjor të rekrutimeve në punë.
-Mbylljen e certifikimit dhe trajnimin e audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore mbi veprimtarinë e IVMT Bashkia Kamëz, u konstatua se ka ushtruar funksionet e veta jo në përputhshmëri të plotë me detyrimet që përcakton ligji për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme dhe ai për planifikimin e territorit.
Nga auditimi i plotësimit të kritereve arsimore të punonjësve të IMT-së, u konstatuan 3 emërime për pozicionin e punës së inspektorit që nuk plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm , në bazë të legjislacionit në fuqi, pasi formimi profesional i tyre është në mospërputhshmëri me kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit Nr. 9780 datë 16.07.2007 "*Për Inspektimin e N*", i ndryshuar. InforM oni periodik 3(tre) - mujor për IKMT, nuk është përgatitur sipas afateve të përcaktuara në nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*". Plani vjetor i punës nuk ka në përmbajtje të tij prioritetet, objektivat, indikatorët e performancës dhe aktivitetet/masat që do të mundësojnë realizimin e tyre por përmban përshkrimet e detyrave të kryeinspektorit dhe inspektorëve. Kryeinspektori, nuk ka miratuar planet mujore të punës, veprim ky në mospërputhje me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore". Për **10** vendime për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, nuk është mbajtur asnjë procesverbal për ekzekutimin e vendimit të prishjes së këtyre ndërtimeve. Nga kontrolli i dokumentacionit, konstatohet mungesa e një bashkëpunimi efiçent, midis IVMT-së dhe DPZHT-së, për shkëmbimin e informacdionit mbi lejet e zhvillimit, N, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit, në mospërputhje me pikën (3) të nenit 51 në Ligjin nr.107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar; VKM-në nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 79-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masat

- Në strukturën organizative të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të punësohen vetëm ata punonjës të cilët plotësojnë kriteret e duhura kualifikuese arsimore.
- Plani vjetor i punës të përmbajë prioritetet, objektivat, indikatorët e performancës dhe aktivitetet/masat që do të mundësojnë realizimin e tyre.

3.2. Rekomandimi: Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Bashkia Kamëz, të marrë masa si vijon:

- Mos lejimin e zhvillimit të N në kushtet e mungesës së lejes së zhvillimit dhe të N të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Në çdo rast që konstatohet shmangie nga projekti i miratuar, përveç ndëshkimit me masë administrative, heqjen e licencës profesionale për personat përgjegjës, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim forcimin e masave për kontrollin e territorit dhe mbrojtjen e tij nga ndërhyrjet abuzive.
- Mbajtjen e akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e N dhe planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit.
- Të aplikojë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave, të pezullimit dhe të prishjes së ndërtimeve.
- Në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që të zbatojë vendimet e prishjes së objekteve për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti. Gjithashtu, të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.
- Rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Planifikim Kontroll Zhvillim Territorit, për shkëmbimin e inforM onit midis tyre. Realizimin e kontrolleve periodike mbi objektet në zhvillim, të pajisur me leje ndërtimi, për të verifikuar nëse zbatimi i punimeve kryhet sipas projektit të miratuar.
- IVMT Bashkia Kamëz të marrë masa për të përgatitur inforM on periodik tre mujor ndaj Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe dhe vendimet e marra.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. G jetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin e programeve sipas prioriteteve vendore dhe institucionale, u konstatua se:

- Nga Bashkia Kamëz, PBA 2022-2024 dhe Plani vjetor i buxhetit 2022 janë miratuar së bashku, pa miratuar veçmas Planin Vjetor të buxhetit 2022, sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 29;
- Bashkia Kamëz nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t'i kushtuar rëndësi programeve: 056-"Ndërgjegjësimi mjedisor" si programe që lidhen ngushtë me 051-"Menaxhimi i mbetjeve"; 041-"Mbështetje për zhvillim ekonomik"; 072/2 - "Shërbimi shëndetësor", 102 "Të moshuarit", 105 "Papunësia",

mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë, tregon për një shërbim ku është cënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 23-30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik me KoordItorin e MFK, KoordItorin e Riskut dhe Drejtoria e fIncës dhe kontabilitetit, të marrin masa që me hartimin e PBA-së dhe Planit vjetor të buxhetit, të miratojnë në Këshillin Bashkiak veçmas Planin vjetor të buxhetit; duke i kushtuar vëmendje planifikimit në buxhet të fondeve për ato programe që kanë të bëjnë kryesisht me ndërgjegjësimin mjedisor, shërbimin shëndetësor dhe punësimin.

Menjëherë e në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi mosrealizimin e planeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin dhe zbatimit të dispozitave ligjore u konstatuan:

-Nga analiza e të dhënave të buxhetit u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit dhe atë zbatimit të buxhetit me burim financimi nga të ardhurat e veta në vlerën 1,597,204 mijë lekë dhe shpenzimit të tyre në vlerën 1,061,114 lekë; kështu nga të ardhurat e veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2021 dhe 2022 të ketë mosrealizime, por vlera e realizimit të buxhetit vjen me trend në rritje nga 83.4% për vitin 2021 në 84.9% për vitin 2022;

- Me VKB nr. 132 datë 22.12.2021 "Për miratimin e PBA dhe planit vjetor 2022" është miratuar Fondi Rezervë (FR) në vlerën 30,400 mijë lekë, Fondi i Kontigjencës (FK) në vlerën 15,000 mijë lekë dhe në total në vlerën 45,400 mijë lekë, kur mbështetur në ligjin nr. 9936/2008 "Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë" këto fonde duhej të llogariteshin deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara. Janë miratuar 109,026 mijë lekë më pak ose rreth 39.4% të vlerës që duhej të planifikohej dhe se Fondi i Kontigjencës për vitin 2022 është përdorur plotësisht kurse Fondi Rezervë nuk është përdorur;

-Referuar kritereve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi nga ana e Pushtetit Vendor/Bashkitë, u konstatua se për vitin 2022 fondi për emergjencat civilenga të ardhurat e veta është planifikuar në vlerën e 26,513 mijë lekë, nga i cili është shpenzuar 6,260 mijë lekë dhe është trashëguar për vitin pasardhës 20,253 mijë lekë. Fondi që bashkitë duhet të kenë për emergjencat civile është në masën 4% të shpenzimeve buxhetore, ku 1% i planifikojnë nga fondet e veta dhe në masën 3% nga fondet e kushtëzuara nga buxheti i shtetit; për vitin 2022 ky fond është planifikuar (FE+MC) në vlerën 97,254 mijë lekë. Bazuar në Ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 65/1, nga auditimi rezultoi se ky fond duhet të ishte në vlerën e 102,951.04 mijë lekë, por që në fakt është planifikuar 5,697.04 mijë lekë më pak ose fondi i planifikuar përbën rreth 94.5% të vlerës që duhej planifikuar. Fondi për emergjencat civile (nga Bashkia Kamëz) është planifikuar në masën 103% dhe mbrojtja civile (nga AKMC) është planifikuar në masën 91.6%.

-Nga auditimi rezultoi se në vitin 2022 janë rritur investimet me burim të ardhurat e veta me një numër prej 33 investime dhe 1 investim me burim nga buxheti i shtetit & AKUM-i; realizimi i shpenzimit të fondit të planifikuar për "investimet" në vitin 2021 është 820,746 mijë lekë, në vitin 2022 është 939,594 mijë lekë ose 118,848 mijë lekë më shumë; ndërsa ndaj planifikimit është (-) 651,043 mijë lekë. Nga analiza e treguesve të tabelës së të ardhurave të veta, rezulton se diferenca mes realizimit faktik të të ardhurave të veta ndaj planifikimit ka trend në rritje pavarësisht se të ardhurat e veta vijnë në rritje nga viti në vit. Nisur nga sa më lart rezulton se për vitin 2022 "investimet" kanë mosrealizim kundrejt

planifikimit, por në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej 118,848 mijë lekë. Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat e veta për asnjë nga vitet (2021 dhe 2022) nuk janë realizuar, veprime këto që bien ndesh me Ligjin nr. 67 datë 27.04.2017 "Për fIncat e vetëqeverisjes vendore" neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre në vitet paraardhëse;
-Nga auditimi rezultoi se niveli i planifikimit buxhetor për investimet vjen në rritje nga viti në vit, ndërsa niveli i realizimit në total vjen në rënie nga viti 2021 në vitin 2022; nga tabela e planifikimit të shpenzimeve me burim të ardhurat e veta në vitin 2022 janë në vlerën 931,960 mijë lekë, investimet kanë mosrealizim kundrejt planifikimit në vlerën (-)146,754.8 mijë lekë; si dhe në krahasim me vitin 2021 ky mosrealizim ka një rritje prej (-)13,091.5 mijë lekë. Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet jo vetëm që nuk janë realizuar, por ka ardhur në rënie, veprime këto që bien ndesh me Ligjin nr. 67 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre në vitet paraardhëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Menjëherë e në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbizbatimin me disa pasaktësi të rregullave dhe të proçedurave të përcaktuara për përfitimet nga programi i granteve të riN, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të dala për menaxhimin e situatës së fatkeqësisë natyrore- tërmetit të 26 Nëntorit 2019, rezultoi se:
-Nga auditimi i dosjeve të 21 aplikuesve të klasifikuar si përfitues nga granti i riN dhe 4 aplikuesve të kualifikuar nga komisioni i ankimimit, rezultuan këto mangësi apo parregullsi: në 7 raste formulari i pikëzimit i pa plotësuar apo pjesërisht i plotësuar, në 4 raste mungonte konfirmimi i pronësisë nga ASHK, në 19 raste mungonte nënshkrimi i aplikuesve. Kjo si rezultat se nga ana e komisioneve të posaçme *nuk janë zbatuar rigorozisht* kërkesat e VKM nr. 05, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të riN dhe projektet model" dhe paketës së akteve nënligjore në vijim; si dhe Drejtoria e RiN nuk ka ushtruar kontroll mbi dosjet e aplikuesve të kualifikuar për fonde nga granti i riN, në moszbatim të detyrave funksionale sipas fushës së veprimtarisë dhe përgjegjësitë përcaktuar në VKB nr. 37 datë 14.01.2021 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz dhe Rregulloren e Brendshme Kapitulli IV neni 25.
-Nga auditimi i VKB-ve të miratuara mbi procesin e RiN, rezultoi se në aktet e miratuara në Këshillin Bashkiak lidhur me miratimin e përfituesve nga programet e riN për objektet e dëmtuara individuale apo kolektive dhe ato për përfituesit e bonusit të qirasë, u konstatua mungesë e informacionit statistikor në përmbajtjen e tyre, konkretisht: nuk ishte shprehur në mënyrë të përmbledhur numri i familjeve /personave përfitues nga programet e riN sipas çdo niveli apo të bonusit së qirasë si dhe vlera totale e përllogaritur; informacion i cili gjendet në listën emërore bashkëngjitur VKB-së, në moszbatim të Vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të

Republikës së Shqipërisë" neni 4 pika 4, Shtojca 1 Model 3 dhe përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative;
- Ndërsa për subjektet përfituese nga granti i riN për rikonstruksionin apo ndërtimin e objekteve të dëmtuara në listën emërore të përfituesve, nuk është vendosur vlera e masës së dëmshpërblimit të përllogaritur sipas mënyrës së miratuar (me anëtarë familje/sip banimi apo preventiv sipas rastit), në moszbatim të Vendimit nr. 5 datë 06.01.2020, Kreu II pika 8; Kreu IV pika 2 dhe tabelës A, si dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë "Metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz" miratuar me Vendimin nr. 4119 datë 11.05.2022 kapitulli IV nenet 18 e 20 pika 7.
-Nga informaciooni i pasqyruar edhe në tabelë, rezulton se: *<u>për vitin 2020</u>* janë planifikuar 340,220,000 lekë për fonde nga buxheti i riN dhe janë shpenzuar 331,762,000 lekë ose 97.5% e tyre; *<u>për vitin 2021</u>* janë planifikuar 1,371,675,640 lekë dhe shpenzuar 1,017,935,261 lekë ose 74.2%; *<u>për vitin 2022</u>* janë planifikuar 1,890,934,592 lekë dhe shpenzuar 1,630,492,994 lekë ose 86.2%. Rezulton se vlera e fondeve të planifikuara dhe të shpenzuara kanë ardhur në rritje, por në raport me vlerën e planifikimit përdorimi i tyre ka ardhur në rënie. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>6.1. Rekomandimi</u>: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik me KoordItorin e Riskut dhe KoordItorin MFK, Nëpunësi Zbatues dhe Drejtoria e RiN, të marrin masa për zbatimin me korrektësi të paketës ligjore të RiN para së gjithash për konfirmimin e titullit të pronësisë së objekteve të dëmtuara në procedurat e përfunduara si edhe për aplikuesit e kualifikuar që janë në proces, për njohjen nga menaxhimi dhe stafi me ligjin e MFK, manualeve dhe udhëzimeve përkatëse të tij, për hartimin e strategjive dhe planeve të veçanta për të parandaluar dhe menaxhuar sa më me efektivitet situatat që mund të krijohen nga fatkeqësitë natyrore në ndihmë të komunitetit.

Menjëherë e në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Mbi planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga, detyrimet kontraktuale për mallra, shërbime dhe investime:
-Nga auditimi i PBA 2022-2024/Planit vjetor 2022, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, u konstatua se fondi për detyrimet e prapambetura nuk është planifikuar veçmas në programin 04960 "planifikim për detyrimet e prapambetura", por është përllogaritur i përfshirë në fondin e secilit program që mbart detyrime; mos ndarja e fondeve sipas programeve përkatëse pra sipas destinacionit të përdorimit, ka sjellë likuidimin pjesor apo të plotë të detyrimeve të prapambetura (sipas rastit) dhe pamundësi likuiditeti të të gjitha faturave për "mallrave e shërbime" e "investimeve" të vitit ushtrimor për mungesë fondesh, duke u shoqëruar me lindjen e detyrimeve të reja dhe trashëgimin e tyre për vitin pasardhës. Rezultoi se vlera e detyrimeve të prapambetura sipas bilancit përputhet me atë të raportuar në MFE. Në gjykimin e grupit të auditimit planifikimi i fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në programin përkatës 04960, do të rezultonte me një menaxhim më me efektivitet të fondeve për çdo program të buxhetuar, në rast se nuk do të ishin reduktuar numri i programeve buxhetore për NJVQV nga MFE nëpërmjet udhëzimeve përkatëse: Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018, Udhëzimit nr. 7 datë 25.02.2022 etj.
-a) Nga auditimi rezultoi se në fund të vitit 2021 janë 17 subjekte kreditore ndaj Bashkisë Kamëz për zërin "investime" me 26 fatura të palikuiduara në vlerën totale prej 172,752,415 lekë, nga të cilat janë likuiduar plotësisht 9 fatura në vlerën 128,437,827 lekë dhe, është trashëguar për tu likuiduar në vitin 2023 sipas planit të likuidimeve 20 fatura në vlerën totale 155,500,629 lekë; u konstatua se për likuidimin e detyrimeve të prapambetura ndaj subjekteve për zërin "investime", Bashkia Kamëz nuk ka respektuar radhën për likuidimin e atyre të krijuara më herët, në kundërshtim me VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e

strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit" pika 13;
-b) Bashkia Kamëz deri në fund të vitit 2021 është debitore "për mallra e shërbime" ndaj 1 subjekti me vlerë totale të faturës së shërbimit prej 88,419,120 lekë; gjatë vitit 2022 kanë hyrë për tu likuiduar edhe 4 fatura në vlerën totale 55,261,950 lekë, prej të cilave 3 fatura janë në tejkalim të afatit 60 ditor; gjatë vitit 2022 janë likuiduar detyrimi i mbartur prej 88,419,120 lekë dhe janë trashëguar për tu paguar në vitin 2023 faturat e palikuiduara të vitit 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 57-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik me Koordinatorin e riskut dhe Drejtoria e Menaxhimit FInciar, të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrit të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve; si dhe për minimizimin e vlerës totale të 20 faturave prej 155,500,629 lekë të detyrimeve të krijuara në periUt e mëparshme për zërin "investime", për minimizimin e vlerës totale të 4 faturave prej 55,261,950 lekë të detyrimeve të krijuara në vitin 2022 për zërin "mallra e shërbime" duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre në afat dhe sipas radhës, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim zvogëlimin e vlerës se vlerës së detyrimeve të prapambetura.
7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit të bëjë planifikim sa më realist të fondeve të çdo programi në PBA dhe Planin vjetor buxhetor, si për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periUt e mëparshme duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre brenda afatit të përcaktuar dhe sipas radhës, por edhe për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit ushtrimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e zërave të pasqyrave fInciare rezultoi se:
-Nga analiza e llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", rezulton se referuar klasifikimit ekonomik kontabël/nomenklaturës së llogarive të planit kontabël, ka të listuar objekte inventarë të klasifikuara gabim, të cilat janë: në inventarin e Bashkisë Kamëz - "Ndërtim lulishte para pallatit të kulturës" viti i krijimit 2011 dhe kosto historike 3,492,744, "Lulishte te Bashkia" vit krijimi 2012 dhe kosto historike 300,793; NJA Paskuqan - "Lulishte para komunës Paskuqan" me kosto historike 478,946 dhe "Gjelbërim ambienti në Paskuqan nr. 2" me kosto historike 240,000 të cilëve u mungon viti i krijimit si aktiv, duhej të ishin regjistruar në llog. 212 ose llog. 211 në varësi të asaj çfarë përfaqëson secili rast (lulishte apo pyje /kullota). Pra në total vlera e regjistruar gabim në llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" është në shumën 4.512,483. Pra llog.213 është mbivlerësuar në vlerën 4,512,483 dhe llog.212 dhe llog 211 janë nënvlerësuar respektivisht për shumën 4,272,483 dhe 240,000. Duhet theksuar fakti që vlera neto kontabël e secilit aktiv në veçanti nuk ndryshon, pasi koeficienti i amortizimit në këtë rast është i njëjtë me 5%;
-Nga analiza e llog. 218 "inventar ekonomik" rezultoi se, kategoria "pajisje kompjuterike" nisur nga karakteristikat specifike të aktivit, nuk është ndarë si kategori më vete llog. 218/1, duke pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit, sipas Udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09.03.2018 "Për proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave fInciare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". Por nga verifikimi i analizës se llogarisë dhe regjistrit të inventarëve rezultoi se llogaritja e amortizimit për pajisjet kompjuterike është llogaritur saktë prej 25% të vlerës së mbetur. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 137-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit Bashkia Kamëz të kryejë veprimet dhe sistemimet kontabël në llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" e cila është mbivlerësuar në shumën 4,512,483 lekë, për të cilën llog. 212 dhe llog. 211 janë nënvlerësuar respektivisht me shumën 4,272,483 lekë dhe 240,000 lekë;
- Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit Bashkia Kamëz, në llog. 218 "inventari ekonomik" të klasifikojë veçmas llog. 218/1 "pajisjet kompjuterike" në regjistrin e aseteve të njësisë konformë kërkesave të nomenklaturës së llogarive.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurën e inventarizimit të aseteve në Bashkinë Kamëz rezultoi se:
- Urdhrat e Brendshëm të titullarit për inventarizimin e aseteve të Bashkisë, nuk kanë afat për përmbushjen e detyrës nga ana e komisionit të inventarizimit, duke riskuar për vonesa dhe zvarritje të procedurës së inventarizimit, në moszbatim të Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" pika 73, 74;
-Bashkia Kamëz ka hartuar dhe miratuar Rregullore "Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe "Strategjia e menaxhimit të riskut të Aktiveve të Bashkisë Kamëz" miratuar me VKB nr. 36 datë 20.03.2020. Nga auditimi rezultoi se në nenet 9 dhe 9/1 nuk është vendosur si kriter përcaktimi në procesverbalin që mbahet nga komisioni i *vendndodhjes* ku do të kryhet ekzekutimi i vendimit për asgjësimin e aktiveve për jashtë përdorimit, gjë e cila u konstatua edhe në procesverbalin e përpiluar nga komisioni i asgjësimit, në moszbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" pika 103, 107, 108, 109, 111 dhe 118;
-Lidhur me asetet e transferuara me VKM në Bashkinë Kamëz rezultoi se deri në 31.12.2022 Bashkia Kamëz nuk ka marrë masa konkrete për verifikimin në terren të të gjitha pronave dhe regjistrimin e tyre sipas statusit aktual juridik dhe destinacionit të përdorimit. Verifikimet kanë qenë sporadike, të paprogramuara sipas një grafiku. Kjo procedurë nga ana e bashkisë ka nisur mbas dërgimit të RPA të KLSH-së. Kështu me Urdhrin e kryetarit nr. 351 datë 06.06.2023 me nr. 351 prot., datë 06.06.2023 për "Ngritjen e grupit të punës për verifikimin, saktësimin, inventarizimin, plotësimin dhe përditësimin e pronave shtetërore të transferuara me VKM në pronësi ose përdorim të Bashkisë Kamëz si dhe pronave që nuk janë transferuar me VKM", ka rezutuar me verifikimin e 1119 pronave nga 1809 në total.
- Bashkia Kamëz së bashku me njësitë Administrative (ish komunat) i kanë kaluar në pronësi gjithsej 1809 prona me Vendime të Këshillit të Ministrave dhe si pjesë e reformës, të cilat deri në 31.12.2022 nuk janë pajisur me dokumentin e pronësisë të regjistruar në ish-ZVRPP-në Kamëz sot ASHK Vorë - Kamëz. Procedura e pajisjes me Certifikatë pronësie nga ASHK shoqërohet edhe me vlerësimin e secilit objekt, vlerë e cila pas regjistrimit në ASHK regjistrohet në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël, si dhe kontabilizohet në pasqyrat fInciare në llogaritë përkatëse -210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, kullota, plantacione" dhe 212 "Ndërtime e konstruksione" (sipas klasifikimit). Deri në 31.12.2022 këto objekte duke mos patur një vlerë kontabël, *nuk janë pasqyruar në kontabilitetin e njësisë.* Për pasojë tre llogaritë kontabël të mësipërme nuk paraqesin vlerën e tyre reale, për shkak të mungesës së 1809 pronave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 137-168, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të marrin masa për të përditësuar Rregulloren e menaxhimit të aktiveve për zbatimin e të gjitha hallkave të procedurës standard të Inventarizimit të aktiveve të njësisë, kryesisht atë të nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjësimit të atyre të amortizuara, sipas kërkesave të akteve ligjore/nënligjore në fuqi;

9.2. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues, GMS me KoordItorin MFK dhe Koordinatorin e Riskut, Nëpunësi Zbatues dhe Struktura e posaçme e ngritur me Urdhrin e Titullarit të njësisë, t'i kushtojnë vëmendje të veçantë përfundimit brenda një afati sa më të shkurtër kohor të procedurës së nisur për regjistrimin, vlerësimin dhe pasqyrimin në kontabilitet në llogaritë përkatëse-llog.210 "toka, troje, terrene", llog.211 "pyje, kullota, plantacione" dhe llog.212 "godI e konstruksione" të 1809 pronave të Bashkisë Kamëz të përftuara me VKM, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të prokurimit të llojit "Blerje me vlerë të vogël" u konstatuan parregullsi në zhvillimin e procedurës, përkatësisht mungesa e dokumentacionit në **2 (dy)** procedura të prokurimit, në **1 (një)** rast skualifikimi i padrejtë i një OE pjesëmarrës në garë, shpallja fitues e Operatorit Ekonomik në **3 (tre)** procedura prokurimi pa plotësuar kriteret e vendosura në AK si dhe në një **1 (një) rast,** u konstatuan 10 procedura të llojit "*Kolaudim punimesh"* prokurimi nën kufirin 100,000 lekë pa u justifikuar situata emergjente dhe pa u mbajtur procesverbali përkatës, si më poshtë:
-Në procedurën e prokurimit "Blerje uniforma për punonjësit zjarrfikës",
-Në procedurën e prokurimit "Blerje ujë të pijshëm për kopshtet dhe çerdhet në juridiksionin e Bashkisë Kamëz.
-Në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje uniformash për punonjësit zjarrfikës".
-Në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje ujë të pijshëm për kopshtet dhe çerdhet në juridiksionin e Bashkisë Kamëz".
-Në procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim interneti".
Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" neni 82, pika 2, Udhëzimi nr. 5 datë 25.06.2021, pika 20 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj në mjete elektronike", si dhe Specifikimet teknike të DST. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 271 - 280 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Prokurimeve e Bashkisë Kamëz (njësia e prokurimit me vlerë të vogël), të marrë masa që në të ardhmen gjatë shqyrtimit të dokumenteve të tenderit të dorëzuara nga Operatori Ekonomik të kryejë verifikimin e saktë të plotësisë së dokumentacionit, vlerësimin dhe krahasimin e tyre.

Menjëherë e në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë të "Sistemit të manaxhimit të të dhënave për të ardhurat" në Bashkinë Kamëz u konstatua se:
a. Ky institucion administron " *Bazë* të dhënash shtetërore" e cila nuk është krijuar dhe nuk e kryen funksionin bazuar në kuadrin rregullator në fuqi. Ky institucion nuk ka paraqitur kërkesë për regjistrimin në regjistrin kombëtar të bazave të të dhënave shtetërore pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vijim (AKSHI), i cili është autoriteti rregullator koordinues, përgjegjës i bazave të të dhënave shtetërore.
b. Mbi përputhshmërinë e "Sistemit të menaxhimit të bazës së të dhënave për të ardhurat" në Bashkinë Kamëz me kuadrin ligjor në fuqi.
Informacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me administrimin dhe menaxhimin e sistemit të bazës së të dhënave që administron veprimtarinë e DTTV- së nuk është i plotë. Në përgjigjen e kërkesës paraqitur Bashkisë Kamëz nga grupi auditimit nuk përmendet kush realizon proceset e administrimit ose procese të cilat nuk janë në kompetencën e njohurive të stafit përdorues. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore" neni 3; Ligjin nr. 2/2017, datë

26.01.2017, “Për sigurinë kibernetike” neni 4; Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” Kreun II “Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave; Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar” nenet 2, 3,.5, 6....20...27,28..; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar nenet 25, 27, 28, 31; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” i ndryshuar; Vendimi nr. 710, datë 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së inforM onit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, (ndryshuar me VKM nr. 755, datë 26.10.2016); Kreun II, pikën k, të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së inforM onit”, (ndryshuar me VKM nr. 36, datë 24.01.2018; nr. 88, datë 14.02.2018; nr. 448, datë 26.7.2018; nr. 872, datë 24.12.2019); pika 4, “Kërkesat e sigurisë” shkronja b, të “Rregullores për Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; pika 4, germa a, të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike”, miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT). *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz të marrë masa për tu regjistruar në Regjistrin Kombëtar të bazave të të dhënave shtetërore pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vijim (AKSHI). Të ndërtojë programin e sigurisë së inforM onit bazuar në elementët kyç të tij, konkretisht: mjedisin i sigurisë së informacionit, vlerësimi i riskut, politikat e sigurisë, organizimi i sigurisë së TIK, menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, menaxhimi i aseteve, siguria e burimeve njerëzore, siguria fizike dhe mjedisore, kontrolli i aksesit, menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, menaxhimi i vazhdueshmërisë së aktivitetit të njësisë, përputhshmëria.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore u konstatua se ndërthurja e veprimtarisë së DTTV Kamëz me sistemin e menaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në komponentët e sistemit të menaxhimit fInciar dhe kontrollit, nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem.

-Struktura e teknologjisë së informacionit (“IT”)nuk organizohet në nivel drejtorie por në nivel sektori brenda **drejtorisë së prokurimit publik dhe IT,** (aktualisht sektor brenda drejtorisë së Mediave dhe Informacionit) dhe përbëhet nga 4 punonjës (Përgjegjës sektori, 3 specialist). Sektori i IT kryen kryesisht procesin Help desk në këtë institucion.

-DTTV nuk ka një rregullore të brendshme për funksionimin e sistemit apo përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem.

-Ndërthurja e veprimtarisë së DTTV Kamëz me sistemin e menaxhimit të të dhënave nuk kryhet bazuar në komponentët e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Drejtoria nuk angazhohet në procesin e monitorimit të sistemit, nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis raporteve të gjeneruara nga sistemi me formatet e përpunuara në excel nga operatorët, nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të bazës së të dhënave, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga sistemi në evidencat format excel dhe më pas shkresore për raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.

-Nuk ka informacion për administrimin e përdoruesve, bashkëveprimin me burimet njerëzore për procedurat e gjenerimit në sistem të përdoruesve të rinj, përdoruesve që ndërrojnë pozicion pune apo që largohen nga detyra. Nuk ka inforM on për procedurën që ndiqet për

përdorues të cilët janë larguar nga detyra apo kanë ndryshuar pozicion në strukturë (A janë aktiv në sistem apo jo?).
-Bashkia Kamëz, procese të rëndësishme si faturimi i detyrimeve në sistem apo delegim dhe ndryshim kompetencash për përdoruesit *i bën bazuar në kontratën pa nr. prot. dt 05.02.2022 për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit elektronik të taksave dhe tarifave vendore lidhur ndërmjet palëve Bashkia Kamëz dhe OE "Bussines Information System Software". Për proceset e përmendura më sipër nuk ka informacion sa i përket:*
-Protokollimit të veprimtarive si **gjenerim apo ndryshim** i detyrimeve dhe të dhënave që përcaktojnë bazën e taksimit në sistem konformë përcaktimeve në Paketën Fiskale apo **delegim dhe ndryshim kompetencash** për përdoruesit ...etj.
-Informacioni i Sistemit të menaxhimit të të dhënave nuk përputhet me evidencat zyrtare mbi të cilat DTTV planifikon dhe raporton.
-Struktura e kategorizimit të sistemit për bizneset dhe popullatën është e ndryshme nga paketa fiskale e miratuar.
-Raportet që prodhon ky sistem dhe që përpunohen më pas në formatin excel nga sektorët për të ndërtuar evidenca nuk protokollohet.
-Nuk ka asnjë rakordim midis drejtorive në lidhje me:
-Realizimet e të ardhurave që kanë përgjegjësi të menaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB-në nr. 137, datë 22.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz".
-Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk rakordojnë me DTTV lidhur me:
- Kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Kamëz për inforM on sa i përket gjendjes debitorë (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve.
- "A janë të riregjistruar këto subjekte në sistemin e DTTV" dhe
- "A kanë detyrime të pashlyera?".
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin fInciar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4 pika 26,neni 5...., neni 11,...;Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave fInciare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, **neni 9, neni 35, neni 41;** Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika ç; ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar", VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores "*Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*", i ndryshuar, Manuali për MFK i miratuar me urdhër të Ministrit të FIncave nr. 108 datë 17.11.2016, kapitulli III, Rregulloren e brendshme të bashkisë miratuar me aktin nr. 4119 prot. datë 11.05.2022, neni 36. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të bashkisë, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e sistemit, përshkrim të proceseve të punës për personelin që operon me këtë sistem.
12.2. Rekomandimi: Drejtoritë të angazhohen në procesin e monitorimit të sistemit, ku evidencat të vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të bazës së të dhënave, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga sistemi në evidencat format excel dhe më pas shkresore për raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.
12.3. Rekomandimi: Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë të rakordojnë me DTTV lidhur me kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Kamëz për informacion sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i "Sistemit të menaxhimit të të dhënave për të ardhurat" u konstatua se nuk ka një monitorim të dokumentuar në lidhje me monitorimin e bazës së të dhënave dhe statistikave operacionale, nuk zbatohen rregulla të integritetit të bazës së të dhënave, Mungon rakordimi midis sektorëve dhe kontabilitetit. *Nuk ka monitorim për veprimet e stornimit që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifat vendore (lista e veprimeve të stornimit sipas natyrës së veprimit); Procesverbalet e Stornimit: Procesverbalet e mbajtura në lidhje me veprimet e stornimit (Credit Note).*
Procesi i popullimit të bazës së të dhënave në DTTV dhe procesi i përpunimit dhe përgatitjes së evidencave kryhet nga të njëjtit përdorues. Raporti vjetor i detyrimeve të subjekteve nga sistemi nuk protokollohet në fund të periudhës ushtrimore. Procesi i përpunimit nga raporti i sistemit në formatin Excel nuk ka një monitorim të dokumentuar, nuk është efektiv, efiçent dhe i sigurt. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin FInciar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 5, neni 11,..neni 22,.....; Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat fInciare", Ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat fInciare"; Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 ,"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Manuali i Menaxhimit Financiar dhe kontrollit, kapitulli III, komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016, Rregullore e brendshme të bashkisë miratuar me aktin nr. 4119 prot. datë 11.05.2022, neni 36. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
13.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz të marri masa për monitorimin e procesit të grumbullimit përpunimit ruajtjes së inforM onit dhe gjenerimit të raporteve të sakta dhe në kohë për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Kamëz, me cilësi dhe konformë standardeve të përcaktuara në kuadrin rregullator. Të vendosen rregulla dhe të organizohet funksionimi i sistemit në mënyrë të tillë që të shpërndahet tek përdorues të ndryshëm përgjegjësia e zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i paketës fiskale për vitin 2022 dhe strukturës së sistemit të DTTV u konstatua se rezultojnë mungesa sipas kategorizimeve për nënkategoritë e taksave/ tarifave dhe përjashtimet nga detyrimi krahasuar me paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Kamëz. Nuk identifikohen taksa dhe tarifa vendore të përcaktuara për pajisjet automatike të cilat krijon aktivitet dhe gjenerojnë të ardhura si: ATM, pajisje elektronike, lojëra për fëmijë, ekranet dixhital të reklamimit, karikues për mjetet lëvizëse (që janë të vendosura në hapësira publike apo biznes privat, pranë institucioneve të ndryshme etj) edhe pse janë të identifikueshme nuk janë të përfshira në taksat dhe tarifat vendore. Bashkia Kamëz nuk ka formularë të miratuar për aplikim lidhur me kërkesat për regjistrim, ndryshim të dhënash ekzistuese apo çregjistrim të subjekteve**.** Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj në sistemin e DTTV nuk është i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacion shoqërues. Procesi për përllogaritjen e detyrimeve sipas Paketës Fiskale nuk është i saktë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin fInciar dhe kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", Neni 2 pika 13: "Subjekt" është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, që ka cilësinë e tregtarit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, shoqëritë tregtare dhe degët e

shoqërive të huaja, Neni 2 pika 16. "Veprimtari" është veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar në mënyrë të vazhdueshme nga subjektet; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 4, pika 7; Udhëzimin nr. 655/1, datë 06.02.2007 pika 3.1, pika 3.2, pika 3.3, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e TTV të marrë masa për :

-Rishikimin dhe saktësimin e regjistrit të taksapaguesve kategoria biznes, duke përshtatur kategorinë/nënkategorinë me "*Veprimtarinë"* që ushtron, në mënyrë që përllogaritja e detyrimeve të bëhet e saktë sipas parashikimeve në Paketën Fiskale.

- Rishikimin e paketës fiskale duke parashikuar taksa e tarifa për të gjitha kategoritë e biznesit që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë.

-Struktura e kategorizimit të sistemit për bizneset dhe popullatën të njehsohet me paketën fiskale të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i "*Regjistrit Elektronik të Subjekteve*" pranë DTTV, u konstatua se popullimi i sistemit me kërkesa për regjistrim të subjekteve të reja, ndryshimet në të dhënat rreth adresës primare, shtimin apo mbylljen e adresave dytësore dhe të dhënave mbi të cilat përllogariten tarifat dhe taksat vendore për subjektet ekzistuese realizohet pa rakorduar inforM onin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB, me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT.

- Akt konstatimet e mbajtura nga sektori i terrenit nuk japin informacione për përputhjen midis llojit të të dhënave që kërkohet të ndryshohen dhe të dhënave që administrohen në sistem apo në dosjen e subjektit pranë DTTV.

- Në sistem janë konstatuar raste ku subjekti ka gjendje debitore në kodin seli apo në kodet që i përkasin adresave dytësore dhe nga DTTV nuk konstatohen evidenca të ndjekjes së procedurës ligjore për mbledhjen e debisë së tyre.

- DTTV Kamëz për të gjitha rastet kur statusi ka ndryshuar (*çregjistrim, pasiv apo pezullim*) ka ndërprerë faturimin e mëtejshëm të subjektit edhe pse ky çregjistrim ka ardhur si pasojë e mos përgjigjes në kohë ndaj kërkesës për evidentimin e gjendjes debitore nga QKB.

-Nga evidencat e trajtuar në DTTV nuk u paraqit asnjë dokument mbi rakordimin me degët rajonale të tatimeve lidhur me klasifikimin e biznesit dhe llojin e aktivitetit që kryen.Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 5, neni 11,...; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 1, neni 2 germat a, ç, neni 5 germat a, d, dh, f, g, gj, h, i, neni 6 pikat 1, 2, 3, neni 12 germat a, b, dh..., neni 13 germa b, neni 15, neni 23 pika 1, 4, neni 26, neni 27,neni 28 pika 1, neni 29, neni 31, neni 40, neni 41, neni42, neni 43 pika1, 2, 3, neni 44, neni 45, neni 47 , neni 48 pika 1, neni 57 pikat 4, 5, nenet 60, 61, 62, neni 65 pika 5, nenet 68, 69 , neni 70 pika 2, neni 71/1 pika 5 ; Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, nenet 28-40, neni 42, neni 43 germa d, neni 59; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108, datë17.11.2016; Udhëzimi nr. 26, datë 16.12. 2014**;** Udhëzimi nr. 655/1 datë 06.02.2007, "Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore;. VKB - në nr.137, datë 22.12.2021 "Për Sistemin Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz"; Rregullore e brendshme e bashkisë. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore të marrë masa për:

-Krijimin e një sektori për regjistrimin dhe të rakordojë inforM onin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren dhe DRT Kamëz.
- Të bëhet optimizimin i arkitekturës së sistemit lidhur me adresat dytësore dhe të regjistrohen në sistem si nënkategori përbërëse e adresave primare ku të identifikohen nëpërmjet të njëjtit numër (NIPT ose NIPT sekondar) që kanë në DRT në mënyrë që sistemi të japë informacion të plotë mbi detyrimin e tatimpaguesit (seli dhe aktivitetin e adresave dytësore).
- Të përllogariten detyrimet tatimore bazuar në paketën fiskale të miratuar në vite dhe nëse dalin diferenca të planifikohen për tu arkëtuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i inforM onit të administruar në sistem dhe evidencave për raportim të DTTV u konstatua diferencë lidhur me numrin e bizneseve që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Kamëz dhe planifikimin e taksave dhe tarifave vendore.
Duke krahasuar të dhënat e evidencave të DTTV dhe sistemit të DTTV konstatohet se ka mospërputhje midis tyre në numrin e subjekteve taksapagues, planifikim dhe realizim.
DTTV evidence sipas llojit të Biznesit për vitin 2022 kanë ushtruar **aktivitet 3,843** subjekte.
DTTV evidence sipas kategorisë për vitin 2022 kanë ushtruar **aktivitet 3,557** subjekte.
DTTV evidence subjekte të çregjistruara, pezulluara sipas llojit për vitin 2022, kanë çregjistruar apo pezulluar aktivitetin në QKB 319 subjekte.
DTTV sistem Kamza Taksa Biznes administron informacion për **4,558 subjekte** nga të cilët:
Subjekte **Aktiv për vitin 2022 janë 3,595**, Subjekte të reja janë 712 për vitin 2022, Subjekte të pezulluara 469 (periU 2017-31.12.2022) nga të cilat 205 vetëm për vitin 2022, Subjekte të mbyllura 614 (periU 2015-31.12.2022) nga të cilat 205 vetëm për vitin 2022.
DTTV në planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk i planifikon dhe faturon detyrim secilit prej subjekteve për të gjitha taksat dhe tarifat e miratuara por vetëm për një pjese të tyre.
-DTTV Kamëz taksën mbi ndërtesën e ndan nga subjekti që ushtron aktivitet dhe e faturon pranë pronarit që ka në pronësi pasurinë ku zhvillohet aktiviteti. Kjo ndarje e bën të pamundur evidentimin dhe mbledhjen e këtij detyrimi. Nga verifikimi i dosjeve të tatimpaguesve rezulton se nuk ka dokument që vërteton bazën e taksës (sipërfaqen në m^2). Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin fInciar dhe kontrollin", i ndryshuar; neni 5, neni 11,...; Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat"; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë " i ndryshuar; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhrin e MFE Nr. 108, datë 17.11.2016; Udhëzimi nr. 655/1, datë 06.02.2007, "Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore, Rregulloren e brendshme të bashkisë miratuar me aktin nr. 4119 prot., datë 11.05.2022, neni 36. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
16.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për:
-Të saktësuar dhe unifikuar kategorizimin/nënkategorizimin e sistemit të DTTV me paketën fiskale dhe evidencat duke rakorduar inforM onin e paraqitur vullnetarisht nga subjektet pranë sporteleve apo QKB me sektorin e verifikimeve në terren, dhe dosjet fizike te tatimpaguesve.

-Të përcaktojë rregulla që e shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjësinë e zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve. Procesi i përpunimit të informacionit nga raportet që gjeneron sistemi të monitorohet, duke lënë gjurmë për çdo fazë të përpunimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të planifikimit dhe realizimit të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura. Për vitin 2022, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore gjithsej që arkëtohen nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, nga 537,448 mije lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 261,706 mijë lekë, ose 61 %, **me një mosrealizim 212,296 mijë lekë**. Pra konstatohet se në planin e të ardhurave me mosrealizim të dukshëm dhe që ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave për periudhën objekt auditimi, janë debitorët e vitit për biznesin, taksë ndertese, taksë trualli, taksa dhe tarifa lokale (familjarët)..etj. Ndërsa zërat me tejkalim janë tarifë shërbimi, tarifë e hotelerisë, tarifë ndricimi, autorizim për tregëti karburanti me pakicë dhe gjoba nga inspektoriati ndërtimor. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimi e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave fInciare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II, pika 2, germa "a" dhe "b", Kreu III, pika 32. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>17.1. Rekomandimi</u>: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i korrespondencës me UKK u konstatua se:
a. Rakordimi mbi numrin real të abonentëve që administron UKK Sh.A nuk është i saktë. Për periudhën 2022 nuk është hartuar një plan apo strategji, për të evidentuar familjet e pa regjistruara të agjenti tatimor UKK, në mënyrë që të ndiqet arkëtimi i tyre jashtë agjentit tatimor, pra nga vetë administrata e taksave dhe tarifave vendore. Regjistri i taksa paguesve familjar nuk është i plotë.

b. Rakondimet përkatëse me agjentin tatimor mbi të ardhurat e arkëtuara nuk janë bërë sipas Aktmarrëveshjen nr. 409 prot., datë 18.01.2022, ndërmjet institucioneve Bashkia Kamëz - UKK SHA.
c. Evidencat e DTTV nuk përputhen me raportet e sistemit të DTTV dhe detyrimet nuk janë pasqyruar korrekt në pasqyrat financiare.
Grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion të saktë dhe të qenësishëm për situatën e menaxhimit, identifikimit, regjistrimit dhe vjeljes së të ardhurave për debin totale për taksat familjare pasi ka pasaktësi në përcaktimet e numrit të familjeve që shërbejnë si bazë për përllogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat, për të cilat DTTV nuk ka marrë asnjë masë për ndjekjen e etapave që parashikon legjislacioni në fuqi për vjeljen e tyre.
Veprime këto në kundërshtim me Aktmarrëveshjen nr. 409 prot., datë 18.01.2022, ndërmjet institucioneve Bashkia Kamëz - UKK SHA, nenet 5 dhe 6, neni 10 pika 1, të kësaj marrëveshje, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin FInciar dhe kontrollin", i ndryshuar; neni 5, neni 11,...; Ligji nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat fInciare"; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat"; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit FInciar dhe Kontrollit miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108, datë 17.11.2016; Udhëzimi nr. 655/1, datë 06.02.2007, "Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore"; aktmarrëveshja nr. 409 prot., datë 18.01.2022, ndërmjet institucioneve Bashkia Kamëz - UKK sha, neni 10 pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
18.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz, të hartojë një program pune për evidentimin e të gjitha taksapaguesve familjar, si dhe të evidentohen familjet e pa regjistruara të agjenti tatimor UKK. Të rakordohet periodikisht me agjentin tatimor në përputhje me kushtet e kontratës.
Të bëhet optimizimi i të dhënave të taksapaguesve familjarë, të krijohet një strukturë për monitorimin e veprimtarisë në bazën e të dhënave, statistikave operacionale, zbatimin e rregullave të integritetit të bazës së të dhënave, për të parandaluar regjistrimin e dyfishtë të taksapaguesve, modifikimin e të dhënave pa dokumentacion mbështetës, moslejimin për ndryshime të pa autorizuara të të dhënave. Të krijohet një strukturë për monitorimin e veprimeve të stornimit dhe credit note, dokumentimin e tyre nëpërmjet procesverbaleve.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, aplikimi i tarifës për akomodim në hotel bëhet sipas deklarimeve të vetë subjekteve, duke mos ushtruar kontroll nga sektori i terrenit nëse deklarimi i subjektit ose regjistrimi në librat përputhet me numrin e personave të akomoduar dhe numrin e dhomave për hotel. Në dosje nuk ka dokumentacion që vërteton numrin e netëve të qëndrimit në hotel, nuk janë ushtruar kontrolle në lidhje me mbajtjen dokumentacionit (fatura me çmim fjetje dhe vlerën e taksës)të p**e**rsonave që kanë fjetur, për një natë, të dhëna këto që do të ndikonin në rritjen e të ardhurave. Pagesat janë bërë një herë në vit dhe jo sipas përcaktimeve në paketën fiskale Nuk ka informacion për llojin e hotelit (hotel me 4-5 yje, bujtinë, fjetinë....).
Të gjitha këto mangësi bëjnë që kjo taksë të mos jetë arkëtuar saktë për numrin e personave që akomodohen në strukturat akomoduese të Bashkisë Kamëz. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; neni 26 pika 6 dhe pika 7; VKB nr. 137 datë 22.12.2022 për "Sistemin e taksave dhe tarifat vendore në Bashkinë Kamëz", pika A.4 "Taksa e fjetjes në hotel". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për vjeljen e tarifës për subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet në fushën e hotelerisë sipas përcaktimeve në paketën fiskale, të ushtrojë kontrolle mbi mbajtjen e regjistrave dhe të plotësojë dosjet e subjekteve me dokumentacion.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se dosjet individuale për subjektet e biznesit të vogël dhe të biznesit të madh që ushtrojnë aktivitet në territorin gjeografik të Bashkisë Kamëz nuk janë të plota. Nga grupi auditimit janë kryer disa testime për të verifikuar procesin e plotësimit të dosjeve me dokumentacion. U përzgjodhën në mënyrë rastësore 35 subjekte për verifikimin e dokumentacionit në dosje dhe planifikimit/arkëtimit për taksa e tarifa vendore. Dosjet nuk janë të pajisura me fletën e inventarit. Në **7** raste nuk ka dokument që vërteton sipërfaqen e ndërtesës, truallit, tabelës për qëllim reklamimi …etj; në **4** raste nuk ka dokumentacion që vërteton sipërfaqen e tabelës për qëllim reklamimi; në **21** raste në dosje nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem (*për ndryshimet që kanë ndodhur në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifat vendore), pra ndryshimet në sistem janë bërë pa dokumentacion vërtetues pa procesverbalet e ndryshimit në lidhje me veprimet e stornimit (Credit Note).* Nuk ka monitorim dhe dokumentim të rakordimeve midis informacionit nga sistemi dhe procesit të popullimit të bazës së të dhënave. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar", nenet 29, 36, 69, 75...; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat"; VKB nr. 137 datë 22.12.2022 për "Sistemin e taksave dhe tarifat vendore në Bashkinë Kamëz". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që, të plotësojë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dosjet e subjekteve si biznes i madh dhe i vogël me qëllim përllogaritjen e saktë të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore.

20.2. Rekomandimi: Ndryshimet në sistem në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifat vendore të shoqërohen me dokumentacion vërtetues, të mbahen procesverbalet e ndryshimit në lidhje me veprimet e stornimit (Credit Note). Të kryhet monitorimi dhe dokumentimi i rakordimeve midis informacionit nga sistemi dhe procesit të popullimit të bazës së të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bahkia Kamëz ka në administrim inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuar me VKM nr. 775/2013, për Bashkinë Kamëz dhe VKM nr. 454/2011, për ish-komunën Paskuqan. Këto inventarë nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Kamëz nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Kamëz-Vorë mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Inventari i pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kamëz nuk është i përditësuar.

Në lidhje me fondin pyjor. Këto pasuri nuk janë regjistruar në DVASHK Kamëz-Vorë dhe nga ana e bashkisë, sektori i pyjeve nuk janë marrë masa për të miratuar plane mbarështimi për menaxhimin e tyre me qëllim dhënien në përdorim. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë",VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar; Udhëzimin nr.13 datë 26.04.2018 Për zbatimin e ketij vendimi; Urdhërin e

Kryetarit të Bashkisë nr. 233 datë 29.03.2019, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz të marrë masat e duhura për ngritjen e një grupi pune për kryerjen e inventarizimit të pronave të transferuara dhe vlerësimin për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i arkëtimeve për detyrimet për tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim...) për të gjitha lejet e marra nga subjektet ndërtuese të pajisura me leje ndërtimi, që kanë ushtruar veprimtari ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Kamëz u konstatua se :

-Subjektet nuk janë pajisur me çertifikatë regjistrimi për adresë dytësore për çdo kantier ndërtimi -Nuk përputhet detyrimi që duhet të llogaritej sipas kategorizimit në paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Kamëz me detyrimin progresiv të evidentuar në sistem për këto subjekte dhe vlerën e arkëtuar. Konkretisht:

-Subjekti "A. C." SHPK me NIPT- L.....R, është subjekt ndërtues për 10 leje ndërtimi në vitin 2021 dhe 17 leje ndërtimi në vitin 2022, ndërsa sipas të dhënave (arkëtimeve në Drejtorinë e Financës) ka paguar detyrimet (vetëm për tarifë pastrimi) për 5 leje ndërtimi për vitin 2021 dhe 11 leje ndërtimi për vitin 2022. Vlera prej **3,628,323 lekë është e ardhur e munguar për Bashkinë Kamëz.** Sipas të dhënave në QKB dhe në sistemin e DTTV, nuk ka të regjistruara adresa sekondare për ndërtimet në territorin e Bashkisë Kamëz.

-Subjekti "K." SHPK me NIPT- L.....V, është ndërtues për 6 leje ndërtimi në 2021 dhe 6 leje ndërtimi në vitin 2022 ndërsa sipas të dhënave (arkëtimeve në Drejtorinë e FIncës) ka paguar detyrimet (taksë pastrimi) për 1 leje ndërtimi, ndërsa në vitin 2022 nuk ka bërë asnjë pagesë. **Vlera prej 1,952,834 lekë është e ardhur e munguar për Bashkinë Kamëz.** Sipas të dhënave në QKB dhe në sistemin e DTTV, nuk ka të regjistruara adresa sekondare për ndërtimet në territorin e Bashkisë Kamëz.

-Subjekti "F." SHPK me NIPT- L.....A, është ndërtues për 18 leje ndërtimi në 2021 dhe 5 leje ndërtimi në vitin 2022 ndërsa sipas të dhënave (arkëtimeve në Drejtorinë e Financës) ka paguar detyrimet (taksë pastrimi) për 4 leje ndërtimi në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 ka paguar detyrimet (taksë pastrimi) për 9 leje ndërtimi. **Vlera prej 3,045,000 lekë është e ardhur e munguar për Bashkinë Kamëz.** Sipas të dhënave në QKB dhe në sistemin e DTTV, nuk ka të regjistruara adresa sekondare për ndërtimet në territorin e Bashkisë Kamëz.

-Subjekti "D." SHPK me NIPT- L.....L, është ndërtues për 8 leje ndërtimi në 2021 dhe 3 leje ndërtimi në vitin 2022 ndërsa sipas të dhënave (arkëtimeve në Drejtorinë e Financës) ka paguar detyrimet (taksë pastrimi) për 5 leje ndërtimi në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 ka paguar detyrimet (taksë pastrimi) për 3 leje ndërtimi. **Vlera prej 1,130,000 lekë është e ardhur e munguar për Bashkinë Kamëz.** Sipas të dhënave në QKB dhe në sistemin e DTTV, ka të regjistruar **1 (një)** adresë sekondare për ndërtimet në territorin e Bashkisë Kamëz.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, "Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 40,... neni 43; Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", neni 19, 22, ...43; VKB nr. 55, datë 20.12.2019 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz" i ndryshuar, VKB nr. 137 datë 22.12.2022 për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz"; Rregulloren e brendshme te Bashkisë Kamëz. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandimi: Drejtoria e TTV Bashkia Kamëz, të marrë të gjitha masat administrative e ligjore për planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave për tarifa vendore

(tarifë pastrimi, tarifë gjelbërimi, tarifë ndriçimi) për të gjitha subjektet e N që marrin leje ndërtimi nga bashkia (për çdo kantier ndërtimi).

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i **14** (katërmbëdhjetë) procedurave të prokurimit me objekt "Punë publike/Mallra", me vlerë të fondit limit 2,587,063,960 lekë pa TVSH dhe, kontrata të lidhura në vlerën 2,552,138,835 lekë pa TVSH të zhvilluara gjatë vitit 2022 në Bashkinë Kamëz, konkretisht për procedurat: (1)-"Rikonstruksion shkolla e mesme "Gramoz Palushi", Babrru, Njësia Administrative Paskuqan", (2)-"Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari"", (3)-"Ndërtim rruga "Albanët" + rrugicat Valias + rruga "Këmbanat", (4)-"Ndërtim Rr. Frutikulturë (Rr. pungul me Rrugën Azem Galica + Rr. "Isuf Gervalla" + Rr. "Brezaret", (5)-"Ndërtimi i Pedonales dhe zonave rekreative të Parkut të Liqenit Paskuqan", (6)-"Ndërtimtrotuare + Ndriçim Rruga "Jon" + Rruga "Fushë Arrëz", (7)-"Nërtim rrugët (Rr. "William Shekspir" + Rr."Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" +Rr. "Isuf Gërvalla"+ Rr. "Brezaret"+ Rr. "Daniel Alia", (8)-"Nërtim rrugët "Lidhja e Prizrenit" Njësia Administrative Babrru, Paskuqan", (9)-"Nërtim rrugët "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari" Zall-Mner Bashkia Kamëz", (10)- "Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamëz, (11)-"Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Halit Çoka (ish Elez Isufi)", (12)-"Ndërtim rrugët Rr. Erzeni, Rr. Marubi, Rr. Valbona, Rr. Tomorri", (13) "Blerje makinë MZSH" për vitin 2022", (14). "Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshteve", është konstatuar se NJP jo vetëm ka hartuar kërkesa për kualifikim të cilat nuk stimulojnë pjesëmarrjen e OE në garë, por janë kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe Dokumentet e Tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, ***ku ndër më kryesore janë***:

- NjP në 4 (katër) raste ka kërkuar që OE duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë e cila të përfshijë kategorinë NP-7 (A) Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje, kriter i cili nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv.
- NjP në 2 (dy) raste ka kërkuar që në personelin kryesor, drejtues në licencën e shoqërisë OE të ketë 1 inxhinier mekanik, kriter i cili nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv.
- NjP në 1 (një) rast ka kërkuar që në personelin kryesor, drejtues në licencën e shoqërisë OE të ketë 1 saldator dhe 1 mekanik, kriter i cili nuk lidhet me natyrën e punimeve parashikuar projekt preventiv.
- NjP në 6 (gjashtë) raste ka kërkuar që për realizimin e kontratës, duhet të disponojë (1) Impiant Betoni automatik me mikser (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B), në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi dhe (2) nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi. Kërkesa të ekzagjeruar me natyrën dhe objektin e kontratës.
- NjP në 2 (dy) raste ka kërkuar që për realizimin e kontratës, duhet të disponojë (1) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton dhe (2) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi.
- NjP në 4 (katër) raste ka kërkuar që AK të vlerësojë ofertën ekonomike më favorshme, bazuar në kosto dhe, jo në çmim, duke mos krijuar kushte për një vlerësim objektiv të OE/BOE pjesëmarrës në garë, sipas peshës specifike për çdo kriter dhe nënkriter.
- NjP në 2 (dy) raste ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një kontrate të lidhur me një laborator për këtë objekt, i cili të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analizat e materialeve (Beton i freskët dhe i ngurtësuar, përzierje bituminoze, materiale rrugore, gur natyror). Ky kriter është i tepërt, sepse kryerja e analizave është

parashikuar në DT (Shtojca 16 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK), neni 13 "Testimet dhe Inspektimet".
- NJP në 3 (tre) raste ka kërkuar që OE ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listë pagesat e shoqërisë për periudha të ndryshme. Konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar.
- NJP në të gjitha rastet ka kërkuar një numër të pa-argumentuar të makinerive/pajisjeve. Nuk ka asnjë analizë teknike ku sasia e makinerive/pajisjeve të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volume e tyre apo grafikun e punimeve.
Veprime dhe mosveprim në mospërputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar dhe, ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 168-271 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
23.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, Njësia e Prokurimit, për çdo rast të procedurave të zhvilluara, të hartojë kritere që stimulojnë pjesëmarrjen e OE në garë, në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe Dokumentet e Tenderit të hartuara e miratuara nga AK.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave për punë publike, u konstatua se në 2 (dy) raste, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, **nuk është kryer oponenca teknike** për projektet e zbatimit me objekte:
- "Ndërtim Rr. Frutikulturë (Rr. pingul me Rrugën Azem Galica + Rr. "Isuf Gervalla" + Rr. "Brezaret"", zhvilluar sipas urdhër prokurimit me nr. 5463 prot., datë 16.06.2022, me fond limit 85,269,315 lekë dhe fitues operatorin ekonomik "V " SHPK.
- "Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza", me nr. 7477 prot., datë 23.08.2022, me fituesin BOE "B" & "N." SHPK me vlerë të kontratës 72,285,722 lekë.
Mos kryerja e oponencës teknike nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamëz, përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të N në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e N.
Për sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të N", neni 6 si dhe, VKM nr. 610, datë 22.9.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve", neni 41, pika 1, germa (c).*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4. faqe 265-268 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
24.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz të marrë masa që të pajisë me ***Oponencë Teknike*** çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destIcionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të N u konstatua se në **5 (pesë)** raste nuk janë respektuar **kondicionet urbane** të parashikuara në ligj, siç janë hapësirat e dedikuara për parkim në raport me numrin e banorëve, **distancat nga ndërtimet** e tjera dhe nga kufiri i pronës, tipologjia e lejuar e N e përcaktuar në dokumentet e planifikimit, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

a. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat me 1 kat nëntokë, me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "M " ShPK, me Vendim Nr. 4594 Prot., datë 27.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Nuk janë respektuar hapësirat për parkim, pasi sipërfaqja totale faktike e parkimit është 1106 m^2, ndërkohë që sipërfaqja sipas dispozitave të sipërcituara do të duhej të ishte 1440 m^2.
- Fasada jug-perëndimore e objektit nuk përmbush kriterin për t'u konsideruar "faqe kallkan", si rrjedhojë, ky objekt nuk respekton distancat urbane nga ndërtimet e tjera dhe nga kufiri i pronës.
- Objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga ndërtesat e tjera, më konkretisht, nga përllogaritja konstatohet se distanca minimale e lejuar është 15 metra, ndërsa distanca e miratuar është 13 metra.
b. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat dhe 2 kat nëntokë, me zhvillues shoqëria "A " ShPK, me Vendim Nr. 4321 Prot., datë 04.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, KSHR = 9.1% dhe KSHP = 30%.
c. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi, 7, 8, dhe 9 kate me 2 kate nëntokë ", me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "S " ShPK, me Vendim Nr. 4551 Prot., datë 07.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, KSHR = 9.1% dhe KSHP = 30%.
ç. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 1, 8 dhe 9 kat, me 1 kat nëntokë, me zhvillues shoqëria "B " ShPK & Shoqëria "D" ShPK, me Vendim Nr. 3770, datë 15.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Objekti që do të ndërtohet në lartësinë e 9 kateve nuk respekton distancën me objektin ekzistues në lartësinë e 8 kateve, pasi distanca ndërmjet tyre është më e vogël se 19 metra.
- Objekti në lartësinë e 9 kateve do të duhej të respektonte distancën minimale nga kufiri i pronës prej 10 metra. Në plan vendosjen e miratuar konstatohet se distanca është më e vogël se 10 metra.
d. Leje N për dy objekte banimi dhe shërbimi 9 kate me 1 kat nëntokë, me zhvillues Shoqëria "P." ShPK, me Vendim Nr. 4108, datë 16.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Në bazë të përcaktimeve të PDV-së së miratuar për njësinë strukturore 1.7.9; 1.7.6 Laknas, tipologjia e njërit prej objekteve duhet të jetë objekt logjistikë, ndërsa objekti tjetër banim 7-9 kate. Në mospërputhje me PDV-në, planvendosjen është miratuar për realizimin e dy objekteve të banimit të zhvilluar në lartësinë e 9 kateve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 40, pika 2; neni 34, pika 2, 3; neni 35, pika 1; Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Kamëz, neni 17, pika 3, 4 dhe 5; neni 29, pika 1, nënpika c); Plani i Detajuar Vendor për njësinë strukturore 1.7.9;1.7.6 Laknas.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 295-309 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
25.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Kamëz të merren masa për respektimin e distancave dhe kondicioneve urbane sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të N dhe zhvillimit u konstatua se në **6 (gjashtë) raste, projekti ndërtimor nuk është i plotë**, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

a. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat me 1 kat nëntokë, me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "M " ShPK, me Vendim Nr. 4594 Prot., datë 27.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjektit dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), për të gjithë hartuesit e projekteve ndërtimor. Të vetmet subjekte që e kanë ngarkuar këtë dokumentacion në sistemin *e-lejet* janë hartuesi i projektit konstruktiv dhe studimit sizmiko-gjeologjik;
- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projekteve: konstruktiv; studimi sizmiko-gjeologjik; studimi gjeologo-inxhinierik;
- Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale për hartuesit e studimit gjeologo-inxhinierik dhe rilevimit topografik;
- Licenca profesionale e hartuesit të rilevimit topografik;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë në formatin DWG;
b. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat dhe 2 kat nëntokë, me zhvillues shoqëria "A " ShPK, me Vendim Nr. 4321 Prot., datë 04.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Mungon licenca profesionale për hartuesin e projektit të mbrojtjes nga zjarri;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë në formatin DWG;
c. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi, 7, 8, dhe 9 kate me 2 kate nëntokë ", me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "S " ShPK, me Vendim Nr. 4551 Prot., datë 07.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për hartuesit e projekteve arkitektonik, konstruktiv dhe të raportit të auditimit të eficencës së energjisë;
- Mungon deklarata e hartuesit të projektit arkitektonik dhe e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, gjithashtu, afati i policës së hartuesit të studimit sizmik dhe atij gjeologjik është jashtë afatit, në raport me datën e aplikimit;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë në formatin DWG.
ç. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 1, 8 dhe 9 kat, me 1 kat nëntokë, me zhvillues shoqëria "B " ShPK & Sh "D" ShPK,me Vendim Nr. 3770, datë 15.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Plan vendosje e miratuar dhe rilevimi topografik nuk janë të plotësuara me të gjitha të dhënat e nevojshme, pasi nuk janë pasqyruar të gjitha numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet.
d. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 1-2-8-9 kate + 1 kat nëntokë, me zhvillues Shoqëria "A" ShPK, me Vendim Nr. 3831, datë 13.05.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Nuk janë pasqyruar në planvendosje të gjitha numrat e kateve të objekteve me të cilat kufizohet;
dh. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 1, 3, 7 dhe 8 kat me 1 kat nëntokë, me zhvillues shoqëria "SH" ShPK, me Vendim Nr. 4435, datë 29.09.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:
- Planvendosje e miratuar dhe rilevimi topografik nuk janë të plotësuara me të gjitha të dhënat e nevojshme.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"*, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika (c), (ç), (e), (ë), (g). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 295-309 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

26.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Kamëz të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të N u konstatua se në **3 (tre) raste** Bashkia Kamëz dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) **nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike** që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të N. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

a. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat me 1 kat nëntokë, me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "M " ShPK, me Vendim Nr. 4594 Prot., datë 27.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk është ri kërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit, mbi identifikimin e linjave dhe projekteve të këtij operatori, pas ndryshimeve të projektit sipas mendimit fillestar të këtij operatori.

b. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 9 kat dhe 2 kat nëntokë, me zhvillues shoqëria "A " ShPK, me Vendim Nr. 4321 Prot., datë 04.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Vendore <u>përkatëse</u> të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).
- Në sistemin elektronik të lejeve, mungon mendimi i Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.
- Nuk është respektuar mendimi i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE).

c. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi, 7, 8, dhe 9 kate me 2 kate nëntokë ", me zhvillues dhe ndërtues shoqëria "S " ShPK, me Vendim Nr. 4551 Prot., datë 07.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk është kërkuar mendimi i Drejtorisë Vendore <u>përkatëse</u> të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).
- Në sistemin elektronik të lejeve, mungon mendimi i Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.
- Nuk është respektuar mendimi i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, Neni 21 *"Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor"*, pika 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 295-309 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) dhe Bashkia Kamëz të marrin të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar, në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të N, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Në **9 (nëntë) raste**, nga auditimi mbi mënyrën e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nga specialistë të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT) Bashkia Kamëz, u konstatua se kjo taksë është llogaritur vetëm për sipërfaqen e shfrytëzueshme dhe jo për të gjithë hapësirat e përbashkëta si pjesë e Intensitetit të N (IN), në mos përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**.** Sipas specialistëve të DPZHT, taksa e ndikimit në infrastrukturë

është llogarit në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 29, datë 16.3.2021 "Për një ndryshim në VKB nr. 167 datë 23.12.2020", vendim i cili parashikon vetëm sipërfaqet e shfrytëzueshme.
Kjo mënyrë llogaritje është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar neni 46 *Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja,* si dhe me nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 295-309, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
28.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit (DPZHT) dhe Drejtorinë Juridike Bashkia Kamëz, të analizojnë paraprakisht në Këshillin Bashkiak Kamëz ndryshimin e Vendimit të KB nr. 29, datë 16.3.2021 "Për një ndryshim në VKB nr. 167 datë 23.12.2020", mbi mënyrën e llogaritjes së Taksës së Ndikimit të Infrastrukturë (TNI), në përputhje me nenin 46 të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, si dhe nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, me qëllim llogaritjen e saktë të Taksës së Ndikimit të Infrastrukturë (TNI), duke marrë në konsideratë përveç hapësirave të shfrytëzueshme, edhe hapësirat e përbashkëta.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje makinë MZSH", sipas urdhrit të prokurimit me nr. 4384 prot., datë 16.05.2022, me fond limit në vlerën 10,900,000 lekë, me fitues operatorin ekonomik "S 32" SHPK dhe kontratë shërbim blerje me vlerë 10,728,000 lekë, është shpallur fitues nga KVO në kushtet mosplotësimit të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK. O.E nuk ka një licencë me titull "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe të rimorkiove", me kodin VII.3.B.1 / a, b, c, ç dhe d. Pra OE fitues ka dhënë një deklaratë për kryerjen e një veprimi, për të cilën nuk është i licencuar që ta kryejë. Nga auditimi i dokumentacioni të paraqitur nga OE fitues rezulton se nga KVO duhej të ishte anuluar kjo procedurë.
Veprime në mospërputhje me nenin 3, pikat 1 dhe 3 të nenit 92, neni 98 në Ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe pikën 2 të nenit 82 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 241-265, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.**
29.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorit ekonomik, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

30. Gjetje nga auditimi: Në 2 procedura prokurimi, konkretisht "Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshteve" dhe "Blerje makinë MZSH", për llogaritja e fondit limit, bazuar në studimin e tregut është bërë mbi subjekte të cilat nuk janë të licencuara ose nuk kanë në fushën e aktivitetit objektin e prokurimit.
1. Në procedurën "Blerje makinë MZSH":
Komisioni me procesverbalin datë 27.04.2022, ka përcaktuar fondin limit në shumën 10,900,000 lekë, bazuar në tre oferta të marra nga OE "C" SHPK, "P" ShPK, dhe U.ShPK. Nga verifikimi në QKB rezulton se shoqëria "C" ShPK, dhe U.SHPK nuk janë të licencuara për tregtimin e automjeteve.
2. Në procedurën "Blerje peleti":
Komisioni me procesverbalin pa nr. i datës 31.01.2022, sipas të cilit është përllogaritur fondi limit mbi bazën e tre ofertave të tre operatorëve ekonomikë, konkretisht: "P" SHPK me

ofertën ekonomike çmimi/njësi (ton) 25,600 lekë; "4S" SHPK me ofertën ekonomike çmimi/njësi (ton) 25,800 lekë; "A " SHPK me ofertën ekonomike çmimi/njësi (ton) 26,102 lekë. Vlera e përllogaritur e fondit limit për 90 ton është 2,325,060 pa TVSH. Ndërkohë për dy O.E, nga kërkimi i bërë në QKB, "P" SHPK dhe "4S" SHPK rezultojnë se nuk ka në fushën e aktivitetit të tyre "prodhim e tregtim peleti".
Veprime në mospërputhje me pikën të nenit 12, neni 13, neni 76 të *VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 241-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.**
<u>30.1. Rekomandimi</u>: Struktura e posaçme për përllogaritjen e fondit limit, të marrë masa që ofertat ekonomike të merren nga subjekte të licencuara dhe që kanë në fushën e aktivitetit të tyre objektin e prokuruar, për të siguruar studim real të tregut.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

31. Gjetje nga auditimi: Në 1(një) procedurë prokurimi, konkretisht në procedurën "Blerje Peleti", grupi i punë i ngritur me Urdhër Nr. s'ka, datë 25.01.2022 "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit i ngritur, me përbërje: z. A.P , znj. F.P , znj. O.G . Më tej, ka hartuar specifikime teknike të paargumentuara dhe rezulton i firmosur vetëm nga një anëtar i grupit të punës, i cili nuk rezulton të jetë specialist i fushës. Veprime këto në mospërputhje me pikën 2 e nenit 74 të *VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 241-265, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.**
<u>31.1. Rekomandimi</u>: Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa që në vazhdimësi në zhvillimin e procedurave me aktivitet të veçantë të përcaktojë specialistë të fushës së objektit të prokuruar, në hartimin e specifikimeve teknike, kjo për të siguruar efektivitet të fondeve të prokuruar.

Në vazhdimësi

A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNË NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.
Nga auditimi i fundit i kryer në Bashkinë Kamëz , nga KLSH janë rekomanduar masa për përmirësimin e gjendjes, të cilat janë dërguar në subjekt me shkresën Nr. 1023/12, datë 25.04.2023. Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e tyre. **Statusi i zbatimit të rekomandimeve është si vijon:**

32. Gjetje nga auditimi:
Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve dërguar me shkresën Nr. 1023/12, datë 25.04.2023, rezulton se:
Bashkia Kamëz për zbatimin e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 3972/1 prot., datë 15.05.2023, brenda afatit ligjorë të **20 ditëve, si** dhe ka hartuar "Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve", duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.
Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor**, Bashkia Kamëz për zbatimin e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7672/1 datë 12.10.2023, brenda afatit ligjorë.
Relacioni mbi zbatimin e rekomandimeve është paraqitur në mbledhjen e **Këshillit Bashkiak** të datës 22.05.2023 dhe të datës 20.09.2023
<u>Në mënyrë të përmbledhur situata e zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:</u>
Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **26** masa organizative, të pranuara plotësisht nga subjekti, prej të cilave, 9 masa janë të zbatuara plotësisht, 10 masa janë të zbatuara pjesërisht dhe **7** masa janë në proces zbatimi.
Gjithashtu, janë rekomanduar **7** masa për shpërblim dëmi, prej të cilave 6 masa janë të zbatuara plotësisht dhe **1** masë është zbatuar pjesërisht.

Janë rekomanduar **6** masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, të pranuara plotësisht nga subjekti, prej të cilave, **6** masa janë pjesërisht të zbatuara.
Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, "Të drejtat e KLSH". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 292-296, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.**
32.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz, bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, të marrë masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht.

Masat të cilat **ri kërkon** KLSH për t'u zbatuar menjëherë nga Bashkia Kamëz janë si vijon:

Masa organizative:

1.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrë masa për të analizuar llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" në vlerën 716,700,299 lekë, për të evidentuar klasifikimin e debitorëve me dhe pa shpresë arkëtimi, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e tyre.*
4.1. Rekomandim: *Kryetari i Bashkisë Kamëz nëpërmjet Strukturës së Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtorisë FIncës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrin masa për përditësimin e inventarit të pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme në DVASHK Kamëz -Vorë.*
5.1. Rekomandim: *Drejtoria e MTPM-se dhe Bordit Kullimit (strukturat përgjegjëse), të rakordojë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Agjencinë Kombëtare të Pyjeve mbi statusin e regjistrimit fillestar të ekonomive pyjore/kullosore për pasqyrimin e sipërfaqeve përkatëse të këtyre pasurive në fondin dixhital të pyjeve ALFIS.*
8.1. Rekomandim: *Kryetari i Bashkisë Kamëz të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për kryerjen një verifikimit në terren për sipërfaqen reale që shfrytëzon subjekti përkatës, duke hartuar një aneks kontrate dhe llogaritur detyrimin për sipërfaqen mbi sipërfaqen e kontratës bazë, si dhe të përcaktohet detyrimi për zëvendësimin e sipërfaqes së shpyllëzuar nga aktiviteti i subjektit.*
10.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit, të marrin masë që detyrimin e çdo subjekti për dorëzimin 3% të sipërfaqes së N si fond banesash të ndajë 50% të sipërfaqes në vlerë dhe 50% si banesë sociale.*
15.1. Rekomandim: *Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa për përshpejtimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi dhe të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 447/3,prot, datë 23.02.2022 "Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kamëz".*
16.1. Rekomandimi: *Drejtoria e Prokurimit Publik, Bashkia Kamëz, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën e fondit limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.*
Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efiçensë dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar.

17.1. Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa që në procedura me aktivitet të veçanta të përcaktojë specialist të fushën së objektit të prokuruar, si në hartimin e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e procedurës, kjo për të siguruar efektivitet të fondeve të prokuruar.*

20.1 Rekomandimi: *Nga ana e Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Kamëz të merren masa për:*

- Respektimin e lejuar të përdorimi të tokës sipas legjislacionit në fuqi.

- Respektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi.

- Respektimin e intensitetit të N në zbatim të planit të përgjithshëm vendore.

21.1. Rekomandimi: *Inspektoriati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit dhe Drejtorinë Juridike Bashkia Kamëz, të marri masa për:*

- Kryerjen e kontrolleve të vazhdueshme në territorin e bashkisë për të gjitha ndërtimet e zhvilluara në këtë zonë me ose pa leje ndërtimi dhe për rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje të ushtrojë kompetencat në zbatim të akteve ligjore e nënligjore për kontrollin e territorit.

- Të ushtrojë kontrolle të vazhdueshme në të gjitha subjektet e pajisura me leje ndërtimi duke filluar nga piketimi i objektit dhe deri për mbylljen e tij, për mos devijimin e lejes së N të miratuar nga DPZHT dhe Kryetari i Bashkisë, kjo në zbatim të ligjit për kontrollin e territorit.

Masa shpërblim dëmi:

4.1. Rekomandim: *Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën* ***479,700 lekë pa TVSh*** *nga BOE* ***"E " & "P V" & "B" SHPK****, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4054 prot., datë 19.04.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore:

1.1. Rekomandimi: *Drejtoria e MTPM-se dhe Bordit Kullimit në bashkëpunim me Drejtorinë e FIncës të marrë masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve për taksën e tokës në vlerën* ***36,566,509 lekë*** *ndaj* ***6703 familjeve.***

1.2.Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Kamëz të ngrejë grup pune me specialist të fushës për saktësimin e sipërfaqes së tokës arë, pasi nuk janë reflektuar ndryshimet që kanë ndodhur si rezultat i zënies së saj nga ndërtimet pa leje e me leje ndërtimi, si dhe transaksionet e ndryshme që janë kryer nëpërmjet ASHK, duke ndryshuar pronarë.*

2.1 Rekomandimi: *Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej* ***270,787,856 lekë*** *ndaj* ***8467 personave,*** *sipas listës që administrohet nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Bashkia Kamëz.*

2.2 Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Kamëz të bashkëpunojë me Drejtorinë e ASHK Tiranë ose Ujësjellës Kanalizime Sh.A Kamëz, për lidhjen e një aktmarrëveshje si Agjent Tatimor në arkëtimin e detyrimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për 8467 ndërtimet e reja për uljen e borxhit në vlerën* ***270,787,856 lekë****.*

2.3 Rekomandimi: *Kryetari i Bashkisë Kamëz nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Tiranë, që të mos pajisë me certifikata pronësie subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

3.1.Rekomandimi: *Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të periudhës në vlerën* ***323,708,712 lekë****.*

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH*-së", germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*" nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", pika 93, **Titullari i Njësisë Publike** në bashkëpunim me **Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,455,968 lekë**, *si më poshtë*:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Blerje Pelet", si dhe zbatimit të Kontratës Nr. 2399 datë 25.03.2022, me vlerë 2,764,800 lekë (me TVSH), ka rezultuar penalitet për vonesat në lëvrimin e mallit e mos përmbushje të Kontratës në vlerën **779,673 lekë** me TVSh. Nga OE **"A& P" SHPK** në afatin e përcaktuar në kontratë, gjithashtu rezulton se nuk është lëvruar sasia e plotë të mallit dhe brenda afateve të përcaktuara, konkretisht për sasinë 90 ton të përcaktuar në kontratë, është lëvruar me 8 ditë vonesë sasia për 62.4 ton në vlerën 1,916,928 me TVSH, ndërkohë pjesa e mbetur e mallit prej 27.6 ton nuk është dorëzuar nga O.E "A& P.", duke mos përmbushur kontratën. Gjithashtu, shtyrja e zbatimit të Kontratës rezulton të jetë bërë nga grupi i marrjes në dorëzim të mallit, në kushtet e mos kompetencës dhe të mungesës së strukturës për monitorimin e saj. Për kontratën në fjalë nuk rezulton të ketë një amendim, modifikim apo shtesë për ndryshimin e kushteve të saj.

Veprime në mospërputhje me nenet 124 e 125, pika 4 e nenit 127 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik", neneve 106, 107 e 108 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"; neni 6.1 i Kontratës Nr.2399 datë 25.03.2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 241-265, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.**

<u>1.1. Rekomandimi:</u> Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **779,673 lekë** me TVSh dhe nga OE "A& P" ., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 2399 Prot., datë 25.03.2022, si pasojë e mos përmbushjes së saj.

Brenda datës 30 qershor 2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të N të kontratës për punë publike me objekt "Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza", me vlerë 72,285,722 lekë me TVSH, fituar nga BOE N. SHPK & "B" SHPK, <u>*rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara*</u>, për zërin e punimeve: "5(An-1) Trotuar, me pllaka betoni me ngjyra të kombinuara (30x30 + 15x15) për trotuare t=6cm" në vlerën **268,800 lekë pa TVSH,** si dhe mos realizim në objekt të "Zërit 2 (An-142) Bojë bikomponente (pastë) për kalim këmbësorësh me ngjyrë të kuqe dhe shirita të bardhë sipas detajit" sipas specifikimeve teknike në vlerën **504,000 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7477 prot., datë 23.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve BOE N. SHPK & "B" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 282-283, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **268,800 lekë pa TVSh** nga BOE N. SHPK & "B" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 7477 prot., datë 23.08.2022, me objekt "Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi "Nënë Tereza" Bashkia Kamëz.

Menjëherë

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërin e punës "Bojë bikomponente (pastë) për kalim këmbësorësh me ngjyrë të kuqe dhe shirita të bardhë sipas detajit" dhe t'i kërkojë realizimin sipas specifikimeve teknike, në vlerë **504,000 lekë** sipërmarrësit të punimeve nga BOE N. SHPK & "B" SHPK, në objekt brenda periudhës së garancisë se defekteve, para datës 10.01.2025 parashikuar në kontratën e sipërmarrjes së punimeve nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Operatori Ekonomik fitues. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas projektit të zbatimit (PZ) dhe specifikimeve teknike për vijëzimet e këmbësorëve, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve BOE N. SHPK & "B" SHPK, ku Bashkia Kamëz të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik.

Deri më 31 maj 2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të N të kontratës për punë publike me objekt "Rruga "Roskovec", segmenti 1,2 + Rr. "Florida" + Rr. "Rekjaviku" + Rr. "Berlin"+ Rr. "Skrapari" + Seg. Te rruga "Xhorxh Bush" + Seg. 1 te Blv. "Donald Tramp" + seg. 2 te Blv "Donald Tramp" + seg. 3 te Blv "Donald Tramp" + seg. 4 te Blv. "Donald Tramp" + Rr. "Altruisti" Rr. "Drita", me vlerë 58,316,780 lekë me TVSH, fituar nga OE "SH" SHPK, *rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara*, për zërin e punimeve: "Zëri 9 (3.288) F.V Hekur betoni i zakonshëm Ø>10 mm" nëobjektet "Ndërtim "Roskovec" seg. 1, 2 Kamëz 1" dhe "Ndërtim "Rekjaviku" seg. Kamëz 1" në vlerën **195,763 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6910 prot., datë 01.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve OE "SH" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 284-285, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën prej **195,763 lekë pa TVSH** nga OE "SH" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 6910 prot., datë 01.08.2022, me objekt "Rruga "Roskovec", segmenti 1,2 + Rr. "Florida" + Rr. "Rekjaviku" + Rr. "Berlin"+ Rr. "Skrapari" + Seg. Te rruga "Xhorxh Bush" + Seg. 1 te Blv. "Donald Tramp" + seg. 2 te Blv "Donald Tramp" + seg. 3 te Blv "Donald Tramp" + seg. 4 te Blv. "Donald Tramp" + Rr. "Altruisti" Rr. "Drita" Bashkia Kamëz.

Deri më 30 prill 2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të N të kontratës për punë publike me objekt: "Rikonstruksion i rrugës Skënderbeu", me vlerë 83,718,202 lekë me TVSH, fituar nga OE "A" SHPK, *rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara*, për punime ndërtimi në trotuar në vlerën **227,732 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7477 prot., datë

23.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve OE "A" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 286-287 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën prej **227,732 lekë pa TVSH** nga OE "A" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 7477 prot., datë 23.08.2022, me objekt "Rikonstruksion i rrugës Skënderbeu" Bashkia Kamëz.

Deri më 30 prill 2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të N të kontratës për punë publike me objekt "Rr. "William Shekspir" + Rr. "Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" + Rr. "Toni Bler" + Rr. "Iball" + Rr. "Daniel Alia", me vlerë 65,271,984 lekë me TVSH, fituar nga OE "E" SHPK, *rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike*, për zërin e punimeve: "Zëri 2 (An-142) Bojë antirrëshkitëse 2 mm me ngjyrë" në vlerën **120,000 lekë pa TVSH,** duke shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të Bashkisë Kamëz. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7673 prot., datë 31.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve OE "E" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 288-289, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërin e punës "Zëri 2 (An-142) Bojë antirrëshkitëse 2 mm me ngjyrë" dhe t'i kërkojë realizimin sipas specifikimeve teknike, në vlerë **120,000 lekë** sipërmarrësit të punimeve nga OE "E" SHPK, në objekt brenda periudhës së garancisë se defekteve, para datës 05.06.2025 parashikuar në kontratën e sipërmarrjes së punimeve nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Operatori Ekonomik fitues. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas projektit të zbatimit (PZ) dhe specifikimeve teknike për vijëzimet e këmbësorëve, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve OE "E" SHPK, ku Bashkia Kamëz të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik.

Deri më 30 prill 2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të N të kontratës për punë publike me objekt "Nd. Rr. "Albanët" + Rrugicat në Valias + Rr. "Këmbanët" + Trotuaret në Rr. "Amsterdam", Valias i Ri", me vlerë 73,112,196 lekë me TVSH, fituar nga OE "N" SHPK, *rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara*, për zërin e punimeve: "Zëri 8(3.605) Shtresë pllake t=6cm mbi shtresë betoni" në vlerën **144,000 lekë pa TVSH,** si dhe mos realizim në objekt të "Zërit (An-138) Vizime me bojë bikomponentë pastë për këmbësorë (Rruga Albanët, Valias i Ri; Ndërtim kunete dhe trotuare nga 1 anë + ndriçimi i rrugës "Amsterdam Kamëz)" *sipas specifikimeve teknike* në vlerën **216,000 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7691 prot., datë 31.08.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve OE "N" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 290-291, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **144,000 lekë pa TVSH** nga OE "N" SHPK,

për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 7691 prot., datë 31.08.2022, me objekt "Nd. Rr. "Albanët" + Rrugicat në Valias + Rr. "Këmbanët" + Trotuaret në Rr. "Amsterdam", Valias i Ri" Bashkia Kamëz.

Menjëherë

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërin e punës "Vizime me bojë bikomponentë pastë për këmbësorë (Rruga Albanët, Valias i Ri; Ndërtim kunete dhe trotuare nga 1 anë + ndriçimi i rrugës "Amsterdam Kamëz)" sipas specifikimeve teknike, në vlerë **216,000 lekë** sipërmarrësit të punimeve nga OE "N" SHPK, në objekt brenda periudhës së garancisë se defekteve, para datës 12.07.2025 parashikuar në kontratën e sipërmarrjes së punimeve nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Operatori Ekonomik fitues. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas projektit të zbatimit (PZ) dhe specifikimeve teknike për vijëzimet e këmbësorëve, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve OE "N." SHPK, ku Bashkia Kamëz të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit ekonomik.

Deri më 31.05.2024

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave fInciare të vitit 2022 konstatohet se vlera e kontabilizuar në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" për taksa dhe tarifa vendore për kategorinë familjare nuk është e saktë për arsye se në të nuk janë pasqyruar të gjithë debitorët e regjistruar në sistemin TAIS konkretisht më datën 31.12.2021, vlera e debitorë nga taksat dhe tarifat vendore është 201,973,700 lekë ndërsa më datën 31.12.2022, në vlerën 297,508,794 lekë. Ndërkohë qe në sistemin TAIS vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore për kategorinë "Familjar" më datën 31.12.2022, **është në vlerën 771,305,000 lekë e cila konsiderohet të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Kamëz.** Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin fInciar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4 pika 26,neni 5...., neni 11,...;Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave fInciare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika ç; ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar", VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores "*Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*", i ndryshuar, Manuali për MFK i miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 108 datë 17.11.2016, kapitulli III, Rregulloren e brendshme të bashkisë miratuar me aktin nr. 4119 prot. datë 11.05.2022, neni 36. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e FIncës të marrë masa të menjëhershme për kontabilizimin e saktë të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" në pasqyrat fInciare të vitit 2023 që i përkasin detyrimeve nga abonentëve familjarë duke bërë rakordimet përkatëse me sistemin TAIS. Gjithashtu të merren masa për arkëtimin e detyrimeve të abonentëve familjarë.

Deri më 31.05.2024

2. Gjete nga auditimi: Nga auditimi mbi masat marra për faturimin dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi, të pajisura me leje legalizimi nga DVASHK -Kamëz-Vore u konstatua se nga DTTV -Kamëz, nuk janë marrë masat për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t'i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare,... etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Vlera debitore progresive **është 297,509,794 lekë për 8,608 subjekte e cila konsiderohet të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Kamëz.**(nga të cilat 1084 subjekte për vlerën **42,580,000 lekë** krijuar në vitin 2022). Veprime këto në kundërshtim me pikën2 të nenit 89 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe të pikës 1 të nenit 22/5 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 99-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **297,508,794 lekë** ndaj **8,608** personave.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Transferimi i të dhënave dhe procesi i vjeljes së detyrimeve nuk është kryer konformë kuadrit rregullator në fuqi për krijimin, dërgimin, marrjen, mbrojtjen, ruajtjen, protokollimin, arkivimin e bazës së të dhënave. Sa më sipër rezultoi se:

- Nuk ka asnjë dokumentim për procesin e transferimit të të dhënave nga baza e të dhënave Kamza live në bazën e të dhënave Kamza Taksa Biznes.
- Mungon protokollimi dhe njohja e drejtorisë së financës për listën e të dhënave që ju nënshtruan transferimit, listave të të dhënave të cilat do të arkivohen (evidentim, protokollim dhe arkivim i kartelave dhe listës emërore dhe vlerave debitore për subjektet që nuk u transferuan dhe subjekteve të cilat janë subjekt arkivimi).
- Nuk ka asnjë dokumentim për Standardet e aplikuara në bazën e të dhënave për këtë proces; Të dhënat në lidhje me monitorimin e bazës së të dhënave dhe statistikave operacionale të këtij procesi; Bazën ligjore për ndryshimin e përbërjes së të dhënave, datën e fillimit të ndryshimit të përbërjes së të dhënave apo çdo ndryshim të nevojshëm që lidhet me ndryshimin e përbërjes së të dhënave; Të dhënat e personit përgjegjës për kryerjen e këtij procesi, roli i personit përgjegjës, të drejtat e personit përgjegjës, afatin e vlefshmërisë së të drejtave të personit përgjegjës, statusi i vlefshmërisë së të drejtave, nivelin e përgjegjësisë së personit përgjegjës.
- Mospërputhje në numrin e subjekteve taksapagues midis dy bazave të të dhënave, vlerën debitore te tyre në pasqyrat financiare dhe Vlera Debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore për vitin 2022 të dërguar në Bankat e nivelit të dytë për bllokim te vlerës që këto subjekte i detyrohen Bashkisë Kamëz**.**
- Në bazën e të dhënave Kamza Taksa Biznes për vitin 2020 nuk janë transferuar 2,414 subjekte. - Në pasqyrat fInciare për vitin 2020 nuk është pasqyruar një diferencë në vlerën **61,301,799 lekë.**
- Në bazën e të dhënave Kamza Taksa Biznes vlera debitore në vitin 2022 **është 72,538,602 lekë më pak** se vlera debitore në bazën e të dhënave Kamza Live në Vitin 2020 ulje kjo e pa argumentuar nga DTTV.
- Nuk rakordon vlera e detyrimit vjetor të subjekteve në sistemin e DTTV me atë të paraqitur në evidencat për raportim në pasqyrat fInciare për vitin 2022. Vlera Debitore e subjekteve

aktivë në "Kamza Taksa Biznes" për taksa dhe tarifa vendore më datë 31.12.2022 është **99,093,059 lekë, kjo vlerë ju përket 400 subjekteve (sipas sistemit). Subjekte pasive çregjistruar 133 subjekte me vlerë 53,606,637.34 (sipas evidencave të paraqitura nga sektori i borxhi).** Në pasqyrat fInciare, vlera debitore e subjekteve për taksa dhe tarifa vendore më datë 31.12.2022 është raportuar **85,866,370 lekë, kjo vlerë ju përket 395 subjekteve.**

Nga auditimi i procesit të vjeljes së detyrimeve u konstatua se ka debitorë të identifikuar dhe aktiv për të cilat DTTV është mjaftuar vetëm me nisjen e njoftim bllokimit të shumës pranë bankave të nivelit të dytë dhe nuk ka marrë asnjë masë për ndjekjen e etapave që parashikon legjislacioni në fuqi për vjeljen e tyre, duke rrezikuar parashkrimin e detyrimeve si pasojë e shmangies nga ndjekja e etapave. Mos ndjekja e etapave të përmendura më sipër dhe shtyrja në kohë e tyre bën që detyrimet e taksapaguesve të parashkruhen e si pasojë bëhet e pamundur vjelja e tyre. **Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkia Kamëz (Bilanci kontabël) Për kategorinë "Biznes" vlera debitore në fillim të periudhës ushtrimore është 121,835,012 lekë. Vlera e paraqitur për debitorët në fund të periudhës ushtrimore është 85,866,370 lekë. Vlera e debitorëve nga viti i kaluar është ulur me 35,968,642 lekë . Kjo ulje është e paargunentuar me dokumenta nga DTTV dhe nuk qëndron për arsyet e renditura më sipër .**

Grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion të saktë dhe të qenësishëm për situatën e menaxhimit, identifikimit, regjistrimit dhe vjeljes së të ardhurave në DTTV Kamëz për debin totale pasi ka pasaktësi në përcaktimet e të dhënave që shërbejnë si bazë për përllogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat, përgatitjen e evidencave për raportim dhe regjistrimit në pasqyrat fInciare. Ekzistojnë debitorë aktiv për të cilat DTTV nuk ka marrë asnjë masë për ndjekjen e etapave që parashikon legjislacioni në fuqi për vjeljen e tyre (bazuar në diferencat midis listës për bankë dhe listës debi).Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin FInciar dhe kontrollin", i ndryshuar; neni 5, neni 11,...; Ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat fInciare"; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave fInciare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat"; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni ..22/5..; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar"; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit kapitulli III, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108 datë.17.11.2016; nenin 22 të VKM nr. 945, datë 2.11.2012 për Miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore"; VKM nr. 357, datë 24.04.2013 për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e dokumentit elektronik në Republikën e Shqipërisë"; Udhëzimin nr. 17 datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Bashkia Kamëz të bëjë saktësimin e vlerës të kërkesave për arkëtim mbi debitorët për të gjitha subjektet tatimpagues, duke përllogaritur detyrimet tatimore bazuar në paketën fiskale të miratuar në vite dhe nëse dalin diferenca të planifikohen për tu arkëtuar dhe identifikuar debinë aktuale. Të paraqesin në dokumentacionin kontabël dhe në pasqyrat fInciare vlerën e saktë të tyre.

3.2 Rekomandimi: Bashkiak Kamëz të vendosi rregulla dhe procedura për njoftimin shqyrtimin dhe raportimin e dobësive administrative ku të përshkruaj qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit. Procesi i përpunimit të informacionit nga raportet që gjeneron sistemi të monitorohet në vazhdimësi nga menaxherët e të gjitha niveleve, për të garantuar marrjen e vendimeve të duhura të cilat prodhojnë pasoja financiare.

3.3 Rekomandimi: Bashkia Kamëz të bëjë saktësimin e vlerës të kërkesave për arkëtim mbi debitorët për të gjitha subjektet tatimpagues, duke paraqitur në dokumentacionin kontabël dhe në pasqyrat fInciare vlerën e saktë të tyre.
3.4 Rekomandimi: Bashkia Kamëz të ngrejë një grup pune për analizimin e të gjitha fazave të procesit të çregjistrimit të subjekteve debitore duke përllogaritur detyrimet tatimore bazuar në paketën fiskale të miratuar në vite dhe nëse dalin diferenca të planifikohen për tu arkëtuar dhe identifikuar debinë aktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjejtje nga auditimi: Nga auditimi i procesit për përllogaritjen e ngarkesave për taksa dhe tarifa lokale u konstatua se nuk rakordon vlera e detyrimit vjetor të subjekteve në sistemin e DTTV me kategorizimin e subjektit sipas paketës fiskale. U përzgjodhën në mënyrë rastësore 13 subjekte nga sistemi dhe u ndoq procesi i planifikimit të detyrimeve për taksa e tarifa vendore.
Detyrimi progresiv i evidentuar në sistem për këto 13 subjekte rezulton se nuk përputhet me detyrimin që duhet të llogaritej sipas kategorizimit në paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Kamëz.
Nga 3,248,672 lekë që duhet të planifikoheshin janë planifikuar 1,456,572 lekë, diferenca prej **1,791,800 lekë është e ardhur e munguar për Bashkinë Kamëz.** Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; VKB nr. 137 datë 22.12.2022 për "Sistemin e taksave dhe tarifat vendore në Bashkinë Kamëz"; nenin 36 të rregullores së brendshme të bashkisë miratuar me aktin nr. 4119 prot. datë 11.05.2022. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1 Rekomandimi: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e diferencave nga përllogaritja e gabuar e taksave dhe tarifave vendore nga biznesi i madh në atë të vogël për 13 subjekte në vlerën 1,791,800 lekë.
4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Njësisë së auditit të Brendshëm të marrë mision auditimi në DTTV Bashkia Kamëz për evidentimin e të gjitha rasteve të cilat ngarkesa fiskale nuk është sipas vlerës së detyrimit dhe të llogarisë diferencat për çdo subjekt e shtrirë kjo për vitin 2022.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i arkëtimeve të kontratave të qirasë për periudhën objekt auditimi u konstatua se pagesat nuk kryhen brenda intervaleve kohore të parashikuara në kontratë dhe nuk janë aplikuar penalitete bazuar në detyrimet kontraktuale. Njësia monitoruese e kontratave të qirasë është Drejtoria e Kadastres, nuk administron një regjistër të veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira, ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në m^2, numri dhe data e kontratës, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qerasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajit kalendarik, zbatimi i kushteve të kontratës....etj.
Për subjektin "(S.) P.S " konstatohet se pagesa nuk kryhen brenda intervaleve kohore, për pagesat jashtë afatit duhej të aplikohej penaliteti bazuar në detyrimet kontraktuale. P. S duhet të paguaj **kamatëvonesa në vlerën 21,356 lekë.**
Për subjektin "T.B ", konstatohet se pagesa nuk kryhen brenda intervaleve kohore, për pagesat jashtë afatit duhej të aplikohej penaliteti bazuar në detyrimet kontraktuale. Subjekti T.B duhet të paguaj **kamatëvonesa në vlerën 14,954 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Kadastrës të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e **vlerës 36,310 lekë** e cila u përket 2 subjekteve si kamatëvonesë për mos likuidimin e detyrimeve të kontratave për marrjen me qira të objekteve.
5.2. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Kamëz të merren masa për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e ecurinë e zbatimit të kontratave të qirasë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se pasqyrat fInciare të bashkisë, Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave nuk ka përfshirë debitorët e taksë së tokës që më datë 31.12.2022 rezultojnë në vlerën 56,704,963 lekë. Planifikimi i taksës së tokës nga viti në vit është bërë pa patur një databazë të saktë për ndryshimet që kanë ndodhur në pakësim të kësaj sipërfaqe nga ndërtimet e reja dhe ato informale si dhe transaksionet që janë kryer ndër vite për shitblerjen e saj duke ndryshuar pronarë për pasojë numri i familjeve debitore nga viti në vit vjen në rritje (ndarë tokë për 2599 familje dhe me datë 31.12.2022 rezultojnë debitorë 6924 familje në vlerën 56,704,963 lekë).
Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave nuk ka bashkëpunuar për inforM on me DPKZHT Bashkia Kamëz, për sipërfaqet që kanë kaluar për ndërtim objektesh dhe nuk ka informacion nga ASHK për ato sipërfaqe toke që kanë transaksione për shitje tokash apo për regjistrim të lejeve të N. Nga të dhënat e Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave sipas listave që administron kjo drejtori rezultojnë se janë debitorë më datë 31.12.2022 për Taksë Toke, **6,924 familje në vlerën 56,704,963 lekë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.** Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar; Udhëzimin nr.13 datë 26.04.2018 Për zbatimin e ketij vendimi; Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 233 datë 29.03.2019, i ndryshuar; Kontratën me nr. 792 rep, 630 kol. datë 01.04.2019,kontratën nr. 4584 prot., datë 19.06.2020,Kontratën nr.1623 prot. datë 25.02.2020; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar neni 23...; dhe VKB nr. 137, datë 22.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz, Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, të marrë masa për saktësimin e regjistrave në përputhje me gjendjen faktike të tokës bujqësore, kontabilizimin e detyrimeve dhe marrjen e masave duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara taksa e tokës bujqësore në total në **vlerën 56,704,963 lekë** duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.
6.2. Rekomandimi: Bashkia Kamëz, Drejtoria e FIncës të sistemojë llogarinë 468 "Debitor të ndryshëm", duke pasqyruar në të vlerën 56,704,963 lekë, e cila u përket debitorëve nga taksa e tokës bujqësore.
6.3. Rekomandimi: Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, si njësi monitoruese e kontratave të qirasë, të rakordojë me Drejtorinë e Financës & Kontabilitetit, për vlerat e arkëtuara nga subjektet qiramarrës të aseteve të bashkisë si dhe të llogariten e arkëtohen penalitetet për pagesat jashtë afatit, bazuar në kushtet e kontratës.

Menjëherë dhe vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve nga taksat për subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtisë së karburantit dhe GLN në territorin e Bashkisë Kamëz u konstatua se ka subjekte debitorë dhe që ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me autorizimet përkatëse konkretisht:

a. 14 subjekte debitorë më datën 31.12.2022, në vlerën **2,864,000 lekë** subjekte që ushtrojnë aktivitet dhe nuk është marrë asnjë masë për ndjekjen e etapave që parashikon legjislacioni në fuqi për vjeljen e tyre.

b. 8 subjekte nuk janë të pajisura me autorizimet përkatëse. Mos pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, për vitin 2022, ka reflektuar dhe në **mungesë të ardhurave në Buxhetin e Bashkisë Kamëz në vlerën 1,316,000 lekë.**

Drejtoria e Transportit Lejeve dhe Licencave nuk ka marrë masat e duhura administrative për aplikimin e gjobave ndaj këtyre subjekteve dhe nuk i është drejtuar Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për marrjen e masa përkatës por këto subjekte ende vazhdojnë aktivitetin.

c. Në 13 raste në periudha dhe intervale kohë të ndryshme nuk është aplikuar në kohë për pajisjen me Autorizime të subjekteve në fushën e tregtisë së karburanteve. Ky veprim ka sjellë **mungesë të ardhurave në Buxhetin e Bashkisë Kamëz në vlerën 2,618,666 lekë.**

d. Subjektet me objekt aktiviteti tregti karburanti në Bashkinë Kamëz nuk janë të pajisura me leje aktiviteti 24 orësh. duke reflektuar në **të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Kamëz në vlerën 660,000 lekë.** Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni, 89, 90...e vazhdim; Udhëzimin e përbashkët nr. 17, datë 20.06.2022, i Ministrit të FIncave dhe Ministrit të Brendshëm "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore"; UMF nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; VKB nr. 137 datë 22.12.2022, "Për sistemin e taksave dhe tarifat vendore ne Bashkinë Kamëz", germa "f", pika 1.1/b.

Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se në ***3 raste*** në dosjet e subjekteve që janë pajisur me autorizim për tregtimin e karburantit dhe të GLN janë konstatuar mangësi në dokumentacion. U analizuan me zgjedhje 8 dosje me praktikat për pajisjen me karburant të subjekteve dhe u konstatua se në dokumentacionin e administruar në dosje ka mangësi:

Subjekti me NIPT- J.....P, me vendndodhje në Kamëz është pajisur me Autorizim nr. 035/01 lëshuar në datë 21.01.2022 me afat 5 vjeçar (rinovim)

-kërkesat të pa plotësuara me llojin e dokumentacionit pa inventar dosje;

-pa nënshkrimin e personit përgjegjës për marrjen e dokumentacionit;

Subjekti NIPT- J.....P, me vendndodhje Rr. N. Tereza Kamëz) ZK 3993 nr. pas.11/467 pajisur me Autorizim nr. **036/01,** lëshuar në datë 21.01.2022, me afat 5 vjeçar (rinovim)

-kërkesat të pa plotësuara me llojin e dokumentacionit pa inventar dosje;

Subjekti me NIPT L.....O me adresë Bathore pajisur me Autorizim nr. **038/03,** lëshuar më datë 28.03.2022 me afat 1 vjeçar (rinovim).

-Polica e sigurimit për përgjegjësinë civile ndaj të tretëve për treguesit e naftës dhe të gazit mungojnë dosje administrohet policë kaluar afatin kohor të vlefshmërisë (19.01.2021 - 18.01.2022);

-Vërtetimi nga DPT (DRT-DSHT) nr. 323 datë 31.01.2022 vërteton se subjekti është debitor në vlerën ***1,051,177 lekë*** (në përgjegjësitë tatimore T/Fitim, T/Burim /Kontr /Sig /shoq/shend/TAP);

Duke ju referuar praktikave të mësipërme organi që ka përgjegjësi për dhënien e licencave, Drejtoria e Licencave nuk ka ushtruar kontroll për të dhënat dhe treguesit e paraqitur në dokumentacionin e personit juridik kërkues.

Gjithashtu nuk ka analizuar vërtetimin e DPT që subjekti "P. " është debitor në vlerën 1.051.177 lekë, detyrime tatimore (në përgjegjësitë tatimore T/Fitim, T/Burim /Kontr /Sig /shoq/shend/TAP). Veprime këto në kundërshtim me Vendimi nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" (ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017) (i përditësuar), Kreu II, Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, pika 2. paragrafi f) dhe g). *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Transportit Lejeve dhe Licencave ne bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencën për aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Transportit dhe Licencave në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet 24 orësh" me qëllim aplikimin dhe pajisja me leje aktiviteti 24 orësh, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara.

7.3. Rekomandimi: Drejtoria e Transportit Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara në **vlerën totale 7,458,666 lekë.**

7.4. Rekomandimi: Drejtoria e Transportit, Licencave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masat e nevojshme për evidentimin dhe regjistrimin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj si dhe mos pajisjen e tyre me leje/licenca/autorizime, pa plotësuar dokumentacionin e plotë ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga Drejtoria e Transportit, Licencave e Lejeve nuk është paraqitur një pasqyrë reale mbi aktivitetin e subjekteve që tregtojnë karburant me adresa aktiviteti në territorin e Bashkisë Kamëz. Kjo drejtori nuk administron një regjistër të saktë dhe të azhurnuar për evidentimin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë. Janë konstatuar subjekte që zhvillojnë këtë aktivitet pa u identifikuar dhe regjistruar në regjistrin e të dhënave që administron drejtoria e licencave, konkretisht:

Subjekti me NIPT L.....P me adresë sekondare: Kamëz, Rruga "Skënderbeu" ZK nr. 1649 nr.pas.27/39 i cili ushtron aktivitetin "Tregti Karburanti" shtuar këtë adresë sekondare(regjistruar në QKB) më datë 25.03.2021. Për këtë subjekt nuk janë parashikuar të ardhura në planin e të ardhurave për vitin 2022.

Duke bërë përllogaritjet si rezultat i mos regjistrimit të subjektit "Ll.D." SHPK, dhe mos pajisjes me autorizim vitet 2021, 2022, **evidentohen të ardhurat të munguara në vlerën 404,000 lekë.**

Bashkia Kamëz nuk ka marrë masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar (as vetë, as nëpërmjet bashkëpunimit duke informuar dhe kërkuar nga institucionet e tjera që përcakton kuadri rregullator ne fuqi), deri në ri paraqitjen e dokumentacionit të plotë nga ana e subjekteve përkatëse.

Nga Bashkia Kamëz nuk konstatohet asnjë shkresë ku të njoftohet me listë subjektesh, vendndodhje, etj., Inspektorati Shtetëror Përgjegjës (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë), për bllokimin e përkohshëm të veprimtarisë së këtyre subjekteve të pa licencuar, apo për propozimin pranë ministrisë përgjegjëse të hidrokarbureve, për fillimin e procedurave të heqjes së licencës së tregtimit me pakicë në stacionet e karburanteve apo njësitë e tregtimit të lëndeve djegëse.
Aktualisht në Bashkinë Kamëz zhvillojnë aktivitet 16 subjekte me liçensë të pa rinovuar dhe 16 subjekte të pa pajisur me licencë.
Veprime këto në kundërshtim VKM nr. 970, datë 02.12.2015, i ndryshuar; Pika nr. 6, nr. 6.1 nr. 12. Pika 3, e nenit 25, të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar; Pika nr. 3 e nenit nr. 25 të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999; Rregulloren e Brendshme e Bashkisë Kamëz (Vendim nr. 4119 datë 11.05.2022, Kryetarit të Bashkisë) neni 34; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; VKB nr. 137, datë 22.12.2022, "Për sistemin e taksave dhe tarifat vendore në Bashkinë Kamëz". *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 79-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Transportit, Licencave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e **vlerës 404,000 lekë e cila i** përket 1 subjekti si rezultat i mosregjistrimit, dhe mos paisjes me autorizim.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Kamëz, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, u konstatua se niveli i arkëtimeve është i ulët. IMTV dhe Bashkia Kamëz nuk kanë marrë të gjitha masat për arkëtimin e këtyre gjobave. Për periudhën objekt auditimi janë arkëtuar **17** gjoba në vlerën **2,170,338 lekë** dhe janë të pa arkëtuara **17** gjoba në vlerën **4,683,017 lekë,** duke **sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Kamëz në vlerën prej 4,683,017 lekë.**
Sa më sipër, u konstatua se për të gjitha praktikat IVMT, DTTV-ja dhe, Drejtoria Juridike nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Kamëz në vlerën prej **4,683,017 lekë.**
Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit u konstatua se vlera totale e gjobave të pa arkëtuara (të vendosura ndër vite nga IVTM) është 128,048,412 Lekë.
Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar; VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*"; Ligji, nr. 10 279, datë 20.5.2010 "*Për Kundërvajtjet Administrative*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 79-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria Juridike dhe IVMT të merren masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave të vendosura nga IVMT. Gjithashtu, të merren masat për përllogaritjen e kamat-vonesës dhe vjeljen e saj në çdo rast që gjobat nuk paguhen brenda afateve të përcaktuara, për vendosjen në dijeni dhe rritjen e bashkëpunimit me Shërbimin Përmbarimor, si dhe Drejtorinë e FIncës dhe Buxhetit, Bashkia Kamëz.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 "*Llojet e masave disiplinore*" të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë", shkronja (b) e nenit 9 "*Masa disiplinore* ", të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kamëz** të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **34 (tridhjet e katër) punonjës,** si më poshtë:

1. Z. K.H , me detyrë Specialist, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
2. Zj. A.S , me detyrë Specialiste, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
<u>Për shkeljet e mëposhtme:</u>
Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në shqyrtimin jo të kujdesshëm të dokumentacionit të OE pjesëmarrës, kualifikimin e ofertës ekonomike në kushtet mosplotësimit të kritereve të vendosura në DST, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike, veprim në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi në prokurimin publik, konkretisht: *me pikën 4 të nenit 87"Kriteret për shpalljen e ofertës fituese", me pikat 1 dhe 3 të nenit 92 "Shqyrtimi i ofertave", të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe me pikën 2 të nenit 82"Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, konkretisht në praktikën*:
- "Blerje makinë MZSH" për vitin 2022" (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4 faqe 249-256 *të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3. Zj. SH.GJ , me detyrë Përgjegjëse e Njësisë së Prokurimit, në cilësinë e Kryetarit të Hartimit të DST.
4. Z. S.S, me detyrë Specialist në Njësinë e Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Hartimit të DST.
5. Zj. S.V , me detyrë Specialist në Njësinë e Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Hartimit të DST.
<u>Për shkeljet e mëposhtme:</u>
a-Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në vendosjen e kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi të prokurimit publik, konkretisht: me nenet 1 dhe 2, pikën 1 të nenit 21, nenin 77 "Kërkesat për Kualifikim", të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe me nenin 39 "Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike, *pikën 2 dhe 3 dhe 6 të nenit 40 "Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave",* të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; *konkretisht në procedurat e prokurimit*:
-"Rikonstruksion shkolla e mesme "Gramoz Palushi", Babrru, Njësia Administrative Paskuqan", -"Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari"", (3)-"Ndërtim rruga "Albanët" + rrugicat Valias + rruga "Këmbanat",

-"Ndërtim Rr. Frutikulturë (Rr. pungul me Rrugën Azem Galica + Rr. "Isuf Gervalla" + Rr. "Brezaret",
-"Ndërtimi i Pedonales dhe zonave rekreative të Parkut të Liqenit Paskuqan",
-"Ndërtimtrotuare + Ndriçim Rruga "Jon" + Rruga "Fushë Arrëz",
-"Nërtim rrugët (Rr. "Ëilliam Shekspir" + Rr."Sami Frashëri" + Rr. "Dituria" +Rr. "Isuf Gërvalla"+ Rr. "Brezaret"+ Rr. "Daniel Alia",
-"Nërtim rrugët "Lidhja e Prizrenit" Njësia Administrative Babrru, Paskuqan",
-"Nërtim rrugët "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Azem Hajdari" Zall-Mner Bashkia Kamëz", - "Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamëz,
-"Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare "Halit Çoka (ish Elez Isufi)",
- "Ndërtim rrugët Rr. Erzeni, Rr. Marubi, Rr. Valbona, Rr. Tomorri",
-"Blerje makinë MZSH" për vitin 2022",
-"Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshteve"
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4 faqe 256-264 *të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

b-Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurat me blerje me vlera të vogla, konstatuar me shkelje të përcaktimeve ligjore në DST, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4 faqe 256-264 *të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6. Zj. O.G , Drejtoria Arsimore Kamëz, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit".
7. Zj. F.P , Drejtoria Arsimore Kamëz, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit".
8. Z. A.P , Drejtoria Arsimore Kamëz, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit".

<u>Për shkeljet e mëposhtme:</u>

Në cilësinë e anëtarit të grupit të punës "Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit", në vendosjen e specifikimeve teknike të pa argumentuara teknikisht e ligjërisht dhe në përllogaritjen e fondit limit, bazuar në studimin e tregut mbi subjekte të cilat nuk janë të licencuara ose nuk kanë në fushën e aktivitetit objektin e prokurimit, pa siguruar një studim real të tregut, veprim në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi në prokurimin publik, konkretisht: me pikën 2 të nenit 78 "Hartimi dhe Publikimi i dokumenteve të tenderit", pikat 1 dhe 2 të nenit 40 "Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave", *me nenin 12 "Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës" , nenin 13 "Studimi paraprak i tregut" dhe nenin 76 "Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së Prokurimit" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, konkretisht në praktikën*:
- "Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshteve" 2022 (më hollësisht trajtuar në pikën 13 faqe 249-256 *të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9. Z. A.D , me detyrë Drejtor i Drejtorisë Arsimore, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe kërkuesi i kësaj procedure.
10. Zj. E.D , me detyrë Specialiste në Drejtorinë Investimeve dhe Projekteve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

<u>Për shkeljet e mëposhtme:</u>

Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në mos dokumentimin e marrjes në dorëzim të mostrave dhe verifikimin e tyre nëse janë dorëzuar sipas specifikimeve teknike të DST, veprim në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi në prokurimin publik, konkretisht: me pikat 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Nr.2, datë 02.05.2019 "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE" të APP.

- “Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshteve” 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4 faqe 249 - 256 *të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11. Z. A.P , Drejtoria Arsimore Kamëz, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës “Për marrjen në dorëzim të mallit”
12. Zj. F.P , Drejtoria Arsimore Kamëz, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës “Për marrjen në dorëzim të mallit”
13. Zj. E.E , Drejtoria Arsimore Kamëz, në cilësinë e anëtarit të grupit të “Për marrjen në dorëzim të mallit”.
<u>Për shkeljet e mëposhtme:</u>
Në cilësinë e anëtarit të grupit të punës “Për marrjen në dorëzim të mallit”,në mos zbatimin e kushteve dhe afateve të përcaktuara në Kontratën Nr.2399 datë 25.03.2022, në mos kompetencën dhe arsyetimin ligjor për shtyrjen e afateve të lëvrimit të mallit (nuk ka amendim, modifikim apo shtesë kontrate), duke sjellë penalitet për vonesat në lëvrimin e mallit e mos përmbushje të Kontratës në vlerën **779,673 lekë** me TVSh nga OE fitues, veprim në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi në prokurimin publik, konkretisht: me nenet 124 e 125, pika 4 e nenit 127 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik“, neneve 106, 107 e 108 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“; neni 6.1 i Kontratës Nr.2399 datë 25.03.2022, konkretisht në praktikën:
- “Blerje pelet për ngrohjen e shkollave dhe kopshteve” 2022(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4 faqe 249-256 *të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14. Z. E.Bme detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz, konstatuar me shkelje në 5 (pesë) raste në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, procesin kontabilizimit të të ardhurave dhe menaxhimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263 – 273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
15. Znj. G.D me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Terrenit, në Bashkinë Kamëz, konstatuar me shkelje në 8 (tetë) raste në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, menaxhimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
16. Z. E.S me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave Familjare, në Bashkinë Kamëz, konstatuar me shkelje në 3 (tre) raste në lidhje me procesin e kontabilizimit të të ardhurave, planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe menaxhimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
17. Znj. R.D Përgjegjës i Sektorit të Analizës dhe Kontabilizimit të Detyrimeve, konstatuar me shkelje në 5 (pesë) raste në lidhje me procesin e kontabilizimit të të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
18. Znj. M.Q me detyrë Specialist i Menaxhimit të Borxhit, konstatuar me shkelje në 21 (njëzet e një) raste në të cilat nuk ka dokumentacion për justifikimin e veprimeve të kryera në sistem, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
19. Z. Z.L , me detyrë Inspektorë të Terrenit, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
20. Z. A.A , me detyrë Inspektorë të Terrenit, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në

përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21. Z. K.N, me detyrë Inspektor të Zonës, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22. Z. E.D, me detyrë Inspektor të Zonës, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23. Znj. XH.M , me detyrë Inspektor të Zonës, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24. Znj. M.GJ , me detyrë Inspektor të Zonës, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25. Znj. R.M , me detyrë Inspektor të Zonës, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26. Z. G.P , me detyrë Inspektor të Zonës, konstatuar me shkelje në lidhje me detyrat funksionale të inspektimit në terren e cila ndikon për realizimin e ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27. **Znj. L.K,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit të Detyrimit dhe Menaxhimit të Borxhit, në Bashkinë Kamëz, konstatuar me shkelje në 3 (tre) raste në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

28. Z. M.G, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të IT, konstatuar me shkelje në 3 (tre) raste në lidhje me menaxhimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29. Z. SH.L, me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Liçensave dhe Transportit, konstatuar me shkelje në 6 (gjashtë) raste në lidhje me, mosmarrjen e masave për faturimin dhe arkëtimin e taksës për subjektet debitorë në fushën e tregtisë së karburantit dhe GLN, për mungesë të ardhurash, nga mos lëshimi i licencave/autorizimeve të subjekteve që tregtojnë karburante, për subjektet që kanë ushtruar aktivitet pa autorizim, për mos pajisje me leje aktiviteti 24 orësh të subjekteve me objekt aktiviteti tregti karburanti, për subjekte që zhvillojnë aktivitet për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, të pa evidentuara nga Drejtoria e Transportit, Licencave e Lejeve, për dhënien e Autorizimeve për subjektet që tregtojnë karburante, gaz të lëngshëm të naftës, pa plotësuar kriteret e parashikuara në aktet ligjore, nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në njësinë administrative të Bashkisë Kamëz, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

30. Z. K.H , me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Liçensave, konstatuar me shkelje në 6 (gjashtë) raste në lidhje me, mosmarrjen e masave për faturimin dhe arkëtimin e taksës për subjektet debitorë në fushën e tregtisë së karburantit dhe GLN, për mungesë të ardhurash, nga mos lëshimi i licencave/autorizimeve të subjekteve që tregtojnë karburante, për Subjektet që

kanë ushtruar aktivitet pa autorizim, për mos pajisje me leje aktiviteti 24 orësh e subjekteve me objekt aktiviteti tregti karburanti, për subjekte që zhvillojnë aktivitet për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, të pa evidentuara nga Drejtoria e Transportit, Licencave e Lejeve, për dhënien e Autorizimeve për subjektet që tregtojnë karburante, gaz të lëngshëm të naftës, pa plotësuar kriteret e parashikuara në aktet ligjore, nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në njësinë administrative të Bashkisë Kamëz, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

31. Z. F.L, z. A.GJ me detyrë Specialist të Licencave, konstatuar me shkelje në 6 (gjashtë) raste në lidhje me, mosmarrjen e masave për faturimin dhe arkëtimin e taksës për subjektet debitorë në fushën e tregtisë së karburantit dhe GLN, për mungesë të ardhurash, nga mos lëshimi i licencave/autorizimeve të subjekteve që tregtojnë karburante, për subjektet që kanë ushtruar aktivitet pa autorizim, për mos pajisje me leje aktiviteti 24 orësh e subjekteve me objekt aktiviteti tregti karburanti, për subjekte që zhvillojnë aktivitet për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, të pa evidentuara nga Drejtoria e Transportit, Licencave e Lejeve, për dhënien e Autorizimeve për subjektet që tregtojnë karburante, gaz të lëngshëm të naftës, pa plotësuar kriteret e parashikuara në aktet ligjore, nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në njësinë administrative të Bashkisë Kamëz, veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 263-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32. **Zj. R.H,** me detyrë "Drejtore" e Burimeve Njerëzore.

<u>Për shkeljet e mëposhtme:</u>

Në cilësinë e personit përgjegjës për mos ndjekjen e procedurave të rekrutimit të burimeve njerëzore, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për nëpunësit civilë sipas ligjit ne fuqi dhe mangësitë në të dhënat e dosjeve të personelit për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi, konkretisht; nenit 11, pika c të ligjit 114.2015 dhe VKM-në nr. 833 datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 18; 31-79; të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

33. Z. A.L , me detyrëKryeinspektor i IVMT-së.

<u>Për shkeljet e mëposhtme:</u>

Në cilësinë e personit përgjegjës për mangësitë e evidentuara në organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kamëz. U konstatua se kjo strukturë nuk e ka përmbushur plotësisht qëllimin e saj, garantimin dhe mbrojtjen për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore përkatëse, veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi, konkretisht; nenin 5, germa (d), (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore" (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 79-273 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

34. Z. E.B , me detyrë"Drejtor"iDPZHT-së.

<u>Për shkeljet e mëposhtme:</u>

Në cilësinë e personit përgjegjës për mungesën e një bashkëpunimi efiçent, midis IVMT-së dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, N, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e

përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit në Bashkinë Kamëz, veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi, konkretisht; me pikën (3) të nenit 51 në Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 18; 31-79; të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

F. <u>PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRTËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL.</u>

Për punonjësit për të cilët do merret masë disiplinore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë**:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

V. ANEKSET

Anekset e mëposhtme, tabelat dhe pasqyrat janë pjesë përbërëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, ku në mënyrë më të zgjeruar trajtohen çështje të caktuara.

Aneksi Nr.2.4. "Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve" nga faqja 149-251 të Raportit të auditimit.

Tabela Nr. 2.4.1 Regjistri i Realizimit të Prokurimeve Publike me vlera të mëdha, në Bashkinë Kamëz për Vitin 2022

Nr.	Objekti i Prokurimit	Tipi i kontratës	Lloji i procedures	Fondi Limit Lekë (pa tvsh)	Vlera e kontratës Lekë (pa tvsh)	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes së kontrates	Afati i punimeve në ditë pune
1	Nd.Rr."Albanet"+Rrugicat ne Valias+Rr."Kembanat"+Trotuaret në Rr."Amsterdam" Valias i Ri	Punë	E hapur	62,386,798	60,926,830	N	31.08.2022	119
2	Nd.Rr."Shen Gjergji"+Rr."Ali Pashe Gucia"+Rr. Arberia"+Seg.pingul me Rr."Selishte"+Rr."Vore"	Punë	E hapur	55,870,362	50,699,379	B.SHPK	17.10.2022	108
3	Nd.Rruga "Kongrei i Dibres"	Punë	E hapur	21,799,353	20,272,300	D.	17.10.2022	84
4	Ndertim Rr. Frutikulture (Rr.pingul me Rrugen Azem Galica + Rr."Isuf Gervalla" + Rr."Brezaret")	Punë	E hapur	85,269,315	83,241,321	V.	09.09.2022	168
5	Ndertim rruga "Haki Taha" Paskuqan 1	Punë	E hapur	11,829,704	9,866,700	XH SHPK	21.09.2022	59
6	Ndertim rruga "Josef Marksel"Paskuqan 1	Punë	E hapur	12,580,000	10,994,615	Sh.	03.10.2022	70
7	Ndertim Rruga "Nato"+ KUN + Trotuare	Punë	E hapur	82,990,760	59,418,186	C.	06.10.2022	136
8	Ndertim rruga "Sado Shenko"	Punë	E hapur	16,755,074	12,811,349	C.	10.10.2022	95
9	Ndërtim rruga OSBE-Bulevardi "Nënë Tereza"	Punë	E hapur	75,510,093	60,073,102	B ...	05.05.2022	112
10	Ndertim rruga Skenderbeu	Punë	E hapur	73,878,487	69,916,835	A.	23.08.2022	125
11	Ndertim rruga tek "Çerdhja e re shkolla Isa Boletini"Paskuqan 2	Punë	E hapur	22,754,371	19,636,521	D.	12.09.2022	76
12	Ndertim Rrugesh Zallmner - Frutikulture	Punë	E hapur	43,278,185	40,736,700	L.	21.09.2022	135
13	NdërtimrrugetBlloku Babrru Shpat 2 Komplet	Punë	E hapur	74,687,761	54,107,430	K...	24.11.2022	125
14	Ndertim rruget (Ëilliam Shekspir + Sami Frasheri+Dituria + Toni Bler +Iballe)	Punë	E hapur	55,493,000	54,393,320	E.	31.08.2022	115
15	Ndertim rruget Babrru Shpat	Punë	E hapur	68,834,105	64,694,104	B.	12.10.2022	125
16	Ndërtim rrugët Bathore 1	Punë	E hapur	54,345,395	49,896,780	K .	12.09.2022	105
17	Ndërtim rruget Kamez 1,2	Punë	E hapur	51,189,627	48,597,317	SH.	01.08.2022	150
18	Ndertim rruget(hamburg+Ylberi+Usaid)	Punë	E hapur	49,988,913	36,807,130	N	27.09.2022	115
19	Ndertim rruget(Rr.Erzeni+Rr.Marubi+Rr.Valbona+Rr.Tomorri)	Punë	E hapur	59,577,725	55,639,430	K	03.10.2022	135
20	Ndertim rrugs "Isa Boletini"Paskuqan 1	Punë	E hapur	19,200,000	16,840,759	2 N	10.10.2022	82
21	Ndertim trotuare + Ndricim Rruga "Jon" + Rruga "Fushe Arrez"	Punë	E hapur	32,500,000	30,695,793	L	14.12.2022	90
22	Ndertim Ura Kembesoreve Laknas-Valias	Punë	E hapur	31,288,930	28,204,099	M.N	24.08.2022	95
23	N i Pedonales dhe Zonave Rekrative te Parkut te Liqenit Paskuqan	Punë	E hapur	209,703,648	198,978,984	U...	03.08.2022	8

24	N i rrugeve (Rr."Pavaresia e Kosoves"+Rr."Pashko Vasa"+Rr.Pishtaret e Demokracise"+RR.Mustafa Qemal Ataturku+AthI+Dubai)	Punë	E hapur	43,947,054	37,572,966	D....	29.09.2022	152
25	N , Rikualifikimi Urban i Rruges"Kujtesa"+ segmentet	Punë	E hapur	78,819,283	67,502,060	A	21.10.2022	152
26	N , Rikualifikimi Urban i Rruges vazhdim i rruges Harku i Triumfit	Punë	E hapur	26,857,870	25,798,730	U	01.08.2022	73
27	Rehabilitimi i Rruges "Kozare"	Punë	E hapur	31,279,836	26,974,890	L	12.10.2022	109
28	Rr.Blloku i pallatevePaskuqan 1	Punë	E hapur	16,087,833	12,302,597	C.	17.10.2022	82
29	Sistemimi i fushavesportiveprane shkolles "Halit Coka" dhe shkolles "Arberia"	Punë	e hapur e thjeshtuar	10,143,704	3,504,368	2 N	11.08.2022	40
		Punë			6,102,100	2 N	11.08.2022	40
30	Blerje kancelari	Mall	e hapur e thjeshtuar	6,066,666	4,581,711	I.	31.05.2022	30
31	Blerje Karburanti	Mall	e hapur	12,786,667	12,378,664	E.	31.05.2022	365
32	Blerje makine MZSH	Mall	e hapur	10,900,000	10,728,000	S 32	29.06.2022	10
33	Blerje mjet transporti per shperndarjen e ushqimeve neper kopshte e cerdhe	Mall	e hapur e thjeshtuar	2,083,333	2,050,000	A.	21.06.2022	30
34	Blerje mjete pastrimi	Mall	e hapur e thjeshtuar	6,983,333	5,357,770	M.	21.06.2022	30
35	Blerje pelet per ngrohjen e shkollave dhe kopshteve	Mall	e hapur e thjeshtuar	2,325,060	2,304,000	A...	25.03.2022	5
36	Blerje ushqime per femijet e kopshteve dhe cerdheve	Mall	e hapur	10,000,000	1,815,345	3 - SH	07.06.2022	365
		Mall			2,615,870	N.	06.06.2022	365
		Mall			1,598,000	M..	06.06.2022	365
		Mall			1,751,400	N.	06.06.2022	365
37	Mbikqyrje e punimeve per objektin "Ndertime rruge ne zonen Valias + Frutikulture	Shërbim	e hapur e thjeshtuar	3,305,109.90	384,532	B.	17.10.2022	
		Shërbim			1,041,665	I.	12.10.2022	
		Shërbim			765,581	I.	12.10.2022	
38	Mbikqyrje e punimeve per objektin: Ndertim rrugeper zonen Paskuqan	Shërbim	e hapur e thjeshtuar	2,485,675	186,461	"D."	12.10.2022	
		Shërbim			243,039	"D."	12.10.2022	
		Shërbim			304,326	"D."	12.10.2022	
		Shërbim			243,049	"D."	12.10.2022	
		Shërbim			235,599	"D."	12.10.2022	
		Shërbim			195,320	"D."	12.10.2022	
		Shërbim			788,376	Z	12.10.2022	
39	Mbikqyrje e punimeve zona Kamez	Shërbim	e hapur e thjeshtuar	2,994,325	485,252	"D."	17.10.2022	
		Shërbim			581,488	N.	17.10.2022	
		Shërbim			570,582	N.	17.10.2022	

		Shërbim			283,130	I.	24.10.2022	
		Shërbim			734,234	H.	18.10.2022	
40	Blerje bojra per printer e fotokopje	Mall	e hapur e thjeshtuar	5,800,000	3,352,600	E.	06.01.2022	
41	Blerje pelet per ngrohjen e shkollave dhe kopeshteve	Mall	e hapur	17,666,667	17,600,000	A SHPK	02.03.2023	365
42	Blerje kosha per selksionim mbetjesh	Mall	e hapur e thjeshtuar	2,205,750	1,896,300	L.	24.02.2023	30
43	Blerje peme + lule ne kuadrin e projektit " Mjedis i paster, arsim i shendetshem dhe cilesor ne shkollat e bashkise Kamez"	Mall	e hapur e thjeshtuar	1,463,375	1,340,000	GJ.	24.02.2023	40
44	Furnizim vendosje Kamera ne hapsiratpublike te Bashkise Kamez	Mall	e hapur	20,833,334	20,500,000	AL.	09.02.2023	44
45	Ndertim rruga ArgjItura nga Kryqezimi i rruges Berisha me rrugen Beselidhjen (Albavija) deri tek rruga Dajti	Punë	e hapur	54,389,491	46,599,600	K	28.04.2023	88
46	RiN i shetitores"B. Gazidede" Bathore	Punë	e hapur	45,833,333	41,076,612	SH.	19.04.2023	104

Tabela Nr. 2.4.2 Regjistri i Realizimit të Prokurimeve Publike në Kuadër të RiN me Marrëveshje Kuadër, në Bashkinë Kamëz, për Vitin 2022.

Nr/R	E m ë r ti m i	Tipi i kontratës	Lloj i procedures	Fondi limit lekë (pa tvsh)	Vlera e fituesit lekë (pa tvsh)	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes së kontrates	Afati ipunimeve
1	Rindërtimi ishkollës 9 vjeçare "Demokracia".	Punë	Marrëveshje Kuadër	382,257,411	380,257,411	A.	13.04.2022	9 muaj dhe 1 muaj projekt
2	Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Halit Coka (ish shkolla Elez Isufi)".	Punë	Marrëveshje Kuadër	437,807,824	435,807,800	A.	13.04.2022	9 muaj dhe 1 muaj projekt
3	RiN im shkolles 9 vjecare "Azem Hajdari" Babrru	Punë	Marrëveshje Kuadër	496,070,422	492,290,400	E.	17.08.2022	9 muaj+ 1 muaj projekt
4	RiN i shkoles 9 vjeçare "Lidhja e Prizerenit" Paskuqan	Punë	Marrëveshje Kuadër	283,206,705	281,000,000	R....	10.08.2022	9 muaj+ 1 muaj projekt
5	Rikonstruksion shkolla "Azem Hajdari "Zall Mner	Punë	Marrëveshje Kuadër	269,364,773	269,064,787	K	20.12.2022	5 muaj
6	Rikonstruksion gjimnazi "Gramoz Palushi"	Punë	Marrëveshje Kuadër	200,201,279	196,189,707	N.	02.11.2022	4 muaj
7	Sistemimi hapsirave publike Zona Valias	Punë	Marrëveshje Kuadër	150,000,000	148,953,230	S.	17.01.2023	7 muaj
8	Loti I -Hartim i projekt idese per RiN n e shkolles 9 vjecare Demokracia.	Shërbim	Marrëveshje Kuadër	1,106,062	1,095,002	"Z	24.03.2022	22 dite
9	Loti II - Hartim i projekt idesë për obj. "Rindërtimin e	Shërbim	Marrëveshje	1,238,435	1,235,270	ID ....."		22 dite

	shkollës 9 vjecare Hali Coka		Kuadër				24.03.2022	
10	Mbikqyrja e shk. 9 vjeçare "Halit Coka(ish shkolla Elez Isufi)".	Shërbim	Marrëveshje Kuadër	4,422,983	3,919,606	ID	29.06.2023	9 muaj
11	Mbikqyrja e shk. 9 vjeçare "Demokracia".	Shërbim	Marrëveshje Kuadër	3,950,223	3,485,491	L.	16.06.2022	9 muaj
11	Mbikqyrja e pun per obj. "Azem Hajdari" Babrru	Shërbim	Marrëveshje Kuadër	4,938,400	4,900,000	E	31.08.2022	9 muaj
12	Mikqyrja e punimeI shkolles 9 vjecare"Lidhja e Prizerenit"	Shërbim	Marrëveshje Kuadër	2,968,835	2,628,536	I	23.08.2022	9 muaj
13	Projekt per Rikonstruksion shkolles "Azem Hajdari" Zall Mner	Shërbim	Marrëveshje Kuadër	6,990,328	5,941,779	N.	01.08.2022	22 dite
14	Mbikqyrja e punimeve per obj.Rikonstr. shkolla "Azem Hajdari "	Shërbim	Marrëveshje Kuadër	2,912,637	2,567,046	H.	06.01.2023	5 muaj
15	Projekt per Rikonstruksiongjimnazi "Gramoz Palushi"	Shërbim	Marrëveshje Kuadër	5,388,743	5,227,080	Z.	01.08.2022	22 dite
16	Mbikqyrja e punimeveper objektin: gjimnazi"Gramoz Palushi"	Shërbim	Marrëveshje Kuadër	2,224,476	1,953,162	Z.	17.11.2022	4 muaj
17	Projekti sistemimit te te hapsirave publike Zona Valias	Shërbim	Marrëveshje Kuadër	5,047,714	5,035,000	A.	27.09.2022	22 dite
18	Mbikqyrja e punimeve per objekt."Hapsira publike Zona valias"	Shërbim	Marrëveshje Kuadër	2,252,057	1,929,001	E.	13.03.2023	7 muaj

Tabela Nr. 2.4.3 Regjistri i Realizimit të Prokurimeve "Blerje me Vlera të Vogla" deri 1,000,000 lekë, në Bashkinë Kamëz për Vitin 2022

NR.	EMËRTIMI I OBJEKTIT	TIPI I KONTRATËS	LLOJI I PROCEDURËS	FONDI LIMIT	VLERA E KONTRATËS (LEKE PA TVSH)	OPERATORI EKONOMIK FITUES	DATA E LIDHJES SË KONTRTËS
1	Baner adeziv	Mall		22,000.00	21,500.00	N.M	08/04/2022
2	Banera për printim	Mall		66,300.00	54,450.00	A.B	24/03/2022
					11,850.00	A.B	24/03/2022
3	Banera për stendat e panairit të Librit	Mall		74,000.00	73,100.00	A.B	09/06/2022
4	Bateri për mikrofona	Mall		10,000.00	10,000.00	A.T	26/05/2022
5	Blerjeelemente dekoripër projektin "Java Europiane"	Mall		50,000.00	48,000.00	A.P	19/05/2022
6	Blerjegaz të lëngshem për gatim në kopshte dhe çerdhe përfshire dhe transporti për çdo objekt	Mall	Small Value	515,200.00	513,380.00	G.G	24/10/2022
7	Blerje bluza me logo dhe stikera me logo në kuadrin	Mall	Small Value	365,844.00	261,979.00	A.G	20/12/2022

	e projektit "Mjedis i pastër, arsim i shëndetshëm dhe cilësor në shkolla"						
8	Blerje bukëthekre + bukë intregale për femijet e kopshteve dhe çerdheve	Mall	Small Value	1,000,000.00	891,000.00	Z.H	16/06/2022
9	Blerje enë guzhine përkopshte+ çerdhe	Mall	Small Value	865,182.00	738,000.00	N.H	28/04/2022
10	Blerje flamuj të vegjel trekëndor	Mall		54,450.00	54,450.00	A.B	25/03/2022
11	Blerje hard -disqe për sisitemin e ruajtjes së të dhënave	Mall		100,000.00	85,500.00	R.K	28/09/2022
12	Blerje kamera dixhitale për shkollen "Hillari Klinton"	Mall		100,000.00	98,000.00	A.	24/05/2022
13	Blerje kompjutera	Mall	Small Value	1,000,000.00	799,990.00	I.	04/10/2022
14	Blerje kompjutera+printer për projektin e çerdhes	Mall	Small Value	378,314.00	314,480.00	A.K	17/02/2022
15	Blerje korniza+Banera+flamuj për pallatin e kultures	Mall	Small Value	373,333.00	272,000.00	S 32	08/09/2022
16	Blerje kuti arshive	Mall		100,000.00	99,800.00	F. Ç	24/06/2022
17	Blerje materiale audio - vizuale për sallen eKeshillit Bashkiak	Mall		100,000.00	96,000.00	B.S	30/12/2022
18	Blerje materiale ndërlidhese elektronike	Mall		100,000.00	97,000.00	A.... P.	30/12/2022
19	Blerje mjete (furçe dhe rulon) për aktivitetin e pikturimit në pedonalen e parkut të liqenit te Paskuqani	Mall		36,000.00	35,291.66	D.	12/05/2022
20	Blerje telajo + bojra +set me penela për pikturë për pallatin e kultures	Mall	Small Value	355,500.00	287,650.00	B. B	08/09/2022
21	Blerje uji të pishëm për kopshtetdhe çerdhetnë juridiksionin e Bashkisë Kamëz	Mall	Small Value	904,000.00	789,950.00	L	28/04/2022
22	Blerje uniforma për Policinë Bashkiake	Mall	Small Value	1,000,000.00	719,000.00	A.	15/08/2022
23	Blerje veshje për punonjesit zjarrfikës	Mall	Small Value	946,000.00	768,000.00	N.H	18/08/2022
24	Blerje yje për zbukurim skeneme rastin e ceromonisësë perurimit	Mall		36,000.00	36,000.00	A.B	10/05/2022
25	Kolaudim punime "Sistemimi i fushave pranë shkolles "Arbëria"	Shërbim		12,023.00	10,439.20	M	30/12/2022
26	Kolaudim punime i shkolles 9 vjecare "Kamza e re"	Shërbim	Small Value	104,666.00	87,825.00	M....	09/02/2022
27	Kolaudim punime per objektin "Ndërtim rrjeti KUN Miqesia. Altruisti, Burimi..." Kamëz 5	Shërbim		35,181.00	32,668.00	M	30/12/2022
28	Kolaudim punime për objektin "Ndërtim rruga Nik Ndreka"	Shërbim		56,198.00	41,742.00	T.	30/12/2022
29	Kolaudim punime për objektin "Punime për ndriçimin e rrugëve"	Shërbim		43,379.00	36,929.00	M	30/12/2022
30	Kolaudim punime për objektin : NdërtimUra Valias-Laknas	Shërbim		99,481.10	94,871.30	M	30/12/2022
31	Kolaudim punime për objektin: " Ndërtim kopështi Kamza e Re"	Shërbim	Small Value	50,271.00	40,114.90	N.	17/02/2022

32	Kolaudim punime për objektin: “Ndërtim i rrjetitit KUN-së dhe furnizimi me ujëzona Valias	Shërbim	Small Value	763,497.00	668,060.22	V.	29/09/2022
33	Kolaudim punime për objektin: “Rikonstruksion gjimnazit "Isa Boletini"	Shërbim	Small Value	265,521.00	220,003.00	"D."	11/08/2022
34	Kolaudim punime për objektin: “Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Niko Hoxha"	Shërbim	Small Value	254,117.00	223,603.43	M.	04/10/2022
35	Kolaudim punime për objektin ndërtimrruga OSBE Kamëz	Shërbim		91,721.61	66,934.70	M	30/12/2022
36	Kolaudim punime për objektin: “Rikonstruksione shkollës “Ahmet Zogu"	Shërbim	Small Value	222,545.00	155,734.50	L.	09/02/2022
37	Kolaudim punime për objektin"Riforcim i njësive të banimit" në ndërtesa (pallat)	Shërbim	Small Value	258,830.00	206,266.72	G	24/10/2022
38	Kolaudim punime për objektin: Ndërtim Kopështi "Ahmet Zogu"	Shërbim	Small Value	82,670.00	66,225.90	N	17/02/2022
39	Kolaudim punime për objektin; "Sistemimi i fushave pranë shkollës"Halit Coka"	Shërbim		19,993.00	17,373.40	M	30/12/2022
40	Kolaudim punime për rrugen ndërtim rruga Azem Galica	Shërbim		98,940.00	88,092.40	N	30/12/2022
41	Kolaudim punime për shkollen e mesme "Ibrahim Rugova"	Shërbim	Small Value	240,493.00	168,361.20	Z	09/02/2022
42	K/trofe + pllakada (me logo) për pallatin e kultures	Mall	Small Value	315,833.00	274,000.00	N.H	12/09/2022
43	Marrje me qera Foni	Shërbim		38,000.00	31,600.00	S 32	23/05/2022
44	Marrje me qera kostome popullore për projektin Java europiana	Shërbim		15,000.00	15,000.00	A.T	19/05/2022
45	Mbikqyrja e punimeve për objektin: Ndërtimtrotuare + Ndriçim Rruga “Jon” + Rruga “Fushë Arrëz”.	Shërbim	Small Value	511,901.20	456,869.66	H.	10/10/2022
46	Mbikqyrja e punimeve për objektin: Nd. Rr.”Albanët” + Rrugicat në Valias + Rr.”Këmbanët” + Trotuaret në Rr.”Amsterdam” Valias i Ri.	Shërbim	Small Value	704,770.70	627,611.20	M....	01/09/2022
47	Mbikqyrje e punimeve për objektin: Ndërtim rruga (Rr.Hamburg+Rr."Ylberi"+Rr."Usaid"	Shërbim	Small Value	800,700.15	722,011.53	"D."	01/08/2022
48	Mbikqyrje e punimevepër objektin : Sistemimi i fushave pranë shkolles "Halit Coka"	Shërbim	Small Value	193,261.20	167,774.61	N	15/08/2022
49	Mbikqyrje e punimeve: Ndërtim rrugët Blloku Babrru Shpat 2 Komplet	Shërbim	Small Value	998,498.86	892,599.50	P.	05/10/2022
50	Mbikqyrje e punimeve për objektin: Sistemim i fushes së sportit të shkolles "Arbëria"	Shërbim	Small Value	114,555.90	99,470.76	N	15/08/2022
51	Mbikqyrje e punimeve per objektin :"N i Ures se Kembesoreve Laknas -Valias"	Shërbim	Small Value	798,832.30	744,238.49	N	12/07/2022
52	Mbikqyrje e punimeve për objektin: "Ndërtimi rikualifikimi urban i rrugës vazhdim i rruges "Harku i Triumfit”	Shërbim	Small Value	388,438.40	343,780.74	T.	08/07/2022

53	Mbikqyrje e punimeve për objektin: Ndërtimi Rrugët Kamza 1,2	Shërbim	Small Value	615,483.50	547,146.59	BN	26/07/2022
54	Mbikqyrje e punimeve për objektin:" Ndërtim rrugët (Rr. "ëilliam Shekspir", Rr."Sami Frashëri",Rr. "Dituria", Rr. "Isuf Gërvalla,"Rr. "Brezaret".....")	Shërbim	Small Value	649,846.30	559,255.28	A.	08/08/2022
55	Mbikqyrje e punimeve për objektin: Nd. Rr. Frutikulturë(Rr. Pingulme Rrugën Azem Galica + Rr."Isuf Gërvalla"+Rr."Brezaret")	Shërbim	Small Value	999,171.03	896,712.40	P.	23/09/2022
56	Mbikqyrje punime për objektin: Ndërtim rruga "Skenderbeu"	Shërbim	Small Value	791,845.30	706,278.34	N.	24/08/2022
57	Mbikqyrje punime për objektin: Ndërtimi i Rrugëve (Rr."Pavarësia e Kosovës"+ Rr."Pashko Vasa"+ Rr."Pishtarët e Demokracisë" + Rr. "Mustafa Qemal Ataturku" + Rr, "AthI"+Rr. "Dubai" Kamëz 2	Shërbim	Small Value	819,918.52	740,392.75	I.	20/09/2022
58	Mbulesa tavoline për diten e panairit të librit	Mall		10,000.00	8,800.00	A.T	20/05/2022
59	Mbushje me gaz kondicionere + montim	Mall		34,000.00	33,750.00	A.	23/06/2022
60	Medalje për fituesit e kampionatit të karatesë	Mall	Small Value	205,000.00	200,000.00	S 32	14/04/2022
61	Mirembajtja dhe zhvillimi i sistemit elektroniktë taksave dhe tarifave vendore	Shërbim	Small Value	800,000.00	800,000.00	B...	24/01/2022
62	Pagesë police sigurimi	Shërbim		30,000.00	29,569.00	E.	23/06/2022
63	Perde	Mall	Small Value	120,000.00	63,000.00	S.SHPK	17/02/2022
64	Print Forez Frezim	Mall		100,000.00	99,800.00	A.B	25/03/2022
65	Pupa për femijët e çerdhes	Mall	Small Value	112,499.00	94,000.00	B.K	17/02/2022
66	Shërbim printimi	Shërbim		100,000.00	99,400.00	A...	07/09/2022
67	Sherbime për skenen dhe orkestracionin për eventin Panairi i librit	Shërbim		45,000.00	20,000.00	I.	20/05/2022
		Shërbim			25,000.00	I.	20/05/2022
68	Sherbimet e internetit	Shërbim	Small Value	1,000,000.00	778,900.00	A.	13/06/2022
69	Siguracion jete për punonjesitzjarrfikës	Shërbim	Small Value	475,000.00	475,000.00	Al.	13/10/2022
70	Siguracion jete për punonjësit e zjarrfikësve	Shërbim	Small Value	575,000.00	575,000.00	Al.	05/04/2022
71	Sigurim kasko	Shërbim	Small Value	140,000.00	139,500.00	E.	17/06/2022
72	Tabela pexikllasi	Mall		12,400.00	10,000.00	A.B	10/05/2022
73	Veprimtari sportive (Akomodim+ushqim) për aktivitetin (Kamza Karate Open 2022)	Shërbim	Small Value	150,000.00	115,000.00	S 32	14/04/2022
74	Shërbim mirëmbajtje printër skaner e fotokopje	Shërbim	Small Value	992,000.00	939,900.00	E.	--

Aneksi nr.2.5. "Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit" nga faqja 251-263 të Raportit përfundimtar të auditimit.

Tabela Nr. 2.5.1. Leje ndërtimi të audituara, për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m^2 .

Nr.	Kategoria	Objekti	Zhvilluesi	Vendimi i lejes	Preventivi (lekë)
1	Leje ndërtimi me sip. më të madhe se 250 m^2	Godinë banimi dhe shërbimi 9 kat me 1 kat nëntokë	"M " SHPK	Vendim nr. 4594 Prot; datë 27.12.2022	356,031,401
2	Leje ndërtimi me sip. më të madhe se 250 m^2	Godinë banimi dhe shërbimi 9 kat dhe 2 kat nëntokë	"A " SHPK	Vendim Nr. 4321 Prot; datë 04.11.2022	715,378,644.84
3	Leje ndërtimi me sip. më të madhe se 250 m^2	Objekt banimi dhe shërbimi, 7, 8, dhe 9 kate me 2 kate nëntokë	"S " SHPK	Vendim Nr. 4551 Prot; datë 07.12.2022	1,769,435,641
4	Leje ndërtimi me sip. më të madhe se 250 m^2	Godinë banimi dhe shërbimi 1, 8 dhe 9 kat, me 1 kat nëntokë	"B " SHPK & "D" SHPK	Vendimi nr.3770, datë 15.02.2022	224,890,337
5	Leje ndërtimi me sip. më të madhe se 250 m^2	Godinë banimi dhe shërbimi 1,7 dhe 8 kat, me 1 kat nëntokë	"E" SHPK & "L" SHPK	Vendimi nr. 4286 , datë 08.09.2022	149 261 224
6	Leje ndërtimi me sip. më të madhe se 250 m^2	Godinë banimi dhe shërbimi 1-2-8-9 kate + 1 kat nëntokë	"A" SHPK	Vendimi nr. 3831, datë 13.05.2022	394,893,561
7	Leje ndërtimi me sip. më të madhe se 250 m^2	Dy objekte banimi dhe shërbimi 9 kate me 1 kat nëntokë	"P" SHPK	Vendimi nr. 4108, datë 16.09.2022	555,467,195
8	Leje ndërtimi me sip. më të madhe se 250 m^2	Godinë banimi dhe shërbimi 9 kate dhe 1 kat nëntokë	"E" SHPK	Vendimi nr. 4155, datë. 15.07.2022	493.555.855,680
9	Leje ndërtimi me sip. më të madhe se 250 m^2	Godinë banimi dhe shërbimi 1, 3. 7 dhe 8 kat me 1 kat nëntokë	"SH" SHPK	Vendimi nr. 4435, datë 29.09.2022	155,785,491

Tabela nr. 2.5.2. Aplikime në sistemin e-lejet për lloje të ndryshme lejesh për vitin 2022

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	142	75	67
Leje për ndërtim të ri, me sip. më të madhe se 250 m^2	50	30	20
Leje për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m^2	50	28	22
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	200	93	107
Leje për rikonstruksion me/pa ndryshim funksioni	45	21	24
Çertifikatë përdorimi	72	57	15
Leje për shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m^2	77	41	36
Leje për shtesë në objekt ekzistues mbi në 250 m^2	11	3	8
Leje për ndryshim projekti gjatë zbatimit	23	10	13
Leje për ndryshim funksioni	7	4	3
Njoftim fillim punimesh	109	80	29
Leje për shtyrje afati të lejes së N	16	11	5
Leje infrastrukture	39	29	10

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTËI SHTETIT